

ENVER HOXHA

VEPRA

70

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË
SHQITËRISË**



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANE KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

·VËLLIMI

70

MARS 1979 — PRILL 1979

.SHTËPIA BOTUESE «S NENTORI»
TIRANË, 1993

PARATHENIE PËR VËLLIMIN E 70-TË

Vëllimi i 70-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përmban diskutime, biseda dhe shënime që i përkasin periudhës dymujore mars-prill 1979. Shumica e tyre botohen për herë të parë.

Tematika që trajtohet në këto materiale është e gjerë dhe e larmishme. Ajo shtrihet në fusha të ndryshme të jetës së Partisë e të vendit. Problemeve politike, ideologjike, ekonomike, ushtarake, të punës së Partisë, si dhe të zhvillimit botëror e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, që gjejnë pasqyrim në këtë vëllim, u bëhet një trajtim marksist-leninist, nga i cili nxirren përfundime teoriko-praktike të rëndësishme me vlera të mëdha për të sotmen.

Problemet ekonomike në tërësi dhe ato të realizimit të planeve në veçanti zënë një vend të rëndësishëm në vëllim. Në disa shkrime nënvizohet ideja që secili dhe të gjithë së bashku duhet t'u përvishen seriozisht punëve për realizimin dhe tejkalimin e planeve, pasi kjo ka të bëjë jo vetëm me forcimin e situatës së brendshme dhe me rritjen e mirëqenies së popullit, por edhe me ruajtjen e forcimin e mëtejshëm të lirisë e të pavarësisë së atdheut tonë socialist, me përballimin me sukses të presioneve të rrethimit kapitalisto-

-revizionist. Realizimi i planeve, nënvizohet në këtë vëllim, kërkon, krahas rritjes së mobilizimit të masave punonjëse, edhe organizim të shëndoshë dhe drejtim shkencor të punëve, kontroll të vazhdueshëm, kërkesë llogarie, studime të thella dhe disiplinë rigoroze në të gjitha hallkat. Pa këto nuk revolucionarizohet prodhimi dhe nuk realizohen planet.

Këto çështje janë objekt i rëndësishëm i punës së organeve e të organizatave të Partisë, të cilat, siç vihet në dukje në vëllim, duhet të merren mirë me këto probleme të mëdha të ndërmarrjeve, institucioneve apo dikastereve, përndryshe në krye të punëve do të vihen administratat, të cilat, në mjaft raste, punojnë me forma burokratike. Aparatet administrative, teknike, si dhe levat e tjera, thekson shoku Enver Hoxha, Partia duhet t'i udhëheqë, t'i vërë në lëvizje që të zbatojnë vijën dhe politikën e saj duke flakur tej konceptet dhe praktikat burokratike.

Me shumë interes dhe me vlera të mëdha aktuale janë idetë e këtij vëllimi për forcimin e vijës së masave dhe të demokracisë socialiste. Masat e gjera punonjëse, vë në dukje shoku Enver Hoxha, duhet ta ndiejnë veten në çdo kohë e në çdo fushë të veprimtarisë shoqërore si një faktor krijues me rëndësi vendimtare. Për çdo gjë, shkruan autori, duhet t'u drejtohem masave, punëtorëve, sepse atyre u dhimbsen milionat që harxhohen për ndërtimin e socializmit, sepse ata kanë mendime, ndaj duhen dëgjuar. Kuadrot e Partisë a të organeve shtetërore, për problemet dhe për punët të takojnë e të bisedojnë jo vetëm me drejtuesit e ndërma-

rrjes, por ca më shumë me punëtorët, sepse nga këta do të merren më mirë dhe realisht situata dhe gjendja e punëve. «Pra, jo të shkohet më parë në drejtorinë e ndërmarrjes, por drejt në repart».

Thellimin e demokracisë socialiste, shoku Enver Hoxha e sheh të domosdoshëm veçanërisht në zbatimin e politikës së Partisë për kuadrin. Për asnjë problem, por sidomos për probleme kuadri, për marrjen dhe vendosjen në punë të specialistëve dhe të punëtorëve, thekson ai, askush nuk ka të drejtë të vendosë personalisht. «Nuk mund të merren e të vendosen në punë kuadro dhe punëtorë sipas qejfit të njërit apo të tjetrit» vihet qartë në dukje në vëllim. Ky problem, nënvizohet aty, diskutohet, rrihet gjerë e gjatë dhe në bazë të nevojave konkludohet e vendoset kolegjisht, duke marrë mendimin e masave.

Me një theks shumë aktual janë edhe idetë për zbatimin e përsosjen e procedurave demokratike të zgjedhjeve në Parti. Këto, theksohet në vëllim, nuk duhet të jenë formale. «Nuk është me vend të mendohet se caktohen që më parë se kush do të zgjidhet në këtë ose në atë forum partie, pasi kjo praktikë nuk është as demokratike, as revolucionare, bile është e dëmshme edhe për Partinë, në radhë të parë, por edhe për personin që zgjidhet». Asgjë nuk duhet t'i pengojë komunistët që të thonë në mbledhje atë që mendojnë për njërin ose për tjetrën kandidaturë, të shprehën se nuk janë dakord të zgjidhet ai që propozohet, bile edhe të propozojnë kandidatura të tjera. Këto mendime e propozime, sqaron shoku Enver Hoxha, hidhen

në balancë, diskutohen, peshohen dhe vlerësohen nga mbledhja.

Kështu luftohet formalizmi në zgjedhjet në Parti, që duket në ato raste kur paraqiten listat e kandidaturave dhe, pa asnjë diskutim, nën petkun e disiplinës së Partisë, miratohen ato. Në qoftë se komunisti ka një mendim tjetër nga ai i komitetit për kandidaturat, kjo nuk e cenon aspak unitetin e Partisë, nuk e shkel disiplinën dhe demokracinë në Parti, përkundrazi, i ngre ato në një shkallë më të lartë.

Në disa shkrime të vëllimit trajtohen probleme të përmirësimit të punës për përgatitjen ushtarake të popullit në të gjitha strukturat e forcave tona të armatosura. Theksi vihet në përsosjen e punës në shkollat e lira ushtarake dhe sidomos në rritjen e efektivitetit të bashkëpunimit midis terrenit dhe ushtrisë, për revolucionarizimin e stërvitjes, të kuadrove të ushtrisë etj.

Në vëllim gjejmë edhe analiza për mjaft probleme të situatës ndërkombëtare të kohës, të politikës luftënxitëse e neokolonialiste të superfuqive në rajone të ndryshme të botës, të gjendjes në vendet revizioniste të Evropës Lindore, në të cilat, siç theksohet në vëllim, nuk ndërtohet socializmi, por ecet drejt rivendosjes së kapitalizmit. Konkluzionet që nxjerr udhëheqësi i Partisë janë të lidhura ngushtë me detyrat që dalin para njerëzve tanë për t'i kuptuar drejt e në kohë situatat, për të jetuar intensivisht me to dhe për t'i përballuar me forcë deri në fund.

Mësimet që gjenden në materialet e këtij vëllimi

mbajnë vulën e kohës kur janë shkruar, por ato përmbajnë vlera të mëdha aktuale, u përgjigjen edhe situatave të sotme. Ato u shërbejnë forcimit dhe revolucionarizimit të pandërprerë të punës së Partisë, të shtetit e të masave punonjëse, thellimit të vazhdueshëm të vijës së masave e të demokracisë socialiste, zgjidhjes së detyrave që shtron vazhdimisht Partia për perspektivat e zhvillimit tonë të pavarur socialist.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

TË INKURAJOJMË NJERËZIT KUR PUNËT SHIKOJNË MIRË, POR TË MOS FSHEHINI TË METAT, TË MOS LUSTROJMË GJËRAT

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

7 mars 1979

Pasi shoku Prokop Murra informoi për disa probleme në sektorin e naftës, e mori fjalën shoku Enver Hoxha, i cili tha:

Edhe në sektorin e naftës, siç u tha, ka raste që çalon bashkërendimi i punëve. Shokët e shpimit, për shembull, mund ta bëjnë punën në mënyrë të shkëlqyer, por kjo s'ka shumë vlerë, kur të tjerët nuk bëjnë projekte e nuk marrin masa për të siguruar në kohë tubacionin. Natyrisht, mungesa e koordinimit në sektorin e naftës është shumë e dëmshme për ekonominë tonë dhe shkaktarë për këtë janë shumë nga njerëzit që punojnë atje, mendoj unë. Këtë çështje duhet ta shikojë me kujdes Partia në këtë sektor se nuk mund ta ndjekë siç duhet njëri ose tjetri prej nesh që vete një herë në muaj. Prokopi, fjala vjen, kur shkon atje, mund të

shikojë që, për mungesë të bashkërendimit, diku puna nuk ecën dhe këtë konstatim mund ta thotë, siç e ka thënë. Por, ajo që ka më tepër rëndësi është fakti që duhet gjetur pse na ngjasin këto. Duhet të ketë më shumë iniciativë dhe këmbëngulje nga organizatat-bazë të Partisë të sektorit të naftës për këto punë. Edhe nga punëtorët atje duhet të ketë kërkesë llogarie dhe të fortë bile, që të mos bëhet vetëm si thotë ai apo ky kuadër a specialist, por të bëhet si thonë edhe ata. Kjo ka rëndësi të madhe, prandaj, jo vetëm që punëtori duhet të flasë, por, nën drejtimin e Partisë, ai t'i shkundë edhe gjithë ata njerëz që s'punojnë.

Koordinimi i mirë i punës kërkon që secili të kryejë me përpikëri detyrat e veta. Instituti për shembull nuk ka përgjegjësi për shfrytëzimin pse i thotë drejtorit të shpim-shfrytëzimit që këtu apo atje mund të dalin tri shtresa. Kaq mund t'i thotë, pastaj i takon drejtorit të shpim-shfrytëzimit të marrë masa për të shfrytëzuar tri shtresat. Në qoftë se këto masa nuk merren, i duhet kërkuar këtij llogari dhe jo të tjerëve.

Detyrat janë të qarta dhe ato i dinë të gjithë. Edhe ai brigadieri që pyete ti, Prokop, i di të gjitha këto, edhe inxhinierët që janë atje, gjithashtu, i dinë, por nuk i zbatojnë kurdoherë vetëm sepse u mungon një organizim i shëndoshë i punëve. Nga kjo mungesë humbasim kohë, humbasim vlera, humbasim flori.

Rrëmuja që është vënë re në disa raste në sektorin e naftës mund të shkaktohet nga disa arsye: ose bëhet posaçërisht që të mos na japin naftë, siç bënë sabotatorët dhe kjo është më e keqja, kurse më pak e keqja

është kur mendojnë që naftë nuk ka, prandaj është e kotë të shpohet; ose ka një çorganizim të madh, ku s'merret vesh se ç'bëhet; ose nuk ekzistojnë mjetet e nevojshme. Të tëra këto janë të mundshme, por kryesorja, më duket, është mungesa e organizimit. Në qoftë se do të forcohet ana organizative, do të sigurohet çdo gjë në kohën e në vendin e duhur, dhe nuk do të na ndodhin të tilla gjëra.

Që të mos bëhet rrëmujë në një uzinë, punëtori vete që në mëngjes dhe i çon të gjitha materialet aty ku duhet, e çon lëndën e parë pranë tornos dhe, pa humbur kohë, fillon drejt në punë. Edhe në sektorin e naftës kështu duhet të jetë. Për të vajtur në thellësinë 3 000 e ca metra duhen disa muaj, prandaj shokët e shfrytëzimit në mos e bërshin menjëherë projektin e futjes së tubave, ta fillojnë atë një muaj e gjysmë përpara dhe tubat të gjenden, ku janë e ku s'janë, e të çohen në vend 20 ditë përpara.

Mungesat që vihen re në organizimin e punës në sektorin e naftës janë shqetësuese, e, megjithatë, disa nga kuadrot, mjeshtrit dhe punëtorët e këtij sektori, të cilët duhet të jenë shembull, nuk marrin masat e duhura në këtë drejtim. Ku e ka burimin kjo gjë? Derisa punëtori shkon për të shpuar në një zonë, ai mund të punojë më javash, por ai mund ta organizojë mirë punën, ta vendosë sondën, të fillojë shpimin duke punuar me turne etj. Pra, mundet që punëtori nuk e realizon normën, por sidoqoftë punën e organizon. Për materialet e tjera që duhet të vijnë medoemos, punëtori duhet të shqetësohet: pse mungon kjo apo ajo gjë, pse çalon

organizimi dhe kush e shkakton këtë çorganizim? Pse punëtori i shpimit nuk i kërkon llogari atij tjetrit që nuk merr masa me kohë për vendosjen e tubave? «Ne këtu do të marrim gaz, — t'i thotë ky atij, — dhe këtë gaz duhet ta çojmë diku, se për këtë kemi disa qendra, siç janë ajo e gazit metan, e gazit me squfur, e gazit të thatë e të tjera. Atëherë, të marrim masa që, në qoftë se do të na dalë, ta futim atje ku duhet me shpejtësi të madhe».

Drejtuesit e këtij sektori na thonë tani se në disa ndërmarrje sasia e planifikuar e naftës nuk merret. Natyrisht, s'ka si të merret, përderisa në disa puse ndodhin avari; në disa të tjera, ku duhet të vendosen 20 sonda, nuk kryhen punimet sizmike e gjcologjike në kohë dhe sondat rrinë pa punë. Ka dhe nga ata që të gjitha këto, ngaqë nuk bien në sy, përpiqen t'i fshehin. Po a mund të fshihet dielli me shoshë? Unë jam i bindur se, po të bëheshin të gjitha punët siç duhet, do të merrnim jo aq sa është marrë, por edhe më shumë naftë.

Ne në asnjë mënyrë nuk i ulim vlerat reale, kur zbulojmë hapur dobësitë dhe gabimet. Përkundrazi, po të mos i zbulonim të metat, do të kishim pasoja të rënda në çdo drejtim. Por, ç'na ndodh në ndonjë rast? U përgatit një përrshëndetje drejtuar Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë, në të cilën thuhej që forcat e Lushnjës dolën në stërvitje në mënyrë të shkëlqyer! Po kujt ia shkruanin këtë? Pse për këto kemi nevojë ne?! Në përrshëndetje shkruhej se të gjithë jemi gati të vdesim në këmbë, se çdo gjë shkoi në mënyrë të shkëlqyer

etj.! Po gabimet që janë bërë atje nga do t'i marrë vesh Komandanti i Përgjithshëm? Pse nuk na i shënojnë edhe këto atje? Unë nuk e kundërshtoj që në disa drejtime puna mund të ketë shkuar mirë, por ama nuk përjashtohet të ketë pasur edhe dobësi, të meta e gabime. Të inkurajohemi për ato që kanë shkuar mirë, po të mos fshehim të metat, të cilat, kur i njohim, do të marrim masa që të zhduken. Nuk është e drejtë të shkruhet një faqe e gjysmë hosanara, si në këtë rast. Si vajtkan punët «shkëlqyeshëm» dhe pa asnjë të metë?! Nuk më bindin ato lustra. Jo, mua nuk më zë gjumi nga shkëlqimi i sipërfaqshëm i gjërave, përkundrazi jam i shqetësuar kur faktet mbulohen me luster. Sa më të zbukuruar të ma paraqesin diçka që nuk vete si duhet, aq më i shqetësuar jam.

Pse na i fshehin të metat për stërvitjen e Lushnjës, apo që të bien në gjumë të gjithë oficerët dhe ushtarët? Po të veprohet kështu, kur të vijë momenti i rrezikshëm, atdheut do t'i kanoset katastrofa¹.

A mund të themi ne që kemi nxjerrë naftën e dynjasë, po bëjmë ashtu e kështu, kur kjo nuk është e vërtetë?! Në qoftë se kanë punuar në mënyrë të

1. Siç u vërtetua më vonë, një nga taktikat e Mehmet Shehut ishte të lustronte gjendjen para Partisë për të mbuluar veprimtarinë e tij armiqësore. Kështu veproi ai edhe me stërvitjen ushtarake të Lushnjës, në të cilën u vërtetuan një varg dobësish e të metash të theksuara në organizimin dhe në zhvillimin e saj, kurse armiku Mehmet Shehu i raportonte udhëheqjes së Partisë për «zhvillimin e një stërvitjeje të shkëlqyeshme».

shkëlqyer naftëtarët e një zone apo të një ndërmarrjeje, kjo nuk do të thotë se s'ka të meta në metodën e punës për drejtimin e sektorit të naftës.

Le të kalojmë në një çështje tjetër.

Kam kërkuar të di se kush mund të shkruajë më mirë për ngjarjet dhe për historinë e Luftës sonë Nacionalçlirimtare. Për këtë kam pyetur edhe herë tjetër, po e përsëris edhe tani.

Lufta Nacionalçlirimtare filloi nga njësitet guerile, pastaj u formuan çetat partizane, batalionet, brigadat. Unë si pjesëmarrës në këtë luftë, si Komandant i Përgjithshëm, por për një kohë edhe Komisar Politik i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e di se si u krijuan brigadat partizane. Ato u krijuan kur ushtria ishte ngritur në këmbë. Shtabi i Përgjithshëm hartoi një plan të posaçëm për krijimin e tyre njëra pas tjetrës, duke porositur dërgimin nga vise të ndryshme të vendit të një numri të caktuar partizanësh, me të cilët u krijuan brigadat. Para se të formoheshin këto, lufta zhvillohej nga batalionet e çetat territoriale, që ishin mjaft aktive. Njësitet e Luftës Nacionalçlirimtare kanë luftuar edhe në prapavijat e armikut, sidomos çetat kanë bërë kërdinë mbi armikun. Kështu është rrjedha e ngjarjeve. Në luftë ka pasur bashkëpunim të ngushtë edhe në mes brigadave e batalioneve me terrenin.

Sot lexova një artikull¹, që fliste për Brigadën e

1. Botuar në gazetën «Bashkimi», me titull «Fitore për partizanët, humbje për armikun».

Parë Sulmuese. Kam mendimin që për çdo brigadë duhet të flitet sa e si duhet dhe të mos dalë sikur çdo gjë është bërë nga Brigada e Parë, kurse të tjerat kanë qenë anësore, se nuk është ky realiteti i luftës sonë. Nuk kam asgjë subjektive as për Brigadën e Parë, as për të Katërtën, apo për të Tetën, se për të tjerat nuk flitet fare, por shqetësohem për ruajtjen e përmasave dhe të objektivitetit shkencor. Brigada e Parë Sulmuese, thuhet në artikull, vjen nga Qafa e Dervenit, nga Qafa e Gjarprit nëpër borë, nëpër shi, nëpër tufan, nëpër këto apo ato kushte, hyn këtej e del andej dhe paska marrë vesh nga batalioni «Reshit Çollaku» (kjo gjë nuk ka shumë rëndësi) që në Dunicë ishin mbledhur edhe hanin pula e pinin raki rreth 500 ballistë. Komandanti i tyre, sipas atij që shkruan artikullin, qenka zënë rob në një ferrë dhe një partizan i vogël, na e paska vënë përpara! Një çunak i vogël partizan e vë përpara komandantin e ballistëve! E po kjo ç'është?! Me Haki Blloshmin ne kemi luftuar, por ai nuk e linte veten sa ta zinte rob një i vogël! Fakt është se në Dunicë luftuan partizanët. Ishte batalioni «Reshit Çollaku» ai që i rrethoi dhe i mundi armiqtë aty dhe jo vetëm një pjesë e forcave të Brigadës së Parë.

Nuk lejohet të dalin artikuj të tillë. Ato që shkruhen duhen vërtetuar, duke ruajtur edhe përmasat. Nuk jam dakord me mënyrën se si shkruhet tani për luftimet. Ne nuk kemi luftuar me armiq fare të dobët, me kope. Se në qoftë se lufton me kope, nuk tregohet

ndonjë trimëri. Po të paraqiten gjërat kështu, ne i japim Luftës Nacionalçlirimtare një pamje që nuk e meriton. Shkruhet në një vend se ballistët pasi e panë keq, nga maja e xhamisë nxorën shaminë e bardhë! Në këtë mënyrë, duke dashur ta demaskojmë armikun si frikacak, teprohet aq shumë sa që ulim luftën heroike dhe përpjekjet e njësiteve tona partizane në përleshjet me armiqtë. Pastaj, po të shkruajmë vetëm për një njësi të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, si në rastin që përmenda për Brigadën e Parë, atëherë lind pyetja: «Po batalionet në Gorë e në Opar çfarë bënin kur po përgatitej që të sulmohej kjo krahinë? Flinin këta?». Jo, doemos nuk është kështu, ata kanë luftuar me heroizëm.

Të shkruash kështu për këto gjëra nuk vete. Do të lejojmë ne që ta shkruajnë në këtë mënyrë historinë e Luftës Nacionalçlirimtare?! Unë nuk jam dakord të veprohet kështu. Duhet vënë rregulla për këto punë. Historia e lavdishme e Luftës Nacionalçlirimtare të shkruhet që nga kreu deri në fund, duke njohur të vërtetën se lufta filloi me njësite të vogla, të cilat u rritën e u bënë brigada, u bënë divizione, u bënë korpamata etj. Nuk mund të shkruhet historia duke i paraqitur ngjarjet me lustër, por t'i themi ashtu siç janë. Nuk është e drejtë që sa vjen një përvjetor dhe del ndonjë që këput fët e fët një artikull me «historira»! Unë mendoj se shkrimet për Luftën Nacionalçlirimtare duhen kontrolluar mirë. Prandaj të jemi shumë të shtrënguar në kërkesat për këto shkrime, të

jemi dakord me ato që janë të vërteta e të drejta, por edhe të qëndrojmë në opozitë kur nuk janë të tilla.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e incizuar, që gjendet në AQP*

SHTYPI ËSHTE NJË FORCË ORGANIZUESE E MOBILIZUESE PËR ZBATIMIN E DETYRAVE

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

9 mars 1979

Në këtë takim, sekretarët e Komitetit Qendror biseduan për disa probleme dhe detyra në fushën e propagandës së Partisë. Shoku Enver Hoxha foli për rolin organizues e mobilizues të shtypit, duke u ndalur veçanërisht në disa aspekte të metodës e të stilit të punës për një shfrytëzim dhe përdorim më efektiv të tij për zgjidhjen e problemeve që ngre jeta e përditshme në vendin tonë.

Nganjëherë, një nga shokët e sektorit të shtypit më bën një përmbledhje të artikujve e të shkrimeve kryesore, që botohen në gazetat qendrore, si «Zëri i popullit», «Bashkimi» e, sipas rastit, edhe të ndonjë shkrimi nga gazetat e tjera, si «Drita», «Luftëtari» etj., megjithëse që në mëngjes shtypin unë e lexoj edhe vetë, se nuk më rrihet derisa të dal në zyrë.

Natyrisht, problemet që trajtojnë organet tona të shtypit janë të njohura për ne e, kur them kështu, kam parasysh kuadrot që nga dikasteret, aparatet e Partisë e deri tek aparati i Komitetit Qendror, që janë në dijeni të të gjitha problemeve, si dhe të vendimeve të Qeverisë për çështje të ndryshme. Por jeta e përditshme tregon se ka kuadro që, megjithëse problemet e vendimet i njohin, nuk dinë ta organizojnë punën si duhet dhe të marrin masa për t'i zbatuar vendimet e për të shëndoshur gjendjen.

Kështu, është folur vazhdimisht për makineri «të tepërta», të cilat duhet të riparohen e të vihen në dispozicion të ndërmarrjeve që kanë nevojë për to e megjithëse janë marrë masa serioze, janë bërë edhe kontrole, përsëri ky problem na del përpara, se, me sa duket, për këto makineri, në praktikë, nuk tregohet nga të gjithë kujdesi i madh që meritojnë. Prandaj u bë mirë që ky problem me rëndësi u ngrit në një artikull dhe unë mendoj që të mos mbetemi me kaq, por vazhdimisht të shkruhet për të.

Drejtori i ndërmarrjes, që ka lënë pa i futur në punë disa makineri, të cilat i quan «të tepërta», duhet ta kuptojë se, kur problemi i këtyre makinerive ngrihet me forcë në shtyp, për këtë çështje organet e shtypit i ka vënë në dijeni ministria. Megjithatë, ai as që merret me këtë problem. Pas një muaji shkruhet një artikull tjetër po për këtë gjë. «Pse shkruhet»? — duhet t'i bëjë pyetjen vetes ky drejtor. «Shkruhet që të më shkundë mua, sepse nuk e kam zbatuar si duhet vendimin e Qeverisë», do të mendojë ai. Kështu që

përnjëherë ai me pesë ose me gjashtë specialistë të ndërmarrjes duhet të venë një ditë të tërë të interesohen e të kontrollojnë gjendjen e këtyre makinerive në magazinë dhe në ç'sasi janë ato. Mbasi të kontrollojë mirë gjendjen, kur e shikon se nuk është në rregull, mbledh specialistët dhe u kërkon llogari se si kanë vepruar ata për zbatimin e vendimit të Qeverisë, që u punua edhe në ndërmarrje. Mundet që ata artikullin e parë të gazetës nuk e kanë punuar fare, por më mirë vonë se kurrë. Kështu që, kur del në gazetë artikulli i dytë për këtë problem, ata menjëherë të zgjohen, të shkunden dhe të zbatojnë vendimin. Si ky ka edhe probleme të tjera, që duhen rrahur seriozisht në organet e shtypit tonë, me qëllim që të ndiqen vazhdimisht nga organet përkatëse e të gjejnë zgjidhje.

Problemet e rëndësishme, natyrisht, duhen ndjekur me përgjegjësi nga sektorët përkatës në organet e Partisë e të pushtetit dhe një nga faktorët që ndihmon për të bërë një punë më të mirë në këtë drejtim, është edhe shfrytëzimi i shtypit. Po sa shfrytëzohet shtypi? Jam i sigurt që po t'i pyesësh, për shembull, punëtorët e një ndërmarrjeje se për çfarë bën fjalë një shkrim i rëndësishëm i gazetës, shumë prej tyre nuk do ta dinë. Edhe kur shtypi ngre një çështje, ajo u duket e njohur njerëzve që e lexojnë, se ata nuk thellohen në atë që trajtohet në gazetë e nuk reflektojnë në punën e tyre.

Detyra kanë këtu edhe instruktorët e sektorit të shtypit, të cilët qoftë me komitetet e Partisë të rretheve, qoftë me dikasteret këtu në qendër duhet të

ndjekin e të kontrollojnë si shfrytëzohet konkretisht shtypi, sa lexohen dhe sa diskutohen artikujt që flasin për rrethin apo për sektorin e tyre. Në qoftë se konstatohet që artikujt nuk lexohen e nuk punohen menjëherë, atëherë punonjësi i aparatit të Komitetit Qendror i tërheq vëmendjen për këtë qëndrim indiferent ndaj shtypit dhe jep porosi që problemet e ngritura në shtyp të gjejnë zgjidhje duke marrë menjëherë masat e nevojshme. Pra, e kam fjalën që për kritikën që bëhen në shtyp të gjithë të reflektojnë menjëherë.

Instruktori i sektorit të shtypit në aparat duhet të interesohet se si shfrytëzohet shtypi, sepse ky ka rëndësi të madhe. Ai vë në lëvizje njerëzit për t'i çuar punët përpara, ndryshe pse i nxjerrim gazetën.

Është botuar një artikull sot në gazetën «Zëri i popullit»¹ që flet për evidencat. Aty thuhet sikur këtyre po u shtohen kolonat e po mbufaten. Edhe evidencat e Komisionit të Planit të Shtetit, siç i kemi parë ne vetë, mezi lexoheshin, prandaj edhe i kemi reduktuar. Mendoj që ne kemi nevojë për evidencë, se pa ato puna e aparateve tona do të karakterizohet nga anarkia. Por këto shërbejnë vetëm në qoftë se mbi to punohet seriozisht në dy drejtime: në drejtimin shkencor dhe në drejtimin praktik. Në qoftë se nuk punohet në këto dy drejtime, evidencat nuk do të kenë vlerë. Natyrisht, ne nuk duam evidencë të shum-

1. Është fjala për artikullin «Të përsosim evidencën dhe jo ta mbufatim».

ta, se këto janë për studiuesit, për ata që merren me anën teorike të problemeve dhe jo për ata që duhet të jenë udhëheqës, drejtues aktivë, të gjallë, të cilët sa të marrin një evidencë, duhet ta lexojnë, të arrijnë në një konkluzion dhe të veprojnë për të zgjidhur probleme që dalin nga këto evidenca.

Evidencat, sigurisht, dërgohen deri në Qeveri, por kjo nuk ka mundësi t'i ndjekë vetë drejtpërdrejt problemet që ngrihen në to. Prandaj secili që merr evidencë, e studion atë dhe ndjek konkretisht problemet dhe detyrat që i takojnë.

U bë kaq kohë që Byroja Politike dhe Qeveria morën vendimin që të hiqen nga prodhimi mbi 1000 kuadro inxhinierë e specialistë për të studiuar shumë probleme aktuale e të perspektivës në fushën e ekonomisë. Po gjithë këtë mori kuadrosh nuk kam dëgjuar që t'i ketë mbledhur ndonjëherë ministria për të diskutuar për ndonjë artikull që flet për revolucionin tekniko-shkencor. Merret me mend atëherë sa i ka mbledhur punëtorët sekretari i organizatës së Partisë në një ndërmarrje për të diskutuar për problemet që trajton shtypi! Ka edhe ndonjë drejtor ndërmarrjeje, të cilit i është folur shumë për makineritë «e tepërta», që gjoja mbahen rezervë dhe po prishen nëpër magazinat e ndërmarrjes, që s'e vret mendjen e s'e vë ujin në zjarr për t'i riparuar e për t'i vënë ato në vend, por kënaqet duke i dërguar evidenca ministrisë.

Kur e pyeta instruktorin e shtypit se si e kontrolloni dhe si e ndiqni ju leximin e shtypit, sidomos të artikujve direktivë, ai m'u përgjigj se kudo bëhet një

lexim i thjeshtë një çerek ore i gazetës dhe se nga sektori kanë vajtur edhe në komitetet e Partisë në rrethe kur është shtruar çështja e shfrytëzimit të shtypit, ku kanë dëgjuar se si praktikohet një gjë e tillë, kanë dhënë edhe mendimet e tyre.

Në komitetin e Partisë të rrethit ka një instruktor në sektorin e edukimit që përgjigjet për problemet e shtypit. Pra, kur merret në analizë çështja e shfrytëzimit të shtypit, ky shok e bën raportin? Po mbi ç'bazë e përgatit ai këtë raport? Me siguri instruktori i ngarkuar për shtypin, e shumta që mund të ketë bërë është se ka vajtur në ndonjë kooperativë bujqësore, të cilën e ka afër, dhe atje ka pyetur si e lexojnë gazetën. Pasi i kanë treguar se si e lexojnë dhe ai ka thënë ndonjë fjalë, ka ikur. Të nesërmen ka vajtur përsëri aty afër në ndonjë ndërmarrje, ku ka pyetur vetëm sa për të kaluar radhën. Ka përgatitur materialin nga zyra dhe pastaj në mbledhje të sekretariatit të komitetit të Partisë të rrethit gjoja diskutohet për këtë problem. Megjithëse bëhet dhe plenumi në rreth për këtë çështje, përsëri ky problem vazhdon të qëndrojë i varur.

Duke gjykuar nga ato që vihen re në praktikë, mua më duket se duhet menduar më seriozisht për punën me shtypin. E kam fjalën që për problemet që ngre ai të veprohet më mirë dhe më shpejt. Në këtë drejtim duhet parë roli i tij, që është jo vetëm edukues, por edhe kujtues, nxitës, mobilizues, në kuptimin që të shtyn të marrësh masa për të përmirësuar gjendjen.

Kur lexon në gazetë se ndër dy kooperativat bujqësore të rrethit të Lushnjës, për shembull, që janë afër njëra-tjetrës e në kushte të njëjta, njëra merr rendimente të larta e tjetra më të ulëta, të duket se ky është një artikull i rëndomtë. Pse? Sepse problemi që trajtohet atje është rrahur vazhdimisht dhe jo vetëm në gazetë, por në gjithë sektorët e bujqësisë në vendin tonë, në kooperativa, në brigada, në skuadra etj., etj. dhe mund të krijohet mendimi i gabuar që ky problem është aq i njohur, sa kot shkruhet për të në gazetë! Por jo, nuk shkruhet kot. Vërtet problemi është i njohur, por artikulli nuk shkruhet për të mbushur gazetën; ai ka për qëllim që edhe të kujtojë të prapambeturin për këtë çështje. Prandaj me të marrë gazetën secili duhet ta studiojë artikullin, dhe, kur them ta studiojë, kam parasysh që duhet ta zbërthejë dhe të pyesë veten pse ngrihet ky problem. Kur të gjejë përgjigjen, atëherë të marrë menjëherë masa në të gjitha ato drejtime, ku puna çalon, për të dalë nga prapambetja.

Në të gjitha hallkat duhet ndërtuar një punë serioze, ndryshe do të kemi mosrealizime, të meta e gabime që vazhdojnë nga viti në vit. Me organizimin e mirë të punës, me kërkesën e fortë të llogarisë dhe me kontrollin e zbatimit të detyrave, ne evitojmë shumë të meta.

Partia i këshillon e i edukon njerëzit, por ajo është edhe vigjilente ndaj çdo veprimi dhe i shohit mirë çështjet. Ndodh që ndaj shkeljeve të disiplinës në punë edhe abuzohet me vijën e drejtë të Partisë, e

cila kurdoherë këshillon e nuk është e prirë për masa administrative në të tilla raste, por kjo nuk do të thotë që kur njëri e ka mbushur kupën, të mos merren masa kundër tij.

Duke e ditur se Partia është kundër masave administrative të shpejtuara lidhur me këto çështje, ndonjë njeri i paformuar e i pandërgjegjshëm, kur vjen puna që t'i kërkohet llogari për këtë ose për atë detyrë të perealizuar, përpiqet të kalojë fare lehtë, me një autokritikë formale me pesë fjalë. Ata që e dëgjojnë nuk i kërkojnë më tej llogari dhe me kaq mbyllet çështja. Ai vazhdon punën ku është, rrogën e merr e të gjitha të drejtat i gëzon. Ka disa që këtë e quajnë normale, se, fundi i fundit, thonë ata, mjaft e kishte një vërejtje, nuk kishte pse ta hiqnim, se kanë qenë të tjerë që kanë pasur edhe më shumë të meta dhe nuk janë hequr, bile më vonë, mund të dalë ndonjë që edhe ta rekomandojë për ta ngritur në përgjegjësi. Edhe kështu mund të ngjasë. Prandaj, po e përsëris, në këto raste, më duket se po abuzohet me vijën e drejtë të Partisë. Ne nuk do të largohemi nga kjo vijë, por në të njëjtën kohë do të jemi ekzigjentë në kërkesën e llogarisë.

Unë, shokë, mendoj se në raste të tilla, të pandërgjegjshmit duhen ndëshkuar për dëmin që shkaktojnë, duke i shtrënguar edhe më tepër masat e zhdëmtimit dhe forcimin e përgjegjësisë materiale që parashikon ligji. Duhet parë mirë kjo çështje, për arsye se po abuzohet në këtë drejtim dhe nuk kuptohet drejt politikisht dëmi i shkaktuar. Pra, ka nga ata që i bëjnë këto

gjëra dhe nuk duan ta kuptojnë problemin në aspektin se sa dëme i sjell neglizhenca e tyre ekonomisë, megjithëse kjo u është vënë shumë herë në dukje. Ata vazhdojnë të shkaktojnë dëme, sepse materialisht nuk preken, ose preken shumë pak. Në fillim, kur ne i kemi marrë këto vendime, kryefamiljari, i vetmi që ishte në marrëdhënie pune, mbante në kurriz gjashtë ose shtatë veta për të ushqyer dhe merrte një pagë relativisht të vogël. Në qoftë se ai prekej pak materialisht, domethënë në rast se do ta zhdëmtonte, një gjë e tillë do të bëhej problem për familjen, pse rëndonte mbi të. Kurse tashti në një familje me fëmijë të rritur, këta janë në marrëdhënie pune e, po të ketë edhe pleq, ata kanë pension. Në vendin tonë janë të pakta ato familje ku nuk merren tri rroga dhe në një të tillë familje nuk ka më tepër se dy apo tre fëmijë të vegjël. Ne kemi krijuar çerdhe e kopshte, për të lehtësuar mbajtjen e fëmijëve, mjekimin e të sëmurëve e kemi falas, qiranë e banesës fare të lirë. Në këto rrethana, gjendja ekonomike, aktualisht është ngritur. Prandaj, në qoftë se nuk bën detyrën dikush në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të saj, i sjell dëm ekonomisë, ai duhet të detyrohet të zhdëmtojë arkën e shtetit në bazë të ligjit, duke i mbajtur një pjesë të pagës për atë kohë sa të shlyhet dëmi.

Kur merret një masë e tillë zhdëmtimi ndaj njërit, si i detyruari me zhdëmtimin, ashtu edhe të tjerët, medoemos duhet ta kuptojnë se ajo është në interesin e shoqërisë. Punëtorëve, në raste të tilla, u

duhet shpjeguar politikisht problemi dhe ata me siguri do të na përkrahin. Jam i mendimit se duhen shikuar masat e zhdëmtimit ekonomik, të mos qëndrojmë në ato që kemi vendosur shumë kohë përpara. Kjo gjë të shihet, sidomos, për ata sektorë, ku rëndësia e prodhimit, rëndësia e vigjilencës duhet të jetë e madhe, ndryshe Partia, shteti, klasa punëtore, që punojnë e derdhn djersë, do të subvencionojnë me këtë mënyrë indiferentizmin, liberalizmin, sabotimin e armiqve ose dëmet e elementëve të pandërgjegjshëm në punë. Pse të vuajë gjithë vendi e shoqëria për shkak të njërit ose të tjetrit, që nuk do të punojë si të gjithë? Gabimet le t'i vuajnë vetë njerëzit që i bëjnë, cilëndo qofshin ata, punëtorë ose drejtorë. Në këtë rast, kur punohet me cilësi të dobët, puna shikohet nga kontrollori i cilësisë. Në qoftë se tërë brigada e ka bërë punën me cilësi të dobët, është tjetër gjë, i kthçhet mbrapsht puna gjithë brigadës, por në qoftë se atje janë dy veta që punojnë keq, puna duhet t'u kthehet vetëm atyre të dyve.

SHOKU PROKOP MURRA: Dhe ta bëjnë pa pagesë.

SHOKU ENVER HOXIIA: Pa pagesë, natyrisht. Me një fjalë ky është një problem që duhet parë, sepse e theksova që kjo punë edukative, politike dhe ideologjike që bën Partia, është në rrugë të drejtë, por janë disa njerëz që abuzojnë në këtë drejtim. Askush s'duhet favorizuar, secili të dënohet për dëmin që i ka shkaktuar shoqërisë. Kështu që për herë tjetër pësimi t'i bëhet mësim.

Të mos u bëhen lëshime njerëzve që dëmtojnë ekonominë, sepse kështu ndikohet negativisht edhe tek të tjerët. Nga lëshimet që bëhen lind edhe indiferentizmi, sepse dikush, kur e shikon që ky ose ai person bën një dëm të tillë dhe ndaj tij nuk merren masa për zhdëmtim, ose kur atij tjetrit i hiqet vetëm një vërejtje etj., etj., krijon një mentalitet të tillë: të mos bëj gabim unë vetë, pa për tjetrin s'ka ç'më duhet mua. Nuk e kupton ai që gabimi i tjetrit dëmton edhe atë, prandaj edhe përgjegjësinë materiale që duhet zbatuar në këtë rast ndaj dëmtuesit nuk e shikon të nevojshme, as të domosdoshme.

Punëtori mëson jo vetëm kur shikon atë që paguan për dëmin që ka kryer, por edhe kur shikon atë që lavdërohet për punë të mirë. Kur të shohë se një shok i tij e realizoi normën 110 për qind ai duhet të reflektojë: po unë kështu do të rri vazhdimisht me 100 për qind? Edhe unë duhet të gjallërohem! Në këtë mënyrë do të shkojmë më shpejt përpara.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Raporte e fjalime 1978-
-1979», f. 204*

Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP

VËMENDJA E KOMISARIATIT TË NAFTËS TË PËRQENDROHET NË PROBLEMET KYÇ

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

12 mars 1979

Me komisariatin e posaçëm për naftën që do të krijohet, në fakt, nuk bëjmë asnjë ndryshim në strukturë. Të tërë punonjësit e naftës, që nga ministria deri te punëtorët, specialistët e teknikët e puseve, do të vazhdojnë të kenë përgjegjësitë dhe detyrat e tyre, të realizojnë planin dhe të japin llogari për këtë në Qeveri dhe në Parti. Ashtu si gjithnjë, ata do të vijnë, pra, të japin llogari edhe përpara Byrosë Politike për problemet e sektorit të tyre.

Komisariati i posaçëm do të ngarkohet të ndihmojë Komitetin Qendror dhe Qeverinë, duke ushtruar kontroll në gjithë veprimtarinë e organeve të Partisë e të pushtetit, për zbatimin e detyrave të caktuara të planit në industrinë e naftës dhe të gazit, në këtë degë të rëndësishme të ekonomisë. Ky organ, pa prekur kompetencat që kanë organet përkatëse shtetërore dhe të

Partisë, do të jetë i plotfuqishëm, ai do të kontrollojë dhe do të marrë masa për zbatimin e detyrave në fushën e industrisë së naftës. Gjithashtu, komisariati, do të ketë të drejtë jo vetëm të pezullojë një vendim apo urdhër që nxjerrin për sektorin e naftës Ministria e Industrisë dhe e Minierave apo drejtoritë përkatëse poshtë, në bazë, në rast se e shikon që ky vendim apo urdhër nuk është i drejtë, por edhe të japë urdhra që, brenda një kohe të caktuar, të zbatohet një detyrë që do të japë ai vetë. Pra, ky organ mund të ndryshojë kohën e zbatimit të një detyre ose mund ta pezullojë atë, kur e gjykon se nuk është e drejtë dhe menjëherë të vërë në dijeni Komitetin Qendror dhe Qeverinë që këtë vendim ose urdhër e pezulloi dhe arsyet përse e bëri këtë. Këtë kontroll komisariati do ta ushtrojë duke filluar, siç thashë, që nga ministria dhe deri te pusi, në të dyja rrugët, edhe në rrugë shtetërore, edhe në rrugë partie. Ai do të ketë të drejtë dhe kompetencë që të vërë para përgjegjësisë në organizatën-bazë të Partisë atë komunist dhe punonjës të sektorit të naftës që nuk zbaton detyrat e ngarkuara dhe të japë mendimin për masat që duhet të merren kundër tij, në bazë të përgjegjësisë ose të fajit që ka bërë, pra, të propozojë që t'i jepet një masë ndëshkimore e rëndë ose mesatare, se për të vendosur nuk do të vendosë ky, por organet përkatëse të nomenklaturës. Komisarati duhet t'i shpjegojë në këtë rast organit përkatës të Partisë që ky ose ai drejtor, fjala vjen, ka bërë këtë faj, që ai e konsideron të rëndë, dhe bën propozimin se ç'masë duhet të merret. Komisarati do të ketë të drejtën që, duke vënë në dijeni

komitetin e Partisë të rrethit përkatës, të mbledhë një organizatë-bazë partie të sektorit të naftës dhe të shtrëjë përpara saj të gjitha ato probleme që gjykon se nuk ecin. Ai nuk do të presë që të vejë në këtë mbledhje sekretari apo instruktori i komitetit të Partisë të rrethit. Këta, po të duan, le të venë me këtë rast, po menjëherë ai ta organizojë mbledhjen e posaçme, ta diskutojë problemin dhe të caktojë detyra, me qëllim që të sigurohet realizimi i planit.

Unë mendoj se duhet t'ia japim këtë të drejtë komisarariatit për naftën dhe për gazin, si dhe detyrën që të bashkëpunojë ngushtë me kuadrot, me drejtoritë dhe me komitetet e Partisë të rretheve përkatëse ku kemi naftë dhe gaz. Sigurisht, për çështjen e naftës e të gazit ai do të ketë lidhje edhe me ministrinë e drejtorinë e naftës në ministri, pa hyrë në detaje me to, por këto organe do të vazhdojnë t'i kenë të gjitha kompetencat e tyre njëlloj si dhe më parë.

Ministri i Industrisë dhe i Minierave ka të drejtë, dhe është detyra e tij, që të raportojë në Qeveri për detyrat që kjo i ka ngarkuar.

Komisariati i posaçëm për naftën dhe për gazin do të ndjekë vetëm problemin e naftës, kurse për industrinë mekanike dhe për sektorët e tjerë të industrisë do të përgjigjet shoku Pali [Miska]¹. Megjithatë, ministri i Industrisë dhe i Minierave mund t'i vejë atij për problemin e naftës, për shembull, për një fond që i duhet.

1. Në atë kohë zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të RPSSH.

Ministri i Industrisë dhe i Minierave, për paratë që i duhen, shkon drejt në Kryeministri, se që të vejë te Ilakiu [Toska]¹, pra në Ministrinë e Financave, i duhet të harxhojë më shumë kohë, sepse do të vejë në dy vende. Në ndonjë rast ministri mund të vijë edhe këtu, në Komitetin Qendror të Partisë. Kur ministri është dakord me vendimin e komisarariatit çështja është e qartë, por në ndonjë rast kur mund të ketë kundërshtime, ai duhet të vijë pa vonesë këtu, në Komitetin Qendror ose të shkojë në Kryeministri dhe të thotë mendimin e tij.

Në rast se ne i themi të bëhet, ai të përgjigjet: «Mirë, unë do të punoj me të gjitha forcat që ta zbatoj urdhrin».

Rëndësi ka çështja se si do ta organizojë konkretisht punën komisaritati. Tash nuk jemi në gjendje të japim receta për këtë problem. Ne po krijojmë një organizëm të ri për funksionimin e të cilit po japim disa orientime bazë. Në radhë të parë, puna nga ana e tij duhet të fillojë me objektivat më të rëndësishëm dhe të mos kapet nga bishtrat, nga gjërat e vogla dhe të dorës së dytë, sepse po iu fut vogëlsirave nuk do të dalë dot kurrë. Prandaj vëmendja e komisarariatit duhet të përqendrohet në problemet kyç, në ato më kryesoret që ne mendojmë se pengojnë realizimin e detyrave në sektorin e naftës. Pjesëtarët e komisarariatit duhet të studiojnë mirë gjendjen, për shembull, në Institutin e Naftës e të Gazit. Atje shokët e komisarariatit duhet të

1. Në atë kohë ministër i Financave.

shikojnë se ç'gjë pengon, pse projektet e tyre, ta zëmë, kanë defekte, pse nuk parashikohet kjo apo ajo vështirësi në studimin e dhënë për pusin iks etj., etj. Pra, kur them të shikojë se ç'pengon e kam fjalën që të kontrollohet mirë puna e studimeve, e përgatitjes së tyre, e perspektivës dhe të nxirren në shesh shkaqet e ngadalësimit ose të javashllëkut, të frymës së liberalizmit ose të burokratizmit, të shikohet metoda e përcaktimit të debiteve të puseve, bashkërendimi i metodave etj., etj.

Në të tilla probleme do të përqendrohet komisarriati, pra në më kryesoret. Shokët e tij do të venë në vend që të dëgjojnë se çfarë thuhet për këto probleme dhe të kërkojnë të dinë vetëm për këto, jo për të tjera. Pastaj, në qoftë se ka diçka që shokët e naftës thonë se ka lidhje me këto probleme, atëherë mund t'i dëgjojnë dhe të diskutojnë edhe për to.

Ose të marrim çështjen e pikave të shpimit. Drejtuesit e Institutit të Naftës dhe të Gazit kanë caktuar pikat se ku duhet të shpohet. Ajo që duhet të bëjë komisarriati është që të studiojë me kujdes nëse janë caktuar drejt pikat e shpimit apo jo. Mos vallë vetëm specialisti që ka komisarriati e di këtë gjë? Jo, këtë e dinë më mirë edhe ata të institutit. Prandaj, duke marrë kontakte, duke biseduar me punonjësit e institutit, duke dëgjuar njerëzit, në diskutim e sipër, komisarriati krijon bindjen nëse ky apo ai njeri gëzkon mirë dhe me logjikë të fortë shkencore për këtë apo për atë problem.

Të tilla probleme ka dhe do të ketë shumë. Ato nuk

mund të diktohen që këtu. Vetë puna do t'i nxjerrë në shesh dhe do t'i diktojë komisariatit format e rrugët për zgjidhjen e tyre. Për të gjithë ne është e qartë se gjendja është e pakënaqshme në sektorin e naftës, por çdo gjë nuk do të vihet brenda një dite në rrugë; mund të shkojnë muaj e muaj të tërë që puna të ecë ashtu siç kërkohet. Por unë kam bindjen se çdo gjë do të ecë më mirë tash e tutje. Edhe të gjithë punonjësit e naftës do ta shohin se komisariati, që krijoi Komiteti Qendror i Partisë, është një organ kontrolli e ndihme për ta. Kjo varet shumë nga puna e komisariatit, që do të drejtoni ju, Hekuran [Isai].

Puna e këtij organi duhet të jetë e gërshetuar mirë me të gjitha organet e tjera shtetërore dhe ekonomike. pa i larguar as këto nga përgjegjësitë që kanë, as organet e Partisë që mbulojnë sektorin e naftës. Komisarriati do të përgjigjet këtu te ne për vendimet që do të marrë, por jo për ato veprime që u takojnë të kryejnë organet përkatëse të Partisë dhe të shtetit. Ai do ta kontrollojë veprimtarinë e tyre dhe do t'u kërkojë llogari deri në një për moszbatimin e urdhrave dhe të porosive të dhëna. Shokët e këtyre organeve duhet ta kenë të qartë se janë përgjegjës për detyrat e tyre dhe se ata duhet t'i mbrojnë mendimet e veta kur këto i gjykojnë të drejta. Kjo gjë t'u theksohet mirë atyre, prandaj t'ua bëni të ditur se për atë që do t'u thoni ju e që mund të jetë në kundërshtim me mendimet e tyre, do të mbani vetë përgjegjësi dhe jo ata. Komisarriati do t'u kërkojë organeve të tjera të zbatojnë vendimet apo urdhrat që do t'u japë. Në qoftë se ato nuk veprojnë

në këtë mënyrë, atëherë përgjegjësia do të bjerë mbi ta. Kjo s'diskutohet. Pra, kur t'u thuhet nga komisarjati se në këtë apo në atë zonë duhet shpuar më tej se thellësia e parashikuar, për shembull, 4 000 metra, sepse na leverdis më shumë, ose sepse këtë bazë teknike kemi mundësi ta sigurojmë, ata duhet ta zbatojnë porosinë tuaj. Kështu që vetëm drejtimi i punës do të ndryshojë me urdhrin që do të jepni, kurse përgjegjësinë për cilësinë e shpimit e kanë kuadrot e specialistët, sepse kjo është puna e tyre. Prandaj ata duhet t'i kenë të qarta përgjegjësitë e tyre dhe të punojnë me ndërgjegje të lartë, jo ta pengojnë vendimin që do të merrni ju. Çështja është që të shohin dhe të kuptojnë se Komiteti Qendror i Partisë ka vënë dorë në këtë punë, për arsye se në sektorin e naftës vihet re mungesë drejtimi dhe përgjegjësie për detyrat e ngarkuara, se atje mungon një kontroll i shëndoshë partie, mungon disiplina në punë, ka frymë liberalizmi dhe qëndrime oportuniste. Për këtë arsye Komiteti Qendror i Partisë po e merr vetë në dorë kontrollin e këtij sektori nëpërmjet komisarjatis.

Secili, që nga drejtori i naftës në ministri e deri te sondisti e punëtori i thjeshtë në pusët e naftës dhe të gazit, të rritë përgjegjësinë dhe ta ndjekë punën deri në fund. Se mund të ndodhë që një drejtor të vijë e të të pyesë: «Si do ta bëjmë këtë ose atë punë?». «Më parë më thuaj si do ta bësh ti, — i duhet thënë, — pastaj të të them unë nëse e ke drejt apo jo».

Pra, për ta përmirësuar gjendjen në këtë sektor

duhet të veprohet në mënyrë të qartë dhe pa humbur shumë kohë.

Për zgjidhjen e problemeve që dalin, mendoj se konsultat nuk mund t'i ekskludojmë, por duhet të punohet më shumë, para se ato të organizohen. Komisariati do të japë një orientim, për shembull, që të shpohet në një zonë të caktuar. Atëherë drejtori i shpimit do të bëjë konsulta, që të shkëmbejë mendime se si do të bëhet e qysh do të realizohet kjo detyrë. Mendoj se medoemos duhet të konsultohen teknikët dhe specialistët, ndryshe s'kanë si të veprojnë. Ose këto konsulta apo mbledhje mund të bëhen edhe para se të jepet orientimi nga komisariati.

Gjatë punës suaj, Hekuran, ju do të jepni edhe këshilla, do të kontrolloni punën në sektorin e naftës, gjendjen për ato detyra konkrete që ka në këtë sektor dhe do të na vini edhe ne në korrent. Ne do të mbajmë lidhje edhe me Prokopin [Murra], edhe me shokët e Qeverisë.

Edhe autoritetin e punonjësve shkencorë të instituteve duhet ta ruajmë. Atje bëhen studime, vetëm se këto duhen kontrolluar dhe, po nuk e bëmë me kompetencë këtë punë, gjendja që ekziston sot ka për të vazhduar. Ajo që duhet të na tërheqë vëmendjen është të shohim se si i bëjnë këto studime. Natyrisht, studimet, kanë rëndësi të madhe dhe për këtë arsye duhen bërë me kujdes.

Ju do të shihni, gjithashtu, se a punojnë specialistët tanë të naftës për të zgjeruar kulturën dhe horizontin e tyre shkencor në fushën e naftës apo jo. Stu-

dimi i literaturës tekniko-shkencore duhet bërë vazhdimisht, prandaj t'u vini në dukje specialistëve që këtë punë ta programojnë që të bëhet mirë dhe në kohën e duhur.

Çështja duhet shtruar kështu shokë: përse i kemi gjithë këta kuadro me arsim të lartë në institute e nëpër drejtori? Që të bëjnë studime serioze dhe me vlerë, me qëllim që të nxjerrim sa më shumë naftë e ta zgjidhim sa më mirë e në mënyrë fitimprurëse këtë problem me rëndësi. Jo vetëm në sektorin e naftës, por edhe gjetkë, në sektorë të tjerë të ekonomisë sonë, ne konstatojmë se puna studimore nuk zhvillohet në masën dhe në nivelin e duhur. Kjo punë duhet kontrolluar. Ja, për shembull, njëri prej këtyre specialistëve, mund të pyetet: «Ç'ke studiuar ti? Pa më thuaj cilët libra ke lexuar dhe ç'ke nxjerrë nga ata?». Dhe ky, do t'u thotë shokëve: «Më kërkuan llogari deri në një, se ç'kisha studiuar, më pyetën për këtë dhe për atë çështje». Dhe, të jeni të bindur, se fjala e tij do të përhapet menjëherë te specialistët e tjerë, të cilët do të shkunden dhe do t'u vihen edhe studimeve. Pra, duhen gjetur mënyrat që ne të nxitim njerëzit tanë t'i futen shkencës, të bëjnë studime të thella që t'i shërbejnë konkretisht e menjëherë qëllimit. Specialistët t'i vëmë në lëvizje, se punën me ta do ta bëjmë. Masa që po marrim për krijimin e një organi të posaçëm për çështjen e naftës, këtë qëllim ka, që «t'i futë shkarpa zjarrit», siç i thonë një fjale, që «ai të ndizet dhe uji të vlojë».

Pra, punët komisarati do t'i kryejë së bashku me kuadrot e specialistët, me naftëtarët. Kështu ai

duhet të përpiqet që ta zhdukë atë mjegull e konfuzion që ekziston. Një gjë e tillë duhet bërë në mënyrë shoqërore, veçse në formë kërkesë të prerë e koncize, për të pasur disiplinë të fortë në punë, për shfrytëzimin maksimal të njohurive dhe të materialeve shkencore që kemi në dispozicion, për shtimin e naftës e për të mirën e atdheut. Ky është dhe qëllimi i krijimit të komisariatit. Këtë gjë duhet ta kuptojnë mirë punonjësit e sektorit të naftës, prandaj komisariati të fillojë punën sa më parë!

Pastaj shoku Enver Hoxha e kaloi bisedën rreth disa mendimeve që i kishin lindur duke lexuar në gazetë një recension për filmin artistik shqiptar «Gjeneral gramafoni».

Dje, në gazetën «Luftëtari»¹ ishte botuar një recension për filmin «Gjeneral gramafoni», që ka dalë këto kohët e fundit. E lexova këtë recension dhe më tërhoqi vëmendjen fakti që personazhi kryesor i këtij filmi, muzika e interpretuar nga Laver Bariu, nuk zihej fare me gojë. Po kujt i drejtohej në këtë shkrim autori? Neve, shqiptarëve, që dimë shqip, që vemi në kinema, shikojmë filmat tanë, u kuptojmë përmbajtjen, i ndiejmë e jetojmë me ta dhe shijojmë muzikën e tyre të bukur? Prandaj është me vend që të bëhet një recension dhe nuk ka asgjë të gabuar në këtë mes, veçse kryesorja nuk është vetëm përgatitja e një recensionit, por nxjerrja mirë në pah e asaj që është thel-

1. Është fjala për artikullin «Bedenat e papushtueshme të artit të popullit».

bësore në filmin, për të cilin shkruhet. Këtë recension unë e kritikoj, sepse autori i tij nuk nxjerr si personazh kryesor të filmit, së pari, muzikën dhe, së dyti, grevën e punëtorëve të Kuçovës.

Kur dëgjon muzikën e filmit «Gjeneral gramafoni», të ngrihen leshrat përprjetë nga emocionet që të ngjall kabaja e bukur me klarinetë e Laver Bariut. Por në pjesën e fundit të recensionit ku radhiten emrat e aktorëve të filmit, emri i atij që e ka ekzekutuar këtë kaba, që ishte kryesori nga kryesorët në këtë film me kabanë e tij, s'përmendet. Edhe 10 vjet pasi ta kesh parë filmin, kabaja e Laver Bariut do të të mbetet e gjallë në kujtesë. Kur i bie gërnetës ai, të bën për vete. Kabatë tona nuk i shijojmë vetëm ne, por edhe të huajt. Kurse autori i këtij recensionit as që e përmend fare emrin e Laverit!

Recensionit flet edhe për artistët e njohur të filmit, si për Sandër Prosin, dhe vë në dukje që ky është një artist i madh. Ashtu është, por Prosi në këtë film nuk luan rol kryesor. Autori i recensionit nuk harron të përmendë as emrin e një vajze që qëndron në dritare dhe luan rolin e një figuranteje, por ai lë në harrësë atë që i jep gjithë bukurinë filmit, *muzikën*. Kush i bie gërnetës aty? Laver Bariu me shokë. Flitet aty për muzikën popullore shqiptare që e këndon dhe e luan i gjithë populli, po në atë rast instrumentistët popullorë ishin pikërisht ata, jevgjit e Përmetit. Gazeta «Drita» nuk e ka bërë këtë gabim që bëri «Luftëtari», as Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve. Megjithatë edhe këto nuk kanë bërë aq sa duhet për të nxjerrë

në pah meritën e madhe që kanë këta njerëz të talentuar të popullit në interpretimin e muzikës sonë popullore me një nivel të lartë artistik. Edhe poshtë, në bazë, më shumë duhet bërë për ta. Para ca kohësh unë i dërgova një letër¹ Laverit, ku vija në dukje talentin e tij dhe këtë nuk ia bëra kot, por me qëllim. Prandaj, sapo pashë artikullin për filmin «Gjeneral gramafoni», thashë me vete: «pa ta lexoj një herë!». Dhe e lexova, por... emrin e Laverit nuk ma zuri syri gjëkund.

E solla këtë recension si shembull për të treguar se ka njerëz që shkruajnë e bëjnë studime, por ajo që duhet të na tërheqë vëmendjen është të shohim se si i bëjnë këto.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e incizuar, që gjendet në AQP*

1. Shih: Enver Hoxha, «Letra të zgjedhura», vëll. 1, f. 383.

**PA SHKENCË, PA STUDIME TË THELLA
SHKENCORE NUK MUND TË
REVOLUCIONARIZOHET PRODHIMI**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

13 mars 1979

Së pari në këtë takim u bisedua rreth problemeve e grupeve të revolucionit tekniko-shkencor dhe detyrave të dikastereve e të instituteve studimore. Që në fillim e mori fjalën

SHOKU ENVER HOXHA: Byrotë teknike, më duket mua. nuk po e luajnë si duhet rolin e tyre. Në qoftë se nuk gabohem, për to nuk po flitet më si më parë. Me se merren byrotë teknike atje ku janë ngritur, bëjnë studime për perspektivën apo nuk bëjnë? Në këtë drejtim sikur nuk po bëhet gjë ose bëhet shumë pak. Sipas informacioneve që kam, del se gjithë puna e byrove teknike është reduktuar në mbledhje të shumta për zgjidhjen e problemeve praktike të nevojave të përditshme. Punën e tyre, siç duket, e kanë mbuluar grupet e revolucionit tekniko-shkencor.

Ne u kemi bërë vërejtje ministrive që s'janë interesuar fare për këtë çështje, prandaj tash Ministria e Industrisë dhe e Minierave, për shembull, ka krijuar një grup që të interesohet dhe të drejtojë veprimtarinë e grupeve të revolucionit tekniko-shkencor. Lind pyetja: Ç'mund të bëjnë ata dy veta që janë caktuar për të ndjekur gjithë këtë punë nga ana e ministrisë? Kur janë pyetur se sa grupe merren me problemet e revolucionit tekniko-shkencor, çfarë problemesh kanë dalë etj., nuk kanë qenë në gjendje të na jepnin një përgjigje të saktë.

Tash, ta vëmë në rrugë këtë punë. A duhet të kemi disa kuadro për t'i drejtuar grupet e revolucionit tekniko-shkencor apo do të mjaftohemi e të kënaqemi vetëm me atë që kemi shënuar në letër se këto grupe i kemi krijuar dhe u kemi caktuar edhe çfarë të studiojnë? Po se kur do t'i përfundojnë këto studime dhe kush përgjigjet për këtë çështje do ta lejojmë akoma të mos na thuhet asgjë? Tash me këtë problem merret Ministria e Industrisë dhe e Minierave, së cilës, siç ju thashë, i janë shtuar dy veta në organikë, për të ndjekur e për të drejtuar punën e këtyre grupeve.

Fakt është se nëpër ndërmarrje ekziston një numër i madh grupesh, të cilat as janë mbledhur, as janë kontrolluar ndonjëherë për veprimtarinë e tyre, bile këta dy veta që janë caktuar në krye të kësaj pune as që kanë mundësi ta bëjnë një gjë të tillë. Prandaj kjo çështje duhet parë, se ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Duhet të kemi ne pranë Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, për shembull, 30 ose 40 grupe për

tema studimore ose grupe që varen drejtpërdrejt nga ministria? Rreth këtij problemi të shkëmbejmë mendime e të mos themi gjë këtu në mënyrë të prerë.

SHOKU PROKOP MURRA: Ka tema studimore që i ndjek Qeveria, ka të tjera për të cilat është ngarkuar ministria t'i përgatitë.

SHOKU ENVER HOXHA: Dimë që të tëra temat studimore i ndjekin ata të aparatit të Këshillit të Ministrave dhe të Ministrisë së Industrisë e të Minierave. Por na intereson neve që të gjitha këto grupe të punojnë frontalisht e të mos i drejtojnë askush, apo do të jetë më mirë sikur të shkrihen tri nga këto grupe të përbëra nga 10-15 kuadro, si inxhinierë etj. dhe të drejtojnë veprimtarinë e të gjitha grupeve? Mua më duket se neve na intereson shumë që të ketë një grup drejtues për të ndihmuar e kontrolluar të tëra grupet e revolucionit tekniko-shkencor, sepse ministria nuk është në gjendje vetë të bëjë dhe nuk bën studime. Këtë gjë e konstatoi dhe Ramizi [Alia].

Një ditë bisedoja me një punëtor, i cili, midis të tjerash, më tha se tapat e shisheve tona kalben. Dhe, sipas tij, shkakun e kësaj ishte se ne nuk e përgatitim si duhet dyllin me të cilin lyejmë tapat. Por ne inxhinierë kimistë kemi mjaft, prandaj, thoshte me të drejtë punëtori, ky problem duhet zgjidhur, në mënyrë që tapa jo vetëm të mos kalbet, por edhe ta mbyllë hermetikisht shishen. Dhe ai bënte krahasim me shishet e huaja, në të cilat tapa është aq e shtrënguar, saqë për ta hequr atë kërkohet një forcë e madhe. Ai kishte mendimin se për ta shtrënguar mirë tapën në shishe nevojitej

vetëm një makinë e vogël. Përveç kësaj, ai sugjeronte që gryka e shishes të vishet me një letër varaku e kështu të paraqitet edhe bukur.

SHOKU RAMIZ ALIA: Sa shumë probleme ka si këto, për të cilat duhet të mendojnë e t'i zgjidhin vetë inxhinierët e punëtorët tanë.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirëpo as iniciativa më e vogël nuk merret për ta projektuar e për ta prodhuar në vend këtë pajisje, që kërkonte punëtori, pa lëre pastaj se çfarë bëhet për studimet e mëdha.

Nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave varet edhe Instituti i Studimeve Mekanike, ku ka mjaft njerëz të cilët duhet të merren më shumë me studime të mirëfillta shkencore, sesa me punë të tjera. Detyra e tyre kryesore është të bëjnë studime. Por punëtori, me të cilin bisedova kishte vërejtje edhe për vetë Drejtorinë e Mekanikës në ministri: «T'ju them të drejtën, shoku Enver, nuk shohim të zgjidhë ndonjë problem kjo drejtori, por vetëm se transmeton kërkesat nga një uzinë në tjetrën».

Këta që punojnë në këtë drejtori, edhe sikur të duan, nuk kanë mundësi të venë dhe të shtrohen në një uzinë të madhe për të bërë një bisedë me punëtorët e inxhinierët, për t'u njohur më mirë e më nga afër me problemet e kërkesat e ndryshme që kanë ata dhe për t'u dhënë atyre zgjidhje sa më parë, me qëllim që prodhimi të mos pengohet për asnjë çast nga mungesa e lëndëve të para e materialeve ndihmëse. Materialet që u nevojiten uzinave të mëdha mund të gjenden në depot e rezervës ose në depot e përgjithshme. Punonjësit

e Drejtorisë së Industrisë Mekanike duhet të interesohen, të marrin kontakt me punonjësit e depos etj., etj., që uzinave t'u sigurohen në kohë materialet e nevojshme. Po a ka kjo drejtori inxhinierët që i duhen për të ndjekur problemet e shumta që ka?

Po mirë, more shokë, ç'janë këta organizma këshutu? Si mund të lejojmë të kemi një Institut të Mekanikës me 40 inxhinierë dhe këta të mos merren sa duhet me punë studimore? Kjo nuk shkon. Ne i kërkojmë të merret e të drejtojë punën studimore edhe Drejtoria e Industrisë Mekanike në ministri, e cila drejton gjithë industrinë mekanike të vendit, por kjo nuk ka inxhinierë. Në qoftë se Drejtorisë së Industrisë Mekanike i jepen më shumë veta, atëherë me siguri puna do të ndryshojë¹. Për këtë duhet bërë një punë e menduar, të nxirren problemet që kërkojnë studim dhe zgjidhje, dhe njëkohësisht të caktohen kuadrot që do të merren, të njihen dokumentet e tyre. Pasi të jetë bërë kjo, sipas problemeve caktohen edhe kuadrot, njëri këtu, tjetri atje, njëri të bëjë disa studime, tjetri të japë të dhëna shkencore etj., etj., sepse nuk është e drejtë që të tillë kuadro ta kalojnë kohën me punë që u takojnë të tjerëve. Ata të merren me punë shkencore, me studime që janë kaq shumë të domosdoshme për ta çuar prodhimin përpara në çdo degë të industrisë së vendit tonë.

1. Në bazë të kësaj porosie të shokut Enver Hoxha kjo drejtori u fuqizua me shumë inxhinierë dhe më pas, u krijua Drejtoria e Përgjithshme Mekanike në varësi të Këshillit të Ministrave.

Punëtori, me të cilin bisedova, më tregoi për një uzinë ku drejtori, një inxhinier shumë i zoti, nuk merret me drejtimin e prodhimit, por këtë ia ka lënë në dorë kryeinxhinierit, kurse vetë mendon se si ta zhvillojë prodhimin në perspektivë dhe në këtë drejtim ka bërë goxha punë. Ai ka gjetur shumë libra, i ka studiuar dhe vazhdon t'i studiojë ata. Bën edhe studime për çështje të ndryshme të prodhimit, të uzinës. Ua jep ata edhe teknikëve të uzinës, shkëmben mendime me ta, shikon vërejtjet e tyre dhe përsëri vazhdon punën.

Pra, tani, kur njerëzit e bazës janë me nivel të ngritur dhe i kuptojnë shumë mirë problemet, kuptohet që në krye të Drejtorisë së Industrisë Mekanike, për shembull, duhet të jetë një njeri jo vetëm i mirë politikisht, por edhe i përgatitur, ndryshe nuk ecën puna. A mund të pranohet që në Drejtorinë e Industrisë Mekanike, tash pas 35 vjet çlirim, kur kemi përgatitur gjithë këta kuadro. të drejtojë një kuadër që nuk është inxhinier mekanik?! Në qoftë se ne duhet të kemi inxhinierë mekanikë në një vend. në radhë të parë na duhet atje, bile drejtuesi këtu duhet një inxhinier mekanik jo shumë i ri, por një kuadër që e ka ushtruar këtë profesion mbi 15 vjet, me qëllim që të ndihmojë sa më shumë në mbarëvajtjen e kësaj dege të gjerë e të rëndësishme të industrisë sonë. Nuk mund të shpjegohet fakti që në krye të kësaj drejtorie të vihet një njeri që nuk është inxhinier mekanik, vetëm sepse është organizator i mirë. Po pse, nuk ka inxhinierë mekanikë që të jenë edhe organizatorë të shkëlqyer?! Megjithëse vazhdimisht kemi thënë dhe themi

që të ngremë në përgjegjësi kuadro të aftë, prapë vihen re raste që kjo porosi e Partisë nuk mbahet parasysht. Mendoj se edhe ne duhet t'i shikojmë një çikë më mirë këto që thashë, se janë probleme kryesore këto, më duket mua.

SHOKU RAMIZ ALIA: Ju, shoku Enver, me të drejtë i ngrini këto probleme. E tillë është gjendja, por mua më duket se këtu ka një mospërputhje të këtyre anomalive me zhvillimin tonë. Ja, të marrim Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave. Sot është krijuar gjithë kjo industri e madhe mekanike, por edhe industrinë kimike e kemi goxha të zhvilluar e kështu me radhë të gjitha degët e tjera të industrisë. Zhvillimi i tyre ka nxjerrë përpara nesh shumë probleme që kanë nevojë të studiohen, të trajtohen në një nivel të lartë nga pikëpamja shkencore në ministri dhe të gjejnë rrugën e zgjidhjes. Por metoda dhe stili i punëve në ministri, shoku Enver, përbëhet nga ai që quhet «operativitet». Veçse ky «operativitet» nuk është në baza shkencore. Funkionarët e ministrive duhet të kontrollojnë gjendjen në bazë e të nxjerrin konkluzione për punën e tyre korente, por dhe për perspektivën.

Për sa i përket drejtimit të grupeve të revolucionit tekniko-shkencor, mendimi im lidhur me këtë çështje është ky: Ne mund të krijojmë një grup jo me dy veta, siç kanë bërë në dikasterin e industrisë, por edhe me dymbëdhjetë sikur ta bëjmë, prapë s'ka për t'u zgjidhur problemi, sepse nuk ka dhe nuk është e mundur të gjenden njerëz enciklopedistë, të gjith-

anshëm, që të njohin të gjitha problemet në mënyrë shkencore dhe që të mundin të drejtojnë e të kontrollojnë punën e gjithë grupeve të revolucionit tekniko-shkencor.

Unë mendoj se kjo punë mund të bëhet dhe duhet të bëhet nga çdo drejtori e ministrisë sipas profilit të vet, duke filluar që nga ministri, i cili ta kuptojë mirë se pa shkencë prodhimi ynë nuk ecën dot përpara, pa studime shkencore të thella nuk mund të zgjidhësh asnjë problem dhe nuk mund ta revolucionarizosh prodhimin.

SHOKU ENVER HOXHA: Byrotë teknologjike dhe grupet e revolucionit tekniko-shkencor problemet t'i shikojnë konkretisht dhe pastaj t'i futen seriozisht punës. Nuk them të jepen urdhra që të bëhet kjo ose ajo pa e studiuar problemin, por të diskutohet çfarë duhet të bëhet, si duhet organizuar puna.

SHOKU HYSNI KAPO: Ajo që thatë ju, shoku Enver, krijon edhe mundësitë që të nxiten për të punuar edhe grupet e revolucionit tekniko-shkencor, edhe byrotë teknologjike, që të merren me studimin e problemeve, të aktivizohen, t'u shtrohen atyre detyra etj., etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Vetë ministrat duhet ta kuptojnë që Komiteti Qendror e sidomos ne, sekretarët e Komitetit Qendror të Partisë, po shqetësohemi seriozisht çdo ditë për këto punë.

Më poshtë biseda vazhdoi për disa probleme të mbrojtjes së vendit të stërvitjeve ushtarake dhe të

*përgatitjes së popullit. Pasi dëgjoji mendimet e sho-
këve sekretarë, e mori fjalën*

SHOKU ENVER HOXHA: Disa kuadro mendojnë se mund të shkosh në luftë si në dasmë. Te këta duket që ekziston fryma që kam thënë se «përpara nesh s'mund të qëndrojnë askush, s'ka ushtri në botë që të matet me ne, bile edhe disa ushtri të bashkuara, pse të tërë jemi në gjendje t'i dërrmojmë». Koncepte të tilla janë shumë të rrezikshme, për të gjithë ata që i kanë, shokë. Ku shkojmë? Si mendojnë këta njerëz kështu? Si mund t'i përballojmë vështirësitë e luftës, vetëm me fjalë?

Ndër të gjitha çështjet e ushtrisë, përgatitja e kuadrove është në radhë të parë. Ata duhet të jenë të edukuar mirë dhe të stërvitur në mënyrë të rreptë. Përvetësimi i anës teorike të Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore dhe zbatimi në praktikë i kësaj teorie, që u mësojmë njerëzve tanë, kërkon një punë të kualifikuar dhe një disiplinë të vetëdijshme. Rëndësi merr në këtë çështje edhe ngritja e nivelit ideoteorik të kuadrove, përvetësimi prej tyre i mësimit në afatin më të shkurtër, më të shpejtë dhe zhvillimi i tij në formën e në mënyrën më të qartë e më të kuptueshme për efektivin.

Që të përvetësohet mirë arti ynë ushtarak, gjithashtu kërkohet vullnet nga rezervistët që vijnë të stërviten në shkollën e lirë, por dhe disiplinë. Këtu, në shkollën e lirë, të provohen disiplina dhe shkathësia e tyre, të provohen ndërgjegjja dhe zelli që kanë për zotërimin sa më shumë e sa më mirë të Artit tonë

Ushtarak të Luftës Popullore. Që të bëhet kjo punë në aq ditë sa janë planifikuar për stërvitjen vërtet është ca e shtrënguar, por megjithatë, mund të realizohet, për arsye se rezervistët që vijnë të stërviten në shkollën e lirë, kanë bërë ushtrinë, kanë qenë për disa vjet me radhë oficerë në rezervë. Këto ndikojnë që të përvetësohet programi i përgatitjes luftarake brenda vitit në aq ditë sa janë caktuar për stërvitjen. Prandaj llogaritë për këtë stërvitje i kemi bërë e duhen bërë brenda këtyre ditëve. Por, në qoftë se bëhen këto stërvitje pa një preokupacion të veçantë, pa një objektiv të qartë, në qoftë se oficeri mendon se ka kohë dhe nuk shqetësohet që programin ta zhvillojë në mënyrë një çikë të ngjeshur, se kemi parasysh që ushtarit aktiv për 3 vjet të tërë i janë zhvilluar programet, atëherë nga kjo punë nuk do të ketë përfitim. Prandaj nuk duhet lejuar të ecet me një mentalitet të tillë, sipas të cilit mund të kthehemi prapë për të mësuar, domethënë oficeri ta zgjatë mësimin në shkollën e lirë sa të mendojë e sa të dojë ai.

Fakt është që në shumë raste në shkollën e lirë, përgatitjes praktike të rezervistëve i jepet më pak rëndësi sesa anës teorike. Kësaj të fundit i jepet më shumë rëndësi që të duket sikur ato që thotë oficeri janë xhevahire.

Unë mendoj se, po të mos u kërkohet llogari kua-drove që japin mësim në shkollat e lira, nuk mund të realizohet programi brenda afatit të caktuar. Kjo bëhet duke ua kontrolluar leksionet. Ato leksione që oficerët i zhvillojnë sipas programit të jenë me të vër-

tetë koncize, me njohuri ushtarake të domosdoshme progresive, në kuptimin që këto të jenë në zhvillim, në mënyrë që, gjatë viteve të mëvonshme, rezervisti që vjen në shkollën e lirë, jo vetëm të freskojë njohuritë ushtarake që ka marrë më parë, por të marrë plus edhe diçka të re, si në teori, ashtu edhe në praktikë. Pastaj, edhe në praktikë oficeri duhet të jetë mirë në krye të detyrës edhe personalisht dhe jo të kërkojë të futë këmbët në ujë të ngrohtë, në një kohë kur ushtarë dhe rezervistë të sëmurë qëndrojnë në shi e në borë. Ai duhet të interesohet edhe për kushtet e për shëndetin e ushtarëve e kështu me radhë për gjithë të tjerat.

Prandaj, në qoftë se lejojmë që në shkollat e lira të përdoren ditë «suplementare», që komandat e një-sive të veprojnë si të duan vetë dhe këtë veprim ato janë gati ta justifikojnë me parullën «mbrojtja e atdheut është detyrë mbi të gjitha detyrat», nuk bëjmë aspak mirë. Është tjetër gjë kur këtë e bëjnë vetë rezervistët vullnetarisht. Është e vërtetë se mbrojtja e atdheut është detyrë mbi të gjitha detyrat, po stërvitja ka caqe dhe kuadri këtë ta kuptojë drejt e si duhet, në mënyrë që ta vrasë mendjen se si brenda këtyre caqeve mund të realizohet kjo detyrë. Kjo kërkon që ai të punojë vetë intensivisht, të rrijë edhe pa gjumë kur është nevoja, që t'i përgatitë sa më mirë, kuptueshëm dhe qartë temat, të bëjë mirë shërbimet në të gjitha drejtimet etj. Kështu duhet të kuptohet kjo çështje, më duket mua, dhe jo të prishen rregullat që kemi vendosur dhe të merret, kur t'i dojë qejfi koman-

dës, gjithë elementi më aktiv nga prodhimi, nga fushat, nga fabrikat, uzinat, kantieret e ndërtimit etj. dhe t'i çojë t'u bëjë stërvitje «suplementare». Përse t'i marrësh këta dhe të bësh orë «suplementare», apo pse kuadrot nuk punuan vetë seriozisht që t'i bënin mirë orët e caktuara të mësimëve brenda atyre ditëve që janë parashikuar? Kur i kemi vendosur dhe caktuar këto afate, kemi llogaritur që kjo kohë është plotësisht e mjaftueshme për këtë qëllim. Orëve të tilla «suplementare» të mësimi duhet t'u vëmë fre, siç u vumë fre mbledhjeve të organizatave të Partisë në ushtri me komunistët rezervistë që të bënin 3 ose e shumta 4 herë në vit, se në fakt bëheshin shumë, ngaqë për çdo urdhër ose komunikatë që lëshohej nga Ministria e Mbrojtjes, thërriteshin edhe komunistët rezervistë të bënin mbledhje tok në repart. Jo, shokë, s'duhet t'i lëmë të na zhvillohen kështu punët sipas dëshirave të njërit apo të tjetrit.

Flitet shumë për integrim, po nuk kuptohet plotësisht kjo çështje. Unë e shtroj problemin kështu: drejtuesit e Partisë e të pushtetit dhe kuadro të tjerë në rreth duhet të mbajnë lidhje të ngushta me kuadrot drejtues të njërive e të reparteve ushtarake që janë në rrethin e tyre, të bisedojnë e të konsultohen me ta jo vetëm për stërvitjet në kohë paqëje, por edhe për detyrat që do të kryejnë secili dhe së bashku në rast lufte. Ky bashkëpunim të realizohet jo vetëm në mbledhje të komanduara, në stërvitje, por edhe në raste të tjera, sepse problemet e mbrojtjes janë të gjithëve. Drejtuesit e Partisë në çdo kohë, pa pritur stër-

vitjet, mund dhe duhet të interesohen e të njohin gjendjen në ushtri, si është disiplina, si shkon përvetësimi i programeve të përgatitjes politiko-luftarake, sepse në bazë të njohjes së gjendjes do të ndërtohet edhe puna e organizatave të Partisë të terrenit dhe të ushtrisë.

Me një fjalë vendoset me kohë, qysh tani në kohë paqeje, një bashkëpunim i tillë terren-ushtri. Pra format e integritit janë të ndryshme. Pastaj shumë gjëra janë të përcaktuara qartë dhe me të gjitha format që dimë. Por për këto dhe për një sërë problemesh të tjera që kanë të bëjnë me ushtrinë, kështu duhet të diskutojnë me njëri-tjetrin drejtuesit e terrenit me ata të ushtrisë. Bashkëbisedime të tilla është e nevojshme të bëhen edhe për shumë çështje të tjera me karakter operativ dhe strategjik, që kuadrot e terrenit të përgatiten që tani për të drejtuar mirë edhe në kohë lufte.

SHOKU RAMIZ ALIA: Sekretari i komitetit të Partisë të rrethit mund të konsultohet me komandantin e njësisë ushtarake, për shembull, se ç'rol do të luajnë forcat vullnetare në rast se armiku do të zbar-kojë në filan vend.

SHOKU ENVER HOXHA: Bile, ta pyesë se në këto vende ç'forca mund të dërgohen, gra apo burra, me qëllim që qysh tani forcat vullnetare të njihen mirë me detyrat e tyre në kohë të veçantë.

A bëhen të tilla bisedime në mes tyre? Po të bëhen këto, veç përfitime ka, sepse ne bëjmë përgatitjen luftarake të të gjithë popullit. Të mos mendojmë

në se në stërvitjen që bëhet në ditët e caktuara për një vit arrihet çdo gjë, pse edhe gjatë kohës jashtë stërvitjes edhe në qendra pune e prodhimi e në shkollë duhet të punohet për çështjen e mbrojtjes, duhet të veprohet ashtu si thashë, të vendoset një bashkëpunim i ngushtë midis Partisë në terren dhe njësisë së ushtrisë që është e vendosur atje. Çështja është që shokët e Partisë të terrenit të rrojnë me shqetësimin e vazhdueshëm që kërkon puna për forcimin e mbrojtjes së atdheut. Prandaj të dyja palët duhet të gjejnë kohën dhe mënyrën dhe të bashkëpunojnë ngushtë me njëra-tjetrën për këto probleme, ta ndiejnë rievonjen e bisedimeve e konsultimeve të përbashkëta, ta ndiejnë nevojën e shkëmbimit të mendimeve në mes udhëheqjes së rrethit dhe shtabit të njësisë, në mes sekretarit të Partisë të kooperativës bujqësore dhe komandantit të repartit që kompletohet me forcat e kooperativistëve e kështu me radhë.

Mua më duket se një bashkëpunim i tillë midis terrenit dhe ushtrisë luan një rol të madh dhe është i domosdoshëm. Duke vepruar kështu, ne do t'i kemi përgatitur si duhet shtabet, kuadrot, por do të kemi përgatitur njëkohësisht edhe ushtrinë, edhe popullin e armatosur, sepse gjatë kësaj kohe Partia në terren dhe në ushtri punon të rritë nivelin e njohurive ushtarake të tyre, të forcojë disiplinën e të rritë ndërjegjen e njerëzve.

Partia punon me njerëzit, me kuadrot që çështjet të mos i kuptojnë në mënyrë shabllone, duke vepruar vetëm me urdhra, me vendime, në mbledhje zyrtare.

Vendimet e direktivat kuptohen dhe zbatohen drejt jo vetëm duke bërë mbledhje zyrtare, por në praktikën e në kudhrën e jetës, ku edhe punohet, edhe zhvillohen njohuritë, ku aftësohen më shumë e më mirë të gjithë, si kuadrot drejtues të Partisë, të pushtetit e të ushtrisë, edhe të gjithë njerëzit tanë që përgatiten për mbrojtje. Integrimi, pra, bën që të gjitha veprimet të jenë të koordinuara mirë, që të gjithë të jenë të përgatitur si duhet politikisht dhe ushtarakisht.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda e
incizuar, që gjendet në AQP*

PUNA ME NJERËZIT ESHITË THELBËSORE NË ÇDO PROBLEM

*Nga biseda në takim in ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

16 mars 1979

Shokët udhëheqës të Partisë duhet ta konsiderojnë veten të lidhur ngushtë me Partinë në bazë, të lidhur ngushtë me kuadrot. Kur studiojnë një problem të shikojnë anët teknike dhe teoritë që lidhen me të, të cilat asnjë nuk mund të pretendojë se i di të gjitha. Kuadri i Partisë mund të mos i dijë që në fillim teoritë që lidhen me problemin, por ai ka një eksperiencë pune në çështjet e drejtimit e të organizimit, gjë që e ndihmon të ketë kujdes në teoritë e ndryshme që shfaqen dhe të arrijë të krijojë një mendim se cila nga këto është më e drejtë, më e përshtatshme, më e arsyeshme, më konkrete, më objektive. Kur kuadrit drejtues i mbushet mendja që të thellohet në këtë ose atë teori kryesore për problemin që interesohet, atëherë kërkon ndihmë nga ata që e njohin në thellësi këtë problem. Të flasim konkretisht për naftën.

Në goftë se ju, shoku Hekuran, që u caktuat të jeni në krye të komisarariatit të posaçëm, mbani lidhje të ngushtë me njerëzit e naftës dhe me të gjithë njerëzit e tjerë, do të fitoni një eksperiencë të madhe. Kjo eksperiencë do të na ndihmojë ne të japim mendime të sakta, ndryshe mund të biem në subjektivizëm. Subjektivizmi duhet luftuar, se të çon në njëanshmëri.

Prandaj, çështja është që jo vetëm në udhëheqjen e Partisë e të shtetit duhen gjykuar problemet kryesore në mënyrë kolektive, por kjo metodë duhet praktikuar kudo. Të rrihen e të ballafaqohen mendimet e të gjithëve. Rëndësi ka që këto mendime që shfaqen, të mos zgjaten e të bëhen tërkuzë, por, nga eksperiencia e madhe e masave dhe e kuadrove, të arrijmë të konceptojmë atë që është e arsyeshme dhe e drejtë dhe të bëjmë sintezën. Pasi të rrihen mendimet, merret vendimi. Praktika do të na bëjë që të bindemi nëse vendimi që kemi marrë është i drejtë ose jo. Gjithashtu do të na kujtohen edhe diskutimet e vërejtjet që ka bërë ky ose ai shok. Praktika do të na tregojë gjatë rrugës, se në këtë drejtim, deri këtu, kemi ecur mirë, por, për drejtimin tjetër, duhet të studiojmë më thellë problemin që ka ngritur një shok. Kjo eksperiencë duhet njohur që të përdoret nga kuadrat.

Çështjen e shtroj edhe për sektorët e tjerë, por veçanërisht për naftën. Ne duhet të njohim njerëzit që punojnë në këtë sektor, që të dimë edhe ku të vëmë dorë. Të gjithë jemi të bindur se, në këto situata, sektori

I naftës ka nevojë të forcohet, prandaj, në radhë të parë, duhet parë puna me njerëzit, me kuadrot. Kjo çështje duhet kuptuar në mënyrë marksiste-leniniste. Stalini e kanë akuzuar se gjoja kishte gabuar kur thoshte se kuadri zgjidh gjithçka. Në qoftë se me kuadro kuptohen zyrtarët burokratë që qëndrojnë larg masave, që formojnë një rreth të ngushtë njerëzish që kanë interesa të kundërt me masat, atëherë ky koncept nuk pajtohet me atë që kishte Stalini për kuadrot. Stalini nuk mund ta mendonte kurrë kështu kuadrin e Partisë. Stalini bënte fjalë për kuadro marksistë-leninistë, masovikë, popullorë që shkriheshin e sakrifikoheshin për interesat e proletariatit. Kuptimi i kundërt nuk mund t'i vishet Stalinit e marksizëm-leninizmit.

Kur bëjmë përcaktimin e kuadrove udhëheqës në mënyrë marksiste-leniniste, në radhë të parë, kemi parasysh gjithë anëtarët e Partisë. Kur themi që Partia udhëheq, nuk mund të mendojmë vetëm anëtarët e forumeve të zgjedhura, por gjithë masën që përbën Partinë. Por ne kemi një koncept të gjerë për kuadrin. Në këtë kuptim kuadro janë të gjithë ata që kanë mbaruar universitetin dhe janë caktuar për të kryer detyra të ndryshme, pavarësisht se janë apo nuk janë anëtarë partie. Edhe për kuadrot e kategorive më të ulëta ne bëjmë përpjekje që t'u japim instruksione, njohuri që të bëhen specialistë. Edhe një punëtor jo shumë i kualifikuar, por që drejton mirë sektorin e punës ku është caktuar, në vetvete është një kuadër.

Në qoftë se kuadri kuptohet me të vërtetë nga pozitat marksiste-leniniste, si një subjekt i pashkëputur nga gjerësia e detyrave që i cakton shoqëria socialiste, ai ka një rëndësi të madhe. Përkundrazi, kur kuptohet ngushtë nocioni kuadër dhe ngrihet pyetja: «Po të tjerët që s'janë kuadro e që nuk vendosin, çfarë janë?» tregohet cektësi dhe prirje e keqe, antimarksiste. Kush e vë në zbatim vendimin? Masat, por nuk duhet harruar, se edhe kur zbatohet një direktivë, kërkohet mendim, punë krijuese, zgjidhje problemesh e marrje vendimesh nga kuadrot dhe masat së bashku. Kështu, nga lart-poshtë vijmë deri te pusi, ku disa i quajmë kuadro e disa punëtorë. Por edhe këta punëtorë kanë kualifikim, pra, përbëjnë një ushtri të madhe kuadrosh.

Ne duhet të krijojmë një situatë më të qartë për sa u përket kuadrove të sektorit të naftës. Kjo situatë, nuk mund të arrihet në një ditë. Ne jemi objektivë. Po ç'do të thotë të jesh objektiv? Do të thotë ta njohësh dhe ta gjykosësh drejt realitetin ashtu siç është, gjë që arrihet duke i dëgjuar njerëzit, duke respektuar mendimet e tyre dhe duke gjykuar në bazë të rezultateve që do të japin këto mendime. Por mendimet, veprimet dhe organizimet e njerëzve duhet t'i gjykojmë në bazë të parimeve, por njëkohësisht edhe në bazë të rezultateve. Mbi këtë bazë të krijojmë një gjykim të shëndoshë edhe për kuadrot e sektorit të naftës. Për këtë gjë, mendoj se kemi jashtëzakonisht nevojë. Këtë mendim për kuadrin ta krijojmë me bindje, me themel e të mos themi për të një herë: «E ke-

mi më të mirin», kurse më vonë, kur ai shpreh një mendim ose teori të vetën, të bëhet vlerësim i kundërt. Mirëpo ai është specialist, ka dituri për naftën dhe ato që thotë vërtetohen. Ne nuk e kemi mendimin aq shkencor sa mund ta ketë një specialist për naftën, prandaj njohuritë e tij shkencore dhe mundësitë e tij të gjera t'i gjykojmë objektivisht dhe t'i shfrytëzojmë. Natyrisht, jo çdo gjë që thotë ai mund të jetë e drejtë. Mundet që, në një rast apo në një rast tjetër, specialisti të jetë edhe subjektiv. Në këto raste këtij specialisti, që i ka dalë nami se është autoritet në fushën e naftës, mund t'i thuhet se «nuk e ke drejt këtë mendim» dhe ta ndihmojmë që ta kuptojë.

Ne duhet të shikojmë mirë dhe objektivisht te njerëzit, te kuadrot, në radhë të parë mendimet, sjelljet, ndërgjegjen, punën, mënyrën e organizimit dhe rezultatet që arrihen në punë. Mbi bazën e këtyre treguesve t'i cilësojmë edhe kuadrot e industrisë së naftës e të gazit. Partia atje, në sektorin e naftës, si kudo, rron vazhdimisht me punonjësit dhe me kuadrot, të cilët i shikon në punë; i ndihmon, i orienton, i kontrollon, u jep detyra. Komisariati, mendoj se do të ndihmojë shumë në drejtimet që përmenda, si dhe në marrjen e masave konkrete për zbatimin korrekt dhe me rreptësi të vendimeve të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë për nxjerrjen e naftës dhe të gazit, për zbatimin rigoroz të shkencës, për marrje vendimesh shkencore, për të njohur e për të vlerësuar kualitetet e njerëzve dhe për të korrigjuar të metat e tyre.

Kemi thënë se komisariati mund të funksionojë

një vit, ashtu sikundër mund të funksionojë dy vjet ose tre vjet¹. Kompetencat dhe autoriteti që i jepen atij, t'i shërbejnë pikërisht plotësimit të qëllimit të Partisë. Por komisarati do t'i zbatojë detyrat që i ngarkohen duke njohur e duke vënë në lëvizje mendimet e njerëzve. Këto mendime kanë rëndësi të jashtëzakonshme, prandaj duhet lënë të shfaqen, të përplasen me njëri-tjetrin për të dalë e mira në shesh. Mendimet e punëtorëve, të kuadrove e të specialistëve do të çmohen të mira e të drejta kur të verifikohen në praktikë, në punë, kur arrihen rezultatet e dëshiruara.

Partia ka nevojë për njerëz të përgatitur politikisht, ideologjikisht dhe teknikisht, prandaj duhet vënë dorë që të gjenden jo një, por aq kuadro sa na nevojiten. Po të hiqet një kuadër, të mos jetë zor për ta zëvendësuar me një tjetër, ose kur të suprimohet i tërë komisarati, për arsye se nuk do të ketë më nevojë për ndihmën e tij, puna të vazhdojë normalisht. Situata në sektorin e naftës do të jetë e qartë, kur fushat e naftës, sistemet e nxjerrjes, të organizimit, të mobilizimit do të jenë përcaktuar mirë; kur gjendja politike, ideologjike e anëtarëve të Partisë e të masave, nëpërmjet punës së Partisë dhe asaj shtetërore, do të jetë në nivelin e duhur. Kështu ne do të jemi në gjend-

1. Në mbledhjen e saj të datës 3.9.1981, Byroja Politike e KQ të PPSH, pasi vlerësoi punën që bëri gjatë dy vjetëve komisarati i posaçëm për naftën dhe gazin, arriti në përfundimin se me krijimin e Ministrisë së Energjetikës nuk është më e nevojshme qenia e këtij komisarati.

je të dimë se mendimi i këtij ose i atij specialisti është i drejtë.

Edhe ministria të shkundet mirë, sa të arrijë që të gjykojë se është në gjendje ta marrë gjithë punën në dorë dhe të vendosë, për shembull, shpimin e këtij ose të atij pusi. Siç dihet, ka puse për shpimin e të cilave vendos ministria, ka dhe puse për të cilat vendos Qeveria. Vendimet e Qeverisë ose të ministrisë për këto probleme nuk duhet të merren formalisht. E mira e punës kudo e kurdoherë kërkon të ecet me një frymë të shëndoshë e me ndjenjë përgjegjësie. Të ecet me një metodë pune të tillë që, fjala vjen, Qeveria të mos marrë vendim vetëm se i propozon ministria dhe, kjo e fundit, të mos propozojë vetëm se ashtu i ka thënë, për shembull, drejtori i Institutit të Naftës e të Gazit, por secili organ, brenda kompetencës së vet, të vendosë pasi të jetë bindur plotësisht në drejtësinë e vendimit që merr. Të bëhet kujdes që ta forcojmë procedurën e shpimeve, të vërejmë mirë punën që bëhet dhe, gjatë punës, të shikojmë kuadrot që t'i vëmë në vende të përshtatshme.

Puna, siç e përfytyroj unë, është e shumanshme. Objektivi kryesor është gjetja e fushave të reja naftëmbajtëse për t'i dhënë atdheut sa më shumë naftë. Në gjithë gamën e punës vëmendja duhet përqendruar edhe në drejtimin që kuadrot me përvojë t'i vendosim aty ku duhet, me qëllim që këta të mësojnë edhe kuadrot e tjerë. Për të arritur këtë objektiv me shumë rëndësi duhet të kemi një pikëpamje të gjerë marksiste-leniniste për kuadrin.

Ti, Hekuran, do të mbikëqyrësh sektorin e naftës, por edhe problemet e tjera, që do të hasësh në punën tënde, do t'i shikosh. Kontaktet me sekretarët, me byrotë e Partisë në rrethe etj., pavarësisht se do të ngarkohet një sekretar tjetër i Komitetit Qendror dhe do të ndiqen nga sektorë të tjerë të aparatit, prapë ti, si anëtar i Byrosë Politike, mos i lër. Ti nuk do t'i shikosh më këta sektorë ashtu si do të shikosh naftën, sepse për atë gjë po të caktohet tashti një detyrë e veçantë, por sidoqoftë nuk mund të mos e thuash fjalën tënde edhe për këto probleme. Mendimi që mund të japësh dhe që duhet të japësh edhe për punët e tjera të Partisë ka rëndësi. Nafta është nën tokë, por nuk duhen harruar edhe gruri e misri që janë mbi tokë. Duhet parë nëse gruri është mbjellë apo nuk është mbjellë mirë, nëse misri është korrur apo nuk është korrur në kohë etj. Ne duhet të jemi të atillë njerëz që të kryejmë jo vetëm atë detyrë që na ngarkon Partia, por ta kemi syrin dhe të ndihmojmë edhe në sektorët e tjerë. Ne jemi udhëheqës që na kanë zgjedhur në Byronë Politike për të mos harruar as detyrën e veçantë kryesore, as detyrat e tjera.

Puna me kuadrin ka shumë hallka. Ajo është, si të thuash, një zinxhir, që duhet kuptuar në tërësinë e tij. Një drejtor i mirë di të edukojë morinë e kuadrove me të cilët bashkëpunon, di t'i gjykojë dhe t'i çmojë vartësit objektivisht e jo në mënyrë subjektive, di të japë urdhra që puna të organizohet mirë. Në një kooperativë të bashkuar, për shembull, të përbërë prej dhjetë fshatrash, kryetari nuk mund të

kalojë çdo ditë në të tëra fushat, por ai mund t'i drejtojë sektorët, duke vënë në lëvizje kuadrot e tjerë, duke i këshilluar, dëgjuar dhe duke i kontrolluar ata. Në qoftë se e bën këtë gjë, ky kryetar jep një ndihmë të madhe, është i mirë. Nuk i bën dot të tëra punët kryetari apo drejtori, por këta duhet të mobilizojnë të tjerët, duke komunikuar mirë me ta. Pse bëhet një kuadër kryetar kooperative apo drejtor ndërmarrjeje? Sepse është nga kuadrot më të mirë, por kjo nuk do të thotë aspak se ky mund t'i zgjidhë vetë të gjitha problemet e kooperativeve ose të ndërmarrjes.

Çështjen e kuadrit në sektorin e naftës duhet ta shikojmë mirë. Ka kuadro të mirë e të aftë në këtë sektor? Unë jam i bindur se ka, por ne nuk i njohim mirë kuadrot. Nga kuadrot e naftës, të paktën unë, njoh tre-katër specialistë dhe shokët e tjerë të këtij sektori, që i kemi të zgjedhur në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë. Mirëpo në Institutin e Naftës e të Gazit, në rajonet e ndryshme të naftës ka shumë inxhinierë, gjeologë e të tjerë, që unë nuk i njoh, dhe nuk shoh të na vijnë këtu mendimet e tyre. Kur ne kritikuar dhe goditëm punën armiqësore në naftë, atje dolën disa emra për keq, por dolën edhe për mirë disa të tjerë. Ata janë atje dhe kanë fituar eksperiencë, por ne nuk jemi interesuar për t'i njohur. Këtu nuk shtrohet çështja t'i njohim të tërë me emra, por të paktën disa gjeologë të shquar të vendit tonë, dhe që janë të vendosur, duhet t'i dëgjojmë, se është bërë zakon që, kur shtrohen probleme të naftës në Qeveri ose në Komitetin Qendror, fjalën e fundit ta thotë një

njeri i vetëm si specialist. Mirëpo mendime të vlefshme kanë e mund t'i thonë edhe specialistët e tjerë, të cilët duhen inkurajuar e ngritur.

Unë nuk them që Byroja Politike duhet t'i dijë të gjithë inxhinierët e naftës me emra, por këta t'i dijë të paktën Ministria e Industrisë dhe e Minierave. Po t'i thuhet ministrisë që të hiqet, fjala vjen, drejtori i ndonjë ndërmarrjeje të naftës se nuk bën, ajo të thotë amin, po s'di të thotë se cilin do të vëmë në vend të tij. Për këtë qëllim do të na vijë karakteristika e ndonjërit e shkruar me tri radhë. Gjer më sot neve nuk na është raportuar se gjatë studimeve që janë bërë në sektorin e naftës, janë shquar tre-katër organizatorë euj., etj. Neve na vijnë njoftime, për shembull, që sekretari i komitetit të Partisë ose kryetari i komitetit ekzekutiv të një rrethi janë të mirë, por për kuadrot që kanë në dorë këtë sektor jetik të ekonomisë, siç është nafta, nuk na thuhet asgjë!! Drejtori i përgjithshëm i naftës do të na i gjejë kuadrot që duhen ngritur në këtë sektor? Dakord, edhe ai të na ndihmojë për t'i gjetur, por kjo nuk e zgjidh problemin. Vitet kalojnë dhe prapë ne mbetëm në disa kuadro, sepse janë vetëm këta që na vijnë vazhdimisht këtu. Të tjerët, që tregojnë zotësi, «nuk dalin mbi ujë». Këtë gjë duhet ta vëmë në vijë.

Pas gjithë atyre që na ndodhën në naftë duhet t'i shikojmë me kujdes kuadrot, se disa mund të kenë bërë gabime, por mund të jenë njerëz të mirë e të aftë, prandaj meritojnë t'u jepet dora. Si duhen inkurajuar? Këta mund të thërrihen në mbledhje të posaçme, ku

studiohet një problem, u kërkohet mendimi dhe dëgjohen me vërejtje. Në fund, pasi të këmbehen mendime, gjykohet nëse ato që tha ky ose ai ishin ose jo të drejta. Kur pranojmë mendimin e këtij ose të atij specialisti, ta inkurajojmë, t'i themi bile që ti ke pasur dhe disa të meta e gabime, por ne po konstatojmë se ke ide të mira, prandaj merre përsipër këtë punë dhe çoje deri në fund. Kësaj i thonë t'i japësh dorën atij që gabon dhe të mos lejosh që, bashkë me drutë e thata, të na digjet edhe druri i njomë. Prandaj, gjatë punës, e cila është e shumanshme, nëpër mbledhje, por sidomos në konsultime me shokët e Partisë të sektorit të naftës, të formohet një mendim, një bindje për kuadrin. Puna me njerëzit është thelbësore në çdo problem.

Kur t'ju shohin ju në gjirin e tyre, te naftëtarët do të krijohet një ndjenjë e fortë besimi për plotësimin e detyrave që u janë caktuar. Për gjërat e tjera, për kërkesat e ankesat e tyre, ti nuk do të merresh drejtpërdrejt, por do t'i dëgjosh për t'ia ngritur sekretarit të komitetit të Partisë ose kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Fierit, për shembull, të cilëve do t'u kërkosh, që shtëpitë t'i ndajnë duke respektuar rregullat e vendosura, duke evituar padrejtësitë etj.

Pra, me gjërat që s'janë kryesore ti nuk do të merresh, por ama nuk do të lësh pa u hequr veshin atyre që nuk i zgjidhin drejt e në kohë. Kështu që naftëtari që të bëri një kërkesë do të shohë se megjithëse i the se nuk merresh me këto gjëra, prapë je kujdesur, i ke qarë hallin, sepse pas bisedës me ty, atij i vajtën shokë nga komiteti dhe, në një mënyrë

apo në një mënyrë tjetër, biseduan shtruar me të. Dhe kjo i bën punëtorët të kenë më shumë besim te Partia, dhe kur të na thotë kjo mobilizohuni, ne do ta dëgjojmë dhe do të rrimë pa gjumë te pusi. Kur ju nuk e dëgjoni punëtorin për hallet që ka, ky do të mendojë: për strehimin, apo për ndonjë çështje tjetër, që i thashë unë, ky nuk e çan kokën, prandaj edhe unë nuk po e çaj kokën për punën. Duhet t'i kuptojmë të lidhura, siç janë në të vërtetë, këta interesa.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e incizuar, që gjendet në AQP*

KOMISARIATI DO TË VEPROJË PA SPOSTUAR ORGANET PËRKATËSE TË PARTISË E TË SITETIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

19 mars 1979

Këtë mbledhje të Byrosë Politike e bëjmë për të diskutuar projektvendimin që na paraqitet për krijimin e komisarariatit të posaçëm për industrinë e naftës dhe të gazit.

Gjendjen e naftës, në përgjithësi, e kemi marrë në analizë në Byronë Politike dhe sidomos në Qeveri. Në këtë sektor me rëndësi të ekonomisë sonë kemi konstatuar disa suksese, por edhe të meta serioze. Vërehen përpjekje për realizimin e detyrave, por ka dhe vështirësi që duhen kapërcyer. Në sektorin e naftës e të gazit vërehen mungesë disipline, mosrealizime, pakujdesi

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth projektvendimit të paraqitur për krijimin e komisarariatit të posaçëm për industrinë e naftës dhe të gazit.

në kryerjen me përpikëri të detyrave, ka edhe liberalizëm. Nuk përjashtohet në këtë situatë që të ketë edhe punë armiqësore.

Ideja, që na shtyu të propozojmë krijimin e një organi të tillë, nuk lindi ngaqë Partia dhe Qeveria nuk e kanë në dorë situatën e naftës e të gazit, por sepse në zbatimin e vendimeve dhe në veprimtarinë e institucioneve që merren me drejtimin e punimeve, vërehen paqartësi. Ka edhe kuadro që merren me naftën dhe gazin, të cilët s'janë shumë të kthjellët, kanë mjegull për probleme kardinale. Kjo turbullirë ndikon shumë në moszbatimin konkret e si duhet të detyrave që janë caktuar¹.

Janë bërë dhe bëhen përpjekje që të forcohet puna në sektorin e naftës e të gazit, por mendimi im, besoj dhe juaji, është se ka nga kuadrot që drejtojnë këtë sektor, të cilët nuk janë si duhet në ballë të punës, lejojnë çorganizime, kanë mendime të papërcaktuara shkencërisht. Me pak fjalë atje po livadhiset me «teori» të ndryshme, siç janë ato për prejardhjen e naftës, për strukturat, për shpimet, për kërkimet, për interpretimet e gjeofizikës etj., etj.

Ne marksistë-leninistët duhet të zgjedhim dhe do të zgjedhim atë rrugë që na tregon teoria jonë. Me mjetet që disponohen, por edhe me konkluzione logjike të

1. Koha vërtetoi se këto çrregullime e turbullira në sektorin e naftës ishin pasojë edhe e veprimtarisë armiqësore të kamufluar të Mehmet Shehut, i cili orvatej t'i burokratizonte aparatet shtetërore, të shmangte drejtimin dhe kontrollin e Partisë, të dobësonte e të liberalizonte kontrollin shtetëror.

forta, si edhe me një disiplinë të fortë mund të kapërcen vështirësitë edhe kur mungojnë disa aksesorë. Po t'i kishim edhe këta aksesorë, do të ishte shumë më mirë, sukseset do të ishin më të sigurta, por, edhe kur nuk kemi mundësi t'i sigurojmë këta, prapë me një disiplinë të rreptë proletare në punë, mund të pësojmë më pak dëmtime. Kjo gjendje na shqetëson të gjithë, shokë, prandaj menduam t'ju propozojmë krijimin e një komisariati, që do të jetë një organ i veçantë, i cili do të përgjigjet për veprimtarinë e tij para Komitetit Qendror të Partisë dhe Qeverisë.

Me shokun Hekuran Isai, që e propozojmë të kryesojë komisaratin e posaçëm për industrinë e naftës, kemi diskutuar mjaft herë në takimet që kemi pasur në sekretarët e Komitetit Qendror të Partisë, kemi folur për kompetencat, për metodën e punës, për sjelljet me kuadrot etj., etj. Shokët që kanë hartuar projektvendimin janë përpjekur t'i caktojnë drejt kompetencat e komisariatit. Puna do të na tregojë më mirë nëse i kemi caktuar si duhet apo jo të gjitha sa kërkohen.

Çështja kryesore, që dua të theksoj në këtë mbledhje, është ajo që të mos mendohet se komisarati do të jetë «shpëtimtari i naftës». Industria e naftës dhe e gazit, ashtu si gjer tani edhe në të ardhmen do të udhëhiqet nga Partia dhe Qeveria në qendër dhe në rrethe, do të drejtohet nga Ministria e Industrisë dhe e Minerave, që është organ qendror i administratës shtetërore i specializuar për veprimtarinë edhe në fushën e naftës e të gazit.

Për industrinë e naftës ka ligje, vendime, urdhëresa, ka rregullore dhe plane të aprovuara nga organet kompetente, zbatimin e të cilave do ta ndjekin ministria, Qeveria, Byroja Politike dhe Komiteti Qendror i Partisë. Të gjithë ne, shokë, jemi përgjegjës para Komitetit Qendror të Partisë që të plotësohet, bile të tejkalohet detyra e Kongresit të 7-të që të hapen horizonte dhe perspektiva akoma më të gjera për naftën dhe gazin. Kjo është absolutisht e domosdoshme, prandaj plotfuqishmëria që i japin Byroja Politike dhe Qeveria komisariatit që krijohet, të mos kuptohet si një spostim që u bëhet organeve përkatëse të Partisë dhe të shtetit.

Plotfuqishmëria dhe marrja e masave në vend nga komisariati do të gjejë zbatim praktik vetëm brenda normave ligjore. Mbështetja kryesore e këtij komisariati është ministria me drejtoritë e saj, janë punëtorët dhe specialistët e naftës në bazë, janë edhe komitetet e organizatat-bazë të Partisë. Komisarati, si organ i jashtëzakonshëm, do të ketë funksione të veçanta; ai do të kontrollojë e do të marrë masa në vend për zbatimin e përpiktë të orientimeve, direktivave dhe vendimeve të Partisë e të Qeverisë për industrinë e naftës, do të gjykojë mirë situatat, duke dëgjuar me kujdes zërin e njerit dhe të tjetrit në të gjitha drejtimet e punës së naftës. Këtu del nevoja e aftësisimit dhe e rritjes së kapacitetit të njerëzve. Kjo aftësi do të fitohet nga eksperiencia, nga rrahja e mendimeve, duke ndihmuar ata që e kanë drejt dhe duke inkurajuar njerëzit për të marrë vendime shkencore që të zbatohen plani i shtetit dhe

vendimet e Komitetit Qendror të Partisë e të Qeverisë.

Komisariati nuk ka përse të hyjë në hollësira që nuk i takojnë si, fjala vjen, munguan pesë ose dhjetë automjete, mungoi çimentoja ose diçka tjetër. Komisarati, pasi bën llogaritë, pasi merr edhe mendimin e shokëve, arrin në konkluzionin, për shembull, që në këtë zonë të shpohen 20 puse dhe urdhëron që të vihen sonda për aq kohë sa shikohet e nevojshme. Ai do të kërkojë që të gjitha këto puse të jenë doemos në gatishmëri në afatin e caktuar. Se ku do të gjendet çimentoja, ku do të gjendet kamioni etj., këto janë punë që u përkasin organeve shtetërore, këto çështje do t'i zgjidhë ministria me drejtoritë e saj dhe jo komisarati, i cili do të kërkojë llogari, do t'i vërë para përgjegjësisë ose do t'u shtrëngojë dorën autorëve për rezultatet e arritura. Në qoftë se detyra e ngarkuar zvarritet ose neglizhohet, komisarati përsëri do të marrë masa të studiara në vend, pa u nxituar dhe pa vepruar në mënyrë arbitrare. Kur e gjykon të domosdoshme, komisarati ka të drejtë të pezullojë nga puna ata kuadro që nuk i kryejnë detyrat dhe t'u propozojë organeve kompetente shkarkimin nga detyra të çdo kuadri, qoftë ky edhe i lartë, kur rezulton se mban përgjegjësi për mosrealizimin e detyrave.

Një ndër detyrat kryesore të komisaritit është që të ngrejë akoma më lart ndjenjën e përgjegjësisë së naftëtarëve, ndërgjegjen politike, ideologjike, organizative dhe teknike të të gjithë punonjësve të naftës, duke filluar që nga Ministria e Industrisë dhe e Minerave e

dcri në bazë. Këtë punë shumë të rëndësishme, natyrisht, nuk do ta bëjnë vetëm disa quadro e specialistë të komisarariatit. Zotësia e tyre duhet të konsistojë në atë që këta, vazhdimisht, të jenë të lidhur me Partinë në qendër, në rrethe e në bazë, të jenë të lidhur me ministrinë dhe me organe të tjera shtetërore, që t'u dalin punëve në krye bashkërisht. Zbulimi i shkaqeve që pengojnë realizimin e detyrave nuk arrihet kurrë me «shkopin e madh», por me sqarim e me bindje. Mbi këtë bazë duhet të merren vendimet dhe të ushtrohet kontrolli për zbatimin e tyre. Në fushën e organizimit e të kontrollit, komisarati do të kërkojë llogari nga kushdo, nga drejtori i shpimit apo nga çdo person tjetër se për ç'arsye nuk po plotësohen detyrat në kohën e duhur. Secili ka detyrat dhe kompetencat e veta për të realizuar planet. Në qoftë se nuk i ka të gjitha kushtet e punës që i nevojiten, secili le të ankohet në ministri, gjersa t'i plotësohen. Komisarati do të urdhërojë që të bëhet kjo dhe ajo punë për të cilën është marrë vendim, pasi është arsyetuar mirë e mirë dhe nuk do t'i pranojë justifikimet e asnjërit që do të kërkojë të mbulojë neglizhencat. Në raste të tilla ai meir masa në bazë të kompetencave që i janë dhënë nga Komiteti Qendror dhe nga Qeveria.

Krijimi i komisarariatit të posaçëm për naftën dhe gazin ka për qëllim të ndihmojë për të kapërcyer sa më shpejt gjendjen e krijuar në këtë degë të industrisë. Nuk mund të them se tani e tutje çdo gjë do të shkojë si sahat, eksperiencia do të na tregojë se ç'fryte do të na japë ngritja e këtij organi të posaçëm. Unë

besoj se, po të kuptohen drejt nevojat për naftën. dhe gazin, qëllimet e Partisë për nxjerrjen dhe për shfrytëzimin e tyre, si dhe detyrat që rrjedhin nga situatat, punët do të na shkojnë si duhet.

Komisariati nuk po krijohet për të ndrydhur iniciativat e njerëzve, as për të bërë sehir, por në radhë të parë për të ndihmuar. Kur kërkohet llogari e rreptë, jepet edhe ndihmë më e madhe. Punonjësit tanë, që janë të ngritur politikisht, duhet ta kuptojnë mirë se ata që nuk janë të disiplinuar, që nuk zbatojnë rregullat dhe nuk plotësojnë planin, nuk mund të pretendojnë se i shërbejnë atdheut. Mund të thuhet tërë ditën e tërë natën me fjalë që jemi të gatshëm të derdhim gjakun, jemi të gatshëm për të bërë këtë e atë sakrificë, po në qoftë se mungon gatishmëria për të kryer konkretisht e me përpikëri të madhe detyrën e ngarkuar, zor se mund të forcohet atdheu socialist.

Prandaj, mua më duket që jo vetëm shokët e komisarariatit, por të gjithë duhet ta kemi të qartë se ky organ i posaçëm nuk po krijohet që t'u presë iniciativat punonjësve e kuadrove të kësaj dege ose që t'i ndrydhë këta. Përkundrazi, ai krijohet që t'i vërë më mirë në lëvizje forcat krijuese, mendore dhe fizike të tyre. Ne kemi njerëz me shumicë që mendojnë drejt, që kanë zotësi, që bëjnë studime, që kanë kurajë, që bëjnë propozime, prandaj ky organizëm i ri që po ngremë, duhet të ndihmojë në shpërthimin e vrullit revolucionar në punë, në krijimin dhe në shfrytëzimin e mundësive të mëdha jashtë caqeve që ishin caktuar. Aprovohet apo jo një propozim, bie fjala,

për të mos u bërë një gjë që është vendosur dhe për t'u bërë në vend të saj diçka tjetër që ka interes ekonomik më të madh, kjo varet nga organi kompetent. Për çështjet shumë të rëndësishme, që s'janë në kompetencën e tyre, që nuk marrin dot vendim as komisarati, as ministri, por sipas rastit, Komiteti Qendror ose Qeveria, kjo nuk do të thotë që të mos mendohet, të mos studiohet, ose të mos propozohet edhe për probleme që hyjnë në juridiksionin e organeve më të larta.

Dua të theksoj se krijimi i komisarimit të posaçëm për naftën dhe gazin nuk ndryshon asgjë në raportet e gjertanishme të organeve të Partisë dhe të atyre shtetërore. Këtë ta kemi të qartë. Që nga shoku Pali Miska, shoku Xhafer Spahiu¹ dhe deri tek tekniku i pusit, secili duhet të kryejë detyrën dhe të mbajë përgjegjësi për të. Ministri nuk varet nga komisarati, por nga Këshilli i Ministrave. Dispozitat kushtetuese, që i njohin të drejtën Këshillit të Ministrave për të drejtuar dhe për të kontrolluar veprimtarinë e çdo ministrie, nuk cenohen aspak. Ministri ka mendimin e tij që mund ta mbrojë në Këshillin e Ministrave, anëtar i të cilit është, dhe atje ai mund të thotë, për shembull, se i ka dalë një problem që kërkon ndryshimin e planit. Atëherë ky mendim i ministrit vete në Qeveri dhe kur është rasti, mund të vijë edhe në Byronë Politike. Nuk është e thënë që, sa herë na vijnë shokët për të na ngritur probleme, ne të bëjmë mbledhjen e Byrosë

1. Në atë kohë, ministër i Industrisë dhe i Ministrave.

Politike ose të Qeverisë. Ka shumë çështje që nuk kërkojnë doemos mbledhje të gjera, por mund të zgjidhen aty për aty nga udhëheqësit.

Kur të bëhet mbledhja e Qeverisë për naftën dhe gazin duhet të asistojnë dhe të thonë mendimin e tyre. Në qoftë se kanë, edhe shokët e komisariatit të posaçëm për industrinë e naftës e të gazit. Këta mund të thonë: «Ne, shokë, vërejmë se këtu nuk ka disiplinë, nuk ka bashkërendim të punëve midis ndër marrjeve etj.» dhe Qeveria do të marrë masat për atë vërejtje që do të gjejë me vend. Në kryerjen e detyrave nuk duhet vepruar as me shkop, as me konformizëm e liberalizëm. Shokët e komisariatit mund të mos jenë specialistë sa shokët e ministrisë, por kjo gjë nuk do t'i pengojë në punë për të ndihmuar e për të kontrolluar. Këta e kanë për detyrë të dëgjojnë punëtorët, teknikët, inxhinierët dhe kuadrot e tjerë, që punojnë në sektorët e naftës e të gazit, dhe pastaj të bëjnë konkluzionet e duhura e të marrin vendime në frymë partie. Në qoftë se do të ketë raste që do ta kenë të vështirë të bëjnë konkluzionet e duhura, të vijnë këtu dhe të rrahin mendimet edhe me ne. As ne nuk jemi specialistë të naftës, po me metodën e arsytimit logjik marksist, mund të ndihmojmë diçka.

Në gamën e gjerë të detyrave, ju, shokë të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, duhet të dalloni mirë se cilat probleme ju takojnë t'i zgjidhni ju dhe cilat do t'i zgjidhin të tjerët. Kur është fjala për çështje të detyrës së vet, secili t'i thërresë nevojës dhe të kryejë misionin që i takon. Në qoftë se ka çështje që u

takojnë të tjerëve t'i zgjidhin, atëherë ministri t'u thotë: «Nuk merrem unë me këto punë». Po të futet ministri në vogëlima, mbaroi roli i drejtuesit kryesor për probleme themelore. Kur del një problem i madh, që kërkon mendimin e disa shokëve me përgjegjësi, atëherë puna ndryshon, diskutohet dhe vendoset.

Dëshiroj të theksoj se të gjithë ne, dre sidomos udhëheqja kryesore me të cilën kam parasysh jo vetëm Byronë Politike, por gjithë Komitetin Qendror dhe Qeverinë, duhet të kuptojmë se situatat aktuale nuk janë si ato që kanë qenë pesë ose dhjetë vjet më parë. Vendi ynë aktualisht është zhvilluar dhe ky zhvillim kërkon një mendim të përpunuar akoma më thellë, një punë akoma më të kualifikuar, një forcë organizative më efektive, kërkon iniciativa më të mëdha.

Zhvillimi i ekonomisë sonë socialiste në të gjithë sektorët, krijimi i situatave të reja politike dhe ekonomike, të brendshme dhe të jashtme, kërkojnë nga secili prej nesh që të mendojë nëse është e përshtatshme metoda e punës që praktikon, nëse është e drejtë rruga që ndiqet për zgjidhjen e këtij ose të atij problemi që ka rëndësi.

Ka ardhur koha t'i rishikojmë format organizative në disa sektorë të jetës e të punës sonë. Në fazë të ndjekjes nga afër të problemeve që nxjerr jeta e përditshme, ne duhet të shohim ku qëndron burokratizmi, se edhe te ne ka burokratizëm, i cili është një e keqe që ringjallet herë pas here edhe pas thyerjes së sistemit burokratik të shtetit borgjez. Burokratizmi nuk qëndron vetëm në shkresat e tepërta që bëhen. Ne duhet

ta kuptojmë burokratizmin kudo ku vërehen pengesa për vënien në zbatim të vendimeve e të direktivave, por edhe të diturive të mëdha dhe të koncepteve të reja që ka kultivuar Partia në kuadrot. Dituria që kemi është me vlerë për të ecur përpara, por pasurimi i saj i mëtejshëm mund të frenohet për arsye të formave organizative të vjetruara që vazhdohet të praktikohen. Format e vjetra të organizimit të punëve mund të ruhen me qëllim ose pa qëllim. Dallimi i këtij qëllimi ka shumë rëndësi për t'i hapur rrugë punës së gjallë revolucionare që e dërrmon burokratizmin.

Ne si udhëheqje, shokë, kemi vërejtur, gjithashtu, herë të tjera, se një përqindje e madhe e kohës së punës e kuadrove drejtues po harxhohet duke u marrë me gjëra të vogla. Në qoftë se vazhdohet kështu, do të mbetemi në fazën artizanale të zhvillimit. Një metodë pune të tillë nuk mund të na e lejojnë situatat e krijuara aktualisht. Metoda arkaike e pa perspektivë e punës do të na pengojë në zgjidhjen e problemeve e në zhvillimin e vendit. Ne e kuptojmë këtë të keqe, prandaj duhet të veprojmë aktivisht në atë mënyrë që edhe vetë ta ndiejmë se me çfarë duhet të merret udhëheqja e me çfarë duhet të merren kuadrot vartës, sipas kompetencave që kanë. Secili të ushtrojë me përgjegjësi kompetencat që i janë dhënë, pa shkarkuar përgjegjësinë dhe pa dubluar punën e tjetrit.

Puna krijuese e njerëzve, studimet me vlerë të madhe, nuk duhet të pengohen për të ardhur gjer lart në Qeveri apo në Komitetin Qendror të Partisë. Puna krijuese duhet nxitur, por kjo nuk do të thotë aspak që në

Institutin e Studimeve dhe të Projektimeve Mekanike, ta zëmë, të mbahen shumë punonjës, nga të cilët një pjesë inxhinierë mekanikë, vetëm për të bërë raporte e për të thënë që studiuam këtë e studiuam atë. Ata që janë marrë në këtë institut s'ka dyshim që janë mekanikë të vjetër dhe me eksperiencë, që kanë punuar nga të katër anët e vendit dhe, si të tillë, kanë mjaft mendime për të shprehur dhe propozime për të bërë. Në qoftë se këta i mbërthen puna rutinë dhe i mbulon burokratizmi, natyrisht, do të merren me disa punë që nuk u takon të merren, për rrjedhim, nuk do të krijojnë e të japin atë që kanë mundësi dhe për të cilën atdheu ka shumë nevojë.

Në metodën e punës sonë ka rëndësi, gjithashtu, që t'i lëmë të tjerët që, përveç studimeve që janë në plan, të hartojnë, të projektojnë dhe t'i paraqesin projektet e tyre. Këto projekte, që paraqiten jashtë planit, të mos futen në raft për të mos u shikuar kurrë, po të studiohen dhe të jepen mendime për to, që të tregohet se me të vërtetë jemi në gjendje t'u hapim horizonte të tjerëve. Po të veprohet kështu, nuk do të ndodhë që të zvarritet 10 vjet të tërë studimi për teknologjinë e përdorimit të oksidit të hekurit. Pse ka ndodhur kjo zvarritje? Kjo ndodhi se zëvendësministri përkatës këtë studim e kishte futur në një radhë me disa studime të parëndësishme. Katër-pesë vjet më parë i ishte thënë të interesuarit: «Shko dhe bluaje në mullirin e Peqinit!». Këto qëndrime duhen parë me shumë kujdes. Nuk them që për oksidin e hekurit të ngremë metalurgjinë e madhe, se më parë duhet të bëjmë mullirin për

këtë qëllim, pastaj të tjerat, por e kam fjalën që t'u vëmë veshin edhe disa gjërave të vogla, që na sjellin fitime të mëdha.

Ardhja e kuadrove nga baza dhe sjellja e eksperiencës së bazës në qendër ka rëndësi shumë të madhe. Kur Partia i cakton kuadrot dhe specialistët në detyrime përgjegjësi në organet qendrore të saj, të shtetit dhe të ekonomisë, secili prej tyre duhet ta dijë se, për t'iu përgjigjur detyrave të reja, nuk është më e mjaftueshme vetëm eksperiencia e punës në bazë. Kjo është ca më tepër e vërtetë për shokët anëtarë të Byrosë Politike ose anëtarë të Qeverisë. Ne shokët që jemi në udhëheqje, duhet të bëjmë përpjekje veçanërisht të mëdha që të ngremë nivelin tonë dhe jo vetëm atë politik, se politikisht jemi të ngritur, por edhe atë ideologjik, bile, për t'u hyrë thellë problemeve që duhet të përballojmë, është e domosdoshme akoma e akoma më shumë të shtojmë edhe njohuritë tona teknike. Natyrisht enciklopedistë ne nuk jemi dhe nuk kërkohet të bëhemi, por, derisa Partia na ka vënë në pozita udhëheqëse, duhet të mendojmë e të punojmë që edhe veten ta kualifikojmë. Nga ne kërkohet të kuptohet thellë situata aktuale e zhvillimit të pandërprerë të ekonomisë sonë. Kuptimi i kësaj situatë kërkon pjekuri më të madhe dhe njohuri më të gjera. Kështu do t'i kuptojmë më mirë edhe shokët e bazës, do të jemi më në gjendje të japim mendimin tonë të drejtë për studimet e tyre dhe do t'u hapim horizonte. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë punë, po e kalojmë kohën duke u marrë me çështjet e ditës si, fjala vjen, «tri automjete të shkojnë

këtej e pesë andej», «pse nuk e çove ti këtë dhe pse nuk e çova unë atë», atëherë ministritë, drejtoritë qendrore, komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive do të flenë, për çdo gjë do të drejtohen në udhëheqje dhe do të gjejnë «arsye» pse nuk u bë kjo ose ajo punë. Po të veprojmë kështu, nuk kemi përse të çuditemi që nuk ka disiplinë, që ka indiferentizëm, që ka liberalizëm. Nëse ndjekim këtë metodë pune, do të jemi ne ata që i shkaktojmë këto pasoja. Ne, në marrëdhëniet me një dikaster qendror, ose me një drejtori të ministrisë duhet të mbajmë qëndrimin e duhur dhe, për ato probleme që ata duhet dhe mund t'i zgjidhin vetë, t'u themi se këto s'janë për ne, prandaj t'i zgjidhni ju. Të jemi të bindur se, duke vepruar kështu, punët do të na shkojnë më mirë.

Çdo kuadër është emëruar në një detyrë sepse ka kapacitet. Në qoftë se një kuadër që ishte i zoti për të drejtuar një uzinë mekanike, dhe prandaj u ngrit në përgjegjësi, nuk ngrihet nga niveli i punës që bënte në bazë në nivelin që kërkon vendi i ri, do të pengohet me siguri plotësimi i detyrave të dikasterit. Nuk mund të drejtohet, për shembull, industria mekanike nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave, po të jetë se drejtori i drejtorisë mekanike nuk ka haber nga mekanika dhe nuk është inxhinier. Thuhet shpesh se ky apo ai kuadër është i mirë. Dakord, ai mund të jetë i sjellshëm, i ndershëm, i dashur me shokët, por këto cilësi shumë me vlerë nuk mjaftojnë për të drejtuar të gjitha uzinat që janë në vartësi të ministrisë, kur shoku, për të cilin thuhet fjalë të mira, nuk është i aftë për

të drejtuar. Qeveria është më në korent, por edhe unë jam informuar se ka ndonjë drejtor në dikastere që vetëm transmeton urdhra, bile dhe kjo bëhet me një ngadalësi të madhe.

Tani për tani, situata që jemi, nuk na dikton nevojën që të kemi një ministri të veçantë për këtë degë të industrisë. Në kushte të tjera do të shohim e do të bëjmë.

Ndoshta u zgjata pak, por desha të argumentoj se ngritja e komisarariatit të posaçëm duhet dhe do t'i japë një impuls industrisë së naftës. Nafta, siç e dimë, është një nga lëndët djegëse më të rëndësishme të ekonomisë sonë e të asaj botërore.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

**SIHTYPI TË JETË MË DINAMIK, MË KONKRET,
QË T'I MOBILIZOJË MASAT, T'I NXITE
E T'I EDUKOJË ATO**

*Nga biseda me një nga instruktorët e sektorit të shtypit
në aparatin e KQ të PPSH*

22 mars 1979

Të gjitha këto që thuhën në kryeartikullin e sotëm të gazetës «Zëri i popullit»¹ janë të drejta. Por tani del çështja se si do të realizohen në jetë konkretisht detyrat që shtron në parim kryeartikulli. Sepse, përveç fushatës së zgjedhjeve në Parti, është edhe fushata e madhe lidhur me vendimin e Komitetit Qendror të Partisë për festimin e 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, që u botua dje në shtypin tonë.

Të kemi parasysh se në shtyp ka shumë fraza në trajtimin e problemeve. Natyrisht, nuk them se artikujt e botuar nuk bëjnë efekt dhe nuk japin rezultate, por jemi të detyruar të pohojmë se ka më shumë fjalë

1. Botuar me titullin «Të shkojmë në mbledhjet për dhënie llogari dhe zgjedhjet në Parti me detyra të plotësuar.»

dhe konstatime sesa interpretime, analiza, rrugëzgjdhje për zbatimin e detyrave të caktuara. Prandaj mendoj që, në një mbledhje me gazetarët, të diskutoni për krijimin e rubrikave, të cilat të kenë vend në një nga faqet e gazetës. Për shembull, kur shkruhet për çështje ekonomike, artikujt të vendosen në rubrikën përkatëse, të evidencohen mirë, se problemet do të jenë të dorës së parë e duhet të tërheqin interesimin e të gjithëve. Ju më parë mendoni seriozisht se për cilat probleme do të hapen rubrika, megjithëse unë do të theksoj më poshtë disa prej tyre. Në këtë mënyrë, pa krijuar burokraci, pa grumbulluar letra, nëpërmjet shtypit qendror, por edhe nëpërmjet shtypit lokal, duhet të jepet e të kërkohet llogari se si janë realizuar konkretisht detyrat, si janë zbatuar orientimet, në ç'shmallë është mobilizimi i punonjësve e të tjera çështje që ju do t'i shtroni në diskutimet tuaja, realizimi i të cilave siguron zbatimin e objektivave kryesorë që janë caktuar në kuadrin e 35-vjetorit të Çlirimit dhe të zgjedhjeve të reja në Parti.

Cilat janë çështjet që na interesojnë? Midis të tjerash, kryesore janë: realizimi i normave, që lidhet ngushtë me realizimin e planit. Pra, a realizohet plani dhe sa realizohet? Sa është pjesëmarrja në punë në kooperativat bujqësore, për shembull, ose, ta zëmë, në fabrika? Me fjalë të tjera, sa dhe si shfrytëzohet koha e punës, sa mungesa bëhen me arsye e sa pa arsye? Domethënë të jenë nja 5-6 drejtime, ku të përqendrohen rubrikat, sipas problemeve që dalin. Drejtimet kryesore të jenë: industria, bujqësia, arsimit e kultura.

Rubrika për një problem të veçantë mund të zgjatë brenda një kohe të caktuar, fjala vjen, gjatë periudhës kur do të zhvillohen mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhje. Por jo të ndodhë që ta fillojmë këtë rubrikë, për shembull, nga qershori, se atëherë e ka marrë ferra uratën, siç thotë populli ynë.

Me qëllim që rubrika të shtrojë probleme të rëndësishme e të jetë mobilizuese, duhen caktuar disa objektiva. Ta zëmë se një nga çështjet që do të trajtohen në këtë rubrikë do të jetë ajo për rendimentin në punë në fabrika e uzina. Si duhet vepruar në këtë rast? Do të caktohen të venë nëpër ndërmarrje gjatë 10 ditëve të para të muajit korrespondentët e gazetës «Zëri i popullit», të cilët do të shohin konkretisht e në mënyrë të hollësishme punën dhe treguesit e realizimit të rendimentit në këto ndërmarrje, dhe pasi të jenë siguruar për saktësinë e këtyre të dhënave, të shkruajnë me përgjegjësi në gazetë. Po kështu edhe në gazetatat lokale, të ketë një rubrikë të veçantë për këto probleme, ku të propagandohen arritjet dhe sukseset e shënuara në treguesit e rendimentit në punë dhe të planit në tërësi në ndërmarrjet e rrethit në kuadrin e zgjedhjeve në Parti. Njëkohësisht në to mund të shkruhet edhe për pakësimin e mungesave në punë, të thyerjeve të disiplinës etj., sepse këto inkurajojnë dhe rritin mobilizimin e njerëzve.

Rubrikat që caktoni ju, zakonisht janë për disa probleme, por unë mendoj se në këtë kohë ju do të përqendrohemi në ato që janë të domosdoshme. Për këtë qëllim duhet të përdorni edhe një formë kontro-

lli, fjala vjen, një herë në pesëmbëdhjetë ditë të verifikoni se si realizohen detyrat. Duke e bërë këtë, atëherë në organet e shtypit të shkruhet, për shembull, që rrethi i Gjirokastrës ka realizuar ose tejkaluar këta objektiva që ka caktuar për nder të zgjedhjeve në Parti, ose për nder të 35-vjetorit të Çlirimit, ashtu siç duhet vënë në dukje edhe që këto apo ato detyra akoma nuk janë realizuar, prandaj kritikohen ndërmarrjet dhe drejtuesit, bile këta të cilësohen me cmër, me qëllim që të nxiten për ta ndrequr situatën sa më parë, duke u caktuar edhe afate.

Me pak fjalë, trajtimi i këtyre problemeve në shtypin tonë të mos mbetet në slogane, në propagandë, siç bëhet shpeshherë në të tilla raste, sepse jemi mësuar me këto gjëra, por ai të bëhet konkret që të mobilizojë masat, kolektivat, drejtuesit, t'i nxitë e t'i edukojë ato. E them këtë sepse edhe në këtë kryeartikull për të cilin po flasim, bëhet një tiradë e gjatë për fushatën e zgjedhjeve në Parti dhe për 35-vjetorin e Çlirimit të Atdheut dhe numërohen një varg detyrash. Por ç'mbetet mbi shoshë? Ato që na preokupojnë e na interesojnë nuk dalin. Këto që thotë sot kryeartikulli i kemi dëgjuar e i kemi lexuar në shtyp sa herë janë bërë zgjedhje. Është e kuptueshme se duhet shkruar si për rëndësinë e zgjedhjeve në Parti, ashtu edhe për 35-vjetorin e Çlirimit të Atdheut. Dakord, po të duash shkruaj edhe dita me ditë për to, shtypi ka për mision që të ndërgjegjësojë njerëzit e t'u bëjë të qartë atyre se duhet të mobilizohesh për ta festuar si duhet këtë 35-vjetor, se kjo arrihet me punë, me realizimin ritmik

të detyrave. Në këtë kuadër organet e shtypit, gazetarët duhet të jenë vazhdimisht në lëvizje, të shkojnë vazhdimisht në bazë, në qendra pune e në kooperativa, të ndjekin në dinamikë realizimin e detyrave, të njohin gjendjen reale, të marrin të dhëna të sakta e të plota, të bisedojnë me punonjësit, me drejtuesit, t'u thonë se këto rezultate e mosrealizime do t'i nxjerrin në gazetë, dhe jo vetëm rezultatet, por edhe emrin e ndërmarrjes, të drejtorit ose të kryeinxhinierit, sepse ata dhe kolektivat e tyre nuk i kanë realizuar detyrat, nuk janë treguar në lartësinë e duhur, se në ndërmarrje ose në kooperativë ka mungesë disipline etj. Në këto shkrime pasi bëhet kritika, duhet të jepen edhe disa konkluzione që dalin nga të dhënat dhe njëkohësisht shtrohet kërkesa për një mobilizim më të madh në punë, sepse me ato rezultate nuk është mirë të vemi në 35-vjetorin e Çlirimit etj.

Pra, dua të them që të shkruhen artikuj konkretë, me të dhëna të sakta e të verifikuara mirë, me frymë kritike, por edhe mobilizues. Në ta të gjejnë vend edhe lavdërimet për ata që janë mirë me realizimin e detyrave, por të ketë edhe kritikë konkrete për ata që nuk i kanë realizuar. Edhe titujt e shkrimeve të jenë sugjektivë, që t'i tërheqin e t'i nxitin njerëzit për t'i lexuar.

Prandaj mua më duket se duhet të gjejmë disa mënyra e metoda efikase për t'i konkretizuar e pasqyruar sa më mirë në shtyp këto fushata. Shtypi duhet t'i vërë në lëvizje të gjithë, që nga ministria në qendër, komitetet ekzekutive të rretheve e deri te punonjësit

e prodhimit duke krijuar një atmosferë luftarake e frymëzuese në punë. Prandaj ju duhet ta mendoni këtë gjë, të hidheni në veprim sa më parë dhe të mos mbeteni, siç e theksova, vetëm në fjalë dhe me mbledhje. Duhet të luftojmë t'i bëjmë punët konkretisht e jo të mbetemi në gjëra të përgjithshme. Direktivat janë të drejta, por Stalini na mëson se, po nuk i realizove konkretisht në jetë, ato nuk vlejné. Dhe neve na interesojné jo fjalët, po realizimet konkrete.

Kjo praktikë pune, që mendojmë të ndiqet tani për të vërtetuar se organet e pushtetit dhe të Partisë e kanë kuptuar seriozisht rëndësinë e zgjedhjeve në Parti dhe vendimin e Komitetit Qendror të Partisë për festimin e jubileut të madh historik të 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, do të bëjë që në mbledhjet e kolektivave punonjës dhe në organizatat-bazë të Partisë të ketë një situatë luftarake. Kjo do të nxitë sderën revolucionare, se ata që kritikohen do të thonë: «Pse e lamë veten në atë gjendje sa na doli emri për të keq» dhe në mbledhje të kolektivit do t'u kërkojnë llogari agronomit, drejtorit, kryetarit të kooperativës ose shefit të seksionit të bujqësisë që nuk kanë drejtuar dhe nuk kanë organizuar mirë punën e nuk kanë kërkuar llogari. Po do të kritikojné, fjala vjen, edhe financierin që rri në zyrë dhe nuk preokupohet fare të llogaritë me laps në dorë vlerën e punimeve që janë bërë dhe të shohë nëse janë të drejta apo nuk janë dhe kur nuk janë të drejta nuk thotë asnjë fjalë që t'u ndalë dorën atyre që lejojnë të harxhohen pa efektivitet paratë e kooperativës. Po kështu, punonjësit do të kri-

tikojnë edhe shokët e tyre të pandërgjegjshëm që, siç thotë populli, tundin derën, rrinë me orë nën hijen e pemës duke pirë cigare, apo ikin përpara orarit të caktuar nga puna. Këtë rol duhet të luajë shtypi, i cili të theksojë edhe idenë se është e nevojshme të organizohen edhe kontrole të efektshme dhe të sugjerojë forma të atilla pune që të shkunden njerëzit, të vihen ata në lëvizje dhe ta shohin me sy kritik punën e njëri-tjetrit, bile edhe të drejtuesve. Dhe kur ta shikojnë se drejtuesi nuk e udhëheq punën mirë, ata t'i thonë pa druajtje: «Ti, shok, nuk e meriton të jesh më në këtë detyrë. Prandaj, propozojmë të vihet ky tjetri, sepse është i palodhur në punë dhe rigoroz në kërkesën e llogarisë, i lidhur ngushtë me masat» etj., etj. E në qoftë se edhe ky ka ndonjë të metë, sado të vogël, ata t'ia vënë në dukje që ta ndreqë. Kjo është një punë revolucionare, që shtypi duhet ta inkurajojë.

Organet e shtypit tonë duhet të gjejnë forma të atilla organizimi dhe të shtrajnë para vetes kërkesën që të mos pasqyrojnë gjendjen vetëm në formë të përgjithshme, po edhe të cilësojnë me emër ndërmarrjet, individët, kolektivat, qoftë kur punojnë mirë, qoftë kur nuk janë në rregull me realizimin e detyrave. Pra ai duhet të bëjë që problemet e rrethit të mos mbeten vetëm në rreth, por t'i marrë vesh gjithë republika, të merret vesh, ta zëmë, që në filan kooperativë nuk po punohet mirë, se në atë kooperativë bëhen vjedhje të prodhimeve bujqësore, të merret vesh se kuadrot drejtues të Partisë e të pushtetit të një rrethi nuk kanë punuar mirë për ngritjen e ndërgjegjes politike të

njerëzve etj. Dhe krahas kritikës në shkrimet e gazetës të dilet edhe me konkluzione për punën e organizatës së Frontit, të organizatës së rinisë e organizatës-bazë të Partisë, të cilat për këto të meta e dobësi nuk janë në lartësinë e duhur, se puna politike atje nuk ka qenë në nivelin e duhur, se nuk ushtrohet kontroll etj., etj. Sigurisht, në jetë dhe në punë ka një mori çështjesh, por shtypi ynë duhet të ndalet në ato që janë nga më të rëndësishmet për ekonominë tonë dhe në disa probleme ku kemi dobësi e për të cilat i biem vazhdimisht çekanit. Kjo do të arrihet duke e organizuar mirë punën.

Partia nuk ia fërkon krahët askujt. Klasës punëtore ajo i thotë të qëndrojë në ballë, por edhe në gjirin e saj ka njerëz të pandërgjegjshëm; në radhët e fshatarësisë ka gjithashtu akoma liberalizëm. Partia dhe levat e saj duhet të bëjnë një punë këmbëngulëse e të fortë edukative dhe të marrin masa të rrepta atje ku punët nuk ecin mirë.

Ne nuk tundemi kurrë nga parimi që klasa punëtore është ajo që udhëheq, por ajo të udhëheqë si duhet e jo të lejohen në radhët e saj punëtorë që nuk janë në rregull në punë, që nuk realizojnë normën, rendimentin. Sepse nga kush kërkojmë ne më parë se kushdo tjetër që t'i zbatojë këto direktiva të Partisë? Pikërisht nga klasa punëtore dhe nga komunistët, sepse ata udhëheqin, ata edukojnë edhe të tjerët. E kupton tashti ku e kam fjalën?

Artikulli «Nafta çan bllokadën» titullin e ka gjë-mues, por sa e pasqyron ai realitetin? Në fakt pu-

nëtorëve të naftës u duhet të bëjnë akoma shumë e më shumë që ta çajnë këtë bllokadë. Në qoftë se në këtë sektor të rëndësishëm ka prapambetje, ka të meta serioze e avari të palejueshme, mund të themi edhe armiqësore, kështu nuk çahet bllokada. Pikërisht kjo gjendje na detyroi ta krijojmë komisaratin e naftës, si një organ ndihmës të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë, si një ndihmës dhe kontrollues për zbatimin e detyrave në këtë sektor kaq të rëndësishëm të ekonomisë sonë.

Artikuj me tituj të tillë si ky që thashë mund të shkruash sa të duash, por a i shërbejnë ato si duhet qëllimit? Po të mos kishte ndërhyrë Byroja Politike duke porositur për shpimin e një pusi, nuk do të ishin arritur ato rezultate që u arritën. Po të ishim bazuar në arsyetimet e specialistëve që ngurrnin, pusi do të kishte rënë në avari. Duhet pranuar se disa specialistë kanë pikëpamje fantaziste dhe mendojnë se të tjerët nuk marrin vesh nga profesioni i tyre. Veç ata duhet ta dinë që Partia i dëgjon me kujdes e me vëmendje specialistët, po, kur e shikon se ata tororisen, atëherë ajo ndërhyr, merr masa dhe i vë gjërat në vend. Partia është më e zonja edhe nga specialisti më i mbaruar në naftë. Pse? Sepse ka eksperiencë shumë të madhe, sepse ajo grumbullon, përpunon dhe sintetizon eksperiencën e punonjësve më të mirë të sektorit të naftës. Por ajo ka eksperiencë edhe në një drejtim tjetër. Në sektorin e naftës ka pasur dhe punë sabotuese e armiqësore. Kjo ka bërë që Partia çdo gjë e shoh me vigjilencë. Ata që kanë sabotuar dhe që tashmë e kanë

marrë dënimin e merituar, kanë përdorur metodat e tyre, të cilat Partia i njeh, prandaj dhe nuk i lejon më. Duhet thënë se ekziston akoma një frymë liberalizmi e konfuzioni në sektorin e naftës. Këtë e shikojmë në ato raste kur në ndonjë pus nuk kryhen veprimet, me disiplinë teknike, gjë që bën që pusi të bjerë në avari. Dëmi që i bëhet ekonomisë në këtë rast është i madh. E përse? Sepse tjetri nuk e bën punën si duhet, ose sepse inxhinieri ka hallin të ikë sa më shpejt në shtëpi dhe nuk e kontrollon si duhet punën. Jo, inxhinieri duhet të rrijë atje në krye të pusit, pa gjumë, ditë e natë, me turne, derisa të dalë naftë.

Ku e kam fjalën? Në këtë frymë duhej ta shkruante gazetari artikullin «Nafta çan bllokadën». Megjithatë, edhe shkrime të tilla do të botohen, që të flasin për mobilizimin e naftëtarëve, por jo eufori, jo vetëm për sukseset. Të shkruhet e të fshikullohen edhe të metat. Pra, ta gjallërojmë shtypin, ta bëjmë atë më dinamik dhe më konkret.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

KUADROT ME ARSIM TË LARTË TË PËRGATITEN MIRË SHKENCËRISHT DHE TË SPECIALIZOHEN MË TEJ

Shënime

22 mars 1979

Problemi i kuadrove me arsim të lartë në vendin tonë mendoj se është i kënaqshëm. Nga universiteti dhe shkollat tona të larta kanë dalë deri sot 33 mijë kuadro dhe vazhdimisht po përgatiten të tjerë në 52 specialitete. Por gjithë këtyre kuadrove me arsim të lartë ne duhet t'u krijojmë mundësitë, qoftë materiale, qoftë teknike, që të specializohen më thellë, gjithashtu të specializohen edhe në fusha të reja që kërkon teknologjia e përparuar, zhvillimi aktual i vendit tonë.

Shumë probleme na dalin për të zgjidhur jo vetëm në metalurgjinë e hekur-nikelit, por edhe të ferro-kromit, të bakrit, të mineraleve të tjera të ngurta e të mineraleve të çmueshme. Për këto degë të ekonomisë duhen kuadro të specializuar, siç na duhen edhe në gjenetikë, në biologji, në biologjinë molekulare, në kibernetikë, në mekanikën kuantike etj., etj.

Ministria e Arsimit dhe e Kulturës duhet të men-

dojë se aktualisht ne kërkojmë të përgatitim sidomos kadro të shëndoshë në shkencat fundamentale, siç janë: matematika, fizika, kimia dhe biologjia. Kadro që të bëjnë studime komplekse, pse edhe problemet bëhen komplekse.

Çështja është të forcojmë anën teorike të shkencave të aplikuara. Për këtë qëllim, të gjendet e të shfrytëzohet mirë literatura e huaj përkatëse për t'u njohur specialistët tanë me të rejat e shkencës. Por ne duhet, gjithashtu, të gjejmë rrugët e mundësitë për të dërguar studentë e pedagogë në disa vende të përshtatshme dhe serioze me bursën tonë ose me bursë të shtetit nga i cili mund të kërkojmë të na japin mundësi për këtë. Këta, pasi të mësojnë një gjuhë të huaj kryesore, të venë të specializohen. Kjo mund të jetë një rrugë, përveç rrugëve të tjera që duhen gjetur për t'i specializuar kadrot brenda vendit.

Unë mendoj se duhet të përmirësohet e të përsohet puna që bëhet në universitet për përgatitjen dhe specializimin e kadrove tanë. Këtu shumë duhet të bëjë Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, por edhe atje organizata e Partisë të merret e t'i drejtojë mirë këto probleme. Fjala vjen ngarkesa mësimore e pedagogëve, pra edhe e pedagogëve të rinj, të shihet me kujdes që këta të mos hallakaten në punë të ndryshme. Në fillim pedagogët kanë nevojë të përqendrohen në përgatitjen e tyre për dhënien e mësimit, në studimin që duhet të bëjnë ata vetë për t'ua dhënë këtë studentëve në mënyrë të kualifikuar, se nuk po bëhet kujdes i duhur në këtë drejtim.

Po ashtu të bëhen përpjekje që studentët t'i edukojmë për një punë të pavarur, sepse ka formalizëm në këtë fushë. Ky formalizëm shfaqet në atë që puna e pedagogut të universitetit i përngjet punës së mësuesit të shkollës së mesme. E kam fjalën në atë që pedagogu nuk e nxit si duhet studentin dhe nuk i jep orientime që ai të punojë në mënyrë të pavarur, të studiojë e të krijojë vetë, nuk i hap horizont se ç'lexime e studime të librave e të revistave mund të bëjë ai lidhur me temën e leksionit etj., etj. Një gjë e tillë nuk bëhet, prandaj shohim që te studentët të ekzistojë një rutinë e thjeshtë në mësim. Ndërsa pedagogët duhet të punojnë pa u lodhur që të ngjallin tek ata dëshirën, por t'u japin edhe metodën e përvetësimit të shkencave në mënyrë të thëllë, të gjerë e sa më krijuese, domethënë të marrin njohuritë më të fundit të shkencës nëpërmjet librave e revistave, pastaj nëpërmjet aplikimit të ndryshëm të atyre teorive që mësojnë, atje ku kemi mundësi dhe mjete, t'i zbatojmë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TE MBËSHTETEMI NË STUDIMET GJEOLGJIKE PËR TË PËRCAKTUAR DREJT PROPORCIONET E SHIPIMEVE

*Nga biseda në takim të ditës së sekretarëve
të KQ të PPSH*

27 mars 1979

Megjithëse brenda një kohe kaq të shkurtër, ju shokët e komisarariatit, keni parë e ndjekur mjaft probleme, keni marrë edhe vendime, që, sipas mendimit tim, janë të drejta. Ju duhet të jeni rigorozë në kërkesat për zbatimin e tyre me doemos brenda afatit të caktuar. Po nuk u zbatuan vendimet brenda afatit të caktuar, përnjëherë merrni masa.

Unë konstatoj edhe diçka tjetër të mirë në punën tuaj. Këto vendime ju i keni marrë pasi e keni studiuar gjendjen, pasi keni diskutuar rreth problemit. Kjo është një gjë shumë e frytshme, diskutimet janë të nevojshme. Ti, Hekuran, tashti po mëson shumë atje, sepse ata që ke rreth e rrotull janë specialistë të naftës.

Konkluzioni që nxjerrim nga raportimi që na bë-

re, që e nxjerr edhe ti vetë, është se në këtë sektor kaq të rëndësishëm të ekonomisë nuk ka drejtim të mirë e të kualifikuar. Ky është fakt. Atje ecet në mënyrë spontane, në mënyrë subjektiviste, si do njëri apo tjetri. Thuhet se gjoja mbahet parasysh interesi i shtetit, por në realitet bëhet e kundërta. Propozime nga specialistë të ndryshëm të naftës ka, dhe bile shumë të vlefshme, siç ishte ky i fundit që the ti, për kursimin e tubave të çelikut, të cilat janë mjetet më të rëndësishme për naftën dhe që i sjellim të tëra nga jashtë. Por, edhe kur t'i bëjmë këtu, në vend, prapë çeliku është çelik dhe duhet kursyer.

Mendoj se ju duhet të shikoni mirë edhe problemin e Institutit të Naftës e të Gazit. Unë nuk e di se si është ndarë puna në këtë institut, por ndoshta struktura organizative ekzistuese nuk i përshtatet shkencërisht dhe konkretisht zhvillimit të sektorit të naftës. Mundet që ky institut, që është krijuar prej kohësh, në vija të përgjithshme ka një strukturë, e cila, mendoj unë, duhet përsosur. Po në ç'drejtim mund të bëhen ndryshimet? Ja, për shembull, shtrohet pyetja: kush e vendos çështjen e proporcioneve të shpimeve? Mendimi im është se këtu duhet të ketë një sektor drejtimi të veçantë, i cili të vendosë për proporcionet e shpimeve: sa do të jenë shpim-kërkime, sa shpim-shfrytëzime, sa shpim-konturime dhe sa shpime-strukture. Këto vendime nuk duhet të jenë punë e mendjes së një personi, as pjellë e hamendjes, por të nxjerra pas një diskutimi të gjerë e serioz dhe që të jenë me efektivitet e me kursim nga ana financiare e

materiale. Dhe, mbi të gjitha, këto vendime të jenë në bazë të të dhënave. Çfarë të dhënash? Të dhënat e gjeologëve, të cilët duhet të kenë një drejtim të caktuar në institut. Edhe në sektorin e gjeologëve është e nevojshme të ketë një ndarje pune jo vetëm me rajone, por në bazë të eksperiencës së grumbulluar lidhur me strukturat gjeologjike. Ky sektor drejtimi bën vazhdimisht përgjithësimin e strukturave dhe në bazë të kësaj ai jep të dhëna për katër llojet e metrazheve ose kërkon metrazhe për strukturat. Në bazë të kësaj ndërvarjeje lind debati shkencor për strukturat gjeologjike të rajoneve të ndryshme të vendit tonë. Në zonën fushore, në përgjithësi, janë bërë studimet e strukturave, prandaj ato nuk mund të jepen të pakontrolluara. Kështu duhet parë çështja e shpërndarjes së strukturave, e cila nuk bëhet në mënyrë automate, por në bazë të të dhënave të shkencës.

Po kështu, me llogari duhet ecur edhe për konturimet. Para se të përcaktohet se ç'fushë do të konturimet, duhet të parashikohet kohëzgjatja në përputhje me nevojat për shpim-shfrytëzimet dhe të sqarohet që më parë sa e gjerë është fusha që do të konturohet për të parë se a i intereson shtetit konturimi i saj etj. Fjalën e kam që në këto gjëra të ecet paralelisht, në mënyrë të kombinuar dhe në raport të drejtë. Unë specialist nuk jam, por mendoj se duhet të kombinohet shpim-kërkimi dhe shpim-shfrytëzimi me shpimin strukturor. Kur bëhet një shpim për shfrytëzim, bëhet edhe një kontur, caktohet një pikë konturimi. Në qoftë se shihet që nuk del gjë, as naftë, as gaz, atëherë thu-

het këtu s'ka, dhe përsëri ecet akoma, bëhen të tjera kërkime. Kjo, më duket mua, është një çështje serioze që keni zbuluar ju. Këtu duhet vënë rregull. Kryesori është shpim-kërkimi, pastaj vjen shpim-shfrytëzimi (domethënë kërkim, gjej dhe shfrytëzo) dhe paralelisht me të ecet me shpim-konturimin që t'i përgjigjet planit të shfrytëzimit. Shpim-kërkimi dhe shpim-shfrytëzimi të konsiderohen njëkohësisht edhe shpime-konturimi, prandaj ky duhet të jetë më i paktë në metrazh.

Shpimi strukturor ka rëndësi të madhe, sepse dihet që më parë duhet të njihen strukturat e pastaj të bëhen shpim-kërkimet dhe shpim-shfrytëzimet. Por, sipas kësaj që na raportohet, del se në mjaft raste atje veprohet sipas mendjes së njërit apo të tjetrit dhe nuk nxirren konkluzione shkencore nga të dhënat gjeologjike dhe nga shpimet strukturore të bëra deri tash në vendin tonë.

Ju të komisariatit t'i futeni mirë punës për ta studiuar gjendjen brenda institutit, prandaj, për një kohë, të merrni një ose dy specialistë, gjeologë të mirë e të zot që të shikojnë si e ka ndarë punën sektori i gjeologëve dhe të marrin të dhëna ku janë bërë shpime për strukturat, ku për kërkime, ku për konturimin e për të tëra me radhë. Në bazë të këtyre të dhënave do të shikoni edhe pasqyrën gjeologjike të strukturave për të krijuar ide të qarta se ku ato janë të njëllajta, ku janë të ndryshme dhe ku janë strukturat në të cilat duhet të bëhen shpime sondazhi etj. Duke u mbështetur në këtë pasqyrë, ministria dhe komisariati do të

bëjnë propozimet për të caktuar proporcionet gjatë këtij pesëvjeçari.

Në raport me nevojat dhe me bazën materiale që kemi, del se neve na duhet të bëjmë më shumë shpime-kërkimi e shpime-shfrytëzimi. Me studime të argumentuara të shtresave të njohura, ku kemi shumë të dhëna për strukturat, të përcaktohen mirë pikat për shpime strukturore për sot, por edhe për të ardhmen. Se ka mundësi që për një periudhë nevojat për shpime strukturore të mos jenë aq sa kërkojnë ata të Institutit të Naftës e të Gazit. Raporti 50 apo 40 për qind që caktojnë ata, unë mendoj se është fiktiv, nuk mund të jetë real. Prandaj kjo çështje duhet të përbëjë një objekt studimi të përcaktuar me ekzaktësi, me të dhëna, me demonstrime, që drejtuesit e institutit të mos thonë: «Këtë gjë e bëjmë që të mos i mbelet hatëri filan gjeologu!» Në asnjë mënyrë të mos ndodhë kështu.

Komisariati t'u kërkojë llogari specialistëve të institutit, t'u kërkojë atyre shpjegime përse të bëhen të tjera shpime strukturore në një zonë me strukturë të njohur ku janë shpuar aq shumë puse? Pse thonë që duhen hapur akoma puse? Kjo është jashtë logjikës, kjo nuk mund të pranohet as nga ana ekonomike, as nga pikëpamja shkencore. Prandaj kjo, Hekuran, duhet parë dhe studiuar.

Të vijmë tash te propozimi i atij inxhinieri, me të cilin ju keni biseduar e që thotë se, në bazë të strukturave të njëllojta, ka mundësi të bëhen ekonomizime të mëdha në harxhimin e çelikut. Kjo është

një ide me leverdi të madhe ekonomike, ide që bazohet në shkencë dhe që rrit më shumë kërkesën e llogarisë ndaj specialistëve që kanë studiuar strukturat, ndaj atyre që kanë drejtuar shpimet dhe kërkimet. Duke u mbështetur në konkluzionet që dalin nga studimi i strukturave, të shpim-kërkimeve, të shpim-shfrytëzimeve etj., do të arrihet në përfundimin e drejtë të atij inxhinierit që tubat të përdoren me nikoqirllëk, në vendet më të domosdoshme.

Por, me sa duket, këtij problemi të rëndësishëm në institut nuk i jepet rëndësi dhe është lënë si vrima e fundit e kavallit. Siç e mendojmë, është caktuar një normë ashtu, pa llogari e pa baza, për metrazhin e shpimeve, një tjetër për ndërtimin e puseve etj., etj. Kjo do të thotë t'i bësh këpucët nr. 41 kur ai që do t'i veshë e ka numrin e këmbës 39. A shkon kjo?! Këpucët duhet të bëhen sipas këmbës, kështu edhe pusi duhet shpuar sipas strukturës dhe jo siç do njëri apo tjetri dhe të harxhohen tubat pa kriter.

Ky qe vetëm një shembull që mora unë. Por ka edhe mjaft shembuj të tjerë që tregojnë se puna në sektorin e naftës duhet të organizohet akoma më mirë.

Po rikthehem edhe një herë te struktura organizative e institutit, sepse mendoj që ky institut, kështu siç është sot, nuk është parë mirë. Kjo duhet lidhur edhe me vetë studimet që kryhen, se ka studime që mund të bëhen brenda në institut, por ka edhe të tilla që mund të bëhen jashtë tij. Në varësi nga kjo, të shikohet edhe se si mund të ndërtohen

grupet e punës për këto studime. Ato mund të ngrihen ose me kuadro të institutit ose jashtë tij, sipas rastit. Prandaj them se duhet bërë rishikimi i strukturës organizative të institutit. Natyrisht, ky nuk mund të bëhet brenda një dite, por, duke parë të gjitha këto gjëra e nga diskutimet e bëra, për të cilat na fole ti, shoku Hekuran, nxjerrim disa konkluzione. Për shembull, një konkluzion është se struktura e këtij instituti është vjetruar, se aty flet e dëgjohet vetëm drejtori, prandaj kërkohen ndryshime.

SHOKU HYSNI KAPO: Ashtu është, për shumë gjëra dëgjohen vetëm drejtuesit, dhe pa u marrë parasysh mendimi i specialistëve, i punëtorëve, vendoset për këtë ose atë problem.

SHOKU ENVER HOXHA: Sigurisht, atje ekziston edhe një këshill drejtues shkencor, por çështja është që ky këshill në çdo hap të tij të frymëzohet nga vija e mësimet e Partisë dhe nga vendimet e Qeverisë, me qëllim që për problemet e ndryshme që dalin të organizohen e të zhvillohen diskutime shkencore me specialistë, teknikë e punëtorë dhe jo të bëhet sipas mendimit të dy-tre vetave. Për këto çështje që kanë të bëjnë me një sektor kaq të rëndësishëm të ekonomisë, ku harxhohen kaq fonde, duhen zhvilluar debate, diskutime e rrahje mendimesh, sepse në këtë mënyrë do të arrihet në konkluzione e vendime të drejta.

Strukturat, në përgjithësi të ne janë të njohura. Megjithatë edhe për këto është mirë të diskutohet e të bëhen debate, pasi mendoj që ka një tendencë që

struktura e Shqipërisë të paraqitet e koklavitur e të thuhet se vetëm këtu, në Shqipëri, miliona e miliona vite më parë kanë ndodhur kataklizma të atilla, që toka nuk ka kontinuitet e çdo gjë është specifike. Kjo që thashë, mund të jetë një çikë e ekzagjeruar, por një pikëpamje e tillë ekziston. Përveç kësaj, ekziston te gjcologët tanë edhe mendimi sipas të cilit ata janë shumë të zotë, pasi punojnë në kushte të tilla ku struktura naftëmbajtëse e vendit tonë ndryshon jashtëzakonisht shumë nga ajo e vendeve të tjera. Kjo pikëpamje është e dëmshme, prandaj duhet luftuar.

Lidhur me ndryshimet në proporcionet e shpimeve, në qoftë se nuk ka mundësi që ato të bëhen që sivjet, atëherë të bëhen meoemos vitin tjetër. Puna e këtij viti, shokë, të shërbejë si bazë, që vitin tjetër të ndryshojë gjithçka.

SHOKU HYSNI KAPO: Duhet të ketë një raport të drejtë në këto gjëra.

SHOKU ENVER HOXHA: Mendimi im është se ky raport i strukturës së metrazhit, është kryesori. Prandaj ai duhet të bazohet në studimin e strukturave ekzistuese gjatë gjithë këtij viti. Pra, në vitin 1980 nuk mund të ruhet proporcioni i tanishëm dhe, që të mos ruhet ky proporcion, duhet shkundur dhe riorganizuar instituti, ose, në qoftë se na del që ky është i organizuar mirë, atëherë të punohet më mirë që njerëzit e tij të bëhen të ndërgjegjshëm për detyrat dhe për drejtimin e sektorëve që u janë ngarkuar.

Për sa i përket ndarjes së sizmikës më duket që kjo duhet të bëhet që tash, mos e lini për më vonë.

Ajo t'i përgjigjet bazës materiale që kemi. Ne nuk kemi sonda e pajisje të tjera për thellësi të mëdha, pra ndaj, aktualisht, duhet të punojmë me këto sonda që kemi. Më vonë, kur të kemi mundësi që të blejmë edhe 10 sonda 4 ose 5 mijë metërshë, atëherë do të sjellim edhe një kompleks sizmik tjetër. Ne do t'u hapim front atyre sondave që disponojmë dhe kjo duhet bërë me docmos. Punimet sizmike të bëhen jo ku të mundet, por atje ku duhet, për të gjetur strukturat që mund të atakohen me sondat ekzistuese.

Këtu është e nevojshme të punohet për të ngjallur interesim të madh për punën dhe për të nxitur kontrollin ndaj njëri-tjetrit. Në këtë drejtim ti Hekuran, tok me shokët e Partisë në rrethet përkatëse, keni mjaft për të bërë, sepse mund të ndodhë që proporcionet ndryshojnë, kurse sizmika caktohet të kryejë punime në ndonjë vend, ku dihet që atje nuk ka gjë. Është krijuar një mendim i tillë te disa që ç'të më thotë drejtori unë vete e bëj, pa, e bëj kështu ose ashtu, është tjetër gjë, doli apo s'doli naftë ose gaz, e bëra mirë, nuk e bëra mirë punën, s'ka rëndësi. Sigurisht nuk mendojnë të tërë kështu, se atje në bazë ka njerëz të ndershëm, tek të cilët duhet nxitur sedra revolucionare, ndjenja e kontrollit. Kështu që, para se të vendoset që punimet sizmike kaq të nevojshme, të kryhen në një pikë të caktuar, të diskutohet gjerësisht, të merret mendimi i njerëzve, të shpjegohet e të argumentohet çdo gjë.

Konstatojmë që në Institutin e Naftës e të Gazit dhe në Drejtorinë e Naftës në Ministrinë e Industrisë

e të Minicrave ka çrregullime, ka raste që merren vendime e nuk zbatohen, duke i shkaktuar në këtë mënyrë dëme të mëdha ekonomisë etj., etj.

Duhet parë ku e kanë burimin këto gjëra kryesore. Kush është ai që ka dhënë urdhër të veprohet ashtu në iks zonë? Këtu gjejmë një kontradiktë, drejtori i Drejtorisë së Naftës në ministri thotë që e ka thënë drejtori i institutit, kurse ky nga ana e tij përgjigjet se as që di gjë fare për këtë. Këto janë gjëra serioze, shokë. Unë nuk vë gisht akoma, por kjo nuk është çështje buloni, por është fjala për një pus që ka vajtur në thellësinë 3 900 metra, ku janë harxhuar gjithë ato para dhe kur s'del gjë e megjithatë pa gjë të keq iket që andej, ashtu siç kanë ikur edhe herë të tjera.

Këto masa që po merrni ju të komisarariatit janë hapat e parë dhe unë mendoj se janë të mirë dhe besoj se ata të bazës i presin mirë urdhrat e vendimet tuaja. Njerëzit, siç na thuhet, sikur janë gjallëruar. Natyrisht, ky është fillimi, mirë, por, kur t'u vihen detyra dhe të merren masa ndaj atyre që nuk i zbatojnë vendimet, atëherë do të shohim ndryshime të mëdha në këtë sektor. Pastaj shikoni problemin e kuadrove në këtë qendër shkencore dhe jashtë saj, proporcionet në strukturën e metrazhit të shpimeve, si i studiojnë atje problemet, apo i futin në sirtar, studimet e specialistëve të ndryshëm. Këto gjëra ndodhin se me sa duket, edhe në ministri studimet futen në sirtar, jo më pastaj atje.

Për t'i parë këto probleme aktivizoni specialistë e kuadro që gjykohen se janë me të vërtetë energjikë,

njerëz me partishmëri dhe që i njohin mirë këto gjëra. Ju i orientoni se në ç'drejtime duhet të ndalen më shumë, dhe pasi t'i kontrollojnë në vend të vijnë e të thonë mendimet e tyre. Bie fjala, mund të kontrollohet gjendja e bazës materiale në ndërmarrjen gjeologjike, të shpim-kërkimit etj. nëse i kanë apo nuk i kanë materialet që u duhen për punën e tyre, për sa kohë u mjaftojnë ato që kanë etj., etj. Këtë punë, në fakt, i takon ta bëjë herë pas here vetë Drejtoria e Naftës, me qëllim që në kohën e duhur t'u plotësojë kërkesat ndërmarrjeve. Por meqë ajo nuk e bën, atëherë kontrollojeni ju. duke u thënë atyre që do të ngarkoni, se brenda 15 ditëve të japin të dhëna të qarta për këtë gjë, jo nga zyra, por duke e parë mirë gjendjen, konkretisht, në bazë.

Puna e drejtuesve të Drejtorisë së Naftës kryesisht duhet të jetë atje në bazë dhe t'i raportojnë për gjendjen edhe ministrit, Xhaferit, edhe ty Hekuran. Kuptohet se ju si komisariat nuk zëvendësoni ministrinë, por për disa gjëra është mirë të keni dijeni që të kërkoni të merren masa nga ana e Ministrisë së Industrisë dhe e Minierave për përmirësimin e situatës.

Natyrisht, në punë e sipër dalin shumë probleme, mjaft nga të cilat, në përgjithësi, njihen prej kohësh. Për shembull, të marrim çështjen e metodave të dyta. Fjalën e kam këtu, që a përdoren në sistem këto metoda? A janë caktuar ndërmarrjet që do të përgatitin mjetet me të cilat do të punojnë njerëzit, a ka interesim për këto etj.? Thuhet që përdoret metoda e injektimit me ujë, por dikush të thotë se nuk ka ujë. Dhe kur nuk

merren masa për ta siguruar ujin për puset, lëre pastaj se ç'bëhet për ujin që nevojitet për të zbatuar metodat e dyta. Po kështu për çështjen e gazit karbonik, të metodës së djegies etj.

Të gjitha këto bëhen në mënyrë spontane dhe jo duke u mbështetur në literaturë. Shumë kuadro atje mendojnë: «E themi njëherë kështu, pa bëhet apo nuk bëhet, s'ka gjë, por ama e kemi thënë dhe kemi raportuar kështu e kështu». Dhe ne i kemi dëgjuar kaq herë këto gjëra, që nga a-ja e deri te ze-ta, saqë i dimë hezber sikur të ishim specialistë, por ama, po të ecet në këtë mënyrë, nuk bëhet gjë.

SHOKU HEKURAN ISAI: Vendime të Qeverisë për këto gjëra ka, ju, shoku Enver, në fjalimet tuaja për naftën i keni trajtuar gjerësisht këto probleme. Por çështja është se nuk janë bërë përpjekje për t'u zbatuar si duhet vendimet e porositë e dhëna.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk mund të zbatohen vendimet, në qoftë se nuk ka organizim dhe, po nuk pati organizim, nuk ka as përgjegjësi. Përkundrazi, në qoftë se ka organizim, përgjegjësi dhe kontroll, atëherë të gjitha vendimet, udhëzimet e porositë zbatohen. Gjatë punës për zbatimin e tyre fitohet një eksperiencë e re, e madhe, që e shtyn përpara prodhimin. Por, në sektorin e naftës ka shumë mungesa dhe ç'është më e keqja atje ka eufori. Kjo është jashtëzakonisht e dëmshme. Euforia e ka burimin te pikëpamja e disa specialistëve dhe e drejtuesve të naftës që e quajnë veten njerëz të zotë, që vetëm ata janë në gjendje të zgjidhin çështje të komplikuar në këtë fushë. «Ne jemi

specialistë të mbaruar, neve na kërkojnë mendim në Qeveri për këtë e atë problem» — mendojnë ata, prandaj dhe i ndryshojnë udhëzimet që u jepen. Këtyre specialistëve t'u kërkojmë më shumë llogari dhe t'u themi si duhet bërë puna.

SHOKU HYSNI KAPO: Këta specialistë drejtues mendojnë se dinë gjithçka. Kur ishim atje, një punonjës u ngrit e foli për pusin C-20, por atij nuk ia vunë veshin fare. Kjo tregon se nuk merret parasysh mendimi i bazës, i punonjësve të tjerë, por vetëm mendimi i drejtuesve. Kjo nuk shkon.

Më kujtohet, shoku Enver, se edhe kur ishte Beqir Alia¹ drejtor i institutit, anëtarët e këshillit shkencor nuk liheshin të diskutonin dhe të jepnin mendimin e tyre, gjithmonë e për çdo problem fjalën e fundit e thoshte ai. Unë mendoj se duhen dëgjuar jo vetëm anëtarët e këshillit shkencor, bile me shumë kujdes, por në mbledhje të tilla duhen thirrur edhe specialistët që punojnë pranë pusëve e deri edhe mjeshtrit e teknikët.

SHOKU ENVER HOXHA: Posi, edhe ata duhet të thirren. Në mbledhjet shkencore studimore që bëhen duhet të kemi parasysh një gjë: në qoftë se shkojmë për të mbajtur një fjalim dhe ta quajmë të mbaruar këtë punë, s'kemi gjë në vijë. Pra, në qoftë se nuk zhvillohet një mbledhje shkencore ku të ketë diskutime për problemet që janë në rend të ditës, ku të bë-

1. Për veprimtaritë antishtetërore e për sabotim në sektorin e naftës mori dënimin e merituar nga gjyqi i popullit.

hen debate, të rrihen mendime dhe të dilet në konkluzione të sakta, të bazuara, atëherë këto mbledhje nuk vlejnë.

Unë kam lexuar, edhe ju natyrisht keni lexuar që, kur zhvillohen mbledhje shkencore në shkallë ndërkombëtare, ta zëmë, për probleme të shëndetësisë, atje shkojnë mjekë nga të gjitha anët e botës dhe japin mendimet e tyre. Pikëpamjet e njërit mund të jenë në kundërshtim me të tjetrit; mjeku që vjen nga një shtet ka pikëpamjet e tij, ka të dhënat e tij, statistikat e spitalit ku ka bërë studime për këtë problem etj., etj. Ndërsa nga statistikat e veta mjeku i një shteti tjetër, fjala vjen, nxjerr konkluzione të tjera. Këtë mendim mjeku ngrihet dhe e argumenton shkencërisht me të dhëna, duke orientuar se si duhet vepruar për të luftuar një sëmundje etj., etj. Se janë të ndryshme pikëpamjet, prandaj edhe diskutohet, rrihen mendime, bëhen debate, çfarë ke bërë ti, deri ku ke vajtur ti për ta ngadalësuar përhapjen dhe zhvillimin e kësaj sëmundjeje, për ta zgjatur një çikë jetën, për të pakësuar dhimbjet etj., etj. Dhe në fund, pas shumë diskutimesh dilet me disa konkluzione.

Kështu duhet vepruar edhe në mbledhjet shkencore që bëhen te ne, pra edhe në sektorin e naftës. Pse të ngrihen e të japin «mësim» vetëm dy-tre veta? Edhe ata që kanë 30 vjet që punojnë në puse kanë shumë eksperiencë e mendime për të thënë. Dakord, drejtuesin do ta dëgjojmë, ky do të koordinojë punën, do të japë edhe mendime, por ama edhe të tjerët duhen dëgjuar, që problemeve të ndryshme t'u jepet një rru-

gëzgjdhje e drejtë. Bile edhe punëtorët e pusit kanë mendime, sepse atyre u dhimbsen milionat që harxhohen. Kurse drejtuesit shpeshherë bëjnë teori, «jo meta-ni kështu, jo metani ashtu». Prandaj këta duhen shtruar të diskutojnë me specialistët, me teknikët para se të vendosin, se këtu është fjala për milionë e dhjetëra milionë. Pastaj vetë shkenca lyp të bëhen debate, ndryshe nuk eçet përpara.

Gjatë gjithë kësaj pune, duke i dëgjuar dhe duke biseduar me njerëzit njihen se cilët janë më energjikë, më të vendosur e që karakterizohen nga një frymë e lartë partishmërie, që nuk pajtohen me të metat, por punojnë me një disiplinë të fortë, duke zbatuar me përpikëri porositë e vendimet e Partisë. Prandaj duhet punuar për t'i njohur mirë njerëzit, pa krijuar përnjëherë mendim, për iks apo ipsilon njeri, por të bisedohet me ta, të dëgjohen dhe të shihen edhe në punë e sipër, si punojnë, si i zbatojnë urdhrat. Se dikush nga fjalët, mund të duket energjik, por në praktikë nuk i zbaton ato që thotë. Ose, një tjetër në një bisedë mund të duket i mefshtë, por, në punë del se është organizator i mirë, pra fjalë s'ka shumë, por punën e organizon, e merr seriozisht zbatimin e vendimeve dhe e çon atë deri në fund.

Pse e them këtë gjë? Këtë e them sepse kur vjen puna për të diskutuar nëse do ta mbajmë iksin atje, apo nuk do ta mbajmë, duhet t'i kemi njohur mirë, ashtu siç duhen njohur edhe të tjerët, sepse nga këta do të ngremë në përgjegjësi. Ky sektor kërkon njerëz të zotë, të aftë, organizatorë, masovikë dhe, mbi të

gjitha, me partishmëri të madhe. Ky problem duhet mbajtur parasysh, që, edhe po të bëhen ndryshime në kuadrot, këto të bëhen me vend, të gjenden pikërisht ata njerëz, për të cilët masat kanë krijuar bindje të plotë se mund të drejtojnë mirë në këtë sektor të ekonomisë dhe ta çojnë punën përpara.

Përveç kësaj, është e nevojshme të vëmë në rregull gjithë strukturën organizative të sektorit të naftës, bile kjo duhet bërë më parë, pastaj të shihet nëse janë kuadro të përshtatshëm ata që janë në krye, apo ka të tjerë që janë më të zotë se këta, më të ndërgjegjshëm e organizatorë më të mirë. Se, siç thamë, ka edhe të tillë që e mbajnë masën të ndrydhur, që nuk i hapin asaj horizont etj. Por tash naftëtarët po shohin se këtë çështje për një kohë e ka marrë në dorë Komiteti Qendror dhe secili thotë: «Unë do të flas, se, po nuk fola, kur do t'i shpreh mendimet që kam për këtë ose për atë problem?». Edhe më parë kanë folur, por nuk i kanë pyetur fare, por tash këta shohin se të tillë njerëzve, që i ndrydhen vartësit, po u dridhen këmbët.

Sektori i naftës duhet të ndryshojë faqe dhe sa më parë të ecë me këmbët e veta. Ministria e Industrisë dhe e Minierave ta drejtojë si duhet këtë sektor dhe, që ta bëjë mirë këtë punë, ajo duhet të ketë një bërthamë të fortë, energjike dhe të zonjën këtu. Por edhe poshtë në bazë të drejtojnë kuadro e mjeshtër të aftë e me partishmëri; struktura organizative e administrative edhe e Institutit të Naftës e të Gazit të jetë e mirë, administrimi i fondeve dhe i materialeve të bëhet si duhet, e kështu me radhë të gjitha punët e tjera.

Pra, punoni në këtë sektor derisa në një periudhë kohe relativisht të shkurtër, me masat e vendimet që morëm, me ndryshimet e bëra këtu e atje, duke caktuar në krye të punëve kuadro të përshtatshëm, të na thuhet: s'ka më nevojë atje për komisaratin.

Ja, ti e the drejt atë, Hekuran, që për një vidhë apo për një astë, që, pa dashje, harrohet pa u shtrënguar mirë në një rast, të mos i quajmë menjëherë sabotatorë punëtorët. Kështu të mbani qëndrim edhe për kuadrot, pra, të jemi të matur me njerëzit. Këta kuadro mund të kenë të meta, mund të shkarkohen edhe nga detyra, por ne të mos kujtojmë sikur ata i dinë të gjitha, pse mund të gabojnë edhe për mungesë njohurish. Çështja këtu është që ne të diktojmë nëse bëhen me qëllim, apo bëhen pa qëllim, veprime të tilla. Sido që të jetë, me qëllim, apo pa qëllim puna është që ne të marrim masa që t'i ndreqim gabimet. Pastaj, ai që bën diçka me qëllim, e përsërit gabimin dhe bëhet e qartë se ç'fytyrë është. Kur çështjet shikohen në këtë mënyrë dhe kur ka një organizim të fortë, edhe gabimi ndreqet më shpejt.

SHOKU HYSNI KAPO: Dy gjëra janë: ose gabimi bëhet nga pazotësia, ose bëhet me qëllim.

SHOKU ENVER HOXHIA: Po, kështu është, s'ka rrugë tjetër. Prandaj këto t'i shikojmë mirë.

Rëndësi kanë dhe disa çështje organizative. Në çoftë se në një zonë hapet një perspektivë e madhe, qendra s'duhet të mbahet larg saj, se atëherë kjo nuk i vlen askujt. Mua më duket se u vjen rëndë drejtuesve të ngrihen e të shkojnë atje ku e dikton puna. Është

e vërtetë që Qyteti Stalin ishte dikur qendër kryesore e naftës, por tashti koha ka bërë të sajën, janë zbuluar qendra të tjera shumë më të rëndësishme naftë e gazmbajtëse. Ne nxjerrim naftë, por nxjerrim edhe gaz. Të dy këta janë nën tokë. Puna do të na tregojë që ka fusha gazi, ka edhe fusha nafte, nxjerrja e gazit ka kërkesat e saj, por edhe e naftës ka të sajat. Të gjitha këto punë i drejton një person. Mundet edhe në të ardhmen të vazhdojë të jetë ai, veçse ne duhet të ndërtojmë një strukturë të tillë organizative në sektorin e naftës që puna të shkojë si sahat. Pra, kur në një vend nevojiten tubat e gazit, atje t'i çojmë në kohën e caktuar, jo të dërgohen të gjitha në kërkime e shfrytëzime. Duhet të veprohet kudo, në çdo sektor, me plan e me grafik; jo të montohen 20 sonda në një strukturë, kur dihet se gjatë kërkesa për to është shumë më urgjente se atje.

Në bazë të të dhënave e të studimit të thellë të gjendjes, të krijojmë një tablo të qartë për fushat naftë e gazmbajtëse. Një gjë e tillë do të na bëjë të marrim masa e të ndryshojmë disa organizime të vjetra në këtë sektor.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga blinda e incizuar, që gjendet në AQP

TË GJEJMË RRUGË TË REJA PËR SHTIMIN E PRODHIMIT TË YNDRNAVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSII¹*

28 mars 1979

Problemi i parë që kemi për të diskutuar është për mundësitë dhe rrugët për shtimin e prodhimit të yndyrnave. Ky është një problem shumë i rëndësishëm. Prandaj neve na intereson që të fluarit në mbledhje të na bëjnë një pasqyrë se si është gjendja, ç'masa mendohet të merren dhe çfarë ndihme kërkohet që t'ia arrijmë qëllimit për të plotësuar më mirë nevojat e popullit me yndyrna.

Ti, shoku Pëllumb², je instruktor në aparatën e Komitetit Qendror dhe, me sa di unë, je specialist i ullirit dhe i ke shkelur me këmbë ullishtet e vendit.

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth projektvendimit «Mbi mundësitë dhe rrugët për shtimin e prodhimit të yndyrnave ushqimore e industriale, me synim që të plotësohen më mirë nevojat e vendit, duke pakësuar importin».

2. Pëllumb Çipi.

Mund të na thuash se në cilat rrethe të Shqipërisë zbatohet mirë agroteknika e ullirit, ku nuk zbatohet mirë dhe ku nuk zbatohet fare? Më shumë na shpjego për ato vende ku nuk zbatohet kjo agroteknikë, na thuaj çfarë masash marrin komitetet e Partisë dhe sidomos seksionet e bujqësisë në komitetet ekzekutive të rretheve. A i shkon në mendje seksionit të bujqësisë të rrethit që, tok me Partinë, të marrë masa për të zbatuar konkretisht agroteknikën, për të planifikuar dhe për të ambalazhuar në thasë plehun për ullirin, për të planifikuar e realizuar ditët e punës që duhen për shërbimet që kërkon ulliri? Si e bëjnë planifikimin komiteti i Partisë në bashkëpunim me komitetin ekzekutiv në rrethet Elbasan, Tiranë dhe Krujë? Në Mallakastër besoj se aplikohet mirë agroteknika, sepse atje marrin prodhim të mirë, pavarësisht se edhe atje mund të marrin edhe më shumë.

Gjithashtu, është mirë të na thuash sa specialistë janë në gjithë Shqipërinë për olivikulturën. Sa kanë mbaruar shkollën për këtë degë dhe sa prej tyre merren me olivikulturë?

E bëj këtë pyetje sepse kam mendimin që nuk bëhet një shpërndarje racionale e këtyre kuadrove nga rrethet. Unë kam edhe një merak tjetër: a kanë specialistët e lartë rreth tyre një, dy, tre, katër ose pesë specialistë të mesëm, të cilët të jenë në kooperativë që të bëjnë kontrollin e vazhdueshëm dhe me kompetenca për olivikulturën? E kanë këtë kontingjent specialistësh kooperativat apo nuk e kanë? Ju thoni se, megjithëse për ullirin mësojnë shumë veta në shkolla

e në kurse, pastaj kur mbarojnë nuk i çojnë në profilin e olivikulturës. Po atëherë pse i mësojmë këta? Kush do të vërë rregull në këtë drejtim? A do të vënë rregull Partia dhe pushteti që kuadrot të venë në profilin për të cilin mësojnë? Ne i caktojmë në shkolla, se kemi nevojë që këta njerëz t'i përgatitim në këto drejtime. Ç'është kjo punë anarkike, që njerëzit punojnë vetëm sipas dëshirës, pa përfillur nevojat e prodhimit e të ekonomisë?!

Këtë problem e kemi ngritur kaq herë, por nuk është çuar gjer në fund. Pikërisht për këtë e kam fjalën. Çështja shtrohet që rregullat e vendosura të zbatohen në mënyrë të rreptë, të merren masa organizative të drejta që t'u futim në kokë mirë drejtuesve të rretheve se ata që kanë mësuar për këtë specialitet do të venë të punojnë në specialitetin e tyre. Shpërndarjen e specialistëve është e zorshme ta kontrollojnë Ministria e Bujqësisë apo Komiteti Qendror. Nga qendra nuk i kontrollojnë dot një nga një se ku punojnë specialistët e pemëtarisë, nëse ata kanë vajtur ose jo në vendet e duhura në brigadën e plehrave apo gjetkë. Rrethi, nëpërmjet kooperativës, mund t'i kontrollojë fare lehtë këta.

Ose të marrim një problem tjetër. Kush mund t'ia japë Ministrisë së Bujqësisë të detajuar pasqyrën se ku duhet të fillojë krasitja e blloqeve të ullinjve, për shembull: këtë vit ky bllok, këtë vit ai bllok? Sigurisht ata që i disponojnë këta blloqe. Po a i dërgojnë ata sistematikisht në ministri apo këto punë bëhen siç i vendosin ata të ministrisë nga lart?

Prodhimi i ullirit është një çështje me rëndësi ekonomike. Në qoftë se atij i bëhen shërbimet e nevojshme, ka një cikël që jep prodhim të mirë, ashtu si edhe molla, dardha, fiku etj. A merret parasysh nga ana ekonomike që, meqenëse ulliri, ta zëmë, ka një cikël më të gjatë prodhimi nga kumbulla ose nga fiku, atëherë ky kërkon edhe një kujdes shumë më të madh? Duke arsyetuar kështu mund të arrihet në konkluzionin që duhet të ndryshohen disi raportet e pagave midis atyre që merren me ullinjtë dhe atyre që merren, fjala vjen, me dardhat. Kështu do të shmangen edhe shfaqjet negative që vihen re kur punonjësit e bujqësisë merren më shumë me dardhën, pse është një punë më e lehtë dhe lënë pas dore ullinjtë, që duan një shërbim më të mirë. Ministria e Bujqësisë i ka futur të gjitha shërbimet e pemëve frutore në një thes, apo i ka klasifikuar dhe i ka diferencuar në bazë të dobisë ekonomike që na japin këto fruta?

Për të tëra fidanishtet e pemëve frutore duhet të bëni kujdes, por mund të ketë prej tyre që kanë nevojë për më pak kujdes, disa të tjera kërkojnë që kujdesi të jetë jashtëzakonisht i madh, se bie, fjala vjen, një brymë dhe i dëmton shumë. Ka një varg çështjesh të tilla.

Këtu, natyrisht, del edhe çështja e plehut, se sa pleh i duhet një bime e sa tjetrës e ku do të përdoret. Këto janë të përcaktuara, por a shihen ndonjëherë këto përcaktime në bazë të rezultateve që merren? Këtu e kam fjalën jo vetëm për vëmendjen e ministrisë, por edhe për komitetet ekzekutive të këshillave popu-

llorë të rretheve. Këto komitete duhet t'ju vënë ju të ministrisë në dijeni për masat, proporcionet etj., pastaj ju i kontrolloni dhe vendosni.

Çdo gjë duhet të bëhet në mënyrë të rregullt, ndryshe, po krijuam anarki, njerëzit do të punojnë sipas qejfit të tyre. Mirëpo kështu nuk mund të zhvillohen frutikultura, olivikultura, vitikultura etj., në ato kushte që kërkojmë ne.

Në qoftë se e duam ciklin e futjes në prodhim për shtatë apo tetë vjet, duke u larguar nga mendimi se ulliri jep prodhim në vitin e 15-të, atëherë duhet të shumëfishojmë masat dhe shërbimet në përputhje me rregullat agroteknike.

Mundet që plehun azotik ose plehun organik në fushat e mbjella me grurë ose me bimë të tjera, e përdorin pa masë, kurse ullirit nuk i japin sasinë e duhur. Kjo praktikë duhet ndryshuar krejtësisht, prandaj në këtë drejtim kërkohet jo vetëm punë shkencore, por sidomos punë organizative. Bile të mendohet edhe për mekanizimin e ujëtjes së ullirit. Tuba plastmase të prodhojmë. Është një problem ky që duhet parë.

Përveç të tjerave, të futet mirë në mendjet e fshatarëve që vërtet ka rëndësi të jashtëzakonshme ngritja e rendimenteve të bimëve njëvjeçare, por edhe me ullirin duhet punuar shumë që të merret rendiment i lartë. Është e qartë se në grurë duhet ta rritin rendimentin çdo vit, por të kuptojë fshatari ynë që edhe pema e ullirit, që do shtatë apo tetë vjet për të hyrë në prodhim, kërkon shërbime, shërbime më të aplikuarra dhe shumë të organizuara, sepse gjersa të vijnë tetë

vjetët për të dhënë prodhimin, do të kalojnë shumë ngrica e do të ketë thatësira, të cilat pema duhet t'i përballojë pa u dëmtuar. Në qoftë se tetë vjet pema lihet në fatin e saj dhe në mëshirën e kushteve atmosferike, pa asnjë kujdes e pa shërbime, atëherë ajo rrezikohet. Nuk rritet e fortë fëmija kur sëmuret vazhdimisht dhe nuk kurohet, kur jeton duke qenë e ekspozuar në mikrobe dhe në pakujdesi. Kështu ndodh edhe me pemët e sidomos me ullirin. Është ndryshe me bimët njëvjeçare, ato mund të kalojnë një rrezik sivjet, por vitin tjetër mund të bëjë një situatë e mirë dhe ato japin prodhim.

Prandaj, më duket mua, detyra e Ministrisë së Bujqësisë është jo vetëm të bëjë planifikim, pa të cilin nuk mund të ecet; jo vetëm të grumbullojë eksperiencën e mirë të bazës, se pa përqendrim dhe pa drejtim nuk ecet, por të ketë në qendër të vëmendjes zbatimin e të gjitha detyrave të shtruara nga Byroja Politike e nga Qeveria për ullirin. Organet dhe organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe sidomos seksionet e bujqësisë të komiteve ekzekutive dhe kooperativat bujqësore duhet absolutisht t'i kenë të qarta direktivat, t'ua futin mirë në kokë kooperativistëve dhe të ndjekin e të kontrollojnë zbatimin e tyre. Cilitdo që prek sasinë e plchut të ullirit, qoftë ky edhe kryetar i kooperativës apo sekretar i organizatës-bazë të Partisë, t'i «pritet» dora! Të merren masa të rrepta gjer në përjashtimin e ndonjërit nga Partia. Në qoftë se nuk mbahen qëndrime të drejta ndaj ullirit, përsëri do të ketë dëmtime e shpërdorime. Kudo, shokë, por

sidomos në bujqësi, ku jashtë vullnetit tonë vepronjë edhe faktorë të tjerë, kërkohet një organizim i fortë.

Sipas mendimit tim, për sa u përket bimëve vajore, të gjitha proceset e punës duhet të vlerësohen e të kryhen frontalisht e me cilësi që nga fillimi, duke u nisur nga planifikimi, te mbjellja dhe deri te vjelja. Njerëzit të jenë në çdo kohë në krye të punëve dhe në qoftë se nuk janë të specializuar, të bëjnë përpjekje, të specializohen. Në qoftë se në një ekonomi bujqësore kemi një specialist për ullirin, por blloku i ullinjve që mbikëqyr ai është i vogël, ky të interesohet jo vetëm për këtë bllok, por edhe për blloqet e tjera. Në qoftë se janë shumë rrënjë e blloqe me ullinj, atëherë të përgatiten specialistë të tjerë. Të gjitha këto kërkesa të shikohen një e nga një dhe të zbatohen, shokë.

Unë kisha edhe një gjë tjetër. Ne kemi deficit në prodhimin e yndyrnave dhe na duhet të importojmë. Ne do t'i kompesojmë këto me vaj ulliri dhe lulëdielli, por mos vallë bota rron vetëm me vaj ulliri dhe me vaj lulëdielli?! Bota përdor edhe margarinën, gjalpin, por edhe disa yndyrna të prodhuara nga bimë vajore. A mendohet të mbillen e të shtohen ato farëra bimësh që kanë vaj? Kështu, përveç vajit të ullirit, lulëdiellit, gjalpit e margarinës, duhet të përdoren edhe yndyrna të tjera. Mua më duket se ky problem nuk është shtruar asnjëherë.

Jashtë nuk përdorin vetëm gjalpë puro, por edhe këtu te ne duhet ta bëjmë këtë gjë. Po dhjami i dërrit e i bagëtive të tjera ç'bëhet? Këto mund të kompozohen me gjalpin dhe të përbëjnë një kontingjent tjetër

të mirë të yndyrnave. Mund të gjenden formula të atilla që të përgatiten yndyrna të shumëllojshme me cilësi dhe me shije të mirë.

Ne kemi filluar të prodhojmë margarinën, por njerëzit ende nuk e konsumojnë shumë. Pse nuk e konsumojnë? Sepse akoma nuk janë mësuar, por edhe sepse ajo nuk është kompozuar mirë, bie crë. Në qoftë se përgatitim një kombinim të mirë kimik të margarinës, atëherë ajo do të hahet për bukuri. Nënata tona e përzierin gjalpin dhe dhjamin e bagëtisë, ndërsa ne nuk e bëjmë këtë gjë. Kjo, veç leverdisë ekonomike, i bën mirë edhe shëndetit, sepse mishi qërohet nga dhjami dhe hahet më mirë pa të. Veç kësaj, ky mish nuk shkakton kolesterolin. Përzierja kimike e përsosur, e studiuar, qoftë nga kimistët tanë, ose nga të huajt, ka avantazhe të mëdha për përgatitjen e yndyrnave. A kemi ne kimistë që të studiojnë përzierjet që mund të bëhen? Kemi. Po përse nuk veprojnë? Për ndonjë fabrikë me teknologji të re, siç u tha këtu, mund të studiohet nga Qeveria brenda mundësive financiare që mund dhe duhet t'i krijojmë.

Ne duhet të vëmë disa rregulla në thertoret tona. E vlen barra qiranë që një kasap të heqë dhjamin nga mihi dhe këtë ta bëjë në kushte higjienike të mira dhe ky pastaj të çohet në fabrikën ku do të bëhet kompozimi me gjalpin.

Të mos vazhdojmë në këtë mënyrë që fatin e yndyrnave ta lëmë vetëm në këto dy bimë kryesore vajore, si ulliri e lulëdielli, të cilat, është fakt, që herë

japin prodhim të mirë e herë jo. Duhet të gjejmë dhe të krijojmë plotësueset e tyre. Të mos harrojmë se kemi edhe bimë të tjera eterovajore që mund të përdoren, si kolza, arakidhi, soja e shumë të tjera, vaji i të cilave është i kulluar.

Prandaj, meqenëse flasim për çështjen e yndyrnave, të punojmë që të çlirohemi nga importi, duke shtuar prodhimin e tyre në vend. Ne duhet të insistojmë që të rritim prodhimin e ullirit për çdo rrënjë. Unë kam në shtëpi një libër që flet për këtë. Vende të tjera si Spanja, Tunizia, vërtet kanë fusha të tëra me ullinj, por duhet parë sa marrin për çdo rrënjë. Greqia, për shembull, merr rreth 24 kilogramë ullinj për rrënjë. Këtë të shohim edhe ne, sa marrim për çdo rrënjë, 24. 20 apo 18 kilogramë. Këtu të ngulim këmbë dhe problemi kryesor është që shifrat që kemi vënë në plan t'i arrijmë, duke i bërë ullirit shërbimet e nevojshme.

Unë mendoj që projektvendimi rreth të cilit po diskutojmë, duhet plotësuar. Mund të mos plotësohet me të tëra ato masa që u propozuan këtu, të cilat është e pamundur t'i zbatojmë tash, por disa duhet të inkludohen në projekt që të mobilizohen njerëzit në punë. Por në vendim të cilësohet mirë që të mbahen mirë parasysh kërkesat e agroteknikës, shërbimet që duhen kryer, shpërndarja e specialistëve dhe e forcave të punës për ullirin, dhe të gjitha këto medoemos të kontrollohen nga Partia dhe pushteti në rreth e në çdo ekonomi bujqësore. Çështja është që disa probleme, siç ishte ai i sapunit, grumbullimi i specialistëve të ullinjve, gru-

mbullimi i dhjavit në mënyrë sistematike etj., të bëhen, sepse do të na shërbejnë të reduktojmë importin e yndyrnave.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

SHKOLLA KA PËR DETYRË TË RRITE VAZHDIMISHT NIVELIN SHKENCOR TË MËSIMIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

28 mars 1979

Instituti i Lartë Bujqësor deri tani ka përgatitur specialistë të përgjithshëm, por tani që bujqësia është zhvilluar ndihet nevoja e një specializimi më të ngushtë. Shumë prodhime bujqësore, si ulliri, perimet etj., kanë marrë rëndësi të madhe ekonomike për konsumin e popullit dhe për eksport. Në këto prodhime kërkohet të sigurohen rendimentet e planifikuara, mirëpo për këtë duhen studiuar shkencërisht rrugët si do të arrihen, që nga përcaktimi i kohës optimale për mbjelljen, nga shërbimet që do t'u bëhen në fazat e ndryshme të rritjes e deri te masat që do të merren për t'i mbrojtur nga sëmundjet. Këto rrethana imponojnë vetvetiu

1. Në këtë mbledhje, ku ishin thirrur në raport drejtuesit e Partisë të Institutit të Lartë Bujqësor dhe të Universitetit të Tiranës, u diskutua mbi ngritjen e mëtejshme të nivelit shkencor të mësimit në shkollat e larta.

nevojën e një specializimi dhe për këtë mendoj se janë krijuar mundësitë, sepse instituti tani ka kuadro me eksperiencë e me nivel të mirë shkencor. Agronomët që kanë marrë një kulturë të përgjithshme në Institutin e Lartë Bujqësor, pas një kohe stazhi në punë, mund të specializohen dhe të dërgohen të punojnë në atë degë për të cilën janë specializuar, për shembull, për pemëtarinë, nëse numri i studentëve që dalin është ose jo në gjendje t'i përgjigjet zhvillimit aktual dhe perspektiv të kësaj dege të bujqësisë. Përpara për pemëtarinë kishte pak specialistë, sepse ky sektor ka qenë shumë i ngushtë, po tashti, me zhvillimin e kësaj dege, del nevoja që të bëhet ndonjë ndryshim në përgatitjen e kuadrit, sepse nuk mund të qëndrohet aty ku kemi qenë. Edhe për ullirin po flasim gjithnjë, mirëpo specialistë të veçantë për të nuk po përgatitim. Pse ndodh kështu?

Zhvillimi i degëve të ndryshme të bujqësisë kërkon që të bëhet një planifikim më i mirë i kuadrove specialistë dhe për këtë ju si institut të diskutoni e të konsultoheni me Komisionin e Planit të Shtetit dhe me Ministrinë e Bujqësisë. Përgatitja e specialistëve të bujqësisë duhet t'u përgjigjet nevojave që dalin nga zbatimi i detyrës që cakton plani pesëvjeçar për zgjerimin e sipërfaqes së kulturave të ndryshme bujqësore. Në qoftë se zgjerohet sipërfaqja e blloqeve të ullinjve, patjetër që kërkohet të përgatiten më shumë specialistë për ullirin, por nuk duhet menduar se me përgatitjen e specialistëve të pemëtarisë në përgjithësi janë siguruar edhe specialistët e ullinjve.

Këtë planifikim duhet ta bëni, të shikohen mirë proporcionet, sepse ekonomia ndiqet në zhvillimin e saj. Këto gjëra ne i ngremë, shokë, sepse janë çështje parimore dhe shumë të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë sonë.

Në Institutin e Lartë Bujqësor përgatiten edhe ekonomistët agrarë, mirëpo shokët e institutit thanë se kanë disa vështirësi, sepse pedagogët që japin kontabilitetin nuk janë në nivelin e pedagogëve të universitetit. Shoku zëvendësministër i Arsimit, që ndodhet këtu, duhet ta mbajë shënim këtë çështje e të merren masa për të bërë ndryshime në këtë drejtim, se nuk është e lejueshme që të nënvleftësohet Instituti i Lartë Bujqësor. Instituti është përpjekur ta kalojë këtë vështirësi duke marrë edhe pedagogë të jashtëm dhe drejt ka vepruar, por këta duhet të jenë ndër kuadrot më të mirë të institucionit ku punojnë.

Për çështjen e kontabilitetit bujqësor janë marrë edhe vendime, diçka është bërë, por jo aq sa duhej. Bazën e kemi të dobët në këtë drejtim. Banka Bujqësore jep një ndihmë të pamjaftueshme. Instituti i Lartë Bujqësor duhet të japë një ndihmë të madhe për kontabilitetin bujqësor, përveç ç'duhet të bëjnë organet e tjera shtetërore, prandaj të tregohet kujdes për studentët që përgatiten në degën e ekonomisë agrare.

Kur bëjmë planifikimin të parashikojmë që ekonomistët agrarë t'i kemi të mjaftueshëm. Këta specialistë nuk përgatiten në një ditë, por duhet të fillojnë punën me synime të qarta që nga viti i parë i fakul-

tetit e gjer në vitin e fundit. Për nevojat që dalin në bujqësi të bëhet balancimi nga Ministria e Bujqësisë dhe nga Komisioni i Planit të Shtetit, që të jepen të drejta studimi aq sa ka nevojë kjo degë, sepse duhet të ecim edhe me kërkesat e kohës. Në qoftë se na mungojnë kontigjentet, mund të shkurtojmë nga ndonjë vend tjetër, për shembull, nga agronomia e përgjithshme dhe të forcojmë ekonominë agrare, veçse kjo punë të bëhet që në fillim të vitit mësimor dhe jo në mes të vitit.

Veç planifikimit të specialistëve sipas degëve e prodhimeve bujqësore, të mbahet parasysh që në institut të vijnë studentë nga të gjitha rrethet. Rregulli i një minimumi të notës mesatare në shkollën e mesme, si kusht për të vazhduar shkollën e lartë, ka kurdoherë edhe përjashtime. Në qoftë se kërkojmë të marrim në shkollat e larta studentë që kanë vetëm notat dhjeta, nënta ose teta dhe nuk bëjmë ndonjë përjashtim, atëherë rrethe të tilla si Tropoja, që nuk e plotësojnë këtë kusht në masën e duhur, do të na mbeteshin pa shumë specialistë vendas.

Ne kërkojmë që studentët të marrin nga shkolla njohuri të gjera dhe të thella, të marrin edhe edukatën e një pune studimore eksperimentuese. Por këtë shembull atij t'ia japë pedagogu në radhë të parë. Pedagogët duhet të studiojnë për t'i azhurnuar leksionet e tyre me të rejat e shkencës. Kështu ata, me shpjegimet verbale në auditor, do të plotësojnë mungesën që ndihet në tekste, se, natyrisht, këto nuk mund të botohen çdo vit, kurse leksioni mund dhe duhet të pasu-

rohet sa herë del diçka e re. Ne kërkojmë që pedagogët të mos mendojnë: «Ç'kemi mësuar kemi mësuar, tani kemi përpara nxënës që nuk i dinë këto gjëra». Pasi rimi i leksioneve është një gjë e madhe për studentët, se u hap atyre horizontin dhe i nxit të studiojnë. Me terma të përgjithshëm mund të flasim shumë e të themi se pedagogët futin në leksione arritjet e reja të shkencës, po për cilat arritje bëhet fjalë konkretisht? Cilët pedagogë i janë vënë kësaj pune? Të dhënat konkrete janë ato që të bindin. Ja, për shembull, bota ka arritur të marrë mesatarisht 5 mijë litra qumësht për lopë. Këtë rezultat ata nuk e kanë arritur me frymën e shenjtë, por e marrin me përdorimin në mënyrë shkencore të foragjereve. Po pedagogët e institutit e njohin këtë teknikë të re moderne në të ushqyerit e lopëve? Kanë të dhëna si e arritën të huajt këtë rezultat, me çfarë lloj bime, me cilat shërbime? Pedagogët mund t'i dinë të rejat e shkencës në fushën e tyre, por ata kanë detyra t'ua bëjnë të njohura edhe studentëve këto dije. Mora si shembull foragjeret, po sa gjëra të tjera mund të kenë.

Shkolla e ka për detyrë të rritë vazhdimisht nivelin shkencor të mësimit dhe t'i japë shoqërisë kuadro të aftë, por, për ta kryer mirë këtë detyrë, nuk mjafton vetëm të realizosh programin mësuesor e t'i japësh diplomën studentit. Instituti t'i ndjekë në praktikë specialistët që përgatit, për të parë si i kanë përvetësuar lëndët e mësimit, në ç'drejtim dhe në cilin sektor kanë dobësi më shumë dhe çfarë lë mangët shkolla tek ata, për të parë njëkohësisht edhe punën që bëjnë rrethet

me këta specialistë, nëse i dërgojnë ose jo në ato profile pune që kanë mësuar.

Njohja me punën e kuadrove që mbarojnë Institutin e Lartë Bujqësor do të tregojë se të ç'niveli dalin ata nga shkolla. Kjo njohje do të ndihmojë që të nxirren konkluzione e të merren masa për rritjen e nivelit shkencor të mësimit dhe për lidhjen më të mirë të teorisë me praktikën. Një punë e tillë do të jetë, gjithashtu, një nxitje e një ndihmë që studentët tuaj të mos qëndrojnë në atë stad që dalin nga shkolla, por të pasurojnë njohuritë e tyre me kualifikimin pasuniversitar.

Një kujdes i veçantë duhet treguar për ata studentë, që janë dalluar gjatë viteve të shkollës e që midis tyre mund të dalin studiues të talentuar të shkencave të bujqësisë. Ju duhet të shkoni edhe në komitetin e Partisë të rrethit e t'u thoni shokëve drejtues që «këtu, në rrethin tuaj, kenë dy studentë që kanë mbaruar studimet shkëlqyeshëm, për të cilët Instituti i Lartë Bujqësor interesohet se çfarë ndihme do t'u jepet nga rrethi, që ata të kualifikohen». Rrethi, nga ana e tij, duhet të dërgojë shefin e bujqësisë në kooperativën ku është dërguar specialisti që ta shohë atë si punon, t'i rekomandojë literaturë për të studiuar, ta pyesë nëse ka nevojë për ndonjë ndihmë, për ndonjë libër etj. Jam i bindur se shokët e komitetit të Partisë do t'i kenë porositur drejtuesit e kooperativave ose të ndërmarrjeve bujqësore që t'i ndihmojnë e t'i kenë kujdes specialistët e rinj, por nuk besoj të kenë dhënë porosi të veçantë që, ky ose ai specialist i ri, të përgatitet dhe të shkojë të japë provimet pasuniversitare.

Po të ndiqet në këtë mënyrë puna e studentëve, atëherë edhe rrethet do të vihen më tepër në lëvizje dhe do ta ndiejnë më shumë përgjegjësinë për kualifikimin e kuadrit. Në rast se shikoni që nga ana e rretheve nuk përdoren drejt specialistët, ju e keni për detyrë të vini në dijeni Ministrinë e Bujqësisë dhe të bëni propozime konkrete se si mund t'u jepet një ndihmë më e kualifikuar.

Ju, si institucion i specializuar për përgatitjen e kuadrove të lartë për bujqësinë, duhet të hidhni vështrimin edhe në shkollat bujqësore që kemi hapur nga të katër anët e vendit, sidomos lidhur me nivelin e dhënies së mësimit, sepse në ato shkolla përgatitet një ushtri e madhe kuadrosh të mesëm. Ju duhet të njiheni edhe me informacionet që bën Ministria e Arsimit dhe e Kulturës për shkollat bujqësore, për të parë se në ç'drejtim duhet të ndihmoni më shumë.

Mund të jetë e nevojshme të diskutohet nga ana juaj se ç'probleme dalin në lidhje me dhënien e mësimit, me tekstet, me praktikën mësimore në prodhim dhe si mund të zgjidhen. Në qoftë se në hartimin e tekstit të ndonjë lënde teknike nuk është bërë punë e vërtetë shkencore, por është dhënë për shkollat e mesme teksti i përmbledhur i shkollës së lartë, siç doli këtu, kësaj i thonë që lënda të vështirësohet, që nxënësi të dekurajohet e të mos mësojë. Ky është formalizëm, prandaj duhet ndryshuar një praktikë e tillë në hartimin e teksteve. Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Arsimit dhe e Kulturës ta kenë të qartë se nuk është çështja vetëm që t'u bëhen ndryshime teksteve,

por të përgatiten me kujdes e në mënyrë të studiuar dispensa të tilla që të jenë baza e tekstit të ardhshëm.

Një nga detyrat kryesore të organizatës dhe të komitetit të Partisë të institutit duhet të jetë edhe propaganda e përgjithshme për të rritur te studentët dashurinë ndaj fshatit. Studentët janë vajza e djem të rinj, me të cilët duhet punuar që t'u futen në shpirt romantika revolucionare për fshatin, dashuria për bimët, për kafshët, për lulet, për natyrën dhe për njerëzit, për çdo gjë të mirë që lidhet me jetën atje. A e bën organizata e Partisë te ju këtë punë? A bën ajo një propagandë konkrete me biseda, me filma etj.? Këtë punë ajo nuk e bën mirë, se mendohet që kjo u përket vetëm poetit dhe shkrimtarit. Jo, kjo është, në radhë të parë, një punë partie. Pedagogu ynë është me partishmëri. Ai duhet t'i mësojë studentit zanatin, por t'i ngjallë edhe dashurinë për punën, për njerëzit, për vendin, për kafshët. Këtë punë pedagogu do ta kryejë mirë kur t'i njohë e t'i dojë vetë i pari fshatrat e fushës dhe të malësive tona dhe t'u flasë me dashuri e me zjarr studentëve për to. Kur pedagogu t'u thotë: «Sa vend i bukur është Tropoja! Sa toka të reja mund të hapen atje, sa pyje me gështenja mund të shtohen!»; kur t'u thotë: «Dvorani i Korçës ka mollë të bukura e të shijshme! Ai është një fshat i mrekullueshëm» e shumë gjëra të tjera të bukura për fshatin tonë, patjetër që në zemrën e studentëve do të rritet dashuria për profesionin e tyre dhe për fshatin ku do ta ushtrojnë atë.

Në qoftë se brenda viteve që vazhdojnë studimet

zien propaganda e Partisë; në qoftë se u flitet me hollësi deri për zërin e ëmbël të bletëve që fluturojnë lule më lule etj., të rinjtë do të thonë: «Nuk na duhet vetëm asfalti, ne do të shkojmë në fshat, se edhe atje jeta zien».

Një çështje me rëndësi që kërkon vëmendje është edhe ajo e kualifikimit pasuniversitar. Më ka ardhur në vesh sikur studentët që mbarojnë universitetin nuk bëjnë shumë përpjekje për t'u kualifikuar. Siç më kanë informuar, mungon edhe interesimi i duhur nga pedagogët që t'i ndihmojnë universitarët për t'u specializuar më tej dhe për t'u bërë kandidatë të shkencave. Edhe kur angazhohen për kualifikimin pasuniversitar, ata japin provimet në gjuhën e huaj dhe në filozofinë marksiste-leniniste, por kufizohen me këto e nuk ecin më tutje. Mirë bëjnë që i japin këto provime, por duhet të vazhdojnë punën edhe për kualifikimin shkencor në atë degë, për të cilën kanë studiuar. Në vend që ta mbarojnë sa më shpejt kualifikimin e të marrin dijeni shkencore sa më parë, kuadrot e zvarritin këtë gjë. Këto dobësi duhet t'i njohim dhe të gjejmë një rrugë të drejtë zgjidhjeje, të mendojmë se si t'i bëjmë kandidatët më të interesuar për kualifikimin, me qëllim që të zgjerojnë njohuritë e tyre pasuniversitare. Një çështje që duhet parë me seriozitet është ajo e udhëheqjes shkencore, si realizohet e ç'probleme dalin. Temat e disertacioneve kërkojnë domosdo udhëheqës shkencorë, mirëpo vërehen mjaft dobësi. Sipas mendimit tim, këto vijnë për arsye se udhëheqësit shkencorë mund të jenë shumë të ngarkuar, ose se kërkesat e

tyre ndaj kandidatëve mund të jenë të lehta, kështu që e çmobilizojnë studiuesin.

Komiteti Qendror dhe Qeveria kanë ndërmarrë një sërë studimesh për planet e ardhshme. Për këto studime, të cilat përbëjnë probleme shkencore, janë caktuar specialistë nga degë të ndryshme, si inxhinierë, agronomë, kimistë etj. Po universiteti i ka marrë në shqyrtim këto punë shkencore, ka bërë ndonjë klasifikim të tyre, që të dihet cilit do t'i jepet prioritet dhe ç'afat do të caktohet për të? I ka marrë në studim ai grupet e punës që janë caktuar dhe lëndët që duhet të studiojnë? Studiuesve t'u bëhet e qartë që më parë se pesëmbëdhjetë studime, për shembull, janë planifikuar brenda këtij pesëvjeçari dhe realizimi i tyre ka rëndësi të madhe ekonomike. Këto studime do të jenë edhe për ekonominë edhe për kualifikimin pasuniversitar, prandaj pedagogu të shkojë tek ata dy apo tre veta që janë në grup dhe t'i nxitë që të japin rezultatin që u kërkohet. E bëjnë universiteti dhe profesorët këtë punë? Më duket se nuk e bëjnë si duhet. Sa më mirë të punojë universiteti në këtë drejtim, sa më shumë të futet profesori ynë në masat e pedagogëve e të studentëve, sa më tepër t'i ndihmojë ai ata për t'u kualifikuar, për të bërë studime me vlerë e për të marrë tituj shkencorë, aq më efektive do të jetë ndihma e universitetit, aq më e nderuar është figura e pedagogut.

Kualifikimi pasuniversitar nga mjaft shokë është kuptuar shumë ngushtë. Ai, më duket mua, është kualifikuar më tepër rreth kuadrove të universitetit, kurse

kuadrot që janë në prodhim nuk afrohen ose afrohen shumë pak për t'u kualifikuar. Ne kemi në prodhim një masë të madhe kuadrosh, që po ndërtojnë ekonominë në të gjithë sektorët, që tregojnë zotësi siç tregojnë edhe pedagogët. Nuk themi që këtyre t'u jepet nga një titull shkencor dhe t'i grumbullojmë në institucionet qendrore, por themi se këta duhet t'i nxitim që ta mësojnë akoma më gjerë shkencën e prodhimit. Kur i nxitim që të bëhen kandidatë të shkencave, ne i inkurajojmë ata që ta bëjnë mirë punën dhe të mësojnë edhe më tepër. Kësaj çështjeje kam përshtypjen se nuk i vihet rëndësia e duhur.

Mjaft inxhinierë, që punojnë në prodhim, janë shquar për një punë të vërtetë shkencore. Këta specialistë të mrekullueshëm kanë përllogaritur dhe matur me saktësi objekte me vlera të mëdha. Shumë prej tyre kanë një moshë të përshtatshme për kualifikim pasuniversitar, sepse njohuritë e shkollës i kanë të freskëta, kanë edhe praktikën. Disa dinë gjuhë të huaj, disa nuk dinë, por, po t'i vihen me zell studimit, ata janë në gjendje të japin provim edhe gjuhën e huaj, edhe filozofinë marksiste-leniniste, edhe një lëndë të caktuar që lidhet me punën e tyre. Kur tjetrit i vë detyrën të studiojë një gjë dhe ai ka dëshirë për të, sigurisht që do të punojë me këmbëngulje për ta realizuar. Këtë ai nuk e bën për të marrë gradën shkencore, por për të realizuar planin, prandaj mëson, studion, eksperimenton etj. Specialisti që punon në prodhim e bën punën studimore me baza, sepse këtij i kërkohen rezultatet. Pra, edhe te këta duhet të drejto-

heni ju, shokë të universitetit, për kualifikimin pasuniversitar. Nuk mund të ekskludohet përgjegjësia e universitetit për këtë çështje. Kuadrot shkencorë të prodhimit nuk janë të shkëputur nga puna juaj. Kemi shembuj që tregojnë se kur kanë vajtur disa pedagogë te punonjësit e prodhimit dhe i kanë pyetur pse nuk kualifikohen, ata janë vënë në sedër, kanë filluar punën, kanë dhënë provimet dhe ka prej tyre që janë bërë kandidatë të shkencave.

Pra, edhe ata njerëz që punojnë në prodhim duhet të nxiten më tej për kualifikim pasuniversitar, se kështu do të mësojnë akoma më tepër, kështu do të dalin edhe profesorët tanë të rinj.

Me fjalë të tjera, këtë çështje, ju, shokë të ministrisë, të universitetit dhe të Institutit të Lartë Bujqësor duhet ta merrni më mirë në dorë, ta shikoni nga të gjitha anët dhe të aktivizoheni. Ky aktivizim të jetë i organizuar, duke i nxitur njerëzit dhe duke u vënë detyra konkrete pedagogëve për të ndjekur studentin që mbaron fakultetin dhe ka shkuar për të punuar në prodhim. Njerëzit tanë janë të ngritur politikisht, janë njerëz të dalë nga gjiri i popullit. Kur të vejë pedagogu në qendrën e punës, ish-studentit, që ka respekt të madh për të, do t'i bëhet zemra behar. Kur pedagogu t'i thotë ish-studentit: «Hajde këtu, biri im, ti ke qenë i zoti në shkollë, ke kapacitet, prandaj duhet të kualifikohesh më tej që të ecësh përpara», ky i fundit do të nxitet. Pra, kërkohet organizim dhe planifikim i studiuar, ç'do të bëhet për sivjet, për vitin tjetër e me radhë, duke pasur parasysh se kuadrot duan tre

ose katër vjet sa të japin provimet e kualifikimit dhe të mbrojnë disertacionet. Po të punohet si duhet, kuadri me perspektivë do të rrijë edhe pa gjumë e do të studiojë për të zhvilluar horizontin e vet shkencor.

Mendimet që u dhanë nga shokët dhe vërejtjet që u bënë, do të ndihmojnë në marrjen e masave për ta përmirësuar gjendjen, por këto masa duhen konkretizuar. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, Universiteti i Tiranës, Instituti i Lartë Bujqësor, Akademia e Shkencave etj., që merren me këto probleme, duhet të përcaktojnë detyrat në kohë, në sasi, në cilësi, në drejtim etj. Edhe vendimi që do të marrim t'u përshtatet këtyre kërkesave.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Raporte e fjalime 1978-
-1979», f. 213*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fja-
lime 1978-1979», f. 213*

PROPORCIONET NË SHPIME KANË RËNDËSI TË JASHTËZAKONSHME

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

28 mars 1979

Çështja e përcaktimit të proporcioneve në njes shpim-kërkimeve dhe shpim-shfrytëzimeve ka rëndësi të jashtëzakonshme, prandaj këto duhet të shikohen nga ana shkencore. Pa u zgjatur dua të them se proporcionet që janë caktuar gjer tani, për mendimin tim, janë shumë të gabuara dhe në dëm të shtetit. Pse janë të gabuara? Janë të gabuara pse shpim-kërkimi dhe shpim-shfrytëzimi ndihmojnë konturimin, konturimi duhet të vijë pas shpim-kërkimit. Këto kanë rëndësi, se po nuk u bë zbulimi i strukturës nuk dihet se ku të shpohet, nuk dihen të tjerat. Te ne janë bërë shpime

1. Në këtë mbledhje u diskutua, veç të tjerash, edhe rreth informacionit për gjendjen në sektorin e naftës, të dhënë nga shoku Hekuran Isai, në atë kohë sekretar i KQ të PPSH dhe kryetar i komisarariatit të posaçëm për Industrinë e naftës dhe të gazit.

strukture me shumicë, por këto nuk kanë qenë objekt i një studimi nga Instituti i Naftës e i Gazit. Nuk është nevoja të përcaktohen më shpime strukturore në fuqshën e Myzeqesë, sepse atje janë bërë me qindra puse dhe struktura dihet; dihet dhe teoria e atyre që thonë se gjoja struktura shqiptare është e jashtëzakonshme etj. Kjo teori synon për të luftuar ekonominë kombëtare. Ajo ka mbuluar neglizhencën e atyre kuadrove e specialistëve që nuk kanë studiuar të dhënat e gjeologjisë, shpimet e strukturës. Prandaj kjo gjendje duhet ndryshuar krejtësisht.

Çështja tjetër me rëndësi, më duket mua, është ajo e Institutit të Naftës e të Gazit, që na është bërë «koka e naftës», por një kokë që nuk ecën mirë. Në qoftë se nuk i futemi mirë strukturës së tij, organizimit të tij, metodës së punës së tij etj., kjo do të na sjellë shumë të këqija. Është fakt se na ka sjellë edhe të mira, por, kur bëjmë bilancin dhe del që pikat nuk janë në rregull, që ato janë dhënë të gabuara, duhet t'i futemi mirë organizimit të tij. Të shikohet kush merret me shpim, kush me kërkim. A është e drejtë që një institut i tillë të ketë të tëra kompetencat? Jo, sipas mendimit tim, nuk është e drejtë. Ministria duhet të ketë drejtimin e vet shkencor dhe instituti t'i bindet ministrisë. Jo t'i bindet ministria institutit e të bëhet kurdoherë si të thotë drejtori i tij. Njihni ndonjë tjetër ju në atë institut? Unë nuk kam dëgjuar emër tjetër veç emrit të drejtorit, dhe drejtori atje e drejtori këtu nuk është e drejtë. Ku janë të tjerët?

Ka shumë probleme, por ky është fillimi. Shokët

kanë akoma kohë që të mësojnë, të zgjerojnë e të thellojnë njohuritë duke bashkëpunuar me Partinë dhe me pushtetin atje. Për këto që thamë, të vihet në korent Xhaferi [Spahiu] dhe të vazhdohet puna.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, që gjendet në AQP

TË JEMI TË MATUR NË GJYKIME E VEPRIME DIE GJITHMONË TË ECIM PËRPARA

*Nga biseda me një delegacion të Partisë
Komuniste të Brazilit¹*

28 mars 1979

*Pas përshëndetjeve të rastit, fjalën e mori shoku
Enver Hoxha:*

Me gjithë punën e madhe që keni, shoku Amazonas, me shëndet duket që jeni shumë mirë. Kjo më gëzon. Gëzohem, gjithashtu, që ju kemi këtu midis nesh.

Në mbledhjen e Byrosë Politike, që kishim sot, lexuam përshëndetjen e Konferencës Kombëtare të Partisë suaj drejtuar Partisë sonë. Ju falënderojmë nga zemra për vlerësimin e lartë që i bëni Partisë sonë. Ky vlerësim na jep kurajë të madhe. Çfarë thoni ju për ne, për Partinë tonë në këtë dokument, ne e konsiderojmë gjithashtu si vlerësim që nuk e meritoj-

1. Ky takim, ku morrte pjesë edhe shoku Ramiz Alia, u bë në selinë e Komitetit Qendror të PPSII.

më vetëm ne, sepse puna që po bëjmë është e përbashkët. «Me një lule nuk vjen behari», thotë populli. Duhet shumë lule, dhe, në fakt, aktualisht ekzistojnë shumë lule të bukura marksiste-leniniste, partitë marksiste-leniniste që kanë lindur. Të tjera do të lindin në të ardhmen. Ato do të duhet të vihen në krye të popujve që janë hedhur në luftë. Ja, për shembull, në Iran, pavarësisht se udhëheq Khomeini, iksi apo ipsiloni, ishin qindra mijë njerëz të popullit ata që dolën në rrugë e në bulevardë dhe sulmuan reaksionin. Frymëzimi i popullit për luftë ishte një forcë tronditëse e drejtuar jo vetëm kundër shahut, por edhe kundër gjithë imperializmit botëror. Kështu krijohen situata, në të cilat, siç na mëson ideologjia jonë revolucionare, marksizëm-leninizmi, që po depërton gjithnjë e më shumë në masat e gjera të proletariatit e të popullit, nëpërmjet përlëshjeve e luftërave klasore, lindin e kaliten forcat marksiste-leniniste.

Shoku Ramiz [Alia] na vuri në dijeni për punën që keni bërë e që do të bëni ju, për perspektivën që i hapet partisë suaj dhe revolucionit në Brazil. E gjithë kjo ne na ka gëzuar e na gëzon. Punën tuaj në të ardhmen ne e çmojmë si një forcë të madhe marksiste-leniniste, si një shembull për partitë e tjera motra, duke filluar nga Partia jonë. Pse themi që nga Partia jonë? Për arsye se vija, më fal që po zgjatëm një çikë, që keni caktuar ju në konferencën kombëtare që bëtë, është e atillë që partia, faktori subjektiv, e gëzkon drejt situatën e vendit dhe di të ruajë forcën e gjallë të partisë, që përbën shpirtin udhëheqës dhe përfaqëson

gjithë politikën korrekte në Brazil, di ta ruajë këtë bërthamë revolucionare nga goditjet e armikut dhe një pjesë ta fusë në gjirin e masave.

Puna e partisë me masat është shumë e rëndësishme, por për t'i bërë ato për vete, ajo duhet të ndjekë një taktikë që çon në krijimin e aleancave. Ne marksistë-leninistët, pa lëvizur asnjë fije nga parimet tona, jemi për aleanca, jo me fashistët dhe revizionistët, por me elementët përparimtarë. Me shokët tanë më të rinj, me grupet marksiste-leniniste që krijohen, duhet të jemi parimorë, por edhe elastikë, pra të mos jemi as të ngurtë, as liberalë. Çështja është që, duke marrë parasysh që iks person nuk është formuar akoma sa duhet ideologjikisht, që ky ose ai grup nuk ka arritur akoma konsolidimin e plotë etj., ne duhet të jemi të durueshëm. Partitë tona kanë një eksperiencë të madhe në këtë drejtim. Me disa elementë të bisedojmë një çikë më me kujdes, kurse në bisedat me të tjerë, mund t'i themi gjërat më troç.

Le të vijmë përsëri te vija e partisë suaj. Ajo është e drejtë dhe do të ketë efekt në vendin tuaj, por edhe në vendet e tjera të Amerikës Latine dhe të Evropës. Çështjen e partive të Amerikës Latine ju e njihni më mirë. Pra edhe ju, edhe ne, të gjithë marksistë-leninistët duhet të ndihmojnë partitë e reja se si duhet të bëhen aleancat me elementët përparimtarë për të goditur në forma të ndryshme kapitalistët, imperialistët. Partia jonë është në fuqi, ndërsa partia juaj nuk është, po ne kemi një vijë, kurse taktika jonë mund të ndryshojë ca nga juaja.

Eksperienca e marksistë-leninistëve në realizimin e detyrave strategjike është në përgjithësi e njëjtë, kurse taktikat e tyre ndryshojnë. Partitë komuniste marksiste-leniniste, duke qëndruar fort në ideologjinë e tyre të përbashkët, duhet të kenë parasysh e të shohin me vigjilencë edhe taktikat që përdorin partitë e tjera dhe jo të veprojnë si disa që duan të bashkohen me revizionistët, me elementë pasues të njërit apo të tjetrit, të cilët ne i njohim se kush janë.

Ju e dini, ashtu si edhe ne, se situatat që po jetojmë, janë të vështira, por edhe revolucionare. Përkërisht në këto situata duhet t'i themi vetes vazhdimisht që të jemi sa të thjeshtë, aq edhe të vendosur, të mos fluturojmë, por të ecim me kujdes duke i gjykuar mirë ato. Populli ynë thotë: «Kur bën një palë rroba, mat 7 herë dhe pri një herë». Me këtë nuk dua të them që ne të mos lëvizim, të mos ecim përpara. Jo, në asnjë mënyrë! Dua të them të jemi të matur, të pjekur në gjykime e veprime, pse një çap i gabuar mund të na sjellë rrjedhime të rënda.

Për të gjitha situatat që krijohen, partitë marksiste-leniniste duhet të mendojnë me kujdes, t'i shfrytëzojnë mirë ato për forcimin e pozitave të revolucionit. Të përfitojmë nga eksperienca e mirë në këtë çështje. Ju e dini ku bëhen greva më shumë në Brazil. Ju e dini më mirë se kushdo ku ka «brumë» për të bërë «bukë». Në Brazil, ku imperializmi amerikan dhe kapitalizmi ndërkombëtar kanë hedhur kthetrat, ka elementë revolucionarë, të cilët, kur dolën në rrugë, tundën dynjanë.

Gjithmonë duke pasur parasysh situatat, ne duhet të luftojmë, të shtojmë veprimtarinë tonë dhe, siç e gzykoni edhe ju, për ne komunistët, rëndësi në këto situata ka që të shohim edhe aleancat, të vëzhgojmë taktikat e armikut, sepse në luftën kundër nesh ai përdor lloj-lloj taktikash, që ka mundësi t'u ngrenë mendjen disave, të cilët ne duhet të mendojmë si t'i shpëtojmë. Kur themi të jemi të rreptë, kjo nuk do të thotë të veprohet kështu në çdo çështje. Rreptësinë duhet ta kërkojmë në mbrojtjen e parimeve, në zbatimin e tyre, në çështjet organizative të Partisë, kur kërkojmë të vendosim disiplinë komuniste. Por ne nuk duhet të ecim si kuaj karroce. Në marrëdhëniet tona me elementë jokomunistë, por përparimtarë, të bëjmë kujdes të madh, t'i gzykojmë thellë mendimet e veprimet e tyre, t'i respektojmë, t'i inkurajojmë e t'i forcojmë më tej ato që janë pozitive. Ne, për shembull, nuk shkuam pas pikëpamjeve të disa sektarëve në lidhje me qëndrimin që duhej mbajtur ndaj atyre shkrimtarëve apo kompozitorëve tanë, që kishin edhe ndonjë «lakër» në kokë. Përkundrazi, ne i mbajtëm ata kurdoherë afër. Dhe me këtë bëmë që ata të mbanin skenën tonë në këmbë, por në të njëjtën kohë, ky qëndrim yni i ndihmoi edhe ata vetë. Po të kishim gzykuar e vepruar ndryshe, të nisur nga pozita sektare, nuk do t'i kishim fituar për popullin këto kapacitete.

Me gjithë vështirësitë që na kanë krijuar revizionistët kinezë, situata sot te ne është e shëndoshë. Për sa i përket prishjes së marrëdhënieve me ta, në vendin

tonë nuk pati as më të voglën lëkundje. Secili çështjen e ka fare të qartë. Te ne është krijuar një gjendje e tillë që në të gjitha hallkat, kudo, poshtë në bazë apo lart, njerëzit kanë krijuar besim të plotë te Partia e në forcat e veta dhe e thonë hapur mendimin e tyre. Kudo pati aprovim të njëzëshëm e të plotë të luftës sonë kundër revizionizmit kinez. Natyrisht, kjo nënkupton aprovim edhe të luftës kundër revizionizmit dhe imperializmit në përgjithësi. Pikërisht ky kuptim i shëndoshë i çështjeve e ka bërë akoma më të fortë gjithë situatën e vendit tonë.

Për të kapërcyer vështirësitë që na dolën nga kjo situatë e re ne kemi marrë masa dhe kemi nxjerrë detyrat e nevojshme. Të gjitha veprat që na i lanë këmbët në mes, ne do t'i përfundojmë, sepse i kemi mundësitë ekonomike, teknike dhe njerëzore t'i ndërtojmë. Detyrat e caktuara për përfundimin e tyre tash janë duke u kryer. Ato patjetër do të realizohen. Po jua konkretizoj këtë me shembullin e Uzinës së Ferrokromit në Burrel. Kur revizionistët kinezë tërhoqën andej specialistët e tyre, ne formuam grupin e posaçëm të punës, u ngrit një furrë, u ngritën dy furra dhe tash po nxjerrim ferrokrom me një përmbajtje prej 6-7 për qind karbon. Përmbajtja e ferrokromit që përpuhohet këtu është ngjitur nga 41 në 63 për qind.

Të njëjtën gjë mund të themi për veprën tonë më të madhe, kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë», ku uzina nr. 12 që do të veçojë paraprakisht në formë karbonati bazik nikelin e kobaltin nga hekuri, është përfunduar së ndërtuari.

Porsa u larguan specialistët kinezë, inxhinierë, mjeshtër, mekanikë e specialistë shqiptarë u mobilizuan dhe rindërtuan tërë linjën dhe para një jave na sollën këtu për të parë gizën e parë shqiptare. Kjo ishte me të vërtetë diçka emocionuese për ne! Linja është ndërtuar në mënyrë të tillë që hekuri i ndarë nga nikeli e kobalti vete drejtpërdrejt si lëndë e parë në aglomerim e pastaj në furrnaltë. Tani na vihet detyra tjetër ta ndajmë edhe nikelin nga kobalti, sepse kinezët nuk na e dhanë teknologjinë e nevojshme për këtë qëllim. Edhe kësaj do t'ia dalim mbanë. Këtë problem specialistët tanë po e studiojnë e do ta zgjidhin. Ata po e studiojnë teknologjinë e ndarjes, do t'i futen veçanërisht studimit të ndarjes në detaje dhe kështu do të ndërtojmë vetë gjithçka që na duhet për të veçuar nikelin nga kobalti. Por derisa ta realizojmë këtë ndarje, ç'do të bëjmë, vallë do t'i lidhim duart? Jo. Për shllamin që del, kemi ndërtuar një furrë tharjeje dhe si rrjedhim, në qoftë se ky ka 70-80 për qind ujë, këtë do ta zbresim deri në 50 për qind, çka do të thotë që me këtë proces pune do të ngremë çmimin e shitjes së tij. Kur të arrijmë të veçojmë nikelin nga kobalti, atëherë në tregjet e jashtme ai do të shitet me çmim akoma më të lartë. Kështu kemi vepruar ne edhe për ndërtimin e vënien në shfrytëzim të fabrikave e të uzinave të tjera.

Tash le të marrim çështjen e ndërtimit të hidrocentraleve. Ne kishim në plan të ndërtonim hidrocentralin e Fierzës. Kinezët nuk donin të na ndihmonin,

prandaj refuzuan, por ne ngulëm këmbë dhe më në fund ata pranuan. Më vonë, Çu En Lai na njoftoi se nuk e merrnin përsipër ndërtimin e tij. Atëherë ne e projektuam vetë dhe vetë po e ndërtojmë me forcat tona, bile tash kemi filluar studimet edhe për një hidrocentral tjetër më të madh. Në kohën e prishjes me kinezët, në Hidrocentralin e Fierzës ishin vendosur dy turbina. Në bazë të kontratave që kishim, arritëm që ata të na sillnin dhe një tjetër, ndërsa për turbinën e katërt sollën vetëm çerekun e saj. Tashmë dy turbina janë vënë në funksionim në Fierzë, të tretën e montuam vetë dhe të katërtën jemi duke e montuar përsëri vetë dhe kështu hidrocentralin do ta mbarojmë krejtësisht.

Pesëvjeçarin që vjen mendojmë të ndërtojmë edhe një hidrocentral tjetër¹. Gjithçka për këtë vepër të rëndësishme, me përjashtim të turbinave, do ta ndërtojmë vetë.

Ne kemi planifikuar të krijojmë mundësi materiale e monetare në kliring e në devizë që, kur të bëjmë një porosi jashtë, asnjëri të mos kujtojë se po e bëjmë me kredi; çdo gjë ne e blejmë me para në dorë, me dollarë ose me kliring, dhe kështu do të bëjmë edhe në të ardhmen. Edhe në minierat kemi marrë të gjitha masat që të punohet ritmiksht, po kështu në industrinë mekanike etj. Në Komitetin Qendror të

1. Është fjala për hidrocentralin e Komanit «Enver Hoxha» që përfundoi më 1986.

Partisë ne kemi një plan të veçantë për këto çështje.

Në shkallë republike, kohët e fundit, kemi ndarë në grupe të veçanta, të revolucionit tekniko-shkencor, sipas specialiteteve e detyrave specifike e nevojave, kuadro me arsim të lartë, inxhinierë, gjcologë, agronomë, ekonomistë, teknikë etj. për të studiuar e për të zgjidhur probleme aktuale, probleme të pesëvjeçarit të ardhshëm dhe për një perspektivë më të largët, për ato të pesëvjeçarëve të tjerë. Grupet, sipas specifikës, janë vënë nën drejtimin e çdo dikasteri përkatës, si dhe të Akademisë së Shkencave. Në dispozicion të tyre kemi vënë mjete dhe fabrika të tëra për të bërë eksperimente, janë vënë gjithashtu edhe mjetet e nevojshme financiare. Puna është organizuar në bazë të një plani dhe janë caktuar afatet se kur do të paraqiten studimet nga ana teknologjike, leverdia financiare dhe ekonomike e tyre, koha e ndërtimit të objekteve, nën mbikëqyrjen e kujt do të punohet etj., etj. Edhe çdo qendër pune, çdo kombinat, fabrikë, ndërmarrje etj. ka planin e vet për zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor, që synon në përmirësimin e teknologjisë sepse teknologjia që kemi është e vjetër, të tillë na e kanë dhënë. Ne jemi të bindur dhe kemi besim të plotë se me forcat tona do t'i arrijmë objektivat që kemi caktuar.

Kjo ishte një pasqyrë e shkurtër për çështjet e industrisë dhe jemi të bindur se do t'i realizojmë detyrat që i kemi vënë vetes në këtë sektor.

Veprimtaria antishqiptare e revizionistëve kinczë nga një anë na bëri keq, por në të njëjtën kohë na

mobilizoi më tepër. Ne i vumë detyrë vetes: gjithçka do ta bëjmë vetë, plotësisht me forcat tona.

Natyrisht, në punët tona kemi edhe të meta. Por ne synojmë që Shqipëria e vogël dhe e rrethuar nga të katër anët nga imperialistë e revizionistë, të bëjë çmos për të vërtetuar para të gjithëve se teoria marksiste-leniniste mbi ndërtimin e socializmit dhe diktatura e proletariatit për mbrojtjen e pushtetit të klasës punëtore bëjnë të mundur që edhe një vend i vogël, qoftë edhe i vetëm, të ndërtojë socializmin e të mbrojë sovranitetin e vet.

Rëndësi të madhe ne po i kushtojmë gjithashtu zhvillimit të bujqësisë. Byroja Politike dhe Qeveria i kanë në rend të ditës çështjet që kanë të bëjnë me bujqësinë. Kemi bërë përparime edhe në këtë fushë. Tani synojmë të forcojmë akoma më shumë bazën, domethënë ndërmarrjet bujqësore dhe kooperativat, sepse natyra e punës në bujqësi ndryshon nga ajo e industrisë, atje punohet jashtë, në natyrë, jo si në fabrika e uzina. Edhe në bujqësi kemi mundësi të ecim përpara. Në fshatra, në kooperativa bujqësore përpiqemi të dërgojmë elementë të rinj dhe energjikë nga qytetet. Në të njëjtën kohë edhe me të rinjtë e fshatit punojmë që të qëndrojnë atje, sepse duke qenë një vend i vogël, në fushën e industrisë ne nuk mund të konkurrojmë teknologjinë e re botërore. Këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë ne përpiqemi gjithashtu ta ngremë sa më lart, që të marrim rendimente sa më të larta në prodhimet bujqësore e nga blegtoaria. Për këtë qëllim, përveç shkollave të larta, kemi

hapur kudo, deri edhe në fshatra, shkolla të mesme bujqësore, të specializuara për pemëtari, për olivikulturë, për perime. Akoma duhet, për shembull, të mësojmë më shumë për të rritur më shpejt e më mirë domaten, sepse tregu i jashtëm na kërkon domate dhe ne, meqë duam të sigurojmë valutë për të blerë makineri të ndryshme, turbina për hidrocentrale etj., mund dhe duhet t'i prodhojmë ato në sasinë dhe në kohën e duhur.

Kështu veprojmë ne për zhvillimin e bujqësisë. Kuadrove drejtues dhe punonjësve të këtij sektori ne po u hapim horizonte që, krahas një bujqësie të përparuar, të zhvillojmë në vendin tonë edhe degë të tjera të reja të ekonomisë, si në industrinë e lehtë, në atë ushqimore etj., për prodhimin e të cilave populli ka nevojë. Çështja është që punonjësve tanë t'u sigurojmë në vend të gjitha ushqimet që u nevojiten, artikujt e veshmbathjes etj. Në këtë mënyrë lindin e rriten kërkesat për të zhvilluar më tej edhe industrinë.

Çmimet te ne nuk ngrihen dhe bëjmë çmos që të mos ngrihen. Qiratë i kemi të ulëta. Kur njeriu sëmurët, nuk paguan asgjë për shtrimin e kurimin në spital, po kështu edhe për arsimimin e tij. Si rrjedhim i rritjes së mirëqenies, kërkesat për të blerë televizorë janë shtuar. Familjet po rriten numerikisht. Mua, për shembull, po më shtohen nga viti në vit nipërit. Kudo ka kërkesa për të ndërtuar shtëpi të reja; fshatari ynë është në gjendje të paguajë sot mijëra lekë për të ndërtuar shtëpi të re, se bukën e ka të siguruar, por,

natyrisht, rritja e popullsisë nxjerr nevojën e ndërtesave të reja të banimit.

Por ne e dimë se ka edhe vështirësi, edhe të meta, të cilat luftojmë t'i kapërcejmë e t'i korrigojmë. Kultura, për shembull, me gjithë zhvillimin e madh që ka marrë, akoma nuk është në nivelin e duhur, nuk është në atë nivel që dëshirojmë dhe në përputhje me stadin që kemi arritur.

Zhvillimi në vendin tonë ka marrë tash hov të madh dhe jeta nxjerr përditë kërkesa të reja, mirëpo kinezët nuk bëheshin merak për t'i përfunduar punët shpejt e në kohë. Një vit të tërë rrinin ata për të bërë diçka që mund të mbarohej për një muaj. Na thoshin se për ndërtimin e industrisë juve ju duhen gjithë ata njerëz dhe, meqenëse nuk i keni, s'ka ç'ju duhet industria.

Sa u larguan kinezët nga vendi ynë, ne zbuluam një fushë të re naftë. Po çfarë bëjmë ne gjatë kësaj kohe? Diskutuam në Byronë Politike për këtë problem, krijuam një komisarjat të posaçëm për naftën dhe gazin me kryetar një anëtar të Byrosë Politike. Vetë ai bashkë me 6 apo 7 specialistë ka shkuar në fushat naftëmbajtëse, pranë puseve për kontroll dhe ndihmë. Atje ai interesohet për çdo aspekt të punës në puset deri edhe për ujin që e kërkon procesi i nxjerrjes së naftës, duke përdorur një stil të ri dhe metodë operative në punë. Me këtë dua të them se, po të ecësh me metodat e vjetra, nuk ia del dot kurrë mbanë.

Po kështu kemi vepruar edhe me punën në pikat e shpimit në fushat e naftës. Për vitin e ardhshëm

ato na jepeshin në tremujorin e parë të vitit. Pra, kur fillonte viti i ri, nuk dihej se ku do të büheshin shpime, për arsye se nuk ishin dhënë pikat e shpimit. Atëherë komisariati i naftës dhe i gazit porositi që ato të jepeshin brenda muajit, sepse vendit i duhet naftë. Pra, ne synojmë që të gjithë të ndërrojnë stilin dhe metodën e punës, sepse kemi akoma shfaqje të burokratizmit në këtë sektor. Në sajë të një stili revolucionar pune dhe sipas porosisë së Komitetit Qendror të Partisë, specialistët e naftës i reduktuan afatet e studimeve në mënyrë të konsiderueshme.

Dua të them se vetëm kështu, vetëm në këtë mënyrë duhet të punojmë. Në sajë të këtij stili pune, populli do të kuptojë se ç'mundësi të mëdha ka vendi ynë për të ndërtuar socializmin me forcat e veta. Në radhë të parë udhëheqja e Partisë kështu duhet t'i kuptojë punët, kështu t'i zbatojë detyrat dhe pastaj me punën e vet t'u tregojë masave se ne mund të ecim përpara me forcat tona.

Kur revizionistët kincë na atakuan me pabesi, gjë që çoi në prishjen me ta, pati njerëz jashtë që pyesnin se ku do të shkonte paskëtaj Shqipëria. Disa thoshin se do të shkonte me sovjetikët, disa të tjerë me italianët. Tash po këta njerëz nuk thonë që Shqipëria bën tregti, por Shqipëria «u hap»! Por ne edhe më përpara bënim tregti, sepse kjo na intereson edhe neve, u intereson edhe të tjerëve që vijnë e blejnë mallrat tona.

Por, siç thashë, ne kemi edhe vështirësi. Shfaqje të stilit burokratik në punë ekzistojnë akoma dhe në

shumë forma të ndryshme dhe në sektorë të ndryshëm, jo vetëm nëpërmjet letrave e shkresave të tepërta. Ekzistojnë ende edhe shfaqje të liberalizmit, të ndjenjës së interesit të vogël meskin, privat, të ndjenjës së rehatllëkut. Na ndodh edhe kështu: ndonjë inxhinier apo mjek, meqenëse nuk i pëlqen dhe nën pretekstin se në frontin e punës ku është caktuar nuk gjen menjëherë strehim e komoditet, ngrihet dhe kthehet në qytet dhe nuk paraqitet në punë. Ka edhe ndonjë agronom që caktohet të shkojë në fshat, sepse pikërisht atje zhvillohet bujqësia, por gruan, shtëpinë ai i ka në qytet dhe në fshat ai shkon, si të thuash, sa për të vajtur, se në mbrëmje kthehet përsëri këtu, në qytet. Agronom, pra, i thënçin, në bulevardin e Tiranës. Sigurisht, në Tiranë, personalisht ai është më rehat, por atdheu të kërkon të vesh kudo ku ka nevojë. Prandaj, Partia u flet njerëzve, i këshillon specialistët e bujqësisë të marrin edhe familjet me vete, sepse edhe në fshat ka shtëpi, ka jetesë të gëzuar, ka punë.

Pra, ka gjëra të këtilla dhe prandaj punën ideologjike Partia e ndërton në mënyrë të tillë që t'i shërbejë qëllimit tonë, njerëzit të pastrojnë ndërgjegjen. Natyrisht, përmirësime në këtë drejtim janë bërë, por kjo nuk realizohet as në 10 vjet, as në 15 vjet, pse shihet që ka edhe reminishenca.

Kështu është situata këtu te ne, revolucionare, ka luftë dhe përpjekje, nëpërmjet të cilave ne ecim përpara, prandaj jemi të lumtur.

Më tha shoku Ramiz se shokët tuaj janë duke shkruar historinë e luftës kryengritëse në Araguaja. U

gëzuan për këtë. Siç e dimë, në Brazil, që është një vend i madh, imperializmi amerikan dhe kapitalizmi ndërkombëtar kanë hedhur kthetrat e tyre. Prandaj kundër tyre luftohet. Dhe Partia juaj ngrihet e fuqishme. Ne marksistë-leninistët jemi të fortë, mund të bëjmë shumë gjëra. Aventura nuk bëjmë, por, kur ka ardhur puna, kemi bërë edhe luftë të armatosur, siç ishte ajo që ju bëtë në Araguaia.

Të gjithë ne gëzohemi shumë, shoku Amazonas, që je mirë, që shokët Arruda, Desio¹ dhe shokët e tjerë janë, gjithashtu, mirë me shëndet. Ne jemi gëzuar për Konferencën Kombëtare të Partisë që bëtë ju. Mendimet tuaja ju ua transmetuat shokëve të tjerë, të cilët do të shkojnë atje ku i keni caktuar për të udhëhequr punën e partisë. Ne, ashtu sikurse edhe vetë ju, kemi bindje të plotë se puna tash do të ecë përpara, shumë më mirë se deri sot.

Ne, me dëshirë dhe me të gjitha mundësitë që kemi, presim të na vini në vendin tonë, prandaj të vini kurdoherë, edhe vetë, por të dërgoni edhe shokët tuaj.

Një kombinim i frytshëm i veprimtarisë së partive motra marksiste-leniniste është më se i nevojshëm. Një kombinim i tillë jo vetëm na bashkon për shkak të ideve dhe të luftës sonë të përbashkët revolucionare marksiste-leniniste, por ndihmon në sqarimin e çështjeve të ndryshme. Ky sqarim do të kontribuonte në

1. Dy shokë udhëheqës të PK të Brazilit, të pranishëm në takim.

arritjen e një orientimi të përbashkët. Të marrim, për shembull, çështjen e Mao Ce Dunit. Ka qenë ai marksist apo antimarksist? Kjo nuk është çështje sentimentale, por ideologjike, prandaj njëfarë koordinimi në qëndrimet tona për këtë problem është i nevojshëm. Po kështu edhe për probleme të tjera të rëndësishme të zhvillimit ndërkombëtar.

Shoku Ramiz më foli për një ide tuajën, shoku Amazonas, dhe që është një ide e shkëlqyer, lidhur me shkëmbimin e mendimeve midis partive marksiste-leniniste. Lufta jonë kundër armiqve është dhe do të jetë e ashpër, prandaj duhet të punojmë që njerëzit tanë të njohin sa më mirë parimet bazë të vijës sonë marksiste-leniniste, kurse për sa u përket taktikave, ato, natyrisht, janë e do të jenë të ndryshme, ato përcaktohen sipas vendeve e kushteve të çdo partie. Megjithëkëtë, ato duhet të jenë taktika që ta ndihmojnë strategjinë tonë të përbashkët. Kjo është rruga që na hapet përpara, në të cilën ne, marksistë-leninistët, ecim së bashku, të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin nga mësimet e mësuesve tanë të mëdhenj, Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit.

Borgjezia, revizionistët, oportunistët e çdo ngjyre pretendojnë se tiparet e epokës kanë ndryshuar, nuk janë më ato të kohës së Marksit dhe të Leninit. Tiparet e saj themelore nuk kanë lëvizur, siç nuk kanë lëvizur as idealet e mëdha komuniste revolucionare që hartuan dhe për të cilat luftuan gjithë jetën e tyre mësuesit tanë të mëdhenj. Ne do të vëmë shpatullat tona që këto ideale të mos lëvizin kurrë. Çdo

epokë lidhet dialektikisht me epokat e mëparshme ashtu siç është i lidhur edhe qëndrimi i partive të vërteta marksiste-leniniste sot me atë të partive të proletariatit revolucionar në të kaluarën. Këto parti përbëjnë atë motor të madh që çon përpara epokën dhe shoqërinë drejt socializmit e komunizmit.

SHOKU ZHOAO AMAZONAS: Këto ide, për të cilat u fol këtu, lindën te ne të frymëzuar nga libri juaj «Imperializmi dhe revolucioni», shoku Enver. Mendojmë se kjo vepër hap perspektiva të reja për lëvizjen komuniste dhe për komunistët; aty qartësohen një sërë idesh për shumë probleme. Prandaj i thamë shokut Ramiz se rrënjët e këtij problemi, domethënë të shkëmbimit të mendimeve midis partive marksiste-leniniste, ekzistojnë në librin e shokut Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo vepër, për aq vlerë sa mund të ketë, buron nga eksperiencia e Partisë sonë, e partive të tjera motra, duke përfshirë edhe partinë tuaj.

SHOKU ZHOAO AMAZONAS: Kjo vepër vlen shumë. Besoj se në këto 20 apo 30 vjetët e fundit, kjo është vepra më e mirë që ka dalë në dritë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare; i rëndësishëm është momenti në të cilin doli, kur gjithë bota zien, kur njerëzit kërkojnë rrugë, disa drejtpërsëdrejti, disa të tjerë veprojnë me intuitë. Vepra e shokut Enver u përgjigjet problemeve që u kanë lindur e u lindin atyre.

Ndjenjat tona janë ndjenja personale. Ne e shikojmë shokun Enver si një komunist të madh, që është kalitur me jetën dhe me luftën. Gjithmonë na ka preo-

kupuar fakti që ta studiojmë veprën e tij. Jo gjithmonë njerëz të mëdhenj dalin në vende të mëdha. Jeta ka treguar se këta njerëz dalin edhe në vende të vogla. Të gjitha problemet që ka shtruar shoku Enver në veprën e tij «Imperializmi dhe revolucioni» kanë rëndësi të madhe. Në qoftë se marrim, për shembull, problemin e luftës politike e ideologjike, kjo luftë ka një qëllim dhe qëllimi është revolucioni, është, siç thotë shoku Enver, ndërtimi i socializmit. Njerëzit shkojnë përpara, ata e bëjnë revolucionin për të jetuar më mirë dhe pikërisht në këtë çështje duket roli udhëheqës i marksizëm-leninizmit. Ideja që dhatë ju këtu, shoku Enver, domethënë ideja se komunistët përfaqësojnë aspiratat e popullit për të ecur përpara, është e shkëlqyer. Ajo është një aspiratë që lind nga vetë revolucionin dhe partia mendon dhe punon për rrugën nëpërmjet së cilës ta çojë atë përpara.

Ndërtimi i socializmit në Shqipëri është emocionues. Te ju njerëzit janë të armatosur me ideologjinë marksiste-leniniste dhe kanë eksperiencë për të kapërcyer vështirësitë. Kjo është një eksperiencë e madhe për gjithë lëvizjen komuniste botërore, sepse në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë borgjezia po spekulon me çështjen e ndërtimit të socializmit. Kurse ju i jepni përgjigje në formë shumë konkrete kësaj çështjeje kapitale dhe jo thjesht në teori, por edhe në praktikë, në jetë. Pikërisht kjo e ndihmon lëvizjen tonë komuniste. Në këtë kuptim mendoj se vepra e shokut Enver «Imperializmi dhe revolucioni» dhe eksperiencia e ndërtimit socialist në Shqipëri duhet të zënë një vend ako-

ma më të madh në lëvizjen komuniste botërore. Ne në Brazil po përpiqemi ta botojmë legalisht këtë vepër dhe besojmë se për pesë-gjashtë muaj ajo do të botohet.

SHOKU ENVER HOXHA: Borgjezia përdor çfarëdo dredhie kundër marksizmit, por ky mbetet i pavdekshëm. Prandaj ajo s'ka si të mos e shikojë vazhdimisht «fantazmën e komunizmit» që e tmerron.

Ngjarjet në Iran, vetëm me rrëzimin e shahut, shkaktuan turbullirë të madhe. Ato shënuan fillimin e një revolucioni demokratiko-borgjez akoma të pastabilizuar, por që mund të përhapet në gjithë pellgun e madh të Lindjes së Mesme. Prandaj Karteri shpejtoi të dërgonte në Arabinë Saudite, në Egjipt, Jordani e vende të tjera, sekretarin e shtetit për mbrojtjen dhe atë për punët e jashtme.

Te popujt arabë ne kemi krijuar një simpati. Ne mendojmë se është vija e drejtë e Partisë sonë ajo që i bën për vete edhe ata, të cilët ideologjikisht nuk janë dakord me të. Politikën e saj të drejtë, qëndrimet e saj parimore, Partia jonë i shpreh në fjalimet e udhëheqësve të vendit tonë, në materiale të tjera, si dhe në artikujt e gazetave e në komentet e Radios e të Televizionit, në të cilat ne flasim edhe për Iranin, edhe për agresionin e Kinës kundër Vietnamit etj. Këto materiale transmetohen nga Radio Tirana edhe në gjuhët arabisht e persisht.

Për çështje politike, si për shembull, për nënshkrimin e traktatit të paqes midis Egjiptit e Izraelit ne mbajmë qëndrime korrekte, që kanë aprovimin e

popujve. Në themi se kjo që u bë është një paqe imperialiste, sepse lufta ishte imperialiste. Luftën kundër popujve arabë e bënë dhe e vazhdojnë imperialistët amerikanë me sionistët izraelitë, edhe «paqen» prapë ata e bënë, Karteri dhe Begini bashkë me Sadatin. Këtë nuk e aprovojnë popujt. Por edhe Sadati ka njerëzit e përkrahësit e tij, jo vetëm në radhët e borgjezisë egjiptiane, por shohim se edhe Arabia Saudite nuk do që të priset me të.

Mendojmë të bëjmë një artikull, me të cilin të mbrojmë sovranitetin e Palestinës, të theksojmë çështjen e domosdoshmërisë së tërheqjes të të gjitha trupave izraelite nga tokat arabe të pushtuara e të dënojmë traktatin që u nënshkrua midis Izraelit dhe Egjiptit. Kur popujt arabë të njihen me këtë artikull, do të thonë që ai është i drejtë.

Për ngjarjet në Iran, kohët e fundit ne botuam një artikull tjetër¹. Në këtë artikull folëm edhe për këshillat revolucionarë, thamë se ushtria duhet të jetë e popullit dhe oficerët të jenë të popullit. Vëmë re se, sipas shtypit iranian, ushtarët e thjeshtë kërkojnë që oficerët t'i zgjedhin vetë. Në artikull ne vumë në dukje gjithashtu se pa parti proletare nuk ka revolucion proletar, se gratë nuk luftuan për të mbajtur perçe e ferexhe, por për të fituar liritë dhe të drejtat që u takojnë etj. Ne mendojmë se ky artikull do të sqarojë

1. «Klasa punëtore iraniane zbriti në fushën e betejës, përmbysi shahun dhe tronditi botën kapitaliste» botuar në gazetën «Zëri i popullit», 18 shkurt 1979.

e do të ndriçojë sadopak mendjen e njerëzve të thjeshtë dhe dalngadalë do ta bëjë punën e vet.

Marksistë-leninistët duhet të punojnë pa u lodhur në çdo drejtim dhe kudo. Edhe në Amerikën Latine, edhe brenda në Evropë, edhe në Amerikën Veriore puna e tyre mund dhe duhet të forcohet, sepse kudo ka elementë përparimtarë e demokratë, të cilëve borgjezia u vë përpara pengesa të stërholluara.

Materialet e Partisë sonë kërkohen në botë, ato bëhen objekt studimi në klasën punëtore, ndër profesorë e studentë, ndër grupet marksiste që po krijohen në vende të ndryshme. Edhe në Afrikë kanë simpati për Shqipërinë. Por edhe revizionistët veprojnë. Kemi lajme se Kina së shpejti do të bëjë një mbledhje me gjithë përfaqësuesit maoistë të Evropës për të luftuar Partinë e Punës të Shqipërisë. Sa do të realizohet kjo, nuk e dimë, por është njoftuar se do të bëhet.

Deri para disa kohësh marrëdhëniet tona me Greqinë kanë qenë të acaruar, për shkak të rivendikimeve tokësore që kishin ndaj vendit tonë. Më vonë qëndrimi i drejtë i Partisë sonë, njohja që i bënë Shqipërisë, pra vendosja e marrëdhënieve diplomatike dhe shkëmbimi i ambasadorëve e çau, si të thuash, akullin. Vetë ata kërkuan të dërgonim atje Ansamblin tonë të Këngëve e të Valleve Popullore dhe ne e dërguam me një repertor që kishte edhe pjesë shqiptare edhe minoritare greke. Kur panë minoritarë grekë në këtë ansambël, kjo qe një gjë e papritur për grekët. Pra qëndrimi ynë ka bërë efekt të jashtëzakonshëm në punonjësit grekë në radhë të parë. Shtypi grek flet për Shqipërinë, po

botohen nga ana e tij shumë artikuj dhe libra nga tanët. Ja kështu po ecin punët në marrëdhëniet tona me këtë vend. Vitin e kaluar unë shkova në Gjirokastër, vajta edhe në fshatrat e minoritetit grek, ku fola për socializmin, për të mirat që ka sjellë ai si për gjithë popullin tonë, edhe për minoritarët. U thashë gjithashtu të ruanin gjuhën dhe zakonet e tyre dhe në çoftë se nuk do ta bënin këtë, atëherë ky do të ishte një gabim i madh. «Partia nuk lejon që ju të harroni gjuhën tuaj amtare», u thashë, «por duhet të mësoni edhe gjuhën shqipe, sepse Shqipërinë socialiste e kemi bashkë, djemtë tuaj kanë luftuar tok me djemtë tanë, për këtë Shqipëri socialiste, për këto ditë të lumtura që jetojmë». Për nevojat e minoritetit ne kemi botuar dhe vazhdojmë të botojmë libra në gjuhën greke, tekste shkollore, botojmë gjithashtu edhe një gazetë në greqisht.

Më 1821 në Greqi plasi revolucioni për çlirimin e këtij vendi nga okupacioni osman. Në këtë revolucion shqiptarët në Greqi luftuan tok me grekët, bile shumë prej tyre ishin udhëheqës të tij.

Si përpara, por edhe mbasi vdiq Skënderbeu, me mijëra e mijëra shqiptarë, u larguan nga atdheu i tyre dhe mërguan në Itali dhe në Greqi, ku u vendosën në Janinë, në Artë e deri në jug të vendit, në shumë nga vendet ku ka kaluar edhe Bajroni. Në të gjitha zonat greke ku ka shkuar, ky poet i madh romantik e përparimtar anglez ka gjetur fshatra e krahina të tëra të banuara nga shqiptarët. Në More, dua të them në Peloponez, ka bërthama arvanitasish deri edhe rreth Athi-

nës, gjithashtu, ka shqiptarë të vendosur që në shekullin e 14-të dhe të 15-të. Grekët i quajnë ata arvanitas.

Siç thashë, më 1821 plasi revolucioni grek i udhëhequr nga Ipsilanti. Në këtë kohë sundimtar i vilajetit të Janinës ishte një shqiptar, i quajtur Ali pashë Tepelena. Ky ishte i zgjuar dhe i zoti. Ai nuk i bindej Portës së Lartë të Stambollit dhe u bë alcat i grekëve në kohën e revolucionit kundër Turqisë. Arvanitasit si Marko Boçari, Foto Xhavella, Bubulina e të tjerë shqiptarë nga më të shquarit, u bënë komandantë të ushtrisë revolucionare greke. Këto gjëra përmenden edhe në tekstet e historisë greke. Pra, miqësia jonë me grekët është e vjetër, ajo e ka zanafillën që në Mesjetë, por u zhvillua sidomos në kohën e revolucionit grek.

Gjithmonë politika e Partisë sonë si në çdo drejtim edhe në marrëdhëniet me Greqinë ka qenë dhe është e drejtë. Ne i themi popullit grek se e kemi vëlla, se prej kohësh kemi luftuar së bashku, kemi luftuar tok sidomos gjatë revolucionit të vitit 1821, si dhe në kohën e Luftës së Dytë Botërore. Kështu, në Greqi, ku tash kërkohen materialet tona, është krijuar një situatë e favorshme. Arvanitasit në Greqi, të parët e të cilëve, siç thashë, u vendosën atje prej shekujsh, shkojnë në ambasadën tonë në Athinë dhe thonë se janë të lumtur e kryelartë që janë shqiptarë.

Në Partinë Komuniste të Greqisë ka pasur edhe sekretarë të Komitetit Qendror që kanë qenë shqiptarë. Kur ishim një herë në Moskë, ndodhej atje edhe Zahariadhisi, sekretari i përgjithshëm i Partisë Komu-

niste të Greqisë, por ishte edhe Kolijanisi, sekretar i Komitetit Qendror. Gjatë bisedës ky i dyti më tha:

«E di ti që jam arvanitas, shqiptar?»

«Po gjuhën shqipe e di?» e pyeta unë.

«Jo», m'u përgjigj, «di vetëm një vjershë» dhe filloi të ma thotë. Ajo ishte një vjershë bukolike.

«E dini përmbajtjen e saj?» e pyeta përsëri.

«Jo», më tha, «atë ma ka mësuar nëna». Atëherë unë ia shpjegova përmbajtjen e vjershës. Aty për aty u hodh edhe një udhëheqës tjetër i kësaj partie e tha se dhe ai ishte shqiptar, arvanitas. Ai ishte sekretar i dytë.

Fjalën e kam që me qëndrimet që mbajmë ndaj këtij vendi fqinj, ne përpiqemi, sa të jetë e mundur, të ruhet gjendja aktuale e marrëdhënieve normale midis vendeve tona.

Me Jugosllavinë, siç e dini, situata është e tillë që titistët i detyron të thonë se me shqiptarët nuk kanë çfarë të bëjnë. Ata e dinë se ne shqiptarët jemi marksistë-leninistë dhe kërkojmë që popullsisë shqiptare në Jugosllavi t'i jepen të drejtat që i takojnë.

Problemi i minoriteteve është mjaft i ndërlikuar në Ballkan. Manovra të shumta bëhen në këtë çështje. Mirëpo, Partia jonë mban qëndrim të drejtë ndaj këtij problemi, qëndrim i cili e neutralizon armikun. Vazhdimisht ne dërgojmë në Kosovë e në Maqedoni ansamble tona dhe na vijnë prej andej ansamble të tyre. Kjo është një gjë e mirë.

Ju mbajta shumë, por të më falni, ju na vini rrallë

dhe na merr malli, duam edhe të shkëmbejmë mendime me njëri-tjetrin. Shëndet dhe suksese të mëtejshme në punën tuaj. Udhë të mbarë dhe mirupafshim, shokë!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

PËRMIRËSIMI I GJENDJES NË SEKTORIN E NAFTËS KËRKON RITËM E STIL REVOLUCIONAR, ORGANIZIM E DREJTIM SIHKENCOR

*Nga biseda në takimim ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

29 mars 1979

Në sektorin e naftës, mendoj unë, duhet të bëhet një punë më e organizuar se deri tash, me objektiva të caktuar, të mos ketë ndërhyrje e dublime dhe secili të kryejë detyrën e tij. Në radhë të parë, ashtu siç kemi vendosur, të zgjidhen atje problemet kryesore, një nga të cilat është stabilizimi i fushës së Cakranit. Kjo fushë përbën tash objektin tonë kryesor të naftës. Pusët që janë në shfrytëzim në këtë fushë, të vazhdojnë të japin debitin e caktuar rregullisht. Për këtë është e domosdoshme që puna e pusit të ndiqet gjatë gjithë kohës, në mënyrë të vazhdueshme, për të vënë re përpjesëtimet, lëvizjet, gazin, naftën etj., etj. dhe të gjitha këto të shënohen në librin e pusit. Po ashtu, në këtë libër, të shënohen dhe masat që merren nga përgjegjësi i pusit, Inxhinieri ose gjeologu, duke shpje-

guar edhe se për ç'arsye u mor kjo ose ajo masë; duza e pusit, për shembull, u hap për këtë arsye, sonda u çmontua për ato arsye e kështu me radhë për çdo veprim. Me një fjalë çdo proces pune të jetë i dokumentuar. Një gjë e tillë duhet bërë, sepse kjo përbën jetën e pusit. Në qoftë se mbajmë një dokumentacion të tillë të përditshëm për aktivitetin e pusit, atëherë do të kemi një ide të saktë e të qartë të asaj fushe naftëmbajtëse ose të shtresës që është takuar.

Kjo do të shërbejë edhe për regjimin që duhet të vëmë nëpër puset e tjera për nxjerrjen e naftës. Specialistët që punojnë në fushat e naftës, nuk janë vetëm për të vëzhguar, por edhe për të nxjerrë konkluzione për sot dhe për perspektivën. Nuk mund të pranojmë fjalë në erë, siç na thotë ndonjë specialist që «ky është gaz i kondensuar me naftë», «kjo është naftë e kondensuar me gaz» etj. Çdo gjë duhet të jetë e dokumentuar, pasi vetëm kështu krijohen mundësi të studiohet më mirë gjendja e shtresave naftëmbajtëse dhe të nxirren konkluzione të sakta. Një kjo.

E dyta, të merren masa që puset të cilat janë në procesin e shpim-kërkimit të mbarojnë në afatin e caktuar pa avari; kudo ku gjendet naftë të veprohet në bazë të orientimeve që kemi dhënë.

E treta, të kërkohet dhe të zbatohet që shpejtësia sondë-muaj të shkojë kurdoherë në rritje. Ky të jetë një tregues i domosdoshëm. Të gjithë punonjësve të pusit do t'u thuhet se vazhdimisht do të kontrollohet puna. Dhe meqenëse shpejtësia sondë-muaj do të jetë në rritje, të gjitha mjetet, pajisjet dhe makineritë e

sondave duhet të jenë në gatishmëri të plotë. Të merren të gjitha masat e nevojshme që, në qoftë se ngjet ndonjë e papritur, ajo të eliminohet në kohë.

E katërta, rëndësi e veçantë t'i kushtohet nga specialistët shfrytëzimit racional të vendburimit. Mënyra e shfrytëzimit të vendburimit të bëhet me përgjegjësi, në mënyrë shkencore dhe në bazë të eksperiencës. Specialistët që e njohin strukturën duhet të japin me përpikërinë më të madhe rrjetin e vendosjes së puseve dhe sasinë e naftës që do të merret nga çdo pus. Kjo është e domosdoshme që të merren masa që fusha naf-tëmbajtëse të mos dëmtohet, e njëkohësisht të ruhen edhe debitet e naftës që merren nga pusët që janë në shfrytëzim dhe, mundësisht, po të lejohet, të merret mbi këto debite. Për këtë, specialistët t'i ristudiojnë debitet dhe, duke u mbështetur edhe në eksperiencën e fituar, të thonë nëse janë apo nuk janë të sakta.

Që punët të ecin mbarë kërkohet që bazamentet e parafabrikuara të vijnë në kohën që është caktuar dhe të fillojë vendosja e sondave atje ku janë projektuar pikat e shpimit dhe ka garanci për marrjen e naftës. Gjatë kësaj kohe të merren masa nga Drejtoria e Shpim-Kërkimit dhe nga ajo e Shpim-Shfrytëzimit që të gjitha materialet të jenë gati. Kjo punë, kuptohet, nuk bëhet në një ditë, por, duke parashikuar largësinë, të përcaktohet koha që duhet për të vendosur sondat.

E pesta, për çdo sondë që shpon 4 000 metra e më shumë, që ne disponojmë, më parë duhet të jetë caktuar vendi se ku do të vendoset dhe sa metra thellë

do të vejë. Kjo lë përcaktohet në bazë të pozicionit të strukturës. Në qoftë se ne akoma nuk kemi vendosur që të vemi më poshtë nga 4 000 metra, atëherë këto sonda të mos i përdorim për thellësi më të vogla, por t'i rezervojmë për thellësi më të mëdha.

Pëi fushën naftëmbajtëse të Cakranit, gjithashtu, të përcaktohet përafërsisht sasia e shpim-kërkimeve, e shpim-shfrytëzimeve dhe e shpim-konturimeve. Në qoftë se duhen bërë edhe disa shpime strukturore, mirë, të bëhen, por gjithmonë duke u udhëhequr nga parimi që thamë, që dy shpimet e para, shfrytëzim e kërkim, të shërbejnë edhe për konturim, edhe për çështjen e strukturës.

E gjashta, për këto komplekse është e nevojshme që të gjithë inxhinierët, që janë caktuar të punojnë për fushën e Cakranit, të rrinë atje ditë e natë, të ngrenë çadrat ose barakat dhe të mos lëvizin andej, se janë përgjegjës që punët në puse të shkojnë si sahat. Kështu duhet bërë, të paktën për një kohë të caktuar.

Pastaj, me mbarimin e disa puseve në bazë të të dhënave, të nxirren konkluzione dhe të bëhen llogaritë me afërsi për sasinë e naftës që do të marrim nga vendburimi.

Ti Hekuran, në takimin që do të bësh me drejtuesit e Institutit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës e të Gazit, si dhe me inxhinierët; pasi t'u bësh të ditur se është krijuar komisariati për naftën, do t'i njohësh me udhëzimet e këtij komisariati. Gjithashtu, do të bisedosh me sekretarin e parë të komitetit të Partisë të rrethit, që duhet të ndodhet në këtë ta-

kim, që të lajmërojë të mblidhet organizata-bazë e naftëtarëve të fushës së Cakranit.

Këtyre t'u vësh në dukje, gjithashtu, se vendimi i Komitetit Qendror të Partisë dhe i Qeverisë për krijimin e këtij komisariati të posaçëm u mor për arsye se në sektorin e naftës ka pasur mungesë disipline, organizimi, kontrolli e vigjilence. Ky komisarjat, t'u thuhet, ka kompetenca që lidhen me zbatimin e orientimeve e të vendimeve të Partisë dhe të Qeverisë për naftën. Prandaj porositë e udhëzimet e tij duhet të zbatohen nga të gjithë, që nga naftëtari e punëtori më i thjeshtë e deri te Ministria e Industrisë dhe e Mincerave.

Për këtë qëllim shokëve të komisarjatisë u është caktuar për detyrë edhe të vijnë të kontrollojnë punën e të kërkojnë llogari deri në një dhe në qoftë se do të shohin që vendimet e marra nuk zbatohen në kohën e caktuar, ata do të marrin masa, do të propozojnë për shkarkim e për ulje nga përgjegjësia të atyre drejtuesve e kuadrove që nuk punojnë mirë, të atyre që nuk tregohen vigjilentë apo që neglizhojnë në punë, ashtu siç do të lavdërojnë ata që punojnë mirë.

Organizata-bazë e Partisë të porositet që të rritë mobilizimin e të gjithëve, të punëtorëve, të teknikëve e inxhinierëve për vënien në jetë të vendimeve, e njëkohësisht të karakterizohen kudo nga një vigjilencë e lartë, nga organizimi i mirë i punës. T'u theksohet, gjithashtu, se duhet arritur që ky ose ai pus që do të vendoset të shpohet, të japë naftë, ashtu siç është parashikuar dhe brenda kohës së caktuar.

Ku duhet ta përqendroni vëmendjen në mënyrë të veçantë?

Së pari, në fushën e Cakranit. Kjo është një fushë naftëmbajtëse me rëndësi për vendin tonë që ndërton socializmin në situatë bllokade. Prandaj nga komisarriati e nga punonjësit atje kërkohet të organizohet puna në mënyrë të përsosur dhe të luftohet e të punohet si në kohë lufte. Vendimet të konsiderohen si urdhra ushtarakë. Zbatimi i tyre kërkon që secili, që nga gjeologu e deri te punëtori, t'i vërë mirë krahët punës në këtë sektor kaq të rëndësishëm për ekonominë e vendit.

Së dyti, të shikohet çështja e fushës së Frakullës që është një fushë gazmbajtëse me perspektivë. Situata atje akoma nuk është e qartë, por të punohet që të sqarohet. Po kështu të veprohet edhe për sa u përket puseve që janë shpuar e që do të shpohen në këtë fushë. Prandaj, të thirren drejtori i Institutit të Naftës e të Gazit dhe kryegjeologu i Ndërmarrjes Gjeologjike të Shpim-Kërkimit dhe ndonjë tjetër, e të diskutohet me ta me harta në dorë. Këtyre t'u kërkohet të flasin shkurt për situatën e gazit të kësaj zone. Në fillim, të dëgjohen gjeologët që kanë studiuar strukturën e zonës në fjalë, pastaj drejtori me shokë. Pasi të dëgjohen ata, të gjykohet se si është kjo strukturë, a është e përshtatshme, ka apo nuk ka gaz dhe ç'duhet të bëhet, ç'masa duhet të merren për ta pasur të qartë situatën në këtë zonë. Pastaj të pyetet se sa e madhe parashikohet të jetë fusha, ç'duhet bërë për përcaktimin e saktë të saj, sa puse shpim-

-kërkimi ose shfrytëzimi do të përcaktohen dhe a janë caktuar drejt pikat e shpim-kërkimit.

Të gjitha këto të dhëna duhet t'i studioni me kujdes; këto mund t'i konsultoni edhe me specialistë kompetentë dhe të mbani shënim që të kontrolloni punën në vazhdimësi.

Pasi të krijohet një ide e qartë e bindje e plotë për situatën, ju t'u jepni mendimet, vërejtjet e sugjerimet dhe të përcaktohet radha e punës e masat e gjithanshme për zbatimin konkret të tyre. Këto të shtrohen edhe në organizatat-bazë të Partisë që naftëtarët dhe drejtuesit të shikojnë se ju nuk pranoni teori dhe muhabetë pa bukë, nuk lejonit të harxhohet koha me debate për debate, por kërkoni të vihen mirë pikat mbi i, të zbatohen detyrat. Për këto, natyrisht, kërkohet që të mobilizohen të gjithë për ta kryer detyrën e caktuar sa më mirë, që drejtuesit të marrin të gjitha masat organizative për zbatimin e detyrave. por veçanërisht komunistët duhet të jenë në ballë të të gjithë punës që vendimet e marra e udhëzimet e dhëna të zbatohen me një disiplinë të hekurt partie.

Shokëve të komisarariatit nuk u kërkohet të zgjidhin detyra teknike, se këto u përkasin Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, Drejtorisë së Naftës, Institutit të Naftës dhe të Gazit e drejtorive të tjera të sektorit të naftës. Ata duhet të jenë në lidhje të ngushtë me organet e Partisë e të pushtetit në rrethe, me organizatat e Partisë, duke u kërkuar këtyre që jo vetëm të kontrollojnë zbatimin e vendimeve, por edhe të japin llogari për detyrat e ngarkuara.

Nga të gjithë punonjësit e sektorit të naftës duhet të ecet si në luftë, se pa naftë nuk ecet dot sot, ashtu si pa pasur municione, topa e predha, dhe disiplinë të fortë nuk mund të bëhet e të fitohet lufta.

Së treti, duhet të shikohet zona e Divjakës. Në qoftë se situata atje është e mirë, në rregull, po qe se është e nevojshme të bëhet ndonjë korigjim, të bëhet. Sigurisht, vend për të marrë masa ka, prandaj të shikohet se ku çalon puna më shumë, në ç'drejtime ka të meta dhe të caktohen detyra konkrete për shëndoshjen e situatës.

Pasi të jenë stabilizuar pikat kryesore në fushat e zbuluara, ku kanë filluar shpimet, duhet të merren masa që Partia në rrethe dhe ministria ta kenë në dorë situatën në këtë sektor, ta bëjmë siç duhet përgjegjëse Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave për kryerjen e detyrave të caktuara në kohë, të bëjmë që ajo të jetë e gjallë, aktive, pra, ta luajë si duhet rolin e vet. Edhe kontrolli i Partisë, edhe komisariati do të ndihmojnë në këtë drejtim.

Çdo gjë duhet të kryhet brenda afatit dhe të gjykohet mirë qysh më parë se të caktohet. E them këtë, sepse nuk janë të rralla rastet kur një punë që mendohet të bëhet brenda tre muajve, thuhet më vonë se mund të bëhet për një muaj e së fundi arrihet të përfundojë në një kohë shumë të shkurtër, siç ishte rasti i ndërtimit të ujësjellësit në Cakran, që u krye brenda tri ditëve. Ky rast u duhet bërë i njohur punonjësve atje. T'u thuhet se, megjithëse baza materiale dhe fuqia punëtore ishin siguruar, nga ana e

drejtuesve për kaq kohë nuk ishte vënë uji në zjarr për ndërtimin e këtij ujësjellësi, gjë që flet qartë për zvarritje të madhe të punëve, që pa dyshim na dëmton. Po, kur këtyre shokëve iu tërhoq vëmendja dhe iu kërkua që kjo punë të përfundonte sa më parë, u punua në mënyrë të tillë sa që brenda tri ditëve uji u shkoi punëtorëve atje ku duhej të shkonte prej kohësh. Po të ishte vepruar me ritmet e zakonshme, ujësjellësi nuk do të qe ndërtuar as pas tre muajsh. Pra, si konkluzion desha të them që punët të bëhen duke futur një frymë të lartë mobilizimi.

Pasi të stabilizohen këto punë, mendoj të studiohet struktura organizative e Institutit të Naftës dhe të Gazit dhe raportet e tij me ministrinë e me drejtoritë e tjera. Studimi i strukturës organizative aktuale të institutit është një çështje e komplikuar. Por ky duhet bërë, se unë mendoj që instituti komandon ministrinë dhe jo ministria institutin. Në fakt duhet të ndodhë e kundërta. Por që të bëhet kjo është e nevojshme që në Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave të ketë një grup specialistësh të zotë që të jenë në gjendje të orientojnë e t'i hapin horizont punës së institutit për studime e kërkime, të sugjerojnë masa e rrugë të frytshme për realizimin e detyrave të sektorit të naftës dhe jo të influencohen nga instituti.

Prandaj them, Hekuran, që duhen parë struktura, funksionet e institutit, ndarja e punës, personeli, numri i kuadrove dhe shpërndarja e tyre proporcionale. Të gjitha këto të studiohen, se s'ka si shpjegohen këto që po na nxjerrin ata të institutit, jo e ka fajin

shpim-kërkimi, jo shpim-shfrytëzimi, jo avaria, jo kjo, jo ajo. Instituti duhet t'i ketë të qarta detyrat dhe funksionet e tij dhe të mos kryejë detyra për të cilat përgjigjet tjetërkush. Instituti ka punë të tjera, studimore e shkencore. Në qoftë se detyra e tij është, për shembull, të orientojë sizmikën, atë duhet ta bëjë mirë; në qoftë se duhet të përcaktojë strukturat (dhe unë mendoj se kjo është një nga detyrat e institutit), ai duhet të interesohet për shpimet strukturore, të korigjojë hartat dhe të projektojë në mënyrë të përpiktë pikat e shpimit; të bëjë studime për strukturat, të cilat duhet të jenë të sakta, që të përputhen me projektin e dhënë. Këto po, janë detyrat e institutit. Dhe nëse ai i ka të qarta këto, atëherë s'ka përse të përzihet në punët e shpimit e të kërkimit, sepse për këtë punë ekzistojnë dy drejtori me kuadro të specializuar, por që kanë ose duhet të kenë edhe sektorë shkencorë medocmos, pasi, siç thashë, të gjithë ata që punojnë atje janë njerëz të shkencës.

Po ashtu duhen parë edhe kompetencat e institutit, sepse më duket që punonjësit e tij futen kudo dhe marrin përsipër shumë gjëra, ata përpiqen të jenë kudo, por kështu ndodh që të mos jenë në asnjë vend. Pra, kujt t'i kërkojmë llogari për këto gjëra? Institutit? Po përse t'i kërkojmë atij llogari për ato gjëra që duhet të përgjigjen të tjerët? Detyra e kësaj qendre shkencore në sektorin e naftës është të hapë perspektivën. Ne, nga ana jonë, t'i krijojmë institutit kushtet e domosdoshme për këtë qëllim dhe të përpiqemi t'ia plotësojmë kërkesat për bazën tekniko-

-shkencore e për disa kuadro të kualifikuar, pastaj t'i kërkojmë që punën ta kryejë sa më mirë. Dime-
 thënë, punonjësit e institutit të na japin në kohën e
 duhur pikat dhe të dhëna të studiuara mirë dhe sa
 më të sakta. Këtë duam ne nga ata. Ne nuk themi
 se të gjitha të dhënat, që japin specialistët, duhet të
 dalin qind për qind ashtu siç i kanë parashikuar, por
 edhe për këto ka norma, të cilat duhen respektuar,
 ndryshe do të livadhisin. Të paktën në pesë-gjashtë
 puse kërkimi që shpojmë, një duhet të japë paljetër
 naftë. Në qoftë se shpohen 20 puse dhe vetëm një
 prej tyre na del me naftë, atëherë do të thotë se in-
 stituti nuk është në rregull dhe në këtë rast duhen mar-
 rrë masa ndaj specialistëve ose përgjegjësve të ve-
 çantë që kanë caktuar strukturat dhe kanë bërë
 projektin e pusit në mënyrë të gabuar.

Për këto arsye, dëshiroj të theksoj edhe një herë
 që kësaj qendre shkencore t'i ngarkohet të studiojë
 disa probleme të rëndësishme të naftës. Instituti ka
 plotësisht të drejtë të shikojë rezultatin e punës së vet,
 duke ndjekur të dhënat e puseve të ndryshme, por
 jo të ndërhyjë në punët e të tjerëve. Ai duhet të shohë
 nëse studimi që ka bërë, fjala vjen, për fushën e Ca-
 kranit, ajo pikë që ka dhënë, ajo strukturë që ka për-
 caktuar, vërtetohen apo nuk vërtetohen në praktikë.
 Pa, se si do të bëhet shpimi, janë të tjerët përgjegjës
 dhe e dinë ata se si veprohet. Instituti u kërkon të
 dhënat për strukturat, për studimet dhe të tjerët do
 t'ia japin medocemos ato, sepse u duhen specialistëve
 të institutit në punën e tyre. Duke u mbështetur në

këto të dhëna dhe në eksperiencën e grumbulluar, instituti shpjegon arsyet e ndryshimeve që mund të nevojiten për t'u bërë, mund të sugjerojë, për shembull, se duhet bërë një provë tjetër në atë zonë, sjell argumente të forta për këtë etj., sepse punonjësit e tij kanë studiuar formacionet gjeologjike dhe kanë arritur në disa përfundime të caktuara shkencore.

Pasi të studiohen struktura organizative e institutit, raportet e tij me drejtoritë dhe me ministrinë, duhen dëgjuar edhe se ç'mendime kanë shokët e institutit. Me siguri që ata do të thonë që i drejton ministria, se ata nuk përzihen në punët e drejtorive etj. Atëherë të shihet se si qëndron puna në praktikë dhe në varësi me problemet që dalin, në bashkëveprim me ministrinë të caktohet një strukturë e re e përshtatshme organizative e institutit, të përcaktohen qartë funksionet dhe kompetencat e institutit, kompetencat që do të ketë vetë ministria, nga do të varen drejtoritë, kush duhet të mbetet atje, kush duhet të vijë në ministri etj., etj.

Unë, shokë, mendoj se, po nuk i patëm të qarta të gjitha problemet, po nuk e patëm të qartë situatën, atëherë do të bëhen edhe veprime që nuk do t'i vlejnjë punës në sektorin e naftës në atë shkallë që dëshirojmë. Në qoftë se më vonë do të duhet të bëjmë ndryshime në organizim, këtë do të na e tregojë vetë praktika. Pra, jo të ecim pa u thelluar mirë, por çdo gjë që propozojmë të bëhet, ta mendojmë mirë më parë.

Natyrisht, është e ligjshme të bëhet pyetja se

kush e ka fajin, kush e ka përgjegjësinë për këtë situatë jo të mirë që ekziston në sektorin e naftës, ku ka mungesë disipline, mungesë studimi, zvarritje etj., etj. Fajin e ka drejtuesi kryesor, të thonë, dhe ne marrim masë ndaj tij. Mirëpo, me këtë nuk zgjidhet problemi, nuk ndryshon situata. Pra, në qoftë se nuk i vëmë në rrugë të gjithë këta organizma, puna përsëri do të na çalojë. Të kuptohemi, një kuadër drejtues, në qoftë se është me të vërtetë organizator i mirë, ndihmon shumë në mbarëvajtjen e punës, sepse ai di kur duhet të bëjë biseda e diskutime të gjata dhe kur duhet të mos e zgjasë, por të japë urdhër të prerë që menjëherë të veprohet se nuk pret koha. Në qoftë se ke dëshirë për të biseduar gjatë, t'i thotë inxhinierit, fjala vjen, urdhëro në shtëpi, atje, po, bisedojmë sa të duash, për historinë e Spanjës e të Finlandës, për shembull, për konceptet e vjetra e mbeturinat që shfaqen në punë e në shoqëri etj., por këtu në frontin e punës më kryej detyrat që të janë ngarkuar.

Në këtë drejtim është e rëndësishme të punohet, Hekuran. Qëllimi ynë, në radhë të parë, është që ta vëmë problemin e naftës si duhet në këmbë. Kjo do të thotë që të gjithë organizmat që punojnë atje t'i jcnë përveshur seriozisht punës, të punojnë me një ritëm revolucionar dhe në bazë të një drejtimi shkençor. Të gjithë punonjësit e këtij sektori duhet të jenë përgjegjës për detyrat që kanë dhe këto të mos i zbatojnë në mënyrë shabllone, por të analizojnë dhe t'i futen thellë çdo problemi.

Këtu duhen mbajtur parasysh disa gjëra: shokët e komisariatit të kërkojnë që porositë dhe urdhrat që japin, kur kanë krijuar bindje se ato janë të drejta, të zbatohen në jetë. Gjithashtu, të bëjnë rregull që instituti të japë llogari përpara komisariatit për të gjitha studimet e përfundimet që ka arritur.

Ju do të organizoni punën në mënyrë të tillë që specialistët e institutit të bashkëbisedojnë, të diskutojnë e të konsultohen me naftëtarët e specialistët e puseve, me qëllim që të nxjerrin konkluzione sa më të sakta, që ju të merrni gjykime të dala nga diskutime të shëndosha. Në këtë mënyrë shokët e komisariatit ndihmohen, krijojnë një ide të qartë dhe japin porosi të veprohet si është më e drejtë.

Gjithashtu, Hekuran, të rishikohet një çikë edhe fakti se ku jemi shpërndarë në shpim-kërkime, si kalohet nga e njohura në të panjohurën, se kam përshtypjen se veprohet me oburra të shkojmë dhe të shpojmë ku ka thënë iks apo ipsilon inxhinier 30 ose 40 vjet më parë, të shohim edhe një herë atje, të shohim edhe një herë këtu e vazhdon ky avaz për vite. Ju do t'u theksoni që Komiteti Qendror ka porositur të veprohet duke kaluar nga e njohura në të panjohurën, por kjo të bëhet kurdoherë në mënyrë shkencore. Prandaj shikoni si është vepruar në praktikë, shikoni edhe shpim-kërkimet, shikoni sa sonda janë, sa fusha do të zbulojnë në pesëvjeçarin e ardhshëm, (jo për këtë që do të hartojmë, por për tjetrin, pra për 10 vjet) e të tjera probleme, sepse duhet të përcaktojmë mirë se me ç'hapa do të ecim në nxjerrjen e

naftës në përputhje me nevojat e zhvillimit të ekonomisë sonë, ashtu edhe për eksport. Çështja është që të mos shpërndahemi si vaji në lakra. Prandaj them se duhet ditur se ku do të bazohemi tash. Ne duhet të bazohemi kryesisht në ato fusha që na kanë dhënë shenja nafte e gazi dhe prej të cilave jemi larguar. Kështu, pasi t'i kemi përcaktuar mirë fushat se ku do të përqendrohen punimet, atëherë, natyrisht, do ta frenojmë shpërndarjen pa kriter dhe do t'i përcaktojmë më mirë proporcionet. Qëllimi është të mos i lëmë sondat të na bredhin sa andej-këtej, por të ngulemi mirë e të nxjerrim naftë në zonat e njohura me naftë. Një gjë e tillë do ta ulë për një kohë përqindjen e shpim-kërkimeve, por këto punime do të intensifikohen në ato zona në të cilat kemi pasur shenja nafte e gazi, duke u kthyer prapë në ato zona nga jemi larguar. Kjo të bëhet që të rregullohen proporcionet për perspektivën, për të qenë më shumë të sigurt për shpenzimet që bëjmë në kërkimet strukturore sot ose për ato të perspektivës. Pra të mos ceket si deri tash, duke u shpërndarë kuturu nga të katër anët, duke harxhuar miliona pa nxjerrë naftë. Të veprohet kështu, harxho e mos merr naftë, nuk është aspak e drejtë, as edhe e lejueshme. Prandaj t'i vihen detyra të mëdha institutit që të bëjë studime të thella për pikat strukturore, në bazë të të dhënave të tjera sizmike dhe të gjithë kompleksit të metodave të kërkimit, me qëllim që të kemi të qartë perspektivën, por që të shohim se ku janë të metat, ku ka mangësi e zvarritje etj., etj. Në përputhje me këto t'i cakto-

hen detyra jo vetëm institutit, por edhe Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave që në kohën e duhur të marrë masa për përmirësimin e gjendjes, duke shfrytëzuar makineritë dhe aparaturat ekzistuese, por edhe duke planifikuar disa aparate më moderne për sizmikën. Për porosinë që do të bëjë ministria për importin e aparatrave duhet t'ju vërë në dijeni ju, me qëllim që kërkesat për to të bëhen sa më të menduara, duke pasur parasysh nevojat e perspektivës, por ama edhe mundësitë tona.

Natyrisht, gjatë punës do të dalin edhe çështje të tjera, por për këto duhet t'u punojë koka të gjithëve, që nga ministria e deri në bazë, që ta ndiejnë të gjithë veten përgjegjës. Komisariati do të kërkojë llogari për punën e ministrisë dhe të bazës dhe këto ta kenë të qartë se komisariati nuk do t'u marrë atyre përgjegjësinë. Jo, ai nuk mban përgjegjësi për moskryerjen e detyrave, për mosrealizimin e planit në sektorin e naftës. Përgjegjësi ai do të ketë vetëm për vendimet që merr dhe për porosinë që jep. Prandaj ç'kanë të bëjnë me probleme teknike, me sigurimin e makinerive e të automjeteve, të materialeve të ndërimit etj. ato do t'i zgjidhin vetë ministria dhe baza, duke vajtur deri në Qeveri. Këto nuk janë punë e komisariatit. Ky do që të gjitha masat të merren e çdo gjë të jetë në vendin e saj, në bazë të vendimeve dhe të planit.

Çështja është që eksperiencia që do të krijoni në sektorin e naftës të na shërbejë edhe për sektorët e tjerë të ekonomisë. Nafta, siç dihet, është një nga lën-

dët më kryesore, jetike për zhvillimin e ekonomisë sonë, prandaj kërkohet që në këtë sektor të vendoset me të vërtetë një disiplinë e hekurt në studim, në organizim, në zbatim dhe në përvetësim. Është e domosdoshme të merren masa të menjëhershme për shëndoshjen e situatës, pse në të gjitha këto hallka, qoftë në zhvillimin e debateve, qoftë në organizimin e strukturave, apo në përgjegjësitë e çdo ndërmarrjeje, ka të meta. Fjala vjen, për sa i përket punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës ne vërtet dimë diçka, por se si është organizuar puna brenda kësaj drejtorie, si funksionon, zbatohen përgjegjësitë, si bëhen studimet, si bëhet kontrolli, këtë nuk e dimë. Prandaj për këtë të informohemi mirë. Këtu duhet të vendosim rregull e disiplinë.

Këto drejtori duhet t'i ngremë në një nivel më të lartë, jo vetëm në sektorin e industrisë së naftës që është shumë i rëndësishëm, po në gjithë sektorët apo degët e tjera të industrisë, sepse nuk do të krijojmë komisariate të posaçme edhe gjatë. Në këtë mënyrë duhet të punojë, për shembull, shtabi i drejtorisë së kombinatit të autotraktorëve «Enver Hoxha», po kështu ai i kombinatit të tekstileve «Stalin» ose i kombinatit ushqimor «Ali Kelmendi» etj. Në qoftë se nivelin e punës në këto drejtori ne nuk e ngremë në një shkallë të lartë, atëherë nuk kemi gjë në vijë.

Për ngritjen e nivelit të punës drejtuese duhet punuar mirë, se ka raste që edhe kuadro specialistë të aftë probleme të tilla nuk i kanë të qarta. Në mbledhjen e Byrosë Politike konstatova se një kuadër drej-

tues, një shkencëtar me të vërtetë i mirë, çështjen e kualifikimit pasuniversitar të kuadrove nuk e kishte të qartë, ishte konfuz. Ne duhet ta ngremë nivelin shkencor jo vetëm në universitet, por dhe jashtë universitetit. Prandaj edhe Akademia e Shkencave, nëpërmjet formave të ndryshme, nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor etj. të punojë në këtë drejtim. Këtyre grupeve u janë ngarkuar të bëjnë studime shkencore për këtë ose për atë problem. Pra, të mos e marrësh në konsideratë punën e një mijë e ca kuadrove nga më të mirët, që janë grumbulluar në disa grupe dhe u kemi caktuar të bëjnë studime shkencore, s'më duket e drejtë. Ne nuk mendojmë t'i nxitim për titull ose të japin provim. Jo, sepse ata titullin do ta marrin ose provimin do ta japin duke kryer detyrën që u është ngarkuar. Pra, e jep provimin ose s'e jep provimin, bën libër ose s'bën libër, kjo nuk na hyn në punë. Ata duhet të paraqiten dhe në këtë u kërkojmë, e kanë bërë studimin apo projektin e kësaj apo të asaj vepre. Dhe ata duhet të na japin dokumentet.

Më kujtohet, kur isha në Francë, që një shoku im, si temë diplome për doktor në medicinë mori problemin e veshkave. Ai studioi për këtë problem, dha provimin, dhe më vonë me studimin e tij për veshkat botoi një libër në frëngjisht. Këtë libër e kam në bibliotekën time. Ky doktor që ishte një nga shokët e mi më të ngushtë, është pushkatuar në kohën e Koçi Xoxes. Pse u pushkatua, as unë nuk e mora vesh, por dihet se qëllimi i Koçit ishte që të godiste të afërmit

ose miqtë e mi, me qëllim që të thoshte: Ja, e shikoni çfarë miqsh ka Enver Hoxha!?

Pra, të gjithë këta specialistë, të cilëve u kemi ngarkuar detyra për të studiuar një varg problemesh të rëndësishme në fusha të ndryshme, nesër, pas përfundimit të studimit, bëhen kandidatë të shkencave, doktorë në shkencë, docentë etj., etj. Kështu që specialistëve të këtyre grupeve tani për tani nuk mund t'u kërkosh të bëjnë libra, kur ata janë ngarkuar dhe po bëjnë studime.

Unë mendoj, Simon [Stefani], se në punën me kuadrin, kur bëhen emërime në disa qendra studimore e shkencore, duhet pasur parasysh që edhe drejtuesit kryesorë të jenë nga ata që merren me studime dhe të ngarkohen të merren me studime. Këtu kam parasysh edhe rektorin e universitetit, që edhe ky të merret vetë me punë shkencore. Se, në qoftë se ai merret me punë të zakonshme dhe me gjëra të vogla, ta zëmë, si u bë kjo, si u bë ajo, jo duhet parketi, jo duhet makina etj., mbaroi puna e tij. Nuk është kjo puna e tij, por ai të drejtojë e të bëjë edhe vetë punë shkencore. Universiteti është një institucion shkencor, atje kemi shkencëtarët tanë, këtë fakt duhet ta kemi shumë në konsideratë, pra edhe rektori duhet të jetë vetë studiues, shkencëtar. Pastaj, në universitet, ka edhe zëvendësrektorë, bile një nga këta është i ngarkuar të merret me problemet administrative. Por ky nuk e bën detyrën si duhet dhe për çdo gjë shkon te rektori. duke e penguar këtë të ndjekë probleme të rëndësishme të punës shkencore në universitet, në dekanate e

në katedra, të shohë e të drejtojnë mirë punën për kualifikimin dhe ngritjen e kuadrove të rinj shkencorë etj.

Nga universiteti po nxjerrim vazhdimisht kuadro, të cilët punojnë në prodhim dhe luftojnë atje të lidhin teorinë me praktikën. Këtyre u japim edhe detyra të caktuara për të studiuar e për të zgjidhur probleme tekniko-shkencore për një perspektivë të afërme dhe të largët. Me punën e tyre kërkimore, me studimet e tyre të aplikuara në praktikë ata ngrihen nga pikëpamja shkencore dhe fare mirë mund të themi se ata janë kandidatë të shkencave. Dikujt i është dhënë titulli profesor, për shembull, sepse ka shkruar një apo dy libra. Po, mirë, more shokë, po ai kryeinxhinieri i Hidrocentralit të Fierzës që zbaton gjithë atë projekt të një hidrocentrali kaq të madh, ose ai tjetri që projektoi urën e madhe të Kukësit, që është një vepër e tërë, nuk e meriton një gradë apo titull shkencor?! Këtë duhet ta shohim, se sikur nuk shkon.

SHOKU SIMON STEFANI: Edhe në universitet, por edhe në institucione të tjera, e sidomos nëpër ministrinë, u bien më shumë në qafë drejtuesve kryesorë për probleme administrative.

SHOKU ENVER HOXHA: Kështu është, ke të drejtë, Simon. Është krijuar një mendim që për çdo gjë t'i kërkohet llogari vetëm përgjegjësit kryesor, ministrit, rektorit etj. Është e vërtetë që Qeveria do të dijë gjendjen për çdo sektor, por ndihmësi i kryeministrit apo i zëvendëskryeministrit jo për çdo gjë, bie fjala edhe për lidhëset e këpucëve, të marrë në

telefon e të bisedojë me ministrin, sepse atje ka edhe drejtori përkatëse. Probleme të tilla dalin sa të duash çdo ditë, por në qoftë se çdo ditë do të bisedosh me ministrin për këto gjëra, atëherë si do ta bëjë ministri atë punë për të cilën është ngarkuar? Prandaj, po të veprohet ashtu siç thashë pak më lart, edhe ministrit do t'i lihet më shumë kohë të merret me problemet e drejtimit e të organizimit më të mirë të punës në dikasterin që drejton. Natyrisht, në raste të veçanta, mund të merret një herë edhe ministri në telefon, por jo të bëhet rrugë që edhe për probleme të cilat mund të zgjidhen fare mirë me drejtorët, të bisedohet vetëm me të.

Kjo duhet parë edhe këtu te ne, në aparatit e Komitetit Qendror. Jo për çdo problem të merret kryeministri. Kur e do puna, mund të bisedohet drejt e me ministrat përkatës dhe jo të themi çdo gjë nëpërmjet kryeministrit apo zëvendëskryeministrit.

Ne shokët e udhëheqjes duhet të mendojmë për problemet kryesore që na preokupojnë. Dhe, sa për ndjekjen e problemeve të shumta të ditës, në aparat kemi instruktorët. Ata janë kuadro të rëndësishëm të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë. Edhe anëtarët e kryesisë së Qeverisë kanë ndihmësit e tyre. Prandaj, kur kanë vërejtje, dhe për të pasur kanë, instruktorit ose ndihmësi i zëvendëskryeministrit të mos venë te ministrat, por edhe në rrethe, të ndërmarrjet e t'u kërkojnë atyre drejtpërdrejt t'u japin rrugëzgjdhje problemeve. Kështu drejtori i kombinatit apo i uzinës do të reagojë më mirë, se i flet instruktori i aparatit

të Komitetit Qendror të Partisë dhe i tërheq vërejtjen kur nuk i realizon detyrat.

Secili prej nesh mund të bisedojë vetë me ministrin, por për probleme të ditës është më mirë të dërgojmë instruktorët. Sekretarët e Komitetit Qendror të Partisë nuk shkojnë në çdo rast në organizatat-bazë të kësaj apo asaj uzine që nuk realizon planin ose që ka disiplinë të dobët. Por instruktori i aparatit të Komitetit Qendror të Partisë shkon edhe në organizatën-bazë, edhe në byronë e ndërmarrjes, apo edhe në komitetin e Partisë të rajonit. Po pse atëherë ta marrim për çdo gjë në telefon sekretarin e komitetit të Partisë të rrethit, për shembull, dhe t'i kërkojmë llogari edhe për gjëra të vogla, për pe dhe gjilpërë, siç i thonë një fjale? Se, të mos harrojmë, kur atë e merr në telefon sekretari i Komitetit Qendror të Partisë, për një problem, atëherë drejtuesi i rrethit duhet të interesohet për ta zgjidhur sa më parë atë, pra do të merrret me atë e do të lërë mënjanë problemet e tjera më të rëndësishme.

Prandaj, shokë, të gjithë të përpiqemi që ta përmirësojmë më tej stilin e punës. Kjo arrihet me një këmbëngulje të vazhdueshme për të gjetur mënyra e forma sa më frytdhënëse për punën tonë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e incizuar, që gjendet në AQP*

KUR MERREN VENDIME DHE ZBATOHEN ATO, PUNËT NUK I LIHEN SPONTANEITETIT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

30 mars 1979

Pasi u interesua se si i ndihmojnë rrethet dhe bazën instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, a u japin atyre një ndihmë të kualifikuar etj., duke marrë fjalën, shoku Enver Hoxha tha:

Çështja e organizimit dhe e shpërblimit të punës është me rëndësi të madhe. Komiteteve të Partisë dhe drejtuesve të kooperativave bujqësore a u shkon ndonjëherë në mendje në këto ditë punësh intensive të bëjnë kategorizimin e pagave sipas punës që kryen secili, duke gjykuar për cilin prodhim a proces pune kërkohet më tepër djersë, për cilin prodhim a proces

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi disa konkluzione dhe detyra për punën e komitetit dhe të organizatave të Partisë për zbatimin e eksperiencës së përparuar në bimët industriale». Si të ftuar merrnin pjesë sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve Berat, Korçë dhe Sarandë.

pune ka më tepër lodhje? A u bien në sy gjëra të tilla drejtuesve në kooperativë? Sigurisht u bien në sy. Për sa kohë që thuhet se një proces pune është i lodhshëm, kurse një punë tjetër nuk është aq e lodhshme, atëherë përse paguhen njësoj? Për shembull, në punën me duhanin kryhen disa procese, ai paloset fletë më fletë, laget në sasinë e duhur sipas duarve të pjekjes dhe sipas cilësisë etj. Të gjitha këto procese pune kërkojnë mjeshtëri të madhe që unë, natyrisht, nuk e njoh sa duhet, po e marr me mend. Kjo punë është më e rëndë se ngarkim-shkarkimi i mallrave në kamion. Por ne duhet të punojmë me këtë bimë, se tani ka shumë fitime nga duhani. Në qoftë se e manipulojmë kështu mirë atë dhe e nxjerrim të cilësisë së mirë, shteti ka fitime, por edhe kooperativistët marrin të ardhura të mira. Ndërsa kur nuk manipulohet si duhet, ka humbje.

Pikërisht këto llogari duhen bërë mirë, qoftë nga Ministria e Bujqësisë, qoftë nga vetë kooperativat që e kultivojnë duhanin, me qëllim që të organizohen punët në mënyrë të tillë që edhe prodhimi i duhanit të shtohet, por edhe manipulimi i tij të përmirësohet e cilësia të rritet. Kështu kooperativat do të kenë shumë leverdi. Por unë mendoj se nga të ardhurat që merren nga duhani të mos përfitojë ai kooperativist që nuk punon me duhanin, por t'i marrë brigada që punon me këtë bimë. Kur të ngrihet pyetja që pse ajo brigadë të marrë më shumë, atëherë t'u shpjegohet njerëzve se ajo në bazë të sasisë dhe të cilësisë së punës e meriton një gjë të tillë. Në qoftë se pretendojnë edhe të tjerët

që të venë të punojnë në atë brigadë, ju duhet t'i bindni se nuk mund të punojnë të tërë atje, po çdo njeri duhet ta bëjë punën mirë aty ku është, në foragjere apo në bimë të tjera, të japin rendiment më shumë që edhe të ardhura të marrin më shumë.

Në foragjere puna nuk është aq e vështirë sa me duhanin. Ata që punojnë në brigadën e foragjereve janë të lidhur me prodhimin e qumështit e të mishit etj. dhe, në qoftë se punën e bëjnë me kujdes dhe rritin rendimentet, edhe brigada e tyre do të ketë më tepër të ardhura dhe çdo kooperativisti do t'i takojë të marrë më shumë për ditë-punë.

Stimuj të tillë duhen praktikuar në rrugë të drejtë marksiste-leniniste që në drejtimin e ekonomisë të mos ecim si kuajt e arabasë, të mos ngulemi në disa gjëra të vendosura me kohë, pa parë tendencën e zhvillimit tonë progresiv.

Ata që punojnë në Ndërmarrjen Bujqësore të Malit marrin rendimente të mira në panxhar, se punojnë me norma, po edhe kooperativat prodhojnë panxhar. Po si janë rendimentet që merren në panxhar në ndërmarrjen bujqësore dhe në kooperativa? Po të ardhurat e kooperativistëve në ç'raport janë me ato të punëtorëve? A bëhet ndonjë studim për ta parë këtë raport? Se një studim i tillë ka rëndësi, sidomos kur kooperativa lufton që ta arrijë e bile ta tejkalojë rendimentin që merr ndërmarrja bujqësore, sepse kjo lidhet me shpërbllimin e anëtarëve. Unë e kam fjalën këtu, që, në qoftë se rendimenti i panxharit në kooperativë është i njëjlojtë me atë të ndërmarrjes bujqë-

sore, po shpërblimi për këtë prodhim a është i një-llojtë?

Pra, për prodhime të veçanta duhet të shikohen të ardhurat që merren në ndërmarrje dhe në kooperativa, me qëllim që ato të shihen të lidhura me rendimentet. Në qoftë se kooperativa bujqësore e Pojanit, për shembull, i ka rritur rendimentin dhe prodhimin e grurit ose të panxharit, kjo do të reflektohet edhe në rritjen e të ardhurave që realizohen për ditë-punë.

Këtu u fol edhe për çështjen e farërave. Unë pyeta për farën e panxharit, ç'bëhet me të, a eksperimentoni farën më të mirë dhe a e kultivoni atë. Por nga ato që dëgjova dola me konkluzionin se nuk bëhet llogari, nuk bëhet një punë e thellë shkencore, por vazhdohet puna me një farë që është bërë rutinë, që nuk ka përqindje të lartë sheqeri dhe në vend që të gjendet, të eksperimentohet e të kultivohet një farë tjetër, që ka përmbajtje më të lartë sheqeri, mendohet që të sjellë shteti sheqer nga jashtë. Unë mendoj që disa hektarë tokë ju duhet t'i përdorni për farë, me qëllim që të bëni rotacionin.

Këtu në Sekretariatit e Komitetit Qendror ju thërresim jo për të na thënë se panxhari ka lulëzuar, ka lëshuar fletë etj., por të bisedojmë për probleme të rëndësishme, të rritjes së pandërprerë të rendimentit të panxharit, të masave agroteknike e shkencore që merren për këtë, për probleme të futjes në bujqësi të të dhënave të reja të shkencës etj. Flasim vazhdimisht për eksperimentim shkencor, që është një gjë shumë e mirë, por në këtë drejtim nuk shohim lëvizje

me hapa të mëdhenj as nga Ministria e Bujqësisë, as nga rrethet. Ministrinë e Bujqësisë ju shokët e rretheve duhet ta vini përpara situatave e problemeve të atilla që t'ju ndihmojë për të futur në shkallë të gjerë e brenda një kohe të shkurtër farën që mendoni ju. Por për këtë duhet të bëni eksperimentime, t'i kryeni me rigorozitet shkencor shërbimet, të llogaritni dhe të provoni sasinë e përmbajtjes së sheqerit, leverdinë ekonomike etj. Para këtyre argumentimeve, pastaj mund të arrihet në konkluzionin që mund të rritet çmimi i blerjes së panxharit, gjë që do t'i nxitë e do t'i stimulojë më shumë edhe punëtorët e ndërmarrjes bujqësore, edhe kooperativistët.

Kështu duhet të bëhen këto punë dhe jo siç thonë shokët e Ministrisë së Bujqësisë se mendojnë të bëjnë këtë e atë pa marrë vendimet përkatëse. Ç'i pengon ata ta marrin këtë vendim që duhej ta kishin marrë gjersa e kanë mendimin? Ne mund t'i themi njëri-tjetrit shumë historira, por një çështje e tillë si kjo e panxharit nuk do llafe. Ju bëni studime, keni marrë e keni shfrytëzuar materiale nga jashtë dhe keni parë ç'rendimente kanë llojet e ndryshme të farërave të panxharit. Nga të gjithë këta faktorë është arritur në disa konkluzione, në bazë të të cilave duhet të merrni një vendim ku të përcaktoni se sa do të sillni nga secili lloj, ku dhe kur do ta mbillni etj., duke shprehur në vendim edhe afatet. Pasi të merret vendimi, punohet ai me punëtorët dhe kooperativistët, duke u shpjeguar atyre vlerat e tij dhe pastaj bëhet me ta edhe sqarimi i agroteknikës që do të përdoret. Kur t'i

marrim rezultatet e prodhimit të kësaj fare, vendosim që brenda dy-tre vjetëve të mbjellim, fjala vjen, 80 për qind të sipërfaqes me të. Ne kemi një eksperiencë jo të mirë, jo vetëm nga Ministria e Bujqësisë, por edhe nga të tjerë, që janë marrë vendime dhe nuk janë zbatuar; lëre pastaj ç'bëhet kur nuk janë marrë vendime.

Duhet të jemi të ndërgjegjshëm, shokë, se, po të marrim një vendim të tillë, ne do të shkurtojmë importin e sheqerit. Por për këtë duhen bërë takime e duhet biseduar me njerëzit, të bëjmë llogaritë bashkë me ta. Shokët nga qendra do të shkojnë në bazë, do të marrin mendimin e specialistëve e të punonjësve të bujqësisë derisa kjo punë të futet në rrugë. Në qoftë se detyra zbatohet, do të dilni faqebardhë përpara Partisë dhe popullit dhe do të lavdëroheni, në rast të kundërt do të jepni llogari.

Pra, duhet vepruar menjëherë. Meqë keni provuar, mund të bëhen eksperimente edhe në Elbasan, po të doni, bile edhe në ndonjë rreth tjetër, por vëmendjen përqendrojeni në Korçë, se atje është baza jonë më e rëndësishme e prodhimit të panxharsheqerit.

Po me këtë sy duhet parë edhe çështja e sistemit të tokave. Unë kam vërejtur se ju keni marrë vendime dhe keni filluar të sistemoni edhe fusha, nga të cilat marrim 30 kuintalë grurë për hektar. Por fjala është që prej tyre të marrim 40-50 e më shumë kuintalë grurë për hektar.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ujitjen me

impiante. Se, me sa kam dëgjuar, i keni shpërndarë pa kriter impiantet e ujitjes. Këto për mendimin tim u duhen dhënë më parë atyre rretheve që kanë fusha nga ku mund të merren rendimente të larta. Dhe jo të nisemi thjesht nga dëshirat e rretheve. Këto dëshira duhet të përputhen e të harmonizohen mirë me interesat e tërë vendit. Ne duam që nga fusha të tilla, si ajo e Myzeqesë, e Korçës, e Dropullit etj., të marrim 40-50 quintalë grurë për hektar. Këto t'i shohim me përparësi, pastaj rrethet që kanë peshë më të vogël në prodhimet bujqësore. Këtu u tha që për ujitjen përdoret energji elektrike. Dhe kur? Në muajt korrik-gusht, kur niveli i ujit të hidrocentraleve ulet dhe pakësohet energjia elektrike, e cila na duhet që të mos ndërpresim punën në fabrika. Pikërisht në këtë periudhë planifikohet për ujitje artificiale me energji elektrike të marrë nga rrjeti! Kjo nuk shkon. Në këtë kohë ujitja të bëhet me motopompa të vëna në lëvizje nga fuqia motorike e traktorëve. Këtu duhet ecur me llogari, si na del më e lirë ujitja dhe si të kursehet sa më shumë ujë, që të mos na shkojë kot. Atë ujë që kemi duhet ta përdorim me ekonomi, që të përballohen të gjitha nevojat. Neve na intereson më shumë ujitja e lirë, pse ajo na kushton më pak. Edhe sikur energjinë elektrike ta kemi të tepërt, ne më mirë ta eksportojmë. Prandaj, kur kemi mundësi të bëjmë ujitje të lirë, të mos kërkojmë përnjëherë modernizimin e saj, sepse duhet të sigurohet më parë energjia elektrike e nevojshme në çdo kohë. Që është më e mirë ujitja në formë shiu, me impiante moderne, jemi dakord. Kjo formë

ujitjeje përkon edhe me kërkesat e tjera të agrotknikës, mirëpo neve na duhet ta kursejmë energjinë, se eksportohet. Me të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike mund të sjellim nga importi traktorë, të cilët mund t'i përdorim edhe për ujitje. Por traktori ka një kohë amortizimi. Punonjësit tanë mund t'ia zgjatin jetën dhe ta mbajnë në gjendje të mirë me vegla ndërrimi, të cilat nuk sigurohen lehtë, por i prodhojmë me djersë. Megjithatë ne më mirë të përdorim traktorët edhe për ujitje, se edhe energjinë elektrike e kursejmë, edhe mundësitë natyrore, ujitjen e lirë, nuk i neglizhojmë. Prandaj të bëhen të gjitha përpjekjet për sistemimin dhe ujitjen e tokave dhe sidomos për bimët e veçanta industriale, të cilat kanë rëndësi të madhe. Për këto probleme të merren vendime në vend, të cilat të zbatohen menjëherë e të mos flihet mbi to. Kur ka mundësi, shteti do të japë edhe energji elektrike nga rrjeti. Por aty ku është e mundur edhe traktorët të përdoren më pak për ujitje e të praktikohet më shumë ujitja e lirë.

Unë desha të di nëse kanë biseduar rrethet, në mënyrë të veçantë, të hollësishme dhe me kompetencë me Ministrinë e Industrisë, me Ministrinë e Bujqësisë, me atë të Tregtisë së Jashtme dhe me dikasteret e tjera të interesuara për duhanin, për të përcaktuar se cila është toka më e favorshme për ta mbjellë me duhan, për sasinë e hektarëve që do të mbillen, për të gjetur se cila farë është më e përshtatshme dhe më e leverdishme etj. Pra, e kam fjalën, a zhvillojnë shokët e rretheve e të bazës debate me Ministrinë e Bujqësisë

për çështje që mendojnë se ajo nuk i shikon mirë? A ka ndodhur që të ngrihet ministri i Tregtisë e të thotë se, fjala vjen, 50 për qind të duhanit që prodhohet nuk e marrin jashtë, se nuk e pëlqejnë si cilësi, si lloj, si farë, si ambalazh, si trajtim etj.? A bëhen mbledhje a konsulta për t'i sheshuar këto probleme, apo nuk bëhen, apo rrethet mjaftohen duke mbjellë atë duhan që u caktohet? Ka shkuar ndonjëherë atje ku kultivohet duhani ndonjë përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë dhe i Ministrisë së Industrisë për të përcaktuar përmasat e mbjelljeve për probleme të tjera të duhanit?

Në qoftë se nuk veprohet kështu, atëherë si do të arrihet në një mendim të kualifikuar e në metoda të përparuara për prodhimin e duhaneve të cilësisë së mirë, që edhe tregtia e cigareve të ecë mirë e të jetë sa më e leverdishme? A e dini ju që në tregun e jashtëm na nxjerrin pengesa për shitjen e duhanit, për arsye se atje nuk e duan siç e duam ne, por siç u pëlqen atyre? Prandaj të përpiqemi ta prodhojmë siç e duan ata. Me mallin tonë ne duhet t'ia plotësojmë kërkesat konsumatorit të huaj, ndryshe ata nuk na i blejnë mallrat tona.

Këto punë bëhen mirë kur prodhuesi i njeh kërkesat e tregut të jashtëm. Shokët e tregtisë së jashtme ankohen se nuk u shiten cigaret. Po pse nuk e kanë marrë ata ndonjëherë mundimin që të bisedojnë me punonjësit e fabrikave të cigareve dhe me ata të bujqësisë, t'ua shtrojnë këto probleme e t'u thonë se të tilla cigare dhe të tilla duhane me cilësi të dobët nuk

po shiten në botë, prandaj të bëjmë përpjekje për të gjetur e për të prodhuar lloje të reja me cilësi më të mirë? Kjo është e lidhur jo vetëm me të ardhurat e ekonomisë në tërësi, por edhe me ato të rrethit, me interesat e kooperativave e të anëtarëve, me interesin e punëtorëve.

Duke bërë këto përmirësime të cilësisë së cigareve e të duhaneve, duhet ndryshuar metoda e punës, duhet rritur niveli i shërbimit agroteknik i duhaneve që janë me leverdi dhe që shiten me lehtësi jashtë.

Këto çështje të shihen më mirë, si nga vetë rrethet, ashtu edhe nga ministria, sepse po nuk u shitën jashtë cigaret, atëherë ekonomia jonë pëson humbje, por edhe rrethet nuk do të financohen si duhet nga shteti. Në qoftë se një rrethi i duhet një fabrikë çimentoje, cigaresh, këpucësh apo tullash, shteti do të financojë për këto, por për ta lehtësuar buxhetin e shtetit vetë rrethet mund dhe duhet të kontribuojnë që të prodhojnë më shumë për eksport, për t'i dhënë ekonomisë më shumë të ardhura. Kështu duhet vlerësuar kjo çështje. Pra, duke u nisur nga interesat e vetë rrethit, por edhe nga ata të vendit, se këta janë të lidhur midis tyre, rrethet të synojnë që të kultivojnë ato duhane që janë me leverdi dhe që shiten në tregun e jashtëm. Këtu kam parasysh edhe njëfarë specializimi të ekonomive bujqësore për lloje të caktuara duhani, në bashkëpunim edhe me shokët e tregtisë së jashtme. Në qoftë se këta nuk i ndihmojnë rrethet, atëherë problemi të çohet deri në Qeveri, pasi Ministria e Tregtisë së Jashtme nuk po e dëgjon zërin e rre-

theve për të përcaktuar llojet më të mira të duhanit për eksport. Edhe Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore nuk po kujdeset që të nxjerrë harman të mirë, se nuk ka specialistë. Specialisti që bën harmanin, është vrina e fundit e kavallit për këtë ministri, kurse kryesori është ai që bën cigaret. Të kritikohen neglizhencat e atyre që nuk marrin masat e nevojshme për përmirësimin e cilësisë së cigareve, të cilësisë së farërave të duhanit. Kur kemi disa lloje farërash, atëherë duhet të bëhet një plan i menduar mirë për shpërndarjen e tyre. Në këtë shpërndarje të shihen interesat e kooperativës ose të rrethit, por edhe interesat e shtetit.

Këto kërkojnë një bashkërendim të mirë të punëve ndërmjet vetë dikastereve, por edhe të dikastereve me rrethet dhe me ekonomitë bujqësore që kultivojnë duhanin. Ky bashkërendim të konkretizohet në vendime të përbashkëta, në zbërthime të përbashkëta të direktivave të Komitetit Qendror ose të vendimeve të Qeverisë. Kështu, duke bashkëpunuar ngushtë dhe në mënyrë sistematike, dikasteret e interesuara dhe rrethet, duke zbatuar drejt orientimet dhe kompetencat që kanë, veprojnë konkretisht për marrjen e masave që sigurojnë rezultate në prodhim.

Punët nuk bëhen me llafe dhe me mbledhje, as duke pritur nga lart dhe duke ecur me prirjen «dale, prit, ta studiojmë». Duhet veprim konkret për zbatim.

Kështu duhet ecur edhe për zbatimin e eksperiencës së Plasës. A mund të na thuhet këtu se sa kooperativa e kanë përqafuar këtë eksperiencë, se çfarë

ka dalë nga kjo për bashkërendimin e punëve, për specializimin dhe për përqendrimin ose shpërndarjen e kulturave bujqësore? Dihet se specializimi i përqendron këto, prandaj disa prodhime bujqësore ky i mënjanon. Por në këtë gjë duhet ecur me mend, në përputhje me kushtet konkrete të çdo ekonomie e të çdo rrethi. Ja, fjala vjen, Korça ka një traditë të mirë për pataten. Por të arrijë ky rreth ta trajtojë këtë sa për të kaluar radhën dhe të mos marrë as farën, kjo nuk është e pranueshme. Patatja për ne është shumë e rëndësishme, është me shumë leverdi, për arsye se në krahasim me drithin raporti del katër me një. Por në qoftë se Korça merr një rendiment shumë të ulët në patate, atëherë, sido që na duhet patatja, mund të themi se e vlen barra qiranë të mbillet më mirë misër. Në kushtet kur merret kaq pak patate a mund të themi se po zbatohet mirë përvoja e Plasës? Kjo tregon se as rrethi, as Ministria e Bujqësisë nuk bëjnë punë me mend. Kultivimi i patates është vendosur me një vendim të veçantë të Komitetit Qendror, duke kërkuar që të merret një rendiment prej 200 quintalë për hektar. Por Korça nuk po jep as farën! Ka gati shtatë vjet që është bërë studimi për Plasën. Po të ishte punuar në mënyrë sistematike për zbatimin e këtij studimi, për zëvendësimin e përqendrimin e prodhimeve bujqësore do të ishin arritur sukseset e dëshiruara, jo vetëm në rrethin e Korçës, por edhe në rrethet e tjera, si në Mat dhe në Lezhë, për shembull, vetëm nga shtimi i rendimenteve mund ta merrnim sasinë e planifikuar të misrit a të patates. Po ashtu, fjala vjen, jon-

xha hiqet nga disa rrethe dhe mbillet në disa rrethe të tjera. Kështu stabilizojmë një bujqësi moderne me të gjitha prodhimet bujqësore të nevojshme për vendin. Në këtë rrugë do të sigurohet rritja e prodhimit në mënyrë të pandërprerë.

Rritja e prodhimëve bujqësore në përgjithësi, por veçanërisht e atyre që shërbejnë për ushqimin e popullit, ka rëndësi të madhe politike dhe ekonomike. Kjo çështje duhet të kuptohet nga ana shkencore dhe nga ana ideologjike, por në mënyrë të veçantë ka rëndësi organizimi i punëve. Specialistë kemi. Po të ishin aktivizuar mirë këta, bashkë me kuadro të tjerë dhe me teknikë të mesëm, brenda këtyre shtatë vjetëve do të kishin bërë mrekulli në rritjen e rendimenteve, si në Korçë, edhe në rrethe të tjera. Por këto gjëra i lihen spontaneitetit. Vetëm kooperativat nuk e bëjnë këtë punë si duhet, pa një organizim dhe pa një drejtim të mirë. «Na e hoqët nga plani pataten, — thonë drejtuesit e kooperativës, — mirë bëtë, se e kemi më lehtë me misrin». Pra, çështjet e organizimit dalin të mprehta. Prandaj këto probleme t'i marrë në dorë komiteti i Partisë, i cili aktivizon dhe vë në lëvizje specialistët, krijon me ta grupe pune që i japin një hov të madh ekonomisë. Veçse ato duhen drejtuar mirë dhe të mos i lihen spontaneitetit. Pëstaj ne kemi institutet bujqësore, stacionet e ndryshme etj. Edhe këto eksperimentojnë. Por ata duhet të jenë në drejtimin e Partisë në rreth, se një person i vetëm ose një institut pa bashkëpunim me të tjerët nuk mund t'i bëjë dot vetë si duhet këto punë. Ata kanë planet e tyre,

por unë kurdoherë ngul këmbë në grupet e specialisteve. Partia duhet të dijë se ç'bën ky ose ai institut dhe t'i kërkojë llogari që të bëhen ato studime që nevojiten brenda kohës së caktuar, si dhe të ndjekë bashkëpunimin e institutit me kooperativat dhe ekonomitë bujqësore, si zbatohen kërkesat e eksperimentimit dhe ç'rezultate arrihen. Në këto drejtime, shokë të bujqësisë, duhet futur thellë që të kuptohen mirë këto çështje dhe, ajo që ka më shumë rëndësi, të organizohet mirë puna.

Por kërkesat për organizimin e mirë të punëve të mos çojnë në fryrjen e organikave me zyrtarë që rrinë larg prodhimit.

Shokët e rrethit të Korçës duhet t'i kushtojnë kujdes më të madh panxharit, për kultivimin e të cilit atje tashmë kanë eksperiencë. Në sajë të punës së bërë në rrethin e Korçës me panxharin ne kemi ulur një sasi të importit të sheqerit, por synimi ynë është që ta pakësojmë më shumë. Rrethi i Korçës po bën një punë të lavdërueshme edhe për ngritjen e fabrikës së re të sheqerit. Ka të meta nga ata që kooprojnë, të cilët dikasteret përkatëse duhet t'i nxitin që në sezonin e ardhshëm fabrika e re, që është më e madhe nga ajo ekzistuesja, të përfundojë me kohë. Me këtë shfaqet më së miri zotësia e kuadrove tanë që bëjnë një fabrikë të tillë me materialet, mjetet dhe me forcat tona dhe që i përgjigjet rritjes së rendimentit të panxharit. Kjo është një gjë shumë e mirë!

Me masat që Ministria e Bujqësisë do të marrë për rregullimin e farërave të panxharit do të synojmë

që të ecim drejt uljes së importit të sheqerit. Kjo do të arrihet në qoftë se do të shtoni prodhimin e panxharit dhe do t'ia plotësoni nevojat fabrikës që ajo të punojë me kapacitet të plotë.

Po ashtu pataten konsiderojeni si një gjë me rëndësi. Korça duhet të ruajë traditën e kultivimit të patates dhe të arrijë rendimente të larta në prodhimin e saj. Korça ka eksperiencë edhe në kultivimin e elbit distik, prodhimi i të cilit mendoj se duhet të rritet, pasi në të ardhmen mund të ndërtojmë edhe fabrika të tjera birre. Megjithatë, krahas kujdesit për pataten, për panxharin e për elbin distik, në Korçë nuk duhet të ulet kujdesi për prodhimin e grurit. Atje fryn era e Jugës, që e dëmton shumë grurin në kohën e pjekjes, në fazën e dyllit. Por ka atje specialistë që të studiojnë se si mund të shmanget në njëfarë mase ky rrezik? Natyrisht, era nuk shmanget dot, po a mund të parashikohen disa masa që të bëhet ajo më pak e dëmshme? Ç'thonë specialistët për këtë? A e vrasin mendjen? Vërtet marksizëm-leninizmi na mëson se ligjet e natyrës kanë karakter objektiv, se ato nuk mund të krijohen ose të zhduken nga njerëzit. Megjithëkëtë njerëzit mund t'i njohin ato, të veprojnë në praktikë në përputhje me kërkesat e tyre dhe të kufizojnë ose të zgjerojnë sferën e veprimit të tyre. Për sa kohë që është kështu, specialistët sidomos nuk duhet të rrinë duarlidhur, por të studiojnë e të synojnë masa që ta kufizojnë sferën e veprimit të dëmshëm të crës së ngrohtë që humbjet në grurë të jenë sa më të vogla.

Folëm më shumë për probleme të rrethit të Kor-

çës, por ç'do t'i themi Beratit më shumë nga ç'i thamë Korçës? Ne e njohim eksperiencën e mirë të Donofrosës, e cila duhet çuar më përpara. Por për ullirin dhe për lulediellin ne folëm edhe pardje, prandaj nuk po ndalem. I përgëzojmë shokët e Beratit. që bujqësia e këtij rrethi, në përgjithësi, ka marrë rrugë të mirë. se atje tregohet kujdes i madh. Edhe çështja e frekuentimit të shkollave bujqësore në këtë rreth po ndiqet mirë dhe prej këtej duhet të marrin shembull të tjerët.

Për sa i përket kultivimit të frutave mund të keni disa përmirësime, po në këtë drejtim nuk shkëlqeni. Ju keni blloqe të mëdha fiqsh, qershish etj. që po i shtoni, po në goftë se i lini në dorë të fatit, ato nuk do të rriten si duhet. Ju ia keni hyrë punës mirë në shumë drejtime dhe keni arritur suksese, duke u bërë shembull, po edhe për drurët frutorë duhet të bëni ato përpjekje që keni bërë edhe në drejtime të tjera.

Po kështu mund t'ju themi edhe për ullirin. Të keni parasysh që ullirit t'ia plotësoni mirë kërkesat agroteknike. Disa nga këto kërkesa janë që ta ujitni ullirin në kohën e duhur dy herë; t'i bëni krasitjet e mëdha, të mesme dhe të vogla, që druri të marrë ajër; t'i hidhni me rigorozitetin më të madh nitratin që caktohet, t'i pastrohen ferrat ullirit, të bëhen mirë vetuloret dhe të stabilizohet prodhimi. Gjithashtu të mbillen ullinj të rinj dhe të realizohet plani i mbjelljes së tyre. Mbjellja të mos lihet pas dorë. Përveç fidanishtes, brenda 5-6 vjetësh, e shumta shtatë, ullinj të rinj të japin nga 15 kilogramë prodhim për rrënjë

dhe ky prodhim të ngrihet deri në 40 kilogramë për rrënjë. Mesatarja të jetë 25 kilogramë për rrënjë. Që të merret ky prodhim duhet bërë një punë e palodhur, brigadat duhet të jenë të forta.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

FRYMËN E DISIPLINËS USHTARAKE TA FUTIM EDHE NË JETËN CIVILE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

30 mars 1979

E dini ju, shokë, që sonte fillon një stërvitje ushtarake? Që do të bëhej një stërvitje ju e dini dhe po punoni për të. Por kohën ekzakte se kur do të fillonte sigurisht nuk e dini. Ja, e mësuat tani që «dekonspirova» unë. Unë e kam fjalën se si ka qenë bashkëpunimi i shokëve të ushtrisë me komitetin e Partisë të rrethit për përgatitjen e forcave rezerviste dhe atyre vullnetare për këtë stërvitje. Si është punuar konkretisht nga kuadrot drejtues të ushtrisë me organizatën e Partisë të terrenit nga i cili do të vijnë në stërvitje gjithë ata kuadro dhe trupa? Me sa di unë në stërvitje marrin pjesë edhe Shkollat e Lira Ushtarake. Duhet

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth projektdejarave për ngritjen e aftësive ushtarako-profesionale të kuadrit rezervist. Merrnin pjesë shokë të ushtrisë dhe të komiteteve të Partisë të disa rretheve.

të jetë e qartë se kush e ka përgjegjësinë për funksionimin e këtyre shkollave.

Prandaj e theksoj që komandat e njëjësive e të re-partëve ushtarake, si dhe ato të Shkollave të Lira duhet të bashkëpunojnë shumë ngushtë me komitetin e Partisë dhe me organizatat-bazë të terrenit. Në qoftë se në kohë paqeje i lihet vetëm komitetit të Partisë të terrenit përgjegjësia për punën në Shkollën e Lirë dhe kuadrot e ushtrisë i lajnë duart, kështu nuk veprohet drejt. Kam dëgjuar të flitet nganjëherë që jo e kanë përgjegjësinë këta, jo e kanë përgjegjësinë ata. Përgjegjësinë e kanë të dyja palët.

Puna e Partisë në terren ka një veçori e një eksperiencë të sajën, të cilën ia jep qytetarit në kushtet e punës e të jetës si punëtor, si kooperativist, si kuadër etj. Dhe këtë ia jep në forma të ndryshme, nëpërmjet orientimeve e mësimëve të saj, në format e edukimit, mbledhjeve, aksioneve etj. Ndërsa kur ata shkojnë në stërvitje, në Shkollën e Lirë, Partia duhet të ndërtojë një formë tjetër pune me ta, në po ato baza dhe në po ato parime, por që t'i përshtatet disiplinës në Shkollën e Lirë dhe në repartin ushtarak, ku punëtorit e nëpunësi janë ushtarë. Këtë frymë Partia e ka në ushtri. Edhe në qendrat e punës, në kombinatin e tekstileve «Stalin», ta zëmë, u flitet dhe u kërkohet disiplinë në punë punëtorëve dhe ata i nënshtrohen në mënyrë të ndërgjegjshme. Por në ushtri kërkohet disiplinë edhe më e fortë, mendoj unë. Për realizimin e saj ndikon dhe është i nevojshëm bashkëpunimi i ngushtë midis komiteteve e organizatave të Partisë në

ushtri me ato të terrenit. Ajo edukatë që merret nga njerëzit tanë në punë dhe në jetën e përditshme për disiplinën, për gatishmërinë, për ndershmërinë, për të qenë të guximshëm, për të mos i pushtuar paniku etj., etj., të tëra këto në ushtri konkretizohen në një shkallë më të lartë dhe kërkesa e llogarisë atje është më e fortë.

Prandaj duhet punuar që kontaktet e organeve dhe të organizatave të Partisë të terrenit me ato të ushtrisë të ekzistojnë jo vetëm brenda ditëve të stërvitjes, por gjatë gjithë vitit. Këto kontakte të sekretarëve të komiteteve të Partisë të njëjsteve e reparteve ushtarake me sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve dhe me byrotë e organizatave të Partisë të ndërmarrjeve e të kooperativave të jenë sa më të shpeshta, me qëllim që këto të ndihmohen e të merren më mirë me problemet e mbrojtjes, të stërvitjes e të përgatitjes ushtarake të punonjësve të tyre. Fjala është që edhe në terren të punohet me njerëzit që jo vetëm të kuptojnë drejt ç'do të thotë gatishmëri luftarake, shpejtlësi, kompaktësi, por edhe t'i konkretizojnë këto. Kjo do të kërkojë që puna ideopolitike e Partisë në terren, agjitacioni e propaganda e saj të lidhen konkretisht me problemet e mbrojtjes e të mos mjaftohen duke thënë që jetojmë në rrethim. Ajo të shërbejë që rezervisti të kuptojë situatën në të cilën jetojmë, që ai të gjejë kohën e të vijë edhe vullnetarisht, jashtë ditëve të stërvitjes në Shkollën e Lirë të shikojë mitralozin, topin dhe mjetet e tjera luftarake, të stërvitet që të jetë në gjendje ta montojë e ta çmontojë armën me

lehtësi, me qëllim që, kur të vejë në ditët e caktuara për përgatitjen në Shkollën e Lirë, të mos harxhohet koha për të zhvilluar përsëri ato gjëra që i ka mësuar një herë, në kohën kur ka kryer shërbimin ushtarak, por të mësojë, me këtë rast, gjëra të reja, të bëjë stërvitje taktike etj.

E theksoj që sekretarët e komiteteve të Partisë të njëjsteve e reparteve ushtarake duhet të bisedojnë e të bashkërendojnë punën me sekretarët e komiteteve të Partisë të terrenit për problemet që u dalin e për një koordinim të mirë të punës së Partisë. Kjo nuk duhet bërë një herë, por vazhdimisht, me qëllim që të ndiqet në vazhdimësi përgatitja e rezervistëve në Shkollën e Lirë, ecuria e tyre në bashkëpunim me shokët e Partisë që punojnë në terren.

Siç doli këtu, në byrotë dhe në komitetet e Partisë të Shkollave të Lira ka edhe kuadro aktivë, edhe rezervistë. Është mirë që me të zgjedhurit rezervistë të punohet që më parë që të lidhen më mirë me punën e Partisë në ushtri, me qëllim që, kur të vijnë në Shkollën e Lirë, ata të futen menjëherë në punë, të mos ndiejnë vështirësi për kompaktësimin e punës së Partisë në frymë luftarake. Kjo arrihet në qoftë se rezervistët vijnë të përgatitur që nga terreni, ndryshe puna nuk do të na ecë siç duam ne dhe siç e kërkojnë kushtet e vendit tonë. Ne themi që edhe në fabrikë ose në fushë të punohet me frymë e me temp ushtarak, por jo kudo punohet në këtë mënyrë, jo kudo ekziston një disiplinë e lartë në punë. Prandaj në kontaktet me shokët e Partisë në terren të theksohet ideja

që atje të punohet për forcimin e disiplinës, pasi kur shkelet disiplina në punë edhe ekonomia dëmtohet, por edhe kur këta punonjës do të vijnë në Shkollën e Lirë, në stërvitje, edhe atje do të manifestojnë shkelje të disiplinës. Por në ushtri kjo është me pasoja të mëdha. Prandaj edukimi i njerëzve me ndjenjën e disiplinës duhet bërë që në terren.

Unë e kam fjalën këtu, që në qoftë se ushtrisë aktive i është bërë e qartë detyra luftarake që do të ketë dhe ajo është e përgatitur dhe përgatitet që ta kryejë atë sa më mirë, po me ushtrinë rezervë a punohet me të njëjtin preokupacion që edhe kjo të përgatitet seriozisht dhe intensivisht? Po organet e Partisë në ushtri e në terren a bashkëveprojnë që ky problem shumë i rëndësishëm të ecë si duhet? Po shokët e ushtrisë, për shembull, i shohin në dinamikë dhe realisht se në ç'gjendje janë forcat vullnetare? Se është fakt, shokë, nganjëherë këto forca nënvleftësohen, komitetet e Partisë të rretheve nuk vihen në korent të gjendjes e të përgatitjes së këtyre forcave. Po ashtu, a i ndjekin shokët e ushtrisë se si punojnë oficerët rezervistë me forcat vullnetare, për t'i stërvitur e për t'u dhënë mësim?

Ju, shokë të ushtrisë, duhet të kuptoni se forcat vullnetare kanë rëndësi të madhe. Në përballimin e një agresioni të mundshëm këto forca do të kenë detyrat e tyre të rëndësishme për ta goditur armikun, për ta dobësuar atë etj. Por për këtë ato duhet të jenë të stërvitura mirë. Prandaj e theksoj se bashkëpunimi i ushtrisë me terrenin duhet të jetë në një mënyrë të

tillë që të mos krijohet asnjë boshllëk për sa i përket edukimit ushtarak të popullit, pra të përfshijë edhe forcat vullnetare.

Pa lënë mënjanë detyrat e mëdha në fushën e ekonomisë, sepse kemi të bëjmë me oficerë rezervistë ose me vullnetarë të thjeshtë, që punojnë në kooperativa e në fabrika, ju shokët e ushtrisë, që keni njohuri ushtarake, duhet të mos i lini oficerët rezervistë të mjaftohen vetëm me disa ditë stërvitje në vit dhe pas-taj të lidhin duart. Jo, me çështjet ushtarake ata të merrren më seriozisht, edhe në kohën e lirë, siç thashë, me forcat vullnetare ose për kalitjen fizike të nxënës-ve të fshatit etj. Të gjithë oficerët rezervistë duhet të angazhohen vullnetarisht qoftë edhe një orë në ditë me forcat vullnetare apo me nxënësit. Me ta fare mirë mund të bëhet një vrapim, një çikë gjimnastikë, marshime të lehta, ose ngjitje për të zënë një kodër. Këto janë edhe aktivitete për të kaluar kohën e lirë, por përmbajnë edhe elemente të artit e të taktikës ushtarake. Në këtë mënyrë këta njerëz kaliten dhe edukohen me shpirtin luftarak dhe, kur ta kërkojë momenti, ata do të ndodhen në çast në pozicione dhe do të dinë ç'të bëjnë, nga duhet të lëvizin që t'u zënë rrugën forcave armike, sepse edhe stërviten dhe e kanë njohur mirë edhe terrenin.

Në këtë drejtim them që puna e komandave dhe e organeve të Partisë në njësitë dhe në repartet ushtarake të dalë nga skema e ngushtë e ushtrisë së kazer-mës, nga kuadri i atyre detyrave që janë caktuar të bëhen gjatë ditëve të stërvitjes. Të kuptohemi, të tëra

këto duhet të bëhen, por fjalën e kam që të bëhet një punë më e zhdërvjellët, më e organizuar bashkë me shokët e Partisë në terren, me qëllim që të zgjerohet horizonti dhe këndi i punës që bëhet për të stërvitur gjithë këtë mori njerëzish. Partia në terren, sigurisht, do të ndihmojë dhe do të krijojë mundësi që kooperativistët, punëtorët, nxënësit ta kuptojnë drejt kërkesën që, kur është fjala për mbrojtjen e atdheut, për stërvitjen edhe mund të sakrifikojnë një gjysmë ore pas pune. Kjo arrihet me një bashkëpunim dhe bashkërendim të mirë të punëve të ushtrisë me terrenin. Po të realizohet mirë kjo, do të thotë që ushtrinë tonë, ushtrinë e madhe të popullit, ta kemi të stërvitur mirë e të kalitur. Këto gjëra nuk gjenden në ato skemat e caktuara, por kur vritet mendja, kur preokupohemi seriozisht për mbrojtjen, atëherë bëhet punë krijuese. Një punë e tillë e gjallë, e larmishme dhe e vazhdueshme me forcat vullnetare është shumë frytdhënëse. Rezultati i saj do të jetë që kur t'u themi që do të bëhet stërvitja, të gjithë do të vijnë menjëherë dhe me dëshirë në stërvitje.

Rëndësi ka që në periudhën që stërviten në Shkollën e Lirë, qoftë nga ushtarët, qoftë nga oficerët kërkohet impenjim dhe disiplinë në stërvitje. Por këto sigurohen kur shokët e ushtrisë nuk presin vetëm ditët e stërvitjes, por që më parë shkojnë në qendrat e punës, në kooperativa, ku marrin kontakt me sekretarin e Partisë ose me drejtuesit dhe bisedojnë shtruar me ta qoftë për pjesëmarrjen në stërvitje, qoftë për ba-

zën materiale të stërvitjes, për probleme të kuadrit etj. Kjo do të ndihmojë që kur të fillojë stërvitja të mos harxhohet koha për të siguruar pjesëmarrjen e për probleme të tjera, por për stërvitje. Kur ushtarakët shohin se punëtorët apo kooperativistët punojnë mirë, janë të disiplinuar, zbatojnë mirë detyrat në prodhim etj., atëherë edhe në stërvitje ata do të manifestojnë disiplinë të fortë ushtarake dhe anasjelltas. Kështu, pra, së bashku, kuadrot e ushtrisë dhe të terrenit do të bëjnë që të eliminohen të metat e dobësitë e tjera dhe do të synojnë mbarëvajtjen në stërvitje. Ose e kundërta. Kur në stërvitje, në Shkollën e Lirë, ata tregohen të vëmendshëm, të disiplinuar dhe shembullorë, sepse e vlerësojnë detyrën e mbrojtjes së atdheut, u kërkohet atyre që po kështu të jenë edhe në fabrikë, edhe në kooperativë dhe u shpjegohet se, po të mos realizohet plani i prodhimit, po të krijohen deficite në prodhimin e drithërave, në prodhimin e veshmbathjeve etj. atëherë është dobësuar edhe mbrojtja e atdheut, sepse neve na duhen këto jo vetëm për kohë paqeje, por edhe për të krijuar rezerva për kohë lufte. Një punë e tillë politike e përbashkët e Partisë në terren dhe në ushtri, do të ndikojë në shëndoshjen e gjendjes.

Pra çështjen e Ushtrisë Popullore ta kuptojmë në tërë gjerësinë e saj, të mos shohim vetëm ushtrinë e rregullt, por frymën e disiplinës ushtarake ta futim gjerësisht edhe në jetën civile, në prapavija. Kjo do të bëhet duke gjetur mënyra e forma të ndryshme të për-

gatitjes ushtarake të të gjithë popullit. Kjo kërkon që edhe organet drejtuese të Partisë në terren të merren më mirë me problemet e mbrojtjes. Ato duhet të njohin kuadrot, të dinë sa forca janë, sa komunistë janë në strukturat e mbrojtjes dhe si janë shpërndarë, si janë të organizuara forcat për stërvitje, që këto të bëhen sa më efektive dhe të japin fryte të mira. Në qoftë se nuk ka një interesim të tillë, atëherë nuk do të arrihen rezultatet që kërkohen.

Të mbahet mirë parasysh se nuk do të jemi më në luftën partizane. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare edhe kishim kohë të bënim manovrime. Po sot? Sot kërkohet një organizim i përsosur. Prandaj që në kohë paqeje gjërat duhen parashikuar deri në detaje dhe të bëjmë një organizim e përgatitje të gjithanshme, me qëllim që në kohë rreziku njerëzit të jenë në këmbë e sa më mirë të përgatitur. T'i përgatitim qysh tani, në kohë paqeje, se lufta nuk fitohet me fjalë, por ajo kërkon trimëri, guxim, njohuri ushtarake, prandaj njerëzve t'ua bëjmë të qarta detyrat e artit ushtarak, të krijojmë tek ata besim e optimizëm që, po t'i kryejmë si duhet që tani këto apo ato detyra luftarake, ne do të jemi të fortë e do të mposhtim çdo armik.

Këto gjëra duhet t'i bëjmë edhe në shkollat e mesme, në shkollën e lartë, në stërvitjet e forcave vullnetare dhe gjatë shërbimit aktiv ushtarak, në mënyrë që në Shkollën e Lirë Ushtarake dhe në stërvitjet e strukturave të tjera të ketë programe të një niveli të lartë taktiko-strategjik e jo t'u mësohet në to rezer-

vistëve si mbërthehet dhe si zbërthehet mitralozi. Presupozohet që këtë ai që vjen në Shkollën e Lirë e ka mësuar me kohë, jo vetëm në ushtri, por edhe në shkollë. Pra, në qoftë se këto gjëra në Shkollën e Lirë përsëriten çdo vit, atëherë stërvitjet këtu do të bëhen të mërzitshme, se kur një njeri mëson një gjë dy vjet të tëra dhe pastaj shkon ua përsërit të njëjtën gjë çdo vit, me siguri që interesi për të humbet. Njerëzit tanë sot janë me shkollë dhe kanë nevojë për dijeni më të gjera ushtarake, për stërvitje taktike e lojëra ushtarake. Pra në ditët e stërvitjes ata duan diçka të koncentruar, një gjë më të lartë. Këtë fakt, më duket mua, oficerët tanë nuk e vlerësojnë si duhet. Mundet që edhe programet janë shabllonc, sepse mendohet sikur këta që vijnë në këto shkolla kanë vetëm disa njohuri elementare. Në të vërtetë nuk është kështu. Një njeri që ka mbaruar ushtrinë është njëlloj me atë që bëhet oficer rezervë nga universiteti, sepse ai i universitetit ka bërë gjatë gjithë periudhës së shkollës vetëm 5 muaj stërvitje, kurse ky ka bërë dy ose tre vjet ushtri.

Prandaj të tillë njerëz nuk duhet t'i konsiderojmë thjesht si ushtarë. Fare lehtë një nga këta mund të komandojë një togë e të drejtojë stërvitje, në qoftë se atij i japim ca njohuri më shumë, një kulturë ushtarake me një nivel më të lartë. Me sa di unë, ditët e stërvitjes i keni ndarë në ditë për mësimë teorike dhe në ditët e tjera për stërvitje praktike. Unë nuk i kam hyrë në hollësi programit të Shkollës së Lirë. Mundet

që ky të jetë i drejtë, por kjo nuk do të thotë që ai të mos ndryshojë. Për shembull, kur e njeh mirë ushtrinë, kur i njeh mirë dobësitë e ushtarëve, kur sheh se në Shkollën e Lirë shumë gjëra rezervistët i dinë, atëherë duhet menduar për ta ndryshuar programin e stërvitjes, me qëllim që të mos ketë përsëritje. Instruktorit që jep mësim në Shkollën e Lirë duhet t'i punojë një çikë koka, mund që të mos e ndajë me thikë programin: 5 ditë teori e 5 ditë stërvitje, por mund t'i propozojë komandës që, në përputhje me nivelin e rezervistëve, ato ditë të bëjë me ta, ta zëmë, vetëm stërvitje taktike, lëvizje, lojëra, pa qenë nevoja që të bëjë teorinë e pushkës e diçka tjetër. Një herë tjetër thotë se duhet medocemos të bëjë stërvitje për mbrojtjen kundër lëndëve helmuese. Koha e stërvitjes është e shkurtër dhe, në qoftë se këtë kohë programin e copëtojmë fije-fije, duke menduar t'u japim rezervistëve nga një çikë nga çdo gjë, në fakt nuk u kemi dhënë gjë, se shumë gjëra nga këto ata i kanë mësuar edhe në stërvitjet e mëparshme.

Më duket se këto janë probleme që duhen menduar më thellë. Praktika do t'ju tregojë se në ç'drejtime, fjala vjen, duhet përmirësuar kjo punë. Mendimet, propozimet e vërejtjet për programet, për stërvitjen e forcave vullnetare etj., etj. duhet t'u bëhen të njohura Partisë dhe Komandës së Mbrojtjes që të rishikohen këto gjëra. Oficerët tanë duhet të bëhen më të zhdërvjellët; të luftohen plogështia dhe indiferentizmi tek ata, të luftohet mendimi «e kam bërë

kursin, gati është çdo gjë, vetëm tani pres sa të më vijnë rezervistët».

Të kemi parasysh, gjithashtu, që rezervistët që vijnë në Shkollat e Lira, kanë mbaruar ushtrinë dikush në marinë, dikush në artileri, dikush në këmbësori etj. Pra, këta janë si punëtorë të kualifikuar, të cilëve u bëjmë një kurs, u kërkojmë të atestohen që të marrin kategori më të lartë apo të bëhen teknikë të mesëm. Kështu është puna edhe me rezervistët, me të cilët duhet punuar që të mësohen e të kualifikohen për t'u bërë oficerë të ardhshëm të ushtrisë sonë. Natyrisht, jo të tërë do ta komandojnë ushtrinë, shumica nga këta do të jenë ushtarë, por ama ushtarë të kualifikuar.

A është arritur në këtë shkallë që në Shkollat e Lira ushtarin ta kemi kështu? Nëse po, s'ka dhe s'mund të bëhet më mirë. Prandaj në Shkollat e Lira Ushtarake të bëhet një punë e tillë që rezervistët të përgatiten mirë si specialistë për detyrën që ka secili. Disa prej tyre, sigurisht, i nënshtrohen edhe një kursi të veçantë që të bëhen oficerë rezervistë. Këtë e kemi vendosur dhe po e bëjmë. Në këtë kurs këta perfeksionohen dhe aftësohen si kuadro të kualifikuar, prandaj fare mirë mund të komandojnë. Po të tjerët? Ata mbeten ushtarë, por ushtarë të përgatitur.

Këtyre, shokë, t'u vëmë një rëndësi të madhe. Ata nuk janë ushtarë të thjeshtë, prandaj në ditët e stërvitjes atyre t'u bëhet mësim dhe edukim si për oficerë, në bazë të një programi me kërkesa e nivel më të lartë, me qëllim që ata të jenë në gjendje të

mësojnë forcat vullnetare, të merren me to, duke i mbajtur kështu gjallë njohuritë që kanë marrë në fushën ushtarake.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

SUKSESI NË STËRVITJE VARET NGA ORGANIZIMI I MIRË DHE NGA ZHVILLIMI SI DUIET I TYRE

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH¹*

3 prill 1979

Nga raportimet gjykoj se stërvitja «Kështjella» në përgjithësi doli mirë, megjithatë jo të gjithë komunistët dhe oficerët e kanë të qartë në shkallën e duhur konceptin e vërtetë të luftës moderne.

Të gjithë në vendin tonë, ushtri dhe popull e në radhë të parë Partia, ta kenë të qartë që nëse sulmohemi lufta nga ne do të bëhet në territorin e vendit tonë. Përfytyrimi i saj jashtë territorit konkret të vendit tonë nuk do të ishte real. Nga të gjithë njerëzit tanë, nga forcat tona të armatosura, nga udhëheqja e Partisë kërkohet të kenë një koncept të drejtë për zbatimin e Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore brenda kufijve të Shqipërisë. Të kesh një koncept të

1. Në këtë takim shoku Hysni Kapo informoi për zhvillimin dhe rezultatet e stërvitjes «Kështjella».

luftës, që mund të na imponohet, jashtë realitetit të vendit tonë, është krejtësisht e gabuar.

Për shembull, koncepti i lëvizjes e i manovrave të mëdha të ushtrisë sonë në territorin shqiptar, nuk është aspak i drejtë, për arsye se vendi ynë është i vogël, i ngushtë dhe aspak i përshtatshëm për manovrimet të mëdha klasike. Edhe popullsia jonë, dhe kur flas për popullsinë kam parasysh edhe ushtrinë, është gjithashtu e vogël, në krahasim me cilindo armik apo grup armiqsh eventualë, që do të na sulmojnë. Prandaj Arti ynë Ushtarak i Luftës Popullore është ndërtuar në një mënyrë të atillë që forcat tona kështu sa janë, por të stërvitura si duhet (gjë që ka një rëndësi të madhe për ne) dhe të planifikuara si duhet, mund të rezistojnë dhe ta mundin çdo armik që do të na sulmojë.

Po nuk u udhëhoqëm nga ky parim, do të gabojmë. Një kjo.

E dyta. Në konceptimin e luftës duhet të kemi parasysh edhe armikun. E kam thënë edhe herë tjetër se armiku nuk mund të futë në Shqipëri më tepër forca nga sa mund të mbajë vendi ynë, ndryshe ai humbet, shkatërrohet ose të paktën do të dëmtohet rëndë. Prandaj, cilindo armik që të jetë, nuk do t'i futë menjëherë të gjitha forcat e tij në luftë. Ai do të përpiqet të na i shkatërrojë forcat javash-javash. Pra, kjo do të jetë një taktikë që do të ndjekë armiku kundër nesh, duke shfrytëzuar faktorin kohë, domethënë ai do të përpiqet ta zgjatë sa më shumë luftën. Por, zgjatja e luftës kundër nesh varet nga strategjia globale e ci-

litdo prej armiqve të mundshëm. Sidoqoftë, më tepër sesa mund të mbajë ushtri vendi ynë armiku nuk mund të futë.

Prandaj në mënyrë të përafërt ne kemi mundësi ta parashikojmë numrin e forcave të armikut që mund të na sulmojnë, qoftë nga një anë, qoftë nga ana tjetër, ashtu edhe nga të gjitha anët njohëresh. Por edhe nga të tëra anët, po të sulmohemi, futja e numrit të forcave ushtarake armike do të jetë e kufizuar, pasi kjo është si puna e një filxhani që e ka të përcaktuar se sa kafe mund të nxërë, se, po i fute më tepër, ai nuk mban, kafeja do të derdhet. Ne, nga ana jonë, armikut do t'i rezistojmë, pavarësisht se me sa forca do të sulmojë, dhe do të luftojmë me të gjitha forcat kundër tij brenda territorit tonë derisa ta shporrim. E kisha fjalën, pra, se lufta nuk bëhet me «hajde oburra» dhe fut e fut forca pa kufi. Se del problemi: ku do të futen gjithë këta njerëz? Duhet të zaptosh terren që t'i vendosësh forcat dhe pastaj ato duhet edhe t'i mbash, t'i kesh në dorë për shumë kohë.

Parashikimet tona për këto gjëra të jenë kurdoherë sa më reale. Edhe në qoftë se lihet ndonjë rezervë, kjo të mos jetë e madhe. Megjithatë, për çdo rast neve na duhet ta stërvitim mirë ushtrinë dhe të mos lejojmë që tek oficerët dhe tek ushtarët tanë të ketë pikëpamje të tilla si të disave, sipas të cilëve «ne s'na thyen dot njeri», «që me predhën e parë ne e asgjësojmë armikun, të cilit, për të na goditur, i duhen njëqind predha». Të tilla pikëpamje, pra, janë shumë të rrezikshme dhe duhen zhdukur.

I theksoj këto se në relacionin që na u dha për stërvitjen pashë që desanti ajror armik ishte parashikuar me 80 apo me 100 mijë veta, prandaj i thashë Mehmetit: «Si është e mundur të hidhen te ne nga ajri përnjëherë 80 mijë njerëz? Kjo është një shifër e ekzagjeruar». «Jo, — m'u përgjigj ai, — nuk janë parashikuar tetë divizione, po dy». Unë e kundërshtova, se në fakt në relacion ishte shkruar për tetë divizione armike.

SHOKU HYSNI KAPO: Ashtu është, shoku Enver, janë parashikuar tetë divizione plus tre të tjera, që janë parashikuar të hidhen të shpërndara në grupe të vogla në brendësi të vendit, dhe kështu gjithsej bëhen 11 divizione.

SHOKU ENVER HOXHA: Tri divizionet e shpërndara unë nuk i dija fare, por edhe pa këto prapë mendoj se të hidhen njëherësh tetë divizione janë shumë. Dhe thuhet më tutje se gjithë këtë numër prej 80 mijë ushtarësh armiq ne e paskemi vrarë, plagosur dhe zënë rob. Këto forca desantësh në këtë masë janë parashikuar kaq shumë, sa nuk janë pasur parasysh forcat e tjera armike që do të na sulmojnë nga toka apo nga deti. Ky ishte esheloni i parë, po do të vijë pastaj esheloni i dytë.

Për këto arsye i thashë Mehmetit se këto parashikime i kanë bërë gabim në Shtabin e Përgjithshëm, se po të vijnë 80 mijë ose 100 mijë veta me avionë dhe me helikopterë plus pastaj mjetet e tjera luftarake e pajisjet që do t'i shoqërojnë ato, si topat e artilerisë etj., pa i bëni një çikë hesap? Për gjithë këta njerëz

e mjete kaq të shumta do të duhen 5 mijë avionë. Mirëpo përveç këtyre, sipas mendimit tim, duhet të ketë medoemos edhe avionë të tjerë luftarakë shoqërues për t'i ruajtur. Përveç të gjitha këtyre mjeteve të shumta që do të vijnë për këtë qëllim, duhet të kemi parasysh edhe bombardierët që do të jenë dërguar në përpara për bombardim për të përpunuar e pastruar terrenin sipas konceptit të armiqve. Vënia në përdorim e një force ajrore kaq të madhe kundër vendit tonë malor dhe shumë të fortifikuar, duke marrë parasysh luftën e madhe strategjike që synon të bëjë armiku nuk është e mundur të praktikohet. Pastaj, ku do të vendosen gjithë këta avionë, gjithë këta njerëz e kjo teknikë, kjo forcë e madhe mjeteshe, mitralozash edhe artilerie? Ky, më duket mua, është një parashikim joreal dhe shumë i ekzagjeruar. Prandaj, duke qenë i tillë parashikimi, edhe shifrat e armiqve të vrarë, të plagosur dhe të zënë robër, nuk janë llogaritur drejt, se janë 100 mijë njerëz këta.

Sipas pikëpamjes së Mehmetit, këto parashikime janë bërë në këto përmasa, me qëllim që stërvitja të bëhej sa më e rëndë, duke menduar forcat maksimale që mund të dërgojë armiku kundër nesh. Mirëpo parashikimi i maksimales ka edhe të mirën, po ka edhe dobësitë e të këqijat e veta. Në kartë duket e lehtë çështja, por në realitet është shumë e rëndë, bile jash-tëzakonisht e rëndë. Po të sulmojnë vendin tonë vetëm 11 divizione aerodesantësh me 100 e ca mijë veta, mërrë me mend se ç'do të bëhet pastaj nëpërmjet kufijve tokësorë a detarë, andej do t'u dërgokan armata

të tëra, të cilat, sipas konceptit në këtë stërvitje, nuk do të presin, por do të sulmojnë përnjëherë vendin tonë. Por unë mendoj se armiku nuk i hedh kështu kot në veprim forcat e veta të gjalla që t'i asgjësohen aq kollaj. Ai i hedh ato nga ajri si një element luftarak të gjallë përgatitor që të gozhdojë forcat tona për të hapur më me lehtësi frontin tokësor, për të çarë kufirin tonë në pikat e frontit që ai ka caktuar të sulmojë.

Unë mendoj se duhen parë me shumë kujdes konceptet e kuadrove të drejtorisë përkatëse të Ministrisë sonë të Mbrojtjes Popullore, të cilët në këto çështje më duket se nuk kanë koncepte të drejta. Sipas këtyre koncepteve ne do të luftojmë që në çastin më të parë të luftës me forcat maksimale të armikut. Armikun ne nuk e mbivlerësojmë, po as nuk duhet ta nënvleftësojmë në asnjë mënyrë. Këtë duhet ta kemi të qartë dhe të gjykojmë çdo gjë me logjikë.

Kam mendimin se në fillim armiku do të na godasë më shumë me mjete dhe me pak njerëz. Bombardimet nga ana e tij kundër territorit tonë qoftë nga ajri, qoftë nga toka, apo nga deti do të jenë të mëdha dhe me një intensitet të tillë që të mos na lërë të ngremë dot krye. Me këtë veprim, në varësi edhe të kohës që ka, ai synon të na dobësojë, njëkohësisht edhe të na demoralizojë. Në qoftë se në luftën që nis ai do të hyjnë edhe të tjerë faktorë, atëherë ai do të përpiqet të pushtojë terren. Për këtë qëllim ai do të hedhë në sulm më shumë forca të gjalla, pse, është e qartë që, pa hedhur ushtri, nuk mund të zërë vend në territorin tonë. Por me këtë që bën ai, të mos kujtojmë sikur armiku do të

hedhë në territorin tonë që në fillim armata të tëra. Kjo është ajo që mendoj unë se do të bëjë armiku në rast agresioni kundër nesh.

Ne, nga ana jonë, për ta përballuar sulmin armik, kemi disa avantazhe, se jemi në territorin tonë. Por unë dua të theksoj avantazhin e stërvitjeve e të parapërgatitjeve që bëjmë vazhdimisht. Por që të jenë më efektive ato duhet absolutisht të bëhen me seriozitetin më të madh. Megjithatë planet tona operative duhet të jenë një nga pikat kryesore më nevrologjike të veprimtarisë sonë, prandaj përgatitja e tyre duhet të bëhet me kujdesin më të madh.

Në qoftë se këto gjëra, që përbëjnë avantazhe të mëdha për ne, nuk na ecin si duhet në bazë të Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore, atëherë nuk mund të arrijmë sukseset që parashikojmë të kemi në rast lufte. Cilat janë këto avantazhe për ne?

Së pari, sistemi i organizimit të ushtrisë sonë. Ky sistem është i tillë, që jep mundësi që brenda një kohe të caktuar forcat tona të jenë kompaktësuar dhe të kenë zënë me shpejtësi të gjitha pozicionet luftarake. Këtë shpejtësi nuk mund ta ketë armiku në sulmin që do të bëjë kundër vendit tonë. Kjo detyrë, për të cilën forcat tona përgatiten e aftësohen qysh tani në kohë paqesje, lidhet me konceptet e drejta që duhet të kenë për luftën shtabet dhe oficerët tanë, siç e thashë më përpara.

Së dyti, shtabet dhe oficerët tanë njohin dhe duhet ta njohin pëllëmbë për pëllëmbë terrenin tonë dhe pozicionet që do të zënë në kohën e luftës. Këtë e kë-

mi thënë dhe herë të tjera. Ata duhet të dinë të le-
xojnë në hartë, por edhe të përcaktojnë në terren me
shpejtësi të madhe dhe me një saktësi të madhe çdo
gjë, çdo objekt deri te më të voglat. Ndërsa kuadrot ofi-
cerë të armikut njohjen e terrenit tonë e bëjnë vetëm
nëpërmjet hartës, pra ata nuk e njohin si ne territo-
rin tonë, se nuk kanë bërë plastikën e Shqipërisë, nuk
e kanë shkelur me këmbë, prandaj nuk mund të dinë
çdo qoshe, çdo gërxh, çdo shtëpi, çdo mulli, çdo kishë
e xhami, çdo pemë e vijë uji, siç i dinë e i njohin ofi-
cerët tanë.

Megjithatë, pa rënë në eufori, duhet t'i kushtoj-
më rëndësi shumë të madhe çështjes që oficerët tanë
të stërviten e të përgatiten intensivisht që të zotë-
rojnë mirë jo vetëm hartat, por sidomos që ta njohin
pëllëmbë për pëllëmbë terrenin. Këtë ta kërkojmë ta
bëjnë jo vetëm oficerët. Meqenëse ne e kemi tërë
popullin ushtar dhe këtë ushtri do ta grumbullojmë
në baza rajonizimi, stërvitjen për njohjen me hollësi
të terrenit ta bëjnë mirë edhe ushtarët, rezervistët,
forcat vullnetare, gjithë populli ynë. Ai që është, ta
zëmë, nga Gjirokastra, e njuh mirë vendin rreth e rro-
tull. E njuh shumë mirë zagoriti truallin e krahinës së
vet, njuh kaçubet, gërxhet, rrugët e monopatet; vijë
për vijë, ku kalon automobili e ku nuk kalon; ai di ku
mbrohet më mirë dhe ku të sulmohet etj. Me një fjalë,
terrenin duhet ta dijë mirë jo vetëm oficeri, po edhe
ushtari. Dhe kjo është plotësisht e realizueshme, sepse
njerëzit tanë edhe pa e ditur mirë hartën, terrenin
ku punojnë e jetojnë e njohin cep më cep, bile njohin

më shumë gjëra sesa përmban harta. Ndërsa oficeri përveç terrenit duhet të njohë mirë edhe hartën, sepse do të bëjë planet, do të drejtojë.

Pra ushtria jonë do të luftojë në vendin e vet. Edhe ky është një avantazh i madh për ne. Këtë avantazh jashtëzakonisht të madh nuk e ka armiku. Ai ka mjetet, ka bombardimet që do të bëjë, po edhe kundër këtyre mjeteve ne kemi marrë me kohë masa dhe duhet akoma të vazhdojmë të marrim të tjera, në mënyrë që, kur të bien bombat, të na vrasin sa më pak njerëz. Për këtë do të na shërbejnë fortifikimet e strehimet që kemi bërë e do të vazhdojmë të bëjmë; kemi malet, pyjet, kaçubet, përrenjtë. Ne të përfytyrojmë e të mendojmë që tash se ku mund të bombardojë armiku. Se ai nuk do të bombardojë kot, duke i hedhur bombat ku të mundë, po atje ku e merr me mend se do të ketë rezistencë nga ana jonë, atje ku e di që ka popullsi, për të thyer edhe për të demoralizuar njerëzit tanë. Armiku nuk mund të bombardojë kot alpet ose malin e Tomorit. Jo, ai mund t'u bjerë, fjala vjen, tre kokojkave diku, sepse e di që ato janë pika të forta strategjike dhe ku mendon se duhet të jenë grumbulluar forcat tona, që do ta pengojnë atë në realizimin e planeve të tij etj., etj.

Çështja është që kuadrot tanë drejtues t'i dinë me kohë këto probleme dhe bile t'i dinë mirë, që t'ua mësojnë si duhet edhe vartësve. Prandaj ka rëndësi shumë të madhe çështja që t'i bëjmë mirë stërvitjet. Në qoftë se kuadrot e Ministrisë së Mbrojtjes nuk i kontrollojnë si duhet stërvitjet; dhe, në fakt, kjo punë

nga ana e tyre prapë ka çaluar edhe në stërvitjen e fundit, këtë çështje të mos e marrim lehtë. Ky është një minus i madh që duhet ta vlerësojmë fort. Kur ka mosvlerësim në shkallën e duhur të stërvitjes, do të thotë që kuadrot, oficerët dhe ushtarët tanë e shikojnë këtë çështje me mendjemadhësi, duke u nisur nga pikëpamja shumë e gabuar se «ne jemi në gjendje t'u bëjmë ballë me lehtësi armiqve» edhe në rast se stërvitjet nuk bëhen me rigorozitetin më të madh. Prandaj drejtoria përkatëse e Ministrisë së Mbrojtjes është e domosdoshme të ketë njerëz të zotë, të zgjuar, të mësuar dhe dinamikë, që të shikojnë dhe të kontrollojnë me pasion stërvitjen e gjithë ushtrisë. Po kështu, edhe kuadrot aktivë e rezervistë të njësisve, reparteve dhe deri të nënreparteve të ushtrisë sonë, kudo, të jenë të përgatitur sa më mirë dhe në mënyrë të tillë që në çdo rast të jenë të shpejtë në gjykime e në vendime, të njohin vendin, terrenin, fortifikatat, kufijtë që i caktohen repartit apo njësisë së tyre, të njohin kë kanë anash, të dinë të lidhen mirë e me shpejtësi me njëritjetrin etj., etj. Puna për të organizuar me sa më efektivitet mbrojtjen dhe për të qenë në gjendje për ta kundërsulmuar armikun, të bëhet qysh tani në lartësinë që kërkohet, sepse kjo ka rëndësi shumë të madhe, prandaj të gjithë duhet të punojmë shumë në këtë drejtim.

Rëndësi ka që kuadrot t'i dinë jo vetëm teorikisht këto çështje, jo vetëm të kenë njohuri të thella, po të bëjnë mirë edhe stërvitje taktiko-operative që të jenë në gjendje t'i vënë në zbatim në praktikë ato që

dinë. Gjithashtu këto t'ua mësojnë mirë edhe ushtarëve në mënyrë që, kur të jepet urdhri, kur të krijohen situatat e vështira e të rrezikshme për vendin tonë, ushtari që stërvitim sot, i cili pasi të mbarojë ushtrinë do të bëhet rezervist, të ngrihet në rangun e oficerit dhe të jetë në gjendje të komandojë një skuadër a nën-repart. Pra, gjithë ushtarët e ushtrisë sonë rezerviste, që kanë bërë dy ose tre vjet shërbim ushtarak dhe që stërviten edhe pas shërbimit ushtarak çdo vit, në mendjen tonë duhet të jenë oficerë, t'i përgatitim në mënyrë të tillë që të jenë në gjendje të dinë mirë pozicionin që do të zënë dhe detyrat që do të kryejnë, të jenë të aftë të flasin për pozitat dhe për synimet e forcave të armikut etj. sikur të jenë oficerë.

Një ushtar apo oficer i tillë, i stërvitur e i përgatitur mirë që tani në kohë paqeje, do të jetë përnjëherë në gjendje të bëjë konkluzionet e situatës dhe të veprojë drejt kur i jepen detyrat që do të kryejnë në rast lufte. Ai do të jetë në gjendje të vlerësojë drejt e në kohë pozitat që ka zënë kjo ose ajo togë dhe në përputhje me situatën konkrete do të dijë të komandojë e të japë urdhër që ushtarët të qëndrojnë fort, të luftojnë e të mos lëvizin nga pozicionet, se pas pak do t'u dërgojë ndihma. Ai do të dijë se ku dhe si do t'i përdorë forcat, ku të dërgojë përforcime e ku të mbajë forca rezervë, kur të sulmojë e kur të bëjë krahmarrje etj.

Që t'i realizojë këto me sukses, oficeri ynë, siç thashë, duhet ta njohë mirë terrenin që i është ngarkuar ta mbrojë. Vetëm kështu ai është në gjendje të

zotërojë e t'ia japë të qartë komandës më të lartë situatën, duke i thënë se në ç'gjendje është ky ose ai pozicion, vështirësitë që paraqiten, raporton se kjo kodër djathtas apo majtas nuk mund të mbahet dot vetëm me forcat e tij dhe propozon të merren këto apo ato masa që ajo të mbahet etj. Është një art i tërë ky. Në bazë të analizës dhe paraqitjes së situatës, komanda, nga e cila varet ai, vepron për t'i ardhur në ndihmë, për të goditur me artileri në atë sektor ku kjo është e domosdoshme etj.

Kështu, kur kuadrot janë të përgatitur mirë, janë në gjendje të informojnë shtabet dhe komandat e prorë në të gjitha nivelet për gjendjen e përgjithshme të forcave e kështu pastaj në shkallë vendi. Pra e kam fjalën që njohja, analiza dhe raportimi për situatat realizohet kur kuadrot i kanë mësuar mirë këto çështje qysh tani në kohë paqeje jo vetëm në letër, po edhe gjatë stërvitjeve në terrenin konkret. E theksoj këtë, sepse edhe gjatë kësaj stërvitjeje, siç më thanë, një batalioni në afërsi të Shëngjonit në Elbasan i ishte dhënë urdhër të kapërcente Shkumbinin, kur ky kishte shumë ujë. Ky urdhër ishte dhënë që këto forca «të asgjësonin» një numër «desantësh armiq që ishin hedhur» në atë zonë. Mirëpo nuk ishte llogaritur nëse mund të kalohej lumi aty dhe se si mund të ecëj në gjithë atë distancë të madhe brenda tri orëve me forca të mëdha në kohë lufte dhe sidomos ditën, të ekspozuar përpara avionëve të armikut. Më duket se llogaria e bërë nuk është reale. Mund të marshohej ditën, po forcave do t'u duhej kohë më shumë, sepse

do të kalonin në rrugë pa rrugë, nëpër gërxhe e ferrra, të maskuar dhe kurdoherë duke ruajtur kompaktësinë në situata shumë të rrezikshme etj.

Në stërvitje çdo lëvizje trupash duhet të parashikohet sa më realisht, qoftë drejtimi, qoftë koha e lëvizjes. Me këtë që them dëshiroj të vij te pikëpamja që thashë më parë, që vendi ynë nuk është i atillë që mund të bësh lëvizje forcash të mëdha, lëvizje të gjata. Në letër mund të parashikosh gjithfarë lëvizjesh, por në terren do të bësh ato lëvizje që janë të domosdoshme të bëhen, duke pasur kurdoherë parasysh si terrenin tonë, ashtu edhe forcën e zjarrit të armikut. Qëllimi është që t'i ruajmë forcat tona nga goditja e zjarrit të armikut, ta dobësojmë ne atë dhe jo të na dobësojë ai, të vrasim ne sa më shumë armiq dhe të kemi sa më pak humbje, sepse jemi në truallin tonë.

Me këtë dëshiroj edhe një herë të theksoj çështjen që ushtrinë duhet ta stërvitim sa më mirë. Stërvitja, nga pikëpamja operative, strategjike dhe taktike, duhet të bëhet në mënyrë sa më konkrete, e organizuar mirë, në mënyrë sa më rigorozë dhe në bazë të Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore e të terrenit tonë. Nuk duhet të bëjmë fantazira jashtë terrenit tonë, jashtë mundësive tona në forca njerëzore, të armëve, të mjeteve dhe të prapavijës.

Ne shpesh themi që shqiptari është i fortë, qëndron. Kështu është, ai është trim dhe qëndron edhe përballë një armiku shumë të fuqishëm. Megjithatë stërvitje duhen bërë vazhdimisht. Por në disa stërvitje kuadrot tanë kanë vepruar edhe me përqendrim

të mëdha forcash. Mirëpo duhet pasur parasysh se ku dhe si do t'i përqendrosh gjithë këto forca, si do të vihen në lëvizje ato. Pastaj, duhet të kemi parasysh atë që thashë më lart se vendi ynë është i vogël, me terren të thyer e të vështirë, se armiqtë do të na sulmojnë nga të katër anët, prandaj forcat tona duhet t'i kemi të shpërndara mirë dhe me kujdes. Këto veprime duhen bërë siç bën një nikoqire e mirë, që, me pak sende ushqimore, natyrisht me ca shtrëngesa, llogarit të ushqejë kalamanët e saj për një kohë sa më të gjatë. Ashtu edhe ne, me këto mjete, forca e ushqime që kemi në dispozicion, të llogaritim që të përballojmë luftën e gjatë që mund të na imponohet. Jo vetëm të përgatitemi që të veprojmë ashtu siç themi shpeshherë që ta goditim objektivin me predhën e parë, por sidomos të llogaritim mirë forcat e gjalla dhe t'i ruajmë fort ato. Ne dëshirojmë të kemi sa më pak të vrarë dhe të asgjësojmë sa më shumë armiq, por ama, në qoftë se do të rrimë zbuluar, në qoftë se do të bëjmë lëvizje ditën dhe të gjata, siç thuhet, me siguri që të vrarë do të kemi shumë. Çështja është që oficerët e ushtarët tanë të përgatiten sa më mirë që nga ana jonë të ketë sa më pak të vrarë. Prandaj kuadrot duhet të jenë më të aftë, të shkathët, të zotë, energjikë, njerëz që të kuptojnë strategjinë, taktikën, të njohin mirë terrenin, të mundin t'i japin mirë në dorë situatën Shtabit të Përgjithshëm, i cili ta zbërthejë më tutje atë dhe këtej t'u dërgohen urdhrat njërive e reparteve të ushtrisë. Këto, në bazë të kushteve e situatave konkrete, do ta zbërthejnë urdhrin dhe do ta vënë atë

në zbatim në mënyrë krijuese. Për këto çështje është e domosdoshme që drejtoritë e Ministrisë së Mbrojtjes, që në rast lufte do të jenë nën varësinë e Shtabit të Përgjithshëm, të mbajnë në lidhje të vazhdueshme të gjitha njësitë e repartet e ushtrisë sonë.

Këto çështje nevrologjike të ushtrisë duhet të përpunohen e të përgatiten në një nivel të lartë që të kemi ato suksese që synojmë të korrим. Prandaj të punojmë e të përgatitim që në ushtri të vijmë në drejtim njerëz të zotë, të rinj, të shkathët, oficerë të mësuar që kanë mbaruar shkollat ushtarake, por jo nga ata elementë që «fluturojnë». Ne duhet të përgatitim oficerë që të jenë të lidhur ngushtë me masën e kuadrove vartës dhe me ushtarët, të lidhur mirë me terrenin, të cilin ta njohin më së miri, ta njohin mirë edhe ekonominë e vendit ku veprojnë dhe shpirtin e çdo ushtari. T'i kenë, pra, parasysh të gjitha këto çështje, se rreth tyre lidhen pastaj të tëra.

Çdo njësi e ushtrisë që të funksionojë normalisht duhet të ketë në rregull ndërlidhjen, ushqimet, shërbimin sanitar, veshmbathjet, pra i do të gjitha. Kjo do të thotë që terreni në kohën e luftës do të bëhet i tëri prapavijë e ushtrisë. Ushtria jonë përgatitet dhe di të luftojë në bazë të Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore, të zbatueshëm në kushtet e vendit tonë. Ajo është dhe do të jetë e zonja të gjykojë për forcat dhe për drejtimet e veprimeve të armikut nga ajri, nga toka dhe nga deti dhe do t'u bëjë ballë atyre me sukses.

I përmenda këto për të theksuar nevojën e një pune intensive që duhet të bëjnë drejtuesit e Mi-

nistrisë së Mbrojtjes e të Shtabit të Përgjithshëm që kuadrot të mendojnë e të veprojnë qysh sot në kushte si të luftës, të jenë në gjendje të parashikojnë me kohë se nga ç'anë mund të na sulmojë armiku, se cila është për të rruga më e lehtë dhe më pak e kushtueshme në njerëz e në materiale, cila është rruga që ai s'mund ta përdorë, sepse andej është e pamundur të kalohet etj. Duke i parashikuar mirë të gjitha, atëherë do të dimë ku t'i dislokojmë forcat tona, cilat vende jashtë vijave të mbrojtjes do t'i përforcojmë me forca vullnetare, me forca të kufirit ose, po të jetë e nevojshme, edhe me forca aktive, në mënyrë që, kur armiku të sulmojë brezin tonë të parë të mbrojtjes, të goditet aq fort dhe me rreptësi, sa të rraskapitet. Por që tani ne duhet të parashikojmë se do të ketë raste që armiku do të përpiqet edhe të na mashtrojë, duke futur disa forca në një drejtim për të na krijuar përshtypjen se në atë anë ai i ka përqendruar të gjitha forcat e veta, me qëllim që ne të grumbullojmë forcat tona më të shumta e më të zgjedhura në atë drejtim dhe papandehur na sulmon në një pikë tjetër që për të ka vështrësi mesatare, por për të na u futur në thellësi të mbrojtjes sonë. Këto stratagjema një oficer i ngritur në të gjitha drejtimet, mund t'i kuptojë dhe të mos bjerë në kurth.

Por për t'u bërë me të vërtetë i zoti, oficeri ynë të jetë i lidhur ngushtë me njësinë ose me repartin, ta mësojë dhe ta stërvitë atë sa më mirë. Ai nuk duhet ta ketë mendjen të ikë sa më parë nga reparti. Oficeri ynë të jetë njeri i pasionuar për punën që kryen, që

e vlerëson lart detyrën me shumë përgjegjësi dhe bën përpjekje vazhdimisht të mësojë pa u lodhur. Në qoftë se ai nuk zotëron mirë Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore, strategjinë, taktikën, në qoftë se nuk njeh terrenin ku do të veprojë, në qoftë se nuk lidhet ngushtë me shokët ushtarë dhe nuk punon për stërvitjen e tyre të vazhdueshme për t'ua mësuar të gjitha veprimet, si nëpërmjet leksioneve teorike, ashtu edhe të stërvitjeve praktike e taktike në terren, oficeri nuk mund ta kryejë dot si duhet këtë detyrë të madhe. Ai e ka për detyrë që edhe në kohën e lirë të mësojë, si vetë, ashtu edhe ushtarët, në mënyrë sa më efektive e të shumanshme.

Unë fola një ditë në Sekretariat¹, shkurtimisht, që oficerët dhe ushtarët tanë rezervistë, që ne i konsiderojmë të tërë si oficerë rezervë, të mendojnë për të mësuar jo vetëm brenda ditëve të stërvitjes vjetore, kur ata duhet të punojnë seriozisht, që të kenë sa më shumë rezultate. Është e nevojshme që për ta përvehtësuar sa më thellë Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore ata të preokupohen edhe jashtë stërvitjes, në jetën e përditshme, në kohën e lirë pas pune. Fjala vjen, duke u bashkuar me rininë ata mund të organizojnë bashkë me mësuesit e kulturës fizike shëtitje e marshime dhe t'u ngjiten bashkë kodrave e shpateve. Kështu ata edhe kaliten, edhe njohin më mirë terrenin. Këto shëtitje e ekskursionet mund të kombinohen me kryerjen e disa veprimeve taktike, për shembull, si të

1. Më 30 mars 1979, shih në këtë vëllim, f. 196.

merret maja e një kodre, bile duke i ndarë forcat më dysh, si kundërshtare, të cilat vihen në garë se kush ta zërë më parë atë kuotë. Stërvitje të tilla të lira mund të duken edhe si lodra, ose si shëtitje, po në fakt këto bëjnë pjesë në përgatitjen taktike të vogël. Kështu rezervisti, gjatë këtyre stërvitjeve në kohë të lirë, edhe argëtohet, por edhe fiton disa shprehje. Po të veprojë oficeri brenda një viti disa herë kështu, pra të bëjë disa lojëra e stërvitje të tilla pasdreke ose të dielave, atëherë në Shkollën e Lirë nuk është nevoja t'u bëjë më rezervistëve gjëra të njohura, por t'u japë atyre gjëra të reja, për të cilat kanë nevojë të ngrihen në drejtimin që thamë, që të kuptojnë nga çështjet ushtarake, nga strategjia, nga taktika, të njohin vendin, të zhvillojnë imagjinatën etj., etj.

Në këto drejtime, më duket mua, të shikojmë se si janë zgjidhur e si duhet të zgjidhen sa më mirë këto probleme. Për këtë është e domosdoshme që në radhë të parë Partia të ketë koncepte të drejta e të qarta për luftën, koncepte të mbështetura në teorinë dhe dialektikën marksiste-leniniste që të mos bëhen veprime të menduara jo mirë. Lufta është llogari, ajo është edhe dialektikë. Në qoftë se në një betejë thyhesh, atëherë, je i detyruar të tërhiqesh. Por edhe në qoftë se dëshiron të fitosh terren, të zësh vendin që të ka okupuar armiku, pra, të rikthehesh prapë atje ku ishe edhe kjo dialektikë është. Në qoftë se dëshiron ta mbash vendin derisa të vritesh, të shuhesh, edhe këtë mund ta bësh, por vetëm për një moment, se pastaj duhet ta kesh të qartë se, kur të kesh mbaruar, armiku

do të futet në vend. Prandaj ai që komandon duhet të llogaritë të mos i lërë asnjë mundësi armikut të dërgojë forca të reja etj., etj. Është gjithashtu dialektike të marrësh vendim të ecësh natën ose të ecësh ditën, të vesh në luftë i përgatitur si duhet, të llogaritësh se kur është koha për t'u futur në luftime dhe jo të futesh në aventurë. Në qoftë se rruga për të shkuar në front është e gjatë, atëherë komandanti të llogaritë mirë dhe ta njoftojë repartin se do t'i duhet të marshojë e të rezistojë, fjala vjen, 10 orë, pse ndihma do të vijë pas disa orësh etj.

Pra, në këto çështje ka shumë gjëra që duhen menduar mirë qysh tani në kohë paqeje. Për këtë lypsen kuadro të përgatitur, të aftë për të zotëruar menjëherë gjendjen dhe situatat ushtarake, të njohin mirë gjendjen e trupave e të pozicioneve, të forcës së zjarrit që ka në dispozicion, si dhe të forcës së zjarrit të armikut etj. Të tëra këto duhet të njihen e të analizohen në lidhje me njëra-tjetrën që gjërat të ccin në rregull. Se ndodh që duke u marrë me disa gjëra, harrohen disa të tjera, siç ndodh me ndërlihdjen, e cila në mjaft raste nuk sigurohet siç e kërkojnë nevojat e luftës.

Por ajo që më shqetësoi në këtë stërvitje është ajo që mora vesh se «armiku» na qenkej futur 20 kilometra thellë territorit tonë në grykën e Semanit. Për këtë problem diskutova me Mehmetin, të cilit i thashë se kjo nuk është e rregullt, pasi të parashikosh që ta lësh armikun të futet kaq thellë në brendësi të vendit, kjo është shumë. Mehmeti m'u përgjigj se në

ndihmë të njësisë sonë që ishte në atë sektor do të dërgoheshin forca të tjera.

Forca të tjera, i thashë, ne mund të dërgonim dhe ato do të venin, po edhe armiku mund të hedhë forca të tjera në këtë pellg. Por unë e kam fjalën përse forcat tona të bregut të detit u dashka të largohen nga buza e ujit dhe të tërhiqen 20 kilometra në brendësi të territorit. Jo vetëm pse kështu ato mund të vihen në mes dy zjarresh, por sepse tendenca jonë është dhe duhet të jetë që qysh në fillim të mos i lëmë armikut mundësi të pushtojë terren, se, po të arrijë të na futet ai deri në 20 kilometra në brendësi, sa ishte menduar në këtë stërvitje, në qoftë se nuk gabohem, për kushtet tona ky është një territor i konsiderueshëm, në të cilin armiku krijon mundësi të zbarrojë forca të reja të freskëta. Një gjë të tillë nuk do ta lejojmë.

Kam përshtypjen që si Shtabi i Përgjithshëm, edhe drejtoritë e Ministrisë së Mbrojtjes, kur i hartojnë këto lojëra, punojnë pa u menduar thellë, prandaj na rrofshin shigjetat kuq e blu që hedhim në hartë. Unë nuk jam kundër shigjetave, por ama këto duhet të jenë në bazë të koncepteve të Artit tonë Ushtarak dhe të lidhura mirë me territorin, me gjendjen e forcave tona ushtarake, duke synuar të mos i lëmë terren armikut, por ta gozhdojmë aty në bregdet dhe t'i shkaktojmë atij humbje sa më të mëdha që ai të mos përparojë në brendësi të territorit tonë dhe forcat tona të bëjnë manovrime.

Por të kemi parasysh që manovrimet tona nuk

mund të jenë të atilla, siç mund të jenë manovrimet e ushtrive të huaja të mëdha. Në ndonjë rast të jashtëzakonshëm, kur pas një sulmi me forca të jashtëzakonshme armiku mund të arrijë të na marrë, ta zëmë, gjithë territorin e një rrethi, atëherë do të lindë nevoja të grumbullohen aty forca sulmuese nga rrethet disi të largëta. Ne do të përpiqemi të organizojmë sulmet tona nga malet dhe t'i biem armikut, ta rrethojmë dhe ta asgjësojmë. Të tilla manovrimet mund t'i bëjmë, po kuadrot tanë t'i mësojmë që ato mund të bëhen vetëm në momente të veçanta, jo të zakonshme.

Këto probleme ne, si Komandë e Përgjithshme, na interesojnë shumë. Ka në ushtri plot gjëra të vogla, po ka edhe probleme të mëdha për t'u zgjidhur e për t'u pasur parasysh. Nuk është gjë e vogël, fjala vjen, ndërlidhja, përkundrazi, kjo ka një rëndësi shumë të madhe në kohën e luftës, se pa ndërlidhje, mbete, nuk drejton dot. Mora mbrëmë në telefon një linjë, e cila nuk e realizoi detyrën. Pa ta provoj një çikë ndërlidhjen me linjën tjetër, mendova me vete. Prandaj mora centralin, i tregova centralistit kush isha dhe i kërkova të më jepte komandantin e njësisë. Pas pak më doli komandanti i njësisë. «Jam Enveri, — i thashë. — Më jep situatën e territorit që mbulon dhe të njësisë» dhe ai më raportoi përnjëherë.

Mora më pas në një drejtim tjetër. Edhe nga ky krahu shumë shpejt më vunë në lidhje me komandantin e njësisë. I thashë gjithashtu këtij se kush isha, po ai më foli me kod. «Raportomë si është gjendja» e

urdhërova unë. Pasi më raportoi, i thashë se s'kisha gjë tjetër. I urova natën e mirë dhe suksese.

E kam fjalën që ndërlidhja duhet të jetë në çdo çast në gatishmëri të plotë. Gjithashtu, me rëndësi kolosale është sigurimi i informacionit ushtarak në kohë lufte, arma e zbulimit. Siç thotë Stalini, zbulimi është syri i ushtrisë, që hidhet kudo në prapavijat e armikut, e shikon atë ç'bën, si bën, ku i ka përqendruar forcat, prapavijën, ku i përqendron mjetet e transportit, municionet, si e bën furnizimin e trupave etj., dhe për të gjitha këto informon sa më parë komandën e vet. Edhe ne duhet ta perfeksionojmë këtë armë.

Po ashtu është e domosdoshme që qysh tani të marrim masa që të bëhet sa më mirë e më shpejt furnizimi i ushtrisë me municione në kohë lufte. Këtu një rol me rëndësi të veçantë kanë prapavijat. Si me çdo nevojë tjetër për luftën, furnizimi me municione mund të bëhet mirë kur parashikimet e luftës taktiko-operative ose taktiko-strategjike janë bërë e janë studiuar me kohë, domethënë kur parashikohen si duhet drejtimet e operacioneve, kur parashikohet sa më afër dhe realisht se në ç'drejtim ka mundësi të bëhet luftë e ashpër. Kjo ndihmon që qysh tani të marrim masa për të çuar me kohë në ato vende municionet e nevojshme. Precedencë, pra, të kenë medoemos ato pika ku mendohet të nevojiten më shumë. Por, që të përcaktohen drejt ato, duhet të parashikosh e të bësh llogaritë mirë dhe jo të veprohet në mënyrë automatike, se pastaj e lë njësinë pa municione, e lë pa bukë, dhe atëherë ajo s'ka me se të luftojë.

Ekonomizimi i forcave tona të gjalla është një problem me rëndësi shumë të madhe dhe që shtabet dhe komandat tona duhet ta kenë në qendër të vëmendjes. Po me ekonomizim të forcave të gjalla nuk do të thotë aspak të vemi të futemi e të rrimë në tunele. Atdheu do të kërkojë të luftojmë kundër armiqve agresorë. Dhe që të luftojmë sa më mirë, njerëzit tanë duhet t'i mësojmë e t'i stërvitim që të dinë se si ta bëjnë mbrojtjen, të dinë si ta bëjnë sulmin, me sa forca ta bëjnë dhe kur ta bëjnë; të jenë në gjendje që kur është çështja të mbrohem, të bëjnë një qëndresë të fortë, derisa ta dobësojmë e ta rraskapitim armikun, pastaj të përgatitin e të bëjnë kundërsulmin e kundërgoditjen, duke synuar që kjo të na dalë me sukses dhe me sa më pak humbje në njerëz e në mjete për ne e me sa më shumë humbje për armikun. Të tilla janë kërkesat e Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore, i cili edhe teorikisht, edhe praktikisht, duhet të mësohet thellë nga të gjithë njerëzit tanë.

Lufta e sotme është e tillë që kërkon në të gjitha veprimet luftarake shpejtësi, absolutisht shpejtësi. Nuk pret koha të mendohesh e të diskutosh gjatë. S'ka shumë fjalë në luftë. Përse themi ne se nuk ka kurdoherë mundësi që për çdo veprim që do të kryhet të bëhen mbledhje partie në kohë lufte? Stalinin revizionistët hrushovianë e akuzojnë që s'ka bërë gjatë kohës së Luftës së Madhe Patriotike mbledhje të rregullta të Komitetit Qendror. Po si mund të bënte mbledhje të rregullta të Komitetit Qendror në kohën e luftës Stalini, kur pothuajse të gjithë anëtarët e plenumit ishin

dërguar dhe drejtonin njësi e reparte në vendet më të vështira e më të rëndësishme të frontit? Anëtarët e Komitetit Qendror edhe në rastin tonë do të dërgohen, qoftë për të drejtuar njësi e reparte, edhe për të zëvendësuar kuadrot më me përgjegjësi, politikë dhe ushtarakë, që mund të na vriten. Në të tilla raste udhëheqja e Partisë i thotë njërit apo tjetrit anëtar të Komitetit Qendror të shkojë të komandojë një formacion luftarak që ka mbetur pa komisar apo pa komandant. Pra, në këto kushte, si mund të thërriten ata që të venë në mbledhje!? Mund të ketë raste që të thërritet njëri ose tjetri anëtar plenumi, kur shihet se situata në njësinë që drejton ai është relativisht e qetë, kurse të tjerët të qëndrojnë medocemos në vendin ku janë caktuar. Këtë e lypin interesat e lartë të mbrojtjes, të fitores mbi armikun. Kjo praktikë duhet të ndiqet edhe në komitetet e Partisë të rrethëve apo të njësive të ushtrisë, bile nganjëherë edhe deri në organizatat-bazë. A mund të jetë normale që, kur batalioni është duke zhvilluar luftime të ashpra në front, kur atje vazhdon lufta, vetëm e vetëm për hir të mbledhjes së komitetit të Partisë t'i thërriten kuadrot e tij në mbledhje? Si të bëjmë mbledhje në të tilla situata? Përkundrazi, në këto raste kërkohet veprim, kërkohet shpejtësi në marrjen e vendimeve, të merret përgjegjësi, të tregohet gjykim i pjekur në mes anëtarëve të udhëheqjes që ndodhen në ato kohë në njësi ku kemi shumë komunistë. Por edhe sikur të mos i kemi komunistë, kuadrot i kemi patriotë, i kemi njerëz të Partisë, prandaj me këta mund të me-

rren vendime me shpejtësi të madhe, duke zbërthyer me mençuri direktivat që vijnë nga lart.

Çështja e zbërthimit të shpejtë dhe të drejtë të urdhrave nga lart në njësi e reparte ka rëndësi të madhe, sidomos në kohë lufte. Por ky zbërthim mund të bëhet si duhet, kur konceptet e atyre që ngarkohen të merren me këtë punë të jenë të drejta, se kemi të bëjmë me luftën dhe lufta nuk është përrallë. Në luftë nuk flitet siç bëhet nëpër mbledhjet e kohës së paqes. Jo. Atëherë s'ka llafe shumë. Kur i thashë komandantit të njësisë, që ishte në stërvitje, se i keni lënë shumë territor «armikut», ai përnjëherë duhet të mendonte dhe të merrte pa asnjë vonesë masa që t'ia ngushtonte terrenin armikut, sepse Komandanti i Përgjithshëm, t'u thoshte ai komandave varlëse, më bëri vërejtjen se ne i kemi lënë shumë terren armikut. Kaq duhet të ishte direktiva për të, prandaj në këtë rast ai të vepronte në mënyrë që forcat që ka në vartësi të fillonin përnjëherë goditjet, ta shtynin armikun më tej dhe, pasi ta kishte realizuar këtë direktivë, të merrte në telefon Komandën e Përgjithshme dhe t'i komunikonte kësaj se, sipas urdhrit, u morën masa dhe forcat e armikut u zbrapsën aq e kaq kilometra. Kjo do të tregonte që ai e kuptoi dhe e zbatoi drejt direktivën, dhe jo vetëm të diskutonte me të tjerët që Komandanti i Përgjithshëm më bëri këtë vërejtje. Në raste të tilla duhet operuar menjëherë, se unë s'ia thashë kot atë. E para, ai duhet të mendonte një herë pse e kanë lejuar të hynte kaq thellë armikun në territorin tonë dhe, e dyta, të vepronte konkretisht dhe

me teknikë luftarake që ta ndreqte këtë situatë. Çdo gjë, pra, është e domosdoshme të mendohet me shpejtësi, se në luftë nuk ka kohë për të bërë leksione e diskutime pa fund. Këto le t'i bëjmë tash, në kohë paqeje.

Stërvitja e fundit, në përgjithësi, doli mirë e dha rezultate. Por, siç e kam thënë edhe herë të tjera, stërvitjet e mëdha duhen bërë pasi të jenë kryer një numër stërvitjesh të vogla, deri në shkallë kompanie. Po e pate nënrepartin, ushtarin të stërvitur mirë, sipas strategjisë e taktikës që përcakton Arti ynë Usharak i Luftës Popullore, atëherë repartin e ke kur të duash të stërvitur, kështu do të kemi të stërvitur mirë, të shkathët, të aftë edhe njësitë e mëdha, edhe tërë ushtrinë.

Përveç lojërave, se këto janë tjetër gjë, edhe stërvitjet janë të domosdoshme dhe duhen bërë. Por në stërvitjet që bëhen, duhen ruajtur me kujdes proporcionet midis teorisë që bëhet dhe veprimeve praktike. Këtyre t'u lihet vendi i duhur dhe teoria të zhvillohet e gjallë dhe e lidhur ngushtë me praktikën, me terrenin ku bëhet stërvitja dhe me kushtet sa më të afërta me ato të luftës sonë kundër armikut.

Shumë rëndësi t'i vihet sidomos stërvitjes së vogël taktike. Kjo të jetë sa më e larmishme, të zhvillohet jo si një ditë një ditë po krejt ndryshe, me një fjalë të zhvillohet me variante të reja. Natyrisht, këto variante të mos jenë vetëm të diktuara në programet e stërvitjes, por, përveç atyre, të provohen edhe të tjera, për të cilat, në përputhje me terrenin e dety-

rën konkrete, duhet t'i punojë vetë koka oficerit, komandantit, që nga ai më i larti e deri te më i ulëti, që të veprojnë në mënyrë krijuese.

Ka disa quadro ushtarakë që shumë çështje i kuptojnë në mënyrë shabllone. Por në ushtri dhe në luftë nuk duhet të veprohet asnjëherë kështu. Ne kërkojmë që jo vetëm oficerët aktivë, por edhe ata rezervë, të bëjnë punë krijuese, që secilit t'i punojë vazhdimisht mendja për mbrojtjen, për stërvitjen. Kështu oficeri, pa pritur ditët e stërvitjes, të mbajë lidhje me kooperativistët dhe kur e sheh të nevojshme zhvillon me ta pas pune një bisedë të lirë për disa minuta për mbrojtjen, për stërvitjen taktiko-luftarake. Një ditë tjetër u bën atyre thirrje të bëjnë një marshim, me disa veprime të thjeshta luftarake, ecje me zvarritje, maskim, marrja e një rajoni të caktuar etj. Pra zhvillon me ta një stërvitje të vogël, të lehtë, por shumë të frytshme. Kur kooperativistët i kryejnë mirë këto veprime, oficeri i falënderon e i përgëzon dhe u shpjegon se edhe në luftë kështu do të veprojnë, si në këtë stërvitje taktike, me ndryshimin që atëherë nuk do të jetë një armik imagjinar, por real.

Një ditë tjetër oficeri i pasionuar mund të futet mes nxënësve të shkollës së fshatit dhe organizon me ta një lojë që edhe i zbavit e i kalit ata, por edhe u fut atyre në ndërgjegje kujdesin për mbrojtjen, disa shprehje veprimesh luftarake, si maskimi me gjethe e degë pemësh, si në luftë. Ai porosit 7-8 prej tyre të fshihen, kurse të tjerët i nxit të përpiqen që t'i gjejnë. Po kështu ai i shfrytëzon këto lojëra dhe marshi-

me për t'u ngulitur mirë atyre se ku ka rrugë, përrrenj, ku ka ujë të pijshëm, puse apo burime, ku ka shtigje, rrëpira. Ai edhe u kërkon të rinjve t'i gjejnë vetë ku ndodhen ato, edhe i porosit që t'i shikojnë me vëmendje e t'i fiksojnë mirë në kokë, se në rast lufte do t'u shërbejnë shumë. Kështu realizohet mirë e me forma të këndshme njohja e vendlindjes, njohja e terrenit edhe nga ana ushtarake. Pra e kam fjalën që kështu duhet t'i punojë koka edhe oficerit rezervë. Ky mund të jetë edhe ushtar i thjeshtë, që ka bërë dy vjet ushtri dhe tash vepron në shkollën e lirë. Pra, ka njohuri dhe eksperiencë dhe mendon vazhdimisht për këto çështje, prandaj është në gjendje ta kryejë mirë detyrën e oficerit.

Çështja është që në stërvitjet ushtarake të ketë një larmi formash, që edhe përgatitja ushtarake të bëhet, edhe njerëzit të mos mërzhiten. Në këto stërvitje të thjeshta kuadri rezervist mund të kërkojë edhe ndihmën e ndonjë oficeri aktiv, i cili ka më shumë përvojë, jep udhëzime më të sakta etj. Ja, pra, ato që thashë se mund të bëjnë oficerët në kohën e lirë janë në të vërtetë përgatitje ushtarake. Kështu mendoj unë realizohet mirë edhe integrimi i punës së terrenit me ushtrinë. Kjo nuk është një punë, si të thuash, e klasifikuar, me takime zyrtare, duke i rënë bilbililit që njerëzit të mblidhen e të bëjnë këtë apo atë stërvitje sipas planit. Ato që janë caktuar në plan, natyrisht, do të bëhen, edhe mirë bile, po është puna të përdoren edhe forma të tjera të cilat njerëzit mund t'i marrin edhe si zbavitje dhe, në fakt, ato janë të tilla sepse,

duke u bërë të këndshme, ndihmojnë që të zbaviten njerëzit; por njëkohësisht ato shërbejnë edhe si stërvitje, se kështu njerëzit përfitojnë dhe mësojnë disa veprime luftarake.

Të tilla forma mund të gjenden shumë. Çështja është që mësimet dhe stërvitjet të mos bëhen formale, por të shërbejnë që të përvetësohen disa elemente të luftës, që nëpërmjet tyre njerëzit të përgatiten mirë për të luftuar, për t'u mbrojtur, për të sulmuar, për të njohur vendin. Ato të ndihmojnë që te njerëzit tanë të krijohen koncepte të drejta dhe shprehitë e një taktike ushtarake konkrete. Një oficer i tillë rezervist që mendon e preokupohet për mbrojtjen, edhe në mbledhjet e kolektivit a të organizatës-bazë të Partisë në kooperativë, ngrihet e diskuton për mbrojtjen, për pjesëmarrjen në stërvitje, për disiplinën. Dhe ai flet konkretisht se edhe në punë ka shfaqje të thyerjes së disiplinës nga disa anëtarë të brigadës. Dhe këtë ai e lidh edhe me disiplinën në ushtri. «Po në kohë lufte, more shokë, — thotë ai, — kështu do të bëjmë ne? Kështu do t'i zbatojmë urdhrat që do të na jepen nga Partia dhe nga komanda? Si mund të vemi ne me një disiplinë të dobët në luftë? Atëherë do të kemi të bëjmë me kokëtonë, more shokë, prandaj jo kur t'i pëlqejë njërit apo tjetrit të vijë të punojë, por secili të jetë edhe në punë i disiplinuar dhe të punojmë të gjithë tamam si në kohën e luftës». Aty në mbledhje ai mund të kritikojë edhe konceptin e disave që thonë: «O, në luftë do ta tregojmë ne se kush jemi». «Mirë, mirë, — u thotë ai, — por është e domosdoshme të jesh i disiplinuar që tashti, në

kohë paqeje, që të jesh i tillë edhe nesër në luftë».

Pra, edhe në organizatën e Partisë oficeri rezervë mendon e punon që t'u futë komunistëve, kooperativistëve ose punëtorëve të ndërmarrjes ku është ndjenjën e disiplinës e shumë gjëra të tjera.

Këto çështje ne duhet t'ua sugjerojmë njerëzve tanë, të organizuar apo të paorganizuar në Parti, oficerë dhe ushtarë, vullnetarë dhe atyre të forcave të vetëmbrojtjes, me një fjalë gjithë popullit. Vetëm se çdo gjë duhet të bëhet në mënyrë të sistemuar, të organizuar mirë, me kujdes dhe pa e tepruar, se po të bëhen pa kriter, tjetri ka të drejtë të thotë që i ka bërë ditët e caktuara të stërvitjes gjatë vitit. E kam fjalën që për të tilla stërvitje duhet gjetur koha dhe momenti. Këtu qëndron zotësia e këtyre njerëzve.

SHOKU HYSNI KAPO: Është fakt se, në përgjithësi, në disa stërvitje veprimet nuk lidhen ngushtë me realitetin e luftës, në to nuk përfytyrohet mirë ajo dhe nuk bëhen sa duhet përpjekje për të njohur vështirësitë e mëdha që ka lufta, por në mbarim të stërvitjes arrihet lehtë dhe shpejt në konkluzionin se «armikun e likuiduam», «e mundëm për dy muaj ose për tre muaj» dhe, sipas këtyre përfytyrimeve që nuk janë të plota e të drejta, «lufta» mbaroi. Vërtet, këto që bëjmë ne janë stërvitje dhe stërvitjet s'kanë si bëhen ndryshe, por kuadrot sidomos luftën dhe vështirësitë e mëdha që sjell ajo duhet t'i imagjinojnë sa më realisht dhe veprimet të kryhen në kushte sa më të përafërta me ato të luftës dhe shumë intensive. Te mjaft kuadro, që nuk kanë koncepte të drejta për atë dhe për armiqtë

e vendit tonë, një përfytyrim joreal i luftës krijon mendimin se kundërshtari do të likuidohet në një kohë të shkurtër, kurse, në fakt, lufta mund të zgjatë me vite e vite të tëra. Edhe armiku i bën hesapet mirë kur do të na sulmojë, ai nuk i hedh forcat e tij kuturu e pa menduar që ne t'ia asgjësojmë ato për një kohë shumë të shkurtër.

SHOKU ENVER HOXHA: Ai i hedh me karar, me normativë, forcat, si njerëzit, ashtu edhe mekanizmat, duke u përpjekur t'i kursejë ato, për arsye taktike dhe për qëllime strategjike të mëdha. Kjo nuk do të thotë se ai nuk do të hedhë shumë njerëz në vendin tonë, sepse dëshiron të na e zптоjë atë, ai e di se po s'futi njerëz sa duhet këtu, s'ka si e zotëron vendin.

Por unë dua të them që stërvitja nuk është lojë.

Të mos priremi të bëjmë lojëra të mëdha e të lëmë stërvitjet e trupës. Ne do të bëjmë edhe lojëra, se ato janë edhe si provë e asaj që është fituar nga stërvitjet, por në qoftë se nuk kemi bërë më parë stërvitjen e trupave si duhet, dita me ditë dhe ta kemi ndjekur këtë këmba-këmbës, oficer-ushtar-nënoficer, atëherë loja nuk mund të ketë sukses, nuk ka për të dalë mirë dhe situata nuk do të jetë e shëndoshë. Ja, ç'tregoi stërvitja e Brigadës së Parë që nuk doli hiç mirë! Kjo ndodhi për faktin se pikërisht stërvitjet me ushtarët e kësaj brigade nuk ishin bërë aspak me seriozitetin e duhur.

SHOKU SIMON STEFANI: Drejt është kjo që thoni ju, shoku Enver, loja është një provë gjatë së cilës vërtetohet se çfarë dhe sa ka mësuar njësia ose

reparti gjatë stërvitjeve që ka zhvilluar, çfarë ka bërë e si i ka bërë këto stërvitje, me një fjalë në këtë rast jep provim.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe tash ne do ta provojmë drejtorinë përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes për të parë se si i ka hedhur këto çështje në letër, i ka hedhur në hava, apo i ka bërë në bazë të stërvitjeve që janë kryer? Në qoftë se ajo nuk e njeh gjendjen e stërvitjes se në ç'nivel është, atëherë çfarë drejtorie është ajo? Nuk mund të bëhen as harta, as lojëra si ia dashka qejfi njërit apo tjetrit. Ato duhet të bëhen në bazë të të gjitha të dhënave të stërvitjeve që janë zhvilluar. Kur loja del keq, kjo, natyrisht, do të thotë që në këtë rast stërvitjet me trupën nëpër reparte nuk janë bërë mirë. Kjo na shtyn të arrijmë në përfundimin që loja duhet bërë më e ngushtë, më e vogël, për të krijuar mundësi që ushtarët të mësohen më mirë. Dhe duhet bërë praktikë që para se të fillojë një stërvitje, t'u thuhet komandës dhe efektivit të repartit që të kenë mendjen, se stërvitja e mëparshme s'ka ecur mirë dhe, në qoftë se nuk i bëjmë stërvitjet sa më të përsosura e me disiplinë të lartë, duke filluar që nga lart e deri poshtë në bazë, me shtabe e me ushtarë, asnjë operacion nuk mund të dalë me sukses. Nga organizimi i mirë dhe nga zhvillimi si duhet i stërvitjeve varet edhe suksesi në një lojë dhe pastaj nesër në luftë. Në qoftë se stërvitjet bëhen mirë, nuk ka pse të mos dalë me sukses edhe loja. Në qoftë se stërvitjet janë bërë të dobëta, edhe operacioni që mund të bëhet pas tyre do të dalë dobët.

Në të gjitha këto veprime, shokë, duhet të provojmë edhe veprimtarinë e nivelin e punës së të gjitha drejtorive të tjera të aparatit të Komandës së Përgjithshme dhe në këtë rast ka rëndësinë e vet roli që luan Shtabi i Përgjithshëm. Ky të ketë përgatitur më parë gjithçka, t'i ketë stërvitur njerëzit, të ketë caktuar edhe veprimet e operacionit si duhet dhe bashkë me të gjitha këto të kujdeset që edhe drejtoritë e tjera të Komandës së Përgjithshme t'i mbajë në lidhje të vazhdueshme me anë të shefit të vet. Këto drejtori nuk mund të qëndrojnë të shkëputura nga njëra-tjetra, që njëra të veprojë ashtu si mendon vetë dhe tjetra ndryshe. Ne i respektojmë, si kuadrot kryesorë të ushtrisë, ashtu dhe të tjerët, ua njohim meritat e së kaluarës dhe të së tashmes. Por vjen koha që ndonjëri ta kuptojë vetë dhe, kur e sheh se nuk jep më, të jetë i gatshëm t'ua lërë vendin të tjerëve. Duhet pasur parasysh se ka elementë me koncepte të vjetra dhe këta mund t'ua fusin ato edhe të rinjve. Do të jetë një krim i pafalshëm që oficerëve tanë të rinj t'u mësohen apo t'u transmetohen koncepte të vjetra që i paraqesin sikur janë koncepte të Partisë sonë.

Në ushtri është e domosdoshme që të zotërojnë në mendjen e kuadrove dhe të ushtarëve konceptet e reja. Këto Partia na i ka dhënë dhe kuadrot të bëjnë përpjekje që t'i njohin e t'i kuptojnë ato.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP

PUNA E PARTISE, ORGANIZIMI DHE KONTROLLI TI BEJNË NJERËZIT TË NDERGJEGJSIEM PËR REALIZIMIN E DETYRAVE

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

4 prill 1979

Ne kemi përparime, kemi realizime, por kemi edhe deficite. Mosrealizimet na shqetësojnë, se ato nuk janë të vogla. Më duket se ato vijnë ngaqë çalojnë organizimi i mirë i punës, drejtimi i përsosur, kontrolli dhe mobilizimi në punë. Gjithashtu, mangësitë vijnë edhe sepse jo të gjithë e kuptojnë si duhet detyrën e caktuar dhe nuk bëhen përpjekjet e duhura tekniko-organizative për realizimin e detyrave nga gjithsecili, si individ dhe bashkërisht si kolektiv. Në këtë drejtim ka dobësi si në punën e pushtetit, ashtu edhe në atë të Partisë. Sigurisht, këtu nuk duhet të ketë ndarje, por edhe ka. Prandaj të luftojmë me forcë që kjo ndarje të mos ekzistojë.

Çështja themelore në organizatën-bazë, për çdo anëtar partie është që ai të analizojë nëse e realizon

detyrën që i ka ngarkuar Partia në atë sektor, ku punon apo jo. Kështu që diskutimi i tij në organizatën e Partisë nuk mund të jetë tjetër veçse një analizë, një konkluzion i punës së tij të gjithanshme, jep apo nuk jep fryte ajo. Kësaj duhet t'i shërbejë gjithë puna politike dhe ideologjike e Partisë, disiplina, autokritika e kritika. Të gjitha këto vlejné për t'i bërë njerëzit të fortë, patriotë të vendosur, komunistë të denjë për Partinë dhe shoqërinë, me qëllimin përfundimtar që gjithçka t'i shërbejë realizimit të planeve.

Kur themi organizata e Partisë, nuk e ndajmë atë nga punët shtetërore, sepse edhe në organet shtetërore ka anëtarë të Partisë, por edhe ata kuadro që s'janë anëtarë partie punën e saj bëjnë. Komunistë kemi kudo, në administratë e në prodhim. Pra Partia drejton konkretisht. Por nuk mund të mendohet se ka ndarje me thikë në këto punë. Nuk është aspak e drejtë kur thuhet se për këto apo ato të meta, për këto dhe për ato gjëra e kanë fajin vetëm organet shtetërore. Jo, s'e kanë fajin vetëm ato, por përgjegjësi mbajnë edhe organet e organizatat e Partisë, sepse Partia është në udhëheqje. Edhe drejtuesit e ndërmarrjeve, në të shumtën e rasteve janë komunistë, e së bashku me anëtarët e Partisë, ata jo vetëm drejtojnë kolektivin, por edhe mbajnë përgjegjësi për punët. Për të gjitha këto, komunisti në sektorin ku punon, duhet të jetë në pararojë dhe të mbajë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për punët, për realizimin e detyrave, të planeve të shtetit etj.

Prandaj e theksoj që, megjithëse shfaqjet e dëm-

shme ne i kemi luftuar, i luftojmë dhe do t'i luftojmë tërë jetën, duhet përsëri t'i shikojmë e t'i kemi parasysh vazhdimisht në punën tonë të përditshme. Unë, për shembull, në disa mbledhje të organizatës-bazë të Partisë ku bëj pjesë, kam vënë re se këto çështje nuk lidhen kurdoherë me njëra-tjetrën e me rezultatet e arritura. Ne kërkojmë rezultate në realizimin e detyrave në të gjitha drejtimet, në ngritjen politike të njerëzve, në çështjen e disiplinës së shëndoshë proletare, në punën e organizatës së Partisë; realizimin e detyrave e kërkojmë edhe në mbledhjen e bashkimeve profesionale etj. Po për se i kërkojmë të gjitha këto? I kërkojmë që të ndërtohet socializmi, të formojmë njeriun e ri dhe që ky njeri i ri të luftojë me të gjitha forcat e dijet për të ndërtuar një ekonomi të fortë socialiste, një jetë të lumtur, duke ngritur vazhdimisht nivelin e jetesës e të kulturës së popullit tonë; të punojmë që Shqipërinë tonë socialiste ta forcojmë, ta kalitim, ta ngremë akoma më lart.

Tërë këtë punë e udhëheq Partia. Por shohim që jo të gjithë anëtarët e Partisë dhe kuadrot drejtues japin mendime e nxjerrin konkluzione për probleme të rëndësishme. Ja, të marrim, për shembull, revolucionarizimin e arsimit të mesëm. Sigurisht, ky ka problemet e veta në të cilat duhet të ndalen Partia, vetë kuadrot e arsimit, por edhe të tjerët. Probleme të tilla, si lidhja e teorisë me praktikën, çështja e edukimit fizik dhe e stërvitjes ushtarake në klasat e larta të kësaj shkolle, si dhe puna e nxënësve në prodhim,

të cilat kërkojnë një vlerësim të madh, duhet t'i nënshtrohen një diskutimi jo vetëm nga shkolla, por edhe nga organet shtetërore, qendrat e punës etj., se, siç kam dëgjuar, ka raste që nxënësit e Tiranës shkojnë dhe pastrojnë ferrat e ullinjve të Saukut gjatë muajit që duhet të kryejnë punën direkte në prodhim. Pra, këtu kemi të bëjmë me një problem që lidhet me ekonominë e vendit. Prandaj, në një mënyrë ose në një tjetër, jo vetëm shkolla, por edhe organizata-bazë e Partisë e ndërmarrjes bujqësore duhet ta ngrejë problemin e vajtjes së nxënësve për ta bërë siç duhet punën në prodhim, që të gjenden frontet e punës dhe sasia e mjaftueshme e kohës.

Sot në gazetë kishte një artikull¹ kritik për ndonjë kuadër të Partisë apo të pushtetit, instruktor ose sekretar komiteti partie, specialist ose nënkryetar të komitetit ekzekutiv që kur shkon në punë, thuhet në artikull, vishet spic e me kravatë sikur do të vejë në dasmë, por që nuk njeh as problemet kryesore për të cilat duhet të përgjigjet. Një ekonomisti, për shembull, në një ndërmarrje i kërkohet jo vetëm t'i njohë kërkesat e ligjeve ekonomike, detyrat e planit, por edhe të bëjë një punë këmbëngulëse për t'i zbatuar ato. Mirëpo ka edhe kuadro, deri edhe sekretar partie që nuk i njohin thellë problemet e prodhimit. Kuadro të tillë nuk dinë jo vetëm se çfarë problemesh do të shtrojnë në organizatën-bazë, por as edhe çfarë dety-

1. Është fjala për artikullin me titull «Ndryshe sy ndër sy, ndryshe me telefon», botuar në gazetën «Zëri i popullit».

rash kanë. Po me se merren këta? Ndonjëri mund të thotë se merret me disiplinën. Po me çfarë discipline? Ai s'merret me planin dhe as që ka asistuar në mbledhjet ku është diskutuar për këtë problem ose për normat teknike, sepse s'ka haber fare nga ato. Po të qe ndryshe, ai do të merrte menjëherë masa për përmirësimin e gjendjes. Sigurisht, të kuptohemi, kjo nuk është e përgjithshme te ne. Por kuadrove të tillë u duhet tërhequr vëmendja.

Ose ka edhe probleme të tjera që ne i mëssojmë edhe nga shtypi. Sekretari i Partisë e dërgon, për sheqerull, instruktorin e komitetit të Partisë për të parë gjendjen në një zonë ose në një fshat. Mirëpo ai shkon e vjen si era. Kur kthehet, ky raporton e bën «rekomandime» në komitetin e Partisë. Por ç'vlerë kanë këto raportime e rekomandime? Për këto gjëra është shkruar në artikullin që thashë edhe më lart. Veçse në këtë artikull unë shoh edhe disa pikëpamje jo të drejta, një interpretim jo të drejtë të një porositë të Partisë. Partia ka thënë, thuhet në artikull, që kuadri 70 për qind të kohës së punës duhet ta kalojë në terren dhe 30 për qind në zyrë! Kjo s'është e vërtetë. Kuadri mund të bëjë edhe 30 për qind të punës në terren dhe 70 për qind në zyrë. Po telefoni? S'hyn në punë, thotë autori. Jo, s'është ashtu. Në artikull përmendet edhe citati i Stalinit lidhur me çështjen e drejtimit të prodhimit, gjë që është e drejtë, por rëndësi ka që porositë e dhëna të interpretohen saktë. Të mos harrojmë se mund të ndodhë që një kuadër i komitetit të Partisë të vejë në fshat e të rrijë atje

20 ditë, të hajë e të pijë, të marrë edhe dietën dhe të mos bëjë gjë në krahasim me atë kuadër që mund të rrijë vetëm 3 ditë, por që bën punë e lë gjurmë.

Kështu, për shembull, kryetari i Bashkimeve Profesionale të rrethit të Dibrës mund të rrijë vetëm 3 ditë në Bulqizë, por, po të dijë të punojë mirë brenda kaq ditëve, ai bën goxha punë, ta zëmë, mbledh aktivin, kontrollon gjendjen e punëve në përgjithësi dhe në ndonjë sektor të veçantë, përpiqet të zbulojë dobësitë e shkëmben mendime si të ndreqen ato. Pastaj, pas ca kohësh, interesohet për zbatimin e detyrave etj. Për këtë ai mund të shkojë përsëri atje, ose të pyesë nëpërmjet telefonit.

Pra, zbatimin e detyrave kuadrot e ndjekin në dinamikë, edhe duke vajtur në bazë, edhe nëpërmjet informacioneve që dërgon baza, ndonjëherë edhe nëpërmjet telefonit. Kështu ata vihen në korrent të punëve shpejt e shpesh. Vetë kuadri duhet të dijë ta ndërtojë mirë metodën e punës që t'ua dalë gjithë atyre problemeve. Rëndësi ka si e organizon kuadri punën për harxhimin në mënyrë sa më racionale të kohës së tij të punës. Kryesorja është të realizohen detyrat dhe jo të bëjë një ndarje thjesht aritmetike të kohës duke thënë: kaq për qind të kohës do të shkoj në bazë e kaq për qind të kohës do të rri në zyrë. Jo kështu. Partia porosit që kuadrot të venë në bazë jo si era, por për të lënë gjurmë, për të ndihmuar në mënyrë të tillë që t'i zgjidhin në vend problemet dhe t'u hapin shokëve të bazës horizont.

E gjithë kjo është një kompleks i tërë që lidhet

me stilin dhe me metodën e punës së kuadrit. Partia kërkon nga secili që të punojë me një metodë e stil revolucionar, që njerëzit t'i kuptojnë më mirë detyrat e përgjegjësitë që kanë, qofshin këto partie apo shtetërore, të cilat janë edhe të ndara, por edhe të lidhura ngushtë. Nuk ka punë «speciale» të Partisë dhe punë «speciale» të pushtetit. Partia është në pushtet, ajo është edhe në udhëheqje të pushtetit, i cili, duke qenë levë e saj, ka ligje, rregullore e plane që i ka vendosur Partia dhe masat e gjera punonjëse, me metodat e me format që kemi caktuar, me centralizmin etj. dhe për zbatimin e këtyre duhet të mobilizohen të gjithë, sidomos anëtarët e Partisë. Pra, kush është në pushtet duhet të bëjë punën e pushtetit, kush është në aparatin e propagandës së Partisë duhet të bëjë këtë punë. Por në fund të gjitha të përqendrohen në një çështje të rëndësishme të përbashkët, siç është realizimi i detyrave dhe i planeve.

Në një relacion që më erdhi nga Kryeministria, vura re se në sektorin e industrisë e të minierave ka ndërmarrje ku puna nuk ecën mirë. Kështu, për shembull, aktualisht, 39 ndërmarrje të këtij sektori nuk plotësuan akumulimin, kurse në sektorin e ndërtimit nuk e plotësuan 32 ndërmarrje. Për vitin 1978 numri i ndërmarrjeve që dolën me humbje, nga 13 të planifikuara, u ngjit në 19 dhe shuma e humbjeve u rrit disa herë. Dhe na kërkohet «nëse kemi ndonjë këshillë»? Ja, të gjitha këto që themi këshilla janë. Veçse këto ne i kemi thënë vazhdimisht. Tash kërkohet t'i bëjmë realitet ato që themi, të kërkojmë me këmbëngulje që

ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të shkunden, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të marrin masa më të efektshme për realizimin e detyrave të planit.

Gjithashtu nga ai relacion mësova se fondi i planifikuar i pagave të punonjësve për vitin 1978 nuk u plotësua, megjithatë mjaft ndërmarrje dolën me mbishpenzime. Kjo gjendje vazhdon. Nga ana tjetër, na thuhet se gjatë vitit 1979 kontrolli financiar u forcua. Me këtë gjendje, ku qëndron këtu kontrolli i fortë financiar në çdo hallkë të prodhimit? Në relacion vihet në dukje se lidhur me këto të meta për anën ekonomike financiare, nëpërmjet organeve shtetërore dhe ekonomike, po merren masa për eliminimin e tyre, duke forcuar kontrollin në ndërmarrje, me qëllim që të realizohet plani dhe çdo tregues ritmikiht etj., etj. Mirëpo, në fakt, të gjithë ata milionë që përmenada nuk u morën. Ata u «darovitën». Por në këta milionë janë bazuar planet tona. Dhe më poshtë, në relacion, thuhet se ndërmarrjet bujqësore nga shitjet realizuan të ardhurat 82 për qind, ndërsa të ardhurat neto të këtyre ndërmarrjeve u ulën më tepër; plani i të ardhurave të përgjithshme të kooperativave bujqësore u plotësua 81 për qind, kurse ai i të ardhurave neto u plotësua 70 për qind.

Edhe pse është kjo gjendje, përsëri na bëhen nga Ministria e Bujqësisë propozime të tilla për t'u dhënë kredi e për t'u falur kreditë e vjetra kooperativave bujqësore të disa rretheve. Pse bëhen këto gjëra?

Por le të kthehemi te çështja e parë, te kryesorja.

Mua më duket se puna dhe përgjegjësitë për rezultatet e arritura janë të përbashkëta, pra, si për organet shtetërore, ashtu edhe për ato të Partisë, të cilat, pa dubluar njëra-tjetrën, të punojnë në linjën e tyre, që të sqarohen mirë e të mobilizohen njerëzit që këto gjëra të mos ngjasin më.

Studimet që bën Qeveria janë me vend, në to shqyrtohen probleme të rëndësishme, jepet edhe ndonjë rezultat, sugjerohen rrugëzgjidhje, duke vënë theksin se duhet bërë kjo apo duhet bërë ajo tjetra. Por me këto studime e relacione të Qeverisë duhet të njihen jo vetëm sekretarët e KQ të PPSH, por edhe aparati politik, instruktorët e sektorit ekonomik, të propagandës, të statutit etj., të cilët t'i bëjnë ato objekt studimi dhe diskutimi. Qëllimi është që të gjithë këtu në aparat të vihen në dijeni të problemeve e të situatës, që të nxjerrim disa konkluzione dhe të përcaktojmë edhe masat e nevojshme për realizimin e atyre që ngre Qeveria, pasi problemet janë të saj, por edhe tonat. Kështu është. Vendimet që marrim ne i shkojnë Qeverisë, e cila i zbërthen dhe i zbaton, por edhe relacionet për gjendjen, si dhe vendimet që na dërgon Qeveria nuk duhet të mbeten vetëm tek unë ose te ndonjëri nga sekretarët e Komitetit Qendror. Pasi të njihet me këto materiale, secili sektor, sipas detyrës që ka, të shkojë në bazë, t'i shohë në vend problemet, të marrë kontakt dhe të flasë me njerëzit për detyrat që dalin, për rrugët që duhen ndjekur për eliminimin e mosrealizimeve, të humbjeve në fushën e prodhimit, të akumulimit etj. Pra, të sqarohen punonjësit e ma-

sat, se po të ecet kështu, me mosrealizime të planeve, do të na krijohen situata të vështira, se kur ka mosrealizime, nuk do të plotësohen si duhet nevojat në rritje të popullit, mungesat do të rriten e do të na krijohen edhe probleme të tjera.

Këtë gjendje, në qoftë se e kuptojmë drejt, duhet ta ndryshojmë medoemos, duke filluar që këtu në aparat. Natyrisht, me fjalë asgjë nuk përmirësohet, por kërkohet punë, organizim, mobilizim, shkathtësi, drejtim i mirë. Këto të reflektohen edhe në bazë. Mundësitë materiale e teknike për të realizuar planet i kemi. Por duhet t'u dalim punëve përpara. Po si? Duke forcuar drejtimin dhe organizimin, si nga ana e pushtetit, ashtu edhe nga ana e Partisë, duke forcuar disiplinën e Partisë e njëkohësisht edhe disiplinën shtetërore. Që të realizohen këto, kërkohet që njerëzit kudo që janë, në të gjitha frontet, t'i vënë krahët punës, me një frymë të lartë mobilizimi.

Në relacionin që përmenda thuhet se do të shtohen ndërmarrjet me drejtim blegtoral, për shtimin e sasisë së mishit. Mirë, t'i bëjmë edhe këto, por duhet të shohim edhe çështje të tjera, që kanë të bëjnë me shtimin e prodhimit bujqësor, si, për shembull, pse nuk e kemi mirë misrin, pse nuk marrim rendimentet e duhura nga serrat që kemi ndërtuar, të cilat na dalin me humbje, pse ato nuk na japin atë që kemi planifikuar. Kemi thënë që prodhimet në serra duhet të na japin rendiment katër herë më të lartë se ato të fushës, kurse, në fakt, ato as planin nuk realizojnë me prodhimet e tyre. Përse ndodh kështu? Sepse atje

ka njerëz që nuk punojnë si duhet, që nuk zbatojnë vendimet, rregullat etj. Partia në bazë duhet të punojë më mirë që këta njerëz t'i bëjë të ndërgjegjshëm për kryerjen e detyrave.

Mua më duket se këto gjëra kanë rëndësi të madhe edhe për Qeverinë, edhe për Partinë. Sigurisht, të metat nuk vijnë vetëm nga dobësitë e punës së Partisë, por nuk mund të themi se vijnë edhe vetëm nga dobësitë e punës së aparateve shtetërore, sepse edhe në këto punojnë komunistë. Në qoftë se një drejtues, që është komunist apo edhe anëtar i Komitetit Qendror, nuk e kryen mirë detyrën shtetërore, atëherë kjo do të thotë që ai nuk e bën mirë edhe punën e Partisë, si komunist dhe si anëtar i Komitetit Qendror. Përse e ka vënë Partia në krye të ministrisë atë? Përse e ka zgjedhur Partia anëtar të Komitetit të saj Qendror? Që t'i realizojë të gjitha detyrat si punonjës i aparatit shtetëror dhe si anëtar partie.

Ne këtu në aparatit e Komitetit Qendror, për këto probleme nuk duhet të mjaftohemi vetëm me konstatime. Në aparat të mos sjellim njerëz vetëm për t'i sjellë, por që ta bëjnë punën që do t'u ngarkohet. Në qoftë se duhet edhe një ndihmës tjetër për problemet e bujqësisë, për shembull, ta sjellim edhe atë. Është fakt që Qeveria ka marrë në shqyrtim një sërë problemesh për bujqësinë, por edhe ne këtu kemi analizuar gjithë ato probleme dhe kemi caktuar detyra për mbarëvajtjen e bujqësisë. Këto i janë transmetuar edhe ministrisë, por çështja është që, sipas rastit e problemeve, ti, Prokop [Murra], këto t'ua thuash

komiteteve të Partisë në rrethet e interesuara, me qëllim që e gjithë Partia të ndalet në ato probleme ku është nevoja, ku puna çalon më tepër, derisa njerëzit të kryejnë si duhet detyrat. Këtë punë nuk mund ta bëjnë vetëm instruktorët e një sektori të aparatit, por gjithë Partia. Të tërë njerëzit që merren drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me bujqësinë, të dinë si të mobilizohen vetë e si të mobilizojnë të tjerët për të vënë në jetë vendimet e Partisë, për të realizuar detyrat e planet. Në këtë drejtim unë mendoj se shembullin duhet ta japë aparati ynë këtu, pra, që edhe Qeveria, ministritë dhe punonjësit e tyre të marrin shembull nga Partia.

Pra, shokë është e nevojshme të thellohemi më shumë në punën tonë drejtuese e kontrolluese, sepse lind çështja: ose planet nuk janë reale, ose çalojnë drejtimi, organizimi i punës, kontrolli etj. Njëra nga të dyja është. Përderisa disa i realizojnë detyrat, përse të mos i realizojnë edhe të tjerët? Ne kemi qenë të bindur se plani është real. Atëherë mbetet ana tjetër dhe tash kësaj duhet t'i futemi më thellë.

Rëndësi, në mënyrë të veçantë, siç na mëson Stalini, ka organizimi i punëve. Pa organizim të mirë nuk zbatohet vija. Po çaloi organizimi, çalon edhe drejtimi. E kam thënë edhe herë të tjera, nuk mund të mendojmë e të vendosim vetëm ne nga lart për një formë organizimi apo për një tjetër. Për këtë çështje duhet ta thotë fjalën e vet edhe baza. Pra, kur shkojmë atje, të dëgjojmë sa më gjerësisht mendimet e njerëzve dhe problemin ta trajtojmë jo për t'ua leh-

tësuar barrën atyre që kanë detyra për t'i realizuar, sepse edhe kjo mund të na ngjasë. Komoditete në asnjë mënyrë të mos u lejojmë njerëzve, por ata të kryejnë detyrat. Në qoftë se në kontrollet e konsultat që bëjmë arrijmë në përfundimin se këtë ose atë punë nuk mund ta bëjë dot një person, ose ky organizim që kemi në këtë apo atë sektor nuk është i përshtatshëm, atëherë të vijmë këtu e të themi se është e pamundur, për shembull, që të ecin mirë punët në një kooperativë me 8 e me 9 fshatra. E bëjmë këtë bashkim, por tash duhet menduar si ta forcojmë punën, si ta organizojmë më mirë dhe si të ushtrojmë kontroll.

Siç thashë, ne e bëjmë bashkimin në një kooperativë të 8 apo të 9 fshatrave, po nëse organizimi i sotëm nuk është i mirë, mund edhe të kthemi prapa, ashtu si dje në luftë, në qoftë se e duan interesat e prodhimit. Pra, edhe mund t'i ndajmë prapë disa kooperativa të bashkuara, një kooperativë ta ndajmë në dysh, 5 fshatra në një dhe 3 ose 4 në një tjetër; ose të vrasim mendjen dhe të gjejmë forma më të përshtatshme organizimi që puna të ecë mirë.

Kooperativat janë ekonomi kolektive socialiste, ekonomi grupi, që, fundi i fundit, e nxjerrin bukën vetë, kurse ne i konsiderojmë këto si shtetërore dhe u themi: kaq e ke normën ti, kaq duhet ta kesh ti, kaq duhet ta ketë ai etj. Pra çdo gjë ia përcaktojmë ne si shtet, deri edhe me sa veta do të jetë brigada. Edhe kur brigadieri në një kooperativë, për shembull, ngrihet e thotë se mua më duhet që brigada të jetë me

30 veta, dikush nga Partia apo nga organet shtetërore i thotë që brigada të jetë me 70 veta. Po përse të jetë me 70 veta? Këtë punë e gjykon më mirë vetë brigada, vetë kooperativa. Punonjësi i Partisë, i komitetit ekzekutiv apo i dikasterit duhet t'i njohin mirë veçoritë e punës në kooperativën bujqësore, jo të diktojnë e të imponojnë çdo gjë. Për këtë ata duhet të shkojnë më shumë atje, ta shikojnë brigadierin si punon, si e kontrollon punën, si e lexon gazetën, si bën matjen e punës, si i shkruan rendimentet, ditë-punët etj. Pra, ia del apo s'ia del dot mbanë punës brigadieri me një brigadë prej 70 vetash.

SHOKU HYSNI KAPO: Tani në kooperativat bujqësore brigadat i kemi me 35 deri në 40 veta, ndërsa në ndërmarrjet industriale i kemi me rreth 20 veta.

SHOKU PROKOP MURRA: Unë mora dhe pashë dinamikën e pesë vjetëve të fundit. Gjatë kësaj kohe në kooperativat bujqësore del se janë shtuar 110 000 krahë pune, ndërsa nuk është shtuar asnjë sektor.

SHOKU ENVER HOXHA: Këto gjëra duhen parë, ndryshe, në qoftë se pajtohem me këtë gjendje, nuk do të kemi rezultate në kooperativat bujqësore. Për ato duhen bërë studime, por, e theksoj edhe një herë, këto studime të mos i zvarrisim, të mos i lëmë për në pesëvjeçarin tjetër.

SHOKU RAMIZ ALIA: Në fillim ju, shoku Enver, shtruat çështjen që të ruhen stabiliteti ekonomik dhe niveli i jetesës së punonjësve e lidhur kjo edhe me çështjen e monedhës. Financa për këto probleme të mëdha duhet të shqetësohet jashtëzakonisht. Këto proble-

me duhen shpjeguar, sepse kemi të bëjmë me ligje ekonomike.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtë gjendje të shëndoshë që kemi, unë e shpjegoj me një gjë, me patriotizmin e madh të popullit tonë dhe me besimin e madh që ka ai te Partia. Ky patriotizëm, ky besim na e lehtëson zbatimin e ligjeve të ekonomisë socialiste. Por ne kemi për detyrë të bëjmë çdo gjë që këto ligje të zbatohen drejt në praktikë, se nuk mjafton vetëm patriotizmi i popullit. Këtë ta shikojmë konkretisht, ndryshe hendeku midis sasisë së parave që janë në qarkullim dhe mallrave në treg thellohet dhe kjo mund të përbëjë një problem të madh politik.

Më parë përmenda faktin që, megjithëse punohet 6 orë, 6 orë e gjysmë, normat tejkalohen dhe si rrjedhim paratë merren, edhe pse nuk është punuar 8 orë. Ja përse themi që ligjet ekonomike nuk zbatohen si duhet.

Le të marrim çështjen e investimeve. Edhe këtu mundësitë janë të shumta. Por jo në të gjitha rastet objektet që ndërtojmë i nxjerrin në kohën e duhur paratë e harxhuara. Ne duhet të investojmë aty ku kemi leverdi ekonomike. Por ngaqë nuk i realizojmë objektet në kohë, krijohen deficite. Kjo ndodh sepse nuk mendohet në mënyrë të studiuar për të ngritur dhe për të shtuar ato objekte ose linja që janë më të nevojshme e me efektivitet ekonomik. Çfarë na jep, për shembull, sektori i industrisë së rëndë? Shumë prodhime të nevojshme për ekonominë. Por ne kemi nevojë edhe për artikuj konsumi. Sigurisht, ne nuk mund ta kthejmë

industrinë tonë të rëndë në industri të lehtë, sidoqoftë ka një raport midis industrisë së rëndë dhe asaj të lehtë.

Po të vazhdohet me deficite dhe me mosrealizime në prodhim, sidomos në ato të konsumit të gjerë, kur punëtorët paratë i marrin dhe çmimet nuk ngrihen, mund të na krijohen shqetësime politike. Ne nuk kemi të tilla shqetësime, njerëzit tanë janë patriotë dhe janë me Partinë, por ligjet objektive ekonomike veprojnë dhe ato bëjnë punën e tyre. Prandaj nuk është e drejtë që veprimin e këtyre ligjeve ta neglizhojmë, por të marrim të tilla masa që në bazë të kërkesave të këtyre ligjeve të zhvillojmë ekonominë për të plotësuar sa më mirë edhe nevojat e riprodhimit të zgjeruar, edhe nevojat e popullit.

Në fund dua të theksoj se, kur na vijnë relacione statistikore nga Kryeministria ose kur del diçka e tillë këtej nga aparati i Komitetit Qendror, mund të organizohen mbledhje të përbashkëta me shokët e Kryeministrit, të diskutohet rreth problemit për të cilin flitet, të merren vendime të përbashkëta dhe të veprohet frontalisht, duke caktuar detyra konkrete, me qëllim që të arrihen rezultate e të likuidohen të metat, nëse bëhet fjalë për një gjë të tillë. Pastaj, po për të njëjtën çështje, menjëherë duhet të diskutojë gjithë aparati.

SHOKU HYSNI KAPO: Mua, shoku Enver, më duket se del edhe një problem tjetër këtu, të cilin ndoshta duhet ta shikojmë edhe ne; çështja se si i shqyrtojnë organizatat-bazë dhe komitetet e Partisë të

rretheve problemet e planit, shkaqet e mosrealizimeve dhe cilat janë përgjegjësitë që nxjerrin për to. Këtë duhet ta dimë edhe ne, sepse ja, informacionin për realizimin e planit ne e marrim në rrugë shtetërore. Këtu nuk e kam çështjen të shifrat, por tek analiza që i bëhet këtij problemi në rrugë partie, se ç'konkluzione nxjerrin, si dhe ç'masa do të merren për realizimin e planit etj. Për një gjë të tillë ne nuk informohemi nga komitetet e Partisë të rretheve, por unë mendoj se duhet ta kërkojmë. E njëjta gjë duhet kërkuar edhe nga organizatat e Partisë në organet qendrore, në ministritë. Organizata-bazë e Partisë në ministri udhëheq gjithë kolektivin e punonjësve të saj, prandaj të analizojë e t'u kërkojë llogari atyre për deficitet e krijuesra në drejtimet që mbulojnë.

SHOKU ENVER HOXHA: Fare mirë mund të thirren këtu edhe sekretarët e organizatave të Partisë të ministrive dhe të bisedohet me ta për problemet e realizimit të planit ose për një vendim apo një direktivë të Partisë. Thirrja e tyre këtu ka dy anë: duke ardhur në aparatën e Komitetit Qendror të Partisë, ata edhe do të japin llogari pse s'janë realizuar detyrat e planit dhe, në të njëjtën kohë, do të tregojnë se çfarë masash janë marrë e do të merren për t'i realizuar ato. Kështu edhe aparati vihet në dijeni, por edhe ata vihen në pozita pune, sepse do ta shohin që nuk do t'u lejojmë as të sjellin vetëm konstatime, as justifikime, por të gjejnë rrugët e plotësimit të detyrave të planit.

Për këto çështje të gjithë ne këtu të mendojmë më shumë, se janë me rëndësi të madhe.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e përfunduar, që gjendet në AQP*

TE MËSOJME MË SHUMË E VAZHDIMISHT NGA NJERI-TJETRI

*Nga biseda në takim in ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

5 prill 1979

Në këtë takim ishte ftuar edhe shoqja Lenka Çuko, në atë kohë kandidate e Byrosë Politike dhe sekretare e parë e Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës, me të cilën shoku Enver Hoxha zhvilloi një bisedë të ngrohtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne, sekretarët, shoqja Lenkë, takohemi vazhdimisht këtu, bisedojmë e shkëmbejmë mendime. Prandaj më mirë mos u lodh duke mbajtur shënime, se më shumë do të të mbeten në kujtesë pa i shkruar. Edhe shokët sekretarë zakonisht nuk mbajnë shënime në këto takime.

SHOQJA LENKA ÇUKO: Shokët sekretarë janë përditë me ju, shoku Enver, këta kanë rast t'ju pyesin sa herë të duan, ju së bashku i qani hallet dhe konsultoheni, kurse ne, që jemi në rrethe, mezi presim t'ju dëgjojmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju e dini që Kombinatin Metalurgjik në Elbasan kinezët na e lanë në mes, por njerëzit tanë iu vunë punës me guxim për të ngritur uzinën nr. 12 dhe, që nga ajo kohë e deri tash, e kanë mbaruar një linjë, e cila e merr mineralin brut, ashtu siç është, dhe e kalon në një proces, që ndan hekurin nga nikel-kobalti.

Specialistët dhe metalurgët tanë akoma nuk e njohin procesin e ndarjes së nikelit nga kobalti, por do të përpiqen ta zbulojnë, ta gjejnë procedurën kimike, fizike apo çfarëdo të jetë ajo, që të arrijnë të veçojnë nikelin nga kobalti. Po e ndamë nikelin nga kobalti, atëherë edhe këta dy zëra do të marrin një vlerë të madhe, do të shiten me çmime shumë të larta. Duke i pasur nikelin dhe kobaltin të veçantë, ose mund t'i eksportojmë dhe kështu marrim devizë për të blerë mallra të tjera, për të cilat kemi nevojë, ose mund të formojmë aliazhe dhe të bëjmë kombinime me to, të prodhojmë me to çelique të markave të ndryshme me atë fortësi që kërkohet, për nevojat tona të brendshme ose për ato të tregut të jashtëm.

Këtë procedurë të re kinezët nuk na e kanë dhënë, prandaj kemi ngarkuar specialistët e punëtorët tanë që të mblidhen e të studiojnë literaturë. Ne kemi kimistë të aftë që mund të çajnë në këtë drejtim. Po të ketë në Lushnjë ndonjë kimist të mirë, mund ta dërgojmë në kombinat, por ti, shoqja Lenka, mos u bëj «gjirokastrite» që ta kursesh.

SHOQJA LENKA ÇUKO: Po të kemi, me gjithë qejf do ta japim.

SHOKU ENVER HOXHA: Tani po punohet për të vënë në punë Uzinën e Ferrokromit në Burrel. Ne dërguam atje shokun Prokop, që të shpejtohet afati i vënies në shfrytëzim të furrës së dytë. Ky afat, nga gjashtë muaj që ishte, u shkurtua deri më 10 prill. Shiko sa mirë është po të organizohet puna në këtë mënyrë!

Tashti, ti Prokop, në afatin e caktuar të vish e të na thuash për këtë shtet. Kushedi, mbase do të jesh këtu edhe ti, shoqja Lenka. Sot është data 5 prill, pas 5 ditësh ti mund të vish edhe një herë.

Ja kështu venë këto punë, moj shoqja Lenka. Si thua ti, nuk do të ishte mirë sikur të na vish më shpesh këtu?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Dakord, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti vërtet ke punë në Lushnjë, por besoj se nuk do të humbasësh gjë duke ardhur këtu herë pas here.

SHOQJA LENKA ÇUKO: Përkundrazi, këtu unë mësoj shumë, por nuk dua t'ju shqetësoj.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne na shqetëson?! Aspak, përkundrazi! Edhe sikur vetë, pa të ftuar ne, të vish, nuk ka përse të mërzhitemi. Fjalën «shqetësim» në marrëdhëniet me shokët e udhëheqjes duhet ta fshijmë nga fjalori. Në këto takime bëhen biseda të lira. Ja, sot, për shembull, unë, shokët e tjerë dhe ti e ndiejmë veten të lirë e të kënaqur që këmbejmë mendime. Kur u nise për këtu, mbase mendoje rrugës: «Përse do të më kenë thirrur? Për çfarë do të më pyesë vallë shoku Enver? Si do t'i them për çështjen e grurit, si do t'i them për lopët?» etj. Tërë natën mbase ti nuk ke fjetur,

duke menduar për këto gjëra, por ti e sheh se këtu bëhet një bisedë e lirë. Unë mendoj që edhe kështu, për të marrë pjesë në këto biseda të lira, të zakonshme, ti mund të vish.

Kur bëhen mbledhjet me shokët instruktorë të aparatit të Komitetit Qendror?

SHOKU SIMON STEFANI: Mbledhjet me instruktorët bëhen në fillim të muajit. Ata marrin detyrat dhe pastaj shkojnë nëpër rrethe.

SHOKU ENVER HOXHA: A nuk do të ishte mirë sikur në këto mbledhje të instruktorëve, bashkë me ty, Simon, të vinte edhe Lenka, që të dëgjonte ç'thonë ata?

SHOKU HYSNI KAPO: Lenka mund të ndihmojë, se ka edhe eksperiencën e punës në bazë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, Lenka ka edhe eksperiencën e bazës. Ti, Simon, lajmëroje Lenkën për datën që do të keni mbledhje dhe kjo të vijë. Nuk është e domosdoshme të flasësh në këto mbledhje, por po të duash edhe flet, se je kandidate e Byrosë Politike dhe mund të japësh mendime ose porosi, mund të bësh edhe vërejtje e të japësh eksperiencën e rrethit. Pastaj, aty do të shohësh edhe shokun Simon se si punon me shokët instruktorë, si i dëgjon, si u ndërhyr kur nuk kanë vepruar mirë, si u kërkon edhe llogari etj. Kështu edhe ti mëson nga Simoni, por edhe Simoni mëson prej teje, që vjen nga baza. Kur vjen këtu, ti mëson pak nga ne, po edhe ne mësojmë diçka prej teje.

Kur kthehen instruktorët nga rrethet, sjellin problemet që kanë ndjekur gjatë një muaji. Nga raportit-

met e tyre gjykohet nëse kanë punuar mirë apo s'kanë punuar mirë.

Siç e di ti, shoqja Lenkë, ne, përveç instruktorëve të sektorëve, në aparatit e Komitetit Qendror kemi edhe grupet e instruktorëve të terrenit e të ushtrisë. Është mirë që edhe ti t'i dëgjosh këta kur flasin për punën në ushtri, sepse kështu edhe do të ndihmohesh, edhe do të ndihmohesh.

Nuk e di e kam drejt apo jo këtë mënyrë komunikimi? Kështu, ti shikon e mëson edhe për veten tënde në mbledhjet me shokët instruktorë. Është gjë e mirë kjo, si mendon ti?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Po, e mirë është kjo mënyrë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne duam që ti ta zgjerosh shumë horizontin, duke mësuar nga shokët e udhëheqjes së Partisë, nga Hysniu, nga Ramizi, nga Simoni, edhe nga unë, megjithëse unë nuk vete shumë në rrethe si më parë. Tani ju kemi ju të rinjtë.

Secili kuadër duhet të mendojë të përgatitë një zëvendës për kohën që vetë do të mungojë në punë. Për shembull, si të gjithë edhe ti do të vesh për pushime, por, që të pushosh me mendje të mbledhur, duhet të kesh një zëvendës. Kjo nuk do të thotë se nuk do të preokupohesh për punët kur pushon, por do të mendosh diçka më pak. Ja, ti, për shembull, duke marrë pjesë në mbledhjet me instruktorët këtu, fiton eksperiencë dhe, ta zëmë, në muajin korrik ose gusht, kur Simoni të pushojë, do të të thotë ty, shoqja Lenkë, që të bësh mbledhjen me instruktorët.

Sido që punët janë të shumta, edhe shokët sekretarë do t'i bëjnë pushimet. Megjithëse, thuaji sa të duash Hysniut që të shkojë me pushime, ai nuk shkëputet kollaj. E detyrojmë ne. Në këtë rast atë do ta zëvendësojë Ramizi, por kur Ramizi do të jetë shumë i zënë, atëherë do ta zëvendësojë Simoni, i cili, për të mbuluar punët e tjera, do të të thërresë në ndihmë ty, Lenka. Atëherë ti do të vish këtu që të ndihmosh dhe mund të ndihmosh, se do të jesh e stërvitur në këto punë. Në një rast të tillë, ty mund të duhet për një kohë të ndjekësh tërë punën e Partisë si kandidate e Byrosë Politike që je. Kështu veprojmë ne. Kur kthehet Hysniu, atëherë shkoj unë me pushime e kështu me radhë bëjmë pushimet e njëkohësisht bëjmë mirë punën e Partisë. Është e drejtë të veprohet kështu apo jo? Mendoj se është e drejtë, pasi, kur është fjala për 15 ditë apo për një muaj pushime, është i domosdoshëm dhe duhet zëvendësi.

Kështu bëmë edhe me shokun Gogo [Nushi] kur e dërguam sekretar të parë në Komitetin e Partisë të Rrethit të Beratit. Kështu do të bëjmë edhe me ty, Lenkë. Një metodë e një stil të tillë pune të duhet ta krijosh edhe ti vetë që tash atje në rreth. Të organizosh e të mobilizosh të tjerët që të punojnë, të gjesh kohë edhe për kualifikimin e vetvetes, se në Lushnjë kemi njerëz që janë të aftë e të mësuar. Me këta duhet biseduar, se kanë njohuri politike, historike, gjeografike etj. Atje ka edhe letrarë që mund të të flasin për problemet e letërsisë dhe të arteve. Ti duhet të konsultohesh me ta, do t'u kërkosh të shprehin me

këtë rast mendimet e tyre si janë trajtuar problemet në këtë ose në atë pjesë të një vepre dhe ata do të sjellin mendime. Por edhe ti vetë, pasi përgatitesh mirë, vete bisedon me ta, u jep edhe detyra. Kështu do të mësosh edhe vetë, por do të mësosh edhe të tjerët. Edhe ne, Partia dhe jeta na kanë mësuar për mjaft gjëra. Megjithatë ne përpiqemi të perfeksionohemi vazhdimisht. Si thoni, shokë, ta bëjmë kështu?

SHOKU RAMIZ ALIA: Drejt është kështu.

SHOKU HYSNI KAPO: Drejt e keni, se po të vijë Lenka këtu, do të njihet me eksperiencën e punës së Partisë në të gjithë vendin e jo vetëm në rrethin e Lushnjës. Duke dëgjuar këtu për probleme të karakterit politik, ideologjik, organizativ, ushtarak etj., që ngrenë sekretarët dhe instruktorët e Komitetit Qendror, kjo do të përfitojë shumë më tepër.

SHOKU ENVER HOXHA: Përfitimi do të jetë i madh. Ju do të shkëmbeni mendime me Simonin, me Prokopin, do t'u kërkosht atyre edhe ndonjë shpjegim. Për një problem të sferës së ideologjisë vete te shoku Ramiz dhe pa ngurruar mund ta pyesësh për çdo gjë, mund t'i kërkosht të të rekomandojë çfarë mund të studiosh në mënyrë të veçantë nga Lenini apo nga Marksi.

Çfarë gjuhe të huaj di ti, Lenkë?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Di rusisht.

SHOKU ENVER HOXHA: Libra në gjuhën ruse kemi ne, se na kishin ardhur mjaft në kohën e Stalinit, por ti duhet të mësosh edhe një gjuhë tjetër. Natyrisht, kështu të hapet shumë punë, por ti je e re, e

shëndetslime dhe e fortë. Shumë kuadro të rinj, për arsye të punës, detyrohen të lexojnë në gjuhë të huaja e jo më ti. Unë nuk them se ti nuk lexon, por shtroj çështjen e nevojës së studimit për cilindo. Edhe unë që jam i moshuar, lexoj libra, por vetëm për të udhëtuar shpesh, siç bëni ju për nevojat e punës, tash nuk kam shumë mundësi. Më thoni si të doni, më kritikoni, por unë nuk bëj dot shumë lëvizje tash. Hysniu bën një çikë më shumë nga unë, por edhe ai nuk duhet të lodhet, prandaj sikur të bashkëpunojmë një çikë kështu për këtë punë.

SHOQJA LENKA ÇUKO: Dakord, shoku Enver.

SHOKU RAMIZ ALIA: Kjo do të jetë për të mirën e Partisë, shoku Enver, në të mirën e të gjithëve.

SIOKU ENVER HOXHA: Ne, në qoftë se nuk ka, mund t'i gjejmë Lenkës një ndihmës të mirë aty në Lushnjë, me qëllim që, kur të vijë ajo këtu, ta lërë të interesohet për punën në rreth.

Duhet t'i përgatitim ata që do të na zëvendësojnë. Ti, Lenkë, je kandidate e Byrosë Politike dhe ndonjëherë mund edhe të transferohesh nga Lushnja. Partia na ka porositur që medoemos duhet të përgatitim kuadro rezervë në çdo sektor. Gjatë kësaj kohe ne do të punojmë që t'i ngremë njerëzit. Na duhen edhe kuadro të rinj, se neve po na ikën mosha. Simonin e kemi më të riun këtu. Tash ne të themi ty që të vish dy ditë në muaj, po nesër mund të të themi të vish pesë ditë, brenda vitit mund të të themi të vish për një muaj resht.

SHOQJA LENKA ÇUKO: Po të ketë nevojë Par-

tia, jam gati, nuk kam asnjë kundërshtim. Por eksperiencën që keni ju, shoku Enver, shoku Hysni, shoku Ramiz e shokët e tjerë, unë nuk e kam.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne mund të kemi një çikë eksperiencë më tepër, por edhe ti ke eksperiencë, se punon në një nga rrethet më të rëndësishme. Në punën tonë ka rëndësi të madhe çështja e drejtimit dhe e organizimit, prandaj njerëzit që ke rreth e rrotull atje mësoji mirë. Po të shprehem në mënyrë figurative, do të thosha që në qoftë se ti, aktualisht, mban në krah një peshë të caktuar, zbrit nga ajo pesë e nga pesë, dhe, duke ua ngarkuar gradualisht të tjerëve, edhe ti lehtësohesh, edhe ata mësojnë. E kam drejt këtë mendim apo jo?

SHOKU HYSNI KAPO: Drejt. Sekretarët e tjerë në Komitetin e Partisë të Rrethit të Lushnjës kanë edhe ata sektorë të caktuar që mbulojnë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ja, për shembull, Simoni, që merret me sektorët e jetës së Partisë, docmos informohet edhe për jetën e Partisë në ushtri dhe, kur bëhen mbledhje, mund të të vërë në korent ty, Hysni, për problemet që dalin në ushtri, se si ecën puna e Partisë atje. Kështu ti, Simon, dhe të tjerët do ta lehtësoni një çikë Hysniun.

SHOKU SIMON STEFANI: Prapë shumë njerëz i venë në zyrë shokut Hysni për probleme të ndryshme.

SHOKU ENVER HOXHA: I venë, po nuk duhet t'i venë më kështu. Le të mësohen shokët ta ndërrojnë pak rrugën. Kjo nuk do të thotë që Hysniu nuk do të

merret fare me këta, por ky ka ndihmës dhe, në raste kur e çmon me vend, i thërret vetë instruktorët, por vetëm për ato probleme që ai ka nevojë të komunikojë drejtpërdrejt me ata.

SHOKU HYSNI KAPO: Ka probleme që instruktorët e ushtrisë i lidhin ngushtë me instruktorët e terrenit. Sikur të marrim vetëm çështjet e mbrojtjes që ka terreni, pa zënë në gojë jetën e Partisë në ushtri, pa folur edhe për ato që thoni ju, del se instruktorët e terrenit e të ushtrisë duhet të bëjnë edhe mbledhje të përbashkëta.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, le të bëjnë edhe mbledhje për jetën e Partisë në ushtri, se janë gati identike. Kur të bëhen kështu, atëherë do të dalë nevoja që të thërritet edhe Lenka për të lehtësuar punën. Si thua ti, Lenkë?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Dakord, shoku Enver, unë duhet të kisha ardhur këtu edhe më parë, se ju dhe shoku Hysni më keni thënë që të vij e të bisedoj me ju për këto probleme.

Pastaj biseda u zhvillua rreth studimit të Eqrem Çabejt «Për pastërtinë e gjuhës shqipe»:

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk e di nëse e ke lexuar ti, Ramiz një studim të Eqrem Çabejt me titull «Për pastërtinë e gjuhës», botuar këto ditë në dy numra të gazetës «Mësuesi»¹.

Çabej, natyrisht, është shkencëtar i zoti, që jo vetëm flet me kompetencë për pastërtinë e gjuhës, por

1. Më 28 mars dhe 4 prill 1979.

problemin e trajton dhe në frymë partie. Ai shtron çështjen që të pastrojmë gjuhën tonë nga ato fjalë të huaja të cilat i kemi në shqip, por nuk i përdorim sepse ose nuk i dimë, ose se priremi nga ndikimet e huaja, se dikush ka bërë një shkollë në një vend, dikush në një vend tjetër. Përpjekja që do të bëjmë për pastërtinë e gjuhës, nuk është shovinizëm, thotë Çabej, por një detyrë patriotike që synon pasurimin e gjuhës shqipe. Ai jep aty shumë shembuj të pasurimit të gjuhës, po unë po përmend dy prej tyre. Irlanda që, siç dihet, është një ishull afër Anglisë, ka qenë koloni e Britanisë së Madhe, por është shkëputur prej saj, duke formuar Republikën e Irlandës, Eire, siç i thonë ata. Irlandezët, shkruan Çabej, kur fituan pavarësinë, hapën librat e mbyllur gjatë shekujve, të cilët i kishte zënë pluhuri dhe nxorën prej andej fjalë të moçme të popullit të tyre. Këto fjalë i bënë të njohura dhe kështu ato që duheshin zëvendësuar, i zëvendësuan.

Qemalistët i dhanë gjuhës turke një shtytje përpara, duke përdorur fjalët e saj të harruara. Një nga farkëtuesit e mëdhenj të gjuhës turke është edhe Sami Frashëri, i cili, shkruan Çabej, ka meritën se e pastroi këtë gjuhë nga arabishtja dhe nga persishtja. Sami Frashëri ka qenë filozof i shquar që e njohin të tërë, por ai ka qenë edhe një njohës i madh i gjuhës turke, ka bërë edhe enciklopedinë turke, e cila sot e kësaj dite, ka mbetur e vetmja enciklopedi e atij vendi. «Shemsedin Samiu, — thonë ata, — vërtet është shqiptar, por, për arsye se ka bërë gjithë këto vepra në Turqi, ai është yni».

Gjuha jonë e lashtë është përpunuar nga Buzuku, Bardhi, më pas nga De Rada; ajo është ruajtur tek arbëreshët etj., etj., të cilët kanë luftuar për pastërtinë e saj. Çabeji shkruan që Samiu, Naimi, Vretoja, Veqilharxhi, Xhuvani e të tjerë e kanë pasuruar gjuhën shqipe me fjalët tona, prandaj fjalët e përdorura prej tyre duhet t'i përdorim edhe ne. Por, vazhdon ai, në popull ruhen shumë fjalë e shprehje shqipe që nuk qarkullojnë, prandaj ato, së pari, duhen njohur. Dhe ai jep disa shembuj të përdorimit të fjalëve në të tëra krahinat e Shqipërisë dhe tregon si i thonë në një krahinë, si në një tjetër. Po ashtu ai thotë se këto ose ato fjalë i përdorin vetëm në disa krahina, për shembull, Shkodra, Lunxhëria, Labëria, Vlora etj.

Ai thotë, gjithashtu, se ka nga ata që gjuhën tonë kanë dashur ta paraqesin si një gjuhë të barinjve, me të cilën nuk mund të shprehen mendimet abstrakte. Kjo tezë e tyre nuk është e vërtetë, thotë ai, dhe jep një sërë argumentesh. Çabej nxjerr së fundi konkluzionin që ne duhet t'i vihemi me pasion çështjes së pastërtisë së gjuhës sonë.

Artikulli i tij, pra, ishte shumë interesant. Kemi njerëz të mëdhenj e të ditur ne.

Për sa u përket disa fjalëve të huaja, ndërkombëtare, si kimi, kibernetikë etj., sipas Çabejt nuk ka përse të shqipërohen, ato do t'i pranojmë kështu siç i ka pranuar dhe i përdor gjithë bota, ndërsa fjalët e huaja, që kanë hyrë në gjuhën tonë, por që ekuivalentet e tyre ne i kemi në shqip, t'i zëvendësojmë dhe duhet t'i zëvendësojmë. Çabej shpreh mendimin se në këtë

drejtim duhet të punojnë të gjithë, duke filluar që nga Akademia jonë e Shkencave dhe deri te mësuesit e fshatrave, të cilët të interesohen për të mbledhur fjalët e popullit. Për këtë do të na duhet, propozon ai, të botojmë edhe një revistë periodike¹.

Unë mendoj të krijohen mundësitë që Instituti i Gjuhësisë ta botojë një revistë të tillë gjuhësore. Ti, Ramiz, duhet ta thërresësh Çabejn e të bisedosh më gjerë me të për këtë çështje. Çabej përmend edhe vlerësimin që i bën librit² të Aleksandër Xhuvanit albanologu dhe gjuhëtari i shquar austriak Maksimilian Lamberg, i cili këshillon se do të ishte me shumë vlerë që ky libër të përkthehet në një gjuhë të pasur e të njohur si frëngjishtja. Këta janë libra shkencorë për dijetarët, për institutet, për bibliotekat, për njerëzit që merren me gjuhësinë etj., prandaj edhe tirazhi i tyre nuk do të jetë i madh. Pra, nuk është ndonjë gjë e madhe, por edhe sikur të kushtojë, unë mendoj se duhet nxjerrë kjo revistë shkencore.

Duke vazhduar bisedën, shoku Enver Hoxha dhe disa mendime rreth një broshure të botuar nga shoqëria «Vatra», e shqiptarëve të Amerikës.

Lexova, gjithashtu, edhe një broshurë që ka botuar federata «Vatra» e shqiptarëve të Amerikës, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Faik Konicës. Artikulli kryesor i saj është shkruar nga një bir beu, njëfarë Namik Resuli. Babanë e tij nuk e kam njohur, por

1. Revista «Gjuha jonë», që fillol të botohej më 1981.

2. «Studime gjuhësore», botuar më 1956.

aneja ime thoshte «Si babai dhe i biri, kungull e bostan çairi».

Pas urës së Mbrostarit, ku është ura e vogël e Gjanicës, në atë krah ka qenë shtëpia e bejlerëve Resulaj. Kur vajta në rrethin e Fierit për të formuar celulën e parë të Partisë, mora drejtimin e rrugës nga krahu i djathtë ku ishte kasollja e Rafael Petros, një shok i grupit. Ky qëndroi i vendosur në rrugën e Partisë, mori pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare dhe, pas Çlirimit, u zgjodh anëtar i Këshillit Popullor, për një kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Qytetit të Fierit dhe ka punuar kurdoherë me nder. Atje, te shtëpia e vjetër e tij, bëmë edhe mbledhjen e celulës. Nga ky rast më kujtohet edhe shtëpia e beut. Namik Resuli erdhi në shtëpinë e Rafaelit. Ai hiqej si dijetar i madh, por ne ia treguam vendin. Ka qenë i një moshë me Eqrem Çabejn, me Aleks Budën e të tjerë. Tani kur lexova broshurën e «Vatrës», thashë me vete: «Ç'mjerim shkencor! Si janë katandisur disa nga këta intelektualë të mërguar!

Mbase edhe ju e patë dhe e dëgjuat Aleks Budën kur foli në televizor për 100-vjetorin e lindjes së Aleksandër Moisiut. Brenda një çerek ore ai e paraqiti Aleksandër Moisiun të gjallë; foli për madhësitinë e tij si artist e deri për ndjenjat e tij humanitare dhe patriotike. Ai mund të fliste edhe tërë ditën për Aleksandër Moisiun dhe të mos i mërziste aspak dëgjuesit.

Namik Resuli, që është «profesor» i gjuhës shqipe në universitetin e Romës, na hiqet si një nga dijetarët

më të shquar në radhët e tradhtarëve, që jetojnë jashtë atdheut. Ky nga ana shkencore, në krahasim me dijetarët tanë, është shumë poshtë, pa folur për të si antishqiptar. Çfarë thotë ai në atë broshurë prej 25 faqesh? Në thelb shprehet kështu: «Do të flas për Faikun, që ka qenë njeriu më i madh, më i larmishëm, më i madhërisëm, më patriot, më diplomat i Shqipërisë! Ka qenë lëvruesi i madh i gjuhës shqipe, që ka parashikuar perspektivën e saj dhe ka luftuar më mirë nga të gjithë për të!».

Në broshurë flitej edhe për të tjerë «të madhërisëm» që ishin «kripë» fare, të cilëve as emrat s'ua kisha dëgjuar ndonjëherë.

«Ka njerëz që e akuzojnë Faikun si bej, — shkruan ai, — por Faiku ka qenë bej me kulturë dhe kulturë e tij nuk mund të krahasohet me kulturën e dervishëve!». Kuptohet se «dervish» për Faik Konicën dhe për Namik Resulin është Naim Frashëri. Tradhtari Namik Resuli meritat e mëdha të Naimit, që është një nga dijetarët dhe përfaqësuesit më të dalluar të lëvizjes kombëtare shqiptare, patriot i flaktë dhe figurë e shquar e letërsisë shqipe, kërkon t'ia atribuojë Faik Konicës. Ai shkruan me paturpësi në këtë broshurë se Faik Konica na paska qenë «udhëheqësi» i rilindësve të periudhës së dytë. Periudha e parë është Rilindja që dimë, por që tradhtari e quan me cinizëm «rilindja e dervishëve», kurse periudha e dytë, sipas tij, është ajo e një kulture të re oksidentale. «Faiku, — shkruan beu injorant, — ishte njeri i kulturës franceze, austriake, gjermane, për të cilën Shqipëria ki-

shte absolutisht nevojë». Dijetarët e poetët e mëdhenj të Orientit, si Saadiu me shokë, që ai injorant nuk i zë në gojë, se nuk i njeh, për të janë «dervishë». Ai mendonte se për Shqipërinë kishte më tepër vlerë kultura e poetëve francezë, si e Verlenit, e Rembosë dhe e Bodlerit.

Po ç'janë këta poetë? Të lexosh poczitë e Bodlerit e të Verlenit, nga ana e formës ato janë shumë të mira, po cila ishte brendia e shkrimeve të tyre? Disa pjesë të shkrimeve të tyre në formë janë të bukura, por në përmbajtje të shëmtuara. Bodleri, për shembull, ka shkruar me një dashuri të ekzaltuar për skenat e pijetoreve e të kafeneve, ku venë e strehohen të dehurit dhe gratë e rrugëve. Këtë kulturë kërkonte të na sillte këtu ky farë Namik Resuli! Po pse i gjeti Namik Resuli këta poetë, kur Franca ka shkrimtarë të mëdhenj, ka filozofë të shquar? Ka zgjedhur këta, se me ta e lidh botëkuptimi reaksionar me të cilin ai është brumosur, se të tjerët s'i duheshin atij.

«Faikun, — shkruan ai, — e akuzojnë se ishte proaustriak» (këtu e ka fjalën për ne, se në një vend përdor shprehjen: «ata të Tiranës») dhe meqenëse nuk ka argumente për të kundërshtuar këtë të vërtetë, thotë: «Pse, me sëpatën e drunjtë do të dilte Shqipëria nga prapambetja?». Më poshtë shton se Shqipëria duhej të mbështetej doemos në një shtet të fuqishëm evropian dhe ky shtet, ku mund të mbështetej në atë kohë, ishte Austria, se vetëm kjo e donte Shqipërinë, për arsye të katolicizmit të Shkodrës! Pastaj tregon se

Faik Konica ka qenë nxënës i kolegjit të jezuitëve dhe herë pas here bisedonte me kontin Berton, ish-ministër i Jashtëm i Austrisë, dhe me Soninon e Italisë. Me këto që shkruan, antishqiptari kërkon t'u mbushë mendjen lexuesve se edhe ajo që bën tani vetë ai për t'u mbështetur tek Italia s'është një vepër e keqe, se Shqipëria nuk bën dot pa u mbështetur diku! Ja përse e mburr ai Faikun, gjoja si një mendimtar të madh, diplomat të shquar etj.

Ai thotë se Faiku vërtet i shërbeu një regjimi të kaluar, por thekson: «Duhet ta kuptoni, o lexues, se ai i shërbeu regjimit të kaluar, duke menduar se kështu i shërbente Shqipërisë!»! Çfarë «shkencëtari»! Merr guximin ta quajë shërbëtorin e të huajve «mbrojtës të Shqipërisë»!

Faiku me përçmim i quante përfaqësuesit e vërtetë të popullit «poturexhinj», nga poturet që mbanin fshatarët, se vetë ishte beu i salloneve.

Ai me paturpësi shtron pyetjen: «Pse akuzojnë Faik Konicën për antishqiptar, kur këtë gjë duhet ta bëjnë për Sami Frashërin, i cili s'ka dashur kurrë që Shqipëria të jetë e lirë, por që të jetë kurdoherë nën sundimin e qeverisë turke?». Dhe shton: «As Vaso Pasha s'e ka zënë kurrë në gojë çështjen e çlirimit të Shqipërisë!». Shikoni gjer ku vete urrejtja e tradhtarit për patriotët e mëdhenj e të vërtetë të Shqipërisë!

SHOKU RAMIZ ALIA: Naimin e Samiun as regjimi satrap i Zogut nuk ka guxuar t'i atakonte. Ky

Namik Resuli është kundër patriotëve tanë të mëdhenj, siç është, natyrisht, edhe kundër Partisë sonë, që mbron të kaluarën e lavdishme të popullit tonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ashtu është.

Kur lexova këtë pjesë, u indinjova dhe e hodha tej atë broshurë paçavure.

Merreni me mend sikur populli shqiptar të rron-te akoma nën thundrën e këtyre antishqiptarëve, të këtyre të shiturve, bij bejlerësh, që e kishin shtypur popullin deri në palcë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Para nja katër ditësh Radio Vatikani transmetoi një shkrim të Namik Resulit, në të cilin i paraqet të gjithë priftërinjtë katolikë shqiptarë e italianë si mbrojtës të gjuhës shqipe.

SHOKU ENVER HOXHA: Namik Resuli zinte në gojë në shkrimin e tij edhe Gjergj Fishtën, për të cilin shkruante se nuk përmendet vetëm për një «incident të vogël» që i ngjau në jetën e tij, kur u bë senator i Musolinit. Këtu ai na e hedh fajin neve që gjoja pa të drejtë nuk e paskemi vlerësuar Fishtën. Një «incident të vogël» e quan ky «dijetar» bashkëpunimin me pushtuesit fashistë!

Këta parazitë rrojnë atje si agjentë të borgjezisë fashiste italiane, marrin para dhe, bëjnë nja dy orë «leksione» për gjuhën shqipe në universitetin e Romës, shkojnë ngandonjëherë tek arbëreshët në Kalabri, në Kozenca, dhe rekomandojnë bibliografinë për «librat» që kanë bërë dhe që s'janë tjetër veçse nja katër a pesë artikuj për gjuhën shqipe, si dhe nuk lënë rastin pa atakuar Shqipërinë dhe historinë e saj. Të tillë

njerëz, që nuk duan vendin e tyre, që sulmojnë patriotët e vërtetë, ndërkohë që u thurin himne «shërbëtorëve të shumë zotërinjve», janë të neveritshëm.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e incizuar, që gjendet në AQP*

PA KËRKESË LLOGARIE, PLANI NË NAFTË NUK REALIZOHET NË KOHËN E DUEJUR

*Nga biseda në takim të ditës së sekretarëve
të KQ të PPSH*

9 prill 1979

Është thënë që i gjithë aparati i Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave të merret me problemet e naftës dhe parimisht është e ditur që kështu duhet vepruar. Por të mjaftohesh vetëm duke e thënë këtë nuk ka asnjë vlerë. Parimet, ka vënë në dukje Stalini, janë shumë të mira, por, po nuk u organizua puna për t'i vënë ato në jetë, nuk zbatohen. Pra, një fjalë goje është të thuhet «të merren», por me se do të merren konkretisht ministria dhe drejtoritë e saj? «Të merren me naftën», na thuhet, dhe, në këtë kuadër, kërkohet që Drejtoria e Mekanikës në ministri, që ka katër inxhinierë mekanikë, t'ia japë një ose dy prej tyre Drejtorisë së Naftës, që ka një inxhinier mekanik. Kjo nuk është aspak e drejtë! Në një kohë kur sektori i naftës ka me mijëra mjete mekanike, Drejtoria e Naftës ka vetëm një inxhinier mekanik. Nuk themi që në Drejto-

rinë e Naftës të ketë dhjetë inxhinierë mekanikë, se kjo, drejtori është dhe jo kombinati i autotraktorëve «Enver Hoxha», ku puna është më e grumbulluar, më e përqendruar. Por, medoemos duhet të ketë më shumë se një, sepse është për tërë republikën, për të gjitha rrethet ku ka naftë. Në këtë drejtori, natyrisht, nuk mund dhe as nuk lejohet të grumbullohen të tërë inxhinierët që ka sektori i naftës, sepse të shpërndarë nëpër ofiçina, inxhinierët e bazës i shërbejnë më mirë punës në këtë sektor.

Studimi i strukturave organike, i numrit të kuadrove dhe i nevojave që kanë ata duhet të bëhet konkretisht, në mënyrë që të kemi një shpërndarje proporcionale të tyre, sepse vetëm me parime nuk mund të zgjidhen tërë problemet e mëdha shtetërore; kështu nuk do të dalim dot gjëkund. Parimet janë me rëndësi të madhe, por ato duhet t'i zbërthejmë dhe të japim udhëzime se si të veprohet e të merren masa konkrete tekniko-organizative që ato të zbatohen. Ndryshe nuk ecet përpara.

Për sa i përket modifikimit të sondave për rritjen e kapacitetit të tyre nga 3 000 në 3 500 metra, që u tha këtu, është një gjë e mirë, po si është gjendja e sondave të tjera? Kam përshtypjen që s'është e mirë, se me siguri, tash, meqë po bëjnë sondën e madhe, i kanë lënë mënjanë të gjitha punët e tjera. Kjo, siç the ti, shoku Hekuran, ka ndikuar për keq edhe në cilësinë e gjithë detaleve e pjesëve të këmbimit që prodhohen për sondat në punë, prandaj, për këtë çështje, t'i kërkohet

Qeverisë që të merren masa për vënien në përdorim të të gjitha sondave të naftës.

Lidhur me sondën e re që po prodhohet në Uzinën Mekanike të Qytetit Stalin, natën ka shkuar Mehmeti atje për këtë çështje dhe punëtorët i thanë se janë gati ta prodhojnë vetë sondën. «Ama jeni gati ta bëni? Atëherë hajdeni, — u tha Mehmeti, — ta bëjmë sondën e madhe!».

Shumë mirë, përse ta blejmë 7 milionë atë (se 7 milionë kushtonte ajo sondë më përpara), kur mund ta prodhojmë vetë? Mirëpo, pas kësaj, atyre u duhej vënë në dukje (gjë që edhe Mehmeti duhej ta kishte bërë) që vërtet sondën e madhe do ta prodhojmë, por edhe këto që kemi do t'i riparojmë dhe kryesisht me riparimin e tyre duhet të merren Uzina Mekanike e Patosit dhe ajo e Qytetit Stalin, duke kooperuar me njëra-tjetrën. Pra, në radhë të parë, këtyre dy uzinave duhet t'u vihet detyrë riparimi i sondave dhe t'u kërkohet llogari për zbatimin dhe kryerjen e kësaj detyre. Tash, për këtë çështje, duhet të bisedohet me Mehmetin, për arsye se ai u ka dhënë urdhër ta bëjnë këtë sondë dhe ata i kanë dhënë fjalën që ajo do të jetë gati në maj, pra pas disa javësh. Por, në qoftë se ata do ta shtyjnë këtë çështje tej muajit tjetër, atëherë duhet të shkohet te Mehmeti me llogari të bëra dhe t'i tregohet se sondat rrinë pa punë për arsye se kanë nevojë të riparohen, t'i thuhet atij se, po të vihen të gjitha këto në punë, ne do të kemi një fitim prej 100 milionë dollarësh në vend të dy milionë e gjysmë do-

llarëve që do të na kursejë prodhimi në vend i sondës së re të shpimeve të thella.

Kështu, me llogari të përpikta duhen bërë këto punë dhe nuk ka këtu «na ka thënë Mehmet Shehu». Duhet të veprohet ashtu si të jetë më mirë për ekonominë e vendit tonë. «Kemi këtë porosi të Mehmetit», mendojnë shokët e uzinave mekanike të sektorit të naftës dhe rroftë se bëpi, si i thonë një fjale, për të «mbulluar» me atë të metat këtu e atje¹. Tani ata vënë përpara ndërtimin e sondës së re dhe të gjitha të tjerat i lënë pas dore. Prandaj, shoku Hekuran, shikoji mirë këto çështje, cakto njeri për të parë se sa inxhinierë mekanikë i duhen kësaj drejtorie dhe të plotësohen këta, me qëllim që të bëhet puna si duhet. Në qoftë se i duhen edhe dy apo tre të tjerë, për shembull, ti kërkoji kuadrit të Komitetit Qendror aq inxhinierë mekanikë sa të nevojiten për punën. Për sistemimin e familjeve të tyre e të gjitha të tjerat merreni përsipër t'i rregulloni vetë.

Uzinës Mekanike të Qytetit Stalin, asaj të Patosit, si dhe të gjitha uzinave të tjera mekanike që ekzistojnë në sistemin e naftës t'u ndahen mirë detyrat se çfarë duhet të bëjnë. Atij që është përgjegjës kryesor t'i thuhet se për çdo punë të përfunduar duhet të rapor-

1. Siç u vërtetua më vonë, armiku Mehmet Shehu nuk i bënte të gjitha këto nga «shqetësimi» për punën, por nga motive krejt të tjera: nga mania për t'u dukur e për bujë, për t'u hequr se i di të tëra, dhe, para së gjithash, për të sabotuar realizimin e planeve në ekonomi, si pjesë përbërëse e gjithë veprimtarisë së tij armiqësore.

tojë, duke dhënë saktë edhe gjendjen e mjeteve të ndryshme teknike. Për këtë, shokëve që i kryejnë këto punë, t'u lihet në dispozicion aq kohë sa mendojnë ata, bile t'u lihet edhe njëfarë kohe rezervë. Për t'u dalë mbanë punëve praktikohet kooperimi edhe me ndërmarrje të rretheve të tjera, mbasi vetëm nuk ia dilni dot.

Ju, Hekuran, mund të lidheni e t'u kërkon drejtuesve të këtyre ndërmarrjeve, si, për shembull, shokut Pilo Peristeri, apo drejtorit të uzinës «Dinamo», atij të Institutit të Projekttimeve Mekanike e të tjerë, që, në bazë të kooperimit që kanë me Uzinën Mekanike të Naftës për një numër detalesh, t'i bëjnë gati në kohën e duhur dhe bile ca më shpejt që puna të mos pengohet, por të shkojë zinxhir. Këto ndërmarrje të fuqishme kanë mundësi t'u përgjigjen në një kohë të shkurtër sepse kanë rezerva, prandaj duhet të insistoni për këtë.

Të tëra punët në sektorin e naftës kanë lidhje me njëra-tjetrën; ndërtimi i rrugëve, i bazamenteve, dhënia e pikave të shpimit mirë e në kohë, që i kërkon vënia e sondave në shfrytëzim, përbëjnë një problem të tërë. Rrugët në këto zona, për të cilat janë caktuar edhe afatet, bëhen për të transportuar bazamentet dhe për të çuar sondat te pikat. Kështu që tash duhet rregulluar koha e riparimit të sondave që ato të jenë gati e të çohen në pikat e caktuara në afatin e duhur.

Pas këtyre duhet parë çështja e pajisjeve të tjera që nevojiten për puset, siç janë tubat. Njëherë duhet filluar me tubat e parë, se ka edhe tuba të dytë e të

tretë. Apo jo? Dhe, për këto, bashkë me drejtorin e ndërmarrjes ku prodhohen tubat, të caktohet grafiku. Por, tubat janë për naftë, pra nuk duhen vetëm për Qytetin Stalin, se naftë s'kemi vetëm atje.

Pra, gjithë çështja qëndron këtu, që punonjësit e këtij sektori të mësohen t'i rregullojnë në mënyrë sistematike punët, sepse nxjerrja e naftës, nga a-ja e deri te zh-ja, ka një numër procesesh. Mirëpo, kemi konstatuar se në këtë sektor, ku proceset janë të lidhura me njëri-tjetrin si hallkat e një zinxhiri të vetëm, nuk ka rregull, nuk ka përgjegjësi, nuk ka lidhje e koordinim të punëve midis ndërmarrjeve të ndryshme, prandaj ndodh që njëri i bie gozhdës, tjetri potkoit.

Të tëra problemet duhen parë e duhen zgjidhur me kohë. Deri tash mjaft kuadro drejtues në sektorin e naftës nuk e kanë vënë shumë ujë në zjarr, prandaj ka pasur dhe mosrealizime. Të kihet parasysh se tani që u krijua komisariati, mund të ketë nga drejtuesit e naftës që të lajnë duart nga përgjegjësia dhe t'ia lënë atij në kurriz.

Edhe shokët e ministrisë duhet të shkojnë në bazë dhe të rrinë atje, në vendet përkatëse, derisa të planifikohen të gjitha këto detyra. Kur të kenë punë, atëherë le të vijnë në Tiranë, se, natyrisht, edhe këtu ka punë, por në plan të parë duhet vënë puna në bazë. Drejtorive të sektorit të naftës në Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave t'u caktohen detyra, për zbatimin e të cilave të mbajnë përgjegjësi.

Një problem tjetër është çmontimi dhe zhvendosja e sondave nga një vend në një tjetër. Edhe për

këtë çështje të jepet urdhër i prerë. Le të nxjerrin arsye sa të duan ata që janë përgjegjës për këtë punë, komisariati t'u llogaritë mirë kohën që duhet për çmontimin e sondës e për transportimin e saj dhe t'u kërkojë llogari. Natyrisht, në disa raste ka edhe gjëra që nuk varen nga drejtori i ndërmarrjes së naftës, por nga ministria, së cilës i duhet kërkuar të zbatojë detyrat që i përkasin.

Këtu u tha se për një varg pusesh, ku puna është lënë në mes, u janë vënë detyra shokëve të institutit që t'i studiojnë edhe një herë me përgjegjësi, punë që ata duhet ta kishin bërë mirë që më parë. Sidoqoftë, shokët e institutit, për këto fusha të studiuara e për këto struktura të njohura, duhet të na japin me shumë përgjegjësi planin e pusit. Urdhrin apo vendimin e komisariatit shokët e institutit do ta zbatojnë në bazë të një plani. Këta, herë pas here, duhet të venë te pushi dhe të caktojnë një grafik pune, jo të japin urdhra, por të marrin informata, të marrin të dhëna dhe t'i studiojnë këto me qëllim që t'i udhëzojnë punonjësit e pusit se si të veprojnë. Shokët e institutit kanë përgjegjësi në dhënien e pikave, në studimin e strukturave të pusit në bazë të shpimit etj., kurse punonjësit e pusit, kanë përgjegjësi për zbatimin e planit të projektit në kohë dhe pa avari. Po kështu këta kanë përgjegjësi edhe për të gjitha të tjerat, për bazën mekanike, për kanxhat, për futjen e tubave në pus, për avaritë etj., etj. Në të tëra proceset duhet shkuar drejt perfeksionimit. Domethënë, në qoftë se pushi është caktuar të vihet në shfrytëzim për tre muaj, ata duhet ta bëjnë

mirë dhe shpejt këtë punë, që, po të ketë mundësi, shfrytëzimi të fillojë edhe më përpara afatit.

Një metodë e tillë pune do të bëjë që të rritet kërkesa ndaj njëri-tjetrit dhe kjo punë të vejë zinxhir. Pra, ai që është sondator e njeh mirë sondën ose tubat dhe, kur shikon që ato janë të një cilësie të dobët, t'i thotë kryesondatorit ose inxhinierit se këto sonda e tuba nuk vlejnë. Kryesondatori duhet të ngrihet përnjëherë, të kontrollojë gjendjen e tyre dhe, në qoftë se thotë që bëjnë, atëherë, si mendimi i tij, edhe ai i punëtorit sondator, të shënohen në dokument, që, sido të ndodhë, përgjegjësia të jetë e qartë. Nëse inxhinieri është i të njëjtit mendim me punëtorin, ngrihet e shkon në drejtorinë e shpim-kërkimit për të kërkuar tuba të cilësisë së mirë. Atje mund të ndodhë që t'i thonë se në vendin tonë nuk ka tuba të një cilësie më të mirë. Në këtë rast ky të kthehet e t'i thotë punëtorit, me plot përgjegjësi, që tuba të tjerë nuk kemi, prandaj do të punoni me këta që kemi, duke bërë kujdes të madh.

Në këtë mënyrë, shokë, ndahet mirë edhe përgjegjësia. E them këtë, se në majë të gjuhës i kanë ca njerëz fjalët: «Punëtori e ka përgjegjësinë». Por, kur veprohet siç thamë, atëherë ndryshon puna e u thuhet edhe të tjerëve se «Përgjegjësi ke edhe ti kryesondator, edhe ti inxhinier, edhe ti drejtor, edhe ti shoku i Qeverisë, që ke në vartësi këtë sektor të ekonomisë e që ke porositur tuba të papërshtatshëm; punëtorët jua kanë thënë mendimin e tyre për tubat, për sondat apo për diçka tjetër, por ju nuk kemi marrë masa-

Përgjegjësi ka edhe Instituti i Naftës dhe i Gazit kur jep struktura jo të studiuara. Prandaj, dhe këtij duhet t'i kërkojë llogari përgjegjësi i pusit, i cili ka gjeologun e tij te pusi, që vërteton saktësinë e studimit të strukturës, jo vetëm kur nuk i del, por që kur dyshon për strukturën e dhënë nga instituti. Në rastin e fundit t'i thuhet institutit se «Këtu mendoj që keni gabuar dhe që tash do ta vë në dijeni Qeverinë për këtë çështje, për arsye se kam shkuar rreth 1 000 metra në thellësi dhe s'më ka rezultuar gjë; prandaj të ndalemi e ta studiojmë mirë strukturën që të mos bëjnë 4 000 metra kot. Kësaj i thonë të varrosësh kaq e aq para dhe të mos nxjerrësh naftë».

Gjeologët e strukturës duhet t'i kenë fort të qarta të gjitha këto punë dhe në çdo pesë apo në çdo një metër shpim të marrin shllamin dhe ta futin në qeska. Pasi këtij t'i bëhet analiza në laboratorin e zonës ose në laboratorin e përgjithshëm të institutit, të dhënat e analizave t'i shkruajnë, që kur të shkojë atje, fjala vjen, drejtori i Institutit të Naftës, t'i thuhet: «Kjo është struktura e studiuar nga ju. Analiza tregon që deri tani nuk kemi as gaz, as naftë». «Vazhdo shpo», mund t'i përgjigjet shoku i institutit dhe përgjegjësi i pusit do të vazhdojë, por, në këtë rast, përgjegjësinë do ta ketë instituti. Natyrisht, studimet mbi strukturat nuk mund të përrputhen 100 për qind me projektin, më duket mua, por, sidoqoftë saktësia e tyre duhet kontrolluar me shumë përgjegjësi.

Duhet pasur parasysh të gjitha çështjet organizative, në lidhje edhe me ato teknike, duke u nisur nga

parimi që të nxjerrim naftë sa më shpejt, sa më shumë dhe që të na kushtojë sa më lirë. Që të zbatohet direktiva e Partisë, kjo duhet të shoqërohet me çdo kusht me një organizim të përsosur në shkallë të lartë. Kjo kërkon që të tërë të jenë në këmbë, të tërë të marrin përgjegjësinë që u takon. Përgjegjësitë janë të lidhura, janë hallka të një zinxhiri. Këtë metodë punë duhet t'ua futim në shpirt njerëzve, ndryshe do të ketë pengesa të shumta; gjatë rrugës do të bëhen sabotime; do të ketë shfajësime e autokritikë sa të duash, kurse naftë, në fakt, nuk do të kemi.

Natyrisht, në një ditë nuk e realizojmë dot qëllimin tonë; nuk bëhen me një të thënë të gjitha këto që kërkojmë; përkundrazi, duhet bërë një punë e madhe për këtë qëllim. Por, ajo që dua të vë në dukje është se, në radhë të parë, duhet të jemi jashtëzakonisht rigorozë në kërkesat tona për zbatimin e vendimeve të Partisë e të Qeverisë. Të kuptohet mirë kur themi që përgjegjësitë janë të lidhura zinxhir, që nga baza deri në ministri. Kurrë të mos harrohen funksionet e ministrisë, përgjegjësitë e saj dhe përgjegjësitë e shokëve të bazës.

I them këto se më përpara ne kishim Drejtorinë e Përgjithshme të Naftës me drejtor Lipe Nashin. Në atë kohë ministria ia kishte lënë në dorë të gjitha punët e naftës Lipe Nashit, i cili bënte si donte, kurse vetë shokët e ministrisë nuk çanin kokën fare; venin e vinin në vendburimet e naftës, jepnin nga një mendje dhe largoheshin. Kështu që për gjithçka vendosnin pastaj Lipja me armikun tjetër Koço Plaku, me iksin e me

ipsilonin, sipas oreksit. Dhe ata na bënë atë sabotim, që e dimë. Tani, që për çështjet e naftës e të gazit ne krijuam një komisariat të posaçëm, i cili do të veprojë për të forcuar punën, mund të përpigjet ndonjë që komisariatit ta konsiderojë si një drejtori të veçantë të ministrisë, një drejtori tampon ose jastëk, domethënë, në qoftë se s'u del naftë, fajin t'ia lënë në dorë atij. Kjo, medoemos, duhet mënjeluar! Drejtuesve të naftës, që në fillim, t'u bëhet e qartë që komisariati nuk është tampon jastëk, por qëndron mbi të gjithë ata. Ai do t'i kontrollojë e do t'i udhëzojë, por edhe masa do të marrë kundër tyre, në qoftë se nuk do t'i përvishen punës seriozisht, në qoftë se nuk do të respektojnë rregullat në fuqi etj., etj., se s'duhet të harrojmë që kemi një përvojë të hidhur pune në sektorin e naftës, nga e cila kemi nxjerrë mësim. Komisarati u krijua për të ndihmuar e për të kontrolluar punën në sektorin e naftës, por, po qe se atje nuk veprohet siç kanë vendosur Komiteti Qendror dhe Qeveria, në bazë të rregullave e udhëzimeve, do të merren masa. Komisarati do t'u hedhë dorën, do t'u japë ndihmë kuadrove e specialistëve të naftës për organizim e për kontroll, që të zbatohen drejt vendimet, sepse shoh që atje ka çrregullime, ka lëshime, ka oportunitet, ka liberalizëm. Këto gjëra nuk do t'i lejojmë; për këtë, të tërë, duhet të vënë rregull e disiplinë të fortë, kudo në çdo sektor.

Për sektorin e naftës ne krijuam komisariat, por nuk mund të mjaftohemi me këtë. Tash duhet menduar se cilat janë pikat kyç të industrisë së naftës, se ky sektor ka shumë halle; duhet menduar për strukturën,

për organizimin dhe për riorganizimin e punës, pastaj të ngulim këmbë edhe për metodën e punës që duhet të praktikojmë atje.

Kështu, edhe ata komunistë që nuk e kryejnë si duhet detyrën, por mbahen me të madh, duke u nisur nga mendimi «Kam tescrën e kuqe dhe nuk më luan as topi», do të vihen mirë në lëvizje. Të mbash tescrën e kuqe në gji do të thotë të jesh i disiplinuar, të kryesh në mënyrë të përsosur detyrën, të jesh i ndershëm dhe i palodhur në punë etj., etj. Drejtuesit duhet të jenë atje ku puna çalon, që t'i vënë në lëvizje masat për realizimin e detyrave dhe, kur këto të kryhen, t'ia vënë mirë gishtin kokës e të reflektojnë si u bë e mundur një gjë e tillë që kjo punë të mos mbetet vetëm si një fushatë, por të përgjithësohet. Pse, vetëm për të mbajtur fjalime e për të dhënë flamurë janë këta njerëz? Pse, vetëm sa të thotë «merre flamurin» dhe të puthet e të përqafohet me njerëzit na duhet kryetari?! Fjalët që thatë, për shembullin e më të mirit, jo për këtë, jo për atë, po nuk punoi ai si duhet, nuk pijnë ujë. Shembulli i më të mirit konkretizohet në goftë se kryetari i bashkimeve profesionale shkon në ndërmarrje, bisedon me punëtorët pararojë, jep mendime se si duhet të veprojnë dhe të tjerët dhe kërkon e lufton që të realizohet zbatimi i tyre. Ja, këto duhet të vëre në jetë ai.

Por kur duhet të vejë ky atje? Në momentin që po realizohen masat që ka marrë një skuadër shembullore, me qëllim që edhe skuadrat e tjera të arrijnë rezultatet e saj. Në goftë se shkon pas të vjelave, siç

i thonë një fjale, aha, mbaroi puna! Pikërisht këtu duket zotësia e komunistëve dhe e kuadrove tanë, që t'u dalin punëve përpara. Ata duhet të vrasin mendjen dhe të thellohen në shkaqet që në një ndërmarrje bujqësore normat realizohen 54 për qind, në një kohë kur atje tri-katër brigada, që punojnë në kushte të njëjlojta me të tjerat, i kanë përfunduar punimet në kohë dhe me cilësi. Pra, kuadri drejtues tërë kohën të punojë për të zbatuar vijën e Partisë e të jetë i preokupuar për prodhimin e për punonjësit, ndryshe s'e kryen si duhet detyrën.

Partia duhet t'i mësojë dhe t'i orientojë vazhdimisht kuadrot e saj, t'i mbajë ata në një drejtim dhe disiplinë të fortë. Komiteti i Partisë të mos mjaftohet me punën e një instruktori që merret me organizatat e masave, por të dijë ta vërë në lëvizje gjithë atë aktiv të gjerë të këtyre organizatave, sidomos në objektet më të rëndësishme ku realizimi i detyrave, më tepër se kudo, shtrohet në mënyrë urgjente. Në këto duhet të përqendrohet vëmendja e komiteteve të Partisë, që të vënë në lëvizje masat, të zhvillojnë iniciativën e tyre krijuese. Vetëm në qoftë se organizohet puna kështu, atëherë themi se udhëheqja e Partisë është në krye të detyrës, pra, kur për problemet thelbësore mobilizon gjithë komunistët dhe masat. Këta janë ata që realizojnë planet, që bëjnë revolucion në çdo gjë, por ky revolucion duhet të udhëhiqet si duhet nga Partia.

Për sa u përket masave që ka marrë komisarati në Cakran dhe në Vlorë, mendoj se mirë ka vepruar.

Tash të bëhen përpjekje që puna të vihet në vijë edhe gjatë. Pastaj komisariati t'u rikthehet edhe një herë zonave që ka kontrolluar, të shohë ç'po bëhet me vendimet që janë marrë, ecin apo nuk ecin punët, ku pengohen ato etj. Se duhet të pranojmë që edhe pengesa do të ketë, nuk do të ecë çdo gjë si sahat. Prandaj, edhe ndihmë do të duhet t'u jepet shokëve të sektorit të naftës.

Të mos harrohet as çështja e rishikimit të punës së Institutit të Naftës dhe të Gazit. Natyrisht, atje, natyra e punës ka karakter më shkencor, pse ke të bësh me një grup intelektualësh, me një grup specialistësh, të cilët kanë në kokat e tyre teori të mira, por disa mund të kenë edhe «lakra»; prandaj, kontrolli i punës atje është pak më i zorshëm. Pra, në institut, duhen diktuar pikëpamjet e drejta të njërit e të tjetrit dhe. për disa gjëra, duhet mbështetur në sqarime që mund të të japin ata që gjykohet se nuk mendojnë keq, por arsyetojnë mirë, më pozitivisht nga të tjerët. Përveç kësaj, duhet të shihet më me vëmendje edhe çështja e strukturës organike të institutit, nëse mund dhe duhet t'i bëjmë ndonjë ndryshim apo jo.

Pastaj, pasi t'i kemi vënë mirë në rrugë punët për zonat e njohura, do të hidhemi më tej, në të panjohurat. Fillimi i punës është më i vështirë, përparon më me zor, por më pas, kur ajo vihet mirë në binarë, zhduken edhe vështirësitë e fillimit. Prandaj të hidhemi pak më tej, të shkojmë në ato fusha që do të përgatitim për të ardhmen, për perspektivën, për të parë ç'po bëhet, qysh po punohet në këtë drejtim etj., etj. Naty-

risht, për bazën materiale të nevojshme përgjigjen ata të prodhimit, por komisariati, pasi t'i njohë situatat, duhet të bisedojë edhe me shokët e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave për zbatimin e detyrave të caktuara. Fjalën e kam këtu, që komisariati të mos e ngarkojë veten me ato gjëra që duhet t'i bëjnë të tjerët. Këtyre t'u kërkohet llogari deri në një për ato detyra që duhet të kryejnë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda e
incizuar, që gjendet në AQP*

PUNA E PARTISË TË JETË NË NIVELIN E KËRKESAVE TË KOHËS

*Nga biseda në takim in ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

11 prill 1979

Për të dy problemet që u trajtuan në seminar¹, si për sjelljen e gjakut të ri në Parti, ashtu dhe për pastrimin e radhëve të saj, kemi folur edhe herë të tjera. Partia ka punuar vazhdimisht në këto drejtime për arsye se këto janë probleme kryesore për të, mbasi e përtërijnë dhe e forcojnë.

Partia kërkon nga anëtarët e saj që, gjatë gjithë kohës, të zhvillojnë një punë tepër revolucionare. Natyrisht, kjo kërkesë realizohet konkretisht në punën e përditshme që ata bëjnë. Prandaj komitetet e Partisë të rretheve, dhe sidomos organizatat-bazë, ta ndjekin nga afër punën e çdo komunisti, sepse nëpërmjet saj

1. Në këtë seminar, që u zhvillua në Tiranë, morën pjesë sekretarët e komiteeve të Partisë dhe sekretarët e komiteeve të rinisë të rretheve: Tiranë, Elbasan, Korçë, Kolonjë, Librazhd dhe Gramsh.

dalin në pah virtytet ose të metat, aftësitë mendore, ngritja politike dhe ideologjike e secilit.

Puna politike dhe ideologjike që zhvillon Partia e përgatit komunistin në dy drejtime: së pari, për të forcuar tek ai ndërgjegjen dhe ndjenjën e përgjegjësisë për kryerjen e detyrave që i ngarkohen; së dyti, për t'i bërë anëtarët e Partisë sa më të ndërgjegjshëm. që jo vetëm ta marrin këtë edukatë, por nëpërmjet punës që do të bëjnë vetë, të përpiqen që ta zgjerojnë atë.

Në përgjithësi, anëtarët e Partisë luftojnë me të gjitha forcat për realizimin e detyrave që u janë ngarkuar në sektorin ku punojnë. Natyrisht, për kryerjen mirë të detyrës, rol të rëndësishëm luajnë shumë faktorë, siç janë ngritja e nivelit ideologjik e politik dhe e shkallës së ndërgjegjes në punë, por rol luan edhe ana ekonomike, e cila nuk mund të neglizhohet. Shteti ynë i diktaturës së proletariatit e ka përcaktuar qartë që te ne barazim nuk ka, secili shpërblehet sipas punës që bën. Ata punonjës që dallohen në punë dhe i tejkalojnë detyrat, marrin më shumë. Pra, përveç stimulit moral, edhe ai material ndikon në këtë drejtim. Por ngritja e nivelit politik-ideologjik e bën punëtorin të ndërgjegjshëm për kryerjen e detyrave, që ai të mos vërë në plan të parë interesin material. Dhe për një njeri që e kupton politikisht kryerjen e detyrës, interesi moral, i padukshëm, është më i fortë, gjë që shprehet në punë dhe në rezultatet e përgjithshme.

Edhe kur flasim për problemin e pranimeve në Parti, duhet të kemi parasysh si ngritjen politik-ideo-

logjike, ashtu dhe zbatimin e detyrave shtetërore. E them këtë se të gjithë e duan Partinë, por jo të tërë pranohen në radhët e saj. Ky është një realitet dhe këtë ta kuptojnë mirë. Në Parti pranohen ata që i kanë kushtet. Ka nga këta që kërkojnë të hyjnë në Parti, ka edhe ndonjë që mendon se «edhe pa qenë në Parti unë i zbatoj disa norma dhe direktivat e saj, prandaj përse të futem në Parti, ku do të më imponohet disiplina e saj. Porositë, direktivat e Partisë do t'i vë në jetë edhe pa qenë në radhët e saj, sepse unë e dua Partinë». Kështu është, në vija të përgjithshme, pikëpamja e disave dhe kjo përbën një nga faktorët që të tillë njerëz të mos kërkojnë të pranohen në Parti.

Me ata që do të pranohen në Parti duhet punuar mirë. Anëtari i Partisë, kur shikon një punëtor të aftë, të zgjuar, të gatshëm për të kryer çdo detyrë, pra që është ashtu siç ka porositur vazhdimisht Partia, duhet ta mbajë afër dhe t'i krijojë një ambient të tillë që te ky të nxitet dëshira për t'u futur në Parti.

Njerëzit e kanë dashur dhe e duan Partinë se dinë që ajo i udhëheq në rrugën marksiste-leniniste. Prandaj e kuptojnë që është nder i madh të jesh anëtar i saj. Por kam mendimin se për pranimet në Parti ndikon për keq edhe koncepti i vjetër i disa komunistëve për Partinë, sidomos në fshat, të cilët nisen nga mendimi i gabuar «që Partinë ta kemi tonën», domethënë ta ketë tarafi i tyre, që vetëm këta të bëjnë pjesë në Parti. Nga kjo vjen që këta shokë nuk punojnë që edhe të tjerë të pranohen në radhët e Partisë.

Ka edhe ndonjë sekretar partie, i cili do që djali ose vajza e tij të futen në Parti. Fëmijët e tij mund të jenë shumë të mirë, po nuk i takon atij të thotë që të futen në Parti. Jo, nuk duhet, për arsye se djali ose vajza, e para, që të futen në Parti, duhet ta meritojnë dhe duhet të tjerët, shokët e Partisë, që janë në ndërmarrjen ku punojnë ata, t'i përgatitin për t'i futur në Parti; e dyta, unë jam kundër tendencës që pjesëtarët e një familjeje të futen të tërë në Parti, pavarësisht se ata, në qytet mund të jenë në qendra pune të ndryshme. Mendimi im është që nuk duhet të jenë të gjithë në Parti.

Fryma e tarafit në organizatën-bazë sjell farën e përçarjes, e cila një ditë do të shfaqet. Mund të ndodhë, për shembull, që një nga të afërmit e njërit ose të tjetrit, në punë e sipër, të gabojë, të jetë i padisiplinuar, i mefshtë ose ndonjë mund të bëhet edhe armik. Kështu që në organizatën-bazë, ky ose ai komunist do të ngrihet kundër të afërmit të shokut të tij komunist, që ka gabuar ose që del armik dhe do të propozojë që ai të flaket jashtë radhëve të Partisë. Këtu pastaj ngre veshët tarafi, sepse duke kërkuar dënimin e këtij, ai «atakon» fisin. Të mos harrojmë se me gjithë punën e madhe që është bërë nga Partia, në fshat vazhdojnë të ekzistojnë tendenca fisnore. Natyrisht, këto tendenca mikroborgjeze nuk mund të zhduken menjëherë të tëra nga ndërgjegjja e njerëzve me t'u pranuar në Parti. Lufta dhe puna e vazhdueshme edukative e Partisë në të gjitha drejtimet që thashë më lart, edukojnë kuadrot drejtues të saj, komunistët dhe

ata që do të pranohen në Parti, që këta të jenë njerëz të brumosur me frymë partie.

Çështja e pranimit në Parti nuk duhet kuptuar në mënyrë burokratike. Kam dëgjuar shumë herë që komiteleve të Partisë, nga të cilat miratohen pranimet në Parti, u merr shumë kohë kjo çështje. Kam dëgjuar se shokët e rrethit, kur u venë ata që do të pranohen në Parti u bëjnë pyetje të tilla: «Përse e do Partinë ti?».

Ç'është kjo pyetje «përse e do Partinë?»! Për këtë nuk e ka zor të të përgjigjet kushdo që nuk është as kandidat për Parti. Pra, mendoj se ka vend për një punë më të mirë në këtë drejtim, se kur shkon në komitet i riu ose e reja për t'u pranuar në Parti e ndien veten si përpara një provimi¹. Natyrisht, koha që do të merret komiteti i Partisë me këtë problem nuk mund të jetë po aq e gjatë sa ç'është periudha që përdoret për pranimin dhe edukimin e një kandidati partie në organizatën-bazë.

Por çështjen e kam këtu që, duke filluar që nga shokët drejtues të Partisë në rreth dhe deri tek anëtarë i byrosë së Partisë të sektorit, apo të kooperativës. të tërë duhet të punojnë që ta kuptojnë mirë ç'është Partia dhe si duhet të jetë ajo etj., etj. dhe si do të mendojnë njerëzit e Partisë për të. Mund të thuhet që në drejtim të edukimit është bërë shumë, se Partia

1. Që nga viti 1982, me vendim të Sekretariatit të KQ të PPSH-nta që pranohen kandidatë ose anëtarë partie nuk paraqiten më në komitetin e Partisë.

ka bërë gjithë këto gjëra dhe këto i ka bërë me njerëzit e saj dhe me masën tjetër patriotë. Por ne duhet të na shqetësojë fakti që të punojmë më mirë dhe sistematikisht edhe me ata që i kemi përjashtuar nga Partia jo për çështje armiqësore. Pra, të bëjmë dallim midis këtyre edhe ndonjë elementi armik që kishte mundur të futej në Parti dhe që pastaj është përjashtuar. Kjo ndodh sepse është e natyrshme që armiku ose elementi i degjeneruar, i cili ka mundur të infiltrojë në Parti, në mos shpejt, vonë, do të dalë. Pra, në një mënyrë ose në një tjetër, ai do ta nxjerrë në shesh fytyrën e tij dhe flaket nga Partia. Por pranimi i këtyre elementëve në Parti tregon se nuk është bërë kujdesi i duhur, nuk është bërë verifikimi dhe njohja e thellë e këtij elementi që në kohën kur është propozuar për t'u pranuar në Parti.

Duhet të tregojmë kujdes për njohjen dhe zbatimin e plotë të parimeve themelore të Partisë dhe të Statutit të saj për problemin e pranimeve në Parti. Tash nuk ka përse të zgjatemi e të përsëritim ja ç'tuhet në faqen kaq e në paragrafin aq të Statutit të Partisë, se politika e Partisë, të gjitha orientimet e saj janë të lidhura me këtë problem.

Puna e Partisë është e gjerë, interesante, delikate dhe e ndërlikuar. Nuk është gjë e thjeshtë të njohësh Statutin. Në fakt, këtu kemi të bëjmë me parimet, të cilat duhen parë të zhvilluara konkretisht në jetë, të njerëzit, me të metat dhe me të mirat e tyre, sepse ata rrojnë në një shoqëri dhe në një ambient të caktuar shoqëror. Në përgjithësi, të tëra ambientet tona kanë

një natyrë të përbashkët, se i përkasin shoqërisë që po ndërton socializmin, por, midis tyre, ka ambiente më të shëndosha, ka edhe ambiente më pak të shëndosha. Në ambientet më pak të shëndosha, ka punonjës që nuk i zbatojnë me korrektësi detyrat që u takojnë. Por kush do t'i shohë ata nëse i kryejnë apo jo këto detyra? Do t'i shohë Partia me të gjitha levat e saj. Në qoftë se në një ambient numri i komunistëve është i mjaftueshëm, nuk ka pse t'i thuhet kësaj organizate-bazë që të pranojë njerëz të rinj për t'i bërë anëtarë partie. Kjo s'është e nevojshme të bëhet, por kësaj organizate t'i tërhiqet vëmendja që t'i bjerë çekani tek anëtarët e Partisë, që secili të marrë në patronazh katër ose pesë punëtorë dhe, bashkë me këta, të mobilizojnë të gjithë punëtorët e tjerë. Po të bëhet si duhet kjo punë nga organizata, fabrika do të shkojë më së miri.

Për sa i përket problemit që po diskutojmë, mendoj se të gjitha materialet e Partisë, që kanë dalë për këtë çështje, duhet t'i kemi vazhdimisht parasysh, t'i studiojmë me kujdes dhe t'u rikthehemi jo një herë në vit, por vazhdimisht, sa herë kemi të bëjmë me pranimet në Parti. Këto materiale t'i kenë parasysh, në mënyrë të veçantë, organizatat-bazë, rekomanduesit dhe komitetet e Partisë sa herë që pranojnë elementë të rinj në Parti. Në qoftë se nuk do të bëhet kjo, atëherë në Parti do të na futen edhe njerëz që në dukje paraqiten të mirë, por në realitet janë të mefshtë, inaktivë etj., etj. Këtyre do t'u pritët rruga dhe në Parti do të pranohen njerëz të mirë, të cilët do të bëhen

akoma më të mirë, në qoftë se puna e Partisë do të jetë e zgjuar dhe e vazhdueshme.

Në bazë të Statutit ata që pranohen në Parti vijnë edhe nga radhët e rinisë. Por kërkohet kujdes që të rinjtë shkollarë të pranohen në Parti pasi të mbarojnë shkollën e mesme e të kenë disa vjet stazh në punë, dhe vetëm në raste të rralla mund të pranohet ndonjë nga shkolla e mesme.

Ne kemi marrë vendim që të rinjtë, porsa mbarojnë shkollën e mesme ose universitetin, para se të marrin diplomën dhe të emërohen, bëjnë një vit stazh. Këtë e bëmë sepse të rinjtë, që kur venë në shkolla dhe derisa mbarojnë universitetin, mësohen me një mënyrë jetese dhe të menduari prej intelektual. Dikush e ka origjinën punëtor, kurse tjetri e ka nëpunës, intelektual, por që të gjithë këta të rinj kanë nevojë të punojnë, prandaj ne i dërgojmë në prodhim, që të bashkohen me punëtorët, për t'i bërë duart me baltë ose me vaj, për të njohur vështirësitë e punës, për të parë disiplinën, zgjuarsinë, dashurinë e punëtorit për klasën dhe për Partinë. Dhe këta të rinj, gjatë stazhit, duhen parë si punojnë e si sillen. Këta t'i shohin punëtori, komunisti, drejtuesit e organizatës së rinisë, të bashkimeve profesionale, organizata e Partisë, pra të preokupohen të gjithë. Edhe organizata e gruas e ka për detyrë të kujdeset për edukimin e të rejave që kanë vajtur të punojnë porsa kanë mbaruar shkollën e mesme dhe që mund të jenë fejuar ose martuar që në moshën 18-20 vjeç, duke ngarkuar ndonjë grua komuniste t'u qëndrojnë afër. Pra për këtë arsye e caktu-

am stazhin në prodhim. Bile nuk është keq që i riu, pasi të marrë diplomën, të vejë edhe ca kohë në punë, të shihet edhe atje se këtë diplomë e mori për stoli apo për të kryer siç duhet punën, pastaj të bëjë kërkesën për t'u futur në Parti. I riu ka kohë t'i shërbejë Partisë derisa të jetojë. Po të ndiqet kjo, Partia do të ketë fitim të madh dhe më pak humbje, do të ketë më pak firo, prandaj unë mendoj që problemin e futjes së të rinjve në Parti ta shikojmë në këtë prizëm.

Shoku Simon [Stefani] tha që shpeshherë propozimet për të rinjtë që kërkojnë të pranohen në Parti i paraqit sekretari i organizatës-bazë të Partisë. Kjo praktikë mendoj se nuk është në rregull. Nuk mund të themi se mendimi i sekretarit të organizatës së Partisë s'vlen, por ai e ka për detyrë që t'i shohë nga afër këta të rinj, t'i provojë edhe vetë, t'i vëzhgojë e të bëjë biseda të lira e të çiltra me ta, për t'i njohur më mirë. Në qoftë se vepron kështu, atëherë kur të vijmë propozimet për t'u shqyrtuar në organizatën-bazë, ai do të jetë në krye të detyrës si një punonjës i vërtetë partie, që e preokupon çështja e forcimit të radhëve të Partisë dhe e pranimit të të rinjve në Parti. Por çështja është që propozimet, në fakt, të vijmë nga organizata-bazë e rinisë, sipas orientimeve të komitetit të Partisë, e cila ia jep sekretarit ose edhe drejtpërdrejt organizatës-bazë të Partisë, ashtu siç veprohet zakonisht.

Duke vepruar kështu, që rekomandimet për në Parti të bëhen nga organizata e rinisë dhe për to të thonë fjalën e tyre edhe bashkimet profesionale, kan-

didaturat për në Parti do të jenë të goditura. Partia e do zërin e masës së punonjësve për çdo gjë, për zhvillimin e ekonomisë, për hartimin e planeve, atëherë si të mos ta kërkojë këtë për ata që do të pranohen në Parti?! Kjo është e domosdoshme. Me këtë rast ne edhe do të gjykojmë nëse bashkimet profesionale, për shembull, e bëjnë apo nuk e bëjnë punën si duhet. Po çfarë pune? Punën për edukimin komunist të njerëzve. Në të gjitha fabrikat tona, shumica dërrmuese e punëtorëve janë të rinj e të reja. Dhe aty nuk punon vetëm organizata e rinisë, por punon njëkohësisht edhe ajo e bashkimeve profesionale. I ngarkuari me punën e bashkimeve profesionale, që është në fabrikë, duhet të dijë të zgjedhë njeriun e përshtatshëm, që i ka aftësitë të merret për të edukuar kategoritë e ndryshme të punonjësve dhe, kur të vejë të zhvillojë bisedën ose temën me punëtorët, të bëjë debate me ta dhe kështu të ndihmojë për ngritjen e tyre politike. Duke i njohur kështu nga afër edhe ai i organizatës së Partisë se cilët nga të rinjtë dallohen në punë, në debate, që ajo t'i ketë parasysh kur bën pranimë të reja në Parti. Pra, e kemi fjalën që edhe organizatat e masave të japin mendimet e tyre për propozimet për t'u pranuar në Parti. Po të ndiqet kjo rrugë, jo vetëm që do të futen në Parti më të mirët, por në këtë mënyrë evitojmë dhe tarafet e miqësitë dhe bëhet një shoshitje më e mirë. Kush e njeh më mirë atë që do të pranohet në Parti? E njeh kolektivi, e njeh organizata-bazë. Kjo ka shumë rëndësi, pasi ai, krahas virtyeteve të mira, ka edhe ndonjë të metë si, për shembull, familjaritetin. Duke

ia njohur këtë organizata jo vetëm ia vë në dukje, por edhe përpiqet t'ia luftojë, se në qoftë se ai nuk ndreqet në këtë drejtim, nesër mund të dëmtojë punën ose organizatën e Partisë. Pra organizata këta të rinj i mban afër, i ndihmon të përparojnë, të ndreqin të metat që kanë, se nuk ka njeri pa të meta, i edukon të lidhen me masat. Ajo insiston që komunisti të jetë i ndershëm, i çiltër, i dashur, i matur, masovik, kërkues në punë, optimist, jo pesimist etj.

SHOKU RAMIZ ALIA: Ose ka të rinj të tillë që janë, siç thotë një shprehje popullore: Ku rafsha, mos u vrafsha.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ka edhe nga ata që mendojnë kështu, ku rafsha, mos u vrafsha, që kur vijnë në punë, më shumë e kalojnë kohën duke bërë shaka, e duke qeshur sa me njërin, sa me tjetrin, pra duken në punë sa për të qenë brenda. Partia jonë si një Parti serioze kërkon që njerëzit edhe të qeshin e të bëjnë shaka, por, në radhë të parë, kërkon të bëhet puna dhe çdo gjë të bëhet me masë, kur duhet dhe jo vend e pa vend.

Pra, e kam fjalën që me këta të rinj Partia të punojë për t'i përgatitur mirë, për t'u pranuar në Parti. Pastaj bëhet një diskutim i shëndoshë dhe në bazë të qëndrimit të atyre që kërkojnë për t'u futur në Parti, krijohen mundësi që të bëhet një punë e mirë për pranimet.

Natyrisht gjatë periudhës së stazhit bëhet edhe shoshitja në radhët e kandidatëve. Kjo është e pavitueshme, por Partia synon që «firot» të jenë sa më

të vogla, me qëllim që të ketë sa më pak «egjër». Pra, ashtu sikurse kujdeseni që gruri të ketë sa më pak egjër ose mollza, të tregojmë kujdes që edhe në Parti të ketë sa më pak elementë të papërshtatshëm, të kemi më pak të përjashtuar nga Partia.

Puna e pranimeve në Parti kërkon shumë kujdes, me qëllim që në Parti të na vijnë njerëz revolucionarë, me të gjitha cilësitë. Në qoftë se një i pranuar në Parti nuk i ka të gjitha cilësitë, po ka disa cilësi bazë, të punojmë me të që t'ia zhvillojmë edhe ato që i mungojnë; të punojmë në ato drejtime që t'i hapim horizont dhe t'i japim forca të reja. Ne do t'i besojmë edhe përgjegjësi atij, sepse kjo i zgjeron horizontin, i forcon ndërgjegjen, ia shton forcat mendore dhe fizike, e pajis edhe me karakteristika të tjera të mira.

Të vijnë tash te çështja tjetër, te puna që duhet të bëjmë me të përjashtuarit nga Partia. Është e vërtetë se Partia ka bërë dhe bën shumë për edukimin e anëtarëve të saj dhe të masës së punonjësve, por ne duhet të shqetësohemi dhe të punojmë më mirë e sistematikisht edhe me ata që i kemi përjashtuar nga Partia. Me të gjithë këta duhet punuar, bile edhe me të përjashtuarit për veprimtari armiqësore të tregohet kujdes, që të neutralizohen, me qëllim që të mos vazhdojnë të ecin më tej në rrugën e tyre të gabuar. Kjo është vija e Partisë, por, në fakt, këtë nuk e bëjnë si duhet jo vetëm anëtarë dhe sekretarë të disa organizatave-bazë të Partisë, por as disa shokë drejtues të komitetit të Partisë. Këta, nga frika se mos i akuzojnë për oportunizëm, shpesh tregohen sektarë. Po ç'të

keqe ka në qoftë se ndonjëri takohet me një njeri të përjashtuar nga Partia e i thotë, për shembull: «E shikon se si u vërtetua puna armiqësore në naftë, për të cilën ne u detyruam të marrim edhe masë ndaj teje? E shikon si dolën gjërat që tha Partia? E shikon si u zbulua pusi? Armiqtë na e kishin fshehur këtë, dhe, megjithatë, pusi u zbulua. Ne u detyruam të marrim masë edhe për ty, sepse ti kishe mbyllur sytë e kishe rënë në kurthin e këtyre armiqve. Po tash ne besojmë se ti e kupton fajin që ke bërë».

Pra, vetëm fakti që një nga shokët drejtues të Partisë në rreth i afrohet dhe bisedon kështu me të përjashtuarin nga Partia (por tani edhe ai e kupton se me qëndrimet e tij mbështeti armiqtë në punën e tyre armiqësore), e bën të përjashtuarin të mendohet dhe të reflektojë. Sigurisht, ne atë nuk do ta futim prapë në Parti, as nuk do t'i japim post drejtues, as nuk do ta vëmë mbi kokë, por e kemi për detyrë të përpiqemi që ai të mos shkojë më tutje në rrugën e gabuar.

Rëndësi të veçantë ka edukimi i atyre që janë përjashtuar nga Partia për mefshtësi, indisciplinim, ose që janë të lidhur pas interesit personal, që janë pa shkollë etj., etj. Drejt është shtruar kjo çështje në seminar që këta të përjashtuar Partia t'i konsiderojë si qytetarë, që, kur ishin në radhët e Partisë, kanë bërë disa gabime, ose kanë pasur disa të meta, megjithatë janë më të gatshëm për t'u aktivizuar sesa disa qytetarë të thjeshtë dhe e kuptojnë më mirë nga ata vijën e Partisë. Deri edhe kuadrot drejtues të Partisë në rreth, kur shkojnë në bazë, në takimet me po-

pullin, midis të tjerave, gjejnë rastin dhe flasin edhe për ndonjë të përjashtuar nga radhët e Partisë, sigurisht jo si armik, por për mefshtësi, kurse tani shikohet që është bërë punëtor i palodhur, realizon normat etj., etj. Kjo ka shumë rëndësi. Në qoftë se këtyre njerëzve u gjen mënyrat dhe format për t'i aktivizuar, këta nuk mungojnë të aktivizohen.

Sa më thellë të futesh në problemet e Partisë, aq më e gjerë bëhet kjo çështje, aq më shumë hapen horizontet, marrin gjallëri e freski metoda e punës, stili, normat, direktivat, dëshira për t'i mësuar dhe për t'i zgjeruar ato, për të shfletuar materialet, për të shfletuar librat, për të vajtur e për të marrë kontakt me vetë njerëzit në fabrikë, në gjirin e klasës, për t'i njohur nga afër ata dhe problemet e tyre.

Problemi i forcimit të Partisë është një nga më të rëndësishmit, një nga detyrat më të shenjta. Po të konsiderohet e tillë kjo detyrë, me siguri që Partia do të kalitet më tej dhe do t'i kapërcejë me sukses rreziqet që i turren vazhdimisht qoftë nga jashtë, qoftë nga brenda, nga degjenerimi i disa elementëve në radhët e saj.

Ne luftojmë që të kemi një Parti të çeliktë, të zgjuar, vigjilente, të mësuar, që drejton dhe organizon ekonominë e gjithë veprimtarinë politiko-shoqërore të vendit. Partia është burimi i fitoreve. Po të thellohesh në çdo gjë, në çdo sektor, në çfarëdo kohe, në çfarëdo momenti, në çfarëdo shfaqje realizimi, konkretizimi. gjithmonë ke të bësh me Partinë. Po të kesh Partinë të fortë, të gjitha problemet do të ecin mirë. Po të kesh

Partinë të dobët, edhe punët dobët do të ecin. Prandaj detyra kryesore është që të punohet me gjithë shpirt për forcimin organizativ të Partisë.

Të gjithë, duke filluar që nga ne sekretarët e Komitetit Qendror e deri tek anëtari i thjeshtë i organizatës së Partisë, me këto synime duhet të punojmë. Puna për forcimin e Partisë nuk duhet bërë në mënyrë shablone. Direktivat janë udhëzime që jepen nga Partia për zbatimin e vijës së saj, ato, si çdo gjë tjetër, duhet të mbështeten e të zhvillohen politikisht, teorisht dhe të zbatohen organizativisht.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha
«Raporte e fjalime 1978-
-1979», f. 226*

Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP

NJERËZ TË RILINDUR NË PËRMETIN E KOHËS SË PARTISË

Nga një bisedë me shokun Simon Stefani

12 prill 1979

Në fillim të bisedës shoku Simon Stefani e informoi shokun Enver Hoxha për disa probleme shoqërore të rrethit të Përmetit.

SHOKU SIMON STEFANI: Në disa fshatra të Përmetit në zonën kufitare, sidomos tek Tri Urat, nga pjesa jonë, ka një mikroklimë të atillë, e cila është mjaft e favorshme, prandaj çdo gjë mund të bëhet në ato fshatra. Kur isha sekretar i Komitetit të Partisë në Përmet, unë veja gjithmonë në zonën e kufirit, se kisha merak që të dallonin fshatrat tona dhe e vërteta është se është bërë një punë e mirë dhe e kujdeshme në këtë drejtim. Fshatrat kufitare i kisha më tepër në kujdes sidomos për furnizimin e për të gjitha nevojat e tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë kam një përshtypje të mirë për fshatrat e asaj zone dhe kjo për dy arsye: E para, se prej andej ne të Gjirokastrës furni-

zoheshim dhe, e dyta, më tërhiqte andej edhe nostalgjia e rinisë. Kur veja nga Gjirokastra në Korçë, andej kaloja dhe më pëlqenin shumë ato vende. Kjo përshtypje e mirë më është rrënjësuar pastaj edhe gjatë kohës që kam ndenjur me Nonda Bulkën, me të cilin kam qenë shok dhe në Liceun e Korçës. Ne ishim shokë shumë të ngushtë derisa e mbaruam liceun, bile flinim në një dhomë bashkë me nja 10 a 12 veta të tjerë. Ai ishte nga Leusa. Kishim edhe një shok tjetër që ishte nga Përmeti, Mantho Leusa i thoshim. Se ç'është bërë tani nuk e di, por ai nuk e mbaroi dot liceun. Megjithatë më kujtohet se edhe ai djalë i mirë ishte në ato kohë, fliste me dashuri të madhe për fshatin e tij e për gjithë njerëzit e asaj zone, fliste për qershitë, për dardhat, për zarzavatet, për çdo gjë që prodhohej në fshatin e tij. Më kujtohet se ai vetëm për një gjë qalej: se po largoheshin njerëzit tanë nga fshati.

Po ajo zona tjetër, zona e Odriçanit, e Cerjes, çfarë zhvillimi ka?

SHOKU SIMON STEFANI: Kjo zonë, që përmbledh fshatrat Pagri, Kosovë, Hotovë, Raban, Alipostivan, kryesisht ka si drejtim bujqësinë, prodhimin e drithërave, dhe blegtorinë.

SHOKU ENVER HOXHA: Tokat e tyre janë të varfra. Edhe kopshtije mund të kenë këto fshatra, prandaj zarzavate mund të bëjnë, se uji nuk u mungon. Ka rezervuarë, ku uji është grumbulluar duke mbledhur përrrenjtë. Me këta mund të ujitet një pjesë e mirë e kopshtijeve me zarzavate, si në Lunxhëri.

SHOKU SIMON STEFANI: Në këtë zonë, shoku

Enver, sidomos në pjesën e mesit, përtej Pagrisë dhe Odriçanit, njerëzit janë edhe më nikoqirë e më të zhvilluar. Para Çlirimit ata emigronin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Australi, në Greqi, në Turqi etj., ku punonin si bahçevanë. Unë kam takuar në Çarshovë nja dy bahçevanë që kanë punuar me vite të tëra në Stamboll. Ata u tregonin të rinjve për kushtet e rënda në të cilat kishin punuar jashtë atdheut dhe edukonin tek ata dashurinë për punën. «Ju tani keni gjithë këto kushte të mira, prandaj të punoni ditë e natë», kështu u thoshin. Ata, megjithëse ishin pensionistë, përsëri dilnin në punë për të dhënë ndihmën e tyre.

SHOKU ENVER HOXHA: Në fshatrat me popullsi myslimane, si në Cerje, Pagri, Raban, po kështu dhe në Alipostivan, zakonet familjare janë më konservatore, kurse Odriçani duket që ka qenë më përparimtar, njerëzit kanë qenë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Po hasmëri kishte në ato zona?

SHOKU SIMON STEFANI: Jo. Nuk kishte hasmëri.

Miqësia dhe afrimi në mes myslimanëve dhe ortodoksëve në rrethin e Përmetit ka qenë një karakteristikë e përgjithshme. Vetëm Dëshnica bën përjashtim atje. Unë, për shembull, jam rritur bashkë me një shok mysliman nga Përmeti, hynim e dilnim në shtëpitë e njëri-tjetrit në raste gëzimi ose në çdo rast tjetër.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë Dëshnica ishte myslimane dhe më konservatore. Atje, natyrisht, kishin ndikimin e vet teqeja e Sukës, e Prishtës dhe

Ali Këlcyra. Sidoqoftë në Dëshnicë kishte njerëz të fortë, që ishin edhe të zotët e pushkës. Prandaj Ali bej Këlcyra nuk mund të bënte si të donte me ta. Dëshnica si është tani nga pikëpamja e zhvillimit? Afrohet me fshatrat e tjera të Përmetit, apo qëndron akoma pas?

SHOKU SIMON STEFANI: Edhe ky fshat ka bërë përparime të dukshme. Unë gati në të gjitha fshatrat e asaj zone kam vajtur dhe kam fjetur në shtëpitë e fshatarëve.

SHOKU ENVER HOXHA: Fshatrat e atyre anëve të grumbulluara janë? Atje sigurisht ka ekzistuar edhe hasmëria. Kishin këta hasmëri, për shembull, me Dangëllinë?

SHOKU SIMON STEFANI: Edhe kanë pasur.

SHOKU ENVER HOXHA: Më e përparuar ishte Dangëllia apo Dëshnica?

SHOKU SIMON STEFANI: Më e përparuar qe Dangëllia.

SHOKU ENVER HOXHA: Pavarësisht nga Frashërlinjë, teqeja e Frashërit kishte influencë këtej nga zona e Dëshnicës, apo nuk e linte teqeja e Sukës?

SHOKU SIMON STEFANI: Jo, nuk ka pasur.

SHOKU ENVER HOXHA: Ajo kishte vetëm në Dangëlli, edhe ndonjë çikë në Kolonjë, nga Qafa e Dëllinjës, prapa. I kishin ndarë zonat. Po myslimanët a bënë krushqi me zona të ndryshme, për shembull, Dëshnica me Dangëllinë?

SHOKU SIMON STEFANI: Po, shoku Enver, bënë.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë për sa u përket marrëdhënieve midis zonave nuk kishte ndarje, bënin krushqi me njëra-tjetrën. Pra, merrnin edhe jashtë zonës, se brenda zonës po e po. Unë sigurisht flas për të kaluarën. Ndarje kishte vetëm për sa i përket besimit fetar, pra myslimanët e të krishterët nuk martoheshin me njëri-tjetrin.

SHOKU SIMON STEFANI: Në rrethin e Përmetit. me ç'kam studiuar unë, kanë qenë shumë-shumë të rralla fshatrat që nuk bënin krushqi brendapërbrenda.

SHOKU ENVER HOXHA: Natyrisht, kur fshati ishte i vogël dhe kishte familje që kishin afërsi gjaku deri në 2-3 breza, s'kishte si bëheshin martesë brendapërbrenda. Në këto zona, përveç teqesë së Sukës, të Frashërit dhe të Prishtës, nuk kishte dervish në vend tjetër. Atje kishte edhe tyrbe. Këto janë ato vende «të shenjta», siç i quanin, ku varroseshin dervishët. Mirëpo kishte apo nuk kishte tyrbe atje, s'kishte fare rëndësi, sepse njerëzit duhej të shkonin në Sukë e jo të vente dervishi tek ata. Kështu teqeja e Sukës ishte qendra ku njerëzit duhej të venin t'i puthnin dorën balait e t'i çonin edhe dashin. Po kështu veprime edhe me teqenë e Frashërit. Teqetë kishin toka.

SHOKU SIMON STEFANI: Teqeja e Sukës dhe e Frashërit kanë pasur toka, shumë bagëti dhe bujq.

SHOKU ENVER HOXHA: Bagëti patjetër që kishin, se u çonin myhibët si dhuratë një nga një. Çdo myhib që vente në teqe, do të çonte atje edhe dy ose tre desh etj. Po tokat teqetë i kishin të blera apo të dhuruara?

SHOKU SIMON STEFANI: Tokat ua dhuronin, i liheshin vasiet teqesë.

SHOKU ENVER HOXHA: Aktualisht, a ndihet në ato zona çështja e fesë? Për shembull, plaku im, as unë nuk e kam marrë vesh çfarë ishte. Po më duket se ai, siç thoshte, ishte edhe «sunit», edhe «bektashi». Se si bashkoheshin këta, as që e kisha marrë vesh ndonjëherë. Plaku im mishin e dërrit as që e fuste në gojë, por edhe po t'i vije për të ngrënë një këmbë lepuri, jo vetëm që s'e hante, por nuk donte as ta shihte me sy «Hiqe këtej lanetin», më thoshte. «Po dale, — i thosha unë, se e dija arsyen, — do t'ia japim lëkurën ndonjë djali për të fshirë dërrasën e zezë». «More hiqma që këtej», më thoshte përsëri. Kushedi ç'kuptim do të kishte për ta këmba e lepurit. Bektashinjtë kanë qenë edhe një sekt trim, bile të gjithë jeniçerët u organizuan nën drejtimin e Haxhi Bektashit dhe morën uniformën e tij, ata mbanin në kokë taç si të dervishlerëve. Haxhi Bektashi ishte përrëndia e jeniçerëve. Kurse sunitët, pasuesit e hoxhallarëve, ishin më tepër njerëz studiues të Kuranit, biçim filozofësh, por filozofë si me thënë, lëkurë lepuri, siç thonë francezët. Shumica vetëm sa e lexonin Kurandin, të cilin vetëm disa e kuptonin, kurse pjesa tjetër as që e kuptonin fare. Them e kuptonin, për ata hoxhallarë që kishin bërë njëfarë shkollë.

Fshatrat ortodokse në rrethin e Përmetit kishin secili nga një kishë të vogël. Mua, për shembull, më kujtohet që Odriçani kishte. Në kohën e luftës, kur ishim atje me Shtabin e Përgjithshëm, mblidheshim

në kishën e vogël të fshatit dhe atje zhvillonim biseda të ndryshme. Kanë mbetur gjë kisha të vjetra bizantine atje, të ka zënë gjë syri ty, Simon?

SHOKU SIMON STEFANI: Ka një në Leusë. Ajo është e vjetër dhe ruhet nga shteti. Një tjetër është brenda në Përmet.

SHOKU ENVER HOXHA: Po teqeja e Sukës ruhet?

SHOKU SIMON STEFANI: Jo.

SHOKU ENVER HOXHA: U prish?

SHOKU SIMON STEFANI: Nuk është prishur, shoku Enver, po është kthyer në qendër shëndetësore. Ndërtesa është ruajtur ashtu siç ka qenë, me po ato mure, me kubënë etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është interesante. Nuk ka gjë që është transformuar në institucion shëndetësor, ne atë nuk do ta bëjmë muze, se nuk ka ndonjë vlerë artistike të veçantë si kishat që i kemi të përmendura në këtë drejtim, për shembull si ajo¹ që është në rrethin e Sarandës pranë kanalit «Filipeu», kur shkon për në hidrocentralin «Stalin». Ajo është e shekullit të 11-të. Më kujtohet, atje është një basoreliev me një kokë luani e me trup gjarpri dhe bisht të skalitur në gur. Brenda ka disa afreske muri.

SHOKU SIMON STEFANI: Kisha e Leusës shquhet edhe për një punim druri ikonostas.

SHOKU ENVER HOXHA: Kam parë një ikonostas

1. Është fjala për kishën e shën Kollit në Mesopotam të Sarandës.

mjaft të bukur në kishën e vjetër të Voskopojës, që sot është monument kulture. Edhe në kishat e Beratit ka afreske e ikonostase shumë të bukura. Sidomos kisha e Kalasë.

Kështu, pra, është gjendja në Përmet. Fabrika e Përpunimit të Frutave dhe të Pijeve, që është ngritur në Këlcyrë, është zgjeruar ndonjë çikë tani?

SHOKU SIMON STEFANI: Fabrika e Këlcyrës është zgjeruar, janë shtuar disa reparte. Atje bëhen shumë lloje reçelrash, duke filluar që nga ai i qershive, i trëndafilave etj. Gjithashtu bëjnë raki, konservojnë perime, specia gogozhare dhe një lloj trangulli të vogël, që e eksportojmë në sasi të konsiderueshme.

SHOKU ENVER HOXHA: Ku mbillen trëndafilat?

SHOKU SIMON STEFANI: Këta i grumbullojnë nga qytetarët, që i mbjellin nëpër kopshte. Unë u mundova t'i ndihmoja në Këlcyrë që ta kultivonin atje këtë lule, se përmetarët dinë ta përgatitin shumë mirë reçelin e trëndafilat.

SHOKU ENVER HOXHA: Tashti besoj se Përmeti furnizohet mirë me zarzavate dhe frutat për fabrikën e Këlcyrës sigurohen nga vetë rrethi, nuk dërgohen nga rrethet e tjera.

SHOKU SIMON STEFANI: Po, mirë furnizohet dhe dy fabrikat e përpunimit të frutave të këtij rrethi e përballojnë tërë sasinë e frutave që vijnë. Atje është ndërtuar edhe një impiant për përpunimin e rigonit, shoku Enver. Nga kjo bimë prodhohet një lloj vaji, që është shumë i kushtueshëm. Për të shitur rigonin atje vinin që nga Gjirokastra, nga Tepelena e nga Buzi.

SHOKU ENVER HOXHA: Zona e Përmetit me Zagorinë kishin lidhje fisnore, martesë me njëra-tjetrën, apo shumë rrallë? Se «të dhimbte beli» të ngjiteshe nga Përmeti në Zagori. Mali Dhëmbel këtej duhet ta ketë prejardhjen e emrit.

SHOKU SIMON STEFANI: Zagoritët kanë punuar në Përmet. Ka pasur shumë nga Zagoria që kishin dyqanet e tyre në qytet. Marrëdhënie, qyteti me Zagorinë dikur kanë pasur, kurse tani kanë më pak, se një rrugë automobilistike e lidh Gjirokastrën me Zagorinë. Rruga e Qafës së Dhëmbelit dhe rruga tjetër mbi Përmet, nga ana tjetër, që del matanë, andej nga Selcka, tani rrihet pak. Dikur edhe nevojat ekonomike shoqërore i kanë detyruar të lidheshin, ndërsa tani i kanë të gjitha në vend.

SHOKU ENVER HOXHA: Besoj se Këlcyra është bërë tamam një qytet.

SHOKU SIMON STEFANI: Po, është bërë e mirë. Atje është ngritur edhe një shkollë e mesme.

SHOKU ENVER HOXHA: Në Përmet vetëm shkollë të mesme të përgjithshme ka?

SHOKU SIMON STEFANI: Ka një shkollë të mesme të përgjithshme, një bujqësore dhe një shkollë të mesme ekonomike të natës. Ndërsa në Këlcyrë ka shkollë të mesme të përgjithshme gjithashtu dhe bujqësore. Shkollë të mesme bujqësore ka edhe në Çarshovë, në Sukë, në Ballaban e në Petran afër Përmetit, ku vijnë edhe fëmijët e fshatrave përreth. Këto janë shkolla të ditës dhe të natës. Nuk e di ç'është bërë tani, por

mendonin të hapnin shkollë të mesme bujqësore edhe në Frashër.

SHOKU ENVER HOXHA: Rruga e Frashërit mbaroi. Nga kalon ajo tani?

SHOKU SIMON STEFANI: Kur nisesh nga Përmeti në drejtim të Këlcyrës, është një fshat që quhet Piskovë dhe bën pjesë në sektorin e fermës. Aty, para se të kalosh urën, kthehesh djathtas për në Pagri, ngjitesh sipër në Bredh të Hotovës dhe del sipër në drejtim të Frashërit.

SHOKU ENVER HOXHA: Po nuk mund të kalohej dot këtej, nga rruga për në Alipostivan, domethënë nga Pagria, apo vendi është shumë i thyer?

SHOKU SIMON STEFANI: Pagrinë e lë në të majtë; anës Pagrisë kalon rruga dhe pastaj ngjitesh në Bredh të Hotovës e që këtej në Frashër.

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'bëhet teqeja e Frashërit?

SHOKU SIMON STEFANI: Edhe ajo është kthyer në një qendër shëndetësore.

SHOKU ENVER HOXHA: Më kujtohet që në kohën e luftës ne kemi vajtur edhe në teqenë e Frashërit, ku na priti babai i teqesë, Baba Fejzoja, ai kriminel që na vrau Baba Fajën. Isha me Spiro Moisiun dhe me disa partizanë. Bam, bam, i ramë derës. Na hapën derën, u futëm brenda dhe u përshëndetëm. «Na zuri nata, — i thamë Babait, — dhe do të qëndrojmë këtu bashkë me partizanët».

«Si urdhëron», — na u përgjigj ai. Na përgatitën darkë për të gjithë shokët partizanë. S'e mbaj mend

dhe aq mirë teqenë, por atje, në fund të avllisë, ishin konakët.

Pasi hëngrëm bukë, babai i teqesë më tha: «Zotërisë suaj, me gjithë zotërinë tjetër, — as na pyeti fare se kush ishim, — ju kam shtruar në dhomën e mysafirëve». «Mirë», — i thashë dhe shkuam atje.

Në dhomë i thashë Spiros:

— Tashti, Spiro, do të të bëj myhib.

— Pse, si bëhesh myhib? Ha, ha, ha, — qeshte ai.

— Mos qesh, — i thashë, — se unë e di nga plaku im dhe nga Bedri Spahiu¹, — megjithëse as njëri, as tjetri, s'më kishin thënë asnjë fjalë se si bëheshin myhibët, po kisha dëgjuar ca historira.

Tashti do të të pyes ty, Simon: ku kanë jetuar evgjitët, brenda në qytet apo edhe në fshatra?

SHOKU SIMON STEFANI: Evgjitët kanë jetuar kryesisht në qytet, por edhe në disa fshatra, si në Kostrec etj. Mbi Ogren është një fshat i vogël, që mund ta quajmë si njëfarë lagjeje, i cili ka qenë i krishterë. Ky ishte i pasur e me banorë të ngritur nga gjendja. Edhe në këtë fshat të krishterë ka pasur evgjitë.

SHOKU ENVER HOXHA: Në përgjithësi këta ishin punëtorë. Punonin gratë e tyre nëpër shtëpitë e të tjerëve?

SHOKU SIMON STEFANI: Në Përmet, gratë e

1. Në pranverën e vitit 1942 Bedri Spahiu u bë myhib gjoja për arsye «taktike», për këtë u kritikua nga Partia. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 12, f. 384.

evgjitëve, në përgjithësi, kanë qenë shërbëtores në tregtarë e në familje të tjera me gjendje të mirë ekonomike. Kurse burrat e tyre punonin si hamej, kovaçë, fshirës të rrugëve etj. Kryesisht evgjitët bënin punë më të vështira e më të rënda. Ndonjëri prej tyre kishte edhe ndonjë parcelë të vogël vreshti.

SHOKU ENVER HOXHA: E ke dëgjuar atë këngën që thotë: «Do më pranosh të vij në bahçe,/ o bahçevan,/ a më pranon të vij në bahçe,/ o xhan, o xhan»/? Është e bukur ajo këngë.

Domethënë ishin të fiksuar këta, nuk kanë qenë endacakë si arixinjtë. E kishin karakteristikë vjedhjen?

SHOKU SIMON STEFANI: Jo, evgjitët e Përmetit nuk vidhnin.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu kanë qenë edhe në Gjirokastër ata, punonin më shumë nëpër shtëpitë e tregtarëve dhe nëpër familjet ku rrinin ishin të besuar, se nuk trazonin. Më përpara nuk ka pasur përbuzje të theksuar për ta, por, sa për ndjenjën e «racës inferiore», kjo, natyrisht, ka ekzistuar. Ata bënin punët më të rëndomta dhe martoheshin vetëm me njëri-tjetrin. Si zanat më shumë punonin si kovaçë dhe nallbanë që mbathnin kuajt.

SHOKU SIMON STEFANI: Ashtu ishin, shoku Enver. I ushtronin këto zanate. Gjithashtu grupet e muzikës përbëheshin nga evgjitë. Me sazet e tyre ata merrnin pjesë dhe gjallëronin e i bënin të gëzueshme dasmat.

SHOKU ENVER HOXHA: Për sa i përket muzikës,

sazet te evgjitet e Përmetit e kanë zanafillën. Ata e kanë mbajtur gjallë muzikën popullore jo vetëm përpara, por edhe tani. Edhe në Gjirokastrë, kur luanin sazet, thoshin: «Janë evgjitet e Përmetit». Unë jam rritur me evgjitet, pse rreth shtëpisë sonë në Palorto kishte mjaft prej tyre, ndonëse zakonisht ata rrinin në hyrje të qytetit. Kam pasur edhe disa shokë evgjitë, bile kam pirë gji nga një grua evgjite që e quatin Rabije.

Tani dua të shpjegoj pak pse ndodhte kështu, domethënë, pse kur dëgjoheshin sazet, njerëzit thoshin «Janë evgjitet e Përmetit». Njëpër dasma, në qytete të ndryshme të vendit tonë, jo kudo dëgjoheshin sazet. Për shembull, në Tiranë preferohej muzika e çingjive, kurse andej nga Përmeti, sidomos të krishterët, ishin më të përparuar dhe e ndienin më shumë muzikën. Edhe në Fier kishte çingi, por atje evgjitet u binin voglave, kurse çingia këndonte. Kështu bëhej nëpër kafenetë, ku venin zengjinët, të cilët ngriheshin dhe u ngjitnin sazexhinjve para në ballë.

Edhe në vende të tjera u vinin para, por në Gjirokastrë nuk ngjiste kjo. Njëpër dasma këta nuk i thërrisnin, pra nuk u shkante zanati. Atje zotëronte kënga labe dhe këngët e grave. Mirëpo te gratë nuk mund të futeshin dot evgjitet.

Në shtëpinë time Ramon e Shamon, që ishin evgjitë, i kishim si të shtëpisë. Plaku im, kur e dërgonte mëmën time te nëna e saj, kur ajo ishte nuse e re e sapomarluar, i thoshte njërit prej evgjitëve që quhej Mehmet: «Merre Gjylon dhe çoje», pa pyetur ishte

katë apo ditë, aq besim kishte. Por ama, që të vinin evgjitet e të këndonin nëpër dasma, në Gjirokastrë nuk lejohej. Po ishte edhe atje një violixhi, siç i thoshin, Ramo e quanin. Më kujtohet, kur isha i vogël, se si xhaxhai, që në atë kohë ishte kryetar i bashkisë, vinte në mbrëmje te plaku, dilnin jashtë në avlli dhe pinin raki. Pas pak dukej Ramo violixhiu me violinë nën sqetull, vinte nën penxheren e shtëpisë sonë dhe thërriste:

— Mulla Hisenj, si u ngrise? T'i bie njëherë kësaj së shkrete?

— Bjeri, — i thoshte plaku. Dhe Ramoja i binte violinës e këndonte me zë «Te rrapi në Mashkullorë», këngën e dashur të baba Çenit, që kishte luftuar me Çerçizin, prandaj e dua shumë atë këngë edhe unë. Kur mbaronte kënga, baba Çeni bërtiste:

— Prit aty, Ramo! Dhe më jep te mua një gotë plot me raki e një çikë meze në grusht të dorës, që ia çoja.

— Xha Ramo, e ke nga baba Çeni këtë, — ia jepja unë.

— Ejvalla, rrofsh sa malet vëlla, — i thoshte ai. — Do këngë tjetër?

— Ik tashti, — i thoshte, — mjaft. — Kështu i kishim marrëdhëniet ne me këta, evgjitet.

SHOKU SIMON STEFANI: Ata kanë ndryshuar shumë tani, shoku Enver, nuk dallohen fare nga të tjerët. Ja, Laver Bariu djalin e ka inxhinier elektrik.

SHOKU ENVER HOXHA: Është i mirë Laveri, unë e dëgjoj gjithmonë, se kam regjistruar nga këngët e kabatë e tij, që më pëlqejnë shumë. Janë nja katër a

pesë veta ata si grup. Se ku morën vesh për lindjen e Ermalit, stisën një këngë. Në vend të asaj kënge që thotë se babai po marton djalin, e rregulluan, gjyshi marton djalin.

Laveri i bie gërnetës e këndon shumë bukur, por sidomos në filmin «Gjeneral gramafoni» me atë avazin shumë të bukur, e qan fare.

SHOKU SIMON STEFANI: Kur isha në Komitetin e Partisë të Rrethit të Tiranës, një ditë më erdhi Laveri në zyrë. Kishte ardhur të shikonte filmin ku kishte luajtur edhe vetë. E prita, siç prisja zakonisht të gjithë ata që vinin nga Përmeti, që të mos thoshin «si i harrove përmetarët» dhe më tha: «A u pëlqeu filmi shokëve»? «Posi, — i thashë unë, — u ka pëlqyer. Ke luajtur mjaft mirë». U kënaq shumë kur i thashë ashtu.

SHOKU ENVER HOXHA: E ka shkrirë ai tërë talentin e tij në atë film.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e incizuar, që gjendet në AQP*

ASKUSH NUK KA TË DREJTË TË VENDOSË PERSONALISHT PËR KUADRIN

*Nga biseda në takimimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

14 prill 1979

Pasi shoku Prokop Murra informoi për disa probleme të organizimit, të kuadrit, të fuqisë punëtore dhe të realizimit të planit në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë» në Elbasan, e mori fjalën shoku Enver Hoxha, i cili tha:

U ngrit këtu se në Kombinatin Metalurgjik del nevoja e shtimit të fuqisë punëtore dhe se për këtë paraqiten pengesa. Mendoj se kjo nuk është pengesë serioze. Në qoftë se duhet medoemos shtimi i fuqisë punëtore dhe ka një rregull që duhet marrë aprovimi për shtesën, atëherë personat përgjegjës të shtrojnë në drejtori kërkesën bashkë me argumentet përkatëse për këtë shtesë. Drejtorja, menjëherë t'i drejtohet Komisionit të Planit të Shtetit, ku pasi të diskutohet e të krijohen bindjet, atëherë vendoset.

Veçse kjo punë s'duhet të zvarritet. Nuk është ne-

voja që në të të angazhohet e gjithë hierarkia e administratës shtetërore, po secili të bëjë punën e vet. Ç'ndodh ndonjëherë në praktikë? Për një rast të tillë, kryetari i Komisionit të Planit vete te zëvendëskryeministri, ky e dëgjon dhe i thotë atij: «Dale, se kryeministri është me pushime, të kthehet ai, pastaj ta shikojmë këtë punë». Në qoftë se kryeministri vendoska vetë se ku do të shkojnë e ku do të shpërndahen qindra inxhinierë, a është e drejtë kjo? Jo, aspak. Asnjë njeri nuk ka të drejtë të vendosë personalisht. Nuk mund të merren e të vendosen në punë kuadro dhe punëtorë sipas qejfit të njërit apo të tjetrit. Ky problem diskutohet, rrihet gjerë e gjatë dhe pastaj në bazë të nevojave konkludohet e vendoset drejt kolegjisht se ç'mund të bëhet. Vendimi i marrë të jetë i drejtë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e pranuara e jo arbitrar.

Ose mund të ndodhë që për rastin që po diskutojmë zëvendëskryeministri të thotë: «Nuk shtojmë më punëtorë veç atyre që janë të planifikuar», se kështu na qenka vendosur që më parë dhe sipas kësaj logjike kërkesa e Kombinatit Metalurgjik dhe aprovimi i Komisionit të Planit anulohen. Kështu s'duhet vepruar. Nevojat duhen parë konkretisht dhe në bazë të logjikës së gjërave të merret dhe vendimi.

Si është e mundur që Instituti i Metalurgjisë, që është me rëndësi shumë të madhe, nuk paska kuadro të mjaftueshëm?! Këtu ka dy gjëra: ose shokët që kanë vajtur atje në vend, nuk i kanë vënë rëndësinë e duhur kësaj çështjeje, ose drejtuesit e kombinatit

ASKUSHI NUK KA TË DREJTË TË VENDOSË PERSONALISHT PËR KUADRIN

*Nga biseda në takimimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

14 prill 1979

Pasi shoku Prokop Murra informoi për disa probleme të organizimit, të kuadrit, të fuqisë punëtore dhe të realizimit të planit në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë» në Elbasan, e mori fjalën shoku Enver Hoxha, i cili tha:

U ngrit këtu se në Kombinatin Metalurgjik del nevoja e shtimit të fuqisë punëtore dhe se për këtë paraqiten pengesa. Mendoj se kjo nuk është pengesë serioze. Në qoftë se duhet medoemos shtimi i fuqisë punëtore dhe ka një rregull që duhet marrë aprovimi për shtesën, atëherë personat përgjegjës të shtrojnë në drejtori kërkesën bashkë me argumentet përkatëse për këtë shtesë. Drejtorja, menjëherë t'i drejtohet Komisionit të Planit të Shtetit, ku pasi të diskutohet e të krijohen bindjet, atëherë vendoset.

Veçse kjo punë s'duhet të zvarritet. Nuk është ne-

voja që në të të angazhohet e gjithë hierarkia e administratës shtetërore, po secili të bëjë punën e vet. Ç'ndodh ndonjëherë në praktikë? Për një rast të tillë, kryetari i Komisionit të Planit vete 'te zëvendëskryeministri, ky e dëgjon dhe i thotë atij: «Dale, se kryeministri është me pushime, të kthehet ai, pastaj ta shikojmë këtë punë». Në qoftë se kryeministri vendoska vetë se ku do të shkojnë e ku do të shpërndahen qindra inxhinierë, a është e drejtë kjo? Jo, aspak. Asnjë njeri nuk ka të drejtë të vendosë personalisht. Nuk mund të merren e të vendosen në punë kuadro dhe punëtorë sipas qejfit të njërit apo të tjetrit. Ky problem diskutohet, rrihet gjerë e gjatë dhe pastaj në bazë të nevojave konkludohet e vendoset drejt kolegjisht se ç'mund të bëhet. Vendimi i marrë të jetë i drejtë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e pranuara e jo arbitrare.

Ose mund të ndodhë që për rastin që po diskutojmë zëvendëskryeministri të thotë: «Nuk shtojmë më punëtorë veç atyre që janë të planifikuar», se kështu na qenka vendosur që më parë dhe sipas kësaj logjike kërkesa e Kombinatit Metalurgjik dhe aprovimi i Komisionit të Planit anulohen. Kështu s'duhet vepruar. Nevojat duhen parë konkretisht dhe në bazë të logjikës së gjërave të merret dhe vendimi.

Si është e mundur që Instituti i Metalurgjisë, që është me rëndësi shumë të madhe, nuk paska kuadro të mjaftueshëm?! Këtu ka dy gjëra: ose shokët që kanë vajtur atje në vend, nuk i kanë vënë rëndësinë e duhur kësaj çështjeje, ose drejtuesit e kombinatit

kryejnë, të mësohen të vrasin mendjen për zgjidhjen në vend të problemeve, për kapërcimin e vështirësive. Po të bëjnë kështu të gjithë, rrugët gjenden.

Cilido nga shokët kryesorë që vete në bazë, partjetër që do të shikojë ç'kërkesa bëhen, po të mos lejojë që këto t'i përsëriten disa herë ngaqë nuk plotësohen me kohë. Për shumë probleme që ngrihen janë marrë vendime, po këto nuk zbatohen plotësisht. Në qoftë se thuhet që në një uzinë mungon baza mekanike dhe atje punohet me një ndërresë e gjysmë, atëherë duhet kontrolluar nëse punojnë vërtet 8 orë punëtorët që janë apo nuk punojnë?! Po të shikohet mirë, do të dalë që baza mekanike nuk mungon dhe punëtorët nuk punojnë 8 orë. Është një dëm i madh për ekonominë, në qoftë se punëtorët punojnë 6 orë. Ne me kushtetutë e kemi caktuar ditën e punës tetorëshe, atëherë pse nuk zbatohet ky orar? Pse nuk punohet 48 orë, po vetëm 36 orë në javë? Punohet 36 orë në javë dhe bëhet pagesa për 48 orë! Ky qëndrim nuk është aspak socialist. Kur punohet vetëm 6 orë ose 6 orë e gjysmë në ditë, si do të të japim punëtorë të tjerë? Kombinati metalurgjik e ka emrin «Çeliku i Partisë», po ka punëtorë atje që nuk janë akoma çelik. Shumë prej tyre kanë ardhur nga fshati ose nga shkolla dhe nuk i kanë fituar akoma si duhet tiparet e klasës punëtorë. Punëtorë janë ata që nuk shfrytëzojnë tetorëshin dhe e bëjnë ndërrimin e turnit në autobus? Proletarë janë ata që heqin këmbën zvarrë? «Nuk kemi fuqi punëtorë», thonë shokët e kombinatit! Si nuk paskan punëtorë, kur në fakt i kanë, por ata nuk shfrytëzojnë kohën

e punës? Pa të vënë një disiplinë të hekurt në punë ata dhe të shikosh se ç'del. Po ndërresa? Punohet me një ndërresë e gjysmë dhe nuk kontrollohen manometrat! Po normat teknike? Në ç'masë praktikohen? Mbi këto gjëra mendoj se po kalohet lehtë dhe flitet havadan.

Ose të marrim atë që tha Ramizi, kombinati vetë ka 400 inxhinierë, kurse instituti kërkohet të jetë me 150 veta?! Kështu nuk gjykojnë mirë shokët atje, nuk gjykojnë në bazë të normave të Partisë. Normat e Partisë duhet t'i detyrojnë ata që t'i kuptojnë drejt dispozitat ligjore, rregulloret dhe normat teknike, që kanë të bëjnë me kombinatin. Normat e Partisë na mësojnë që të punohet, në radhë të parë, politikisht dhe ideologjikisht për t'u ngritur ndërgjegjja, disiplina dhe përgjegjësia e gjithë kuadrove që dalin nga shkollat e mesme teknike e të tjera. Shokët e kombinatit, me sa duket, i hedhin pas krahëve këto detyra. Po kush duhet ta bëjë këtë punë? Ne? Në asnjë mënyrë jo. Këtë punë ta bëjë vetë organizata-bazë e Partisë atje. Detyra jonë është ta mësojmë organizatën-bazë të jetë me të vërtetë revolucionare, që t'i shohë ligjet e rregullat e punës të lidhura ngushtë me normat e Partisë. Vetëm atëherë çdo gjë do të zgjidhet mirë dhe shpejt.

Në mbledhjet e përgjithshme që organizohen në Kombinatin Metalurgjik mund të shkojmë edhe ne, por të kihet parasysh që atje të mos merren me analiza në plan të përgjithshëm që nuk thonë gjë. Unë rekomandoj që, kur të shkojmë në Kombinatin Metalurgjik, të informohemi më parë se cila është pika më e dobët

e punës së tyre, është mungesa e punëtorëve, mungesa e kuadrove apo diçka tjetër? Në qoftë se nuk janë plotësuar organikkat, të thuhet përse nuk janë plotësuar. Dhe, pasi të analizohen arsyet, të merren masa.

Kur vemi në kombinat, duhet të nisemi me një synim të caktuar, për të shkuar në një sektor të vetëm dhe aty të shikohen 2 ose 3 nga problemet që janë më shqetësuese. Në një sektor tjetër mund të shihet problemi i kuadrove me arsim të lartë, në një sektor tjetër ai i kuadrove të mesëm, organikkat etj. Por edhe kontaktet, bisedat e konsultat të mos i bëjmë vetëm me drejtorinë, por me sekretarët e organizatave-bazë, me përgjegjës sektorësh, me punëtorë, sepse nga këta merret më mirë situata për ato probleme që na interesojnë. Kjo është një punë më me fryt, sesa ajo që praktikohet shpeshherë. Pra, jo të shkohet më parë në drejtorinë e ndërmarrjes, por drejt në repart. Pasi merren kontakte të drejtpërdrejta me kuadrot dhe me punëtorët e sektorit apo të repartit dhe pasi formohet bindja për gjendjen e punëve, atëherë shkohet edhe në mbledhje, dëgjohen edhe drejtuesit. Në qoftë se këta e lustrojnë gjendjen, atëherë u thuhet se në të vërtetë punët janë ndryshe, se atje, fjala vjen, nuk ka disiplinë, nuk ka norma të studiuara, se drejtuesit nuk dinë të përdorin kuadrin në mënyrë racionale, se atje ka kuadro të mesëm të tepërt, që mund t'i kaloni nga ky sektor në atë sektor etj. Dhe këto thuhën në bazë të njohjes në vend të gjendjes, se këto dolën gjatë kontrollit dhe bisedave që u bënë nëpër reparte. Dhe kështu, në mënyrë të argumentuar kritikohen drejtuesit

dhe porositen që të ndërrojnë mentalitetin, organizimin, metodën e punës etj.

E theksoj dhe një herë se duhet të ruhem nga ajo metodë pune që të merremi me ç'të na dalë përpara. Përpara do të na dalin një varg i tërë problemesh dhe, po të merremi me të gjitha përnjëherë, nuk zgjidhet asgjë. Kur vemi në bazë, duhet të përpiqemi që problemet t'i zgjidhim drejt e mirë. Sidomos, ne, shokët e udhëheqjes, duhet të shkojmë në bazë për ato çështje që kanë më tepër rëndësi. Më përpara të njihemi me situatën, që të jemi pastaj në gjendje ta ndreqim. Me të tëra nuk merremi dot njëherësh, por problemet kyç duhet t'i shikojmë në vend, duke aktivizuar edhe disa kuadro e specialistë që janë më afër këtyre problemeve.

Problemin e perspektivës së përdorimit të forcave të punës, domethënë të punëtorëve, të specialistëve të mesëm dhe atyre të lartë, duhet ta shohim mirë. Kjo perspektivë zgjerohet në fusha të ndryshme të pahlapura gjer tani për ne. A mendojnë dikasteret për këto probleme? Pse nuk mendojnë Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, ajo e Industrisë dhe e Minierave që të rinjtë që mbarojnë shkollën e mesme t'i futin në kurse të ndryshme? E ndien nevojën e përdorimit të këtyre forcave Ministria e Industrisë dhe e Minierave, duke pasur parasysh edhe gjithë këto të këqija që na sollin veprimi i udhëheqjes kineze ndaj vendit tonë? Ne mendoemos duhet t'i ndryshojmë një çikë planet në këtë drejtim. Në Byronë Politike këto gjëra janë thënë, prandaj nuk duhen harruar nga shokët drejtues të di-

kastereve. A e kanë ata guximin të paraqiten në Byronë Politike dhe në Qeveri e të thonë: «Shokë, vërtet plani është ligj, po situata që na krijoi Kina, imponon nevojën që ne të bëjmë disa ndryshime në plan». Një gjë e tillë nuk bëhet. Në qoftë se ministrinë do të veprojnë me dinamizëm, do të venë në Qeveri për t'i çuar gjërat në fund gjërat, atëherë ajo do të marrë masa, fjala vjen, për hapjen e kurseve në Kombinatin Metalurgjik për të kualifikuar punëtorët e teknikët e mesëm. Edhe Partia do ta inkurajojë këtë veprim. Por as Ministria e Industrisë dhe e Minierave, as Komisioni i Planit nuk veprojnë në këtë mënyrë, sepse mendojnë të mbetet me atë që është caktuar njëherë e një kohë, se ashtu e kanë më lehtë për vete. Ja, për shembull, për prodhimin e materialeve refraktare kemi shumë vjet që po flasin; masat për hapjen e kurseve të kualifikimit të punëtorëve për këtë lloj prodhimi duhej të ishin marrë, bile, të ishin përfunduar. Po ç'ndodh? Këto nuk janë bërë dhe kur të vijë koha që të fillojë prodhimi i tullave, punëtorët akoma nuk do të jenë përgatitur. Unë nuk mund ta imagjinoj një gjendje të tillë. Këto çështje, më duket mua, duhen zgjidhur nga ana shtetërore, po edhe në rrugë partie.

Në qoftë se organizata-bazë e Partisë nuk i shikon këto probleme të mëdha, kjo do të thotë se ajo nuk është në krye të punëve. Në një rast të tillë është në krye administrata, që shumë herë punon me forma burokratike. Partia të jetë në krye, se ajo është udhëheqësjë, prandaj duhet të mendojë e të veprojë për të gjitha problemet kyç të ndërmarrjeve, të drejto-

rive, të ministrisë, të Kryeministrisë, të Komitetit Qendror. Ajo do t'i ndjekë dhe do t'i zgjidhë problemet nëpërmjet komunistëve dhe nëpërmjet kuadrove që punojnë atje. Edhe në administratën shtetërore, që është administrata e shtetit të proletarëve, komunistët drejtojnë. Partia jonë udhëheq shtetin e diktaturës së proletariatit, prandaj anëtarët e saj të mendojnë si militantë për problemet e mëdha që preokupojnë dikasterin ose ndër marrjen ku punojnë. Aparatet administrative, teknike, propagandistike, si dhe levat e fondet që kemi, duhen shfrytëzuar pikërisht për të zbatuar politikën e Partisë që shprehet edhe në ligjet e shtetit.

Prandaj kudo dhe në çdo gjë duhet rritur roli udhëheqës i Partisë. Ka organizata-bazë partie që, në vend që t'u futen thellë disa problemeve me të cilat duhet të merren, e kanë më të lehtë të thonë se kjo çështje është në kompetencë të ministrisë, duke harruar se punën e ministrisë e drejton dhe e kontrollon Partia. Ministria, si një nga organet qendrore të administratës shtetërore, ka kompetencat e veta të caktuara me ligj, por Partia është forca e vetme politike udhëheqëse e shtetit, pra dhe në ministri është organizata e Partisë. Edhe në ndërmarrje, në sektor, në fabrikë është organizata-bazë ajo që udhëheq politikisht tërë punën dhe ushtrimin e kompetencave të organeve shtetërore. Nga organizata-bazë, ku bëjnë pjesë punëtorët e pararojës, dalin detyrat; organizata mbikëqyr e kontrollon zbatimin e tyre dhe punën e kuadrove drejtues. Partia i ka edukuar komunistët në organiza-

tën-bazë që, para se ata të kërkojnë punëtorë, të kontrollojnë si zbatohen normat e Partisë në tërësi, nëse ka disiplinë, nëse punëtorët marrin pjesë rregullisht në punë dhe nëse shfrytëzohet plotësisht koha normale e punës etj. Të gjitha këto organizata e Partisë i sheh në këndin e punës së saj. Ajo vë në lëvizje drejtuesit, kuadrot që çdo gjë ta llogaritin me laps në dorë, që secili të bëjë kujdes që asgjë të mos harxhohet kot, të mos harxhohet më shumë se ç'duhet dhe që të ruhet e të përsoset teknologjia. Përdorimi i lëndëve të para e djegëse të bëhet me kursim, duke harxhuar aq sa nevojitet për prodhimin në bazë të normativave. Në qoftë se nuk zbatohen këto kërkesa, në qoftë se ka rezerva të pashfrytëzuara etj., atëherë nuk ka përse të kërkojnë punëtorë e të tjerë.

Këto probleme duhet t'i ndjekë Partia, por duke vënë më mirë në punë organet shtetërore dhe ekonomike. Komunistët që bëjnë pjesë në këto organe duhet të luftojnë për zbatimin e normave, të kenë iniciativë e guxim që të kritikojnë drejtorin kur ky tregohet liberal, nuk kërkon llogari, nuk merr masat e duhura administrative për ato probleme që u vendos në mbledhjen e organizatës. Komunistët, përveç punës edukative që bëjnë me njerëzit, kur është e nevojshme, do të kërkojnë të merren edhe masa administrative ndaj atyre që shkelin disiplinën apo dëmtojnë e përvetësojnë pasurinë socialiste. Ata ngulin këmbë që të zbatohen me përpikëri ligjet nga të gjithë. Prandaj, kur e shohim që puna edukative e Partisë nuk e bën efek-

tin e duhur te një apo dy-tre veta, atëherë komunistët kërkojnë që ata të vihen para përgjegjësisë.

Të bësh leksione për leksione, të bësh politikë për politikë dhe të mos kontrollosh realizimin e kësaj politike në jetë, në praktikë, të mos marrësh masa të forta organizative dhe sa herë është nevoja edhe administrative, për të forcuar disiplinën proletare, do të thotë të mos bësh asgjë dhe ato që thua të jenë vetëm fjalë pa vlerë.

Në këto drejtime duhet luftuar seriozisht, sepse këto janë probleme me shumë rëndësi që ne duhet t'i thellojmë politikisht dhe ideologjikisht, pasi kemi parasysh që socializmi në vendin tonë ndërtohet me forcat tona dhe nuk e presim nga askush. Ne nuk e ndërtojmë socializmin si në ndonjë vend afrikan, ku «socializmi» është i varur nga kreditë e të tjerëve dhe vendi është i krimbur me borxhe, nga të cilat nuk del dot kurrë. Një socializëm i tillë është i rremë. Ne ndërtojmë socializmin e vërtetë shkencor. Por kjo arrihet duke zbatuar rreptësisht normat politike e teorike të Partisë. Këto norma kërkojnë që ata që administrojnë pasurinë e përbashkët të popullit, të veprojnë në bazë të ligjeve, të rregullave, të cilat shprehin frymën e lartë politike proletare. Vetëm në bazë të këtyre normave e ligjeve ne do të krijojmë mundësi që nga bujqësia e blegtoaria jonë, nga industria jonë socialiste, nga kursimet tona, nga mjetet e punës së përbashkët, të ndërtohet socializmi. Po nuk i pamë problemet ekonomike me këtë sy, një mëngjes do të ndodhemi para vështirësive se-

rioze. Kërkesat e ligjeve ekonomike kurrsesi nuk mund të injorohen.

Kur kritikojmë dobësitë e të metat në punë, këto nuk i kritikojmë si gjëra në vetvete, po si fenomene që ndikojnë në kuadrin e përgjithshëm kombëtar. Çdo gjë ka peshën e vet, që ndikon në të përgjithshmen, prandaj këto probleme duhet të na preokupojnë, para së gjithash, ne që jemi në udhëheqje. Kur flas për udhëheqje, kam parasysh jo vetëm ne këtu në qendër, por tërë Partinë, tërë komunistët që e përbëjnë atë. Që këta të jenë si duhet në rolin e tyre udhëheqës, është e domosdoshme që edukata e tyre, niveli i tyre ideopolitik të jetë në një nivel të atillë që ata të kuptojnë drejt rolin dhe përgjegjësinë që kanë.

Natyrisht, ka një ndryshim midis ndjenjës së përgjegjësisë së udhëheqësve dhe asaj të komunistëve të thjeshtë. Sidoqoftë vullnetin, guximin, disiplinën dhe vendosmërinë për të realizuar detyrat, për të qenë në pararojë të masave duhet ta kenë të gjithë ata që kanë taserën e Partisë. Komunistët ta ndiejnë orë e çast obligimin që u jep fakti që janë anëtarë të kësaj Partie heroike. Secili ka dhe zotësinë e vet që nuk është e njëllajtë te komunistë të ndryshëm. Kapacitetet teknike, ideologjike, organizative të njerëzve ndryshojnë, por të tëra këto kapacitete të veçanta përbëjnë kapacitetin e madh të Partisë. Asgjë nuk duhet të na shpëtojë pa u kapur, që të mund të përballojmë me sukses këto situata që po kalojmë, si dhe të tjera që mund të jenë akoma më të vështira. Kurdoherë të mendojmë dhe të jemi të përgatitur se do të ketë situata të vështira.

Situatat aktuale dhe perspektiva e afërt nuk janë të tilla që të shpresojmë se mund të bëhet revolucioni proletar në ndonjë vend të Evropës, çka, po të realizohej, do të ishte një mbështetje për socializmin në vendin tonë. Akulli na rrethon në të katër anët dhe ky akull do të vazhdojë. Ndaj na duhet të jemi të kujdesshëm, se edhe kur të huajt na buzëqeshin, mos kujtoni se janë për socializmin. Jo, mjaft prej tyre na e kanë me hile «ndihmën» që na ofrojnë. Prandaj të jemi vigjilentë dhe të punojmë me të gjitha forcat që nevojat jetike t'i plotësojmë këtu brenda vendit dhe të synojmë që të shtojmë prodhimet që të kemi edhe për eksport, prej nga të sigurojmë devizën që na nevojitet.

Të gjitha këto t'i mendojë Partia në qendër e në bazë dhe t'i mendojë të lidhura ngushtë me kërkesat e kohës, në përputhje me detyrat që diktojnë situatat. Vetëm kështu do të zgjidhen shumë mirë problemet dhe do të ndërtohet me sukses socializmi.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP

RRETHI GJENDJES NË VENDET REVIZIONISTE

Shënime

15 prill 1979

Të gjitha vendet revizioniste të Evropës dhe të Azisë, ku në fuqi janë parti pseudokomuniste, gjenden në një falimentim të plotë politiko-ekonomik. Këtë situatë në këto shtete e ka krijuar vetë sistemi i tyre. Koha e shkurtër, brenda së cilës vendet dikur socialiste bënë kthesën e tyre regresive në vende kapitaliste, ka kaluar nga disa faza të turbullta kaotike nëpër të cilat kanë kaluar më përpara edhe vetë vendet kapitaliste, por me kohë ato disi e kanë stabilizuar gjendjen.

Shtetet aktuale revizioniste të Evropës dhe të Azisë u përpoqën të ruanin fasadat dhe të shkatërronin strukturat e superstrukturat e mëparshme. Me fjalë të tjera, kush më shumë e kush më pak, duke u quajtur të gjitha vende socialiste dhe partitë e tyre marksiste-leniniste, u futën në disa labirinte, me qëllim që të shkaktonin çoroditjen e masave të gjera punonjëse dhe të udhëheqjeve të tyre. Udhëheqjeve të këtyre vendeve, sigurisht, me pikëpamje borgjeze

kapitaliste, për të ruajtur fasadën pseudokomuniste, u është dashur të krijonin një klasë funksionarësh burokratë që t'u shërbenin atyre dhe regjimit që po ndërtonin.

Pra duhej të bënin njëkohësisht edhe seleksionimin e njerëzve dhe shkatërrimin e sistemit të mëparshëm politik, ideologjik, juridik dhe ekonomik. Kjo, natyrisht, nuk mund të bëhej brenda një dite e as kudo njësoj. Në përgjithësi, në të gjitha vendet revizioniste të Evropës, me Bashkimin Sovjetik në krye, pas ardhjes së hrushovianëve në fuqi, u shpreh dëshira e zjarrtë e një «çlirimi» nga sistemi socialist dhe secili shtet me udhëheqjen e tij iu vu punës me zell për të çarë rrugën drejt kapitalizmit, duke rritur e duke forcuar klasën e re borgjeze revizioniste dhe duke kryer me shpejtësi transformimet ekonomiko-shoqërore.

Natyrisht, të parët, revizionistët sovjetikë me Hrushovin në krye, dhe më vonë pasardhësit e tij me Brezhnëvin, u përpoqën të dominonin mbi të gjitha shtetet e tjera revizioniste në Evropë, pra t'i kishin ato në zap. Duke e ditur se një çështje e tillë ishte e vështirë, ata forcuan në radhë të parë garnizonet e tyre ushtarake të vendosura në këto vende, me fjalë të tjera proceduan drejt pushtimit të vendeve të Evropës Lindore, të ashtuquajtura vende të demokracisë popullore. Vetëm me Shqipërinë nuk e bënë dot një gjë të tillë, megjithëse u orvatën, sepse ajo i dëboi dhe u çori maskën.

Çështja tjetër ishte që Bashkimi Sovjetik t'u im-

ponohej këtyre vendeve për t'i futur në sistemin e vet kapitalist të zhvillimit. Natyrisht, në këtë drejtim gjente pengesa, për arsye të zhvillimit jo të barabartë, mbasi sistemi në të cilin po kalohej ishte një sistem kapitalist, që kishte si objektiv të pasuronte më të madhin në kurriz të më të vegjëlve. Pra, midis këtyre vendeve dhe Bashkimit Sovjetik krijoheshin kontradikta, të cilat sa vinin e thelloheshin. Në përgjithësi ato huazonin mënyrat e drejtimit të ekonomisë në disa sektorë, ngulnin këmbë në shkëmbim eksperience, zhvillonin tregti midis tyre, natyrisht, të pabarabartë, por tendencat centrifugale shtoheshin. Kështu që Bashkimi Sovjetik, si shteti më i madh revizionist, KNER-in, organizatën e përbashkët ekonomike, e transformoi në një mjet për t'u imponuar vendeve satelite të tij pikëpamjet e veta në zhvillimin e ekonomisë dhe në koordinimin e planeve të prodhimeve e të shkëmbimeve. Me fjalë të tjera, u vendos ndarja e punës njëlloj si në një shtet federativ, pa qenë federatë, domethënë të mirat materiale, më të shumtat dhe më të çmuarat, i përkitnin shtetit më të fuqishëm.

Megjithëse e kishte organizuar punën në këtë drejtim, Bashkimi Sovjetik hasi dhe do të haste më vonë në kontradikta të mëdha politiko-ekonomike, prandaj i duhej ta forconte gjendjen e pushtimit. Me fjalë të tjera, zinxhirët që u kishte hedhur satelitëve të tij, duhej të forcoheshin më tepër. Për këtë qëllim u gjend mënyra për furnizimin e industrisë së këtyre vendeve me lëndë të para të tilla si, për shembull, me naftë, mineral hekuri, energji elektrike, çelique e të tjera, në

atë masë që këto, domethënë vendet e ish-demokracisë popullore, të mos kishin një industri të pavarur.

Kështu, nëpërmjet garnizoneve të tij ushtarake të vendosura në këto vende, Bashkimi Sovjetik i pushtoi ato ushtarakisht dhe i lidhi pas qerres së vet ekonomikut. Me këtë u krijuan mundësitë që ai t'u impononte interesat e vet të zhvillimit të ekonomisë e të shpërndarjes dhe prodhimit e specifikuar për çdo vend. Ai i detyroi këto vende që, para së gjithash, t'i paguanin borxhet Bashkimit Sovjetik me mallra të fabrikuara prej tyre, dhe me çmime më të lira, gjithashtu edhe me prodhime bujqësore.

Një gjendje e tillë, natyrisht, solli varfërimin e vendeve të Evropës Lindore, shtoi zemërimin kundër partnerit të madh ose padronit të tyre, Bashkimit Sovjetik, me të cilin u thelluan kontradiktat e u acarua gjendja, u bë eksplozive, ndonjëse akoma nuk po ngjasin shpërthime. Këto me siguri do të dëgjohen më vonë. Megjithëkëtë, kjo situatë nuk e çoi ekonominë e Bashkimit Sovjetik atje ku synohej, pra nuk e bëri të begatshëm. As gjendjen politike Bashkimi Sovjetik nuk e stabilizoi dot dhe s'mund ta stabilizonte; po kështu edhe çështjen nacionale jo vetëm nuk e forcoi, por, përkundrazi, e shpartalloi, gjë që i shtoi edhe më tepër kontradiktat në gjirin e popujve sovjetikë.

Bashkimit Sovjetik që kishte marrë tipare të qarta të një superfuqie imperialiste, i duhej t'i vinte një rëndësi të madhe industrisë së rëndë, në dëm të industrisë së lehtë e të bujqësisë, të krijonte një ushtri të madhe, një flotë ajrore dhe detare të fuqishme. Nuk

mund t'i mjaftonte atij Evropa Lindore, prandaj duhej të konkurronte Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të krijonte sferat e tij të influencës e të tregtisë edhe në kontinente të tjera. Për t'ia arritur kësaj, i duhej të fuqizohej ekonomikisht dhe ushtarakisht në një shkallë të atillë që, në fakt, ishte e pamundur për të në atë kohë.

Kjo rrugë, së cilës i qe futur Bashkimi Sovjetik, e detyroi të kërkonte ndihma nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga vendet perëndimore kapitaliste të përparuara. Ishte i detyruar Bashkimi Sovjetik të merrte kredi prej tyre, të lejonte krijimin e shoqërive shumëkombëshe në territorin e vet, të bënte një politikë sipas parimit të «bashkekzistencës paqësore» hrushoviane me kapitalizmin, të hynte në ujdë e në marrëveshje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të krijonte një potencial të atillë që të konkurronte partnerët e tjerë të fuqishëm në pushtimin e tregjeve. Imperializmit amerikan dhe atij botëror u leverdiste që të investonin në këtë rrugë në Bashkimin Sovjetik, të nxirrnin fitime të mëdha për veten e tyre dhe të rritnin, gjithashtu, influencën e tyre në botë, të zinin pikat kyç dhe të rforconin sistemin neokolonialist, pra t'i bënin popujt e botës të varur sa më shumë nga kapitali i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjë që për këta popuj do të thoshte të humbitnin edhe atë liri, pavarësi dhe sovranitet borgjez që gjoja kishin.

Në këto situata satelitët e Bashkimit Sovjetik u gjendën në vështirësi të mëdha. Ata po e shihnin se interesat dhe sistemi i tyre kapitalist, të cilin po për-

pëliteshin ta vendosnin, po rrezikoheshin, bile edhe nëpërmjet vetë krijesave të përbashkëta të tyre me Bashkimin Sovjetik, KNER-in dhe Traktatin e Varshavës. Kështu këto vende përpiqeshin të dilnin nga kthetrat e padronit të tyre, Bashkimit Sovjetik social-imperialist, mbasi popujt e tyre nuk mund të sakrifikonin çdo gjë për interesat e një shteti të madh. Prandaj ato kërkuan të marrnin kredi nga shtetet borgjeze kapitaliste dhe nga imperializmi amerikan, i cili i vëzhgonte me kujdesin më të madh këto ndryshime politiko-ekonomike dhe bënte çmos që ta minonte më tej këtë gjendje të krijuar, për favorin e vet. Ai nuk mungoi, pra, që të infiltrohej, bile të depërtonte thellë me kapitalët e tij në të gjitha këto vende duke filluar që nga Polonia, Hungaria, Rumania etj. Kështu influenca e Bashkimit Sovjetik në këto vende mbahej vetëm me forcën e armëve, sepse asnjëfarë simpatie nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë në mes këtyre vendeve e padronit të tyre të madh, përderisa, si në çdo vend kapitalist, edhe në vendet revizioniste ekziston ligji i xhunglës. Vendet e ish-demokracisë popullore fare lehtë, bile që nesër, janë gati të shkëputen nga Bashkimi Sovjetik dhe të lidhen me kampin perëndimor, në mos të futen në NATO, por në shoqëritë e përbashkëta medoemos, duke u kthyer në neokoloni të kapitalit amerikan dhe perëndimor. Por ato s'lëvizin dot në këtë drejtim, sepse Traktati i Varshavës, kjo mburojë e interesave të socialimperializmit sovjetik, u qëndron mbi kokë duke i kërcënuar vazhdimisht. Kjo është, pra, gjendja e Bashkimit Sovjetik në vendet satelite të tij.

Gjendja ekonomike në këto vende është shumë e rëndë, çmimet ngrihen çdo ditë, inflacioni është i madh, ka mungesë prodhimesh bujqësore e industriale. Përpjesëtime të mëdha ka marrë numri i disidentëve të djathtë e ultra të djathtë. Një diktaturë e egër shtypëse rëndon mbi popujt e mbi revolucionarët e këtyre vendeve. Çdo ditë që kalon në këto vende rritet e zhvillohet me vrull degjenerimi në të gjitha fushat, janë përhapur në shkallë të gjerë përdorimi i narkotikëve, krimet, pornografia dhe spiunazhi. Familja, si celulë e shoqërisë, po shkatërrohet, po merr tiparet më të dobëta e më të shthurura të familjes borgjeze. Në këtë drejtim një ndihmë të pakursyer japin vetë regjimi dhe kreditorët e mëdhenj të huaj që kanë investuar e po investojnë në këto vende.

Një vend revizionist nga më të çoroditurit, nga më të falimentuarit, nga më të degjeneruarit është Jugosllavia titiste, e cila, siç dihet, ka hyrë në rrugën e kapitalizmit kaotik më përpara nga vendet e tjera të ish-demokracisë popullore. Këto të fundit e simpatizojnë titizmin, por ishin të detyruara nga orientimi hrushovian të bënin një politikë balancimi ndaj Jugosllavisë. Ne i kemi ndjekur me vëmendje të gjitha këto balancime të politikës së tyre, por kemi ndjekur e demaskuar, gjithashtu, edhe degjenerimin flagrant e total të Jugosllavisë.

Ky vend është një nga shembujt më tipikë të një shteti kapitalisto-revizionist, i cili jo vetëm ka degjeneruar, por është bërë një koloni e vërtetë e imperializmit amerikan dhe e të gjitha shteteve borgjezo-kapitaliste

pa përrjashtim, është bërë një «lypës» për çfarëdo ndihme, e çfarëdo natyre nga çdo anë që t'i vijë. E në të njëjtën kohë është përpjekur që jo vetëm ta quante veten vend «socialist», por, për të mbuluar kalbëzimin e vet, është orvatur, gjithashtu, të krijojë disa teori, të cilat nuk janë aspak teori të reja revizionisto-kapitaliste, por teori anarkiste, socialdemokrate të vjetra, që në kohën e armiqve të Marksit, të Engelsit, të Leninit. Megjithatë, grupi titist ruante tiparet e një partie gjoja të vërtetë marksiste. Nën këtë maskë nga periudhë pas luftës kundër pushtuesve që ishte faza e rreme e një fillimi gjoja të ndërtimit të socializmit në Jugosllavi, u kalua në një fazë tjetër që u quajt faza Tito-Kardel-Rankoviç.

Për të ndërtuar sistemin kapitalist, grupit udhëheqës në Beograd i duhej të likuidonte hovin revolucionar të masave jugosllave, atë hov që e treguan me tërë forcën e tyre në luftën e çlirimit nacional. Për këtë qëllim ata ndërmorën, në radhë të parë, shkatërrimin e Partisë Komuniste. Megjithëse kjo parti kishte bërë gabime në të kaluarën, në kohën e luftës kundër fashizmit ata i dhanë asaj forma organizative të ngjashme me ato të Partisë në Bashkimin Sovjetik. Por udhëheqja jugosllave kishte në plan, dhe ia arriti qëllimit, që kjo parti të ndryshonte në drejtimin regresiv, duke u shndërruar në një vegël në duart e sigurimit të shtetit, me fjalë të tjera, kjo parti të ndryshonte ngjyrën krejtësisht dhe, nga një parti qoftë edhe socialdemokrate, se komuniste as që mund të quhej, të bëhej një agjenturë e stërvitur e sigurimit të shtetit. të

Rankoviçit, i cili të vepronte me lehtësi për likuidimin e komunistëve të vërtetë, për likuidimin e revolucionarëve dhe për vendosjen e diktaturës fashiste, natyrisht të kamufluar.

Titistët ishin në konflikt me Bashkimin Sovjetik të udhëhequr nga Stalini, që në kohën e luftës. Ky konflikt u zgjerua dhe kontradiktat u shtuan pikërisht sepse Partia Komuniste e Jugosllavisë po ndryshonte dhe shteti jugosllav i krijuar pas Luftës së Dytë Botërore po merrte format fillestare të një shteti kapitalist me karakteristikat e një borgjezie të re, të paformuar akoma, por në formim e sipër. Sidomos borgjezia serbo-madhe, e cila ndjenjat shoviniste dhe prepotente që e kanë karakterizuar në çdo kohë, do t'i zhvillonte në gjithë Jugosllavinë.

Kështu, regjimi i pasluftës në Jugosllavi dhe partia pseudokomuniste jugosllave, e cila do të bëhej dhe u bë agjenturë e Intelixhens Servisit dhe e imperializmit amerikan, ndërmorën një veprimtari të gjerë, të kamufluar deri diku, për të shkaktuar një të çarë në unitetin socialist që u krijua pas Luftës së Dytë Botërore. Por në një situatë të tillë kur në botë, përveç Bashkimit Sovjetik, u krijuan edhe vende të tjera socialiste, dhe u dallua më mirë orientimi i çdo vendi dhe i çdo partie që quhej marksiste-leniniste, veprimet titiste lidhjet e titizmit me vendet kapitaliste perëndimore, veçanërisht me anglezët dhe me amerikanët, nuk kishte si t'i shpëtonin syrit vigjilent revolucionar të komunizmit ndërkombëtar.

Grupi titist evoluoi në një situatë të tillë ndërkombëtar.

bëtare të pasluftës, kur forcat kapitaliste perëndimore, imperializmi amerikan dhe imperializmi anglez bënë çdo gjë kundër Bashkimit Sovjetik e në të njëjtën kohë edhe për të dëmtuar ndërtimin e socializmit në Evropën Lindore dhe në Ballkan.

Kjo situatë, natyrisht, u dha dorë Titos, Kardelit e Rankoviçit për të manovruar në atë drejtim që ishte i favorshëm për imperialistët, pra të përpiqeshin që të bëheshin liderë të këtyre vendeve të Evropës Lindore dhe të Ballkanit, të cilat kishin fituar lirinë, pavarësinë e sovranitetin dhe kishin hedhur themelet e ndërtimit të socializmit. Grupi Tito-Kardel-Rankoviç u përpoq qysh në ditët e para të çlirimit që t'u imponohej të gjitha këtyre vendeve, veçanërisht vendit tonë, duke menduar se, meqë ne ishim një vend i vogël, mund të na shtinte lehtë në dorë.

Titistët, që në fillim, i përdorën për qëllimet e veta situatat e vështira të krijuara në Ballkan. Nën këtë maskë ata tregoheshin si mbrojtës të vendeve socialiste të Ballkanit, veçanërisht të Shqipërisë, nga pretendimet e monarko-fashistëve grekë. Me këtë pretekst Jugosllavia u orvat të pushtonte Shqipërinë *manu militari*. Pas Çlirimit ajo vendosi me ne edhe marrëdhënie ekonomike, për të cilat ishim dakord, mbasi mendonim me sinqeritet se kishim të bënë me një vend që kishte luftuar kundër fashizmit e po ndërtonte socializmin.

Titoja shfrytëzoi, gjithashtu, edhe idenë e dikurshme të Dimitrovit, i cili para luftës mendonte për krijimin e një Federate Ballkanike, për të cilën pas luftës as që mund të bëhej fjalë. Pra, megjithëse kjo ishte

e pamundur, Titoja u përpoq ta përdorte këtë kartë, por nuk i shkoi as te Bashkimi Sovjetik i Stalinit, as te Bullgaria e Dimitrovit dhe as te Partia jonë Komuniste. Klika Tilo-Rankoviç e shtoi luftën kundër Shqipërisë, në radhë të parë, duke komplotuar nëpërmjet Koçi Xoxes për të likuiduar Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë sonë Komuniste e shokët e tij dhe për ta bërë Shqipërinë një republikë të shtatë të Jugosllavisë. Më vonë ai intrigoj edhe kundër Bullgarisë.

Kështu Jugosllavia titiste shkoi duke i shtuar zullumet politike e ideologjike deri në vitin 1948 kur u detyruam ta godasim, ta demaskojmë.

Gjoja për t'u mbrojtur nga një invadim sovjetik, siç trumbetonte, gjë që ishte pa baza, kjo klikë u lidh me padronët e saj të vjetër, me imperializmin anglez dhe atë amerikan dhe në të gjitha fushat, politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake filloi ndërtimin e hapët të kapitalizmit në Jugosllavi. U shkatërrua çdo gjurmë e ndërtimit socialist që mund të kishte mbetur, filloi terrori i madh rankoviçian, filloi gjenocidi kundër shqiptarëve që jetojnë në tokat e veta në Jugosllavi. Vërshuan «ndihmat» e mëdha të imperialistëve në këtë vend e investimet nga të katër anët. Mirëpo të gjitha këto kërkonin që huadhënësit të vinin dorë plotësisht mbi shtetin jugosllav dhe kjo u arrit. Duheshin transformuar krejtësisht struktura dhe superstruktura e Jugosllavisë, duke iu përshtatur nevojave të padronëve neokolonialistë, gjë që edhe kjo u arrit. Kështu, pas një peripecie, pas dallaveresh të shumta, pas intrigash, fjalimesh, diskuresh demagogjike të Titos e

të shokëve të tij dhe pas shkëmbimeve të delegacioneve të shumta me vendet kapitaliste, u arrit më në fund që të mëkëmbej njëfarë kapitalizmi kaotik në Jugosllavi, i cili nuk i përngjiste edhe shtetit më të dobët kapitalist. Megjithatë u krijua një borgjezi e re e fuqishme, e mbështetur në një diktaturë të fortë, e cila e shfrytëzonte sistematikisht popullin. Tri të katërtat e «ndihmave» të investitorëve venin në favor të rritjes dhe të forcimit të pasurisë private të borgjezisë së re jugosllave. U likuidua në Jugosllavi prona e përbashkët, në qoftë se kishte, dhe iu dha zhvillim legal pronës private dhe pronës shtetërore kapitaliste.

Me ardhjen e hrushovianëve në fuqi, natyrisht dhe me autokritikën që bëri ndaj Titos Hrushovi, i cili me peripecitë e tij klouneske e ndihmoi Titon t'i ngrihej nami, Kardeli me Titon sajuan teorinë e vetadministrimit jugosllav, domethënë legalizuan kapitalizmin, shoqërinë borgjeze kapitaliste në Jugosllavi. Këtë e kemi sqaruar në librin ««Vetadministrimi» jugosllav — teori dhe praktikë kapitaliste».

Aktualisht, ne konstatojmë, se në Jugosllavi është një rrëmujë e madhe, ku «nuk e njeh qeni të zonë», siç thotë populli. Titoja po çahet andej-këndej për të mbjellë njëfarë uniteti, të cilin s'mund ta arrijë kurrë. Sepse atje nacionalitetet e ndryshme të republikave që formojnë Federatën Jugosllave janë në luftë të vazhdueshme, që sa vete e rritet. Disa duan të thonë se vetëm ekzistenca e Titos i mban ata në fre. Nuk mund të mohohet që Titoja ka njëfarë autoriteti, por në të vërtetë janë pushteti diktatorial, forcat e ushtrisë

dhe të UDB-së, ato që veprojnë me terror, në Jugosllavi dhe mbajnë frerët. Aktualisht investitorët i kanë forcuar mjaft pozitat e tyre brenda klanit borgjezo-kapitalist jugosllav. Atje tani janë krijuar klane të ndryshme proamerikane, profranceze, proruse e çfarë të duash. Këto veprojnë si e si të forcojnë pozitat e tyre.

Megjithëse pozitat e shteteve imperialiste nuk janë për t'u neglizhuar, duhet thënë se Jugosllavia e sotme është vazhdimi i Jugosllavisë së regjimeve monarkiste serbokroate, tek të cilat ka ekzistuar ndjenja e përçarjes dhe e unitetit, domethënë ndjenja e përçarjes në mes serbëve dhe kroatëve dhe ndjenja e ruajtjes së unitetit të republikave nën drejtimin hegjemon të njëres prej këtyre kombësive. Kështu që çështja e brendshme luan dhe do të luajë vazhdimisht një rol vendimtar, pavarësisht se ç'bluan propaganda e jashtme kapitaliste. Shumë shpresa vihen në klanet, e të tëra klanet i vënë shpresat e tyre dhe mbështeten tek Titoja. i cili luan rolin e një moderatori.

Sa për influencat e ndryshme që mund të ketë Perëndimi ose Lindja mbi Jugosllavinë, për fatet e këtij vendi gjoja të unifikuar në një federatë, kjo është një çështje tjetër, që varet, siç e theksova, më parë nga situata brenda vendit sesa nga rrethanat e jashtme.

Por, aktualisht, në ngrysjen e jetës së Titos, bëhen shumë spekulime. Perëndimi propagandon çdo ditë se Bashkimi Sovjetik do ta gllabërojë Jugosllavinë, të tjerët thonë se do të jenë anglo-amerikanët ata që do të vendosin influencat e tyre në Jugosllavi pas Titos.

Perëndimi për hesapet e tij i bën shumë propagandë «influencës» së Bashkimit Sovjetik në Jugosllavi pas vdekjes së Titos. Ai nuk mungon të vërë në majë të gjilpërës, për ta parë i gjithë opinioni, se Bashkimi Sovjetik po bën manovra të mëdha e të vogla, se po bën lëvizje trupash në kufirin hungarez, çekoslovak, bullgar, se prapa rivendikimeve të Bullgarisë mbi Maqedoninë gjendet Bashkimi Sovjetik, se ky ka një influencë të madhe të vjetër në Serbi, se klanet serbe të eliminuara nga klani i Titos janë pro Bashkimit Sovjetik, se po zëvendëson trupat e tij në vendet e Traktatit të Varshavës me trupa të reja, se ato kanë një kohë të gjatë që po vërtiten nëpër këto garnizone të posaçme e të tjera. Të gjitha këto krijojnë në botë dhe në Ballkan një situatë të acaruar që në realitet nuk mund të themi se është një fokus nga të dyja anët. Por nuk është dhe aq e lehtë të ndodhë ashtu siç e paraqet Perëndimi, që thotë se Bashkimi Sovjetik gjoja nuk pret veçse vdekjen e Titos për të sulmuar Jugosllavinë.

Sipas mendimit tim, Perëndimi e bën një propagandë të tillë për të vënë në dukje, gjë që është e vërtetë, frymën ekspansioniste të influencës sovjetike në Ballkan dhe në vende të tjera. Veçse lëvizjet e trupave të reja të Traktatit të Varshavës, ose manovrat e trupave sovjetike në vendet e Evropës Lindore, që janë satelite të tij, nuk bëhen të gjitha për të sulmuar Jugosllavinë, por bëhen po ashtu për t'i pasur më mirë në zap këto vende dhe për të përforcuar frontin që ka Traktati i Varshavës me NATO-n.

Partnerët e NATO-s, natyrisht, flasin për potencia-
lin e madh ushtarak të Bashkimit Sovjetik e nuk thonë
se ai bëhet kërcënues për NATO-n, por e paraqesin si
rrezik kërcënues vetëm për Rumaninë dhe për Jugo-
sllavinë, natyrisht edhe për Shqipërinë, sido që nuk
flitet shumë nga ana e tyre për vendin tonë. E gjithë
kjo zhurmë shurdhuese që bëhet nga perëndimorët ka
për qëllim t'u futë frikën edhe popujve të vendeve të
Evropës që janë anëtare të Traktatit të NATO-s, por,
gjithashtu, edhe popujve të vendeve anëtare të Trak-
tatit të Varshavës, të cilëve u thonë se Bashkimi Sov-
jetik, pas vdekjes së Titos, do të ndërhyjë *manu militari*
në Ballkan. Kështu zotërinjtë e NATO-s hiqen sikur kjo
ndërhyrje ushtarake e Bashkimit Sovjetik nuk i prek
interesat e aleancës së tyre agresive. Është e qartë se
ky është një bluf. Në realitet të dyja superfuqitë ar-
matosen më së miri me bomba atomike e me hidrogjen
bile edhe me neutron, dhe Ballkani është një pikë
nevralgjike për të dyja palët siç mund të jetë, gjith-
ashtu, edhe një pikë neutrale. Unë mendoj se hyrja e
Bashkimit Sovjetik në Jugosllavi do të thotë që në
të njëjtën kohë të hyjë në luftë edhe me NATO-n.

Por propaganda shurdhuese e Perëndimit në këtë
çështje, natyrisht, bën efekt të madh në popujt e Ju-
gosllavisë, në popujt e tjerë të Evropës dhe në popujt
e botës, që i kanë mbuluar frika e një lufte atomike,
kriza e madhe ekonomike e superprodhimit dhe kriza e
përgjithshme në çdo pikëpamje. Pra një zhurmë të
tillë luftëdashëse borgjezia e vendeve perëndimore e
bën për të kaluar vështirësitë kolosale që po hasin të

gjitha vendet kapitalisto-revizioniste në këto momente tragjike për to, për pushtetin e tyre, për ekonominë e vet, për qenien e tyre si shtete kapitalisto-revizioniste dhe imperialiste. Pra, kjo më tepër është përgatitje e një lufte imperialiste, një psikozë lufte sesa një përgatitje ndaj një eventualiteti të mundshëm dhe qind për qind të një sulmi sovjetik mbi Jugosllavinë.

Është e kuptueshme që udhëheqja e Jugosllavisë së falimentuar katërcipërisht, e këtij vendi që ka një deficit vjetor prej 4 miliardë dollarësh, e ka futur vendin deri në grykë në borxhe. Titoja marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik i paraqet herë të mira, herë të acaruar. Kjo taktikë nga ana e tij përdoret si politikë për të zhvatur kredi ose për të shtyrë afate të kredive që merr nga anglezët, amerikanët, francezët, gjermano-perëndimorët etj.

Titoja, natyrisht, përpiqet me mjeshtëri që sa është gjallë të përfitojë nga kjo situatë dhe të bëjë përpjekje për të forcuar diktaturën titiste e ushtrinë, që, kur të vdesë, atëherë kur nuk do të ndihen më dora dhe mendja e tij e djallëzuar, të ekzistojë dora e fortë e ushtrisë që t'i vërë në zap ata që do të përpiqen të marrin pushtetin, të cilët aktualisht janë kundër Titos, ose të dijë të manovrojë me të dyja superfuqitë.

Këto situata, pra, janë si me thënë të organizuara, të koordinuara, të sistemuara. Që Bashkimi Sovjetik revizionist ka qëllime të ketë në Jugosllavi një udhëheqje pro tij, kjo nuk ka asnjë diskutim, por duhet pasur parasysh se tash Bashkimit Sovjetik revizionist jo të gjitha udhëheqjet revizioniste të klanit të vet po

i qëndrojnë besnike. Bile edhe Zhivkovi i Bullgarisë, që është shërbëtori më i bindur i revizionizmit sovjetik, në një përqindje të ndjeshme nuk e pranon grushtin sovjetik.

Duke marrë parasysh këtë situatë kuptohet se është larg që Bashkimi Sovjetik të ketë atë influencë që mendojnë disa se ai e ka në Jugosllavi, veçanërisht në Serbi e në Mal të Zi; këto janë mbeturina të pikëpamjeve të vjetra pansllaviste, pikëpamjet e vjetra cariste në një periudhë historike të caktuar për mbrojtjen e sllavëve të Jugut, për t'u dhënë pseudopavarësinë këtyre popujve, duke i çliruar nga Perandoria Osmane. Shkëputja e tyre nga kjo perandori për carët rusë ishte t'i ngulte thikën «të sëmurit të Bosforit».

Nuk mund të themi se në ato kohë nuk ekzistonin një simpati e një miqësi e madhe në mes rusëve dhe serbëve e malazezve. Por kohët ndryshuan. Jugosllavia e Karagjorgjeviçëve ishte më tepër properëndimore, ishte shumë më afër Francës së Klemansoit, të Puankaresë etj. Bile ishte ajo Francë dhe ajo qeveri që erdhën pas Traktatit të Versajës, ishte ai ministër i Jashtëm Bartu, i cili ra, tok me Aleksandrin e parë Karagjorgjeviç, në rrugët e Marsejës nga një atentat i terroristëve kroatë, që krijuan mbretërinë serbokroate dhe i dhanë Serbisë prioritetin dhe predominencën mbi Jugosllavinë ku jetonin popuj të ndryshëm, të cilët i lidhën sipas qejfit të fituesve të Luftës së Parë Botërore.

Kjo mbretëri e Karagjorgjeviçëve që u krijua pas Luftës së Parë Botërore dhe vazhdoi si një mbretëri që

robëronte popuj të ndryshëm, pas Luftës së Dytë Botërore u shndërrua në një mbretëri të re me forma të reja konstitucionale, ndonëse s'u quajt më mbretëri e Karagjorgjeviçëve, por u emërtua Federata Popullore e Jugosllavisë. Në krye të saj ishte gjoja një parti komuniste me udhëheqës Josip Broz Titon, «i deleguar» i Kominternit, i cili kishte likuiduar fraksionin e Gorkiçit dhe ishte emëruar sekretar i përgjithshëm i partisë.

Kjo Jugosllavi, natyrisht, si të gjitha vendet e tjera në atë kohë, kaloi nëpër Luftën e Dytë Botërore, e cila i shkaktoi asaj gjakderdhje të madhe. Popujt e Jugosllavisë e panë se fitorja e tyre kundër nazizmit, kundër italianëve, kundër bullgarëve të Borisit, u arrit me luftë e jo vetëm me luftën e tyre, por edhe me ndihmën e Ushtrisë së Kuqe të Stalinit, për të cilin kishin një dashuri dhe respekt të madh, njëkohësisht edhe me luftën e popujve të tjerë, me luftën e anglezëve, me rezistencën dhe me Luftën Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar dhe me rezistencën e popujve të tjerë. Kjo, mendoj unë, ka lidhje me pikëpamjet që u krijuan gjatë luftës në Jugosllavi, pikëpamje të cilat, natyrisht, forcuan ndjenjën e përgjegjësisë së këtyre popujve si shtet dhe si federatë.

U krijuan te këta popuj, po ashtu, konceptet e fillimit për lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e federatës, koncepti i alcancave me Bashkimin Sovjetik të Stalinit dhe me perëndimorët. Por, siç e theksova edhe më parë, kjo situatë evoluoi në udhëheqjen e Jugosllavisë, evoluoi në çuarjen e këtij vendi drejt rrugës ka-

pitaliste, në shndërrimin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë në një parti vegël dhe në shërbim të sigurimit të shtetit jugosllav, derisa më në fund grupi Tito-Kardel-Rankoviç e orientoi politikën e Federatës Jugosllave më shumë drejt Perëndimit sesa drejt Bashkimit Sovjetik stalinian.

Kështu që prej një kohe të gjatë ajo e quajtura simpati dhe miqësi, ose influencë pansllave, që pretendojnë sociologët e historianët perëndimorë dhe sovjetikë, nuk ekziston në Jugosllavi, është larg, shumë larg ai mentalitet i vjetër pansllav, prorus, pra është e zorshme, për të mos thënë e pamundur, që kjo të jetë vendimtare pas vdekjes së Titos. Unë mendoj se ky është një bluf i kurdisur me qëllim nga të gjitha palët, përkundrazi, gjatë gjithë kësaj periudhe, në Jugosllavi është krijuar një mentalitet tjetër «antirus», mund të themi, duke nënkuptuar me këtë antisovjetik.

Kjo nuk ekskludon një sulm nga ana e sovjetikëve mbi Jugosllavinë, flas për sulm të armatosur, sepse një sulm psikologjik, politik, një sulm ekonomik nuk ka munguar as me Titon gjallë, ai ka ekzistuar dhe vazhdon të ushtrohet pa ndërprerje. Se sa e fortë do të jetë kjo influencë për të krijuar në udhëheqjen e Federatës Jugosllave një klan prosovjetik dhe antiperëndimor, ky për mua është një problem, zgjidhja e të cilit është kjo: ky klan do të humbasë.

Por edhe në qoftë se në fuqi vjen një klan i tillë kundër klanit titist, kroat dhe slloven, domethënë në qoftë se vjen në fuqi një klan serb biçim Rankoviçi, Popoviçi, Nikeziçi e të tjerë, ai do të përpiqet ta ruajë

Federatën, t'u japë serbëve epërsinë dhe hegjemoninë mbi gjithë Jugosllavinë, t'i japë njëfarë pjesëmarrjeje të vogël pa zarar, në këtë fuqi, kroatëve dhe slovenëve, por jo të bëhet koloni e rusëve. Jugosllavia nuk bëhet koloni e Ruisë brezhnjeviane ose e çfarëdo Rusie që të jetë. Për këtë jam i bindur.

Udhëheqësit jugosllavë në fuqi, tash që shovinizmi ka marrë përpjesëtime të mëdha, nuk pranojnë mbi kokë një shovinizëm të ri më të fuqishëm dhe as e ndiejnë veten inferiorë përpara shovinizmit sovjetik revizionist. Përkundrazi, ata e ruajnë shovinizmin serb që kërkon t'i shtypë popujt e republikave të tjera të Jugosllavisë. Por ky shovinizëm është i pleksur njëkohësisht me një kozmopolitizëm perëndimor, me një mënyrë jetese perëndimore. Udhëheqja aktuale dhe e ardhshme e Jugosllavisë është e do të jetë e degjeneruar dhe përpjekjet e saj për të dominuar do të mbësheten në një aleancë më tepër perëndimore, sepse interesat e saj do të jenë më të mëdhenj, duke pasur shanse më shumë që të jenë si me thënë me një liri e pavarësi të rreme, por jo nën thundrën e Ivanit shovinist rus.

Prandaj udhëheqja e ardhshme, qoftë serbe, qoftë kroate, qoftë serbokroate, nuk do ta ulë kurrizin përpara sovjetikëve. Ajo mund të bëjë një politikë të balancuar, mund t'u buzëqeshë edhe njërit, edhe tjetrit, duke vazhduar të zhvatë njëkohësisht edhe njërin, edhe tjetrin, por nuk do t'i shesë lirinë dhe pavarësinë false, ashtu siç i shiti në kohën e Aleksandrit të parë Karagjorgjeviç, i cili kërkoi nga qeveria franceze që

a jo ta ndihmonte për të dominuar mbi Kroacinë, ose do të jepte dorëheqjen, duke bërë kështu që qeveria franceze të kontraktonte aleancë me mbretërinë serbokroate dhe kroatët t'i nënshtronte ndaj serbëve.

Këto situata e ndodhi të mundshme, që unë parashikoj të ngjasin në Jugosllavi, mund edhe të mos jenë kështu, por konkludoj duke gjykuar mbi bazat që i njoh. Mbi këto baza, mendoj se, pas vdekjes së Titos, ka mundësi që në Jugosllavi të ketë lëvizje, por kjo lëvizje në vitet e para do të jetë një përpëlitje, si me thënë, për të tatuuar terrenet. Disa mendojnë se vdekja e Titos do të jetë fatale, se, pa u futur akoma trupi i tij në gropë, Jugosllavia do të ndizet zjarr. Unë mendoj se kjo nuk është reale. Titoja që e ka kuptuar fare mirë falimentimin e regjimit të tij, ka marrë dhe po merr masa; ai shpreson në format e strukturës që ka krijuar, të cilat po i ndryshon herë pas here. Bile tash ai ka krijuar sistemin e drejtimit kolegjial ku presidenti i republikës nuk duhet të qëndrojë më tepër se një vit në fuqi. Por, përveç këtyre, Titoja ka menduar, sidomos, për diktaturën, e cila të paktën në vitet e para nuk do të lejojë një shpërthim në Jugosllavi, jo vetëm shpërthim nga jashtë, por edhe nga brenda. Popujt e ndryshëm që formojnë Jugosllavinë, natyrisht do të lëvizin, por me kujdes dhe do ta ndiejnë veten të pasigurt. Atyre do t'u duhet njëfarë kohe për të manovruar dhe për të forcuar rezistencën e tyre në një drejtim ose në një drejtim tjetër.

Pra në të njëjtën mënyrë fuqitë e mëdha imperialiste, qoftë Bashkimi Sovjetik, qoftë anëtarët e

NATO-s nuk do të hyjnë përnjëherë me lugët në brez në çorbën jugosllave. Secili prej tyre do të forcojë pozitën e veta brenda, do të forcojë, natyrisht, edhe pozitën jashtë, përpara një sulmi eventual të papritur mbi Jugosllavinë. Prandaj në këtë çështje ato do ta shikojnë njëri-tjetrin, siç thotë francezi, *en chiens de faïence*¹.

Bëhet shumë zhurmë aktualisht për rivendikimet bullgare mbi Maqedoninë. Ky është një problem akut. Jugosllavët e bëjnë këtë akoma më akut, bullgarët ca më tepër, të shtyrë nga rusët. Pra, pas dy vjetësh mund të acarohen situatat, mundet që Bullgaria të bëjë orvatje, dhe kjo s'i kushton gjë rusit ta shtyjë këtë gur shahu, bile edhe në veprime ushtarake ta shtyjë përpara dhe ta tërheqë, pra ta tatojë pulsën jo vetëm brenda në Jugosllavi, por edhe pulsën e opinionit ndërkombëtar. Megjithatë, në të dyja çështjet sovjetikët nuk mund të luajnë me zjarrin dhe nuk mund të zhvillohet një luftë e pjesshme në mes Bullgarisë dhe Maqedonisë. Lufta, po të provokohet, do të jetë midis Traktatit të Varshavës dhe Jugosllavisë, e cila nuk do të lejojë që të sulmohet Maqedonia. Unë kam bindjen se ajo do të hyjë në luftë në rast të një agresioni, qoftë në Maqedoni, qoftë në anët e tjera të kufijve të Jugosllavisë.

Natyrisht, një veprimtari e tillë e sovjetikëve është shumë e rrezikshme për ta dhe për botën, opinionin botëror do të ngrihet në këmbë, siç u ngrit për Çekoslllovakinë. Populli çekoslovak dhe udhëheqja e tij nuk

1. Frëngjisht — me kërcënim.

hodhën asnjë pushkë, kurse unë kam bindjen se në Jugosllavi do të luftohet këmba-këmbës dhe nuk do të lejohen brezhnjedianët sovjetikë të hyjnë në tokën jugosllave pa u gjakosur mirë me popujt e Jugosllavisë. «Armikun mos e duaj, por pjesën ia ruaj», thotë populli ynë. Është fakt se popujt e Jugosllavisë janë popuj trima dhe udhëheqja revizioniste jugosllave nuk do t'i nënshtrohet sulmit sovjetik, siç bëri udhëheqja çekoslllovake.

Për sa u përket shqiptarëve që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi, në një rast të tillë, në rast se sovjetikët do të sulmojnë, jemi të sigurt se do të ngrihen e do të luftojnë. . . Ne nga ana jonë, jemi dhe do të jemi kurdoherë në gatishmëri për të mbrojtur atdheun tonë dhe për të ndihmuar Jugosllavinë në luftën e çlirimit kundër të njëjtit armik, ashtu siç e kemi deklaruar.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha: «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 12 f. 447

**NË BAZË TË SHIKOJME TË PËRGATITUR
DUKE NJOHUR MIRË PROBLEMET
QË E SHIQUETËSOJNË ATË**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

17 prill 1979

Në këtë takim u bisedua për konferencat e Partisë në rrethe dhe për një stil të ri pune në Parti.

Duke marrë fjalën, shoku Enver Hoxha tha:

Në dy vjet një herë ne bëjmë zgjedhjet në Parti¹. Këto zgjedhje, siç kemi thënë, nuk duhet të jenë formale. Nuk është aspak me vend të mendohet se janë caktuar që më parë se kush do të zgjidhet në këtë ose në atë forum, pasi kjo praktikë nuk është as demokratike, as revolucionare, bile është e dëmshme edhe për Partinë, në radhë të parë, por edhe për personin që zgjidhet në forum. Kjo nuk do të thotë se Partia nuk mund e nuk duhet të bëjë njëfarë parashikimi, por një gjë e tillë nuk duhet t'i pengojë komunistët

1. Është fjala për konferencat e Partisë në rrethe.

që të thonë në mbledhje ato që mendojnë për njërën ose për tjetrën kandidaturë. Siç ka të drejtë sekretari i komitetit të Partisë të bëjë një propozim, të njëjtën të drejtë ka edhe çdo komunist i thjeshtë që të propozojë, ose të shprehët se nuk është dakord të zgjidhet ai që propozohet dhe për këtë të japë arsyet. Mund të ngrihen të tjerët ta mbështetnin atë e të argumentojnë me fakte se kjo që thotë parafolësi është e vërtetë, kurse këto të tjerat që na u thanë nga ai që propozoi nuk janë të vërteta. Diskutimet hidhen në balancë, peshohen e pastaj vlerësohen nga mbledhja.

Të gjitha të dhënat për kandidatët që propozohen të jenë të lidhura ngushtë me punën. Të mos bëhet zgjedhje për zgjedhje, se formalizmi në zgjedhje nuk është revolucionar. Në organet drejtuese të Partisë të zgjidhen njerëzit më të mirë që me punën, me sakrificat dhe me virtytet e tyre komuniste kanë bërë përpjekje të mëdha për të plotësuar detyrat, kanë treguar zotësi, zgjuarsiri, kanë dhënë shembull, në organizim, në disiplinë etj. Të tillë njerëz duhet të dalin në udhëheqje, se këta janë më të mirët në radhët e Partisë.

E them këtë, se mendoj që ekzistojnë edhe shfaqje të formalizmit në zgjedhje. Ndodh që mbledhjet për këtë qëllim bëhen të shpejta dhe të përcipta. Ka komunistë që në këto mbledhje nxjerrin nga xhepi diskutimin që kanë përgatitur, e lexojnë atë, solidarizohen me detyrat e raportit dhe pastaj edhe me kandidaturat e propozuara. Unë nuk them që mbledhjet të vazhdojnë me ditë e me net të tëra, por një mbledhje për

dhënie llogari e zgjedhje duhet të bëhet në mënyrë revolucionare dhe si e tillë ajo mund të vazhdojë edhe deri në dy të natës. Të tilla mbledhje shumë të rëndësishme për jetën e Partisë, natyrisht, ne nuk i bëjmë për të diskredituar njerëzit, por komunistët duhet t'i mësojmë t'i kërkojnë llogari mirë njëri-tjetrit, që ata të shkunden nga të metat, të njohin gabimet. Edhe ata që kanë qenë në udhëheqje dhe që kanë bërë ndonjë gabim, por që e kanë kuptuar këtë dhe janë përmirësuar, mund të dalin prapë në udhëheqje, vetëm se «koka duhet t'u lahet» mirë për gabimet që kanë bërë, që të mos i përsëritin.

Shumë herë listat e kandidaturave hartohen me kohë në komitetin e Partisë dhe komunistët në konferencë, me një disiplinë gjoja proletare, presin që t'u flasë i deleguari dhe pastaj t'u lexohet lista e kandidatëve që propozohen, me të cilën ata, për të mos thyer «disiplinën» e Partisë, pa u thelluar, bien dakord edhe kur kanë vërejtje. Po të ecet kështu, komunisti edhe kur ka gjëra për të thënë, nuk i thotë. Këto vërejtje, në qoftë se nuk janë bërë zyrtarisht nga komunistët, miqësisht ata ia thonë shoku-shokut. Ne duhet të bëjmë një punë të tillë edukative që vërejtjet për kandidaturën e propozuar komunistët t'ia bëjnë pa asnjë ngurrim kandidatit përpara të gjithëve në mbledhjen e Partisë. Ka edhe raste që, pavarësisht se mund të jenë dakord me kandidaturën e propozuar, komunistët mund të kufizohen vetëm sa ta kritikojnë kandidatin, fjala vjen për neglizhencë, për lënien e problemeve pa zgjidhur gjer në fund, për mungesë në or-

ganizimin e punës etj. dhe prapë të jenë dakord me zgjedhjen e tij, me kusht që ai të revolucionarizohet, të garantojë e të luftojë që të zhdukë në të ardhmen të metat e dobësitë që iu vunë në dukje.

Gjatë diskutimeve, krahas kandidaturës së propozuar, çdo komunist ka të drejtë dhe mund të propozojë për diskutim në mbledhje edhe ndonjë kandidaturë tjetër. Me këtë rast autoritetin dhe demokracinë e Partisë ai nuk e shkel aspak, bile kështu e ngre këtë më lart. Mirëpo të tilla qëndrime të drejta dhe revolucionare kuptohen keq në ndonjë rast. Duhet ditur mirë se autoriteti i Partisë nuk është vetëm te sekretarët e komitetit të Partisë ose tek anëtarët e byrosë, që kanë projektuar listat. Në mbledhje duhet të mbizotërojnë autoriteti i gjithë Partisë, pra i të gjithë delegatëve.

Komiteti i Partisë, natyrisht, ka të drejtë të propozojë kandidaturat, se ai ka në dorë kartotekën, ka statistikën, ndjek në parim dhe në praktikë veprimtarinë, sjelljet e mendimet e çdo militanti, në punë, në shoqëri, në familje, në jetë. Masa e komunistëve ka besim te komiteti si organ, si udhëheqje, por çdo anëtar partie ka të drejtë të mos e pranojë mendimin e komitetit për një kandidaturë, kur nuk bindet për drejtësinë e tij. Kjo, kur bëhet me qëllime të pastra, natyrisht, është vetëm në të mirën e Partisë. Unë nuk kam parasysh në këtë çështje për ndonjë dru të shtrembër, që mund të flasë me cmirë, po e kam fjalën për vërejtjet që bëhen të bazuara dhe nga pozita partie. Në qoftë se komunisti ka një mendim tjetër, të ndryshëm nga ai i shokut të tij, kjo nuk e cenon aspak

unitetin e Partisë, por ia ngre asaj më lart autoritetin. S'ka asgjë të keqe, përkundrazi, është një gjë shumë e mirë, kur u thuhet shokëve, që ky ose ai mendohet të zgjidhet në forumin e Partisë, dhe, kur zgjidhet, të ndihmohet që në atë ose në këtë drejtim të ketë kujdes gjatë dy vjetëve, të jetë në krye të detyrës, se, kur të vijë zgjedhjet, do të kalojë përsëri në vrimë të gjilpërës e jo si thika në gjalpë. Vetëm puna, drejtësia, forca e mendimit marksist-leninist, në qoftë se i kanë manifestuar në punë dhe në mbrojtjen e vijës së Partisë, duhet t'i bëjnë komunistët që të ngrihen në udhëheqje.

E kam theksuar edhe herë të tjera se ka rëndësi shumë të madhe që këtu, në Komitetin Qendror, të bëhet një punë përgatitore e tillë për këtë qëllim. Instruktorët, që do të përgatiten për këto punë, t'i lënë mënjanë gjërat e vogla, të thjeshta, të rëndomta, mbeturinat e një pune rutinë që kur shkojnë në bazë, të diktojnë duke u dhënë çdo gjë nga lart: kjo të vihet këtu, ajo të vihet atje, kjo të bëhet kështu dhe ajo ashtu. Në grumbullin e madh të problemeve, natyrisht, ka shumë gjëra, në të cilat është e domosdoshme të vërë dorë Partia. Udhëheqjes i duhet të merret me problemet e mëdha, se të voglat, që janë të shumta e të përditshme, i shikon e duhet t'i zgjidhë vetë baza. Instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror duhet të merren me problemet kyç dhe konkluzionet që nxjerrin nga puna që bëjnë t'i diskutojnë me sekretarët e Komitetit Qendror. Pastaj ju, shokë sekretarë, mund të bëni mbledhje në aparatit e Komitetit Qendror dhe të

nxirrni detyrat kryesore që dalin për t'ua shtruar rretheve.

Ju thatë se me rastin e zgjedhjeve do të dërgohen në rrethe instruktorë të aparatit të Komitetit Qendror dhe të deleguar. Mendoj se është e domosdoshme që këta të njohin mirë problemet që kanë të 26 rrethet e republikës. Ata nuk duhet të mendojnë sikur i dinë të tëra gjërat, por të vrasin mendjen për të përcaktuar ato që janë më shqetësuese në njërin apo tjetrin rreth. Ndryshe, kur të shkojnë në bazë, do të merren vetëm me probleme që duken shqetësuese në sipërfaqe. Ne duam që mbledhjet këtu në aparat të zhvillohen me debate, që instruktorët të pyesin, të përgjigjen e të debatojnë gjerësisht dhe jo të flasin vetëm shokët sekretarë, si Hysniu, Ramizi, ti Simon ose ndonjë tjetër. Vetë instruktorët të ngrihen e të diskutojnë për problemet në rrethe, të gjejnë dhe të sugjerojnë rrugëzgjidhjet e tyre etj.

Dihet se çdo rreth ka veçoritë e tij, bile edhe brenda një rrethi, në zona të ndryshme të tij, ekzistojnë veçori, pra, edhe probleme të veçanta. Edhe brenda në familje ka veçori, ka probleme që dalin në marrëdhëniet midis nuses dhe vjehrrës, kunatit e kunatës, vëllait e motrës, prindit e fëmijës, pra lindin edhe fërkime që duhen zgjidhur. Por këto duhen zgjidhur me urtësi. Logjika e njerëzve, autoriteti i atij që përpiqet t'i zgjidhë mosmarrëveshjet me drejtësi e në frymë partie, bën që në familje pjesëtarët të merren vesh dhe të rrojnë në harmoni e në unitet. Kështu edhe në punën e Partisë. Në qoftë se udhëheqja e Partisë nuk

do t'i shikojë mirë dhe nga afër këto veçori që ekzistojnë në bazë zone e rrethi, atëherë ajo nuk do ta njohë si duhet situatën dhe nuk mund të sigurojë unitetin që dëshirojmë.

Fjalën e kisha këtu që instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror dhe ca më tepër anëtarët e Komitetit Qendror, që shkojnë si të deleguar në bazë, të marrin me problemet më kryesore, që dalin nga analizat e konkluzionet që bëhen, pra, këta t'u futen punëve që çalojnë atje dhe që janë përcaktuese në zhvillimin e rrethit, në çdo fushë: politike, ekonomike etj. Kur them që ata t'u futen problemeve kryesore të rrethit, nuk kam parasysh një angazhim në përgjithësi, por një angazhim konkret. Në qoftë se në fushën e bujqësisë, fjala vjen, del e theksuar ndjenja e pronës private që shfaqet, ta zëmë, në prirjen për të zgjeruar kopshtin në përdorim personal, duke shtyrë gjerdhet, ose kur këto kopshte përdoren jo për nevojat e familjes apo për rritjen e bagëtive të oborrit, por për të prodhuar për tregun privat, se anëtarët i kullosin bagëtitë personale arave të kooperativës, atëherë në këto çështje duhet qëndruar konkretisht, se këtu është thelbi dhe duket qartë që është deformuar direktiva që ka dhënë Partia. Pra, kur shihet se në një rreth kooperativistët i kushtohen më shumë oborrit personal dhe nuk dalin rregullisht në punët e kooperativës, ose nuk i dërgojnë rregullisht fëmijët në shkollë, por i mbajnë për të ruajtur bagëtitë personale, atëherë duhet konkluduar se këtu ka shfaqje të theksuara të ndjenjës së pronës private të fshatarit. Këto fenomene duhen vlerësuar si

shfaqje të liberalizmit e të plogështisë në punën e Partisë, gjë që ndikon në dobësimin e bujqësisë e të ekonomisë kolektive kooperativiste. Në një rast të tillë duhet menduar se në këtë rreth, me gjithë përpjekjet e bëra për kuptimin e drejtë politik të pronës kolektive, ka akoma mangësi që duhen eliminuar.

Le të marrim prapambetjen në fushën e zakoneve të vjetra. Çfarë zakonesh prapanike ka, për shembull, në Kukës, më tepër se në rrethet e tjera? Atje mund të ketë, bie fjala, shkelje të të drejtave të gruas, fejesa në moshë të mitur, dhënie shpërblimi për martesë, martesë me pajë të madhe etj. Këto janë probleme shoqërore që Partia nuk duhet t'i harrojë. Lufta kundër tyre duhet vazhduar, se, po u ndërpre, do të nxjerrin përsëri krye e do të ringjallen më me forcë.

Në rrethin e Pukës, nga sa më kujtohet, ruhet akoma një traditë e vjetër, sipas së cilës martesat i bëjnë shumë larg fshatit. Kjo është një mbeturinë fisnore, që e konsideron lidhjen e gjakut midis djalit dhe vajzës gjer në tre breza e më shumë, por njëkohësisht këtu kemi të bëjmë edhe me një traditë që ka lidhje me përpjekjet që bënte fisi në të kaluarën për të siguruar miq e aleatë në fshatra e krahina të largëta me qëllime mbrojtjeje etj.

Në rrethe të tjera në fushat e industrisë e të bujqësisë ka gjithashtu probleme nga më të ndryshmet. Po a u futen këtyre problemeve instruktorët? Në qoftë se problemet do të njihen dhe do të evidencohen në këtë mënyrë nga ana e tyre, atëherë anëtarit të Komitetit Qendror që do të ngarkohet të shkojë në rreth si i

deleguar, do t'i sugjerohet që ta përqendrojë vëmendjen në këtë dhe në atë çështje, kurse për të tjerat le të diskutojnë vetë drejtuesit e Partisë në rreth, ose t'ua lënë t'i diskutojnë organizatat-bazë. Kështu, pra, ndihmohet i deleguari që të trajtojë ato probleme që preokupojnë rrethin dhe ta vërë theksin atje ku plaga kërkon një kujdes më të madh për t'u kuruar. Vetë i deleguari, duke vajtur në rreth, do të njohë gjendjen dhe problemet, do të kontrollojë disa organizata partie, do të konsultohet gjerësisht me komunistë e sekretarë organizatash-bazë, që pastaj të mund të shtrojë e të zbërthejë mirë problemet dhe jo të kënaqet duke thënë pesë fjalë dhe me këtë ta quajë punën të përfunduar.

E kam theksuar vazhdimisht që kuadrot drejtues të Partisë në rrethe nuk e kanë bërë akoma të vetën frymën popullore të zbërthimit të problemit. Del në televizor sekretari i një komiteti partie dhe flet me fraza: «Partia ka vendosur», «Qeveria ka vendosur», «kjo është një gjë e madhe». Flet disa minuta ai, por nuk thotë hiçgjëkafshë, vetëm fraza të njohura, me një formalizëm e zyrtarizëm burokratik. Pse nuk flasim këta shokë në mënyrë të natyrshme, me fjalë të thjeshta, të flasim, për shembull, lidhur me tërmetin, se në rreth na goditi një fatkeqësi e madhe, na janë shembur kaq shtëpi, patëm kaq të vdekur dhe akoma na kanë mbetur kaq të plagosur, se tash po marrim masa për zhdukjen e pasojave, po zhvillojmë një veprimtari të madhe në popull, dhe për të na lehtësuar dhimbjet gjithë Shqipëria është ngritur në këmbë etj., etj. Përse nuk flasim, pra, siç flet populli? Ja, ne

dëgjuam edhe një grua, Drane e quanin, e cila tha: «Ne kemi Partinë në ballë, gëzimet dhe hidhërimet i ndajmë bashkë me të, prandaj nuk tutemi fare. Kur dëgjova vendimin e Komitetit Qendror të Partisë, m'u zhduk hidhërimi fare për rrëzimin e shtëpisë. Do të punojmë dhe do t'i bëjmë prapë shtëpitë». Ja, kështu flasin njerëzit e thjeshtë të popullit. Kështu duhet të flasim edhe ne, bijtë, kuadrot dhe udhëheqësit e tij. Të trajtohen problemet ashtu siç kërkon Partia dhe siç i kupton më mirë populli.

Po pse nuk trajtohen kështu problemet nga disa kuadro? Sepse ata nuk u futen atyre në brendësi dhe nuk i shohin ato në të gjitha aspektet. Një njeri që ka njohuri të mjaftueshme për anët kryesore pozitive e negative të thelbit të një problemi, nuk e ndien nevojën të flasë me letër. Përse të vemi në popull e të flasim me fjalë «të mëdha»? Që të tregojmë kush jemi?! Jo, masat të dëgjojnë më me vëmendje kur u flet thjesht, shtruar e hapur. Nuk i kapërdin frazat boshe e të përgjithshme populli. Pra të mos u qepemi formulimeve intelektualiste që nuk thonë gjë, por të mësojmë e të flasim me shpirtin dhe me gjuhën e kuptueshme të popullit.

Përgatitja e shokëve të aparatit të Komitetit Qendror që shkojnë në rrethe, më duket se duhet të bëhet me kujdesin e seriozitetin më të madh. Unë nuk them se nuk është futur kjo praktikë në punën e tyre, por, në përgjithësi, kam përshtypjen se jo të gjithë shokët e aparatit e bëjnë këtë përgatitje në nivelin e duhur. Shokët e udhëheqjes nuk duhet të venë në ato mbledhje

që bëhen, pa siguruar qysh më parë një përgatitje serioze nga ana e punonjësve të aparatit të Komitetit Qendror. Edhe pa vajtur në rreth, unë mund t'u them shokëve atje shumë gjëra, kështu siç po ju them juve, dhe besoj se deri në njëfarë shkalle do të jem në temë për mënyrën se si duhet të venë e të punojnë shokët në rrethe. Por kjo është një punë krejt e pamjaftueshme. Që të vejë atje Hysniu e Ramizi, që i njohin problemet si edhe unë, duhet të jenë ndihmuar më parë nga instruktorët e aparatit, të cilët duhet të jenë në gjendje t'u referojnë shokëve të udhëheqjes problemet më preokupante të rrethit, si qëndrojnë ato, ç'pengesa e dobësi ka atje etj.

Aparati i Komitetit Qendror duhet të bëjë një punë të menduar edhe për caktimin e të deleguarve që do të venë në konferencat e Partisë të rretheve. Fjala është që këta të caktohen në bazë të njohjes që kanë për gjendjen e punëve në rreth dhe jo të bëhet shpejt e shpejt një listë sa për të caktuar se ku do të dërgohet njëri apo tjetri. Formalizmi edhe këtu duhet luftuar. Në caktimin e tyre të mbajmë parasysh çështjen që në shtruarjen e problemeve ka të bëjë shumë autoriteti dhe aftësia e personit që shkon në rreth. Fakt është se jo të tërë anëtarët e Komitetit Qendror kanë autoritet dhe kapacitet të njëllojtë. Ata nuk janë të informuar plotësisht njëllor për të gjitha problemet dhe për gjendjen e të tëra rretheve. Prandaj është mirë të bëhet një punë e diferencuar. Në qoftë se në një rreth na shqetësojnë çështje organizative partie, atëherë atje duhet të vejë me shërbim ai anëtar plenumi

që është më me eksperiencë në këtë drejtim. Për problemet ideologjike duhet të vejë ai që është më kompetent në këtë fushë dhe në gjendje që të ngrejë si duhet këtë ose atë problem. Kur na shqetësojnë në një rreth, ta zëmë, çështje të industrisë mekanike, atëherë atje më mirë është të vejë një anëtar i Komitetit Qendror që mund të jetë inxhinier. Në qoftë se diku ka çështje që kanë të bëjnë me jetën e rinisë, s'ka dyshim që duhet të vejë ai anëtar i Komitetit Qendror që ka punuar me rininë. Në bazë të këtyre kritereve, mendoj unë, duhen caktuar shokët e Plenumit të Komitetit Qendror me shërbim nëpër rrethe, pra sipas aftësisë, profilit dhe sipas nivelit të përgatitjes së tyre. Por nuk është e domosdoshme që kurdoherë të shkojnë me shërbim të tërë anëtarët dhe kandidatët e Komitetit Qendror. Në qoftë se një anëtar ose kandidat i Komitetit Qendror punon në Librazhd ose punon në një ndërmarrje ekonomike si drejtor apo inxhinier në Kukës, le të rrijë atje, se edhe atje kemi organizata partie, kemi halle, kemi përpertime, por edhe vështirësi. Ai e njih situatën atje, prandaj të mos e shkëputim andej, bile mund t'i dërgojmë edhe një ndihmës, po të jetë nevoja. Një herë në dy vjet edhe këta shokë mund t'i dërgojmë në ndonjë aktiv, plenum etj., se duhet t'i mësojmë, por jo t'i lëvizim disa herë brenda vitit, duke u thënë shkoni atje apo në vend tjetër.

Më parë të dihet nga i deleguari problemi që do të shtrohet në rreth. Ne nuk mund të themi që nuk i njohim situatat, por nuk duhet të harrojmë se këto si-

tuata, natyrisht, nga koha në kohë, pësojnë evolu-
cion, për mirë ose për keq. Një rreth, për shembull,
deri dje ishte mbrapa me planin. Por tash ka dalë në
krye, kurse një rreth tjetër në disa drejtime kyç nuk
ecën mirë. Atëherë del problemi cilin anëtar të Ko-
mitetit Qendror duhet të dërgojmë atje? Përse duhet
të flasë në këtë rreth i deleguari i Komitetit Qendror?
Për patriotizmin apo për disa probleme në përgjithësi?
Është mirë që atje të dërgojmë një kuadër tjetër që,
duke e njohur mirë rrethin, të flasë për ato fenomene
jo të mira që ngjasin atje dhe të ndihmojë me punën
e tij për të forcuar edhe më shumë ndjenjën e patrio-
tizmit në masat e popullit të kësaj krahine. Ai edhe
mund të zbërthejë se ç'është patriotizëm dhe ku
e si shfaqet ai në kushtet e sotme e të vërë theksin
se patriotizëm me fjalë nuk ka, se nuk mund të jetë
patriot ai që vjedh, ai që nuk punon si duhet në koo-
perativë ose kudo ku e lyp interesi i atdheut, ai që nuk
dërgon fëmijën në shkollë, që vajzën e marton me
shkuesi. Këto nuk kanë të bëjnë me patriotizmin socia-
list, patriotizmin revolucionar, që i shërben ndërtimit të
socializmit, përmirësimit të jetës së popullit dhe for-
cimit të mbrojtjes së atdheut. Ky problem, më duket
mua, është me rëndësi.

Instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror të
përgatiten mirë edhe për 35-vjetorin e Çlirimit të At-
dheut dhe 100-vjetorin e lindjes së Stalinit, që këto të
festohen siç duhet dhe të priten me arritje të mira në
çdo fushë. Ata duhet të thellohen edhe vetë sidomos
lidhur me jetën dhe veprën e Stalinit, sepse, siç dihet,

atë e sulmojnë edhe revizionistët, edhe borgjezia. Atë e sulmuan në fillim revizionistët sovjetikë, Hrushovi dhe hrushovianët. Lidhur me këto rrethana, edhe instruktorët duhet ta dinë mirë se në cilat drejtime u sulmua ai, pse u sulmua etj. Çfarë nuk është thënë për Stalinin nga armiqtë e komunizmit! Ne si komunistë duhet ta mbrojmë Stalinin, duke hedhur poshtë me argumente të gjitha ato që janë thënë kundër tij, sepse nuk janë të vërteta ato që thuhet se luftën gjoja e paska bërë Hrushovi, kurse Stalini bënte shir përpara një globi të shkollës fillore etj., etj.! Pra, ç'thotë bota, ç'thonë komunistët e vërtetë dhe ç'thotë borgjezia për Stalinin, të gjitha këto duhen njohur mirë. Borgjezia për Stalinin shpif, se, natyrisht, ai ishte kundër saj. Dhe shpifjet e Hrushovit kundër Stalinit, borgjezisë i erdhën sipas midesë.

Duhet vënë gjithashtu në dukje edhe ç'kanë thënë kundërshtarët më të rreptë të Stalinit. Ç'ka thënë Çërcilli, ç'ka thënë Rusvelti apo Dë Goli. Rusvelti e ka cilësuar Stalinin si «strategun më të madh të Luftës së Dytë Botërore».

Kështu, pra, puna e Partisë duhet të shërbejë për të bërë mirë zbërthimin e vendimit¹ të Komitetit Qendror, me synimin që të ndihmohen njerëzit tanë të mësojnë të vërtetën dhe të mos ndikohen nga propaganda armiqësore borgjeze e revizioniste. Zbërthimi i vendi-

1. «Për festimin e 100-vjetorit të lindjes së J. V. Stalinit», 20 mars 1979. Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëllimi VII, f. 448-451, Tiranë, 1982.

mit nuk mund të bëhet duke thënë disa fjalë të thata të përgjithshme se «Stalini është një marksist-leninist i madh, nxënës besnik i Leninit, mik i shtrenjtë i Partisë sonë dhe i gjithë popujve të botës, udhëheqës i proletariatit» etj., etj., të cilat janë thënë e stërthënë. Ne duhet t'u kundërvihemi armiqve me argumente për të bërë që shpifjet e armiqve kundër Stalinit të mos zënë vend tek asnjë. Për këtë qëllim të bëhen leksione, artikuj, ku të theksohet se çfarë thotë Stalini për unitetin, për shtetin, për diktaturën e proletariatit, ç'kupton ai me kritikën dhe autokritikën, me ndihmën reciproke në marrëdhëniet midis vendeve socialiste etj., etj. Të shkruhet, gjithashtu, ç'ka thënë Stalini për imperializmin, për fashizmin, si duhet interpretuar traktati i mossulmimit me Gjermaninë etj.

Gjithashtu ne duhet të përgatitemi edhe për zbërthimin e zbatimin e vendimit¹ të Komitetit Qendror «Mbi festimin e 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor». Në vështrimin e parë duket sikur të tërë e njohin mirë gjithë periudhën 35-vjeçare që na ka sjellë deri në këtë përvjetor, sepse e kemi jetuar, se kemi luftuar për socializmin etj. Kjo është një periudhë me rëndësi të madhe, se gjatë kësaj kohe janë zhvilluar ngjarje historike shumë të ndërlikuara. Në Luftën Nacionalçlirimtare janë zgjidhur një varg problemesh, por edhe më vonë lufta ka vazhduar e pandërprerë për 35 vjet me radhë. Kjo luftë ka qenë

1. Shih: «Dokumente kryesore të PPSH» vëll. VII, L 452-455, Tiranë, 1982.

shumëformëshe dhe është zhvilluar në shumë fronte: kundër vështirësive e mungesave të shumta, kundër armiqve të brendshëm të popullit dhe të Partisë, kundër revizionistëve jugosllavë, atyre sovjetikë, kinezë etj. Gjatë këtyre 35 vjetëve janë bërë, pra, edhe shumë luftëra të tjera, të kombinuara, të koklavitura, të vështira. Në vazhden e kësaj lufte heroike për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut, shquhen në mënyrë të veçantë disa momente historike politike që kanë të bëjnë me organizimin shtetëror, me ndërtimin e shtetit, me luftën e brendshme e të jashtme të Partisë, me ndërtimin e aparateve të saj, me ndërtimin e ekonomisë, të ushtrisë etj., etj.

Këto çështje instruktori duhet t'i dijë mirë, pasi në këtë mënyrë ai do të jetë në gjendje t'i shtrojë çështjet drejt, të flasë me kompetencë, konkretisht dhe në mënyrë bindëse. Që ta arrijë këtë, ai për çdo problem e vendim të Partisë duhet të mbështetet në materiale e dokumente të Partisë.

Para se të dërgohen shokët instruktorë në bazë, ne duhet t'i porositim që të bëjnë një plan të detajuar të të gjitha këtyre që thamë dhe të punojnë edhe vetë pa u lodhur që të përgatiten seriozisht për të instruktuar shokët e rretheve me qëllim që t'i shtrojnë problemet jo me pesë fjalë, por në mënyrë të plotë.

Kështu, mendoj unë, marrja me këto probleme kaq të rëndësishme nuk është detyrë vetëm e një apo e dy shokëve, por e të gjithë instruktorëve të aparatit. Prandaj të koordinohet mirë puna midis sektorëve këtu në aparat. Secili të mendojë se çfarë duhet bërë

për ta festuar sa më mirë këtë jubile, për të nxitur mobilizimin e komunistëve e të masave. Kjo kërkon që në punën edukative e propagandistike të kujtojmë se çfarë është bërë në vendin tonë gjatë këtyre 35 vjetëve për ndërtimin e ekonomisë socialiste, si i kemi arritur tërë këto suksese, vështirësitë që kemi kapërcyer dhe si i kemi vënë në zbatim porositë e Partisë... Sigurisht, në shpjegimet që do të bëjnë punëtorët dhe agjikatorët e Partisë nuk do të futen në hollësi, por do të përqendrohen në disa drejtime kryesore. Fjala vjen, do të theksohet se këto suksese u arritën për arsye të një organizimi të fortë dhe të unitetit të çelikut të Partisë, për arsye se kemi ndjekur rrugën që përcaktoi Partia që në themelimin e saj. Partia jonë gjatë kësaj periudhe u rrit e u forcua gradualisht dhe sot në radhët e saj janë 110 mijë komunistë. Është punuar shumë për ta mbajtur Partinë të pastër dhe të fortë, është derdhur djersë e gjak sepse, krahas njerëzve e komunistëve të devotshëm, kemi pasur edhe kundërshtarë të vendosur ndaj të cilëve kemi luftuar e fituar. Kështu duhen trajtuar arritjet tona në festimet e këtij 35-vjetori të lavdishëm.

Prandaj t'u japim rëndësi përgatitjeve të instrukto-rëve para se të shkojnë në bazë. Edhe kur ata të kthehen në aparat, mendoj, të kemi kujdes që të mos na raportojnë për gjëra të rëndomta, por të na informojnë për ato më të rëndësishmet, thelbësoret, të përcaktojnë arsyet politike, organizative, ideologjike pse ndodh ky ose ai fenomen e ç'masa janë marrë, jo vetëm për t'i eliminuar ato, por edhe për të mos u përsëritur më.

Këto na nevojiten që të dalim me konkluzione se ku nuk ecën puna mirë, ç'masa duhen marrë për përmirësimin e gjendjes, ç'ekipe e grupe pune me njerëz kompetentë dhe të aftë duhet të dërgojmë për ndihmë, për të ndryshuar situatën etj. Kështu duhet të punojë aparati i Komitetit Qendror, të funksionojë mirë, të jetë gjithnjë në lëvizje «makineria», e cila të përpunojë materialet e Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror në mënyrë të sintetizuar dhe këto t'ia dërgojë pastaj bazës.

Ne duhet t'i përgatitim njerëzit, kuadrot dhe Partinë me një stil pune krejt të ndryshëm. Në këtë drejtim kuadrot e Partisë të mësojnë nga shembulli i klasës punëtore, nga shembulli i popullit, të hedhin poshtë formalizmin, të hedhin poshtë frikën se mund t'u bjerë autoriteti nëse nuk do të flasin me fraza të bukura. Populli kërkon fjalë të thjeshta, të lidhura me jetën e gjallë, me realitetin tonë. Populli nuk ka nevojë për llafe pa bukë, ai do që ta zësh demin nga brirët.

Kështu mendoj unë t'u themi shokëve të vepronjë kur bashkëbisedojnë me njerëzit e popullit. Bile me ta të bëhet edhe debat, të flitet me pyetje e përgjigje, me qëllim që ata të binden për ato që u thuhet dhe jo t'u imponohen mendimet. Kur u flet masave me qetësi dhe pa i imponuar, kur bëhet debat dhe bashkëbiseduesi thotë edhe mendimin e tij, kjo është shumë e frytshme për dy arsye: së pari, se do të diskutohet e do të dalë në shesh si është e drejta dhe, së dyti, kështu bëhet më mirë edukimi i njerëzve, sqarohen mendimet, hidhen poshtë me argumente e urtësi men-

dimet e gabuara, interpretimi i keq i çështjeve. Dhe kjo ka shumë rëndësi, se Partia kështu i fiton njerëzit, sepse i mësojmë këta jo vetëm të mos gabojnë, por edhe të mos veprojnë në mënyrë të verbër, pra luftohen oportunizmi dhe konformizmi, që janë shumë të rrezikshëm. Prandaj kur dikush e shtron gabim një problem, qoftë ky edhe kuadër me përgjegjësi, secili duhet të reagojë e të ndërhyjë që të korrigjohet. Kështu, në punë, ne t'i mësojmë njerëzit që ta kuptojnë se Partia është kudo.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e inçizuar, që gjendet në AQP*

**NË ZONAT E DËMTUARA NGA TËRMETI
NDËRTIMET TË BËHEN MË TË FORTA
E MË TË BUKURA**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

18 prill 1979

Në këtë takim shoku Ramiz Alia informoi gjerësisht për gjendjen në rrethet Shkodër e Lezhë, të dëmtuar nga tërmeti i 15 prillit:

SHOKU RAMIZ ALIA: Në rrethet Shkodër e Lezhë u takuam me njerëzit, me popullin. T'ju them të drejtën, shokë, kur shikoje atë fatkeqësi të madhe, ato shtëpi të rrënuara fare përtokë, të vinte shumë keq. Por, kur takoje njerëzit në këto rrethe të dëmtuara aq rëndë nga tërmeti, ata nuk prisnin t'u jepje kurajë, por flisnin me optimizëm, me një besim të madh te Partia, me një dashuri e siguri të madhe për mposhtjen e fatkeqësisë, që me të vërtetë të ngrinte peshë. Dhe aty ku nuk kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi në njerëz, të tërë në një gojë thoshin: «Mirë që nuk na u vra njeri, pa vështirësitë do t'i kapërcejmë. Partia

na është ndodhur gjithnjë pranë, të gjithë ne e ndiejmë pranë Partinë». Një malësor më tha: «Partia ka ardhur qysh mbrëmë këtu mes nesh. Kush na solli bukë, kush na i solli çadrat?».

SHOKU ENVER HIXHA: Ai shprehu kuptimin e vërtetë se ç'është Partia.

SHOKU RAMIZ ALIA: Po, kuptimin e vërtetë të asaj çka është Partia. «Na erdhi Partia, na erdhi shoku Enver që në minutën e parë të fatkeqësisë» tha malësori. Fjalët ishin prekëse. Malësorët kanë një të folur të rrjedhshëm e plot emocion.

SHOKU ENVER HIXHA: Ashtu duhet të flasim edhe kuadrot, Ramiz, thjeshtë, siç flet populli.

SHOKU RAMIZ ALIA: Më bëri përshtypje, shoku Enver, ajo që më thanë shokët e Partisë në Shkodër. Sapo kishte ndodhur tërmeti, të gjithë komunistët, sidomos të vjetrit, në masë, kishin shkuar në komitetin e Partisë. «Jemi në dispozicion të Partisë, jemi gati të shkojmë ku të na thotë Partia», thanë të gjithë, Shyqyri Hafizi, Nazmi Dibra, komunistë dhe nga ata që s'janë në Parti. Dhe të gjithë, bashkë me shokët e komitetit të Partisë, shkuan menjëherë në fshatrat që ishin dëmtuar më rëndë. Kjo është një gjë shumë pozitive. E kanë traditë të mirë këtë shkodranët. Në të gjitha qendrat e punës në qytet ishin bërë mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë (se qendrat e punës i kanë në patronazh fshatrat) dhe kishin dërguar menjëherë njerëz të vëllëzërit e tyre fshatarë, të cilët i pyesnin: «Për çfarë keni nevojë? Keni nevojë për fuqi punëtore. për vegla pune, për para? Për çdo gjë që keni nevojë,

na thoni, se jemi gati t'ju ndihmojmë». Buka menjëherë iu sigurua fshatrave nga qyteti.

Gjithë kjo gatishmëri e popullit tregon besimin e madh që ka ai në vijën e Partisë, besimin tek e sotmja dhe tek e ardhmja e tij e ndritur...¹.

SHOKU ENVER HOXHA: Të gjitha këto tregojnë për frymën e zjarhtë revolucionare që i karakterizon komunistët tanë. Partia vetëvepron. Nuk është nevoja, si të thuash, që t'i biesh bilbilit për t'i mbledhur anëtarët e saj. Të gjithë menjëherë u nisën atje ku i thërriste detyra.

Tani rëndësi ka që të organizohen mirë punët. Është e domosdoshme të koordinohet puna midis organeve të Partisë dhe atyre të pushtetit. Sapo jepet një urdhër nga shtabi qendror për zhdukjen e pasojave të tërmetit, menjëherë komitetet e Partisë të këtyre rretheve marrin masat dhe së bashku me komitetet ekzekutive, me organizatat e masave, me ndërmarrjet, i vihen seriozisht punës për kryerjen e detyrave, marrin masa të dërgohen kontrollorë dhe të caktohen afate e të gjitha të tjerat, që urdhri i dhënë nga shtabi të zbatohet mirë e në kohë. Po në shtabin qendror kishin harruar të caktonin një shok nga aparati i Komitetit Qendror të Partisë. Është mirë që ky të jetë, se do të ndihmonte për koordinimin e punës me Partinë.

1. Më tej shoku Ramiz Alia informoi për mobilizimin e madh të popullit për normalizimin e gjendjes në fshatrat e dëmtuara rëndë, për ndihmën që u dha nga banorët e qytetit dhe repartet ushtarake.

Edhe drejtimi nga ana e Ministrisë së Ndërtimit të jetë në lartësinë e duhur. Për të gjitha materialet që do t'u dërgohen rretheve të dëmtuara nga tërmeti, për kuadrot dhe vullnetarët që do të venë për të dhënë kontributin e tyre atje, të merren masa që jo vetëm të priten mirë, por edhe të sistemohen sa më shpejt, që të mos humbasin asnjë minutë kohë. Në zonat e dëmtuara duhet të ketë një shtab të fortë, në varësi të Ministrisë së Ndërtimit, i cili të ndjekë punët deri në fund. Një nga zëvendësministrat e Ministrisë së Ndërtimit të jetë atje, por në shtabet për drejtimin e gjithë kësaj pune të caktohen njerëz të aftë, drejtorë ose zëvendësdrejtorë ndërmarrjesh dhe jo njerëz të fjetur, por energjikë, të papërtuar që t'i rrinë mbi kokë punës atje në Bushat, në Velipojë, në Dajç etj., se atje janë skuadrat që punojnë, atje do të venë edhe materialet. Pra, në këto vende të ketë njerëz që t'i presin e t'i sistemojnë materialet dhe forcat t'i drejtojnë atje ku duhet të fillohet puna menjëherë. Është mirë që të gjithë ata, që do të shkojnë vullnetarë në këto rrethe, të jenë specialistë, karpentierë, muratorë etj. Por mendoj se atje ka nevojë edhe për arkitektë, se shtëpitë në këto zona duhet të bëhen të mira, të paktën dykatëshe. Për ndërtimet e reja të mendojnë e të punojnë arkitektët, të krijojnë disa modele shtëpish të bukura dhe të ndryshme.

Në mënyrë të veçantë të kujdesen për Bahçallëkun. Bahçallëku është hyrja e Shkodrës, lagjja që të jep përshtypjen e parë për këtë qytet. Prandaj të tregohet kujdes i veçantë për të. Atje duhen ruajtur pe-

mët, shegët, dhe jo pri këtej e pri andej, se për këto e ka marrë edhe emrin Bahçallëk. Atje ka vend ku të ngrihen shtëpi edhe me dy kate, por, në qoftë se nuk ka mundësi, le të bëhen me një kat e me dy-tri hyrje dhe jo të gjitha të një tipi, por të tipave të ndryshëm. Ca prej tyre të ngrihen në anë të rrugës, disa të tjera në mes të kopshtijeve. Me një fjalë, atje të bëhen të tilla ndërtime që t'i japin Bahçallëkut pamjen e një kopshti me të vërtetë të lulëzuar, ashtu siç e ka edhe emrin.

Në fshatra është mirë të largohemi nga modeli i qytetit. Dua të them, të mos i nxjerrim tash të gjitha shtëpitë në rrugë, njëra pas tjetrës në radhë, si ushtarët. Në vendin ku kanë qenë dy-tri apo katër shtëpi, ashtu t'i bëjmë ato, bashkë. Shtëpitë atje i kanë kopshtet zakonisht nga mbrapa. Por ne të nisemi nga një frymë e re, prandaj të bëhen ndërtime që t'i japin «mushkëri» fshatit, që të marrë ajër. Dhe kjo realizohet me gjelbërimin që nuk duhet të jetë vetëm nga pas, por diku përpara e diku edhe në mes të shtëpive.

Tash, përderisa këto shtëpi i bëjmë të reja, duke përdorur fondet që kemi caktuar, atëherë edhe çështja e arkitekturës të shikohet. Edhe në qendrat e tjera të banuara të bëhen ndërtime të bukura, si për shembull në Pentar, i cili pothuajse është rrafshuar krejt. Të merren masa që i tërë ky fshat të bëhet i bukur, jo ashtu hajde si të marrë rryma, po të zgjedhim dhe të planifikojmë ndërtime të mira, të studiuara me kujdes, se një herë i bëjmë. Në qoftë se atje ka pasur ndonjë kopsht apo vresht të mirë, këto të ruhen. Fjalën

nuk e kam vetëm për këtë fshat, por për secilën qendër të re që do të ndërtohet. Të parashikohen që në projekt të gjithë faktorët, edhe erërat, edhe vendi, edhe stili i shtëpisë, se kurdoherë populli i ka pasur parasysh këto kërkesa. Gjithashtu, çështjet e sizmikës duhet të mbahen në qendër të vëmendjes. Të rikuperohen të gjitha materialet që nuk janë dëmtuar, si gurë, çulla, trarë etj. Tullat për Bahçallëkun, që është në rrugë, t'i çojnë nga Barbullushi dhe për shtëpitë që do të ndërtohen këtu, të përdoren tulla të kuqe. Shtëpitë e ndërtuara me këto tulla në mes të gjelbërimit, me siguri që do t'i japin këtij vendi një pamje shumë të bukur.

Pse ngul këmbë në këto gjëra? Sepse shkodranët kanë bërë një gabim të madh që unë nuk ua fal. Ata kanë prishur Shkodrën e Vjetër, Pazarin e Vjetër, për të cilin flet edhe Barleti. I prishën, po tani ç'të bëjnë? T'i ndroqin, siç u bë në Gjirokastër? Ç'është kjo mani e rrafshimit të traditave?! Duhet ruajtur tradita sidomos në stilin e ndërtimeve. Nuk e kam fjalën për të gjitha, por për disa tradita në Shkodër, siç janë disa kolonada. Fundja tash ne mund t'i bëjmë dy shtëpi afër e afër me njëra-tjetrën dhe t'i lidhim me qemer, me disa kolona; dritaret të jenë të stilit të vjetër, por të bukura, të mbjellim atje ca hardhi etj., etj. Sidomos në Bahçallëk, e theksoj, të mbahet parasysh tradita në ndërtimet, por edhe në qendrat e tjera.

Gjithë kjo punë për likuidimin e pasojave të tërmetit duhet të bëhet nëpërmjet një aksioni të madh në shkallë kombëtare. Në rrethet e dëmtuara të venë,

në mënyrë të organizuar, specialistë vullnetarë nga të gjitha rrethet e vendit tonë, jo vetëm nga ndërmarrjet e ndërtimit, por edhe nga fshatrat, se edhe atje kemi specialistë ndërtimi. Menjëherë pas grumbullimit të tyre të caktohen teknikët që do t'i drejtojnë, t'u jepet plani i ndërtimeve se si e ku do të fillojnë punën më parë etj., etj. Duhet që çdo gjë të rikuperohet, çdo gjë të ecë në rregull, koha të shfrytëzohet sa më mirë që të shkurtohet afati i likuidimit të pasojave të tërmetit dhe materialet të përdoren me nikoqirllëk. Pra, kërkohet një organizim i mirë, se specialistët janë specialistë, por organizatorët luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Situatat janë të tilla që puna në këtë aksion të madh të fillojë në orën gjashtë të mëngjesit dhe të lihet vonë në mbrëmje, se njerëzit duhen strehuar sa më parë në shtëpitë e reja. Gjithashtu, të gjenden materialet ku janë e ku nuk janë, të sigurohen ato në kohën e duhur dhe të merren të gjitha masat e nevojshme që puna në frontin e ndërtimit të mos ndërpritet për asnjë çast.

SHOKU RAMIZ ALIA: Ishim edhe në Lezhë, shoku Enver. Qyteti është dëmtuar, sidomos pjesa ku është komiteti i Partisë dhe vendvarrimi i Skënderbeut. Shumica e shtëpive të dëmtuara atje duhen rrafshuar, se gati të tëra kanë dalë jashtë përdorimit.

SHOKU ENVER HOXHA: Të përgatitet një plan rregullues për qytetin e Lezhës. Këtu kemi të bëjmë me një qytet me histori të lashtë. Më hanë se disa ishin të mendimit që ta linin për kopshte atë pjesë që është dëmtuar shumë nga tërmeti. Por unë nuk jam dakord

me këtë mendim. Të ngarkohen dy-tre arkitektë të zotë t'i futen punës e të bëjnë planimetrinë për rregullimin e saj. Kurse varri i Skënderbeut të qëndrojë patjetër atje. Para se të vihet dorë në këtë pjesë të dëmtuar, ku ishte komiteti i Partisë etj., duhet menduar mirë, se ka pjerrësi. Prandaj mendoj që atje të bëhet diçka, për shembull, të bëhen shkallë dhe rruga të mbetet atje ku është. Pra në këtë vend deri te varri i Skënderbeut të bëhet një shesh. Ky të jetë një vend mitingjesh, vend për shëtitje, ku të ndërtohet në të ardhmen edhe ndonjë teatër veror, ku të ngrihet skena dhe disa shkallë që të shërbejnë për t'u ulur njerëzit.

Shtëpitë e qytetit të ndërtohen me planimetri. Unë jam i mendimit që këto ndërtime nuk duhet të shkojnë deri në lumë. Është gjë e bukur që një qytet të ketë pranë lumin. Dhe këtë lumë që kalon nëpër qytet, ta zësh me mure dhe me shtëpi, artistikisht nuk shkon. A ka nevojë qyteti i Lezhës për një pyllëzim, për një vend të ajrosur, ku të shkojnë banorët e saj të çlodhen e të dëfrenë? Ka, si nuk ka. Atëherë, sikur anës së Drinit të bëhet një shetitore e bukur, e pyllëzuar, a nuk do të ishte mirë? Ta zbukurojmë Lezhën, duke mbjellë shelgje të bukura lotuese dhe drurë të tjerë dekorativë. Të merret uji me pompa për ujitje dhe të krijohet një gjelbërim i madh në qytet, të zbukurohen rrugët. Ndërsa për sa i përket amfiteatrit me shkallë, të bëhet ashtu si ta mendojnë arkitektët. Duhet bërë parashikime edhe për vendvarrimin e Skënderbeut.

Tani është çështja e shtëpive, se si dhe ku do t'i

ndërtojmë. Ne nuk duhet të zëmë tokë buke. Mirëpo, në qoftë se nisemi nga ky mendim, atëherë nuk do të ketë gjelbërim në qytet. Mua më duket se qyteti i Lezhës ka mjaft vend që të zhvillohet. Shtëpitë e reja për banorët të ndërtohen në hyrje, nga krahu i djathtë tutje dhe nga krahu i majtë, që është një çikë si kodër.

SHOKU RAMIZ ALIA: Dje, shoku Enver, biseduam për këto probleme me shokët e Lezhës. Cili ishte mendimi i lezhianëve? Mendimi i tyre përputhet me këtë që thoni ju. Ata shprehën mendimin që shtëpitë të mos i ndërtojnë në breg të Drinit, po në hyrje të qytetit.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu të bëhet.

SHOKU RAMIZ ALIA: Mirëpo Mehmeti ua preu. duke u thënë që gjithë Lezha të ngjitet në mal. Ata nuk ishin dakord me këtë mendim.

SHOKU ENVER HOXHA: Të ngjitet në mal! E pse të bëhet kjo? Nuk duhen dhënë mendime të tilla të nxituara. Për këto çështje duhet marrë edhe mendimi i specialistëve, se Lezha është qytet me rëndësi historike. Ne ta bëjmë këtë qytet tamam siç e meriton, si një qendër që lidhet me historinë e Skënderbeut. Tani, që do të bëhet planimetria e qytetit, duhet mbajtur parasysh se ku do të kalojë hekurudha. Stacioni mund të bëhet në hyrje të Lezhës dhe treni të dalë në Zadrimë. Në këtë mënyrë ndërtohet një urë dhe qyteti lihet i pastër nga tymrat dhe nga të gjitha ndotjet e tjera të dëmshme për qytetin. Problemin e ndërtimeve në Lezhë ta shikojmë me kujdes.

Zhdukja e pasojave të tërmetit do të na kushtojë

miliona. Po këto miliona janë materiale, të cilat ne duhet t'i japim medoemos me plan, veçse të jemi të sigurt që do të lëmë mangut diçka diku gjetkë. Që të bëhet kjo punë si duhet, nuk është aq e lehtë. Kjo kërkon studim. Pra, se ku do të heqim, ku do të lëmë dhe ku do të zëvendësojmë ose ku do t'i bëjmë të reja që të mund të kompensohen, të tëra këto duhen menduar mirë. Rrethit të Beratit, për shembull, do t'i kërkohet që të prodhojë kaq tulla, një rrethi tjetër, kaq tjegulla. Rrethit të Durrësit të mos i kërkohen vullnetarë, por t'i shtrohet detyra që Fabrika e Gozhdë-Bulonave, për shembull, të prodhojë kaq tonë gozhdë mbi planin me dimensionet e nevojshme dhe brenda një afati të caktuar; asaj të qelq-xhamit t'i kërkohet të prodhojë xhama mbi planin. Po kështu Korçës t'i thuhet që duhen kaq mijë mentesha brenda dy muajve; kombinatit të drurit dyer e dritare e të tjera, e të tjera me radhë. Duhet forcuar prodhimi, të gjitha fabrikat e tullave të punojnë me tri ndërresa, ndërsa ato fabrika që janë në ndërtim, me goditje të përqendruar të përfundojnë dhe të futen sa më parë në shfrytëzim, në afatet që u duhen caktuar.

SHOKU RAMIZ ALIA: Menjëherë shoku Enver, qysh të dielën që ra tërmeti, nëpër ndërmarrje në Shkodër kishin shkuar sekretarë të komiteteve të Partisë të rretheve të ndryshme, nga Vlora, Korça, Durrësi, Elbasani dhe deri nga Saranda e Lushnja.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo tregon që njerëzit tanë janë me iniciativë, me vullnet, me energji, njerëz që i dinë ligjet, njohin dhe mundësitë. Të gjitha i dinë,

prandaj le të veprojnë me iniciativë. Kjo nuk do të thotë të krijojmë anarki. Jo, të krijojmë komisione, dakord, t'u japim dhe urdhër, por të jemi të sigurt se ato do t'i kapërcejnë vështirësitë. As i lajmëroi njeri, u ngritën vetë gjithë ata njerëz në këmbë dhe u thanë shokëve të rretheve të dëmtuara se ç'duhet të bëjnë për t'i ndihmuar.

SHOKU HYSNI KAPO: Që atë ditë, shoku Enver, më erdhi një shok i Partisë në Vlorë dhe më tha se ç'kishin bërë: «Kemi mbledhur sekretarët e organizatave-bazë dhe u kemi thënë që të jenë në gatishmëri; në fshatra, në bazë zonash, kërkuam të na njoftojnë sa specialistë kanë. Tani po presim të na vijnë kërkesat, se sa të tillë duhen dërguar në Shkodër e në Lezhë».

SHOKU ENVER HOXHA: Pra, ka një gatishmëri të plotë. Vetë iu futën kësaj pune. Kjo tregon se shokët e Partisë në bazë janë njerëz të pjekur, me eksperiencë, prandaj dinë se si duhet vepruar në këtë apo në atë rast. Ne mund të kemi një eksperiencë më të gjerë, më të përgjithshme se, duke qenë në funksionin e udhëheqësit të Partisë, informohemi e mësojmë nga të gjithë. Megjithatë edhe kuadri drejtues i Partisë në rreth nuk është njeri i ngushtë, se ai drejton një rreth të tërë.

Tani kërkohet mobilizim i madh në çdo front pune për t'i ardhur në ndihmë Republikës që të përballojë edhe fatkeqësinë natyrore që ndodhi në disa rrethe.

Më poshtë biseda vazhdoi rreth strukturës organizative të disa instituteve e ndërmarrjeve.

Për zhvillimin e ekonomisë sonë me ritmet që kërkohet, ne duhet të ndalemi e të shikojmë disa çështje, siç është ajo e strukturave tona organizative, që ato të jenë sa më efikase. Për këtë të mendojnë të gjithë shokët drejtues, ministra, zëvendësministra, drejtorë etj. Struktura organizative në sektorin e naftës, për shembull, është e vjetër. Këtë e kam thënë edhe një herë tjetër, që kjo çështje të rishikohet. Në Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave duhet të ketë një drejtor të fuqishme për çështjen e naftës, që të drejtojë gjithë punën në këtë sektor, që nga shpim-shfrytëzimi, transporti dhe të tëra degët e tjera me radhë, drejtoritë dhe Institutin e Naftës dhe të Gazit. Tani instituti i ka marrë të tëra kompetencat dhe ata pesë veta që ka ministria atje bëjnë siç thotë instituti. Në fakt duhet të ndodhë e kundërta. Ky duhet të funksionojë jo në mënyrë të pavarur dhe jo t'i imponohet ministrisë, por të marrë prej saj detyra, porosi dhe t'i zbatojë ato në mënyrë krijuese. Për një sektor kaq të rëndësishëm, siç është ai i naftës, në ministri duhet të ketë specialistë që të jenë në gjendje të orientojnë dhe t'i kërkojnë llogari institutit për çdo problem. Ky të bëjë detyrën dhe të japë llogari deri në një përpara Ministrisë së Industrisë e të Minierave për realizimin e detyrave që i ngarkohen. Nuk mund të lejojmë të punohet si do njëri apo tjetri, por si e kërkojnë interesat e ekonomisë sonë socialiste.

SHOKU HYSNI KAPO: Këto ditë që isha në Vlorë, Hekurani [Isai] më foli për gjendjen e makinerive dhe për prodhimin e pjesëve të këmbimit për sektorin

e naftës. Ofiçinat tona mekanike që duhet t'i prodhojnë, pengojnë, sepse ato janë të ngarkuara të bëjnë pajisje të mëdha, siç janë sondat. Pra angazhohen vetëm me këto, dhe meqë plani realizohet, lënë pas dore pjesët e vogla të ndërrimit e pajisje të tjera, që duhen për sektorin e naftës.

SHOKU ENVER HOXHA: Po mirë, more shoku Hysni, po sa kushton sonda që do të prodhojnë këta, 2 milionë, 2 milionë e gjysmë dollarë?! Është e drejtë që gjatë kësaj kohe të rrinë pa u shfrytëzuar kaq e kaq sonda që të japin, për shembull, 400-500 mijë tonë naftë? Këtu, më duket mua, duhet ecur me llogari. Përse i bëjmë këto gjëra, për famë? Kështu nuk bën të veprohet.

SHOKU HYSNI KAPO: Më bëri përshtypje, shoku Enver, edhe diçka tjetër që më tha Hekurani. Disa ndërmarrje, të cilat nuk janë të sektorit të naftës, pa lënë mënjanë detyrat e tyre, do të bëjnë gjithë ato gjëra për të shpejtuar punën në sektorin e naftës, siç është, për shembull, hapja e rrugëve për në pikat e shpimit etj. Ç'tregon kjo? Një gjë e tillë tregon se sa rezerva kanë këto ndërmarrje dhe se kush duhet t'i disponojë këto rezerva.

SHOKU ENVER HOXHA: Është shumë e qartë, atje ka munguar drejtimi.

Unë e kam thënë edhe herë tjetër, struktura e Institutit të Naftës dhe të Gazit duhet studiuar, që të ndryshojë e të përsoset, se ashtu siç është tani nuk po funksionon mirë.

SHOKU PROKOP MURRA: Pikat e shpimit nuk

jepen në rregull, ato shkojnë edhe 1 mijë metra më thellë. Pra, jepet për 3 mijë metra thellësi dhe shpimi shkon deri në 4 mijë metra.

SHOKU ENVER HOXHA: Po këtë kush e përligj? Nuk ka njeri përgjegjësi për këto gjëra? Pra, puna çalon në disa drejtime. Askush nuk e bën dhe nuk studion, për shembull, jetëshkrimin e puseve. Në institut apo në Drejtorinë e Përgjithshme të Naftës duhet të ketë një sektor të veçantë që të merret me këtë çështje të rëndësishme. Edhe vetë instituti duhet ta bëjë metodë pune që për të gjitha problemet që i dalin të organizohen diskutime, konsultime, debate shkencore, ku të rrihen e të shkëmbehen mendime dhe eksperiencë midis sektorëve të veçantë, pastaj të dilet me konkluzione. Mund të shihet edhe organika e institutit, se mund të jenë shumë veta, por që nuk punojnë mirë, që e kalojnë kohën duke u sorollatur etj. Mbase duhet «krasitur» një çikë organika e këtij instituti dhe të mbahen ata që janë njerëz të aftë, të ndërgjegjshëm në punë. Gjithashtu mendoj që institutit, drejtuesve dhe punonjësve të tjerë të tij t'u kërkohet më shumë llogari për kryerjen e detyrave të caktuara.

Ose të ndalemi e të shikojmë strukturën organizative të Institutit të Studimeve dhe të Projektiveve nr. 1 këtu në Tiranë. Institutet për të gjitha ndërtimet e Shqipërisë i kanë bashkuar në një të vetëm. Këtij instituti i kanë ngarkuar edhe projektimet për ndërtimet në zonat e dëmtuara nga tërmeti. Do t'i bëjë dot të gjitha këto detyra ky?! Përse është bërë ky bashkim? Po e kishim me dy-tre, na thuhet, dhe e bashkuam që

të shkurtonim organikat. Po në fakt, çfarë u shkurtua? A mendohet një çikë thellë se për kantieret e objekteve të mëdha industriale duhen edhe administrata, llogaritarrë, financierë e të tjerë? Kështu siç është, ne kursejmë pagën e dhjetë vetave të shkurtuar, por humbasim miliona. Duhet patjetër t'i ndajmë këto institute. Instituti për projektimin e veprave industriale mendoj se duhet të jetë më vete. Por edhe tani sektor më vete është, mund të thonë. Po, por ama me drejtorin e tij lidhen të gjithë. Ja, tani do të bëhen projekte për qytete të tëra. E po ku të venë më parë specialistët e këtij instituti?

Ka rëndësi të mendohet thellë për këtë punë, sepse vendin po e ndërtojmë me forcat tona, edhe projektet e fabrikave tani po i bëjmë vetë. Në këto kushte duhet të jemi realistë më shumë se kurrë. Shokët e Qeverisë thanë se kështu do të bëjmë, do ta studiojmë këtë çështje. Ta studioni, u thashë unë, por kjo punë të bëhet një çikë shpejt, të mos zgjatet gjashtë apo shtatë muaj.

Përse t'i ngre unë çështjet e organikave dhe nuk i ngrenë ministrat dhe zëvendësministrat që merren me këto gjëra përditë? Ç'bëjnë këta njerëz? Pse, vetëm ne këtu duhet të japim mendime e porosi që kjo të bëhet kështu e ajo të bëhet ashtu? Përse ngurrojnë ata ta ngrenë këtë problem?

SHOKU HYSNI KAPO: I mësojmë njerëzit që të mos vetëveprojnë, të jenë pa iniciativë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ata kanë iniciativë, por i vënë disa përpara. Kështu nuk mund të ecë puna

jonë. Kur pyeten «pse nuk e shtroni problemin?» ata të përgjigjen se e kanë shtruar, por nuk po zgjidhet çështja. Dhe është e vërtetë kjo, përderisa çështja vjen këtu tek unë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Po ja një shembull konkret që na doli tani që shkuam në Oblikë me rastin e tërmetit. Kur vajtëm në ndërmarrjen bujqësore, shokët shprehën mendimin që ndërmarrja është e madhe dhe se është shumë e vështirë të administrohet gjithë ajo ekonomi prej 3 mijë e ca hektarësh, prandaj sektori i Oblikës mund të ndahet më vete.

SHOKU ENVER HOXHA: Posi, ata e shohin që nuk ecën kjo punë kështu siç është organizuar. Mendoj që problemet duhen parë konkretisht, të veprohet ashtu siç e kërkon zhvillimi ynë dhe të mos merren orientime si diçka e vendosur një herë e përgjithmonë. Ato duhen ndryshuar e përsosur kur jemi të bindur se, duke marrë këto masa, arritjet do t'i kemi më të mëdha.

SHOKU SIMON STEFANI: Ja, ndërmarrja bujqësore «Gjergj Dimitrov», shoku Enver, që përfshin 10 mijë hektarë tokë, ka 12 mijë punëtorë, po me shumë vështirësi u nda.

SHOKU ENVER HOXHA: Ta marr mendja që me shumë vështirësi u bë ndarja e saj, prandaj kjo të mos përsëritet gjatë. «Ka disa gjëra, — më tha Mehmeti, — për të cilat nuk ju informojnë mirë». «Po edhe ti duhet të informohesh më mirë, — i thashë. — Ti ke gjithë ata ministra dhe çdo ministër ka deri katër zëvendësministra, çdo zëvendësministër ka nga dy-tre drejto-

rë. Mua më duket se ti duhet t'u kërkosh atyre të të informojnë si duhet».

SHOKU HYSNI KAPO: Këto probleme neve na i ngre Partia në bazë. Ja, tani që isha në Vlorë me pushime, më pyeti drejtori i ndërmarrjes bujqësore: «Shoku Hysni, kur do të bëhet ndërmarrja blegtorale në Shashicë?». Tri herë më ka folur për këtë problem ai. Kongresi i 7-të i Partisë vendosi të krijohen ndërmarrje bujqësore e blegtorale. U studiua njëherë ky problem, u kthye, u studiua prapë dhe përsëri u kthye. Po të ishte zgjidhur me kohë problemi, tani ne duhet të kishim marrë frytet e kësaj pune, se kanë kaluar gati tre vjet që nga ajo kohë. Dhe çështja e blegtorisë ka shumë rëndësi. Prandaj kësaj i duhet kushtuar shumë vëmendje.

SHOKU PROKOP MURRA: Toka të reja hapen, forcat e punës shtohen, por ndërmarrjet bujqësore nuk janë shtuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Këto probleme nuk i zgjidh dot një njeri i vetëm, po gjithë Partia. Kur i foli Mehmetit për problemet në Kombinatin Metalurgjik, siç më kishe informuar ti, Prokop, ai më tha: «Nuk e di, po mua më kanë informuar ndryshe. Ja, do të vete prapë në kombinat». «Ti mund të shkosh dhe njëqind herë atje, po të duash, — shtova unë, — por fjalën e kam këtu, që ty të të raportojnë si duhet ministri i Industrisë, zëvendësministri dhe të tjerët. Kështu bëhen punët, ndryshe mbeten pa zgjidhur». Kur vajti Mehmeti në Kombinatin Metalurgjik, u tha shokëve atje se kanë shumë punëtorë dhe ata shkurtuan 500 ve-

ta. Kurse tani na thonë se kanë nevojë për punëtorë!!

SHOKU PROKOP MURRA: Baza mekanike atje nuk shfrytëzohet për mungesë të fuqisë punëtore.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo do të thotë se në kombinat kanë nevojë për punëtorë.

SHOKU HYSNI KAPO: Shoku Enver, këtu kemi të bëjmë me një problem të madh, së pari, ndërmarrjen e kemi dhe kapacitetin e saj nuk e shfrytëzojmë plotësisht; së dyti, në qytet kemi fuqi punëtore të lirë, të cilën duhet ta sistemojmë në punë.

SHOKU ENVER HOXHA: Çdo vit sjell zhvillim, sjell ndryshime. Të ardhurat e ekonomisë duhet paktjetër të mbahen parasysh. Por hapja e vendeve të reja të punës nuk na dëmton aspak; ajo diktohet nga vetë zhvillimi i vendit tonë. Ky dikton, gjithashtu, që të avancohet realizimi i detyrave dhe shkurtimi i afateve të ngritjes së veprave. Këtë preokupacion ta kenë të gjithë dhe jo të ngrihet e të vejë Prokopi në Burrel, për shembull, që të mbarojë brenda një kohe të shkurtër Fabrika e Ferrokromit, ose që diku gjelkë të vejë uji brenda një dite e gjysmë, kur mendohej që kjo punë duhet të bëhej për një muaj. Vetë komunistët, kuadrot, punonjësit në bazë duhet të mendojnë e të veprojnë kështu. Dhe si këto ka plot raste, more shokë!

Tani shokët në Burrel do ta përfundojnë fabrikën dhe do ta pastrojnë mineralin, se i dhanë fjalën Prokopit. Por del çështja e ngritjes së furrës së madhe në këtë fabrikë e për këtë u dashka të shtohen 4-5 veta në organikë. Mirë, le të shtohen, se kjo është një ve-

për e rëndësishme. Tash, që punët atje janë shtuar, edhe këta kuadro le të shtohen. Po kush duhet të mendojë për këtë? Përse të marrim masa ne këtu dhe të mos mendojë e të veprojë vetë ministria, apo zëvendësministri i ngarkuar për këto punë? Kuptohet, ai vetëm me pak veta që ka në vartësi nuk ia del dot, se nuk ka mundësi. Sepse, sado i zoti të jetë një kuadër, prapë, i vetëm, nuk bën dot gjë. «Trimi i mirë me shokë shumë» thotë me të drejtë populli ynë, prandaj ai duhet të aktivizojë specialistë e kuadro të bazës.

SHOKU HYSNI KAPO: Dje, gjatë rrugës, kur po vija nga Vlora, shoku Enver, mendoja për gjithë ato dëme që na shkaktoi tërmeti dhe thosha me vete se do ta përballojmë edhe këtë situatë, ashtu siç ka vendosur Partia: do të përdorim materialet që i kemi planifikuar për objektet e ndryshme, me qëllim që brenda një kohe të shkurtër t'i kapërcejmë vështirësitë e krijuara nga kjo fatkeqësi, sepse kjo ka edhe rëndësi politike.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, edhe në këtë aspekt duhet parë kjo çështje. Mua më duket se Qeveria ndërtimin e objekteve për prodhimin e materialeve të ndërtimit si, çimento, tulla, tjegulla etj. duhet ta shikojë një çikë më gjerë dhe më aktivisht, se nuk pret puna. Nuk e kam fjalën vetëm të ngremë fabrika të reja, por ne mund të shfrytëzojmë projektet e objekteve ekzistuese, duke i perfeksionuar dhe duke i bërë edhe më të mëdha ato.

Në këto kushte është e domosdoshme të përqendrohet vëmendja në problemet e revolucionit tekniko-

-shkencor. Nuk mjafton të mblidhen specialistët, të caktohen 300-400 tema për studime shkencore, të bëjnë libra dhe të mendohet sikur u mbarua puna. Jo, puna nuk mbaron. Kjo duhet ndjekur, duke konkluduar se cilat objekte duhen projektuar më përpara e cilat më pas, duke pasur parasysh zhvillimin e situatave. Forcat duhen përqendruar për zgjidhjen e problemeve kyç. Për shembull, disa gjëra që i kemi parashikuar të bëhen për tre vjet, specialistët t'i futen punës që t'i përfundojnë brenda një viti. Këto arrihen kur edhe vetë ministritë punojnë në mënyrë dinamike, ndjekin zhvillimin në çdo hap, ndryshe nuk mund të përballohen vështirësitë që dalin në sektorët e ndryshëm të ekonomisë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor, ideja juaj, shoku Enver, për avancimin e studimeve, jo vetëm është plotësisht e mundshme, por është reale dhe e domosdoshme të vihet sa më parë në jetë.

Gjatë vizitës në Korçë isha në Kombinatin e Trikotazheve dhe në uzinën e instrumenteve të precizionit të lartë «Petro Papi». Bisedova atje me komunistët e drejtuesit e këtyre ndërmarrjeve për t'u njohur me punën që po bëhej. Të dyja këto qendra pune i realizojnë shumë mirë detyrat. Në uzinën e instrumenteve po bënin një studim lidhur me shkrirjen e çelikeve speciale që dilnin jashtë përdorimit në uzinat e tjera. Këta i shkrinin këtu «mbeturinat» dhe me stampat e tyre bënin vegla të precizionit të lartë, gjë që është me leverdi të madhe për ekonominë tonë. Studimin

për shfrytëzimin e mbeturinave atje e kishin parashikuar ta mbaronin në fund të vitit 1980, por, kur më folën mua, e kishin mbaruar. Nga kjo kuptohet se ata kanë mundësi të punojnë me një temp më të shpejtë.

Nga biseda që bëra me shokët e Uzinës së Instrumenteve dhe me ata të Kombinatit të Trikotazheve mësova, midis të tjerave, se në Shkodër është në plan që në fund të vitit 1980 të ngrihet reparti i trikotazhit në fabrikën e pëlhurave, por për këtë priten disa vegla e mjete nga jashtë. Në Kombinatin e Trikotazheve të Korçës, kur biseduam për këto çështje, ishin të pranishëm të gjithë inxhinierët, drejtori dhe sekretarët e organizatave-bazë të Partisë. Ata më premtuan se merrnin përsipër t'i bënin mjaft nga pajisjet që akoma nuk kishin ardhur nga jashtë për këtë repart të ri, bile edhe të dërgonin atje specialistët e tyre për montim. Kështu do të punojmë, thanë ata, me synim për ta vënë atë vepër në shfrytëzim gjashtë muaj para afatit të planifikuar. Mirëpo ky është një objekt i madh, prandaj edhe leverdia ekonomike e vënies së tij në funksionim gjashtë muaj para afatit është e madhe.

SHOKU ENVER HOXHA: Është me të vërtetë një gjë e mirë të shkrihen mbeturinat e çelikeve speciale dhe të përdoren në ekonominë tonë. Iniciativa të tilla të mira marrin njerëzit tanë. Ja, edhe në kolektivin e spitalit dhe të Oficinës së Automjeteve të Shkodrës kanë marrë një iniciativë të lavdërueshme. Pas tërmetit u shtruan atje mjaft të plagosur. Për t'i shëruar sa më shpejt, disave u duheshin futur hekura brenda kockave të thyera. Ku t'i gjenin këto? Kishin

vetëm disa të ardhura nga jashtë, por ato nuk mjaftonin. Atëherë iu drejtuan pa vonesë kolektivit të Oficinës së Automjeteve dhe u thanë: «I shikoni këta hekurë? Na duhen 120 a 150 copë të tilla brenda 24 orëve, me çelik puro». Dhe brenda 24 orëve punëtorët e kësaj uzine i dorëzuan spitalit 150 copë të tilla dhe më të mira nga të importit. Kjo punë, siç thashë, u bë brenda 24 orëve. Prandaj dhe veglat e mjetet për reparatin e trikotazhit që premtuan t'i prodhojnë punonjësit e Kombinatit të Trikotazheve të Korçës, kanë mundësi t'i bëjnë edhe vetë ndërmarrjet e Shkodrës.

SHOKU RAMIZ ALIA: Unë mendoj, shoku Enver, që me këtë rast, siç kanë lindur gjithë ato iniciativa, duhet të inkurajohet një lëvizje e tillë për avancimin e afateve të vënies në shfrytëzim të objekteve të ndryshme. Ka shumë objekte që mund të avancohen, nga të cilat ekonomia jonë do të ketë dobi shumë të madhe, në qoftë se ato objekte, që janë planifikuar, do të futeshin, të themi, një vit më parë në prodhim, ose qoftë edhe gjashtë muaj. Ky do të jetë një fitim i madh për ekonominë tonë. Mundet të ndizet një lëvizje e madhe në këtë drejtim.

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet treguar interesim për këtë gjë. Dhe kjo të bëhet me frymë të shëndoshë partie për t'i avancuar studimet dhe objektet, për t'i dhënë prioritet sigurimit të materialeve. Të mos bëhet, siç është zakon ngandonjëherë, duke vënë kushte të tilla, si «jo po çështjet duhen studiuar, duhen materiale, duhet çelik, duhet kooperim, kjo uzinë është e zënë, tjetra s'është e zënë» etj., etj.

SHOKU RAMIZ ALIA: Tani mundësitë janë shumë më të mëdha, shoku Enver, edhe gatishmëria e njerëzve tanë është e madhe. Jo vetëm në rrethet ku ra tërmeti, por në tërë vendin është krijuar një situatë shumë e favorshme revolucionare, njerëzit janë të gatshëm të kontribuojnë, prandaj ka mundësi të nxiten iniciativat.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është, te ne ka tash mundësi më të mëdha. Fabrika tullash ne kemi ndërtuar në Peshkopi, do të ngremë një të tillë edhe në Kukës, në Sarandë e në Gjirokastër. Po kështu do të ngremë edhe fabrika për prodhimin e çimentos, të cilat kemi mundësi t'i bëjmë vetë. Veçse del problemi i teknologjisë së tyre. Një specialist i huaj u ka thënë shokëve tanë se teknologjia që zbatojmë ne në fabrikat e çimentos është e vjetër, këto harxhojnë 45-50 për qind më tepër energji e qymyr. Ka sot një teknologji më të përparuar që, përveç kursimit të energjisë, jep edhe çimento të një cilësie më të mirë. Për këtë neve na duhet vetëm të blejmë një model, sipas të cilit të ndërtojmë vetë fabrika të tjera me kapacitet të lartë prodhues. Por për t'i realizuar këto kërkohet që njerëzit tanë t'i vihen punës konkretisht e vendosmërisht, të marrin iniciativa, të merret mendimi i specialistëve deri në Qeveri, ku të shihet se cilit objekt duhet t'i jepet prioritet dhe të merren vendime për to. Tani që na dëmtoi tërmeti, po harxhojmë për ndërtime shtëpish e objekteve socialkulturore një sasi të konsiderueshme materialeve ndërtimi, si tulla, çimento etj. Rrethet e tjera kanë dërguar çimento, tulla etj. në zonat e pre-

kura nga tërmeti, por të kemi parasysh se ata i kanë pasur për të realizuar planet e tyre të ndërtimeve, që tash ka mundësi t'u mbeten pas, pra, si të thuash, po bëjnë sakrificë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Edhe për çështjen e tullave, që thatë ju, u interesova. Në Korçë ka një fabrikë tullash, që nuk punon me kapacitet të plotë. Kjo do të thotë se fabrika ka shumë rezerva akoma, prandaj, po të punojë me kapacitet të plotë, do të japë dyfishin e prodhimit të sotëm. Natyrisht, në këtë objekt kishin si pikë të dobët furrën e tharjes, kapaciteti i së cilës ishte më i vogël. Por, në qoftë se është kjo pika e dobët, atëherë pse të mos ndërtojnë një furrë tjetër tharjeje, ose të zgjerojnë ekzistuesen, me qëllim që të dyfishohet kapaciteti i prodhimit?

Unë mendoj se lidhur me iniciativat e punonjësve për likuidimin e pasojave të tërmetit duhet biseduar shtruar dhe konkretisht me shokët e dikastereve, sepse është e nevojshme që këto të aprovohen e të centralizohen, pasi edhe tërë punën që po bëhet në këtë drejtim e kemi të përqendruar.

SHOKU HYSNI KAPO: Për këtë kërkohet që dikasteret, ministrat të lidhen e të veprojnë aktivisht në bazë, të drejtojnë punën që të realizohen detyrat sipas sektorëve që mbulojnë. Gjithsecili nga titullarët e dikastereve të mendojë, në radhë të parë, për të aktivizuar ndërmarrjet që varen prej tyre që t'u përgjigjen sa më mirë nevojave për likuidimin e pasojave të tërmetit.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ashtu është. E kam

thënë edhe herë tjetër: le të jetë sa të dojë i zoti një kuadër drejtues, nuk mund të ecë përpara puna, në qoftë se do të mbështetet vetëm në punën e tre vetave, pasi punët dhe problemet janë të shumta. Këto kërkojnë aktivizimin e sa më shumë specialistëve, të cilët tash nuk na mungojnë. Por ky problem nuk duhet zvarritur. Sot nuk na krijon vështirësi lëvizja, fjala vjen, e katër-pesë inxhinierëve mekanikë, sepse kemi shumë të tillë. Prandaj duhet biseduar konkretisht me këta, bile ata të marrin edhe vetë iniciativë e zotime konkrete që i shërbejnë kryerjes së detyrave.

Le të kthehemi përsëri te problemi i strukturave organizative për të cilin fola më parë. Ky problem të kuptohet mirë dhe nga pikëpamja filozofike. Flitet shumë për indiferentizëm. Por dihet se asnjë njeri nuk lind indiferent, asnjë njeri nuk lind i mirë, ose i keq. Veçse në jetë ka njerëz të mirë, ka të këqij, ka edhe indiferentë. Ka një sërë shkaqesh që e bëjnë dikë indiferent. Ai mund të jetë njeri i zgjuar, njeri i mirë i Partisë, por bëhet indiferent kur shikon që zelli dhe hovi i tij në punë, mençuria e zotësia e tij futen në disa kuadrate, futen në kallëpe burokratike, në disa kompetenca të vogla, në njëfarë organizimi të ngushtë rutine e të kufizuar. «Pse të flas, — arsyeton një njeri i tillë me vete, — pse ta them këtë mendim, kur shikoj se asgjë nuk bëhet, ose kur e ngre një çështje, bëj vërejtje për këtë apo për atë problem dhe ato bien në vesh të shurdhër?». Nga këto gjëra ky njeri, që nuk është indiferent, por mund të bëhet i tillë, ngaqë s'ia

vënë veshin, thyhet. Po u kritikua për këtë, bën një autokritikë dhe kaq.

Këto çështje duhet t'i kuptojmë dhe t'i luftojmë shfaqje të tilla, se ja, në situata jo të zakonshme, si këto pas tërmetit, njerëzit hidhen në veprim, nuk u shmangen sakrificave, preokupohen e mobilizohen seriozisht. A nuk flet për këtë fakti që mjaft drejtues partie e të pushtetit në rrethe të Jugut, që nga Saranda, Gjirokastra, Vlora etj., etj. shkuan deri në Shkodër, duke udhëtuar për tërë natën, për t'iu gjendur pranë e për t'u thënë vëllezërve të tyre se ata janë gati t'i ndihmojnë për çdo gjë që të kenë nevojë? Pra këtu jo vetëm që nuk ka indiferentizëm, por përkundrazi kemi të bëjmë me një tipar të lartë të njeriut tonë, që, kur është fjala për të ndihmuar tjetrin në rast fatkeqësie, siç thotë populli, e heq nga goja e tij dhe nuk kursehet. Kështu ndodhi edhe me rrethet që u erdhën në ndihmë të dëmtuarve nga tërmeti. Ato ndofta kanë shumë probleme dhe nevoja për vete, por në këtë rast nuk mund të prireshin nga interesat e ngushtë lokale. Me një gatishmëri e ndjenjë solidariteti socialist ata vunë në dispozicion të të dëmtuarve forca të gjalla dhe mjete e materiale nga më të ndryshmet. Kjo është një fitore tjetër që ka arritur Partia. Është Partia po ajo që do ta drejtojë këtë aksion të madh, që do të organizojë këto forca për realizimin me sukses të tij. Prandaj komunistët, organizatat e Partisë të jenë në krye të punëve, në veprim. Ca më pak në situata të tilla nuk duhet të ketë asnjë organizatë partie të fjetur, që të lejojë pasivitetin, indiferentizmin e njerëzve ose imponimin

e mendimeve të njërit a të tjetrit. Rëndësi ka që në organizatë të flitet haptazi dhe jo të pranohet mendimi i sekretarit të organizatës-bazë edhe kur ai nuk është i drejtë. Partia kurdoherë duhet të mbajë qëndrime parimore. Qëndrimi i drejtë, ndershmëria e cilësi të tjera janë tipare që secili komunist duhet t'i zhvillojë te vetja e tij dhe tek të tjerët. Kjo është e domosdoshme që Partia të jetë revolucionare. Dhe po të jetë e tillë ajo, realizimet në çdo fushë do të jenë të mëdha.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e incizuar, që gjendet në AQP*

SHTYPI TË PROPAGANDOJË INICIATIVAT REVOLUCIONARE NË NDIHMË TË ZONAVE TË DËMTUARA NGA TËRMETI

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

19 prill 1979

SHOKU ENVER HOXHA: Të gjithë njerëzit te ne janë të shqetësuar për dëmet që shkaktoi tërmeti në rrethet e Veriut, u ka therur në zemër fatkeqësia e vëllezërve të Shkodrës, Lezhës etj. Gjatë këtyre ditëve na kanë ardhur shumë telegrame e letra nga punëtorë, kooperativistë, ushtarakë etj. nga i gjithë vendi, në të cilat shprehen solidariteti i tyre dhe gatishmëria për të ndihmuar vëllezërit e rretheve të dëmtuara. Midis të tjerave, mësova se në një nga ndër-marrjet e Tiranës ishte bërë një mbledhje e posaçme ku punëtorët e kuadrot kishin shprehur gatishmëri revolucionare për të kontribuar me pagën e një dite pune për ndërtimin e banesave. Mua më duket se kjo është një iniciativë e mirë dhe përbën një ndihmë të konsiderueshme për likuidimin e pasojave të tërmetit,

se mesatarja e pagës së një dite pune është për çdo punonjës 20 lekë.

SHOKU SIMON STEFANI: Kjo iniciativë e lavdërueshme e punëtorëve, me siguri që do të përqafohet edhe nga punëtorët e nëpunësit e ndërmarrjeve të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Me siguri që të tërë do ta përkrahin, si punëtorët, edhe nëpunësit.

SHOKU HYSNI KAPO: Kur dëgjova mbrëmë radion, shoku Enver, më bëri përshtypje lajmi për iniciativën e një kooperative bujqësore, e cila ka marrë përsipër të ndërtojë me shpenzimet e saj dy shtëpi në një nga fshatrat e dëmtuara nga tërmeti. Edhe kjo është një iniciativë e vlefshme dhe plotësisht e mundshme për t'u realizuar, sepse në vendin tonë ka sot kooperativa që kanë fonde e mundësi për të përballuar shpenzimet që duhen për një gjë të tillë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, ne sot kemi shumë kooperativa të tilla, në gjendje që të japin kontribute të kësaj natyre.

SHOKU SIMON STEFANI: Dje bisedova me shoqët drejtues të Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës. Shoqja Lenka më tha se kooperativistët e Divjakës kanë shprehur dëshirën t'i japin shtetit një fond prej 100 apo 200 mijë lekësh t'i përdorë për zonat e dëmtuara nga tërmeti.

SHOKU ENVER HOXHA: E si të mos i japin ndihmë shtetit të tyre anëtarët e kooperativave tona bujqësore, kur neve na ofrojnë ndihma për këtë rast edhe të huajt, por që ne në asnjë mënyrë nuk i pra-

nojmë? I gjithë populli ynë patriot, i edukuar nga Partia me ndjenja të larta revolucionare, me frymën e lartë të solidaritetit socialist, është ngritur në këmbë dhe po ndihmon shtetin, ndihmon vëllezërit e tij të dëmtuar nga tërmeti. Këto zotime e iniciativa janë të mira. Shtypi t'i propagandojë si duhet ato. Unë mendoj që letrat, telegramet e punonjësve, sidomos ato në të cilat bëhet fjalë për zotime e iniciativa konkrete, siç është rasti i kësaj ndërmarreje të Tiranës, t'i jepen shtypit dhe të propagandohen si iniciativa revolucionare. Kështu i gjithë populli, duke u njohur me to, do t'i përkrahë menjëherë.

Kudo po vihet re një mobilizim e entuziazëm i madh revolucionar, jo vetëm për kapërcimin e vështirësive të krijuara nga tërmeti, por, në të njëjtën kohë, edhe për realizimin e detyrave në frontin ditor të punës. Sot kisha një telegram nga Shkodra. «Të tërë jemi në këmbë, — thuhej atje, — i jemi përveshur punës dhe, me të gjitha masat që kemi marrë e do të marrim, do t'i ndërtojmë fshatrat, shtëpitë e objektet e tjera para afatit të caktuar. Do të realizojmë dhe do të tejkalojmë planin në industri, në bujqësi e në tërë sektorët e tjerë».

Kjo frymë e lartë revolucionare e masave tona punonjëse të pasqyrohet mirë në shtypin tonë qendror e lokal. Gazetat lokale ta pasqyrojnë patjetër gjendjen e rëndë që është krijuar, veçse gabimi u bë qysh në fillim me dhënien e komunikatës për tërmetin. Ditën kur lexova komunikatën u thashë shokëve që pse keni vënë në to vetëm Shkodrën dhe Lezhën, kur tër-

meti ka goditur edhe 5 rrethe të tjera, si Mirditën, Matin, Pukën, Tropojën dhe Dibërën. Një gjë e tillë nuk është reale, për arsye se nuk janë prekur vetëm 2 rrethe, por gjithë Veriu i vendit tonë është dëmtuar rëndë.

I lexova me radhë gazetat, edhe ato të rretheve. Të gjitha në krycartikujt e tyre me tituj me germa të mëdha shkruanin për mobilizimin e masave, i bënin thirrje popullit për t'u vajtur në ndihmë të dëmtuarve. Por, t'ju them të drejtën, më bëri shumë përshtypje qëndrimi i shokëve të gazetës «Pararoja» të Gjirokastrës. Atyre u duhet hequr veshi për qëndrimin indiferent që po tregojnë në këto momente, kur kudo gjendja zien. Ndodhi një tërmet kaq i madh në vendin tonë dhe, kur të gjitha gazetat e rretheve kanë mbushur faqen e parë me njoftime për këtë ngjarje, në gazetën «Pararoja» janë mjaftuar duke vënë në një qoshe vetëm nja 15 radhë. Pse, nuk u bëri atyre përshtypje ky tërmet? Nuk i tundi vendimi i Komitetit Qendror të Partisë dhe i Qeverisë për zhdukjen e pasojave të tërmetit? Tash po tundet e gjithë Shqipëria, kurse në gazetë flitet për gjëra të dorës së fundit. Sigurisht, edhe ato duhen, se çdo gjë ka rëndësinë e vet, por momenti aktual dikton diçka tjetër më të rëndësishme. Pse, me ato pak radhë që janë vënë në gazetë do të mobilizohet populli i Gjirokastrës? Apo mendohet se, meqë vjen gazeta «Zëri i popullit», nuk ka nevojë të shkruhet? Është gabim po të mendohet kështu, ndryshe Komiteti Qendror i Partisë nuk do të kishte vendosur për nxjerrjen e gazetave lokale. Pastaj, jo të gjithë ata që

abonohen në gazetat lokale marrin edhe «Zërin e popullit».

Gazetat kanë një mision e detyrë të rëndësishme, prandaj duhet treguar kujdes që në të aktualisht të pasqyrohen mirë edhe hovi revolucionar e mobilizimi i masave për zhdukjen e pasojave të tërmetit.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda e
incizuar, që gjendet në AQP*

TI RUAJMË DIE TI VLERËSOJMË OBJEKTET E KULTURËS SONË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

23 prill 1979

SHOKU RAMIZ ALIA: Isha në Korçë, shoku Enver, dhe shumë të fala keni nga pleqtë e korit.

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit, ata i kanë miq të vjetër.

SHOKU RAMIZ ALIA: Më ftuan edhe mua për të parë përgatitjet që po bënin për një ekskursion në Fierzë, ku do të jepnin disa koncerte. Ndenja afro një orë me ta, kënduam dhe bëmë muhabet, ndërsa ata në të njëjtën kohë bënin edhe prova.

SHOKU ENVER HOXHA: Të pasionuar pas këngës janë pjesëtarët veteranë të këtij ansambli.

SHOKU RAMIZ ALIA: Ashtu është, shoku Enver. Ata kanë bërë edhe një gjë tjetër të mirë. Në grupin e mandolinave kanë marrë pionierë. Në këngë kori ruan karakteristikën e vet, por si soliste kanë marrë

edhe një vajzë, si edhe të rinj. Kjo është një gjë shumë e mirë dhe grupit i jepte më tepër bukuri.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo do të thotë se ata e kanë gjallëruar më tej grupin.

SHOKU RAMIZ ALIA: Po, po, e kanë gjallëruar. Grupit i japin gjallëri, në radhë të parë, vetë pleqtë, që, me gjithë moshën e tyre, janë aq shumë entuziastë. Ata kënduan edhe «Këngën e mullirit». «E do shumë këtë këngë shoku Enver», më thanë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ta treguan historinë e këngës së fabrikës së miellit? E di ti atë?

SHOKU RAMIZ ALIA: Jo, nuk e di, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Vajtën ca e u thanë sikur t'i bëjmë ndonjë ndryshim «Këngës së mullirit», t'i vëmë ca fjalë të reja, ta bëjmë ca kështu e ca ashtu etj. Kërceu një nga ata pleqtë dhe tha: «E po mirë, ia bëjmë, po atëherë ta quajmë «Kënga e fabrikës së miellit!»». (Të qeshura.)

SHOKU RAMIZ ALIA: Vizitova pastaj shtëpinë-muze të Vangjush Mios, të cilën e kishin restauruar plotësisht.

SHOKU ENVER HOXHA: Është një shtëpi karakteristike ajo, me divanin, me bahçet, avllinë, pusin etj.

SHOKU RAMIZ ALIA: Po, me të vërtetë e tillë është, me të gjitha ambientet që përmendët ju. Kishin bërë një punë mjaft të mirë. Më pëlqeu shumë. Të gjitha ishin vënë ashtu siç kishin qenë në kohën e të zotërve të shtëpisë. Në tërë shtëpinë ishin ekspozuar pikturat e Mios. Një pjesë e tyre janë vendosur në

Galerinë e Arteve. Ishin, gjithashtu, kavaleti, tavolina e deri te një kolltuk i tij.

SHOKU ENVER HOXHA: Po autoportretin e Vangjushit e kishin vënë?

SHOKU RAMIZ ALIA: Po, po, ishte aty edhe autoportreti. Kur vajta për ta vizituar shtëpinë e Mios, gjeta vajzën dhe djalin e tij, të cilët më folën për të gjitha objektet që qenë vendosur në këtë shtëpi-muze.

SHOKU ENVER HOXHA: Ai bënte shumë piktura dhe gati në një masë, pastaj i vendoste njërën mbi tjetrën dhe më thoshte: «Hajde ti, kolopuç, të t'i tregoj» dhe i hapte ato si libra. Pastaj më ka folur mua edhe për gjëra të tjera, më ka treguar që, përpara se të fillonte tablotë, bënte skicidenë, të cilat i ka ruajtur. Ai ka pasë përgatitur, gjithashtu, skica të përpunuara me laps, në formë vizatimi. Prandaj edhe këto duhet t'i kenë në shtëpinë e tij muze.

SHOKU RAMIZ ALIA: Atje nuk kishte të ekspozuara nga këto lloj skicash, po pamë ca nga etydet e tij që i kishte bërë kur ishte student, sidomos portrete, se në tërë krijimtarinë e tij mbizotëron kryesisht peizazhi.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, peizazhet e Mios janë të bukura shumë. Disa nga pikturat e tij i kam në shtëpinë time.

Përmbi shtëpinë-muze të Vangjushit është edhe shtëpia e Zengos, i cili është, gjithashtu, një piktor i vjetër, ikonograf. Te kjo shtëpi unë kam qenë gjithashtu nja dy herë. Babai i Androniqit ka qenë ikonograf i kishave. Prej tij kishte mësuar të pikturonte e bija.

SHOKU RAMIZ ALIA: Më zuri syri një pikturë të Zengos në Mitropoli, që e vizitova për të parë se ç'po bëhej. Në fakt edhe ajo duhet kthyer në muze.

SHOKU ENVER HOXHA: Po a mbahen vallë mirë këto objekte?

SHOKU RAMIZ ALIA: Kishte dy veta që kujdeseshin për to, por i kanë lënë shumë pas dore gjithë ato objekte.

SHOKU ENVER HOXHA: Ikonat kanë shumë vlerë dhe njerëzit tanë duhet të njohin më mirë vlerat e tyre.

SHOKU RAMIZ ALIA: Ka shumë nga këto që duhet medoemos të studiohen çfarë janë, por kryesorja është që të ruhen mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë vjet përpara, në një galeri të Tiranës, që atëherë ishte në rrugën «Fortuzi»¹, kam parë disa ikona të punuara me ngjyra shumë të bukura. Të vogla ishin ato, por, megjithëse të dëmtuara nga të plasariturat, shumë të bukura, të shkëlqyeshme e të ndritshme i kishin ngjyrat. Këto, sigurisht, janë objekte me vlerë shumë të madhe. Ikona të tilla me ngjyra të bukura unë kam parë jo vetëm nëpër muze, por edhe në albume të posaçme.

SHOKU RAMIZ ALIA: Një pjesë të ikonave, që ne çuam para disa vjetësh në Francë², u vlerësuan shumë. Atje bile u shkrua në shtyp për to, sidomos

1. Sot rruga «Asim Vokshi».

2. Në nëntor 1974 në Paris u hap ekspozita «Arti shqiptar në shekuj».

për ngjyrat dhe për anët e tjera të bukura të tyre.

SHOKU ENVER HOXHA: Po të bëhet një politikë e kujdesshme dhe josesktare me disa të moshuar që i ruajnë ikonat të fshehura diku në shtëpi, institucionet përkatëse, duke u shpjeguar vlerën e madhe që kanë ato po të vendosen në muze, kam bindjen se do të mbledhin shumë prej tyre. Natyrisht, jo të tëra kanë vlera artistike dhe muzeale, por, në mes tyre ndonjë do të jetë me vlerë. Këto ikona duhet të kenë ardhur nga Greqia, nga mali Athos¹, Mali i Shenjtë, siç i thonë, nga Bizanti, nga Fanari, nga Porta e Lartë. Ka pasur shqiptarë pasanikë të mëdhenj në Stamboll e në Greqi, siç janë Zhapajt², që kanë edhe sot një pasuri të madhe. Njerëzit e kësaj shtëpie ishin të lidhur me Fanarin. Për ta ishte një gjë me rëndësi të merrnin një ikonë për vete dhe një për t'ua dërguar vëllezërve të tyre në Labovën e Madhe. Prandaj, po të bëhet një politikë më e zgjuar, mund të gjenden gjëra me vlerë, sepse besoj shumë plaka ikonat i ruajnë në sënduqe.

SHOKU HYSNI KAPO: Të tilla objekte mund të ketë në të gjitha fshatrat që kanë pasur emigrantë ekonomikë në Greqi, në SHBA etj.

SHOKU SIMON STEFANI: Edhe në Berat, shoku

1. Ndodhet në jug të gadishullit më lindor të Kallkidës, qëndër fetare e njohur për kuvendet e themeluara që nga shekulli i 10-të, ku ruhen vepra të rëndësishme të artit mesjetar dhe dokumente historike.

2. Me origjinë nga fshati Labovë e Madhe e rrethit të Gjirokastrës.

Enver, ku ka mjaft kisha, me siguri duhet të ketë nga këto objekte.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo vetëm Berat, por edhe Gjirokastra ka, sepse gjithë banorët e lagjes Varosh jo vetëm ishin të krishterë që besonin, por edhe shkonin e vinin në Greqi. Një pjesë e ikonave kanë ardhur prej andej.

Unë e kam fjalën që me këta njerëz që ruajnë nga këto objekte fetare të mos tregohemi sektarë. Se ka disa kuadro që edhe sot sillen kështu. Ja, këto ditë Nexhmija më tregonte për një ndodhi në Lezhë. Një familjeje, kur iu rrëzua shtëpia nga tërmeti, i zuri njërin djalë 20 e ca vjeç, i cili u vra. Përveç këtij kishte edhe dy djem të tjerë azganë. Por një djalë tjetër ishte arratisur vite më parë. Për këtë shkak kësaj familjeje nuk i vajti fare njeri për ta parë se ç'i ndodhi pas tërmetit, ndërsa në të tëra të tjerat vajtën. E zonja e shtëpisë nuk bënte zë, as djemtë; ata prisnin. Por kur vajti andej sekretari i komitetit të Partisë të rrethit dhe mori vesh për këtë qëndrim ndaj kësaj familjeje, tha: «Po le ta kenë atë të poshtër. Për anëtarët e tjerë të familjes ne do të interesohemi, këta janë bashkëqytetarët tanë». Por kur sekretari i Partisë hyri në shtëpi, plaka i tha: «Si është e mundur që erdhe ti këtu, tek unë?! Si është e mundur kjo?!».

SHOKU PROKOP MURRA: Po, po, shoku Enver, ajo pikërisht i tha kështu: «Mos ke ngatërruar rrugën, mor bir, mos je nisur për në tjetër vend?».

SHOKU ENVER HOXHA: «Jo, nuk e kam ngatërruar, — iu përgjigj sekretari, — po erdha këtu te ju»,

dhe i tha se shteti do t'ia ndreqë shtëpinë. E më t'i futen punës të dy djemtë. «Harram i qoftë sisa, — tha plaka për atë që ishte arratisur, — dhe hallall ju qoftë juve!».

Djemtë u shkrinë nga gëzimi, e harruan shtëpinë dhe iu hoq dhimbja për vëllanë që u vra nga tërmeti. Pra edhe ky rast tregon se me njerëzit duhet të jemi të kujdesshëm dhe midis tyre të bëjmë diferencim. Me qëndrimin e mbajtur në rastin e plakës, mos u bë gabim? Jo, se dy djemtë e saj ne nuk i bëmë sekretarë partie. Po në vend që t'ia lëmë armikut, me këtë qëndrim ne i bëmë ata të ndiejnë ngrohtësinë e Partisë dhe i nxisim që të punojnë e të jetojnë ndershmërisht.

Kur po shikonim një film tonin më thanë se për artistin që luante rolin kryesor mbahet një qëndrim i rezervuar në vlerësimin e tij, sepse paska ca të afërm jashtë shtetit. Po ky është sektarizëm me brirë. Ai luan aq bukur e po hyn në radhën e artistëve të dalluar. Populli e simpatizon. Ai duhet të vlerësohet për talentin e interpretimet e tij me mjeshtri të lartë. Duke e vlerësuar për punën e mirë që bën, ne e inkurajojmë të punojë edhe më mirë.

Tash që po bisedojmë m'u kujtua artisti Pandi Raidhi që është një artist i madh, luan shumë thjesht dhe është konkret, e interpreton tamam jetën e fshatarit. Ai në rolet që luan tregon se si mëson nga populli.

SHOKU HYSNI KAPO: E takuam një natë me Ramizin, aty tek universiteti, ishte veshur me rrobat

që del në skenë, me një xhaketë, me qillota dhe na foli vetë.

SHOKU ENVER HOXHA: Vjershën e Dritëro Agollit «Krevati i perandorit», që është një kryevepër, ai e interpreton për nrekulli. Sa bukur e luan këtë monolog: «E ke njohur Meken ti?, — i drejtohet ai portretit të Viktor Emanuelit. — E ore, Meken!». Artistë si Pandi Raidhi e Sandër Prosi janë të rrallë.

Tash kanë filluar të dalin mjaft artistë të rinj. Po me ta të punohet që të kemi më shumë njerëz të këtij kalibri edhe në teatër, se nga teatri kanë dalë këta që kemi kaq të zotë. Të rinjtë duhen ndihmuar që të perfeksionohen gradualisht, që të kemi kështu aktorë të aftë për të prodhuar më shumë filma në vit.

SHOKU RAMIZ ALIA: Me filmat tashti ka filluar puna më mirë, shoku Enver, bëhen rreth 12 filma në vit.

SHOKU ENVER HOXHA: S'ka dyshim që këtej e tutje do të punohet edhe më mirë në këtë drejtim.

SHOKU RAMIZ ALIA: Prekopi më tregoi se gjatë festivalit të filmit, disa nga punorjesit e tregtimit të librit e të filmit dhe të sektorit përkatës të Ministrisë së Arsimit e të Kulturës shfaqën mendimin që filmat të mos i japin në televizor, se pastaj nuk shkojnë njerëzit në kinema.

SHOKU ENVER HOXHA: Po kjo është një pikë-pamje jo e drejtë!

SHOKU RAMIZ ALIA: Po, ashtu është. Prandaj të nesërmen u dhashë një listë filmash që luhen vazhdimisht në televizor, u kërkova të më japin të dhëna se

sa spektatorë shkojnë në kinema për të parë, për shebull, filmat si: «Lulëkuqet mbi mure», ose «Kapedani». Rezultoi që këta filma kanë prioritet në publik në kinema, domethënë megjithëse i jep edhe televizori, njerëzit shkojnë e i shikojnë me ëndje. Këta shokë që shfaqën atë pikëpamje mendojnë sikur ne i bëjmë filmat për fitim material, kurse ne kryesisht synojmë të edukojmë njerëzit me ta.

SHOKU ENVER HOXHA: Vajtja në kinema, sidomos e të rinjve dhe e të rejave, ka edhe një anë tjetër. Ja, edhe fëmijët tanë shkojnë në kinema, po ata venë atje jo vetëm për të parë filmin, po edhe për t'u takuar me shokë pas filmit, për të bërë edhe një shëtitje etj. Kështu ndodh te ne, kurse të tjera qëllime ka shfaqja e filmave në vendet kapitaliste.

Duke e marrë sjalën në këtë takim, shoku Simon Stefani informon për vizitën që bëri në rrethin e Mirditës, për punën që bëhej për realizimin e detyrave në uzinën e bakrit dhe në ndërmarrjen gjeologjike si edhe për disa çështje të fuqisë punëtore në fshatrat e këtij rrethi.

SHOKU SIMON STEFANI: Në Mirditë kanë problem fuqinë punëtore, se fshati në këtë rreth ka pak forca pune, mbasi burrat, përveç 500 e ca punëtorëve që punonin në sektorin e ndërtimit në tërë rrethin, gati të tërë i kanë marrë minierat dhe ndërmarrja gjeologjike. Kështu që bujqësia në këtë rreth është dobësuar ca, sepse tani, pjesa më e madhe që punojnë në fshat, janë gra.

SHOKU ENVER HOXHA: Më e mira do të ishte

që rrethi i Mirditës të popullohet me njerëz të rinj, që mund e duhet të shkojnë nga qytetet e rretheve të tjera. Mirë, po të rinjtë, nga sa shohim, i drejtojnë vetëm në Ksamil. U mbush Ksamili me të ardhur, se atje është vend i bukur dhe venë të gjithë. Të punohet që edhe në rrethe të vogla si Mirdita, Kolonja etj. të shkojnë djem e vajza nga rrethet e tjera dhe jo vetëm për të punuar në miniera, por edhe në bujqësi. sepse aty ka mungesa të forcave të punës dhe prodhimet bujqësore, siç na thoni, nuk realizohen.

Grumbullimi i bimëve mjekësore, që është mjaft i rëndësishëm, më duket se është përqendruar në kooperativat bujqësore. Por, me sa duket, atje ka mungesë të forcave të punës dhe ky është një problem kyç për këtë rreth. Duhet përtërirë e shtuar atje pyjet? Patjetër, bile të bëhet edhe më shumë sesa bëhet sot, por çështja është se s'ka njerëz. Duhet grumbulluar sherbela? Sigurisht. Po kjo kërkon të vejë dikush që ta mbledhë këtë bimë mjekësore, se rrethi nuk ka shumë forca. Duhet misër e grurë? Medoemos, por edhe për prodhimin e këtyre produkteve të dorës së parë duhen forca pune. Prandaj e shikoni se si shtrohet te ne problemi i shpërndarjes së forcave të punës?

Të rinjve e të rejave që venë në këto zona, duhet t'u krijohen edhe kushtet për të punuar e jetuar. Leskoviku, s'ka dyshim, që ka kushte më të mira nga Fani, por me një propagandë më të organizuar dhe me krijimin e kushteve, me ndërlimin e shtëpive, të ndonjë shtëpie kulture në Fan etj., do të bëjnë që edhe atje të grumbullohet rinia. Këtë çështje ta shohim ne

këtu, se nuk është gjë e vogël. Atje ka mjaft mungesa të forcave të punës në miniera, në bujqësi, në pyjore e kështu me radhë në gjithë sektorët e tjerë.

SHOKU HYSNI KAPO: Po ta marrësh hollë-hollë, në Mirditë ka edhe avantazh, se ka më shumë lëvizje sesa në Leskovik, që është si më i mënjanuar. Mirditën e përshkojnë rrugë nga të gjitha anët, nga Puka e Kukësi, Durrësi e Tirana, Lezha e Shkodra, Mati e Dibra.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, nga të tëra anët. nga Shkodra, fjala vjen, mund të vejë prindi brenda ditës ta shikojë vajzën apo djalin që do të jetë vendosur atje me punë.

SHOKU HYSNI KAPO: Pastaj në këtë rreth ka qendra të rëndësishme, siç janë Rubiku, Rrësheni, Kurbneshi etj. Të tërë këta janë si qytete të vogla.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, tamam qytete dhe janë rregulluar e janë bërë qendra shumë tërheqëse. Unë kam 11 vjet pa vajtur në Mirditë.

Pra ky vend duhet populluar me njerëz. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe.

Problemin e popullimit të fshatrave nuk mund të themi se nuk e kemi parë. Kemi bërë bile edhe studime për këtë problem, por ato, më duket mua, kanë qenë ca si spontane dhe kemi menduar ta bënim mbi baza vullnetare. Kur them kështu, nuk e kam fjalën që ta kthejmë tash në një veprim të detyruar, por kam përshtypjen se vullnetarizmi sikur është ca si shumë i theksuar. Unë mendoj se për sa i përket shpërndarjes së përgjithshme të të rinjve e të rejave ne nuk kemi një studim të përcaktuar e të ndarë për

çdo vit ose për çdo pesëvjeçar. Për shembull, dimë se te ne çdo vit nga shkollat e mesme dalin kaq ose aq të rinj e të reja, nga të cilët në shkollat e larta para-shikohet të futen kaq. Mirëpo ne nuk kemi të planifikuar edhe shpërndarjen e të tjerëve, që nuk ndjekin studimet e larta. Planëzohet thjesht vetëm fuqia punëtore, duke u nisur nga kërkesat e bazës.

Në bujqësi ka njëfarë stabiliteti, për arsye të disa rregullave që kemi vënë në fshat, dhe këta zihen të gjithë me punë. Kështu që na mbeten zbuluar një pjesë e të rejave e të rinjve të qyteteve që pas shkollës së mesme nuk vazhdojnë shkollën e lartë. Pikërisht për këtë pjesë nuk ka një studim që të përcaktojë sa punëtorë do të na duhen për fabrikat, uzinat, ndërmarrjet e ndryshme. Është e nevojshme të dimë sa nga këta do të sistemohen në fabrika e ndërmarrje të tjera në qytete. Edhe për këta duhet të kemi studime, që të dimë me kohë çfarë do të bëjmë me këta të rinj. Ky studim na mungon, prandaj dhe planet bëhen globalisht, ndërsa, mendoj unë, duhet të dihet në detaje për çdo vit e për çdo rreth sa forca të reja dalin për t'u sistemuar në punë. Organet e planifikimit, si edhe ato të Partisë e të pushtetit t'i kenë që më përpara këto përllogaritje; zyrat e punës, gjithashtu, duhet t'i kenë të dhënat për të rinjtë e të rejat, që të planifikojnë se ku do t'i çojnë me punë. Çdo rreth e ka të përcaktuar limitin e fuqisë punëtore. Por mund të lindë nevoja që disa të rinj të punësohen jashtë rrethit. Në qoftë se me këta bëhet një punë e mirë sgaruese e edukative, atëherë arrihet që vetë i riu të zgjedhë se në cilin rreth

dëshiron të shkojë. Në qoftë se ndonjë nuk shprehet i gatshëm për këtë, atëherë me të duhet punuar që ai të mos lihet të hajë e të pijë në kurriz të babait e të nënës. Këtu del edhe roli që duhet të luajnë zyrat e punës, por edhe puna e propaganda e Partisë, e organizatave të Frontit e të rinisë, që me të rinjtë të punohet me kohë që të përgatiten të shkojnë atje ku ka nevojë për forca pune. Kjo çështje mund të realizohet nëpërmjet një pune ideopolitike e propagande të shkathët, por edhe duke marrë masa konkrete për t'i siguruar të riut disa kushte të nevojshme jetesc, atje ku i thuhet të vejë të punojë. Se ndodh që atje ku do të vejë djali mund të gjejë një vajzë e të martohet me të, se atje mund të venë edhe vajza nga rrethet e tjera.

Studime të tilla për mundësitë e sistemimit të të rinjve qytetarë në punë nëpër fshatra, thashë na mungojnë, prandaj duhen bërë sa më parë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Organizmat e caktuar bëjnë në këtë llogari aritmetike të tillë: kaq fuqi punëtore duhen në qytet, kaq në fshat, ndërsa kaq mbarojnë shkollat këtë vit. Duke vepruar kështu, si llogari kjo del në rregull, mirëpo i riu që mbaron shkollën banon në Tiranë ose në Durrës, ndërsa ne kemi nevojë për njerëz edhe në fshatrat e Mirditës ose të disa rretheve të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Këto janë edhe probleme shoqërore. Në Tiranë ka forca të pazëna me punë, në mes tyre ka edhe gra të martuara. Ka pastaj raste të tjera, siç mund të jetë ai i një djali që është fejuar

me një vajzë tekstiliste. Nuk mund t'i thuash djalit, siç kanë vepruar kinezët, ti shko atje dhe vajzën lëre këtu. Ata duhet të jetojnë e të punojnë së bashku. Prandaj vajzën duhet ta përgatitësh më parë që të ndërrojë zanat, se atje ku do të vejë mund të mos i sigurohet punë në profilin që ka mësuar, ose të fejuarit t'i sigurosh vend që të punojë gjëkund pranë vajzës. Prandaj mendoj se duhet bërë një diskutim me specialistët e Drejtorisë së Punës, për këtë problem. Mund t'i diskutojnë ata këto çështje në Qeveri dhe në Komisionin e Planit të Shtetit. Ky është një problem me rëndësi, që ka të bëjë me demografinë e një rrethi apo të një qyteti dhe të tërë vendit.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e izoluar, që gjendet në AQP*

TREGTI ME INTERES RECIPROK DHE PA NDERIHYRJE NË PUNËT E BRENDSIHME

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

25 prill 1979

Do të ishte mirë të kishim një pasqyrë nga Ministria e Tregtisë së Jashtme ose nga ata që mbulojnë tregtinë e jashtme në Këshillin e Ministrave, se cilat janë situatat e krijuara në botë për marrëdhëniet me Shqipërinë pas prerjes së marrëdhënieve tregtare me Kinën dhe cila është gjendja për gjetjen e tregjeve të reja. Do të ishte mirë, gjithashtu, që Byroja Politike të dinte se ku kemi gjetur ne tregje të reja për eksport me njëfarë sigurie relative. Duke marrë parasysh që ne luftojmë për lidhjen e kontratave me afat të gjatë, duhet t'i bëjmë përpjekjet me ato shtete që tregojnë një siguri relative në furnizimin me ne, pra me ato

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi përfundimin e marrëveshjeve dhe të kontratave për vitin 1979 nga organet e tregtisë së jashtme dhe problemet që dalin për realizimin ritmik të planit të eksportit dhe importit».

shtete që janë të dispozuara për arsyet e tyre. Ne nuk lejojmë të bëhet tregti ndryshe, përveçse me interes reciprok dhe pa ndërhyrje në punët e brendshme. Duhet parë çështja e perspektivës edhe për marrëdhëniet me një sërë shtetesh të tjera që, megjithëse kanë nuanca në qëndrimin ndaj vendit tonë, duan të bëjnë tregti me ne. Këtej ne mund të orientohemi më me siguri.

Çështja e dytë është që tregtia jonë e jashtme të luajë një rol të madh e më aktiv në çështjet e importit, që ndikojnë shumë për zhvillimin e ekonomisë sonë. Tregtia të bëhet duke shfrytëzuar koniunkturat aktuale të krizës së përgjithshme të superprodhimit. Mund të na thuhet diçka në bazë të këtyre relatave dhe të studimeve që duhet të keni bërë. Kjo punë të bëhet e koncentruar dhe me kujdes. Studimi i këtyre situatave është i domosdoshëm, se ne nuk mund të ecim qorrazi. Pra, duhet studiuar se cilat janë perspektivat e kësaj krize në ato vende, ku, për një arsye ose për një arsye tjetër, ne mendojmë se është gjendja e favorshme për pesë vjetët e ardhshëm. Kështu, për shembull, duhen parë ato shtete ku mendohet se kriza do të shkojë duke u thelluar dhe nuk do të fillojë ringjallja e përkohshme e ekonomisë, e sidomos e industrisë për të cilën ne jemi të interesuar.

Ne kemi interes edhe për eksportimin e mallrave të tjera, po, në radhë të parë, në eksportin tonë zërë vend mineralet. A do të kemi ne në të ardhmen më shumë siguri në tregtinë e kromit me disa shtete? A do të kemi më shumë siguri për bakrin, për hekurin

ose për produktet e naftës, qoftë brut, qoftë të rafinuar? Do të kemi siguri edhe për tregtinë e prodhimeve të tjera? Si do të shkojë kjo çështje?

Unë lexova në raport edhe për çështjen e mallrave që duhet të mbajmë rezervë, pa i shitur. Aty thuhet me të drejtë që disa mallra tonat nuk po i kontraktujmë, për arsye se parashikohet që çmimet e tyre mund të ngrihen. Ky është një qëndrim që duhet mbajtur parasysh në tregtinë me jashtë. Por ama kjo të bëhet në bazë të një studimi të vëmendshëm të tregjeve të jashtme dhe sipas rastit duhen përcaktuar kontraktimet. Ne nuk kemi interes të mbajmë mallra rezervë për një kohë të gjatë. Mund të mbahet rezervë vetëm kur dimë që në ndonjë treg, ku ne shesim mallrat tona, ka tendenca të favorshme për tregtinë tonë. Prandaj mendoj që, në qoftë se është vëzhguar situata, të na jepet një pasqyrë e saj, siç e theksova që në fillim, bashkë me konkluzionet që nxirren. Kjo do të jetë një eksperiencë e mirë edhe për kontratat e ardhshme që do të lidhen me afat të gjatë. Detyrimi kontraktor duhet nënshkruar që të ketë fuqi për nënshkruesit. Këtu duhen mbajtur parasysh edhe koniunktura, edhe çmimet.

Ne mundet që edhe me vendet e Evropës Lindore të kemi marrëveshje me çmim të caktuar. Marrëveshjen me këta do ta bëjmë me çmimin aktual. Por edhe specialistët tanë duhet të aftësohen në mënyrë të tillë që të mund të parashikojnë në tregtinë botërore çmimin e kromit, nëse do të ngrihet ose do të ulet, se do të punojnë këto ose ato fabrika që mund të kenë ne-

vojë për kromin tonë. Se mund të ndodhë që të huajt, duke ditur perspektivën, mund të pranojnë të paguajnë gjobë, por kromin nuk na e marrin me atë çmim që i takon. Por këtë duhet ta parashikojnë specialistët tanë. Pikërisht për këtë gjë, për këtë perspektivë mund të na jepet nga shokët, që merren me tregtinë, ndonjë sqarim.

Megjithatë dua të theksoj disa momente. Jam dakord që tregtia ka bërë përparime gjatë këtyre kohëve dhe, duke marrë parasysh vështirësitë e mëdha që ka në këtë mes, rezultatet e arritura duhet t'i konsiderojmë si një përpjekje të mirë nga ana e Qeverisë. Por tregtia e jashtme varet edhe nga prodhimi i brendshëm. Me këtë nuk po them ndonjë gjë të re, por dua të tërheq vëmendjen se drejtimi i prodhimit tonë të brendshëm çalon në disa pika kyç. Drejtimi, sidomos ai nga Partia, duhet të jetë më i shëndoshë e më i fortë. Kur them drejtimi i Partisë, kam parasysh të gjithë kuadrot që punojnë në Parti e në pushtet, aparatet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë. Ky drejtim duhet forcuar dhe përsosur. Sepse dobësitë në drejtim i sjellin vështirësi ekonomisë sonë socialiste. Në qoftë se nuk e kuptojmë mirë këtë, do të gjejmë vështirësi edhe në tregtinë me jashtë. Kjo çështje bëhet më e mprehtë, po të mbahen parasysh edhe vështirësitë politike që i nxjerrin shtetet e tjera vendit tonë. Pra edhe në këto kushte nevojat e zhvillimit tonë ekonomik duhen plotësuar.

Unë mendoj se tani kërkohet t'i futemi më mirë çështjes së drejtimit, që ky të përsoset. Në praktikë ka

raste që drejtuesit kënaqen me fjalë, me raportime e zotime. Kush mundet raporton sipas qejfit, planet e prodhimet shpesh bëhen jo reale, që mbajnë shumë rezerva, bëhen kërkesa të fryra për import etj. Këto, përveç të tjerash, tregojnë mungesë të ndërgjegjes politike për momentet që kalon vendi ynë socialist, tregojnë për nivel të ulët politik dhe ideologjik të disa njerëzve tanë. Prandaj Partisë i del për detyrë ta forcojë punën e saj për ngritjen e vazhdueshme të nivelit ideopolitik të njerëzve, se vetëm kështu do të vihen në jetë në mënyrë më të kënaqshme masat organizative që janë marrë për shtimin e prodhimit për konsum të brendshëm dhe për tregun e jashtëm. Kjo është detyra kryesore që kemi përpara.

Byroja Politike dhe Qeveria kanë marrë vendime dhe duhet të qëndrojnë fort që të mos lejojnë kërkesa të tepruara, por të nxitet shpirti revolucionar i masave punonjëse që të realizohet plani, duke vrarë mendjen, duke bërë përpjekje për të plotësuar me mjetet e forcat tona të brendshme atë që i lë mangët importi.

Për materialet që mund t'u duhen nga importi, metoda e drejtimit të punës në ministrinë të jetë e tillë që, para se të kërkojnë, të llogaritin një herë ato që kanë dhe t'i futin në përdorim. Si është e mundur të bëhen me kaq lehtësi kërkesa për import? Ku gjenden këto para kështu?! Si zbatohet parimi i mbështetjes në forcat e veta në çdo rreth, në çdo ndërmarrje?

Disa shokë bëjnë kërkesat dhe planin e importit, por nuk mendojnë si do t'i përballojë shteti këto, ku do t'i gjejë? Më parë duhen shfrytëzuar të gjitha mun-

dësitë që shumë sende t'i prodhojmë në vend, në kohën e duhur, me cilësinë e duhur, me masa organizative të shëndosha, me ndërgjegje të lartë për situatat që po kalojmë dhe të mos kërkohet çdo gjë nga importi. Nga ana tjetër, që të realizohet importi, është e domosdoshme që çdo rreth e çdo ndërmarrje të realizojë planet e prodhimit, planet e eksportit. Ekonomia socialiste është e komplikuar, e unifikuar. Në qoftë se një rreth nuk prodhon, tjetri nuk e realizon planin, atëherë krijohen vështirësi që një rreth ta marrë atë që kërkon nga importi. Hallkat e ekonomisë janë të lidhura me njëra-tjetrën si ato të zinxhirit.

E kemi thënë shumë herë rëndësinë që ka çështja e bashkërendimit të punëve ndërmjet ministrive. Sa bëhet dhe si bëhet ky bashkërendim? Mendoj se ky nuk është në nivelin e duhur. Ka raste që edhe për gjëra të vogla shokët ministra shkojnë në Kryeministri. Kryeministria ka njaft probleme për të zgjidhur. Po të veprohet kështu që edhe për gjërat e vogla, që duhet t'i zgjidhin vetë ministrat, të futen edhe instancat eprore, nuk do t'i lihet kohë as Qeverisë, as Byrosë Politike të merren me problemet kryesore. Kur tregohet interesim dhe kur u vihen këmbët në një këpucë personave përgjegjës, puna e caktuar për një muaj bëhet para afatit. Nga rrethet po bëhen shumë propozime për të shpejtuar ato punë që janë planifikuar të bëhen më 1981. Parashikimet për vitin 1981 janë bërë mbi bazën e propozimeve të vjetra. Tani po lindin mendime të reja. Këto duhen studiuar me shumë kujdes e përgjegjësi. Mirëpo ministrinë nuk po

interesohen për këto propozime, që të shkojnë në vend, t'i shohin e të veprojnë konkretisht. Por kur nuk interesohet ministria, kjo do të thotë se nuk interesohet organizata e Partisë atje, sepse ministri është anëtar partie, zëvendësministri, drejtori e të tjerët, po ashtu, por edhe në mos qofshin të tërë komunistë, ata bëjnë punën e Partisë, dhe si të tillë duhet të interesohen për t'i çuar punët përpara. Po nuk e bënë ata këtë, kush do të interesohet, vetëm ne këtu lart? Kjo nuk është e drejtë. Kështu punët nuk mund të ecin mirë. Në këtë drejtim duhet të marrim masa dhe masa të forta bile.

Nuk mund të thotë asnjëri se këto defekte nuk ekzistojnë, përkundrazi, defekte ka në shumë drejtime. Por këto duhen eliminuar me një punë të gjithanshme. A ekziston te ne vrull i madh revolucionar? Shikoni ç'bëhet pas tërmetit! E gjithë Shqipëria u ngrit në këmbë! Po pse të mos ngrihen kolektivat punonjës në këmbë edhe për eksportin? Pse të mos ngrihen të tërë njerëzit në këmbë, kur dihet që vendi ynë është i rrethuar dhe ne luftojmë në këto kushte të vështira për realizimin e planit, në cilësi, në sasi, në kohë e në të gjitha? Siç më thanë mua, sa ra tërmeti, përpara Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës u mblodhën të tërë komunistët, ata ishin atje në këmbë dhe donin të dinin se ku duhet të shkonin tani për të punuar si bij të popullit e të Partisë. Po pse nuk mbahet i njëjti qëndrim edhe në punën e përditshme, në fabrikë, në ara e kudo? Duhet të punojmë, shokë, që këtë gjë ta realizojmë. Kërkohet një mobilizim total për realizimin

e detyrave të planit dhe nëpërmjet tregtisë së jashtme medoemos t'i plotësojmë deficitet e krijuara. Që të arrihet kjo duhet të realizojnë planin një varg ndërmarrjesh. Nxjerrjes së mineraleve që kanë shumë rëndësi, janë me leverdi dhe që i kërkojnë nga të katër anët, duhet t'i kushtojmë më tepër kujdes. Prandaj t'i vihemi më mirë punës në miniera.

Por edhe organizimi, drejtimi dhe kontrolli kanë rëndësi të madhe, shokë. E kemi thënë edhe herë të tjera se në mjaft raste problemeve u kalohet përciptas. Përveç ndërgjegjes, natyrisht, ka dhe çështje teknike, që duhen zgjidhur, siç na tha edhe Hekurani [Isai].

Si konkluzion unë them që duhet të forcojmë drejtimin, organizimin dhe kontrollin në të gjitha nivelet. Edhe edukimi i njerëzve të jetë në rendin e ditës, pasi ata duhet ta kuptojnë mirë atë që bëjnë dhe të dinë përse e bëjnë. Po nuk i kuptuan këto, nuk ka rezultate në punë, nuk ka as organizim, as drejtim të mirë, as kontroll efikas. Njerëzit ta kuptojnë situatën entuziashte, por të njohin edhe vështirësitë, që të luftojnë për t'i kapërcyer ato, për të mbajtur të gjallë situatën revolucionare.

Qeveria dhe Ministria e Tregtisë së Jashtme të vazhdojnë të aktivizojnë akoma më mirë aparatet e tyre, sepse detyrat në këtë fushë janë shumë të rëndësishme.

Për sa i përket raportimeve të kemi kujdes e të kërkojmë nga kuadrot që të jenë të saktë, të mos ketë në to eufori dhe fiktivitet. E them këtë se ka kuadrc e drejtues që detyrat që u ngarkohen nuk i ndjekin si

duhet, i lënë në letër, nuk luftojnë me të gjitha forcat për t'i vënë në jetë. Mirëpo, kur vijnë të raportojnë, flasin me hamendje.

Kushdo që vete në bazë nuk është nevoja t'u raportojë shumë vetave dhe të njëjtën gjë, kur mund të raportojë vetëm atje ku duhet.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

PO TË KUPTCHET IDEOLOGJIKISHT RËNDËSIA E PRONËS SË PËRBASIKËT, EDHE PUNA DO TË ORGANIZOHET NË MËNYRË MË RENTABEL

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

25 prill 1979

Pyetjet që bënë shokët këtu se si sillen në rrethin e Dibrës kuadrot me popullin etj., janë me vend. Mendoj se duhet t'u japim disa këshilla këtyre shokëve, se ne nuk jemi të mendimit që nuk punon Partia dhe ca më pak populli në rrethin e Dibrës. Populli i Dibrës është patriot e punëtor. Vetëm se në këtë rreth duhen luftuar disa pikëpamje që nuk i ka vetëm populli, por kanë dhe komunistët. Çështja duhet parë nga ana ideologjike, siç thotë shoku Foto Çami.

Ju, shokë, të Partisë e të pushtetit në rrethin e Dibrës duhet t'u futeni një çikë më thellë këtyre proble-

1. Në këtë mbledhje u diskutua dhe rreth raportit «Mbl punën e organeve dhe të organizatave të Partisë për forcimin e ndërgjegjes socialiste në luftë kundër mbeturinave të psikologjisë mikroborgjeze dhe ndjenjës së pronës private», paraqitur nga Komiteti i Partisë i Rrethit të Dibrës.

meve, të sqarohen mirë komunistët për këto mbeturi-na, që nuk mund të zhduken me pesë fjalë. Partia në rreth duhet t'u vërë rëndësi të madhe çështjeve ideologjike e politike. Po të punoni mirë në këtë drejtim, do të shihni që do të keni një ndryshim në mentalitetin e njerëzve. Kur ata ta kuptojnë ideologjikisht rëndësinë e pronës së përbashkët në socializëm, kur të dinë ç'është kjo pronë, atëherë ata jo vetëm do të shtojnë përpjekjet për forcimin e saj, por do t'i vënë shpatullat punës dhe do ta organizojnë atë në mënyrë të tillë që të japë më shumë rendiment dhe më shumë rentabilitet se deri tani.

Partia ka bërë studime, Ministria e Bujqësisë ka bërë studime për strukturën e mbjelljeve sipas rretheve dhe këto sigurisht kanë ardhur deri te ju, por, me sa duket, këto studime e orientime ju nuk i keni parë fare. Në rrethin tuaj mund të ndiqej një praktikë e tillë që në ato toka ku mbillni duhan, mund të mbillnit qiçra, që ju sjellin më shumë të ardhura nga duhani, duke rregulluar strukturën e mbjelljeve në gjithë rrethin sipas eksperiencës së Plasës, për të cilën, me sa duket, ju nuk e keni vënë fare ujin në zjarr! Kur fshatarët në rrethin tuaj janë në gjendje të marrin në atë kopshtin e vogël personal 300 kuintalë patate për hektar, atëherë ju duhet të vrisni mendjen që të mbillni në tërë rrethin sa më shumë patate për tregun. Vjet, siç e dini, te ne ka pasur vështirësi për patate, se u prodhua vetëm në Korçë, megjithëse edhe kjo e bëri një gabim, se e hoqi patatën nga ato toka ku mbillej zakonisht. Kështu edhe tregu mbeti pa patate, edhe fara mezi u sigurua.

Përpara një situatë të tillë ju, shokë të Dibrës, duhet të arrini në konkluzionin që ka kooperativistë që nuk e kanë kuptuar mirë ideologjikisht çështjen e kolektivizimit. Prandaj kërkohet një punë akoma më e thellë nga Partia në rreth. Kjo çështje duhet kuptuar edhe politikisht, në kuadrin e tërë vendit e të ekonomisë sonë socialiste, me qëllim që të bashkërendohen veprimet e individit, të kooperativës me zhvillimin e ekonomisë shtetërore në tërësi. Në qoftë se ua bëjmë të qartë kooperativistëve këtë gjë, ata do të shohin shumë të mira për veten e tyre, por edhe për shoqërinë.

Në qoftë se ju, siç u tha këtu, merrni në misër rendimente të larta, siç keni marrë më parë, se tani jua kanë kaluar, siç thotë populli, dhjetë pash rrethet e tjera ose më shumë, atëherë mbillni më shumë misër, se gruri bëhet në rrethet e tjera. Grurin që ju nevojitet, ne mund ta blejmë me gjysmën e misrit që prodhoni ju. Janë çështje ekonomike, financiare dhe tregtare këto, që kompensojnë njëra-tjetrën. Ne nuk themi që ju të hiqni dorë nga gruri, të kuptohemi, grurin mbilleni prapë, por ama në misër ju duhet të merrni mbi 50 quintalë për hektar, që dhe ta ruani traditën që keni, por edhe t'i rritni më tej rendimentet e tij. Ju, dibranët, e keni dashur misrin, të cilit i shërbenit mirë. Duke forcuar më shumë punën, në bazë edhe të traditës që keni, atëherë do të arrini të merrni 60, 65 quintalë dhe më shumë misër për hektar dhe nuk do të bëhet më fjalë pastaj për vështirësi në kthimin e borxheve që disa kooperativa bujqësore i kanë shtetit.

Mirë u tha këtu që kooperativisti të prodhojë në oborr, por jo të ndodhë që për shkak të oborrit të mos punojë sa duhet në kooperativë. Oborri kurdoherë, siç na ka mësuar Partia, është ekonomi e vogël në ndihmë të familjes së kooperativistit. Ai nuk do të ekzistojë, kur vetë kooperativisti të mos e ndiejë më nevojën për të. Por aktualisht mentaliteti i fshatarit në Dibër është i atillë që kooperativistin e ka mbërthyer pas oborrit. Edhe në rrethe të tjera ka tendenca të tilla, ka kooperativistë që oborrit i vënë kujdes më të madh se punës në kooperativë. Prandaj Partia në rreth duhet të bëjë përpjekje më të mëdha në punën bindëse me kooperativistët. Kjo kërkon që të shtohen kontaktet e kuadrove të ndërgjegjshëm, të ngritur politikisht dhe ideologjikisht me masat e kooperativistëve. Edhe kuadrot drejtues të Partisë të mos kënaqen vetëm me një shkollë a kurs partie që kanë bërë, por t'i diskutojnë vazhdimisht problemet në mes tyre nga ana teorike dhe ideologjike. Diskutoni, fjala vjen, pse ngjanë këto shqetësime në zonën tuaj. Në zbulimin e këtyre shkaqeve është e domosdoshme të thelloheni nga ana ideologjike, të zbuloni se ç'koncepte, ç'mendime ka te njerëzit dhe pasi t'i analizoni mirë, të hyni pastaj edhe në çështje politike e organizative.

Drejtimi i punëve ka rëndësi të madhe. Njerëzit duhet t'i ngremë politikisht dhe ideologjikisht që të ndërtojmë socializmin, të ndërtojmë një ekonomi të fuqishme, një shoqëri të re, të ndërtojmë një jetë të lumtur, të begatshme e të kulturuar për popullin. Por pa organizim, pa një drejtim të përsosur, pa sakrifica

nuk arrihen ato që kërkojmë. Në qoftë se fshatari nuk del herët në mëngjes në punë, siç e ka pasur zakon që në kohën kur kishte një copë të vogël toke dhe e punonte, e prashiste, e vadiste me ato hauzet që në mëngjes, nuk shkon përpara bujqësia. Tani që i kemi kushtet një mijë herë më të mira, duhet të prodhojmë më tepër. Këto tradita që i ka populli i Dibrës, t'i ruajmë, t'i forcojmë e t'i çojmë akoma më përpara.

Edhe mentaliteti i bajraktarizmit dhe mbeturinat e mentalitetit të fiseve duhet të mos lejohen në socializëm. Kemi 35 vjet që fshatari i malësisë është bashkuar me fshatarin e fushës, prandaj nuk është e drejtë që malësori të mendojë, siç ndodh në disa raste, se për arsye të kushteve të vështira të klimës, të terrenit etj. mund të rrijë duarkryq dhe për ta ushqyer të punojnë ata të fushës. Malësori të mos i lejojë vetes që ai të bëjë 100 ditë-punë, kur ai i fushës bën 320.

Ne kemi besim se në rrethin tuaj situata do të shëndoshet. Porositë dhe detyrat që morët këtu shtrojni atje në bazë, në popull. Me siguri të gjithë do të reflektojnë, do ta ndiejnë që diçka nuk ka shkuar në rregull dhe do të bëjnë përpjekje që t'i shlyejnë me punë mungesat. Atëherë vitin tjetër t'i raportoni udhëheqjes për kthesën e bërë në rrethin tuaj.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

OBJEKTET ME VLERË HISTORIKE TË RUHEN DHE TË RESTAUROHEN

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

25 prill 1979

*Pasi shokët e Byrosë Politike panë maketin dhe
ndoqën shpjegimet e arkitektit, e mori fjalën shoku
Enver Hoxha:*

Mendimi ynë është të ruhet ana historike. Sheshi
i Flamurit është me rëndësi historike. Unë mendoj që
këto ndërtesa midis sheshit dhe varrezave të dëshmo-
rëve të mos jenë këtu, është më mirë që vendi para
monumentit të jetë i hapur, që ai t'i shikojë varrezat.
Edhe muzeu, biblioteka, galeria e arteve etj., etj. të
jenë medoemos këtu. Më duket se është më mirë që
teatri të bëhet në Skelë.

Mund të mendohet se është larg qytetit, por nuk

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për maketin e qend-
rës së qytetit të Vlorës dhe për maketin e monumentit të Dra-
shovicës.

është ashtu. Qyteti i vjetër duhet të ruhet me ato karakteristika që ka dhe të rregullohet, siç janë rregulluar edhe Gjirokastra, Korça dhe qytetet e tjera. Për ato shtëpi që do të prishen, të mos vihet kazma pa u menduar, por në qoftë se është dëmtuar ndonjë shtëpi karakteristike për arsye se është rrënuar, të restaurohet. Kudo të bëhet gjelbërimi.

Për sa i përket qytetit, mua më duket se ka marrë rrugën e zhvillimit drejt Skelës. Këtë rrugë e ka marrë edhe pa e vendosur ne.

Rrugës së Skelës vetëm teatri i mungon, se të gjitha të tjerat, domethënë dyqanet, shkollat, i ka. Këtu, diku, duhet të ndërtohet edhe një kinema.

Në qytet ka kinema, siç ka edhe teatër, gjithashtu dhe të gjitha ambientet e tjera, por kur i gjithë qyteti dhe ndërtesat e mëdha venë andej, duhen bërë edhe këto andej. Por unë mendoj të mos ia zëmë sytë sheshit, se nuk është e domosdoshme që t'i mbyllim sheshet me ndërtesa. Ato sheshe që njihen në botë, si për shembull Trokadero, Konkord etj. nuk kanë ndërtesa rreth e rrotull, para tyre ka hapësira të mëdha. Kjo hapësirë që shohim në maket nuk është edhe aq e madhe. Unë do të kisha mendimin që këtu, ku janë varrezat, shkallët të bëheshin drejt dhe jo me ato kthesat që kanë. Në rastet kur të bëhej ndonjë koncert, njerëzit do të shikonin, të ulur nëpër shkallë. Këtu të shërbënin edhe skalinat.

Të mendoni ç'do të bëhet edhe në anën tjetër të sheshit. Ndërtesa e komitetit ekzekutiv mund të qëndrojë këtu, se kjo është ndërtesë e vjetër dhe e ma-

dhe. Edhe këto shtëpitë e vjetra, që janë këtu pas, duhet të ruhen e të restaurohen të tëra si ato në rrugët e Korçës. Këto janë ndërtesa të vogla, por shumë të bukura.

Kështu, siç po shohim maketin, këtej Vlora do të bëhet e bukur dhe me gjelbërim. Mirë. E bukur do të dalë. Ja dhe kjo këtu është ndërtesa ku u formua qeveria e Vlorës. Sigurisht ju keni menduar për të dhe si mund të pasurohet me ndonjë objekt tjetër.

Të keni kujdes, të parashikoni në projekte se ku do të jetë edhe stacioni hekurudhor.

Për sa i takon veprës që do të ngrihet në Drashovicë¹ mendoj se në qendër të saj mund të bëjmë monumentet e dy ushtarëve, një të Luftës së Vlorës dhe një të Luftës Nacionalçlirimtare. Të shihet mundësia me ç'material do të punohen.

S'na mbelet gjë tjetër vetëm të përgëzojmë shokët për këto vepra dhe për të tjerat që kanë bërë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

1. Monumenti i Drashovicës. I Skulptorit të Popullit Mumtaz Dhrami, u përrua më 1939.

TEORIA E «BOTËS SË PAANGAZHUAR» PO FALIMENTON

Shënime

26 prill 1979

Teoria e «botës së paangazhuar», e kësaj bote që renegati i marksizëm-leninizmit dhe agjenti i imperia-
lizmit botëror, Titoja, përpiqet ta udhëheqë, po falimen-
ton kokë e këmbë. Siç kam shkruar në shkrimet e mia
edhe më përpara, kjo pseudoteori ose pseudopolitikë
që kanë ndjekur Naseri, Nehruja, Sukarnoja, Titoja
e ndonjë tjetër, ka pasur për qëllim që imperializmi
të ruante dominimin e vet politik, ekonomik dhe ush-
tarak mbi vendet e vogla të kontinenteve të ndryshme,
të cilat pas Luftës së Dytë Botërore dolën nga kolo-
nializmi shumëvjeçar dhe u futën nën një zgjedhë të
re neokolonialiste nga imperialistët amerikanë dhe
imperialistët e tjerë nën pretekstin e dhënies atyre të
njëfarë lirie e pavarësie.

Këta agjentë të imperializmit, natyrisht, e shpikën
këtë krijesë, teorinë e «botës së paangazhuar», për t'u
dhënë përshtypjen popujve të atyre vendeve, ku sun-
donin klika borgjezo-kapitaliste, se këto shtete ishin

çliruar, ishin gjoja me të vërtetë të pavarura dhe pra edhe popujt ishin gjoja të lirë e të pavarur. Me fjalë të tjera, kjo agjunkturë ndërkombëtare e imperializmit mori përsipër të ruante atë statukuo që krijuan pas Luftës së Dytë Botërore, për interesat e vet të mëdhenj, imperializmi amerikan kryesisht dhe shtetet e tjera kapitaliste si Anglia, Franca etj.

Natyrisht, u gjend edhe termi i përshtatshëm për këto vende. Ato u quajtën «të pavarura». Po nga kush ishin të pavarura? Nga shtetet e tjera, që në të kaluarën kishin bërë ligjin mbi to, domethënë nga shtetet imperialisto-kapitaliste. Por a ishin me të vërtetë të pavarura këto vende? Në asnjë mënyrë nuk ishin e nuk kishte se si të ishin, për arsye se ekonomikisht qenë krejtësisht të dobëta dhe për pasojë, ato nuk mund të rronin të pavarura dhe s'mund të quheshin të tilla në atë formë shtetërore borgjeze të sapokrijuar, të dala nga një kolonializëm i egër.

Për sa i përket pavarësisë politike, për shumë nga këto shtete, as që mund të flitej, për arsye se politika e tyre jo vetëm ishte një politikë borgjeze kapitaliste e bazuar në struktura akoma të paformuara të borgjezisë industriale ose uzurare, por shumë prej tyre ishin akoma në feudalizëm, akoma nën rendin e vjetër të tribuve. Pra, nga ana politike ato nuk kishin asnjëfarë pavarësie. Udhëheqësit e këtyre vendeve, natyrisht, ishin kapitalistë dhe kapitalizmi i vuri në fuqi ata, u dha njëfarë kushtetute, duke përcaktuar një rend politiko-ekonomik dhe kështu vende të tilla mbe-

tën të varura nga politika e imperializmit amerikan ose e zonave të sterlinës dhe e zonave të frankut.

Natyrisht, gjatë viteve të pasluftës këto shtete, të krijuara nga kolonializmi, i cili nuk mund të mbahet më në këmbë në ato forma dhe me ato struktura shtypjeje e shfrytëzimi si më parë, do të pësonin disa evolucione. Evolucionet në këto vende bëheshin sipas interesave të padronëve të tyre të vërtetë, të cilët, në mënyrë të hapët ose të tërthortë, drejtonin jetën e tyre nëpërmjet klikave në fuqi, nëpërmjet shoqërive ekonomike, konccsioneve ekonomike ose specialistëve të degëve të ndryshme dhe synonin të ndryshonin, herë pas here, liderët e këtyre shteteve gjoja të pavarura.

Mirëpo këto evolucione shoqëroheshin me një shfrytëzim të madh, edhe më të egër nga ai i mëparshmi, për arsye se pasuritë e mbitokës dhe të nëntokës së këtyre vendeve në kontinente të ndryshme filluan të shfrytëzohen më egërsisht, më barbarisht, me metoda më moderne. Kolonizatorët e specializuar u bënë në kolona kryesore, të cilët i përdorën autoktonët (vendasit) si punëtorë të thjeshtë. Ata që bëheshin vegël e tyre, i dërgonin nëpër shkolla e në universitete në metropol. Ky instruktim i tyre, sidoqoftë, edhe në këto vende solli një frymë disi të ndryshme nga regjimet shtypëse koloniale të mëparshme. Zhvillimi u hapi sytë shumë prej njerëzve të inteligjencies së re, të cilët filluan të gjykonin format dhe metodat që përdorehin për shtypjen dhe për shfrytëzimin e popujve të tyre.

Kështu që neokolonializmi, me gjithë shtypjen, solli edhe njëfarë zgjimi disi më të madh në këto shtete

të reja të kontinenteve të ndryshme. Kjo bëri që përkrah organizatave të mëdha ndërkombëtare, siç ishte Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe organet e saj të ndryshme, të specializuara, të krijoheshin edhe organizata të tjera ndërkombëtare, gjoja për mbrojtjen e interesave të një grupi shtetesh në Afrikë, ose të shteteve arabe etj. Kjo gjë krijoi një gjendje disi më të vështirë për neokolonialistët, mbasi kërkesat u bënë më të theksuara e këtyre, medoemos, u duhej bërë ballë. U duhej bërë ballë brendapërbrenda, gjithashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Përpara opinionit botëror duhej krijuar e duhej forcuar përshtypja se këto shtete pseudo të lira e sovrane ishin me të vërtetë të lira e sovrane, se gjoja kishin të drejtë ta thoshin fjalën e tyre në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në organizata të tjera të ndryshme ndërkombëtare. Por historia e gjithë periudhës, që nga krijimi i tyre e deri sot, tregon se në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, për shembull, të gjitha këto shtete të ashtuquajtura të pavarura votonin në bllok me imperializmin amerikan. Me dekada të tëra u duk qartë që këto shtete, të ashtuquajtura të pavarura, ishin krejtësisht të varura nga imperializmi amerikan, nga Franca, nga Anglia dhe nga shtetet e tjera kolonialiste, aq më tepër kur në këto organizata u pranua edhe Gjermania e Bonit, edhe Japonia e mikados etj.

Brenda secilit prej këtyre vendeve, natyrisht, duheshin përballuar revoltat e masave të gjera, antagonezmat që krijoheshin në mes shfrytëzuesve të huaj e

vendas, që pasuroheshin, dhe popujve të këtyre vendeve, që shtypeshin; i duhej bërë ballë polarizimit të brendshëm. Natyrisht, borgjezia përdori taktikën e saj të vjetër. Kështu në këto vende u krijuan parti të ndryshme. me programe të ndryshme, që përfaqësonin shtresa ose klasa të caktuara, parti që kishin organet e tyre të shtypit, ku shfaqnin opinionet politike. Në këto vende bëheshin zgjedhje gjoja demokratike, krijoheshin parlamente, bëheshin mbledhje të pambaruara, por asgjë nuk ndryshonte, çdo gjë bëhej për të forcuar klikat në fuqi dhe padronin e tyre të madh që kishin mbi kokë.

Lindën kontradikta të mëdha midis këtyre shteteve të ndryshme të sajuara, dolën rivendikime tokësore, gjë që do të thotë se kufijtë midis tyre nuk ishin caktuar drejt, bile këto shtete midis tyre shfaqën edhe pretendime territoriale dhe arritën deri aty sa t'i shpallin edhe luftë njëri-tjetrit. Borgjezia kapitaliste e këtyre vendeve, e mbështetur nga fuqitë e ndryshme imperialiste, nxitte luftërat lokale midis shteteve për të zgjeruar pushtetin dhe fitimet e veta, me qëllim që t'i siguronte padronit të vet ato pozita kyç që rrezikoheshin nga kundërshtari i tij politik e sidomos ekonomik.

Pra, gjatë gjithë kësaj periudhe, në formacionin e këtyre shteteve gjoja të pavarura, që ishin nën sundimin e neokolonializmit, nën sundimin e klikave kapitaliste borgjeze të shitura dhe të varura nga kapitalizmi ndërkombëtar, u krijuan situata të tilla që kërkonin të gjendeshin forma më të reja, domethënë më

të rreme, më të alambikuara, më të sofistikuara, për shfrytëzimin maksimal të pasurive të këtyre vendeve dhe për zhdukjen sa më shpejt dhe sa më mirë të tendencave e lëvizjeve liridashëse dhe revolucionare të popujve të tyre.

Pra, në këto situata shohim që grupi i Tito-Nehru-Nascrit e të tjerëve krijoi këtë farë organizate të «vendeve të paangazhuara», që nuk kishte formë organizative, por gjoja kishte si parim çështjen e mospjesëmarrjes në organizatat ushtarake që kishte krijuar imperializmi amerikan, dhe në Traktatin e Varshavës që e krijoi Bashkimi Sovjetik për t'u mbrojtur, e që më vonë, me tradhtinë e hrushovianëve, u bë një traktat agresiv. Natyrisht, gjatë kësaj kohe, gjatë kësaj periudhe dekadash, imperializmi amerikan krijoi baza dhe flota ushtarake në vende të tjera, krijoi konsorciume, monopole, shoqëri të mëdha të përbashkëta, zhvilloi flotën e madhe oqeanike. Gjithashtu, zhvilloi armët moderne atomike e konvencionale dhe, tok me krijimin e bazave tokësore, detare e ajrore në territore të vendeve të tjera dhe me forcimin e tyre me trupa amerikanë, armatosi shtetet që kishte nën drejtimin e vet si dhe udhëhoqjet e këtyre shteteve, pse vetëm kështu imperializmi amerikan do t'i bënte ballë socialimperializmit sovjetik që kërkonte rindarjen e botës, do t'i bënte ballë hovit revolucionar të masave punonjëse të varfëruara e të mjeruara të kontinenteve të ndryshme, të inkuadruara në shtete me një regjim neokolonialist. Këta popuj, gjoja të pavarur, ai do t'i shfrytëzonte nga ana ekonomike nëpërmjet ndihmave

dhe shoqërive të përbashkëta, kredive që jepte e investimeve që bënte në to.

Përveç NATO-s imperializmi amerikan krijoi edhe organizata të tjera si SEATO-n, SENTO-n etj., për t'u bërë ballë njëkohësisht edhe socialimperializmit sovjetik hrushovian, por edhe revolucionit që mund të përçatetej, të merrte frymë e gjallëri dhe të shpërthente në shtetet që shtypeshin me forma të reja.

Titoja, që mbeti gjallë pas vdekjes së gjithë liderëve të vendeve aziatike dhe afrikane, natyrisht, me ndihmën e teoricienëve e të dollarit amerikan, u përpoq që t'i jepte njëfarë forme organizative kësaj «lëvizjeje të të paangazhuarve», t'i jepte njëfarë baze teorike, të përcaktonte qëllimet e kësaj lëvizjeje të pakufi, pa kokë, pa këmbë, pa zemër. Me fjalë të tjera, Titoja, me ndihmën e amerikanëve, u përpoq dhe përpiqet që këtë lëvizje ta quajë organizatë. Më në fund ai arriti të krijojë një komitet ekzekutiv të kësaj organizate, i cili mblidhet herë pas here dhe bën muhabetë e llogje, që nuk kanë asnjë vlerë dhe s'hapin asnjë perspektivë për këto vende, të cilave nuk u jepet as minimalja që kërkojnë, megjithëse lëmoshat vazhdojnë t'u jepen sipas interesave të fuqive imperialiste që kanë influencë në këto vende të ndryshme, në këtë stan lepunjsh që ka grumbulluar Titoja.

Në punën e tij për ta bërë operuese këtë organizatë të vendeve «të paangazhuara», Titoja ka marrë shumë kredi, bile kolosale, për Jugosllavinë. Këto kredi jo vetëm e kanë bërë Titon gjoja liderin e vërtetë të vendeve «të paangazhuara», por edhe Jugosllavinë

e kanë bërë prototipin e një vendi të falimentuar në organizimin shtetëror, politik dhe ekonomik. Jugosllavia është një nga vendet prototipe ku ekziston një diktaturë kapitaliste e kamufluar me gjoja liri demokratike, me të drejtat e njeriut. Mirëpo në Jugosllavi kush ngre krye kundër klikës në fuqi, futet përnjëhërësh në burg.

Po t'i hedhim një sy gjendjes aktuale të vendeve «të paangazhuara», shohim se kjo është jashtëzakonisht e çoroditur dhe e çorganizuar. Ajo nuk ka qenë kurrë e organizuar, por edhe atë formë të lehtë organizimi që kishte mundur të krijonte imperializmi me Titon, edhe ajo po thërrmohet. Në fakt vendet që bëjnë pjesë në këtë të ashtuquajtur organizatë, nuk janë dakord as për mbledhjen e të ashtuquajturit komitet ekzekutiv, ose mbledhja e përfaqësuesve të vendeve «të paangazhuara», jo vetëm për qëllimet e mbledhjes, por as për vendin se ku duhet të bëhet mbledhja, për arsye se grupe të ndryshme shtetesh, por edhe shtete të veçanta të këtij grupimi janë në grindje, janë në luftë, janë në kontradikta të mëdha me njëri-tjetrin, janë në kontradikta gjithashtu me shtetet imperialiste që mbështetin njërin apo tjetrin grupim...

Në mbledhjen e vendeve «të paangazhuara», vendet arabe do të gjenden në konflikt; në vend që të flitet për gjoja unitetin e këtyre vendeve, do të flitet për dizunitetin e tyre. Për sa i përket Iranit, ky mund të konsiderohet si një vend i paangazhuar, mirëpo atje akoma nuk ka stabilitet. Ai është në një konfuzion të madh dhe kërkon të angazhohet diku, por ka frikë edhe

nga Bashkimi Sovjetik, edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pra ky vend «i paangazhuar» mezi do të vejë në atë mbledhje. Por çështja qëndron më larg: imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, si njëri, edhe tjetri, nga ana e tij edhe imperializmi kinez, luajnë atje kartën e tyre.

Karta e «tri botëve», «teoria» e famshme e Mao Ce Dunit, ra në ujë. Kjo pseudoteori a dogj nga ne dhe nuk përmendet më. Tash, në qoftë se përmendet ndonjë çikë, është «bota e paangazhuar» dhe kjo ndodh për arsye se po organizohet mbledhja. Natyrisht, në këtë «botë të paangazhuar» luajnë rolet e tyre edhe imperializmi amerikan, edhe socialimperializmi sovjetik, edhe socialimperializmi kinez.

Aktualisht «bota e paangazhuar» është bërë një botë fiktive, një botë që emri i qëndron vetëm mbi kartë dhe asgjëkundi tjetër. Do të bëhen përpjekje për ta shtyrë këtë mbledhje, siç po duket, do të përiqen të gjejnë një *modus vivendi* për të mos e bërë mbledhjen në Havanë, me qëllim që të neutralizojnë ndërhyrjet sovjetike dhe të triumfojë teza amerikane e Titos. Pra shohim se kjo «botë e paangazhuar» që gjoja ka qëllime të larta, që gjoja i është kundërvënë imperializmit, po ndahet edhe kjo në blloqe. Kështu janë vendet e konglomeracionit afrikan, vendet e botës arabe, vendet aziatike, Afganistani, Pakistani, të cilat janë ndarë disa nën influencën e sovjetikëve, disa nën influencën e kinezëve etj.

Me fjalë të tjera, është ajo që thashë më parë: kjo «botë e paangazhuar» është një bluf i vërtetë, është

një skandal, është një krijesë kukull, e veshur me një petk të botës kapitaliste, revizioniste, titiste, për të shtypur revoltat, kryengritjet e popujve të ndryshëm, që kërkojnë liri e demokraci brenda vendit dhe nga zgjedha e neokolonialistëve të huaj.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 12 f. 482

DETYRAT REALIZOHEN DUKE RRENJOSUR KONCEPTE SOCIALISTE TE NJERËZIT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

27 prill 1979

Pasi të ftuarit në mbledhje iu përgjigjën pyetjeve të ndryshme që u bënë, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Lufta dhe përpjekjet që keni bërë ju shokë të rretheve janë një gjë e mirë, po deri ku kanë arritur këto përpjekje dhe çfarë ka dalë prej tyre?

Nuk e mohon njeri se keni bërë analiza, por nuk është kjo çështja. Ju duhej të futeshit më shumë në punë, se mund të vazhdoni me analiza, po në fund të fundit ç'del prej tyre? Të llogaritni më mirë anën ekonomike.

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi punën e bërë dhe masat që do të merren për zbatimin e vendimit të KQ të PPSH për plotësimin dhe tejkalimin e detyrave të planit të pambukut». Ishin të ftuar sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve Fier dhe Lushnjë.

E keni llogaritur ju sa i vete kostoja pambukut, kur, megjithëse ka muaj që po bie shi, ju përdorni impiantet e ujitjes, duke e harxhuar naftën për traktorët?! Po kështu ndodh që fshatarët paguhen për të dytën herë edhe për punët që bëjnë për të riparuar të këqijat e punës së mëparshme të kryer prej tyre pa cilësi. Po kjo nuk e shton koston e prodhimit? Dihet se pambuku duhet të mbillet në disa kushte dhe me një cilësi të caktuar. Po nuk u mboll kështu, atëherë përsëri punëtori në fermë ose koöperativisti do të duhet t'i kthehet që të bëjë të njëjtën punë. Por ama kjo të paguhet vetëm një herë. Mos ka ndonjë padrejtësi këtu? Jo, nuk ka padrejtësi, përkundrazi, duke e paguar punën vetëm një herë, secili merr shpërblimin që i takon dhe jo më tepër. Shoqëria nuk mund të mbajë në kurriz pasojat e punës së dobët të disa punonjësve të pandërgjegjshëm.

U tha këtu se për gjëra të tilla qenka shkarkuar një brigadier. Nuk i intereson Sekretariatit të Komitetit Qendror që u shkarkua apo nuk u shkarkua një brigadier. Ajo që na shqetëson nuk është kjo. Këtu diskutojmë për çështjen e masave të gjera organizative dhe teknike që duhet të merren për mbarëvajtjen e punës. Se, siç doli këtu, me qindra veta nuk dalin në punë në kooperativa. Pra, nuk është fjala për punën e dobët të një brigadieri, por për tërë ato forca që nuk marrin pjesë në punë dhe për këtë shokët në rreth nuk llogaritin fare ditët e humbura. A, shokë, nuk mund të ecet kështu!

Ju duhet të na flisni këtu për probleme të rëndë-

sishme, për shembull për cilësinë e shërbimeve, për cilësinë e pambukut, ç'përpjekje bëni ju që të merrni pambuk të cilësisë së parë e të dytë. Kjo do të na interesonte dhe jo duke na thënë disa llafe aty-këtu, por të na flisni me gjykime të mbështetura shkencërisht. Për shërbimet që i bëhen pambukut etj.

Çështja shtrohet si do të vejë kjo punë në të ardhmen. Pambuku na kushton mjaft, se me këtë bimë zëmë tokat më të mira të Myzeqesë. Të shpenzojmë shumë dhe të marrim pambuk të kategorisë së ulët, kjo nuk është aspak e pranueshme. Për shkak të cilësisë së dobët të pambukut tonë, kemi qenë të detyruar të importojmë pambuk fijejgatë. A na lejohet të vazhdohet të ecet në këtë mënyrë? Jo, nuk mund të ecet. Me këtë frymë kërkojmë ne që ju të diskutoni këtu.

Ju duhet të studioni e të zgjidhni disa probleme, si llojin e farës që u shkon më shumë klimës dhe tokave të rrethit tuaj. A keni bërë ju prova dhe eksperimentime të farës para se ta mbillni në sipërfaqe të gjera apo e mbillni se kështu ju kanë thënë? Pra, ju, pa bërë fare prova, u kënaqët që siguruat farë dhe e mbollët. Po a i mbani parasysh ju, shokë të rretheve, ndryshimet e kushteve klimatike midis vendit tonë dhe vendit prej nga është marrë fara e pambukut? Këto ndryshime nuk mund të mos mbahen parasysh për të arritur në një përfundim të drejtë nëse ajo farë është e përshtatshme për kushtet tona apo nuk është e përshtatshme.

Megjithëse Instituti i Kërkimeve Bujqësore e ka provuar këtë farë dhe është i mendimit që të mos për-

hapet, siç u diskutua edhe këtu, ju po e mbillni në sipërfaqe të gjera dhe po e përhapni! Instituti i Kërkimeve Bujqësore zhvillon veprimtarinë e vet në rrethin e Lushnjës, po sa ndihmon ai që atje të merren 13 kuintalë pambuk për hektar? Sa njerëz punojnë atje? Kemi thënë disa herë që Lushnja duhet të jetë fushë eksperimentale e këtij instituti. Veprohet kështu apo jo? I dëgjojnë kooperativistët rekomandimet e institutit apo dëgjojnë vetëm urdhrat e brigadierit? Natyrisht, në rrethin e Lushnjës, si kudo, ka shumë agronomë që mund dhe duhet të merren me eksperimentimin shkencor, por unë pyes për institutin që mund të ndihmojë më tepër se një agronom i ri që sapo ka dalë nga Instituti i Lartë Bujqësor. Ju të rrethit në bashkëpunim me Institutin duhet të arrini në disa konkluzione të qarta për bimën e pambukut, për afatet optimale të mbjelljes, për kohëzgjatjen e ciklit etj. që të punohet në mënyrë shkencore e të arrihen rezultatet e dëshiruara. Përse veprohet kështu, kur nuk po dëgjojmë të na thuhet se po merret pambuk i kategorisë së parë dhe as i kategorisë së dytë? Që të merret pambuk i kualitetit të parë e të dytë kërkohet zbatimi i një agroteknike të përsosur. «Kemi bërë mbledhje, konsulta», na thuhet. Mirë, mbledhjet e konsultat që keni bërë janë të domosdoshme, por neve na duhen rezultatet. Pra, krahas mbledhjeve, duhet të merren edhe masa organizative e teknike të atilla që këto mbledhje e konsulta të japin rezultate.

Ju thatë se në rrethet tuaja u mor në pambuk një rendiment mesatar prej 8 kuintalë për hektar. E shikoni

se jemi akoma larg nga rendimentet që kërkohen? Ne kemi mundësi të marrim edhe 17, edhe 18 kuintalë pambuk për hektar. A i studion dhe i krahasoni ju, që merreni me bujqësinë, të dhënat e rendimenteve të pambukut? Në qoftë se i studioni, ku janë rezultatet e studimeve e të eksperimentimeve që po bëni? Nuk di ç't'ju them tjetër për këtë problem, por derisa në Lushnjë merret maksimumi 17 kuintalë pambuk për hektar, përse të mos merren atje mesatarisht të paktën 12-13 kuintalë pambuk për hektar, por i një cilësie të lartë dhe me kosto të ulët?

Unë mendoj se kjo nuk arrihet, pasi nuk punohet mirë nga organizata e Partisë, nga kuadrot drejtues. Për shembull në Lushnjë, duke qenë se kooperativistët mbajnë në oborrin personal më shumë se nga ç'u lejohet me statut, atëherë ata nuk dalin rregullisht në punët e kooperativës, se merren më shumë me oborrin personal. Nga kjo ka rrjedhime jo të mira. I shikon komiteti i Partisë këto probleme? Kur del një vendim a direktivë, Partia në rreth e në bazë duhet t'u shpjegojë e t'ua bëjë të qartë masave dhe të këmbëngulë që ato të zbatohen pa lëshime. Jo të bëhen punë gjysmake në këtë drejtim. Po të veprohet në mënyrë korrekte e në përputhje me vendimet, nuk ka pse t'ju lindin probleme. Partia i sqaron njerëzit, i bind ata që të shohin edhe interesin e përgjithshëm.

Ne jemi komunistë dhe, si të tillë, kemi përgjegjësi të madhe para popullit për ndërtimin e socializmit. Socializmi nuk ndërtohet pa njohur e pa studiuar në thellësi të gjitha fenomenet ekonomike dhe shoqë-

rore që kanë një ndikim të madh në zhvillimin socialist të vendit. Krahas këtyre duhet studiuar edhe formimi politik dhe ideologjik i njerëzve. Në qoftë se të tëra këto fenomene nuk i studiojmë dhe mendojmë se me disa mbledhje ose me disa masa të përcipta do të ndryshojmë situatën, unë them se e kemi gabim. Në qoftë se nuk ngremë vazhdimisht në një shkallë më të madhe nivelin e punës edukuese për të forcuar ndjenjën e ruajtjes dhe të forcimit të pronës së përbashkët, në qoftë se lejojmë që ndjenja dhe psikologjia e pronës private të shtohet, atëherë, ashtu siç thotë Lenini, kjo pronë krijon vazhdimisht, çdo ditë, çdo orë kapitalizmin.

Lufta midis dy rrugëve, kapitaliste e socialiste, është ligj objektiv i zhvillimit të shoqërisë. Prandaj në të gjitha këto punë për të cilat Partia thotë se duhen bërë, duhen organizuar e duhen kontrolluar etj., të bëhet kujdes, të rritet interesimi jo vetëm i Partisë, i komunistëve, por i të gjithëve. Detyrat e mëdha që ka bujqësia përbëjnë një kompleks të tërë të madh. Ato realizohen kur me njerëzit punohet për të rrënjësuar konceptet socialiste për punën, për pronën. Ndryshe, ata gjejnë rrugën tjetër, atë të fitimit, që është në kundërshtim me ligjet socialiste.

Po t'i shohim 35 vjetët që kanë kaluar nga Çlirimi e këtej për nga përparimet e arritura, themi se ato përbëjnë një periudhë kohe të gjatë, brenda së cilës janë bërë shumë punë e transformime të mëdha në të gjitha fushat. Por në të vërtetë 35 vjet për historinë e një populli janë një periudhë shumë e shkurtër. Gjatë

kësaj periudhe jo vetëm të moshuarit, por edhe të rinjtë, bijtë e bijat e tyre, kanë ndryshuar konceptet në favor të socializmit. E kam fjalën sidomos për konceptet e reja socialiste që janë futur në fshat. Mirëpo mbeturinat e së kaluarës, atavizmi i shoqërisë së vjetër, janë shumë të rrezikshme. A ka raste që te disa njerëz manifestohet njëfarë lodhjeje? A ka raste që disa njerëz e quajnë normale që edhe pa arsye të mos dalin në punë një ose dy ditë? Ka. Këto shfaqje vërtet nuk tregojnë se njerëzit tanë nuk janë patriotë, ose se ata nuk e duan socializmin, por, sidoqoftë, me qëndrimet e tyre ata e dëmtojnë ecjen tonë përpara.

Ne komunistët nuk i mësojmë njerëzit që të punojnë e të sillen si automatë, që atyre t'u kanoset disiplina e urisë, siç bën kapitalizmi, por punojmë për t'i bindur për nevojën dhe për dobinë e punës. Pikërisht në punën për bindjen e njerëzve qëndron forca e Partisë sonë. Dhe bindjet formohen jo vetëm me leksione dhe me fjalime, por me shumë mënyra e me shumë forma edhe në punë e sipër, pa përjashtuar edhe përpjekjet për t'u krijuar njerëzve mundësi që punën ta bëjnë jo thjesht për të marrë pagën, por për të gjetur edhe kënaqësi tek ajo. Prirja nga fitimi me çdo kusht edhe në kurriz të shoqërisë është krimbi më i madh që i prish njerëzit. Kjo nuk do të thotë të mos i paguajmë punonjësit sipas sasisë dhe cilësisë së punës që kryejnë, por çështja është që ata të mos shohin vetëm interesin e ngushtë personal, por të luftojnë edhe për dobinë e shoqërisë, për interesat e atdheut e të socializmit.

Njerëzit tanë duhet të shtojnë vazhdimisht përpjekjet e tyre në punë që ta përmirësojnë jetën, sepse ky është edhe synimi i Partisë. Por përmirësimi i kushteve materiale duhet të bëhet në përputhje me ligjet e shtetit socialist. Përmirësimi i nivelit të jetesës do të arrihet në procesin e zhvillimit dhe të shtimit të pasurive kombëtare, në rritjen e fuqisë blerëse të punonjësve për pajisjet e nevojshme vetjake e familjare, për ushqime etj., në mënyrë që ata të rrojnë gjithnjë e më mirë. Këtu lidhet edhe problemi i vlerës së parasë me ngritjen e nivelit të jetesës. Pa e mbuluar me prodhime të bollshme tregun, nuk ka vlerë paraja. Pra, kryesorja është të shtohet prodhimi që të mbulohet fuqia blerëse e popullit. Këtë situatë do ta krijojmë jo me fjalë, por me punën e njerëzve tanë.

Këtu del edhe roli i punës edukative. Puna bindëse i ngre njerëzit shpirtërisht e moralisht, i ndërgjegjëson dhe i bën ata entuziastë që të shkojnë me kënaqësi në punë. Ka raste kur, për të arritur në frontin e punës, kooperativistit i duhet të ecë goxha më këmbë. Në kushtet tona nuk sigurojmë dot automjete me bollëk për transport, prandaj t'i bindim njerëzit se në këto kushte duhet të ngremë nivelin tonë ekonomik që të përmirësojmë edhe kushtet e punës. Por që ata ta kuptojnë drejt Partinë dhe ta ndiejnë se sakrificat e tyre bëhet për interesat e atdheut, kërkohet që punonjësit e Partisë, kuadrot e komunistët t'u qëndrojnë afër atyre, të shkojnë së bashku me ta në punë, dhe jo vetëm t'u japin urdhra. Puna e Partisë nuk mund të reduktohet në formula dhe në leksione

të gatshme. Nuk edukohen njerëzit duke u thënë: «Hajde, lexo këtë libër dhe shko!» Jo., puna e Partisë është shumë e gjerë dhe e larmishme. Kur ajo bëhet në mënyrë efektive, edhe punën e jetën e njerëzve tanë e bën më të gjallë, edhe vetë njerëzit më entuziastë që të punojnë të gëzuar, me dëshirë e me vullnet, me këmbëngulje, i bën të thellohen vazhdimisht në njohuritë shkencore për të marrë rezultatet e kërkuara dhe për të pasuruar e zbukuruar jetën e tyre.

Po ka edhe formalizëm në punën me njerëzit. Ja, për shembull, unë jam i bindur se traktoristit vetëm i kërkohet të punojë dhe nuk mendohet se ai, duke qëndruar tërë ditën mbi traktor, shkundet si dega e ullirit për të dhënë kokrra, sepse ai lodhet shumë. Ai bën një punë të lodhshme, e cila duhet inkurajuar, duke i dhënë traktoristit njëfarë satisfaksioni qoftë moral, qoftë material. Janë të rrallë ata që mendojnë për këtë çështje me rëndësi. Punëtorët tanë dallohen në punë, ata janë njerëz të fortë e të disiplinuar. Të tillë që duhen inkurajuar, ne kemi me mijëra.

Po ashtu kërkohet një përdorim sa më racional i forcave të punës. Kur përgatiten impiante ujitëse, për shembull, duhet të merrni lapsin e të llogaritni sa forca pune kursehen po të bëhet ujitja me impiantet. Kjo duhet bërë, se ne kemi në plan të bëjmë edhe impiante të tjera ujitëse, që të ujiten edhe mijëra hektarë të tjerë. Por që tani duhet menduar se si dhe ku do të përdoren forcat e punës që lirohen nga ujitja, se po ia lamë këtë gjë spontanitetit, atëherë bujku do të bjerë në vetëkënaqësi e rehati e do të dalë

në orën dhjetë të ditës për të punuar, sepse do të mendojë që ujitjen «ma bën elektriku dhe ditën e punës e marr 14 lekë». Dhe ç'ndodh? Edhe atje ku duhet bërë prashitja katër herë, bëhet vetëm dy herë dhe thuhet që është prashitur mirë!

Puna në bujqësi nuk është e lehtë, prandaj e kemi thënë vazhdimisht që të tërë mekanizmat duhet të jenë gati për punë në çdo kohë. Kjo është e domosdoshme për të lehtësuar punën e kooperativistëve, sidomos të grave. Mirëpo ka kooperativa dhe organizata-bazë partie që nuk e vrasin mendjen për këtë gjë. Por Partia porosit vazhdimisht për mbajtjen në gatishmëri të mekanizmave edhe për arsye sepse ato ndikojnë në rritjen e prodhimit. Detyra të mëdha kanë këtu edhe uzinat mekanike, por edhe bazat mekanike të SMT-ve, që edhe të kryejnë në kohë dhe me cilësi riparimet e mekanizmave ekzistues, edhe të prodhojnë vegla bujqësore e mekanizma të rinj.

Atëherë, në përfundim, unë ju këshilloj që të bëni të gjitha përpjekjet që planin e pambukut ta realizoni. Të mbani parasysh vështirësitë e shumta që i janë krijuar shtetit tonë në këto situata kaq të turbullta që ekzistojnë në botë dhe pasojat e rënda të tërmetit që na ngjau. Jemi në vitet e fundit të planit të gjashtë pesëvjeçar dhe deficite kemi. Rrethimin imperialisto-revizionist ta kuptoni si një rrethim konkret, real. Armiqtë mund të na buzëqeshin, por ata duan të na dëmtojnë. Ne u ofrojmë atyre mallra për t'u shitur, po na blejnë gjysmën, duke na mbajtur me premtime. Disa, si për hatër, duke na u hequr si miq, marrin

diçka nga ne, por me zor. Kur ne kërkojmë të blejmë prej tyre, ata nuk na shesin aq sa duam, por na japin shumë pak. Ata veprojnë kështu se janë armiq dhe është pikërisht armiqësia ndaj nesh që i shtyn të përdorin të gjitha mjetet kundër vendit tonë.

Ne nuk mund të praktikojmë kurrë autarkinë në ekonomi, prandaj na duhet të bëjmë tregti edhe me shtetet kapitaliste e revizioniste. Veçse, që të shesim, më parë duhet të prodhojmë. Shumë kuadro drejtues të ndërmarrjeve tona qahen se nuk kanë materiale importi për të realizuar planin, por kjo ndodh edhe për arsye se shumë të tjerë nuk kanë realizuar planet e eksportit. Po t'i kishin realizuar, do të kishim më shumë mallra për të shitur dhe do të krijoheshin mundësitë të blinin materialet e kërkuara nga importi.

Të gjitha këto rrethana, shokë, duhet t'i mendoni. Kryerja e detyrave në afatet e caktuara ka një objektiv të madh ekonomik, por edhe politik. Me ekonominë lidhen liria, pavarësia dhe sovraniteti i atdheut. Që të na shkojnë mirë punët në fushën e ekonomisë, problemet duhet të kuptohen politikisht dhe ideologjikisht. Afatet, ciklet, mbjellja në kohë, përdorimi racional i mekanikës etj., etj., të gjitha këto ndikojnë për të prodhuar sa më mirë dhe sa më lirë.

Të gjitha pjesët e ndërrimit të traktorëve, të makinave ose të automjeteve të tjera të mos kthehen në magazina për t'u zëvendësuar me të reja, kur ato mund të rikuperohen. Ka njerëz që mendojnë me naivitet se, meqë kemi gjithë këto uzina, mund t'i zëvendësojmë mjetet e vjetra të punës me të reja. Por ata nuk gjy-

kojnë sa çelik kërkon një mjet i ri, sa punë të gjallë, sa para duhen nxjerrë nga arka e shtetit. Kur nuk kontrollohet puna për misrin, për pambukun e të gjitha prodhimet e tjera bujqësore, kur paguhet e njëjta punë dy herë dhe shteti detyrohet të falë për disa vjet me radhë të tëra kreditë që u ka dhënë disa kooperativave, sepse atje nuk punohet si duhet, atëherë doemos do të ketë më shumë para në qarkullim, të cilat nuk do të mbulohen me mallra. Në këtë rast njerëzit do të mbledhin buzët dhe fajin nuk do t'ia hedhin vetes, por Partisë. Po kush është Partia? Janë ata që punojnë e që prodhojnë, ata që mendojnë për hallet e popullit. Komunistët, kudo që punojnë, të mos mendojnë e të mos shikojnë vetëm punën e tyre, por të jenë të preokupuar për problemet e mëdha të vendit, të jenë të mprehtë dhe të gjitha këto dukuri t'i shikojnë të lidhura me njëra-tjetrën. Prandaj të kërkojnë kryerjen e detyrës me disiplinë e me ndërgjegje të lartë jo vetëm nga vetja, por nga të gjithë. Ata duhet të shquhen për punën me njerëzit, për forcimin e ndërgjegjes e të qëndrimit socialist ndaj punës, duke bërë shpjegime të qarta, argumentime të sakta, që secili, kur neglizhon, të mos ketë nga të lëvizë dhe të mos guxojë të imponohet për diçka që nuk ka të drejtë. Askujt që kërkon t'i bëjë bisht një vendimi të drejtë, nuk duhet t'i bëhen lëshime. Në qoftë se i bëjmë lëshime njëri-tjetrit, atëherë diktatura e proletariatit vjen duke u dobësuar.

Të gjitha këto çështje, në tërësinë e tyre, formojnë punën e madhe të përbashkët e të shumanshme

të Partisë në çdo sektor, për çdo grup njerëzish në fabrika, në ndërmarrje, në kombinat, në kooperativa. Natyrisht, të gjitha detyrat nuk mund të realizohen me një të rënë të shkopit, por me punë sistematike, me lodhje, me sakrifica. Mundimet dhe sakrificat e popullit, natyrisht, duhet t'i shikojmë të ecin drejt uljes. Për këtë qëllim kërkohet që puna e punëtorëve dhe e kooperativistëve çdo vit të bëhet më e lehtë, që mësimet e Partisë të jenë më efektive. Kjo ka rëndësi të madhe. Efektiviteti në punë sjell çdo gjë të mirë e të dobishme. Me llafe nuk bëhet asgjë.

Ju rekomandojmë, shokë, t'i vini rëndësi të madhe pambukut, meqenëse e kemi problem. Por as bimëve të tjera të mos u ndahemi, se të tëra janë jetike për vendin. Me kaq i japim fund kësaj çështjeje.

Ditën e mirë! Punë të mbarë! Të fala shokëve andej!

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verball i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjëndet në AQP*

VEPRAT QË I KANË THIEMELET NË TABANIN E POPULLIT NUK SHLYHEN KURRE

*Nga biseda në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSII¹*

27 prill 1979

SHOKU ENVER HOXHA: Çfarë do të na thonit për këtë problem që ju keni thirrur?

SHOQJA VALDETE SALA²: Dëshiroj të them diçka për këtë problem. Sipas porosive të Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë dhe të fjalës suaj, shoku Enver, të dhjetorit 1974, si dhe në bazë të detyrave që na ka dhënë Kongresi i 7-të i Partisë për shfrytëzimin e arteve nga rinia dhe për aktivizimin e saj në fushën e krijimtarisë, Komiteti Qendror i BRPSH e ka ndjekur këtë problem.

Vitet e fundit e kemi bashkërenduar edhe më mirë aktivitetin e rinisë me shokët e Lidhjes së Shkrimtarëve

1. Në këtë mbledhje, ku merrnin pjesë edhe disa të ftuar, u diskutua edhe për shfrytëzimin e letërsisë e të arteve nga rinia dhe për krijimtarinë e saj në këtë fushë.

2. Në atë kohë sekretare e Komitetit Qendror të BRPSH.

dhe të Artistëve. Lëvizja e madhe amatore i ka dhënë gjallëri organizatës së BRPSH. Ju, shoku Enver, na keni porositur që, krahas grupeve amatore, të zhvillohet shumë edhe teatri amator në rini. Ne jemi përpjekur ta zbatojmë këtë porosi dhe mund të themi se ky art ka marrë një zhvillim të mirë.

Edhe në fushën e krijimtarisë ka suksese. Ne përqemi ta ushqejmë e ta stimulojmë tërë krijimtarinë e talenteve të reja. Vitet e fundit po mundohemi ta bëjmë si traditë që krijimtaria e talenteve të reja në fushën e letërsisë apo të arteve figurative të diskutohet në organizatën-bazë të rinisë.

Edhe muzika popullore, edhe folklori janë bërë të dashur për rininë. Ne kemi vënë detyrë që jo vetëm ta përvetësojmë e ta shfrytëzojmë folklorin tonë, por edhe ta pasurojmë e ta ruajmë gjithnjë të pastër.

Megjithatë mundësitë që i ka krijuar Partia rinisë janë më të mëdha sesa realizojmë ne në të vërtetë, qoftë në leximin e librit, qoftë në shfrytëzimin e arteve figurative, të filmit etj., prandaj luftojmë në këtë drejtim për rezultate akoma më të mira.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti je fizikan, por njeh edhe letërsinë dhe artet. Kjo tregon se nuk e kemi keq që ngarkojmë me detyra shoqërore edhe specialistë të shkencave të natyrës. Nga mosha ti je e re, po me rininë je e vjetër, se më kanë thënë që ke punuar prej kohësh me këtë organizatë. Dëgjova mbrëmë në televizor një fizikan që fliste për Ajnshtajnin, i cili m'u duk shumë i zoti si specialist, se fliste rrjedhshëm, me kompetencë dhe me lehtësi për teorinë e këtij

shkencëtari të madh, që është një teori shumë e thellë dhe e komplikuar.

SHOKU RAMIZ ALIA: Ishte Petrit Skënde, ai është fizikan shumë i mirë. Ka studiuar edhe filozofinë, sidomos për të aplikuar materializmin dialektik në shkencat fiziko-matematike.

SHOKU ENVER HOXHA: Aq më mirë që ka studiuar edhe filozofinë marksiste-leniniste, se ajo e ndihmon shumë në interpretimin e saktë të konkluzioneve që dalin nga studimet në fushën e shkencave të natyrës.

Neve na vjen mirë që shokët e Kinostudios dhe të Radiotelevizionit nxjerrin herë pas here në ekran njerëzit e shquar të popullit tonë, artistët dhe ndërtuesit e mëdhenj që kanë punuar në Dalmaci, në Turqi e gjetkë. Pavarësisht se ata kanë bërë manastire, kisha e xhami, sepse ashtu e kërkonte koha, në punën e tyre këta shqiptarë kanë qenë mjeshtër shumë të talentuar. Veprat e tyre dallohen më tepër nga arti, se nga përmbajtja fetare. Kur e shikon bukurinë e kupolës dhe të minareve të Xhamisë Blu, nuk të hyn fare në sy hoxha që thërret atje. Kur sheh xhamitë e arkitekt Sinanit, ndien krenari për njerëzit e shquar e të mëdhenj të kombit tonë. Unë i kam parë ato xhami, por vetëm së largu, nga vaporit. Monumente kulture ka edhe në vendin tonë. Kemi biseduar edhe me shokët që këto vepra arti e monumente që kemi, duhet t'i ruajmë me kujdes të madh, t'i njohim, t'i vlerësojmë e t'i klasifikojmë. Në mes tyre ka edhe kisha, por disa janë, si të thuash, xhevahire të artit, si ajo e Labovës

së Kryqit¹, që është e kohës bizantine, pra që u përket shcekujve të kaluar, siç janë kishat dhe manastiret e malit të Athosit në Greqi, që janë aq të bukura. Thuhet se ndërtuesi i një kisha të vjetër e të bukur, që ekziston edhe sot në Stamboll, ka qenë shqiptar. Jash-tëzakonisht e bukur është edhe kisha e Mesopotamit afër Finiqit². Me vlerë është edhe manastiri i Voskopojës, ku bien në sy sidomos arkadat. Prandaj, duhet t'i ruajmë dhe t'i vlerësojmë këto objekte të kulturës sonë të lashtë.

Shteti ynë është laik dhe si i tillë e lufton fenë, ju e dini këtë, prandaj ka të ngjarë që ka të shkuar në moshë, të cilët akoma ngurrojnë t'i dorëzojnë ikonat. Mund të ketë akoma pleq e plaka që i mbajnë të fshehura në sepete objekte të tilla, pa ditur se ato janë me vlerë të madhe artistike.

Në Greqi, ku ka pasur një zhvillim të madh ikonografia, si dhe në Turqi e gjetkë, kanë jetuar mjaft shqiptarë të mërguar. Në Stamboll kanë jetuar shqiptarë, që kanë qenë pasanikë të mëdhenj, si Zhapët për shembull, të cilët pasurinë e tyre ua kanë lënë me testament fshatarëve tanë, por turqit nuk duan të na i kthejnë ato pasuri që arrijnë në shuma të mëdha.

Shqiptarët e mërguar, sidomos ata që ishin pasanikë dhe njerëz me gusto për krijimet e artit botëror,

1. Fshat në rrethin e Gjirokastrës.

2. Fshat në rrethin e Sarandës, ku ndodhen rrënojat e qytetit antik Foinike.

mecenë¹, që u thonë, siç ishte Piero di Kozimo², i cili mbronte Xhioton e Mikelanxhelon, ata patjetër kanë blerë ikona nga piktorët e vjetër bizantinë dhe ua kanë dërguar miqve të tyre këtu, të cilët, si besimtarë që kanë qenë, i kanë ruajtur ato. Disa prej tyre i kemi mbledhur, por ka të tjera që janë të fshehura. Disa keqbërës kanë dashur të na i vjedhin. I përmenda të tëra këto, se duhet të dimë të punojmë me gjyshet që edhe atyre t'u hiqet frika dhe të na i japin ikonat, në qoftë se kanë. Kështu do të pasurohet një çikë më mirë edhe muzeu në Korçë.

Natyrisht, rinisë t'ia tregojmë ikonat për vlerën e tyre artistike, për shkollën, ngjyrat dhe të tjera aspekte që ju i dini më mirë nga unë, por jo për ideologjinë fetare, jo për t'i puthur dhe për të bërë kryqin para tyre.

Shoku Enver ngrihet nga vendi i tij i zakonshëm, ku drejton mbledhjen, dhe zë një karrige përballë diskutantëve.

Unë erdha këtu, pranë jush, që t'ju shoh e t'ju njoh më mirë për së afërmi, t'ju shoh fytyrat tuaja të gëzuara.

Diskutimet duhet të jenë të lira dhe jodogmatike. Në disa vise të Shqipërisë qëndisin bukur, se e kanë traditë të zbukurojnë këmishët ose veshje të tjera.

1. Mbrojtës i letërsisë, i arteve dhe i shkencës. (Nga Mecena këshilltar i Augustit.)

2. Piktor italian i shkollës së Firencës (1462-1521).

Asaj që e ka bërë zakon qëndisjen, nuk i rrinë duart pa bërë një shqiponjë e diçka tjetër të bukur. Kur mbledhen njerëzit tanë, nuk rrinë pa ia thënë një kënge shtruar ose pa marrë një valle.

Sipas mendimit tim, në mbledhjet e rinisë, pasi të diskutohet, është mirë të dilet me konkluzione dhe të rishikohet herë pas here zhvillimi që merr arti i qëndisjes etj. Qëndisimat tona janë të bukura, por duhet të diskutohet edhe se ç'mund të bëhet për t'u dhënë një hov akoma më të madh përpara. Me këtë nuk e kam fjalën që gratë dhe vajzat të mbeten me gjilpërë në dorë, sepse ato sot kanë shumë detyra shtetërore dhe shoqërore, kanë tërë këtë pasuri të arritjeve të kulturës, të artit e të shkencës, që është mirë ta njohin e të zgjerojnë horizontin e dijeve, por e kam fjalën që tradita e qëndisjes, si çdo traditë tjetër e mirë, të ruhet e të zhvillohet më tej.

SHOKU MOIKOM ZEQO¹: Të flas unë tani?

SHOKU ENVER HOXHA: Ti je sekretar i komitetit të rinisë në Durrës, që shkruan poezi?

SHOKU JAKUP MATO: Por merret edhe me arkeologji, se e ka me pasion.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë ti, Moikom, je diletant i arkeologjisë. Shumë mirë. Komisariatit të Naftës i intereson shumë arkeologjia².

1. Në atë kohë, sekretar i Komitetit të Rinisë të Rrethit të Durrësit.

2. Burimet e autorëve antikë tregojnë se në lindje të Apo-

SHOKU MOIKOM ZEÇO: Me shokët e naftës mbaj lidhje të rregullta, jam përpjekur të jap edhe ndonjë mendim për arkeologjinë.

SHOKU ENVER HOXHA: T'u japësh mendime, pse të mos u japësh? Është tjetër punë sa do t'i marrin parasysh ata, por ne kemi nevojë edhe për mendimet e tua, si të kujtdo tjetër. Ju jeni të rinj dhe Partia punon për të ardhmen tuaj.

Ne themi se rinia do të marrë stafetën, por kjo nuk është diçka që dorëzohet në një ditë. Në të vërtetë ju stafetën po e merrni në duar ditë për ditë dhe këtë duhet ta mbani. Ne, të moshuarit, do të jemi kurdoherë përkrah jush, do të punojmë kurdoherë së bashku. Detyra juaj është që të punoni për t'i forcuar akoma më shumë atdheun e Partinë dhe mundësitë e keni. Ju zotëroni dituri dhe shkencë. Tok me shkencën ju njihni edhe praktikën e ndërtimit të socializmit. Ne, të moshuarit, nuk e kemi mësuar shkencën me themel, kështu si ju, por e kemi njohur me plot boshllëqe, se kështu ishin kohët e rinisë sonë para Çlirimit. Por ne jemi mësuar e rrahur me praktikën e ndërtimit të socializmit, që nuk është një

Ilonisë ka ekzistuar Nimfeu, me një flakë të përhershme; kjo dhe të dhëna të tjera arkeologjike, si relieve e monedha, u kanë shërbyer naftëtarëve si shenja për të kërkuar pasuritë e mëdha naftëmbajtëse e gazmbajtëse të zonës. Edhe kërkimet intensive sipërfaqësore të gjeologëve kanë ndihmuar në sinjalizimin e objekteve arkeologjike të trevës ku shtrihej fisi ilir i Bylinëve (sot krahina e Mallakastrës).

praktikë empirike. Ndërtimi i socializmit bazohet në shkencë, në radhë të parë në shkencën e marksizëm-leninizmit. Në praktikën e ndërtimit socialist, natyrisht, ne mësojmë edhe shkencën, ndihmohemi edhe nga njerëzit e shkencës, prandaj çdo gjë që del nga dora e Partisë, është e bazuar shkencërisht.

Aktualisht, shkencëtarët tanë të rinj nuk duhet të mendojnë që shkencën ta kenë monopol të tyre, por t'ia «shesin» atë masave. Mendimet tuaja të drejta t'i mbronni pa druajtje, pa hezitim. Diskutoni, zhvilloni debatin, se më të shumtat e herës ju do të keni të drejtë. Këto nuk jua them për t'ju bërë qejfin, se unë jam kundër lajkave dhe lajkatarëve.

Në art, në letërsi e në të gjitha fushat e dijes duhet ta nxitim dhe ta inkurajojmë brezin e ri, por inkurajim nuk do të thotë fërkim i krahëve para kohe. Nuk dua të përmend emra, por ne kemi edhe ndonjë konstatim të hidhur që ndonjë të riu, i cili akoma nuk ka dalë mirë nga «veza», kur bën ndonjë «vjershë» apo «përrallë», i bëhet një recension i fryrë me aq shumë elozhe, sa vlerësimi me shkrim është tri herë më i madh se «përralla» e botuar, që nuk vlen ose vlen pak. Këto mburrje të tepruara prishin punë, në vend që të ndreqin. Duke vepruar kështu, ne i prishim kuadrot. Por unë kam respekt për ata njerëz, qofshin këta edhe të rinj, që kanë me të vërtetë vullnet e logjikë të fortë, kanë dije të shëndosha. Pavarësisht se ti je 30 vjeç, vjershat e tua i lexoj me dëshirë se kanë mendime, brumë dhe ide me vlerë.

Unë sot po të shikoj për herë të parë, se ti je i ri, por, duke lexuar ato që shkruan, tek ti dalloj një të ri me eksperiencë në jetë.

E kisha fjalën te kuraja për të dhënë mendime, prandaj fola për talentet e reja. Mos mendoni se harrova ku e kisha fjalën. Vërtet jam pak i moshuar, por nuk i harroj mendimet që dua të shpreh dhe mund t'i lidh ato kurdoherë. Mendimet t'i thoni kudo që të jeni dhe të diskutoni. Në qoftë se nuk keni të drejtë, pranoni dhe tërhiquni, por, në qoftë se keni të drejtë, ngulni këmbë që t'ju jepet e drejta.

Vazhdo, më fal se të preva fjalën, por ja që bëjmë shumë pyetje se duam t'i marrim vesh të gjitha.

SHOKU PILO PERISTERI: Tahmaqarllëku për të ditur gjithçka.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është, o Pilo, po s'ke ç'i bën, njeriu duhet të mësojë gjithë jetën.

SHOKU RAMIZ ALIA: Ju, shoku Enver, jeni konsekuent në idenë që thatë kundër dogmatizmit, pra edhe kjo mbledhje e Sekretariatit është krejt e lirë, në formë bisede, kështu mendimet dhe bisedimet shkojnë drejt e në zemër dhe në mendje të njerëzve.

SHOKU XHELIL GJONI: Para se të hynim në mbledhjen e Sekretariatit ishim në tension, por ja tani nga kjo bisedë që u bë këtu në këtë mënyrë e harruam fare emocionin.

SHOKU ENVER HOXHA: Mbase kështu duhen zhvilluar mbledhjet. Në qoftë se kam ndonjë të metë, që jua pres fjalën, ma thoni.

SHOKU RAMIZ ALIA: Edhe rinia kështu duhet t'i zhvillojë mbledhjet.

SHOKU MOIKOM ZEÇO: T'ju them të drejtën, shoku Enver, mbrëmë nuk më zinte gjumi.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk të zinte gjumi, se mendoje që nesër do të vete në Sekretariat, ç'do të them unë atje? Si do të më dëgjojnë shokët Hysni, Ramiz, Enver dhe gjithë shokët e tjerë?

SHOQJA LUMTURI REXHA¹: Kjo vjen dhe nga dëshira për t'u takuar me shokët e Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne nuk i gjykojmë njerëzit vetëm nga fjalët që thonë nëpër mbledhje, por i çmojmë në tërësi, duke parë gjithë veprën e tyre, gjithë punën e tyre, të shkuarën, të tashmen dhe perspektivën e tyre. Ju që jeni të penës, mundet të gjeni plot gabime në frazat tona, por në biseda të lira nuk i shikojmë shumë frazat.

SHOKU DRITËRO AGOLLI: Po edhe ne të penës plot ujëra kemi në shkrimet tona.

SHOKU ENVER HOXHA: Ua kam thënë edhe shokëve këtë që po ju tregoj. Vajta njëherë në Gjiro-kastër për festën e Pavarësisë Kombëtare dhe mbajta një fjalim në darkë. Atje ishte i pranishëm edhe mësuesi im i vjetër dhe patriot, Thoma Papapanoja. Pasi mbajta fjalimin, e pashë Thomanë, për të cilin vazhdimisht kam pasur shumë respekt, dhe iu afrova. «Si

1. Në atë kohë sekretare e parë e Komitetit Qendror të ERPSII.

të kam, more basho Thoma?» e pyeta dhe i hodha dorën në qafë. «E, — vazhdova unë, — si fola? Më thuaj të drejtën si mësuesi nxënësit».

«Sa për mendimet nuk kam çfarë të të them, — m'u përgjigj Thomai, — ato ishin të tëra të mira, kurse për gramatikën po të vë notën shtatë». Që ta zbuste një çikë qëndrimin e tij, shtoi: «E po kuptohet, se fole pa kartë». «Pa kartë, — i thashë unë, — por ngatërrova rasën emërore me rasën dhanore dhe në vend që të them ne, thashë neve».

Po t'u futemi, sidomos tani, rregullave të drejtshkrimit, duhet të themi se në këtë fushë bëjmë shumë gabime. Zotërimi i drejtshkrimit, i gjuhës dhe i shenjave të pikësimit, ka mjaft rëndësi. Disa shkrimtarë, ndër ta edhe Aragoni, për të qenë origjinalë e jo «konformistë» me gramatikën, në një kohë i zhdukën edhe shenjat e pikësimit nga shkrimet e tyre.

SHOKU DRITËRO AGOLLI: Po, po, sidomos në vjersha i zhdukën të gjitha shenjat e pikësimit.

SHOKU ENVER HOXHA: Një shkrimtar francez e shkroi një përrallë pa asnjë shenjë pikësimi dhe në fund e ftonte lexuesin që presjet e pikat t'i vinte vetë.

Më fal që të ndërpreva, na thuaj ndonjë gjë tashti.

SHOKU MOIKOM ZEÇO: Duke qenë vetë krijues, si dhe duke u marrë me organizatën e rinisë, ne e ndiejmë shumë thellë avantazhin e madh që na ka dhënë gjithë ky realitet, ndiejmë horizontin e madh që na hapi Partia, në mënyrë të veçantë Plenumi i 4-t i Komitetit Qendror të Partisë dhe fjala juaj, shoku

Enver, e 20 dhjetorit 1974. Në këtë kuptim talentet e reja kanë sot një avantazh mjaft të madh.

SHOKU ENVER HOXHA: Faik Konica e mononte trashëgiminë letrare shqipe.

SHOKU MOIKOM ZEQQ: Po, ai ka qenë poeti i tatave e tototove. Ai flet për Naimin dhe e godet atë, godet dhe Luigj Gurakuqin.

SHOKU ENVER HOXHA: Më erdhi një libër nga Nju-Jorku, që e kishte botuar shoqëria «Vatra», me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Faik Konicës. Për këtë libër ka shkruar një artikull njëfarë Namik Resuli, një maskara, që disa njerëz e mbajnë si «studiues të madh» të gjuhës sonë. Namik Resuli është djalë i një beu ose gjysmëpashai nga Fieri. Ky kishte mbajtur fjalimin kryesor me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Faik Konicës «Të vjen të qash për ata njerëz që e konsiderojnë Faik Konicën arrogant», shkruan ai. Dhe vazhdon: «Po pse ky njeri kaq i madh, kaq i lavdishëm, duhet të merrej me gjëra të vogla? E akuzojnë Faik Konicën se mori para nga një udhëheqës i Shqipërisë (nuk thonë nga Zogu), por ata harrojnë se ky i mori ato para për të mbrojtur Shqipërinë. Thonë për Faikun se shante rilindësit...» etj., etj.

Më kuptoni, nuk shtoj gjë nga ana ime. Kështu, në një formë të tillë kaq të rëndomtë e të trashë, shkruan ai tradhtar për Faik Konicën dhe pastaj në atë libër mburrte fuqitë e mëdha. «Faiku ishte njeriu që simpatizonte Austrinë, shkruan ai, por këtë e bënte sepse tek Austria shihte atë shtet që do ta bënte Shqipërinë të lirë dhe të pavarur! Kishte të drejtë Fai-

ku ta mbronte katolicizmin, — thekson më poshtë Namik Resuli, — sepse kishte mësuar në kolegjin e jezuitëve dhe se katolicizmi është shpirti i patriotizmit shqiptar!». Ç'kritik i madh ky djali i beut!

Mirë, vazhdo ti, Moikom.

SHOKU MOIKOM ZEQO: Desha të them se edhe Jeronim De Rada, Naimi e Migjeni kanë qenë talente të reja, por atyre u ka munguar ky avantazh i madh, ky horizont i madh që kemi ne, të cilin na e ka hapur Partia. Kjo na bën ne, shoku Enver, edhe më përgjegjës përpara Partisë.

Në organizatën e rinisë po forcohen edhe më shumë konceptet që me talentet e reja duhet me u marrë, sepse këto janë një pasuri e popullit dhe e organizatës së rinisë nën udhëheqjen e Partisë. Kaq e vërtetë është kjo sa një pjesë e talentëve të reja janë edhe aktivistë shoqërorë.

Çështja e dytë që desha të theksoj është se puna e madhe që ka bërë Partia për njohjen e traditave të mëdha të popullit tonë ka rritur ndjenjën e krenarisë kombëtare. Rinia e kupton që figurat e mëdha që ka nxjerrë populli ynë janë një pasuri e çmuar që duhen njohur prej saj. Në këtë drejtim mendoj se ndoshta duhet të ketë më shumë botime figurative dhe popullore, përveç botimeve shkencore.

SHOKU ENVER HOXHA: Në drejtim të kësaj që the ti, a nuk do të ishte mirë që të mendohet për të bërë një enciklopedi për këta njerëz të mëdhenj të vendit tonë?

SHOKU MOIKOM ZEQO: Po, shoku Enver, do të

ishte shumë mirë të bëhet një enciklopedi e kulturës dhe për këtë janë të gjitha forcat e mjetet.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, për ta janë shkruar dhe do të shkruhen akoma monografi. Studiuesit tanë do ta thellojnë këtë çështje. Unë do të doja të shihja në enciklopedi Andrea Aleks Durrsakun¹, për shembull, që ka bërë katedralen e Trogirit në Split, e shumë nga njerëzit tanë të tjerë të mëdhenj; do të doja të shihja edhe Samiun dhe të mësoja nga enciklopedia se cili ishte Namik Qemali², fjala vjen. E di ti, Moikom, cili ishte Namik Qemali? Ai ishte një nga romantikët më të mëdhenj të Turqisë, të shekullit të 19-të, një shkrimtar i dëgjuar me origjinë shqiptare. Poemat e tij, të shkruara në gjuhën turke, i kam lexuar të përkthyer në frëngjisht. Në to, sido që shkruan për fshatin turk, ai ruan nostalgjinë për fshatin tonë, ruan ndjenjën e hollë artistike të popullit të tij.

Pra, nuk do të jetë mirë që në këtë enciklopedi t'i kemi të pasqyruara këto figura të shquara?

SHOKU DRITËRO AGOLLI: Është shumë e domosdoshme. Është ngritur njëherë kjo çështje, shoku Enver, por është lënë pas dore se duan të bëjnë një enciklopedi të madhe.

SHOKU ENVER HOXHA: Që të bësh enciklopedi-

1. Arkitekt dhe skulptor i njohur i shekullit të 15-të (1425-1506), me origjinë shqiptare nga Durrësi. Ka bërë shumë vepra të çmuara në Split, Raguzë, Arbe, Ankonë, Paris, Londër etj.

2. Shkrimtar, publicist dhe personalitet politik turk, përfaqësues i shquar i lëvizjes së «osmanllinjve të rinj»!

dinë e madhe duhen shumë dhjetëvjeçarë. Unë di kohën që është dashur për të përgatitur e për të botuar enciklopedinë franceze. Tani, me zgjerimin e dijeve, ata po bëjnë enciklopedi të veçanta për fushat e ndryshme të dijeve, për shembull, enciklopedinë e mjekësisë, enciklopedinë e poetëve të Rilindjes, të poetëve të vjetër, një enciklopedi për bujqësinë, një tjetër për artet, për shkencën, për arkitekturën etj. Bëhen më parë enciklopedi të veçanta që plotësojnë dora-dorës me kohë të madhen. Ashtu si pasurohet gjuha, duke dalë fjalë të reja, kështu bëhen kërkime dhe plotësimet në enciklopedi.

Po për arkeologjinë mund të na thuash ndonjë fjalë, se në ç'drejtim duhet të ecë më shumë, natyrisht për aq sa mendon ti.

SHOKU MOIKOM ZEKO: Para Çlirimit arkeologjia konsiderohej një fushë e bardhë. Kjo është një nga shkencat që ne tani po e ndiejmë se sa na ndihmon për të pasur një ide më të qartë për historinë e popullit tonë, duke përfshirë këtu aspektin e theksuar politik. Për shembull, Ugolini¹ ishte arkeolog, por me anë të mitit të Eneut dhe me anë të arkeologjisë, duke bërë edhe falsifikime shkencore, nëpërmjet atij miti «programatik» donte të justifikonte pushtimin e Shqipërisë.

1. L. M. Ugolini (1895-1937), shef i misionit arkeologjik italian. Në vitet 1928-1937 bëri kërkime në Finiq e në Butrint, zhvilloi një aktivitet të gjerë në shërbim të qeverisë fashiste italiane për përgatitjen ideologjike të pushtimit të Shqipërisë. Vodhi e dërgoi në Itali objekte me vlera të mëdha arkeologjike e artistike të gjetura në vendin tonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sipas poemës së Virgjilist «Eneida», kur vajti Eneu në Itali, e pritën në buzë të detit dhe e pyetën: «Cila është perëndia jote?». «Ja, të dy duart janë perëndia ime», iu përgjigj Eneu.

SHOKU MOIKOM ZEÇO: Arkologjia vitet e fundit ka bërë një punë shumë të gjerë dhe ka plotësuar një boshllëk të madh. Tani kemi një konceptim më të plotë për ilirët dhe është avancuar problemi në një formë më të ngritur edhe për banorët që kanë ekzistuar para ilirëve.

SHOKU ENVER HOXHA: Mund të na thuash ndonjë gjë për banorët para ilirëve, për pellazgët, për shembull?

SHOKU MOIKOM ZEÇO: Problemi i pellazgëve do të ketë një ngritje të re, natyrisht do të ketë dokumente më të studiuara, më shkencore.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë ti qenke partizan i pikëpamjeve të Kondës, të cilin unë e kam pasur mik.

SHOKU MOIKOM ZEÇO: Në Shqipëri janë ruajtur disa elemente që janë të thelbit, të djepit të kulturës mesdhetare. Këto tregojnë që çështja e pellazgëve nuk është një çështje fantazie. Parailirët, ata që quhen protoilirët, patjetër lidhen me një gjë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po për fiset e dorëve që sulmuan grekët e kontinentit, ka ndonjë të dhënë të re?

SHOKU MOIKOM ZEÇO: Si në rrugën mitologjike, ashtu dhe në legjendat që na kanë lënë, shikohet

lidhja e dorëve me ilirët. Ata në kulturën e tyre kanë pasur më tepër elemente ilire.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, se ata këndeji, nga veriu i Greqisë kanë ardhur. Kështu thonë sidomos historianët gjermanë, që mbrojnë tezën se dorët kanë ardhur nga veriu i Greqisë. Mos kanë lidhje këta me pellazgët?

SHOKU MOIKOM ZEÇO: Teza e ardhjes nga Veriu, më tepër është tezë e shkollës gjermane, shoku Enver. Pellazgët ka të ngjarë të kenë qenë banorë të pjesës këtu dhe ndoshta jo të ardhur nga Veriu.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, unë flas për këtej nga Ballkani, për nga veriu i Greqisë dhe jo nga Skandinavia. Nuk e kam fjalën për vikingët. Thonë se Dodona¹ ka qenë një tempull që ka ekzistuar para grekëve dhe bile para dorëve. Flas me aq sa di, se mund ta kem edhe gabim. Dodona mbeti si një monument i vjetër pellazgjik. Tashti, po të lidhim Dodonën me fisin e molosëve², duhet ta lidhim edhe me Epirin, domethënë me kohën para Pirros. Është një gjë e komplikuar kjo!

1. Qytet e qendër e lashtë fetare në Epir. Rrënojat e saj ndodhen 18 km në jugperëndim të Janinës, pranë malit të lartë Tomaros. Tradicioni antik njëzëri e konsideron Dodonën si qendër të lashtë fetare të pellazgëve, popullsi që banonte në këto anë para grekëve.

2. Një nga fiset kryesore ilire të Epirit. Aty nga fundi i shekullit të 5-të krijuan mbretërinë e njohur me emrin Lidhja Molose. Dodona ndodhej në tokat e tyre dhe ishte vendi ku sundimtarët molosë bënë betimin para popullit ditën që vinin në fuqi.

Ç'është Mikena¹? Ka që thonë se është kulturë greke, ka që thonë se ajo është zhvilluar para grekëve, pra është një kulturë shumë e lashtë. Vazhdo.

SHOKU MOIKOM ZEQQO: Desha të them nja dy fjalë për talentet e reja. Ato ndihmohen dhe kjo është një çështje e të gjithë shoqërisë, por unë kisha mendimin që ndoshta duhet dhënë njëfarë ndihme më e kualifikuar sidomos për poemën, e cila nuk po ecën edhe aq mirë. Vetë lufta e Partisë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit kundër imperializmit dhe revizionizmit është një kulturë që na ndihmon shumë. Kjo do të bëjë që të ketë një ngritje cilësore krijimtaria, që t'u përgjigjet më mirë kërkesave të kohës.

SHOQJA VITO KAPO²: Dëshiroj të pyes si mendojnë këta, shokët e krijimtarisë, lidhur me një fenomen të tillë: Në shkollat 8-vjeçare dhe të mesme vajzat kanë dëshirë dhe punojnë në fushën e krijimtarisë, pastaj largohen. Pse ndodh kështu?

SHOKU MOIKOM ZEQQO: E vërteta është se ekzistojnë akoma konceptet që e pengojnë vajzën të shkruajë.

SHOKU DRITËRO AGOLLI: Kjo është e lidhur me emancipimin e përgjithshëm të gruas. Te vajzat vjen një kohë që fillojnë preokupimet familjare e të

1. Qytet i lashtë në Peloponez, kryeqendër e Argolidës dhe e qytetërimit të quajtur kreto-mikenas.

2. Në atë kohë presidente e Bashkimit të Grave të Shqipërisë.

tjera, prandaj mendoj se pikërisht këtu duhet bërë një punë e madhe për ta emancipuar krejtësisht gruan.

SHOKU ENVER HOXHA: Kush do të diskutojë tjetër?

SHOKU DRITËRO AGOLLI: Dëshiroj të them ndonjë gjë si nga ana e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve. Siç dihet nga të gjithë, pjesën më të madhe të aksioneve dhe të aktiviteteve artistike i ka rinia. Pa talentet e reja nuk mund të bëhet asgjë në fushën e letërsisë dhe të arteve. Gjithë puna e Partisë, veçanërisht pas Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror, luajti një rol shumë të madh. Ne shikojmë se në botimet, në artet figurative e në muzikë ka një vërshim të talenteve të reja dhe një pjekuri më të madhe në krijimtarinë e tyre. Është me rëndësi edhe fenomeni që ndodh në shpërndarjen gjeografike të talenteve të reja, ku kemi një shpërndarje harmonike që të ngjall optimizëm. Një fenomen i tillë do të ishte interesant edhe për sociologët, sepse tregon pjekurinë e socializmit. Ne kemi arritur që edhe krijimtaria e të rinjve të ketë një bazë të shëndoshë kombëtare, një dashuri më të madhe ndaj traditës, ndaj kulturës dhe folklorit tonë, ndaj gjithë patriotizmit.

Sukseset e arteve tona jashtë shtetit, qoftë të letërsisë, qoftë dhe ato të ansambleve e të filmave tanë, e rritën krenarinë tonë kombëtare edhe te letrarët dhe te talentet e reja, të cilët thonë: «Dale more, se ne këtu nuk jemi pas botës, nuk jemi të tillë që të vështrojmë nga bota tjetër!». Vihet re edhe një fenomen tjetër: talentet e reja vijnë te ne në letërsi dhe në gjithë

artet shumë më të përgatitur nga ana kulturore dhe nga ana e nivelit artistik sesa vinin në kohën tonë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Mos ky zhvillim i talenteve të reja është i lidhur edhe me mësuesit, se, për shembull, ti dole nga Gjirokastra, edhe Ismail Kadareja po ashtu. Cilin kishit mësues letërsie ju në atë kohë?

SHOKU DRITËRO AGOLLI: Po, edhe mësuesit luajnë rol. Ne kishim atëherë mësues letërsie Vehbi Balën, kurse mësues të gjuhës kishim Thoma Papapanon. Letërsinë na e mësonin me një dashuri të veçantë, edhe bukurshkrimin, kur na e mësonte Thoma Papapanoja, na fliste me një dashuri, na fliste me poezi, prandaj është e vërtetë ajo që thoni ju, shoku Ramiz, se luan rol të madh mësuesi. Ai ngjall dashurinë për dije, sidomos për atë fushë të dijës ku është specialist.

Gjithë kjo veprimtari letrare-artistike nxjerr edhe disa probleme të rëndësishme. Një nga këto probleme është se duhet të rregullojmë raportin në mes llojeve dhe gjinive të arteve. Për shembull, shumica dërrmuese shkruajnë poezi, kemi pak krijime në prozë. Në pikturë po ecet mirë. Këtu ka luajtur rol të madh Instituti i Lartë i Arteve. Në muzikë, sidomos në kompozim, kemi shumë pak kompozitorë. Kam një mendim, ndoshta e kam gabim, por unë do t'ia them Sekretariatit të Komitetit Qendror: kur ne pranojmë në Institutin e Lartë të Arteve ata që paraqiten në konkurs, nuk duhet të jemi aq qibarë. Djali i një kompozitori, kur paraqitet në konkurs, mund të marrë notën 10, kurse ai që vjen nga Kukësi merr notën 7 apo 8 e mund të

mos pranohet, mirëpo i pari e merr 10-n, sepse ka pianon në shtëpi, ka babanë kompozitor, ka traditën, bibliotekën etj., kurse ai tjetri mund të jetë talent i vërtetë, po merr notë më të ulët, sepse nuk i ka pasur mundësitë e të parit. Ai vetëm kur ka pasur kohë ka vajtur në shtëpinë e kulturës dhe vetëm kur vegla ishte e lirë mund të praktikohet dhe me kaq pak ai arrin të marrë notën 7 apo 8. Kjo mendoj se duhet parë.

SHOKU ENVER HOXHA: Drejt, sigurisht duhet parë.

SHOKU DRITËRO AGOLLI: Mendoj se nga talentet e reja në përgjithësi ne kemi një krijimtari letrare dhe artistike shumë të shëndetshme në përmbajtjen e saj ideore, por në disa lloje të arteve, si në poezi e në këngë, ndonjëherë ka gjëra që nuk shkojnë. Ne në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve, në komisionet që kemi për krijimet e të rinjve, pak punojmë. Edhe kritika letrare dhe shtypi duhet të bëjnë më shumë në këtë drejtim.

Desha të them edhe diçka tjetër: ne vërtet kemi mjaft krijues të rinj e me talent, por më shumë duhet të punojmë për pranimet e reja në Parti nga radhët e tyre.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë, shumë mirë. E po ja, patëm një bisedë të lirë, nga e cila po dalim me njohuri pak më të thella. Me zhvillimin e madh të artit popullor, të këngëve e të valleve popullore, të përpjekjeve të lavdërueshme të të gjithë letrarëve dhe artistëve tanë, që kanë një gjykim shumë të drejtë për ndjenjat e njerëzve dhe për botëkupti-

min e shëndoshë të tyre, literatura, artet, muzika, kinematografia, teatri ynë etj., po bëhen çdo ditë ushqim i gjithë popullit. Duhet të jemi plotësisht të bindur, se ajo që bëri Partia për të mos lejuar të vërshonin në vendin tonë literatura, poezia dhe filma të huaj në atë mënyrë siç donin Fadil Paçrami, Todi Lubonja ose siç dëshiron Perëndimi, ka qenë e drejtë. Ne, duke vepruar kështu, nuk kemi bërë një punë sektare, por shpëtimtare. Për aq sa kemi mundur, pse dhe forcat tona përkthyesë nuk kanë qenë aq të mëdha, ne kemi përkthyer për lexuesit edhe vepra të klasikëve të letërsisë botërore. Megjithatë në mes tyre mund të bëhej një zgjedhje më e mirë. Natyrisht, ajo është një literaturë borgjeze, por në të ka disa gjëra që i ndihmojnë njerëzit tanë të shoqërisë së re socialiste për të kuptuar zhvillimin e botëkuptimit në shoqërinë borgjeze. Kështu njerëzit tanë shohin inferioritetin e kulturës borgjeze ndaj kulturës sonë socialiste. Nuk thoshte kot Marksi që «Balzakun e mbaj nën jastëk». Balzaku, megjithëqë ishte ruajalist, e demaskoi ashpër borgjezinë dhe e bëri atë shoshë, e zhveshi fare lakuriq. Në veprat e tij pasqyrohet lufta kundër borgjezisë, kundër kapitalizmit dhe kalbëzimit të kësaj borgjezie...

Të shkosh me mendjen e Namik Resulit, që përmenda pak përpara, i cili thoshte se «Faik Konica nuk mund t'i duronte pikëpamjet e Sami Frashërit, të Jani Vretos e të Naum Veqilharxhëve», është tradhti. Ai mbronte Konicën, duke u shprehur se kultura e Perëndimit ishte një kulturë më e përparuar. Ai, në mbrojtje të kësaj teze, citon Verlenin, që ishte një element

homoseksual. Në formë, Verleni poezitë i ka të bukura, por brenda poezive të tij ka ide të mbrapshta. Namik Resuli, gjithashtu, citon Rembonë, që ishte i dashuri i Verlenit, i cili në një kafe të errët të Brukselit qëlloi me kobure dhe plagosi Rembonë. Ai përmend poezinë e Bodlerit, që njihej si njeriu i kafeneve, i opiumeve dhe i vajzave të liga. Kryevepra e tij është «Lulet e së keqes». Kjo ishte «kultura» e tyre, që ne nuk mund ta linim të hynte në vendin tonë, e të na njolloste këtë rini kaq të pastër që ka edukuar Partia. Jo, këtë gjë ne nuk do ta lejojmë.

Unë, kur kam kohë të lirë, lexoj libra në gjuhën franceze. Më shumë lexoj libra politikë, por herë pas here marr në dorë edhe romane e poezi. Ju flas si marksist që ata nuk lexohen. Prej tyre nuk mund të lexosh më tepër se 20 faqe. Ata libra as mund t'i krahasosh me veprat e klasikëve, bile as të atyre të borgjezisë së shekullit të 19-të. Kur lexon, për shembull, një libër borgjez të kohës së kaluar, shikon karakterin e punëtorëve, të fshatarëve, të grevave e të tjera. Kurse botimet aktuale borgjeze janë të tmerrshme, janë refleks i një degjenerimi ideologjik e shpirtëror të paparë. Kjo nuk do të thotë që në mes tyre të mos ketë edhe romane e poezi që mund të lexohen. Flas për letërsinë franceze, po edhe të tjerat pak a shumë në ato ujëra janë. Prandaj nuk kemi bërë keq që e kemi kufizuar letërsinë e huaj. Ne nuk mund të ushqejmë popullin me helme.

Ne kemi sjellë e do të sjellim filma nga jashtë. Më përpara nuk kishim as njerëz kompetentë, as mjete

për të prodhuar vetë filma. Megjithatë filmat që kemi marrë jashtë nuk i kanë prishur ndërgjegjen dhe shijet artistike të masave, sepse jo vetëm që kemi zgjedhur më të pranueshmit midis filmave të huaj, por edhe se propaganda e Partisë ka bërë punën e saj. Kjo propagandë është e thellë te njerëzit tanë, të cilët e ruajnë karakterin e fortë, ndershmërinë, burrërinë, ndjenjën e drejtësisë dhe të urrejtjes kundër vrasjes, korrupsionit e ligësive. Njerëzit tanë i shikojnë filmat e huaj me sy klasor, me sy kritik, duke dalluar ç'është mirë e ç'është keq. Partia jonë i dha me kohë një hov zhvillimit të kinematografisë, me të cilën jemi të kënaqur. Ne duhet të jemi të kënaqur që, aktualisht, kemi një brumë të formuar në të gjithë sektorët për të cilët folët ju. Këtë brumë të mirë duhet akoma ta mbrojmë vazhdimisht për t'i shërbyer ndërtimit të socializmit dhe mbrojtjes së atdheut.

Zhvillimi i këngës dhe i valles popullore, për njëfarë kohe, na kishin mbetur akoma në një nivel të paorganizuar si duhet. Këngët janë ruajtur nga populli brez pas brezi dhe njerëzit, të mbledhur kokë më kokë, vazhdimisht këndonin, por përpara niveli i koncerteve linte shumë për të dëshiruar. Është krejt ndryshe tani.

Tërmeti i rëndë i 15 prillit të këtij viti e ngriti në këmbë gjithë popullin. Nga heroizmi i punonjësve tanë për të përballuar pasojat e tërmetit do të frymëzohen shkrimtarët dhe artistët për të bërë poezi, romane, piktura, pjesë muzikore etj. Kur dëgjon të flasin njerëzit e popullit me një gjuhë që të mahnit, nuk mund të mos frymëzohesh. Për këtë arsye Partia na

këshillon të shkojmë në popull, se në gjirin e tij është gura e madhe që ushqen njerëzit. Te populli gjendet pasuria e madhe e gjuhës sonë, e shprehjeve tona, e mendimeve tona më të mira. Atje duken qartë guximi, shpirti i gjërë dhe mençuria e thellë.

Ashjeriut të mos i rritet mendja nga sukseset në punë sa të thotë: «S'ka si unë!». Sadë i zgjuar të jetë një njeri, ai kurrë nuk mund të jetë më i mençur se populli. Në kontaktet me popullin gjendet gjithçka që i duhet dijetarit e artistit. Zotësia e secilit duket në sintezën që ai i ben diturisë së masave me botëkuptimin e shëndoshë marksist-leninist. Botëkuptimi i shëndoshë dhe karakteri militant që krijon një veprë, e çdo natyre doftë kjo, lë mbresa edhe te brezat e ardhshëm, kur pasqyrojnë shpirtin e popullit. Nuk shlyhen kurrë ato vepra, që i kanë themelet në tabahm e popullit.

Në historinë botërore njihen shumë vepra letrare e artistike të botuara nga institucione të ndryshme. Janë shkruar me miliona libra në të gjitha gjuhët, por pjesën më të madhe i ka marrë me vete rrekeja e kohës. Lumi është zhdukur dhe ka mbetur vetëm ajka. Shekuj të shumtë kanë kaluar pas Homerit, por veprën e tij ata nuk e kanë shlyer, sepse në të është pasqyruar një epokë historike, ajo e lashtësisë.

Një nga ato drejtime të zhvillimit tonë idcoartistik, ku ju nuk u ndalet në mbledhje, është kinematografia. Mund të thuhet se kinematografia jonë ka bërë një hop të madh cilësor përpara, filmat tanë, që për shohim aktualisht, rrallë i gjen jashtë. Ndjenjat e

shprehura, interpretimi i bukur, ambienti i ngrohtë e i shëndoshë i tyre, frymëzojnë me realizëm jo vetëm njerëzit tanë, por, siç tha Dritëroi, edhe të huajt që na e duan të mirën. Filmat tanë tregojnë me realizëm jetën tonë, të kaluarën, perspektivën dhe aspiratat tona. Në qoftë se filmat tanë nuk blihen jashtë, kjo provon se borgjezia trembet nga përmbajtja e tyre revolucionare. Ne kemi informata se ndonjë qeveri ka dhënë urdhër të mos blihen filmat shqiptarë me arsye timin se: «Na futet zjarri brenda». Nga ana tjetër, ne kemi informata se në festivalin e filmit që u zhvillua në Stamboll, njerëzit thyenin dyert e kinemave nga dëshira e madhe për të parë filmat tanë. Nuk na u dha çmim se atje konkurruan vetëm filmat me metrazh të shkurtër, kurse filmat tanë ishin me metrazh të gjatë dhe ishin jashtë konkursit.

Filmi «Dollia e dasmës sime», që u dha në festivalin e filmit tonë është i zhanrit që shkruan Dritëroi. Kush e ka bërë skenarin e atij filmi, Dritëro?

SHOKU DRITËRO AGOLLI: Atë e ka shkruar Ruzhdi Pulaha, ai që ka shkruar edhe komedinë «Zonja nga qyteti».

SHOKU ENVER HOXHA: Sidoqoftë ky skenar është i zhanrit të Dritëroit. i cili shkruan me realizëm dhe konkretisht për fshatarët. Ju, poetët e rinj, duhet ta ndiqni shembullin e tij. Sa film i bukur, i realizuar e me ndjenjë, ishte ai për ne! Sa bukur interpretonte artistja që është një vajzë e re! Vetëm me sytë e saj, pa folur fare, ajo flet për atë që është zor të shprehet me fjalë. Le t'i bëjnë reklamë sa të duan në Francë

dhe në të gjithë botën Brixhid Bardosë, por sipas mendimit tim, artistja jonë e re e këtij filmi e lë në bisht të urës Bardonë. Bardonë e shumë të tjera si ajo i ngre propaganda borgjeze, sepse ato i hapën më shumë dyert e kinematografisë atyre shfaqjeve të ulëta, sëmundjeve e veseve që po degjenerojnë e' cungojnë shpirtrat e njerëzve e sidomos të të rinjve. Arti ynë është i shëndetshëm si era e maleve e uji i burimeve tona. Ky takim me ju po më frymëzon edhe mua të flas me shprehje e figura poetike. Jo vetëm kjo, por vetë jeta jonë është shumë frymëzuese.

Në filmin që përmenda, tregohen në mënyrë pre-këse zakonet e popullit tonë, tregohet jeta e nënave tona, të cilat i fejonin që në djep. Aty unë pashë edhe jetën e nënës sime. Një ditë gjyshi im, babai i nënës, siç më kanë treguar, rrinte i mërzhitur në kafe. Ç'ke more Jonuz, pse rri kështu i vrenjtur? — e kishte pyetur vëllai i gjyshit tim nga ana e babait.

— Po ç'të kemi, më lindi vajzë, — i qe përgjigjur gjyshi.

— O... , punë e madhe. ta marr unë për djalin tim.

— Po ti s'ke djalë, — i ishte përgjigjur gjyshi.

— Nuk kam unë, por im vëlla, Nexhipi, ka Halilin, — dhe aty për aty e kishin vendosur e i kishin dhënë dorën njëri-tjetrit! Gjyshi qe kthyer shpejt i gëzuar në shtëpi dhe u kishte thënë familjarëve: e fejo-va çupën me të birin e Nexhip Hoxhës. Kaq e kishte pasur fejesa e nënës sime me babanë tim. Të tilla ngjarje na kujtohen në këtë film!

Episodet në filmin «Dollia e dasmës sime» janë

thurur kaq bukur dhe me shije të hollë, sa të bëjnë për vete. Kur plaku në anë të oxhakut i flet vajzës, spikat dukshëm karakteri i vjetër i bashkuar me ndjenjat e kulturës sonë. Me të gjitha ato gjestet e tij paraqitet i rreptë për diçka, por edhe i dashur, përparimtar e patriot për gjërat e mëdha. Kjo duket natyrshëm kur ai thotë: «Hajde, ti, vajzë, lidhja plagën të plagosurit!».

Ose te filmi «Gjeneral gramafoni» është historia që kemi jetuar vetë ne. Muzika e këtij filmi është zgjedhur nga ato melodi të ëmbla që na kanë kënduar nënat tona në djepe e jemi ushqyer në rininë tonë. Kënga jonë tronditëse e shoqëron aksionin politik këmba-këmbës dhe del fitimtare. Ajo e dërrmon armikun, siç e dërrmuan trimat me armë në dorë. Kënga jonë, me jehonën e saj të fuqishme, të thellë, prekëse, luftarake, revolucionare, popullore është kushtim për luftë.

Në shoqërinë borgjeze doemos nuk i pëlqejnë filmat tanë. Nuk i pëlqen borgjezia, se morali ynë proletar është në kundërshtim me moralin e degjeneruar borgjez. Megjithatë edhe në këtë shoqëri ka shumë njerëz që nuk e durojnë degjenerimin e djemve dhe të vajzave të tyre, thirrjet e borgjezisë për «liri seksuale». Klasat shfrytëzuese e ushqejnë degjenerimin, kurse popujt janë armiq të tij.

Pse njerëzit e popullit i duan filmat tanë? I duan se shohin si kemi kaluar ne nga errësira në dritë. Ata shohin një film që paraqet si ka qenë gjendja 40 vjet më parë në Shqipëri, pastaj një film tjetër që paraqet periudhën e ndërtimit të socializmit.

Njerëzit jashtë, kur bien në kontakt me literaturën tonë ideologjike, nuk duan t'ia dinë për asgjë dhe bëhen copë për ta blerë. Të ndjekim këtë rrugë, thonë ata, se kjo është rruga jonë. Në këto kushte qeveritë e tyre urdhërojnë që të mos blihen librat tanë, se u «futin zjarrin brenda».

SHOKU RAMIZ ALIA: Edhe për filmin «Gjeneral gramafoni», që u shfaq në Turqi e gjetkë, thanë se kjo që është bërë në Shqipëri nga Italia, bëhet edhe te ne nga kultura amerikane.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, kultura amerikane depërton në këto vende, sepse në kapitalizëm shteti më i fortë u eksporton edhe mënyrën e jetesës shteteve më të dobëta. Mënyra e jetesës nuk është vetëm blerja e drogave, e najloneve, e kostumeve ekstravagante e lloj-lloj xhixhlave, por nëpërmjet blerjes së tyre blihet edhe kultura e huaj, që korrupton masat.

...Aktorët tanë, të vjetër e të rinj, profesionistë dhe amatorë, janë të mëdhenj, se kanë dalë nga gjiri i popullit dhe i ka edukuar Partia. Kur shikon Sandër Prosin në filmin televiziv «Udha e shkronjave», duke interpretuar rolin e Dhaskal Todrit, secili jeton me përpjekjet e sakrificat e luftëtarëve, e dijetarëve tanë të mëdhenj, që flijuan jetën e tyre për këtë dhe e këtë gjuhë. Ai film paraqet me vërtetësi forcën e madhe të popullit tonë, zotësinë dhe vetëmohimin e njerëzve tanë. Kur shohin filma të tillë, njerëzit tanë thonë: «More, në ato kohë vritej tjetri edhe për shkronjat e gjuhës shqipe, siç u vra Dhaskal Todri. Kisha reak-

sionare të fuste thikën prapa shpine e përse? Sepse doje gjuhën tënde!».

Të njëjtat përshtypje për të kaluarën e hidhur, për intrigat e klasave shfrytëzuese, u krijuan spektatorëve edhe kur shikojnë filmin për Tefta Tashkon e të tjera. Robert Ndrenika, që interpreton me mjeshtëri rolin e nënprefektit në filmin «Koncert në vitin 1936», është një artist i talentuar, që dallohet edhe në filmat e tjerë që kemi parë.

Ju jeni të rinj, por ne, të moshuarit, e mbajmë mend Lushnjën e paraçlirimit tamam ashtu sikurse paraqitet në film. Edhe ai që luan rolin e komandantit të xhandarmërisë, e interpreton bukur atë rol.

Ne po ecim përpara në artin e kinematografisë, të cilin duhet ta ndihmojmë që të zhvillohet akoma më shumë. Edhe artistët e rinj ne i kemi të mirë dhe me perspektivë. Ata kanë luajtur në filma të rinj, si «Vajzat me kordele të kuqe», «Lulëkuqet mbi mure» etj. Në këta filma si dhe në atë «Beni ecën vetë» dhe «Tomka dhe shokët e tij» luajnë edhe të vegjël, të cilët interpretojnë aq bukur, sa habitesh, kur i shikon.

Edhe televizioni ynë ka marrë një rrugë të mirë. Nuk është kollaj të mbushet programi i tij me shfaqje nga ora tetëmbëdhjetë e deri në njëzet e dy e më vonë. Televizioni i huaj gjysmën dhe treçerekun e kohës së shfaqjeve e angazhon me reklama, me filma me vrasje dhe me lajme, kurse televizioni ynë ka një program të pasur, me përmbajtje të shëndoshë e të gjithanshme.

I vini rëndësi edhe përhapjes së librit në masat e rinisë, se në relacionet tuaja lexova që librat nuk

para venë shumë në fshat. Të punoni më shumë që, kur të marrë i riu një poezi të Dritëro Agollit, të Ismail Kadaresë, të Fatmir Gjatës, apo të Moikom Zeqos, të cilin e kemi këtu sot, t'i japë asaj tonin e duhur kur ta lexojë dhe ta ndiejë shpirtërisht atë që shkruhet, që të tjerët të hapin sytë e të thonë: ku është ky libër që ta marrim e ta lexojmë edhe ne. Këto forma pune shpeshherë kanë më shumë efekt sesa një konferencë.

Mua më duket se fola shumë për këto çështje, prandaj t'i japim fund dhe t'ju urojmë suksese në punë. Të na jepni sa të jetë e mundur më shumë vepra të mira nga krijimtaria juaj dhe të punoni që ato t'i shfrytëzojnë masat e rinisë.

Punë e mbarë dhe mirupafshim!

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha «Raporte e fjalime 1978-1979»,
f. 237*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për rininë»
(Përmbledhje veprash), vëll.
2, f. 510*

TREGUESIT

TREGUESI I LENDES

A

Aftësia prodhuese, shfrytëzimi i saj — 11-12, 14, 96, 192-193, 280-282, 392, 402-403, 463-464.

Aktonet, iniciativat dhe lëvizjet revolucionare — 164-165, 385-386, 400, 402-403, 407-409.

Albanologjia, albanologët — 272.

Armiqtë, veprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre — 277-278, 288-289, 299, 403, 487.

Arsimi në RPSSH; revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës; programet, tekstet, lëndët mësimore; lidhja e teorisë me praktikën — 120-121, 122-123, 244-245;

— arsimi i mesëm profesional; arsimi i lartë. Roli dhe detyrat e shkollës

— 86, 119, 120-121, 122, 141-142, 244-245;

— mësuesit, pedagogët, stu-

dentët; kualifikimi pasuniversitar — 86-87, 118, 119-120, 121, 123-127, 174-176, 272.

Arti Ushtarak i Luftës Popullore; njohja dhe përvetësimi i tij — 41-42, 204, 209-217, 219-221, 223, 225, 227, 229, 231-232, 234-235.

B

Bashkimet Profesionale të Shqipërisë; detyrat, kuadrot e tyre — 290-292, 302-303.

Bashkimi Sovjetik, socialimperializmi sovjetik

— gjendja e brendshme, degjenerimi kapitalist; strategjia dhe taktikat — 338-342, 343, 353-354.

Borgjezia; borgjezia e re në vendet revizioniste — 150, 348, 349, 374, 447, 493.

Bujqësia në RPSSh — politika e Partisë dhe ndihma e shtetit për zhvillimin e bujqësisë

— 108, 141-142, 182-184, 186, 436-439;

— organizimi dhe drejtimi i punës; kuadrot, specialistët — 107-108, 113, 116-120, 142, 186-188, 191, 193, 438-439, 456;

— agroteknika dhe shërbimet agroteknike; rendimentet e prodhimeve bujqësore; eksperimentet dhe studimet shkencore — 107, 108-109, 110-111, 116, 181-186, 190-192, 437, 455-456, 457, 461-462;

— toka, sistemimi i saj — 184, 188-191;

— pemëtaria, perimet; ulliri, bimët vajore; fidanishtet, farërat, foragjeret — 106-109, 110-112, 113-114, 116, 117, 142, 181, 182, 189, 194-195, 455;

— patatja; bimët industriale (duhani, pambuku, panxhari i sheqerit) — 180-182, 186-189, 190, 192-193, 436, 454-456, 465.

Burokratizmi, lufta kundër

shfaqjeve të tij — 69-70, 71, 144-145, 332.

D

Demokracia socialiste — 253-254, 325.

Disiplina proletare — 328-329.
Drejtimi dhe organizimi shkencor i ekonomisë — 391-398, 429-431, 433-434.

E

Edukimi komunist — edukimi ideopolitik, patriotik dhe kulturor i masave; edukimi me dashurinë për fshatin — 16-20, 123-124, 145, 420, 421-425, 430, 433, 435-437, 438-439, 458-461;

— edukimi dhe masat administrative; bindja — 334-335, 459, 460.

Efektiviteti i ekonomisë — 256-257, 400-404.

Ekonomia në vendet kapitaliste e revizioniste — 343, 344.

Ekonomia popullore — politika e Partisë për zhvillimin e

saj; stabiliteti i ekonomisë — 72, 256-257, 463-464;
— shfrytëzimi i rezervave dhe i mundësive të brendshme — 400-404, 430-431.

Engels, Fridrih — 147, 345.

Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 5, 6, 10, 32, 142, 153, 154-155, 174-175, 229, 267, 272-273, 277, 310, 314-315, 318-319, 321-322, 414, 475-476, 477, 488, 492.

F

Financat — kontrolli financiar; ndërmarrjet që dalin me humbje — 248-249, 256.

Folklori — muzika, kënga dhe vallja popullore — 31, 320-321, 322, 486-487, 489.

Fshatarësia kooperativiste; roli i saj në zhvillimin e bujqësisë; edukimi ideopolitik, lufta kundër koncepteve dhe shfaqjeve të huaja — 367-368, 436-437, 438-439, 454, 459, 462.

Fuqia punëtore — politika e Partisë për angazhimin e të gjitha forcave të afta për punë; perspektiva e përdorimit të forcave të punës — 331-332, 421-425;

— nevojat për fuqi punëtore; sigurimi, sistemimi dhe shpërndarja e saj — 324-325, 327, 396-397, 421-422, 461-462.

G

Gruaja dhe Bashkimi i Grave të Shqipërisë — 301.

GJ

Gjeologjia, studimet gjeologjike; gjeologët — 90-96, 129-130, 287.

Gjuha shqipe — lufta për pastërtinë dhe pasurimin e saj — 269-270, 271-272, 476.

H

Historia e Shqipërisë; lidhjet dhe solidariteti i popullit shqiptar me popujt fqinjë në luftërat për liri e pavarësi; rilindësit — 153-154, 270, 274, 481-482.

I

Imperializmi — politika demagogjike dhe e luftës; për-

projekjet për hegjemoni — 353, 443-452.

Industria e lehtë dhe ushqimore në RPSSH — prodhimi i yndyrnave — 112-114.

Industria e rëndë në RPSSH — industria mekanike, prodhimi në vend i makinerive, i fabrikave dhe i uzinave — 36, 137-138, 139-140, 261, 262, 279-283, 402;

— *industria minerare dhe ajo metalurgjike; Industria e materialeve të ndërtimit* — 85, 243, 261, 402-403.

Industrializimi socialist — përpunimi i lëndëve të para të vendit; specialistët, punëtorët — 113, 261.

Iniciativa dhe vetëveprimi — 389-390, 405.

Interesat në socializëm — 295-297, 458-461.

Investimet — përdorimi i tyre me efektivitet — 256-257.

Irani — gjendja e brendshme, revolucioni iranian — 133, 150, 450-451.

J

Jetesa në shoqërinë tonë socialiste — 460.

Jugosllavia, revizionistët jugosllavë

— *gjendja e brendshme, vijat politike; degjenerimi në kapitalizëm; shovinizmi serbomadh* — 344-346, 348-350, 356-358, 449-450;

— *roli sabotues në lëvizjen komuniste botërore dhe në luftërat e popujve për liri e pavarësi; lidhjet me imperializmin, marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj BS* — 346-347, 348, 353-360;

— *veprimtaria armiqësore kundër Shqipërisë* — 347-348.

K

Kapitalizmi — ligje dhe karakteristika të zhvillimit të tij — 343, 344, 427, 444-452, 459, 494.

Këshillat popullorë; komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, seksionet e tyre — 107, 108, 109-110, 249, 424-425.

Këshilli i Ministrave (Qeveria), Kryesia e Këshillit të Ministrave — 14, 21, 22, 35, 51,

- 56, 60, 61, 62, 63, 65, 67-63, 69, 74, 113, 125, 141, 161, 176-177, 188, 250, 252, 253, 267, 289, 327, 332, 394, 398, 426, 429, 430, 431, 433.
- Kina, revizionizmi kinez — qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPSSH — 136-137, 133, 140, 143, 144, 152, 261, 331.*
- Kinematografia, filmi në RPSSH — 419, 420, 408-409, 490-493, 494-495.*
- Klasa punëtore në RPSSH; roli udhëheqës, cilësitë dhe detyrat e saj — 20, 82, 461; — edukimi ideopolitik, lufta kundër shfaqjeve të huaja — 82, 295.*
- Kolonializmi, neokolonializmi dhe lufta e popujve për shkatërrimin e sistemit kolonial — 413-452.*
- Kompetencat, përgjegjësitë — 26-27, 70, 99, 168-169, 172, 173, 176-178, 213, 285-287, 288, 325.*
- Komunisti — cilësitë, detyrat dhe roli i tij pararojë; kandidati i Partisë — 163, 243, 252, 289-291, 294-295, 296, 298, 300, 333-335, 336, 361-365, 382, 405-406, 432, 457-458, 464.*
- Kontrolli dhe kërkesa e llogarisë — 99, 100, 431-432.*
- Kooperativat bujqësore — organizimi dhe drejtimi i punës në to; ndihma dhe kontrolli — 179-182, 254-255, 454-457;*
- pjesëmarrja e kooperativistëve në punë; të ardhurat dhe shpërblimi i punës — 179-182, 454, 457.
- Kuadrot, specialistët — politika dhe kujdesi i Partisë për kuadrin — 53, 54, 55-58, 175-176, 267, 291, 325-326;*
- përcaktimi marksist-leninist i nocionit kuadër; roli dhe detyrat e tyre në ndërtimin socialist të vendit — 11-13, 28-29, 30, 50-51, 72, 138, 169, 173-175, 191, 192, 244, 245-247, 255, 264, 290-291, 386, 393, 404, 433-434, 460, 463;
- zgjedhja dhe vendosja e kuadrove; vlerësimi dhe ngritja e tyre në përgjegjësi; kualifikimi, kujdesi dhe ndihma për ta — 27-39, 50-52, 54, 73-74, 85-87, 102-103, 107-108, 117-120, 121-123, 126-129, 165-166, 173-175, 279-280, 282, 325-326;
- metoda dhe stilli i tyre në punë; marrëdhëniet

kuadër—masë — 38, 70,
72-73, 101-102;

— kuadrot e Partisë — 48,
50, 72-73, 245-247, 264,
369-370, 378-379, 389, 438.

*Kultura në RPSSH — politika
dhe kujdesi i Partisë për kul-
turën; institucionet dhe ve-
primtaritë kulturore e artisti-
ke — 412, 413, 469.*

*Kultura përparimtare botë-
rore — 270, 275, 479, 480, 483,
487, 490.*

L

*Lenin, Vladimir Iliç — 147,
266, 345, 375, 458.*

*Letërsia dhe artet në RPSSH
— politika dhe kujdesi i Par-
tisë për letërsinë dhe artet —
136, 416-417, 418, 470, 486-
487, 489-490;*

— kritika letrare dhe arti-
stike; përkthimet. Lufta
kundër depërtimit të ide-
ologjisë borgjezo-revizio-
niste në letërsi — 30-32,
473, 487;

— shkrimtarët, artistët, ta-
lentet e reja — 136, 473-
474, 486-487, 491-492, 494,
495.

*Lëvizja marksiste-leniniste
ndërkombëtare*

— marrëdhëniet ndërmjet
partive marksiste-lenin-
niste — 133, 146-147, 152;

— roli i partive marksiste-
leniniste; strategjia dhe
taktikat — 133-136, 146-
148;

— përkrahja për PPSH —
132-133.

*Libri — puna me librin —
23-29, 86, 495-496.*

*Ligjet ekonomike të socializ-
mit — 256-257.*

*Ligjet në RPSSH — njohja
dhe zbatimi i tyre — 17-19.*

*Lufta Antifashiste Nacional-
çlirimtare e popullit shqip-
tar; rëndësia e saj; objektiviteti shkencor në shkrimet për
të — 6-9, 204, 375-376.*

*Lufta — koncepti marksist-len-
inist për luftën; shkaktarët e
saj — 226-227, 350-353, 359-360.*

*Luftërat nacionalçlirimtare të
popujve — 133, 150-151.*

M

*Marksizëm-leninizmi — armë
dhe busull për udhëheqje e
veprim; njohja, përvetësimi
dhe zbatimi krijues i tij —
133, 147-148, 150, 468, 473.*

*Marks, Karl — 147, 266, 345,
487.*

- Mbështetja në forcat e veia*
— 137-140, 141, 144, 192, 431.
- Mbrojtja e atdheut — forci-
mi i gatishmërisë luftarake
dhe i mbrojtjes së vendit —*
41-47, 66, 196-203, 215-241,
360.
- Metoda dhe stili në punë —*
69, 70-71, 130, 143-144, 164-
-165, 176-178, 247-248, 289-
-291, 327-333, 404.
- Ministritë dhe kuadrot e ty-
re; kompetencat, detyrat —*
40, 136-137, 189, 248-249, 252
253, 331-332, 333, 391, 393,
431-432;
— Ministria e Mbrojtjes
Popullore — 214, 217-218,
223-224, 226, 240;
— Komisioni i Planit të
Shtetit — 13, 117, 119,
324, 325, 332;
— Ministria e Industrisë
dhe e Minerave — 21,
23-24, 34, 35, 36-37, 54,
57, 62, 63, 64, 68-69, 91-
-92, 96-97, 98, 103, 130,
161, 163, 164, 165, 168,
172, 279, 284-285, 288, 293,
331, 332, 391, 398;
— Ministria e Industrisë së
Lehtë dhe Ushqimore —
187, 189;
— Ministria e Bujqësisë —
108, 109, 111, 117, 119,
122-123, 180, 183, 184, 190,
192, 249, 436;
— Ministria e Ndërtimit —
333;
— Ministria e Arsimit dhe
e Kulturës — 85-86, 118,
122-123, 127, 128, 331;
— Ministria e Tregtisë
Jashtme — 187, 184-189,
426, 433.
- Minoriteti grek në Shqipëri*
153.
- Mirëqenia në shoqërinë tonë
socialiste; rrugët për ngritjen
e saj —* 18, 142-143, 460-461
- Monumentet e kulturës —* 315-
-316, 466-469.
- N
- Nafta dhe gasi, shpim-kërki-
met për naftë e gaz —* 129-
-130;
— politika dhe kujdesi i
Partisë për sektorin e na-
ftës; Komisariati i naftës,
kompetencat, detyrat dhe
përgjegjësitë, metoda dhe
stili në punë, ndihma dhe
kontrolli — 21-28, 29,
52-53, 60-69, 73-74,
83-84, 88-105, 143-
-144, 160-164, 170-173,
284-285, 289, 291-293;
— organizimi dhe drejtimi
shkencor, bashkërendimi

i punëve në sektorin e naftës; lufta kundër të metave e gabimeve — 1-4, 5-6, 83-84, 88-105, 157-178, 279-290, 291-293, 391-393;

— studimet shkencore; kuadrot, specialistët dhe punëtorët e naftës — 2, 3-4, 49-59, 61, 102-103, 130-131, 157-159, 234, 285-286, 289-292;

— veprimtaria sabotuese në sektorin e naftës — 83-84, 238-239.

Ndërmarrjet socialiste — drejtimi i tyre ekonomik — 248-249, 395-396.

Ndërtimet — ndërtimi i hidrocentraleve dhe i objekteve industriale; ndërtimet në fshat

— 138-139, 333-385, 397, 398.

Ndërtimi i socializmit në Shqipëri — politika e Partisë për ndërtimin e socializmit — 458-459;

— parime, karakteristika të ndërtimit socialist; transformimi i gjlthanshëm i njeriut — 141, 144-145, 244, 335-337, 438-439, 457-458, 460-461, 473.

O

Organet shtetërore dhe ato ekonomike, detyrat e tyre —

26-27, 111, 242-243, 245, 249.
Organizata-bazë e Partisë; roli udhëheqës dhe detyrat; puna me masat, sekretari — 163, 242-243, 245, 300-304, 332-333, 405-406;

— organizatat-bazë të Partisë në ndërmarrje, në dikastere dhe në institucione — 1-2, 23, 123, 253, 329, 333-334;

— organizatat-bazë të Partisë në terren dhe në ushtri — 44-47, 196-199.

Organizimi dhe drejtimi — 11-16, 33-40, 99, 169, 173-173, 242, 251, 253-254, 262, 268, 382-383, 429-434.

P

Paga — politika e Partisë në fushën e pagave; shpërblimi i punës — 109, 179-180, 181-182, 459.

Paraja — mbulimi i fuqisë blerëse me mallra — 256-257, 460.

Partia e Punës e Shqipërisë — vija, vendime, direktiva, ndërtimi dhe jeta e brendshme

— vija, vendime, direktiva; njohja dhe zbatimi i tyre — 14, 16-17, 46-47, 49, 60, 99, 111, 136, 161, 196.

- 244, 308, 329, 335-337, 374-375, 457;
- roll udhëheqës, forcimi i Partisë — 50, 52, 62, 243, 250-253, 290, 291, 307-308, 332-333, 336, 377, 405, 429;
 - pranimet në Partitë, kriteret e pranimit — 295-305;
 - parimet dhe normat e Partisë; demokracia e brendshme. Statuti — 299-300, 361-366;
 - zgjedhjet në Partitë; mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhje — 361-366;
 - puna e Partisë, metoda dhe stili i saj në punë; analiza dhe sinteza, trajtimi konkret, kapja pas hallkës kryesore; ndihma dhe kontrolli për bazën, lidhja me masat — 48-49, 72-73, 243, 246-243, 250-254, 265-266, 268, 294, 295, 328-331, 365-373, 374, 376-379;
 - puna e Partisë me njerëzit, qëndrimi ndaj të metave e gabimeve dhe ndaj njerëzve që gabojnë; masat ndëshkimore, përjashtimet nga Partia; qëndrimi ndaj të përjashtuarve — 83-84, 104, 111, 296-297, 299, 305-307, 460-461, 464-465;
 - edukimi në Partitë, edukimi ideopolitik; propaganda e Partisë — 72, 295-298, 373-378;
 - lidhja e organeve të Partisë me ato shtetërore — 67-68, 243, 247, 250-252, 257, 382;
 - materialet, studimet, informacionet për organet udhëheqëse — 56-57, 327-332, 370-373, 377-378, 433-434.
- Partia e Punës e Shqipërisë — organet udhëheqëse qendrore dhe në rrethe — 26-27, 44-47, 163, 164;*
- Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretaria-ti i KQ — 14, 21, 22, 25, 27, 40, 57, 60, 62, 63, 65, 67, 69, 72, 83, 103, 125-132, 139-140, 141, 143, 161, 179, 173, 182, 190, 225, 232, 250, 252, 260, 262-263, 233, 331-332, 365, 367, 368-369, 370-373, 410, 428, 430, 431;
 - aparatit i KQ. instruktorët — 12-13, 14-15, 177-178, 250-251, 252, 253, 258-259, 263-264, 365, 366, 367, 368-369, 370-371, 373, 376-378;

- komitetet dhe aparatet e Partisë në rrethe; sekretarët, instruktorët — 15, 23, 107, 121, 179, 191-192, 196-199, 200, 246, 252-253, 291, 294-295, 298, 363, 364, 369;
 - organizatat dhe komitetet e Partisë në ushtri; Komiteti i Partisë i Ministrisë së Mbrojtjes Popullore — 196-200, 201-202, 231-233;
 - komitetet e Partisë të rrethëve të Dibrës, të Fierit dhe të Lushnjës — 160-161, 435-436, 437, 438, 457.
- Partia e Punës e Shqipërisë — politika e jashtme*
- analiza marksiste-leniniste e situatës ndërkombëtare; mbrojtja dhe zbatimimi krijues i marksizëm-leninizmit — 147-148, 373-374;
 - përkrahja për partitë e lëvizjen marksiste-leniniste dhe për luftërat nacionalçlirimtare të popujve; rritja e prestigjit dhe e autoritetit të PPSH në botë — 132-133, 134, 146-147, 150-152.
- Partia Komuniste e Greqisë — 154-155.*
- Partia Komuniste (marksiste-leniniste) e Brazilit — 132-134, 145-147.*
- Patriotizmi socialist — 373.*
- Përvoja e përparuar, përgjithësimi i saj — 189-190, 194.*
- Planifikimi i ekonomisë popullore, parime të planifikimit — 137-140, 431;*
- hartimi i planeve dhe pjesëmarrja e masave në planifikim; mobilizimi i tyre për realizimin e detyrave të planit — 248-259, 429-433;
 - planifikimi dhe realizimi i planeve në bujqësi — 107, 114, 251-252;
 - organet e planifikimit; ndihma dhe kontrolli — 259, 257-258, 423;
 - plani i 6-të (1976—1980) dhe i 7-të (1981—1985) pesëvjeçar — 139-140, 462.
- Politika e jashtme e RPSSH*
- parimet themelore të saj; rritja e autoritetit të RPSSH në botë — 426-427, 491, 491;
 - qëndrimi parimor marksist-leninist ndaj popullsisë shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi — 155;
 - marrëdhëniet me Greqinë, qëndrimi ndaj Jugo-

slavisë — 152-153, 154, 155, 344, 360;

— përkrahja për luftën e popujve palestinez dhe iranian — 150-152.

Populli shqiptar — cilësitë, traditat dhe trashëgimia në fushën e punës, të kulturës dhe të artit — 221, 256, 409, 463-471, 489.

Popullsia — demografia — 142-143, 421-425.

Prodhimi material — rritja e tij e pandërprerë; prodhimi i sendere të konsumit; cilësia, asortimenti — 35-36, 112-113, 187-189, 430.

Prona në RPSSH — 367-368, 436, 457.

Propaganda, agjitacioni — përmbajtja, format — 123-124, 150, 151-152, 198, 374-375, 377, 410-411, 424;

— propaganda për botën e jashtme — 150, 151-152.

Propaganda, shtypi dhe botimet në vendet revizioniste — 144, 272-273, 350-351, 352-353, 374.

Psikologjia mikroborgjeze, lufta kundër saj — 367-368, 435-436, 437-438.

Psikologjia socialiste — 458-461.

Puna — kuptimi, qëndrimi

socialist ndaj saj — 16-20, 145, 423-424, 458, 463-464.

R

Regjimi i kursimit — kursimi i energjisë elektrike dhe i lëndëve të para — 89-90, 92-93, 135-186, 331, 463-464.

Revolucioni tekniko-shkencor — byrotë teknike, grupet e punës; kuadrot, specialistët, punëtorët; eksperimentimet dhe studimet shkencore — 33-

-39, 40, 140, 174-175, 398-404.

Rinia dhe Dashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë; kujdesi i Partisë për rininë, edukimi ideopolitik dhe kulturor i saj; lufta kundër shfaqjeve të huaja — 301-303, 304, 467, 470, 472, 473-474, 495.

RR

Rrethimi, bllokada e presioni imperialisto-revizionist dhe lufta për përballimin e tyre — 82-83, 141, 162, 337, 462.

S

Socializmi — ligje, tipare të përgjithshme të tij — 457-458.

Solidariteti socialist — 405, 407-411.

Stalin, Josif Visarionoviç — 50, 80, 147, 230, 231-232, 246, 253, 266, 270, 346, 348, 355, 373-374, 375.

Stimujt moralë dhe materialë — 181, 295, 461.

SII

Shfaqjet e huaja dhe lufta kundër tyre — 20, 49, 144-145, 404.

Shkenca në RPSSH — politika dhe kujdesi i Partisë për shkencën — 28, 29-30, 70-71, 125, 166-167, 171-172, 468, 472-473;

— masivizimi i shkencës; roli i saj në zhvillimin e shoqërisë dhe të prodhimit — 171, 456, 473;

— organizimi dhe drejtimi i punës shkencore, debati shkencor; institucionet shkencore dhe punonjësit shkencorë; studimet shkencore — 28-29, 33, 34-35, 36-39, 40, 70-71, 93-94, 97, 100-101, 102, 124-125, 126-128, 140, 165-169, 174-175, 191-192, 292, 456-457, 473.

Shkolla e Lirë Ushtarake; edukimi ideopolitik dhe për-

gatitja luftarake e efektivit të SHLU; programet, stërvitja ushtarake — 41-44, 196-205, 226;

— kuadrot ushtarakë dhe rezervistë — 204-208.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës — politika e jashtme, strategjia dhe taktikat — 242, 448-449.

Shtypi dhe botimet në RPSSH — zgjerimi i botimeve — 272, 479;

— përmbajtja, roli dhe detyrat e tyre; shfrytëzimi i shtypit — 7-9, 10-13, 14-16, 30, 32, 75-83, 84, 153, 245, 246, 375, 409-411, 479;

— organet e shtypit, gazetarët, korrespondentët; shtypi lokal — 77-80, 81, 409-411.

T

Teoritë borgjezo-revizioniste dhe kritika ndaj tyre

— teoria e revizionistëve jugosllavë e «vendeve të paangazhuara»; teoria e revizionistëve kinezë për «tri botët» — 443-452.

Tërmetet — mobilizimi i Partisë e i popullit për zhdukjen e pasojave të tyre — 381-390, 407-411.

Tregtia e jashtme

- importi, zëvendësimi i mallrave të importit me ato të vendit — 112, 114-115, 142, 184, 192, 427, 430-431;
- eksporti, zgjerimi i tij, gjetja e tregjeve të reja; njohja dhe shfrytëzimi i koniunkturave të çmimeve — 142, 187-189, 426-429, 462-463;
- organet e treglisë së jashtme dhe punonjësit e tyre — 187-188, 428-429.

U

Urbanistika, plani rregullues i qyteteve dhe i fshatrave — 383-385, 386-388.

Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare — 6-7, 8.

Ushtria Popullore

- Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë, Komandanti i Përgjithshëm; Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë — 212, 222, 224, 228, 229, 233, 241;
- njësitë dhe repartet ushtarake, komandat dhe shtabet e tyre — 43-44, 197, 201, 215-216, 220-221, 222-223, 224;
- organizimi, forcimi i lidhjeve dhe i bashkëpu-

nimit ushtri—terren — 44-47, 197-208, 215, 236-238;

- stërvitja ushtarake; organizimi dhe përsosja e saj; programet e përgatitjes politiko-ushtarake — 4-5, 211-241;
- ndërlidhja, zbulimi, prapavijat — 229-230;
- disiplina ushtarake; urdhri, zbatimi i tij; lufta kundër të metave e gabimeve, koncepteve e shfaqjeve të huaja në ushtri — 4-5, 41-42, 197-198, 199-200, 203, 211-214, 233-234, 237-238, 241;
- kuadrot ushtarakë aktivë dhe rezervistë; ushtarët, rezervistët — 41-42, 43, 200-201, 202-203, 215-221, 222-226, 227, 234-238, 241.

V

Vendet revizioniste; kriza, kontradiktat me BS dhe tendencat e tyre centrifugale ndaj tij; degjenerimi kapitalist, lidhjet me imperializmin — 338-344.

Vështirësitë, lufta për kapërcimin e tyre — 136, 137, 143, 144-145, 336, 409, 462.

Vigjilenca revolucionare — 5, 83, 337.

TREGUESI I EMRAVE

A

Alia, Ramiz — 35, 36, 39-40,
45, 132, 133, 145, 147, 255-
-256, 264, 265, 266, 267, 269,
272, 276-277, 304, 326, 329,
366, 371, 380-382, 386, 388,
389, 395, 399-400, 401, 402,
403, 412-416, 419-420, 421,
468, 474, 475, 485, 494.

Agolli, Dritëro — 419, 475,
476, 479, 483-486, 491, 498.

Ainshtajn, Albert — 467-468.

Aleksandër I Karagjorgjeviç
— 354, 357-358.

Amazonas, Zhoao — 132, 146,
147, 148-150.

Antoni, Androniqi — 414.

Aragon, Lui — 476.

Arkitekt Sinani — 463.

Arruda, Diogenes — 146.

B

Bajron, Xhorxh Gordon —
153.

Balzak, Honore de — 487.

Bardo, Brixhid — 492.

Bardhi, Frang 271.

Bariu, Laver — 30, 31, 32, 322,
323.

Barleti, Marin — 385.

Bartu, Lui — 354.

Begin, Menahem — 151.

Bektashi, Haxhi — 314.

Berton (konti) — 276.

Biloshmi, Haki — 7.

Boçari, Marko — 154.

Bodler, Charl — 275, 488.

Boris III — 355.

Brezhnjev, Leonid — 339.

Bubulina, Llaskarina — 154

Buda, Aleks — 273.

Bulka, Nonda — 310.

Buzuku, Gjon — 271.

Ç

Çami, Foto — 435.

Çuko, Lenka — 260-268, 269.

Çabej, Eqrem — 269-272, 273.

Çërçill, Uinston — 374.

Çipi, Pëllumb — 106-107.

Çuçi, Jonuz — 492.

Çu En Lai — 139.

D

- De Rada, Jeronim — 271.
 Desio, Dineas Agiar — 148.
 Dë Gol, Shari — 374.
 Dimitrov, Gjergj — 347, 348.
 Durrsaku, Andrea Aleks — 479.

F

- Fishta, Gjergj — 277.
 Frashëri, Naim — 271, 274.
 Frashëri, Sami — 270, 271, 479.

G

- Gorkiç, Milan — 355.

GJ

- Gjata, Fatmir — 496.
 Gjoni, Xhelil — 474.

H

- Hoxha, Nexhmije — 417.
 Homeri — 490.
 Hoxha, Ermal — 323.
 Hoxha, Halil — 314, 321-322, 492.
 Hoxha, Hysen — 322.
 Hoxha, Nexhip — 492.
 Hrushov, Nikita — 339, 349, 374.

I

- Isai, Hekuran — 26, 28, 49, 55, 58, 62, 88-89, 92, 91, 96, 98, 99, 104, 129, 160-161, 165, 169, 170, 280, 282, 283, 433.
 Ipsilant, Aleksandër — 154.

K

- Kapo, Hysni — 40, 94, 95, 100, 104, 209, 212, 238-239, 255, 257-258, 263, 264, 265, 266, 267, 268-269, 366, 371, 390, 391-392, 394, 396, 397, 398, 403, 408, 416, 418-419, 422.
 Kadare, Ismail — 496.
 Kapo, Vito — 433.
 Kardel, Eduard — 345, 347, 349, 356.
 Karter, Xhimi — 150, 151.
 Këlcyra, Ali — 312.
 Khomeini, Ajatollah — 133.
 Klemanso, Zhorzh — 354.
 Kolijanin, Kosta — 155.
 Konda, Spiro — 481.
 Konica, Faik — 272, 274, 276, 277, 477, 487.

L

- Lambere, Maksimilian — 272.
 Leusa, Mantho — 310.
 Lubonja, Todi — 457.

M

Miska, Pali — 23, 67.
 Murra, Prokep — 1-2, 19, 28,
 35, 252, 255, 262, 266, 324,
 326-327, 392-393, 396, 397,
 417.

Mao Ce Dun — 147, 451.

Mato, Jakup — 471.

Mikelanxhelo Buonarotti —
 479.

Mio, Vangjush — 414.

Moisiu, Aleksandër — 273.

Moisiu, Spiro — 313, 319.

Musolini, Benito — 277.

N

Nashi, Gogo — 265.

Naser, Gamal Abdel — 413,
 418.

Nashi, Lipe — 288

Ndrenika, Robert — 495.

Nehru, Xhavarharlal — 413,
 418.

Nikeziç, Marko — 356.

P

Peristeri, Pilo — 283, 474.

Paçrami, Fadil — 487.

Papapano, Thoma — 475-476.

Petro, Rafael — 273.

Pirro (mbreti) — 432.

Pjero di Kozimo — 470.

Plaku, Koço — 288.

Popoviç, Vilado — 356.

Prosi, Sandër — 31, 419, 491.

Puankare, Rajmond — 351.

Q

Qemal, Namik — 479.

R

Raidhi, Pandi — 418-419.

Rankoviç, Aleksandër — 345,
 346, 347, 348, 356.

Rembo, Zhan-Artur — 275,
 488.

Resuli, Namik — 272-276, 277,
 477-478, 487-488.

Rexha, Lumturi — 475.

Rusvelt, Franklin — 374.

S

Skënderbeu, Gjergj Kastrioti —
 153, 387, 388.

Stefani, Simon — 175, 176, 239-
 240, 263, 264, 265, 266, 267,
 268, 302, 309-323, 326, 366,
 395, 403, 416-417, 420.

Saadi, Ebu Abdull-llah Mu-
 sherrefedin — 275.

Sadat, Anvar el — 151.

Sala, Valdete — 466-467.

Skënde, Petrit — 467-468.

Sonino, Xhiorxhio Sidnei — 276.
 Spahiu, Bedri — 319.
 Spahiu, Xhafer — 67, 98, 131.
 Sukarno, Ahmed — 443.

SII

Shchu, Mehmet — 5, 61, 212, 213, 227-228, 281, 282, 327, 395-396.

T

Toska, Haki — 24.
 Tashko, Tefta — 495.
 Tepelena, Ali Pashë — 154.
 Tito, Josip Broz — 345, 347, 348, 349, 350, 351, 352, 353, 355, 356, 358, 443, 448, 449, 450, 451.
 Todri, Dhaskal — 494.
 Topulli, Çerçiz — 322.

V

Veqilharxhi, Naum — 271.
 Verlen, Pol — 275, 467-488.

Virgjili — 481.
 Vreto, Jani — 271.

X

Xoxe, Koçi — 174-175, 348.

XII

Xhani, Mustafa (Baba Faja) — 318.
 Xhavella, Foto — 154.
 Xhioto di Bondone — 470.
 Xhuvani, Aleksandër — 271, 272.

Z

Zahariadhis, Niko — 154-155.
 Zengo, Vangjel — 414.
 Zeqo, Moikom — 471-472, 473-474, 475, 476-477, 478-479, 480, 481-482, 483, 496.

ZII

Zhivkov, Todor — 354.

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

- Afganistan — 451.
Afrikë — 152.
Akademia e Shkencave e
RPSSH — 128, 140, 174, 272.
Alipostivan (Përmet) — 311,
313.
Amerika Latine — 134, 152.
Ansambl i Këngëve e i Valle-
ve Popullore i RPSSH — 152.
Arabia Saudite — 150, 151.
Araguaia (Brazil) — 145-146.
Athinë — 153-154.
Azi — 338.

B

- Bahçallëk (Shkodër) — 383-
-384, 385.
Ballkan — 155, 347, 351, 352,
482.
Barbullush (Shkodër) — 385.
«Bashkimi» (gazeta ~) — 10.
«Beni ecën vetë» (filmi ~) —
495.
Berat — 194, 417.

- Brazil — 133, 135, 146.
Britania e Madhe — 270, 444,
446.
Bullgari — 354, 359
Burrel — 397.
Bushat (Shkodër) — 383.

C

- Cakran (Tier) — 157, 160, 161,
162, 164-165, 291.
Cerje (Përmet) — 310, 311.

C

- Çekoslovakia — 359-360.

D

- Dajç (Shkodër) — 383.
Dalmaci — 468.
Dëshnicë (Përmet) — 311-312.
Dibër — 410, 435-436, 437, 438,
439.
Divjakë (Lushnjë) — 164.

«Dollia e dasmës sime» (filmi~) — 492-493.

Drejtoria e Përgjithshme e Naftës dhe e Gazit, Fier — 160, 238, 393.

«Drita» (gazeta ~) — 10, 31.
Dropulli (fusha ~, Gjirokastër) — 185.

E

Eboasan — 184, 327.

«Eneida» (poema~, Virgjili) — 481.

Evropë — 134, 152, 333, 339, 341, 342, 347, 352, 428.

F

Fabrika e Përpunimit të Frutave dhe të Pijeve e Këlcyrës, Përmet — 316.

Fan (Mirditë) — 421-422.

Fier — 273, 321.

Finiq (Sarandë) — 469.

Frakull (Fier) — 162.

Francë — 275, 354, 441, 446, 491-492.

G

Greqi — 114, 152-153, 154, 116, 417, 469, 482.

GJ

«Gjeneral gramafoni» (filmi~) — 30, 31, 32, 323, 493.

Gjermania Perëndimore (RF e Gjermanisë) — 446.

Gjirokastër — 153, 309-310, 320, 321, 322, 335, 492, 405, 410, 417, 441, 475.

H

Hidrocentrali i Fierzës [Hidrocentrali «Drita e Partisë»] — 138-139, 176.

Hidrocentrali i Komanit [Hidrocentrali «Enver Hoxha»] — 139.

I

«Imperializmi dhe revolucioni» (Enver Hoxha, vepra~) — 148.

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë — 272.

Instituti i Kërkimeve Bujqësore, Lushnjë — 455-456.

Instituti i Lartë Bujqësor, Tiranë, — 116, 117, 118, 120-121, 122, 127, 128.

Instituti i Naftës e i Gazit, Fier — 25, 56, 89, 91, 92, 93-94, 95, 96-97, 103, 130, 160,

162, 163, 165, 166-168, 170,
171-172, 285, 287, 292, 391,
392, 393.

Instituti i Studimeve dhe i
Projektiveve Mekanike, Tira-
në — 36, 37, 71, 283.

Instituti i Studimeve dhe i
Projektiveve Nr. 1, Tiranë —
393-394.

Instituti i Studimeve dhe i
Projektiveve të Metalurgjisë,
Elbasan — 325-326.

Irlandë — 270.

Itali — 153.

J

Janinë (Greqi) — 153, 154.

K

Këlcyrë (Përmet) — 317.

Kinostudioja «Shqipëria e
Re», Tiranë — 468.

KNER (Këshilli i Ndhmës
Ekonomike Reciproke) — 340,
343,

Kolonjë — 312, 421.

Kombinati i trikotazheve
«Drapër e çekan», Korçë —
401.

Kombinati metalurgjik «Çeli-
ku i Partisë», Elbasan — 137,
261, 324, 326, 327, 328, 329,
396-397.

«Koncert në vitin 1936» (fil-
mi ~) — 495.

Kooperativa Bujqësore e Ba-
shkuar e Donofrosës, Berat —
194.

Kooperativa Bujqësore e Tipit
të Lartë e Plasës [Ndërmarrja
bujqësore «Enver Hoxha»],
Korçë — 189, 436.

Korçë, 184, 185, 192, 194-195,
310, 436, 441, 442, 470.

Kosovë — 155.

«Krevati i perandorit» (poe-
ma ~, Dritëro Agolli) — 419.
Kroaci — 358.

Ksamil (Sarandë) — 421.

Kukës — 176, 368, 402.

L

Leskovik — 421.

Lezhë — 386-388, 407, 417.

Lidhja e Shkrimtarëve dhe e
Artistëve të Shqipërisë — 31.

Lindja e Mesme — 150-151.

Lufta e Dytë Botërore (1939-
-1945) — 154, 355, 444.

«Luftëtar!» (gazeta ~) — 10,
30, 31.

«Lulëkuqet mbi mure» (fil-
mi ~) — 495.

Lunxhëri (Gjirokastër) — 310.

Lushnjë — 5, 265, 268, 456, 457,
495.

M

- Mali Athos (Greqi) — 416, 469.
 Mali i Zi — 354.
 Mallakastër (Fier) — 107.
 Maqedoni — 155, 351, 359.
 Marsejë (Francë) — 354.
 Mat — 410.
 «Mësuesi» (gazeta~) — 269.
 Mikenë (Greqi) — 483.
 Mirditë — 410, 421.
 More (Greqi) — 153.
 Moskë — 154.
 Myzeqe — 130, 185, 455.

N

- NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verlor) — 343, 351, 352, 359, 449.
 Ndërmarrja Bujqësore e Malit, Korçë — 181.
 Ndërmarrja bujqësore «Gjergj Dimitrov», Tiranë — 395.
 Ndërmarrja Gjeologjike e Shpim-Kërkimit, Fier — 162

O

- Odrriçan (Përmet) — 310, 311, 314.
 Ofiçina e Automjeteve, Shkodër — 400.

P

- Pagri (Përmet) — 311, 318.
 Pakistan — 451.
 Palestinë — 151.
 «Pararoja» (gazeta~) — 410.
 Pentar (Shkodër) — 384.
 Peshkopi — 402.
 Përmet — 31, 309-313, 314, 316-320, 321.
 «Për pastërtinë e gjuhës» (artikull~, E. Çabej) — 269.
 Pukë — 368, 410.

R

- Raban (Përmet) — 311.
 Radiotelevizioni Shqiptar — 150, 468, 495.
 Rumanë — 343, 352.

S

- Sarandë — 315, 402, 405.
 SEATO (Organizata e Traktatit për Azinë Juglindore) — 449.
 Serbi — 351, 354.
 Spanjë — 114.
 Stamboll — 416, 469, 491.
 «Studime gjuhësore» (libri~, A Xhuvani) — 272.

SH

- Shkodër — 385, 405, 407, 409, 411.

T

Tempulli i Dodonës (Greqi) — 482.

«Te rrapl në Mashkullorë» (kënga~) — 322.

Tiranë — 245, 321, 407, 415, 424.

«Tomka dhe shokët e tij» (filmi~) — 495.

Traktati i mosulmimit ndërmjet Bashkimit Sovjetik e Gjermanisë (gusht 1939) — 375.

Traktati i Varshavës — 343, 351, 352, 359, 448.

Tropojë — 119, 410.

Turqi — 468, 469.

U

UDB (Drejtoria e Sigurimit Shtetëror në Jugosllavi) — 350.

«Udha e shkronjave» (filmi~) — 494.

Universiteti i Romës — 273, 277.

Universiteti Shtetëror i Tiranës [Universiteti i Tiranës

«Enver Hoxha»] — 125, 127, 128, 175-176.

Uzina «Dinamo», Tiranë — 283.

Uzina e Ferrokromit, Burrel — 137, 262.

Uzina Mekanike e Naftës, Patos — 281, 282, 283.

Uzina Mekanike e Qytetit Stalin — 281, 282.

V

«Vajzat me kordele të kuqe» (filmi~) — 495.

«Vatra» (shoqëria) — 272, 276, 477.

««Vetadministrimi» jugosllav — teori dhe praktikë kapitaliste» (E. Hoxha, vepra~) — 349.

Vlorë — 405, 440-442.

Z

Zagori (Gjirokastrë) — 317.

«Zëri i popullit» (gazeta~) — 10, 13, 75, 77, 410.

LE N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 70-TË	V—IX
TË INKURAJOJMË NJERËZIT KUR PUNËT SIIKOJNË MIRË, PËR TË MOS FSHEHIM TË ME- TAT, TË MOS LUSTROJMË GJËRAT — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (7 mars 1979)	1—9
SHTYPI ËSHTË NJË FORCË ORGANIZUESE E MO- BILIZUESE PËR ZBATIMIN E DETYRAVE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (9 mars 1979)	10—20
VËMENDJA E KOMISARIATIT TË NAFTAËS TË PËRQENDROHET NË PROBLEMET KYÇ — Nga bi- seda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (12 mars 1979)	21—32
PA SHKENCË, PA STUDIME TË THELLA SHKEN- CORE NUK MUND TË REVOLUCIONARIZOHET PRODHIMI — Nga biseda në takimin ditor të sekreta- rëve të KQ të PPSH (13 mars 1979)	33—47
PUNA ME NJERËZIT ËSHTË THIELBËSORE NË ÇDO PROBLEM — Nga biseda në takimin ditor të se- kretarëve të KQ të PPSH (16 mars 1979)	48—59

- KOMISARIATI DO TË VEPROJË PA SPOSTUAR ORGANET PËRKATËSE TË PARTISË E TË SHTE-TIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (19 mars 1979) 60—74
- SHTYPI TË JETË MË DINAMIK, MË KONKRET, QË T'I MOBILIZOJË MASAT, T'I NXITË E T'I EDUKOJË ATO — Nga biseda me një nga instruk-torët e sektorit të shtypit në aparatin e KQ të PPSH (22 mars 1979) 75—84
- KUADROT ME ARSIM TË LARTË TË PËRGATI-TEN MIRE SHKENCËRISHT DHE TË SPECIALI-ZOHEN MË TEJ — Shënime (22 mars 1979) 85—87
- TË MBËSHTETEMI NË STUDIMET GJEOLGJIKE PËR TË PËRCAKTUAR DREJT PROPORCIONET E SHPIMEVE — Nga biseda në takim in ditor të se-kretarëve të KQ të PPSH (27 mars 1979) 88—105
- TË GJEJMË RRUGË TË REJA PËR SHTIMIN E PRODHIIMIT TË YNDYRNAVE — Diskutim në mble-dhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (28 mars 1979) 106—115
- SHKOLLA KA PËR DETYRË TË RRITE VAZHDI-MISIIT NIVELIN SHKENCOR TË MËSIMIT — Dis-kutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (28 mars 1979) 116—123
- PROPORCIONET NË SHPIME KANË RËNDËSI TË JASHTËZAKONSHME — Nga diskutimi në mbledh-jen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (28 mars 1979). 129—131
- TË JEMI TË MATUR NË GJYKIME E VEPRIME DHE GJITHMONË TË ECIM PËRPARA — Nga bi-scda me një delegacion të Partisë Komuniste të Bra-zilit (28 mars 1979) 132—136

PËRMIRËSIMI I GJENDJES NË SEKTORIN E NAFTËS KËRKON RITËM E STIL REVOLUCIONAR, ORGANIZIM E DREJTIM SHKENCOR — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (29 mars 1979)	157—178
KUR MERRRËN VENDIME DHE ZBATOHEN ATO, PUNËT NUK I LIHEN SPONTANEITETIT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (30 mars 1979)	179—195
FRYMËN E DISIPLINËS USHTARAKE TA FUTIM EDHE NË JETËN CIVILE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (30 mars 1979)	196—208
SUKSESI NË STËRVITJE VARET NGA ORGANIZIMI I MIRË DHE NGA ZHVILLIMI SI DUHET I TYRE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (3 prill 1979)	209—241
PUNA E PARTISË, ORGANIZIMI DHE KONTROLI T'I BËJNË NJERËZIT TË NDËRGJEGJSHËM PËR REALIZIMIN E DETYRAVE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (4 prill 1979)	242—259
TË MËSOJMË MË SHUMË E VAZIHDIMISIT NGA NJËRI-TJETRI — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (5 prill 1979)	260—278
PA KËRKESE LLOGARIE, PLANI NË NAFTË NUK REALIZOHET NË KOHËN E DUIIUR — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (9 prill 1979)	279—293
PUNA E PARTISË TË JETË NË NIVELIN E KËRKESAVE TË KOHËS — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (11 prill 1979)	294—308

NJERËZ TË RILINDUR NË PËRMETIN E KOHËS SË PARTISË — Nga një bisedë me shokun Simon Stefani (12 prill 1979)	309—323
ASKUSH NUK KA TË DREJTË TË VENDOSË PER- SONALISHT PËR KUADRIN — Nga biseda në takimi- min ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (14 prill 1979)	324—337
RRETH GJENDJES NË VENDET REVIZIONISTE — Shënime (15 prill 1979)	338—360
NË BAZË TË SHKOJMË TË PËRGATITUR, DUKE NJOHUR MIRË PROBLEMET QË E SHIQUETËSOJ- NË ATË — Nga biseda në takimin ditor të sekreta- rëve të KQ të PPSH (17 prill 1979)	361—379
NË ZONAT E DËMTUARA NGA TËRMETI NDËR- TIMET TË BËHEN MË TË FORTA E MË TË BU- KURA — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (18 prill 1979)	380—408
SHTYPI TË PROPAGANDOJË INICIATIVAT REVO- LUCIONARE NË NDIHMË TË ZONAVE TË DËM- TUARA NGA TËRMETI — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (19 prill 1979) ...	407—411
T'I RUAJMË DIE T'I VLERËSOJMË OBJEKTET E KULTURËS SONË — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (23 prill 1979)	412—425
TREGTI ME INTERES RECIPROK DHE PA NDËR- HYRJE NË PUNËT E BRENDSHME — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 prill 1979)	426—434

PO TË KUPTOHET IDEOLOGJIKISHT RËNDËSIA E PRONËS SË PËRBASHKËT, EDHE PUNA DO TË ORGANIZOHET NË MËNYRË MË RENTABEL — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 prill 1979)	435—439
OBJEKTET ME VLERË HISTORIKE TË RUHEN DHE TË RESTAUROHEN — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 prill 1979) ...	440—442
TEORIA E «BOTËS SË PAANGAZHUAR» PO FALI- MENTON — Shënime (26 prill 1979)	443—452
DETYRAT RËALIZOHEN DUKE RRENJOSUR KON- CEPTE SOCIALISTE TE NJERËZIT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 prill 1979)	453—465
VEPRAT QË I KANË THEMELET NË TABANIN E POPULLIT NUK SHILYHEN KURRË — Nga biseda në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 prill 1979)	466—496
Treguesi i lëndës	499
Treguesi i emrave	513
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera	517